
بسم الله الرحمن الرحیم

Eruditi, juristi dhe komentuesi

NASER MEKARIM SHIRAZI

KOMENTIM I PËRSOSUR I KUR'ANIT

(Xhuzi i njëzetegjashtë)

Nga ajeti 33 i sures "El Xhâthije" deri te ajeti 32 i sures "Edh Dhârijât"

Titulli: ***KOMENTIM I PËRSOSUR I KUR'ANIT***

(Xhuzi i njëzetegjashtë)

Autori: ***Eruditi, juristi dhe komentuesi***

Naser Mekarim SHIRAZI

Recensent: ***Vullnet MERJA***

E përktheu nga arabishtja:***Edmond ABAZI & Vullnet MERJA***

E redaktoi: **Jerida KULLA**

Korrektura teknike: ***Vjollca KARAJ***

Përkujdesja grafike: ***Sabrie FEZA***

Kapaku: ***Sabrie FEZA***

Botoi: ***Shoqata "FLLADI"***

Copyright: ***Shoqata "FLLADI"***

Shtypshkronja e shtëpisë botuese ***LILO***

Ajetet 33 – 37

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

وَبَدَا لَهُمْ سَيِّـاتُ مَا عَمِلُواْ وَحَاقَ بِهِم مَّا كَانُواْ بِهِۦ يَسْتَهْزِءُونَ٣٣ وَقِيلَ ٱلْيَوْمَ نَنسَىٰكُمْ كَمَا نَسِيتُمْ لِقَآءَ يَوْمِكُمْ هَٰذَا وَمَأْوَىٰكُمُ ٱلنَّارُ وَمَا لَكُم مِّن نَّٰصِرِينَ٣٤ ذَٰلِكُم بِأَنَّكُمُ ٱتَّخَذْتُمْ ءَايَٰتِ ٱللَّهِ هُزُوًا وَغَرَّتْكُمُ ٱلْحَيَوٰةُ ٱلدُّنْيَا ۚ فَٱلْيَوْمَ لَا يُخْرَجُونَ مِنْهَا وَلَا هُمْ يُسْتَعْتَبُونَ٣٥ فَلِلَّهِ ٱلْحَمْدُ رَبِّ ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَرَبِّ ٱلْأَرْضِ رَبِّ ٱلْعَٰلَمِينَ٣٦ وَلَهُ ٱلْكِبْرِيَآءُ فِى ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَٱلْأَرْضِ ۖ وَهُوَ ٱلْعَزِيزُ ٱلْحَكِيمُ٣٧

Me Emrin e All'llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit!

"Natyrisht, atyre do t'u dalin në shesh të këqijat që kanë bërë e do t'u bjerë kokës ajo me të cilën talleshin."

"Pastaj do t'u thuhet: 'Ne sot po ju braktisim në harresë, ashtu siç e keni harruar ju takimin e kësaj dite. Vendqëndrimi juaj është Zjarri dhe për ju nuk ka kurrfarë ndihmësi.'"

"'Ky dënim ju erdhi ngaqë i përqeshnit Shpalljet e All'llahut dhe u mashtruat nga jeta e kësaj bote'. Atë ditë ata nuk do të nxirren nga zjarri e nuk do të pranohet prej tyre asnjë arsyetim."

"Falënderimi i përket vetëm All'llahut, Zotit të qiejve dhe Zotit të Tokës - Zotit të gjithësisë."

"Atij i përket e tërë madhështia në qiej dhe në Tokë. Ai është i Plotfuqishmi dhe i Urti."

Komentimi

Atë ditë do të duken hapur të këqijat

Ajeti 33 flet për shpërblimin dhe dënimin e tyre. Ai shpërblim nuk u ngjason ndëshkimeve të gjykatave të kësaj dynjaje. Ajeti thotë: **"Natyrisht, atyre do t'u dalin në shesh të këqijat që kanë bërë..."**. Pra, veprat e shëmtuara dhe të këqija, do të materializohen përpara syve të tyre. Edhe shoqëruesve të tyre të përhershëm, jo vetëm që do t'u bëhet e qartë, por do të ndihen keq nga prania e tyre, madje edhe do të ndëshkohen pse janë shoqëruar me ta: **"...do t'u bjerë kokës ajo me të cilën talleshin."**.[1]

[1] Fjala *"haaka"* rrjedh nga fjala *"haukun"*. Në zanafillë kuptimi i saj është: ardhje, mbërritje, zbritje, goditje dhe përfshirje. Disa kanë thënë se origjina e saj është *"hakkun"*, me kuptimin e vërtetimit. Shkronja "*kaf*" është zëvendësuar e para në shkronjën *"vav"* e më pas në *"elif"*.

Dhimbja e tyre më e madhe është mënyra se si All'llahu, Mëshiruesi, Mëshirëbërësi u flet atyre. All'llahu i Madhërishëm u thotë: **"Ne sot po ju braktisim në harresë, ashtu siç e keni harruar ju takimin e kësaj dite."**.

Kjo mënyrë të shprehuri është përmendur shpesh në forma të ndryshme në Kur'an si në ajetin e 51 të sures "El A'raf": **"Sot, pra, Ne i harrojmë ata, sikurse e patën harruar takimin e Kësaj Dite."**.

Ky kuptim është përmendur, gjithashtu, me një mënyrë tjetër, në ajetin 14 të sures "Elif lam mim es sexhde."

Nuk ka dyshim se harresa nuk ka kuptim në lidhje me All'llahun e Madhëruar, dituria e të cilit ka përfshirë çdo gjë në botën e ekzistencës. Mirëpo ajo këtu është një metaforë që lidhet me përbuzjen, talljen e njeriut kriminel e mëkatar dhe mosinteresimin e tij për të. Kjo mënyrë të shprehuri vihet re edhe në bisedat tona të përditshme, kur themi: "Harroje filanin, se është i pabesë", domethënë trajtoje atë si një njeri të harruar, mos i jep atij as dashuri, as dhembshuri e as respekt, lëre ta humbin brengat e tij e mos shko kurrë tek ai.

Më pas, kjo mënyrë të shprehuri ka një kuptim tjetër për çështjen e trupëzimit të veprave dhe përshtatjes së krimit e dënimit, sepse harresa e tyre në dynja, për Ditën e Kiametit, i shtyn ata ta harrojnë All'llahun. Sa fatkeqësi e madhe është të harrosh All'llahun, të Mëshirshmin, Mëshirëbërësin për çdo individ! Sa fatkeqësi e madhe është ndalimi nga Ai, nga të gjitha mirësitë dhe begatitë e Tij!

Për harresën, komentuesit kanë përmendur mendime të ndryshme. Këto komentime përmblidhen në kuptimin e përmendur më lart, prandaj nuk e shohim të nevojshme që të përsëriten.

Me harresën duhet të kuptohet harrimi i takimit të Ditës së Kiametit, harresa e të gjitha çështjeve dhe ngjarjeve që ndodhin Atë Ditë, si llogaridhënia apo të tjera gjëra, të cilat ata i mohonin.

Supozohet, gjithashtu, që qëllimi mund të jetë harresa e takimit të All'llahut të Madhëruar Atë Ditë, sepse Dita e Kiametit, në Kur'anin e lavdishëm, është përshkruar si Dita e takimit me All'llahun dhe dëshmitarët e padukshëm.

Ajeti vazhdon: **"Vendqëndrimi juaj është Zjarri...".**

Mos mendoni se mund t'ju ndihmojë dikush: **"..për ju nuk ka kurrfarë ndihmësi."**.

Ju i meritoni këto përjetime: **"Ky dënim ju erdhi ngaqë i përqeshnit Shpalljet e All'llahut dhe u mashtruat nga jeta e kësaj bote."**.

Mendjemadhësia dhe tallja, zakonisht, nuk ndahen nga njëra–tjetra, sepse njerëzit kryeneçë dhe mendjemëdhenj i shikojnë të tjerët me syrin e përbuzjes, tallen me ta, i përqeshin. Sjelljeje të tilla bëhen burimi i kryeneçësisë në këtë botë. Kryeneçët dhe mendjemëdhenjtë nuk i japin rëndësi thirrjes së të Dërguarve të All'llahut.

Në këtë ajet përsëritet ajo që u përmend në ajetin e kaluar dhe e mbështet atë, kur thotë: **"Atë ditë ata nuk do të nxirren nga**

zjarri e nuk do të pranohet prej tyre asnjë arsyetim.".[1] Në ajetin më lart flitej për vendqëndrimin e tyre të pandryshuar, kurse këtu fjala është për mosdaljen e tyre nga zjarri dhe mospasjen e asnjë ndihmëtari. Gjithashtu, prej tyre nuk pranohet pendimi, prandaj për ata nuk ka asnjë rrugë shpëtimi.

Në përfundim të kësaj sureje dhe për ta plotësuar diskutimin e Teuhidit dhe të Ahiretit, nga të cilët përbëhej pjesa më e madhe e komentimeve të kësaj sureje, dy ajetet e fundit sqarojnë qartë unikalitetin e hyjnisë së All'llahut, madhështinë, fuqinë, mençurinë e Tij. Këtu përmenden pesë cilësi prej cilësive të All'llahut të Madhëruar: **"Falënderimi i përket vetëm All'llahut, Zotit të qiejve dhe Zotit të Tokës - Zotit të gjithësisë."**.

Fjala *"err Rrabbu"* përdoret për të treguar sunduesit, kontrolluesit, gjykatësit dhe reformuesit. Ky kontekst qartëson se çdo e mirë dhe begati vjen nga All'llahu i Madhëruar, prandaj të gjitha falënderimet dhe lavdërimet janë për Të, deri edhe lavdërimi për Kur'anin, edhe qartësia e shikimit të syve, edhe ëmbëlsia e flladit dhe bukuria e yjeve, janë falënderim e lavdërim për Të, sepse të gjitha burojnë nga Ai dhe zhvillohen me mirësinë dhe kujdesin e Tij.

Tërheq vëmendjen fakti se ajeti, një herë thotë Zoti i qiejve dhe herë tjetër, Zoti i Tokës dhe, së treti, Zoti i botës së ekzistencës dhe i botëve. Këtë e bën për të sfiduar dhe për të mos miratuar besimin në zota të ndryshëm. I fton të gjithë në

[1] Për kuptimin e fjalës *"jesta'tebune"*, kemi dhënë sqarimin e nevojshëm në fundin e ajetit 57 të sures "Err Rrum".

Njehsimin e All'llahut të Madhëruar, në besimin, në njëshmërinë e Tij.

Pas përshkrimit dhe falënderimit të All'llahut të Madhëruar, ajeti shton cilësinë e tretë: **"Atij i përket e tërë madhështia në qiej dhe në Tokë. Ai është i Plotfuqishmi dhe i Urti."**, sepse gjurmët e madhështisë së Tij janë të dukshme në qiellin pa kufi dhe në çdo cep të Botës.

Në ajetin e kaluar u diskutua për All'llahun e Madhëruar, për Sunduesin mbi çdo gjë, për Kontrolluesin e gjithçkaje, kurse këtu fjala është për madhështinë e Tij, që konkretizohet në krijimin e qiellit dhe të Tokës. Po të shohim me kujdes, do ta konstatojmë këtë të vërtetë.

Së fundi, ajeti, në përshkrimin e katërt dhe të pestë, thotë: **"Ai është i Plotfuqishmi dhe i Urti."**.

Me këtë plotësohet seria e diturisë, e fuqisë, e madhështisë, e hyjnisë, e të qenit Zot dhe të qenit i falënderuar, të cilat janë nga seritë më të rëndësishme të cilësive të All'llahut dhe Emrave të Tij të bukur.

Mbase ajeti, edhe një herë, përpiqet të theksojë se All'llahut i takon falënderimi, prandaj lavdërojeni Atë. Ai është Zoti, prandaj falënderojeni Atë. Ai është Lartmadhëria, prandaj madhërojeni Atë, Ai është i Forti, i Mençuri, prandaj bindjuni Atij!

Me përshkrimin e All'llahut të Madhëruar, si i Forti dhe i Urti, përfundon surja "El Xhathije", ashtu siç filloi, me po këto dy cilësi. Gjithë përmbajta e saj dëshmon për fuqinë dhe mençurinë e lartë të All'llahut të Madhëruar.

O All'llah, ne betohemi për ty, për Madhështinë Tënde, për Shenjtërinë Tënde, për Fuqinë e urtësisë Tënde, që të na i forcosh këmbët tona në rrugën e bindjes së urdhrave të Tua!

O All'llah, çdo falënderim dhe lavd i bëjmë vetëm me suksesin Tënd, sepse çdo gjë që kemi, është nga begatitë dhe mirësitë e Tua!

O All'llah, bëji të përhershme këto mirësi dhe na i shto ato neve!

O All'llahu ynë, ne jemi të mbytur në detin e mirësisë dhe të bujarisë Tënde, prandaj, o All'llah, na jep mundësinë të të falënderojmë Ty!

Pranoje këtë lutje, o All'llahu i Gjithësisë!

Fundi i sures "El Xhathije"

SURE "EL AHKÂF"

Zbritur në Mekë , 35 vargje

Përmbajtja e sures

Kjo sure është prej sureve mekase, edhe pse disa komentues kanë thënë se një pjesë e ajeteve të saj ka zbritur në Medine. Ne do t'i komentojmë dhe do t'i shpjegojmë këto ajete, në dashtë All'llahu. Meqenëse kjo sure zbriti në kohë të vështira, kur idhujtaria përballej me thirrjen në Teuhid dhe Ahiret dhe me çështjet bazë të Islamit, pa dyshim që kjo sure flet rreth këtyre çështjeve.

Mund të themi shkurtimisht se kjo sure ndjek këto qëllime:

1- Sqarimi i Madhështisë së All'llahut.
2- Luftimi i prerë i të gjitha llojeve të idhujtarisë dhe paganizmit.
3- Orientimi i njerëzve drejt Ahiretit dhe Gjykatës së Drejtësisë së All'llahut.
4- Paralajmërimi i politeistëve dhe kriminelëve, duke ua bërë të qartë historinë e popullit të Adit, që banonte në tokën e El Ahkafit. Prej tyre është marrë emri i kësaj sureje.
5- Tregimi për fuqinë e thirrjes së Profetit të Islamit, Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhembi familjen e tij!)*. Tregimi i vlerave përgjithësuese të saj, të cilat i tejkalojnë edhe kufijtë e njeriut. Pra, ajo përfshin edhe llojin e xhindeve.
6- Zgjimi i interesit të besimtarëve, frikësimi i jobesimtarëve dhe kërcënimi i tyre, gjenerimi i nxitjeve të frikës dhe shpresës.
7- Thirrja drejtuar Profetit të Islamit, Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhembi familjen e tij!)*,

për durim dhe të qëndrojë i fortë në Rrugën e Drejtë, si dhe të ndjekë rrugën e Profetëve të kaluar.

Mirësia e leximit të kësaj sureje

Në një hadith nga Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhembi familjen e tij!)*, për mirësinë e kësaj sureje, thuhet: "*Atij që lexon suren "El Ahkaf", i jepet një shpërblim sa dhjetë herë numri i kokrrizave të rërës në dynja, atij i fshihen dhjetë të këqija e ngrihet lart në gradë dhjetë shkallë.*".[1]

Meqenëse fjala "*el ahkaf*" është shumësi i fjalës "*hikfun*" dhe tregon "*dunat ranore*", të cilat mblidhen e formohen në forma të ndryshme nga erërat e shkretëtirës, me këtë emër emërtohej toka e popullit të Adit, sepse edhe ajo ishte e shtruar në këtë formë.

Në një hadith tjetër nga Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* thuhet: "*Kush lexon çdo natë, ose çdo ditë të xhuma suren "El Ahkaf", All'llahu nuk do ta godasë atë me ndonjë frikë në jetën e dynjasë dhe do ta garantojë atë nga frika e Ditës së Kiametit, nëse do.*".[2]

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", fillimi i sures "El Ahkaf".
[2] Tefsiri "Mexhmaul Bejan" dhe tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, f. 7, fillimi i sures "El Ahkaf".

Ajetet 1 – 3

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

حمٓ١ تَنزِيلُ ٱلْكِتَٰبِ مِنَ ٱللَّهِ ٱلْعَزِيزِ ٱلْحَكِيمِ٢ مَا خَلَقْنَا ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَٱلْأَرْضَ وَمَا بَيْنَهُمَآ إِلَّا بِٱلْحَقِّ وَأَجَلٍ مُّسَمًّىۚ وَٱلَّذِينَ كَفَرُواْ عَمَّآ أُنذِرُواْ مُعْرِضُونَ٣

Me Emrin e All'llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit!

"Hâ, Mîm."

"Ky Libër është shpallur prej All'llahut, të Plotfuqishmit dhe të Urtit."

"Ne i kemi krijuar qiejt dhe Tokën dhe çfarë gjendet midis tyre me qëllim të plotë dhe me afat të caktuar. E megjithatë, mohuesit shmangen nga ajo që u është paralajmëruar."

Komentim

Kjo botë është ndërtuar mbi baza të vërteta

Kjo është surja e fundit, që fillon me "Ha, Mim".

Kemi pasur shumë diskutime për shkronjat e ndara, sidomos për (Ha, Mim) në fillimet e sureve "El Bekare", "Ali Imran" dhe suret e kaluara që fillojnë me "Ha Mim", prandaj nuk është nevoja t'i përsërisim këtu. Po mjaftohemi, duke thënë se këto fjali që tronditin dhe vënë në lëvizje ndërgjegjen, Kur'ani i përfshin midis dy skajeve të tij. Këto fjali janë të përbëra nga shkronjat e lehta të alfabetit, prej 'elifit', prej 'be-së', prej 'ha-së' dhe prej 'mimit' e të tjera si këto. Është argument i mjaftueshëm për të treguar Madhështinë e All'llahut, i Cili ka realizuar këtë kompleksitet madhështor prej këtyre fjalëve të thjeshta. Po të jemi vëzhgues të kujdesshëm, do të vëmë re se në atë fjali ka mjaft sekrete, përfshirë edhe Kiametin.

Mbase ky ka qenë shkaku që ajeti të shtojë menjëherë: **"Ky Libër është shpallur prej All'llahut, të Plotfuqishmit dhe të Urtit."**.

Me të njëjtën fjalë fillojnë të tri suret që fillojnë me "Ha Mim". Ato janë: "El Mu'minu", "El Xhathije" dhe "El Ahkaf."

Nuk është e nevojshme të tregojmë nevojën e fuqisë që nuk mposhtet dhe të mençurisë së pakufishme të All'llahut të Madhëruar, që të zbritet ky Libër. Më pas, ajetet u shndërruan nga libër i regjistrimit në librin e krijimit. Ajeti flet për

madhështinë e qiejve dhe të Tokës dhe tregon se të dyja janë të vërteta.

Ajeti thotë: **"Ne i kemi krijuar qiejt dhe Tokën dhe çfarë gjendet midis tyre me qëllim të plotë dhe me afat të caktuar."**, prandaj nuk gjendet në Librin e qiellit një fjalë që kundërshton të vërtetën. Në të gjithë botën e krijimit të All'llahut nuk do të gjendet asgjë që nuk është e bashkërenduar, që nuk harmonizohet, që nuk është e vërtetë, sepse gjithçka është e mirorganizuar dhe e shoqëruar me të vërtetën.

Mirëpo, ashtu siç ka një fillim për çdo gjë, edhe për Gjithësinë ka një fillim dhe një fund. Për këtë ajeti shton: **"me afat të caktuar"**.

Pra, kur të vijë afati, do të shkatërrohet edhe dynjaja dhe çfarë ka në të. Përderisa kjo botë është e shoqëruar, e lidhur me të drejtën dhe ec sipas udhërrëfyesit të saj, sipas një qëllimi të caktuar, është normale që do të ekzistojë edhe një Botë Tjetër, në të cilën kërkohen veprat dhe lajmërohen rezultatet. Ekzistenca e kësaj bote të vërtetë, reale, është vetë një argument për ekzistencën e Ahiretit, në të kundërt, do të ishte lojë e kotë, pa asnjë dobi dhe, në të njëjtën kohë, do të shoqërohej me padrejtësi dhe shkatërrime.

Mirëpo, meqenëse Kur'ani është i vërtetë, edhe krijimi i botës është i vërtetë, gjithashtu: **"E megjithatë, mohuesit shmangen nga ajo që u është paralajmëruar."**.

Pasi ajetet kur'anore i kërcënojnë dhe i paralajmërojnë ata në mënyrë të vazhdueshme, pa ndërprerje, i paralajmërojnë se edhe Gjykata e Madhe është përpara tyre. Nga ana tjetër, pa

dyshim se sistemi i krijimit, në mënyrë të përpiktë, tregon vetvetiu se në krijim ka llogari dhe rregull, edhe pse këta ishin të pavëmendshëm.

Fjala *"mu'ridine"* tregon se këta, po të shikonin argumentet e krijimit dhe regjistrimin e veprave, atëherë do t'i kuptonin të vërtetat. Por ata vazhdimisht kundërshtuan dhe u larguan nga e vërteta, me qëllim që të mos ndryshonte tradita e tyre, të mos mbeteshin pa plotësuar dëshirat dhe parapëlqimet e tyre, si dhe të vazhdonin të ndiqnin pasionet e tyre.

Ajetet 4 – 6

قُلْ أَرَءَيْتُم مَّا تَدْعُونَ مِن دُونِ ٱللَّهِ أَرُونِى مَاذَا خَلَقُواْ مِنَ ٱلْأَرْضِ أَمْ لَهُمْ شِرْكٌ فِى ٱلسَّمَٰوَٰتِ ٱئْتُونِى بِكِتَٰبٍ مِّن قَبْلِ هَٰذَآ أَوْ أَثَٰرَةٍ مِّنْ عِلْمٍ إِن كُنتُمْ صَٰدِقِينَ۝ وَمَنْ أَضَلُّ مِمَّن يَدْعُواْ مِن دُونِ ٱللَّهِ مَن لَّا يَسْتَجِيبُ لَهُۥٓ إِلَىٰ يَوْمِ ٱلْقِيَٰمَةِ وَهُمْ عَن دُعَآئِهِمْ غَٰفِلُونَ۝ وَإِذَا حُشِرَ ٱلنَّاسُ كَانُواْ لَهُمْ أَعْدَآءً وَكَانُواْ بِعِبَادَتِهِمْ كَٰفِرِينَ۝

“Thuaju: ‘A i shihni ata që i adhuroni në vend të All’llahut? Më tregoni, çfarë pjese të Tokës kanë krijuar ata?! Mos vallë kanë ndonjë pjesë në krijimin e qiejve?! Më sillni një libër të shpallur para këtij (Kur’anit) **ose ndonjë gjurmë tjetër të dijes, nëse flisni të vërtetën!”**

“Kush është më i humbur se ai, i cili, në vend All’llahut, u lutet atyre që nuk mund t’u përgjigjen deri në Ditën e Kiametit e që janë krejt të pavetëdijshëm ndaj lutjes së tyre?!”

“Kur të tubohen njerëzit (në Ditën e Gjykimit)**, idhujt do të jenë armiq të tyre dhe do ta mohojnë adhurimin e tyre.”**

Komentim

Njerëzit më të humbur

Në ajetet e kaluara është folur për krijimin e qiejve dhe të Tokës dhe se të gjitha këto janë vepër e All'llahut, të Fuqishmit, të Urtit. Këto treguan, në mënyrë të padiskutueshme, që në Gjithësi nuk ka tjetër zot përveç Tij dhe Ai është Krijuesi dhe Kontrolluesi i Botës. Këto dy cilësi janë bashkuar në Vetën e Shenjtë.

Këto ajete të plotësuara, i thonë Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: **"Thuaju: 'A i shihni ata që i adhuroni në vend të All'llahut? Më tregoni, çfarë pjese të Tokës kanë krijuar ata?! Mos vallë kanë ndonjë pjesë në krijimin e qiejve?!'"**.

Nëse deklaroni se putat, statujat nuk kanë pjesë, në mënyrë absolute, në krijimin e gjallesave tokësore dhe as në krijimin e Diellit dhe të Hënës, të yjeve dhe të krijesave të botës së lartë dhe e thoni qartë se All'llahu është krijuesi i të gjitha atyre[1], atëherë, përse i shtrini duart tuaja drejt statujave, të cilat as nuk dëmtojnë e as nuk bëjnë dobi, as nuk dëgjojnë e as nuk logjikojnë?! Përse kërkoni prej tyre, t'ju ndihmojnë në zgjidhjen e problemeve tuaja dhe t'ju largojnë shqetësimet, të sjellin begati për ju?! Nëse keni supozuar se ato janë ortakë në krijim dhe formim, atëherë: **"Më sillni një libër të shpallur para këtij** (Kur'anit) **ose ndonjë gjurmë tjetër të dijes, nëse flisni të vërtetën!"**.

Si përfundim, mund të themi se argumenti, ose është i transmetuar nga rruga e Shpalljes qiellore, ose është logjik, ose

[1] Ky kuptim është përmendur në katër ajete të Kur'anit. Për sqarim më të thellë, lexoni fundin e ajetit 25 të sures "Ez Zukhruf" në këtë komentim.

është nga dëshmia e dijetarëve dhe vendimi i tyre. Kurse fakti që ju nuk mbështeteni në Shpallje dhe në Librin qiellor, por mbështeteni në thirrjen tuaj rreth statujave, që nuk vërtetoni dot pjesëmarrjen e tyre në krijimin e qiejve dhe të Tokës, që nuk vërtetoni se ato janë hyjni, zota, që nuk ka asnjë gjurmë të thënieve të dijetarëve të mëparshëm që e mbështet mendimin tuaj dhe e pohon bindjen tuaj, tregon më qartë se besimi dhe feja juaj janë trillime të shëmtuara dhe të papranueshme.

Mbështetur në këtë arsyetim, fjalia: **"Më tregoni, çfarë pjese të Tokës kanë krijuar ata?!"**, është argument logjik; fjalia: **"Më sillni një libër të shpallur para këtij** (Kur'anit)**"**, tregon Shpalljen qiellore, kurse fjalia: **"ndonjë gjurmë tjetër të dijes"**, tregon traditat e Profetëve të mëparshëm dhe këshillat e tyre, ose gjurmë të dijetarëve të mëparshëm.[1]

Dijetarët e gjuhës dhe komentuesit kanë përmendur disa kuptime të fjalës *"etharetun"* - *"gjurmë"*. Disa nga kuptimet e përmendura prej tyre, janë: mbetja e diçkaje, tregim, shenjë. Mirëpo, nga sa duket në pamje të parë, ajo i referohet vetëm një kuptimi, që është *"gjurma"* që mbetet nga një gjë. Kjo shenjë, kjo mbetje vërteton ekzistencën e saj.

Ky lloj debati dhe kjo mënyrë të gjykuari me paganët, është përmendur në ajetin 40 të sures "El Fatir": **"Thuaj: 'Më tregoni për zotat tuaj që i adhuroni, përveç All'llahut, më bëni të shoh se ç'krijuan ata në Tokë, a mos kanë pjesë ata në qiej, a mos u**

[1] Në një hadith të transmetuar nga Imam Bakiri *(Paqja e qoftë mbi të!)*, në veprën "Usulul Kafij", për komentimin e fjalisë: "ose ndonjë gjurmë të mbetur të diturisë", lexojmë: "Unë, për atë gjë, kam diturinë e këshillave të Profetëve". Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, f 9.

kemi dhënë atyre ndonjë libër, e ata kanë argument në të? Jo, por mizorët nuk i premtojnë njëri–tjetrit, vetëm se mashtrim.'".

Ajeti, në kapitullin e Tokës, thotë: **"çfarë krijuan ata në Tokë..."**, kurse në kapitullin e Qiellit, thotë: **"... apo kanë pjesëmarrje në qiejt..."**, pra, fjala është për dy kapitujt e pjesëmarrjes, sepse shirku në adhurim duhet të rezultojë nga shirku në procesin e krijimit, të kontrollit dhe të origjinës.

Këtu shtrohet një pyetje: Nëse idhujtarët besojnë se çështja e krijimit është e veçantë për All'llahun e Madhëruar, atëherë përse kanë nevojë për ndonjërin prej këtyre tri argumenteve?

Përgjigjja: Kjo kërkesë i referohet një grupi të vogël në mesin e adhuruesve të putave, për të cilët supozohej se e kishin fjalën për pjesëmarrjen e putave në krijim. Nëse një ditë ju do të mendoni se statujat janë pjesëmarrëse në krijimin e botës, atëherë ta dini mirë se nuk keni asnjë argument për këtë, as nga librat, as nga tradita e as nga logjika.

Pas kësaj, ajeti që vjen më pas, e bën të qartë humbjen e thellë dhe shmangien e idhujtarëve, kur thotë: **"Kush është më i humbur se ai, i cili, në vend All'llahut, u lutet atyre që nuk mund t'u përgjigjen deri në Ditën e Kiametit..."**.

Çështja nuk qëndron vetëm në mospërgjigjen e tyre. Përkundrazi, ata nuk e dëgjojnë fare fjalën e tyre **"janë krejt të pavetëdijshëm ndaj lutjes së tyre"**.

Disa komentues mendojnë se në këtë ajet, përemri u referohet putave të ngurtësuara, të vdekura, duke konsideruar se shumica e zotave të idhujtarëve arabë ishin statuja. Disa të tjerë e kanë konsideruar si tregues të engjëjve dhe njerëzve, të cilët u

adhuruan, përveç All'llahut, sepse nuk ishte i paktë adhurimi i engjëjve dhe i xhindeve në mesin e arabëve. Shprehjet e ndryshme në këtë ajet, janë simetria dhe harmonia me intelektualët, të cilët e mbështesin këtë kuptim.

Nuk ka ndonjë pengesë që ta komentojmë ajetin me kuptimin e tij të gjerë, në të cilin të përfshihen të gjitha këto krijesa të adhuruara, si ato që janë të gjalla, edhe ato që janë të vdekura, si ato që janë të arsyeshme, edhe ato që janë të paarsyeshme. Kështu edhe mënyra e të shprehurit, bëhet e harmonizuar me intelektualët.

Kur ajeti thotë: **"nuk mund t'u përgjigjen deri në Ditën e Kiametit"**, nuk do të thotë se ata do t'u përgjigjen atyre atë Ditë, siç mendojnë disa. Përkundrazi, ky qëndrim është mohim i sigurt, siç themi, për shembull: Nëse i kërkon me këmbëngulje filanit diçka, ai nuk do të ta japë deri në Kiamet, domethënë se ai nuk do ta bëjë kurrë atë vepër dhe jo se ai do t'i përgjigjet kërkesës tënde në Ditën e Kiametit.

Keqardhja më e madhe është: **"Kur të tubohen njerëzit** (në Ditën e Gjykimit)**, idhujt do të jenë armiq të tyre dhe do ta mohojnë adhurimin e tyre."**.

Edhe krijesat e adhuruara prej atyre, me arsye, do të shfaqin armiqësinë e tyre ndaj këtyre të humburve. Mesia, për shembull, do të shfaqë neverinë dhe urrejtjen e tij për ata që e kanë adhuruar atë. Edhe engjëjt largohen prej tyre, madje edhe shejtanët dhe xhindet shfaqin pakënaqësinë e tyre. Kurse krijesave, pa arsye dhe pa jetë, All'llahu i Madhëruar do t'u japë

arsyen dhe jetën, që të shqiptojnë pafajësinë e tyre dhe të shfaqin inatin ndaj atyre.

Një shembull i tillë është përmendur në ajetin e 14 të sures "El Fatir": **"Nëse ata i thërrisni, ata nuk dëgjojnë thirrjen tuaj, po ta zëmë se dëgjojnë, nuk mund t'ju përgjigjen juve në Ditën e Kiametit, ata do të mohojnë adhurimin tuaj ndaj atyre. E askush nuk të informon ty si i dituri** (All'llahu)**."**.

Të gjitha këto çështje, me një ndryshim të vogël, janë përsëritur në ajetin që po komentojmë.
Mirëpo, si do ta mohojnë krijesat adhurimin ndaj atyre?

Mbase ky është një tregues se ata, në të vërtetë, adhuronin dëshirat e tyre dhe nuk adhuronin ata zota, sepse baza e paganizmit është adhurimi i dëshirës.

Këtu meriton të kihet kujdes se miratimi i armiqësisë së atyre që u adhuruan ndaj adhuruesve të tyre në Ditën e Kiametit, nuk është përmendur vetëm. Për këtë lexojmë në ajetin e 25 të sures "El Ankebut" në gjuhën e Profetit Ibrahim *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*. Protagonisti, heroi i Teuhidit dhe shkatërruesi i putave, thotë: **"Ai** (Ibrahimi) **tha: 'Ju përqafuat, veç All'llahut, idhuj vetëm sa për bashkëjetesë mes jush në jetën e kësaj bote, e në Ditën e Kiametit,** (ndryshon gjendja)**, ju do të refuzoni njëri–tjetrin."**

Në ajetin e 82 të sures "Merjem" thuhet: **"Përkundrazi, ata** (idhujt) **do të tërhiqen prej adhurimit të tyre dhe do të bëhen armiq të tyre."**.

Ajetet 7 – 10

وَإِذَا تُتْلَىٰ عَلَيْهِمْ ءَايَٰتُنَا بَيِّنَٰتٍ قَالَ ٱلَّذِينَ كَفَرُوا۟ لِلْحَقِّ لَمَّا جَآءَهُمْ هَٰذَا سِحْرٌ مُّبِينٌ ۝٧ أَمْ يَقُولُونَ ٱفْتَرَىٰهُ ۖ قُلْ إِنِ ٱفْتَرَيْتُهُۥ فَلَا تَمْلِكُونَ لِى مِنَ ٱللَّهِ شَيْـًٔا ۖ هُوَ أَعْلَمُ بِمَا تُفِيضُونَ فِيهِ ۚ كَفَىٰ بِهِۦ شَهِيدًۢا بَيْنِى وَبَيْنَكُمْ ۖ وَهُوَ ٱلْغَفُورُ ٱلرَّحِيمُ ۝٨ قُلْ مَا كُنتُ بِدْعًا مِّنَ ٱلرُّسُلِ وَمَآ أَدْرِى مَا يُفْعَلُ بِى وَلَا بِكُمْ ۖ إِنْ أَتَّبِعُ إِلَّا مَا يُوحَىٰٓ إِلَىَّ وَمَآ أَنَا۠ إِلَّا نَذِيرٌ مُّبِينٌ ۝٩ قُلْ أَرَءَيْتُمْ إِن كَانَ مِنْ عِندِ ٱللَّهِ وَكَفَرْتُم بِهِۦ وَشَهِدَ شَاهِدٌ مِّنۢ بَنِىٓ إِسْرَٰٓءِيلَ عَلَىٰ مِثْلِهِۦ فَـَٔامَنَ وَٱسْتَكْبَرْتُمْ ۖ إِنَّ ٱللَّهَ لَا يَهْدِى ٱلْقَوْمَ ٱلظَّٰلِمِينَ ۝١٠

“Kur mohuesve u lexohen Shpalljet Tona të qarta, ata thonë për të Vërtetën (Kur’anin) **që u vjen: ‘Kjo është magji e qartë!’.”**

“Ose ata thonë: ‘Ai (Muhammedi) **e ka trilluar vetë atë** (Kur’anin)**’. Thuaju: ‘Por, nëse unë e trilloj atë, ju nuk do të mund të më mbroni nga dënimi i All’llahut. Ai i di më së miri të gjitha shpifjet tuaja për të** (Kur’anin)**. Mjafton Ai dëshmitar ndërmjet meje dhe jush. Ai është Falës dhe Mëshirëplotë.’”**

“Thuaju: ‘Unë nuk jam i pari i Dërguar dhe nuk e di çfarë do të ndodhë me mua ose me ju. Unë ndjek vetëm atë që më është Shpallur dhe kam për detyrë vetëm të jap paralajmërime të qarta.’”

"Thuaju: 'Më tregoni, se ç'do të bëhet me ju, nëse Kur'ani është vërtet prej All'llahut e ju e mohoni, ndërkohë që një dëshmitar nga bijtë e Izraelit dëshmon për vërtetësinë e tij dhe e beson atë, kurse ju tregoheni kryelartë?!' Me të vërtetë, All'llahu, nuk i udhëzon (në Rrugë të Drejtë) **njerëzit e padrejtë."**

Komentim

Nuk jam i pari Profet!!

Në këto ajete vijon diskutimi për idhujtarët dhe mënyrën e sjelljes së tyre me argumentet e All'llahut dhe thuhet: **"Kur mohuesve u lexohen Shpalljet Tona të qarta, ata thonë për të Vërtetën** (Kur'anin) **që u vjen: 'Kjo është magji e qartë!'"**, sepse ata nuk mund të mohojnë depërtimin e shpejtë të Kur'anit në zemrat e tyre dhe forcën tërheqëse të tij, e cila nuk mund të përballohet nga njëra anë. Nga ana tjetër, ata janë të papërgatitur, që të dorëzohen përpara madhështisë dhe vërtetësisë së All'llahut. Prandaj edhe ata e komentojnë këtë depërtim të fortë, por me një koment të gabuar, të shmangur. Ata thonë: "Është një magji e hapët". Kjo fjalë, në vetvete, është pranim i qartësisë së pastër të efektit, të ndikimit të jashtëzakonshëm të Kur'anit në zemrat e njerëzve.

Mbështetur në këtë argumentim, "e vërteta" në ajetin e përmendur, është tregues i ajeteve të Kur'anit, edhe pse disa e kanë komentuar me profecinë apo Islamin, apo mrekullitë e tjera

të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Por komentimi i parë është më i përshtatshëm me shënimin e fillimit të ajetit.

Por këta nuk u mjaftuan me hedhjen e këtyre akuzave dhe bashkimit të tyre me to, madje këmbëngulën dhe hodhën një hap më tej dhe më të qartë: **"Ose ata thonë: 'Ai** (Muhammedi) **e ka trilluar vetë atë** (Kur'anin)**.'"**.

All'llahu i Madhëruar e urdhëron Profetin e Tij, që t'u përgjigjet në mënyrë të prerë dhe t'u japë atyre argumentin e pastër, duke u thënë se, nëse është kështu, atëherë duhet të më vijë mua turp dhe ju nuk mund të më mbroni mua përballë ndëshkimit të All'llahut: **"Thuaju: 'Por, nëse unë e trilloj atë, ju nuk do të mund të më mbroni nga dënimi i All'llahut.'"**[1], sepse si mundet All'llahu i Madhëruar, të shfaqë argumentet e Tij të qarta në duart e një mashtruesi? Kjo është me të vërtetë shumë larg mençurisë dhe mirësisë së All'llahut.

Kjo është përmendur edhe në ajetet 44-47 të sures "El Hakka": **"Sikur të trillonte ai,** (Muhammedi) **për Ne ndonjë fjalë, Ne do ta kapnim atë me fuqinë Tonë. E pastaj do t'ia këpusnim atij arterien e zemrës. E askush prej jush nuk do të mund të ndërhynte për mbrojtjen e tij!"**.

Por, a mundem unë t'ju paraqes juve një punë të tillë përpara jush? E si mund të besoni se është e mundur që të them një gënjeshtër të tillë e më pas All'llahu të më lërë të gjallë, madje të më japë edhe mrekulli të tjera?!

[1] Fjalia: **"nëse unë e trilloj atë",** është një fjali kushtore, rezultati i të cilës është fshirë. Vlerësimi është: Nëse unë e kam trilluar atë, Ai do të më merrte dhe me shpejtësi do të më ndëshkonte.

Më pas shton, duke kërcënuar: **"Ai i di më së miri të gjitha shpifjet tuaja për të** (Kur'anin)**"**[1] dhe Ai do t'ju ndëshkojë ju në kohën e duhur.

Ai di çdo akuzë që më drejtuat. Ju qëndruat përballë të Dërguarit të Tij dhe i pengonit njerëzit të besonin të vërtetën.

Fjalia që pason, është garanci e një lidhjeje të fortë: **"Mjafton Ai dëshmitar ndërmjet meje dhe jush."**, sepse Ai e njeh sinqeritetin e thirrjes sime për të përcjellë mesazhin tim, ashtu siç e di gënjeshtrën dhe pengesat që ju vendosni në rrugën time. Kjo është e mjaftueshme për mua dhe për ju.

Me qëllim që t'u tregojë atyre rrugën e kthimit tek e vërteta dhe t'u mësojë atyre se kjo rrugë është e hapur, në rast se duan të kthehen, thotë: **"Ai është Falës dhe Mëshirëplotë."**, sepse Ai i fal ata që pendohen dhe i fut ata në mëshirën e Tij.

Ajeti që vijon, thotë: "**Thuaju: Unë nuk jam i pari i Dërguar dhe nuk e di çfarë do të ndodhë me mua ose me ju. Unë ndjek vetëm atë që më është Shpallur dhe kam për detyrë vetëm të jap paralajmërime të qarta."**.

Këto fjali të shkurtra, por me përmbajtje të pasur, u japin përgjigje shumë dyshimeve të idhujtarëve. Njëri prej dyshimeve, i cili shkaktonte edhe habi të madhe te idhujtarët, ishte fakti që

[1] *"ma"* në fjalinë *"ma tufidune fihi"* - **"shpifjet tuaja për të",** ka mundësi që të jetë e lidhur dhe do të thotë akuzë e pavërtetë, të cilën Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e dinte. Në bazë të kësaj, atëherë përemri *"fihi"* i referohet asaj. Nëse do të ishte paskajore, atëherë përemri *"fihi"* i referohet Kur'anit, ose të vërtetës dhe këtu bëhet *"tefidune"* - *"vishni"* me kuptimin hyrje në një punë çfarëdo, me qëllim prishjen dhe shkatërrimin.

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* mund të komunikonte me All'llahun dhe të lidhej me Të.

Ata habiteshin edhe me faktin se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* hante ushqim dhe ecte natyrshëm nëpër tregje.

Herë të tjera kërkonin mrekulli të ndryshme, të mahnitshme e të çuditshme. Secili prej tyre kërkonte diçka.

Mendonin se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ishte magazina e diturisë së fshehtë dhe kërkonin prej tij që t'i lajmëronte për të gjitha ngjarjet e së ardhmes.

Pa dyshim që edhe ata, ndonjëherë, kënaqeshin nga thirrja që u bënte ai për të lënë zotat dhe për t'iu drejtuar adhurimit të All'llahut dhe Njehsimit të Tij.

Ky ajet është një tregues përmbledhës i përgjigjeve për të gjitha pyetjet dhe arsyet imagjinare e të kota të tyre.

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* thotë se unë nuk jam Profeti i parë që ka bërë thirrje në Teuhid. Para meje kanë ardhur shumë Profetë të tjerë, të cilët ishin njerëz, vishnin rroba e hanin ushqim dhe askush prej tyre nuk ka pohuar se e dinte të fshehtën absolute. Përkundrazi, ata thoshin se dimë aq sa na ka mësuar All'llahu për Gajbin dhe të fshehtat që lidhen me të.

Askush prej tyre nuk është dorëzuar para mrekullive që u propozonin njerëzit, të cilat bëheshin në bazë të dëshirës dhe pasionit.

Edhe Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është, gjithashtu, një rob prej robëve të All'llahut. Dituria e fuqia e tij është e kufizuar. Edhe ai di aq sa dëshiron All'llahu i Madhëruar që t'i japë, sepse dituria dhe fuqia absolute është vetëm për All'llahun e Madhëruar.

Këto të vërteta njerëzit duhet t'i dinë dhe t'i kuptojnë, që t'u japin fund dyshimeve të tyre.

E gjitha kjo është thënë pas komentimit që u janë bërë ajeteve të kaluara, në të cilat e akuzonin Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* një herë për magji e herë tjetër për mashtrim. Këto sqarime synojnë të tregojnë se të gjitha këto akuza e kanë burimin në imagjinatat për të cilat diskutuam në këtë ajet.

Ky diskutim sqaron se kuptimi i këtij ajeti nuk bie në konflikt me ajetet e tjera që shpallin se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e di të fshehtën. Kjo gjë thuhet edhe në suren "El Fet'h", ajeti 27, e cila flet për çlirimin e Mekës dhe hyrjen në Qabe. Në një ajet tjetër flitet për çështjen e Mesiut *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, i cili thotë: **"Unë ju tregoj për atë që e hani dhe për atë që e depozitoni në shtëpitë tuaja."**.[1]

Ka shumë ajete që flasin për këtë çështje. Ajeti që po diskutojmë, e mohon diturinë e fshehtë absolute, por nuk mohon

[1] Sure "Ali Imran", ajeti 49.

gjithçka nga dituria e Gajbit, e të fshehtës. Thënë ndryshe, ajeti e mohon diturinë specifike të Gajbit, të cilën e di vetëm All'llahu i Madhëruar. Ka ajete të tjera që flasin për diturinë e Gajbit, për dijen e fshehtë, e cila përfitohet nga begatia e diturisë hyjnore.

Kjo dëshmohet në dy ajete. Në ajetet 26-27 të sures "El Xhind": **"Ai është që e di të fshehtën, por fshehtësinë e Vet nuk ia zbulon askujt. Me përjashtim të ndonjë të Dërguari që Ai do."**.

Disa komentues kanë përmendur shkakun e zbritjes së ajetit që po komentojmë. Ata kanë thënë: "Kur në Mekë u shtua ngarkesa e problemeve dhe presioni mbi shokët e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, ai pa në ëndërr sikur po emigronte drejt një toke me shumë palma dhe me shumë ujë. Ai ua tha atë shokëve të tij. Ata u gëzuan nga kjo dhe menduan se do të çliroheshin më në fund nga lëndimi i idhujtarëve. Ata duruan për një farë kohe, mirëpo nuk po dukej ndonjë shenjë e tillë, prandaj i thanë: 'O i Dërguari i All'llahut, nuk po shohim gjë për atë që na lajmërove. Kur do të emigrojmë në ato toka, që ti i pe në ëndërr?'

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nuk foli. Ndërkohë zbriti ky ajet: **'... nuk e di se ç'do të bëhet me mua e as me ju.'**."[1]

Por ky shkak zbritjeje, duket si i largët nga situata, sepse ata që flasin në këtë ajet, janë armiqtë e Profetit Muhammed *(Paqja*

[1] Tefsiri "El Kebijr", vëll. 28, f. 8.

e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe jo shokët e tij. Por mundet që kjo të jetë nga kapitulli i zbatimit, domethënë se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e mori këtë ajet dhe me të iu përgjigj shokëve të tij.

Ajeti i fundit i këtyre ajeteve, për të plotësuar atë që është përmendur në ajetet e kaluara shton: **"Thuaju: 'Më tregoni, se ç'do të bëhet me ju, nëse Kur'ani është vërtet prej All'llahut e ju e mohoni, ndërkohë që një dëshmitar nga bijtë e Izraelit**[1] **dëshmon për vërtetësinë e tij dhe e beson atë, kurse ju tregoheni kryelartë?!' Me të vërtetë, All'llahu, nuk i udhëzon** (në Rrugë të Drejtë) **njerëzit e padrejtë."**.[2]

Ka shumë thënie të komentuesve rreth dëshmitarit Beni Israil, i cili dëshmoi se Kur'ani i lavdishëm është i vërtetë.

Disa thanë se ai është Musai, i biri i Imranit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, që lajmëroi në kohën e tij shfaqjen e Profetit të Islamit dhe ka dhënë përshkrimet dhe shenjat e tij.

Por ky supozim nuk është i vërtetë. Po ta shohim mirë, fjalia thotë: **"...dëshmon për vërtetësinë e tij dhe e beson atë, kurse ju tregoheni kryelartë."**.

E thënë kështu, fjalia shpall se ky dëshmitar Beni Israil e besoi Profetin e Islamit, pikërisht kur idhujtarët bënë kryelartësi dhe nuk e besuan. Kjo fjali tregon se ky dëshmitar ishte i pranishëm në kohën e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i*

---

1. Ai është Abdullah bin Selam, një ish-rabin hebre, që pranoi Islamin në Medine.

2 Përftimi i fjalisë kushtore: "Nëse ai është prej All'llahut", është i fshehur. Vlerësimi i saj është: "Kush është më i humbur se ju.".

All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe e besoi atë, kurse të tjerët zgjodhën rrugën e kryelartësisë dhe të mohimit.

Të tjerë thanë se ai ishte njëri prej dijetarëve të popullit që i kishte zbritur libri dhe jetonte në Mekë. Pse ndihmësit e fesë çifute dhe asaj të krishterë ishin pakicë në Mekë, nuk do të thotë se njëri prej tyre të mos e pranojë të vërtetën e shpallur nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Megjithatë, asnjëherë nuk u bë e ditur se kush ishte ky njeri, ky dijetar prej Beni Israilëve.

Edhe ky është një koment pa vlerë nga ana e tyre, sepse nuk ka pasur ndonjë dijetar të njohur nga njerëzit e Librit në Mekë, në kohën e shfaqjes së Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Historitë nuk kanë përmendur asnjë emër të tillë.[1]

Sigurisht, dallohet ky komentim dhe ai para tij, se të dy harmonizohen me të gjitha ajetet e sures " El Ahkaf", e cila është sure mekase.

Komentimi i tretë, të cilin e ka zgjedhur shumica e komentuesve, tregon se ky dëshmitar, ishte Abdullah ibn Selami, një dijetar i njohur çifut, i cili besoi në Medine dhe u rreshtua në radhët e myslimanëve.

Në një hadith është thënë se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nisi të ecë, derisa u fut në një tempull çifutësh, ditën e festës së tyre. Çifutët e urryen, pse ai u fut brenda. I Dërguari i All'llahut *(Paqja e bekimi i*

[1] Mënyra e shprehjes këtu me fjalën "*shahid*" - "*dëshmitar*", është në formën mohore, për respekt. Kjo tregon se ai ishte një njeri i njohur, i respektuar.

All'llahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!) u tha atyre: *"O popull i çifutëve, më tregoni mua dymbëdhjetë burra prej jush që dëshmojnë se nuk ka tjetër Zot, veç All'llahut dhe Muhammedi është i Dërguari i All'llahut. All'llahu do të ruajë çdo çifut që është në qiellin e furisë së përhershme, i cili është mbi kokën e tij."*.

Ata heshtën. Askush nuk iu përgjigj. Më pas ua përsëriti tri herë dhe ata përsëri nuk u përgjigjën. Atëherë ai tha: "Ju refuzuat, po pasha All'llahun, unë jam ai që do t'ju nxjerr nga varri, që do t'ju tuboj. Unë jam ai, trashëguesi, unë jam ai që do t'ju jap vendimin, besuat apo nuk besuat.", dhe u largua. Kur po dilte nga dera, erdhi një njeri dhe i thotë se është ashtu si thua ti, o Muhammed.

Ai njeri u tha të pranishmëve: "Si më njihni ju mua, o populli i çifutëve?"

Ata thanë: "Për Zotin, nuk njohim në mesin tonë njeri më të ditur rreth Librit të All'llahut dhe më njohës të dispozitave fetare se ti dhe babai e gjyshi yt."

Ai tha: "Unë dëshmoj se ai është Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, për të cilin është shkruar në Teurat dhe në Ungjill."

Ata thanë: "Ti gënjen."

E refuzuan atë dhe thanë fjalë të këqija. I Dërguari i All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)* tha: "Ju përgënjeshtruat dhe fjala juaj nuk do të pranohet."

Ky njeri ishte Abdullah ibn Selami. Zbriti ajeti: **"Thuaju: 'Më tregoni, se ç'do të bëhet me ju, nëse Kur'ani është vërtet prej All'llahut...'"**.[1]

Sipas këtij tefsiri, ky ajet ka zbritur në Medine, edhe pse surja është mekase. Kjo nuk është e përkufizuar në ajetin që po komentojmë. Ka ndodhur që edhe në suret e tjera të Kur'anit të ketë ajete që kanë zbritur në Mekë, në tekstet e sureve që kanë zbritur në Medine dhe anasjelltas. Kjo tregon se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* kishte urdhëruar që ajetet të vendoseshin bashkë me ata që përshtateshin prej përftimit të sures, pa marrë parasysh historinë e zbritjes së saj.

Nga shumë këndvështrime, duket qartë se ky komentim është më i përshtatshmi.

[1] Tefsiri "El Meragij", vëll. 26, f. 14.

Ajetet 11 – 14

وَقَالَ ٱلَّذِينَ كَفَرُواْ لِلَّذِينَ ءَامَنُواْ لَوۡ كَانَ خَيۡرٗا مَّا سَبَقُونَآ إِلَيۡهِۚ وَإِذۡ لَمۡ يَهۡتَدُواْ بِهِۦ فَسَيَقُولُونَ هَٰذَآ إِفۡكٞ قَدِيمٞ ١١ وَمِن قَبۡلِهِۦ كِتَٰبُ مُوسَىٰٓ إِمَامٗا وَرَحۡمَةٗۚ وَهَٰذَا كِتَٰبٞ مُّصَدِّقٞ لِّسَانًا عَرَبِيّٗا لِّيُنذِرَ ٱلَّذِينَ ظَلَمُواْ وَبُشۡرَىٰ لِلۡمُحۡسِنِينَ ١٢ إِنَّ ٱلَّذِينَ قَالُواْ رَبُّنَا ٱللَّهُ ثُمَّ ٱسۡتَقَٰمُواْ فَلَا خَوۡفٌ عَلَيۡهِمۡ وَلَا هُمۡ يَحۡزَنُونَ ١٣ أُوْلَٰٓئِكَ أَصۡحَٰبُ ٱلۡجَنَّةِ خَٰلِدِينَ فِيهَا جَزَآءَۢ بِمَا كَانُواْ يَعۡمَلُونَ ١٤

"Mohuesit thonë për besimtarët: 'Nëse (Kur'ani) **do të ishte ndonjë gjë e mirë, ata nuk do ta kishin besuar atë para nesh!". E përderisa ata nuk e pranojnë udhëzimin e tij, ata thonë: 'Ky është një trillim i lashtë.'"**

"Para Kur'anit është shpallur Libri i Musait, një udhërrëfyes dhe mëshirë për gjithë njerëzimin. Ky Libër (Kur'ani) **e vërteton atë. Ai është shpallur në gjuhën arabe për t'i paralajmëruar ata që bëjnë të këqija dhe për t'u sjellë lajme të mira punëdrejtëve."**

"Pa dyshim, ata që thonë: 'Zoti ynë është All'llahu!' dhe pastaj qëndrojnë të palëkundur në Rrugën e Drejtë, nuk do të kenë

arsye për t'u frikësuar e as për t'u dëshpëruar (kur t'u vijë vdekja)**."**

"Ata do të jenë banorë të Xhennetit, ku do të qëndrojnë përgjithmonë, si shpërblim për atë që kanë punuar."

Shkaku i zbritjes

Komentuesit kanë përmendur shumë shkaqe për zbritjen e ajetit 11. Po përmendim disa prej tyre:

1- Ky ajet ka zbritur për Ebu Dherr El Gifarin, i cili u bë mysliman në Mekë. Më pas atë e ndoqi fisi i tij në besim. Fisi i tij, fisi Beni Gifar banonte në periferi dhe ishte fis i varfër. Mohuesit kurejshë ishin pasanikët e qytetit. Mohuesit kurejshë thoshin se, sikur Islami të ishte i mirë, nuk do të na paraprinin ne në besim aleatët e Gifarëve. Zbriti ky ajet dhe iu përgjigj atyre.

2- Në Mekë ishte një robëreshë romake që quhej "Dhi En Nejireh"[1], e cila iu përgjigj thirrjes së Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* në Islam. Paria e kurejshëve tha, se sikur të ishte e mirë ajo me të cilën ka ardhur Muhammedi, "Dhi En Nejireh" nuk do ta përqafonte para nesh.

[1] "Dhi En Nejireh", ka qenë prej të parave që e pranojë Islamin në fillim. Për këtë shkak, Ebu Xhehli e lëndonte dhe e torturonte atë.

3- Fiset e periferive u bënë myslimanë, para banorëve të qytetit të Mekës dhe fisnikët e Mekës thanë se, sikur të ishte i mirë Islami, nuk do të përqafonin para nesh rojet e deveve.

4- Pa dyshim se një grup prej burrave të pastër dhe të varfër, si: Bilali, Suhejbi dhe Omari, e përqafuan Islamin.

Paria e Mekës tha: "A mund të jetë e mirë feja e Muhammedit, kur këta njerëz e përqafojnë atë para nesh?".

5- Sapo Abdullah ibn Selami dhe disa nga shokët e tij besuan, një grup çifutësh thanë: "Sikur feja e Muhammedit të ishte e mirë, nuk do ta përqafonin këta para nesh.".[1]

Shkaqet e para të zbritjes mund t'i përmbledhim me thënien se Islami pati një përkrahje të gjerë dhe një shtrirje të shpejtë midis shtresave të varfra dhe banorëve të periferive, sepse ata nuk kishin interesa të paligjshme, që të kërcënoheshin me ndonjë rrezik, nuk ishin kryelartë. Zemrat e tyre ishin më të pastra se zemrat e atyre që ishin në luks dhe e atyre që ndiqnin dëshirat dhe pasionet.

Pranimi i gjerë i Islamit u shtua. Grupet që e përkrahën Islamin, formonin pikat më të forta të kësaj feje, kurse pika e dobët përfaqësohej nga mendjemëdhenjtë, të cilët thoshin: "Çfarë feje është kjo, që e ndjekin banorët e periferive, të varfrit, këmbëzbathurit, robëreshat e skllevërit? Nëse do ishte fe e pranuar dhe e arsyeshme, atëherë ndjekëse e saj nuk duhet të ishte shtresa e ulët e shoqërisë dhe të varfrit, por ne, ajka e shoqërisë dhe fisnikët e saj.".

[1] Tefsiri i "Kurtubijjut", vëll. 9, f. 6009.

Është e çuditshme kjo mënyrë e të menduarit, e cila përpiqet të përcjellë mendimin e pasanikëve dhe të atyre që jetojnë në luks, në lidhje me fenë. Ata thonë se feja është e dobishme për të varfrit dhe këmbëzbathurit, të cilët janë të dobishëm për shoku-shokun, kurse ne kemi një status më të lartë se ata.

Kur'ani u është përgjigjur këtyre. Kjo përgjigje do të qartësohet në komentimin e këtyre ajeteve.

Shkaku i pestë i zbritjes është përmendur më lart. Si shkak nënkuptohet që është Abdullah ibn Selami dhe shokët e tij. Megjithëse kjo transmetohet nga shumë komentues, si nga Tabersiju, në veprën "Dispozita e sqarimit" dhe Kurtubiju në tefsirin e tij. Ai duket shumë larg në dy anë:

Së pari: Fjalia: **"Mohuesit thonë për besimtarët: 'Nëse** (Kur'ani) **do të ishte ndonjë gjë e mirë...'"**, përdoret për të treguar idhujtarët dhe jo popullin e Librit dhe çifutët e të krishterët.

Së dyti: Abdullahu, i biri i Selamit, nuk ishte njeri i panjohur apo me karakter të dobët, në mesin e jehudive, që të thuhet: Sikur Islami të ishte i mirë, nuk do ta përqafonte atë ky dhe shokët e tij.

Komentim

Kushti i triumfit, besimi dhe palëkundshmëria

Këto ajete vazhdojnë të analizojnë thënien e veprave të idhujtarëve. Pastaj bëjnë qortimin dhe fyerjen e tyre. Më pas tregojnë atë që kanë thënë këta, fjalë pa logjikë, të cilat mbartin mendjemadhësi dhe kryelartësi. Ajeti thotë: **"Mohuesit thonë për besimtarët: 'Nëse** (Kur'ani) **do të ishte ndonjë gjë e mirë, ata nuk do ta kishin besuar atë para nesh!'"**.[1]

Këta që përqafuan Islamin, janë këmbëzbathurit dhe të varfrit, banorët e fshatrave dhe skllevërit, të cilët kanë fare pak njohuri. Atëherë, si munden këta, që ta dinë të drejtën dhe ta pranojnë atë, kur ne, ajka e shoqërisë dhe fisnikët e saj, jemi të pavëmendshëm ndaj saj?!

Mirëpo mangësia është te vetë ata dhe jo tek Islami. Sikur të mos ishte pengesë mendjemadhësia dhe kryelartësia e hedhur në zemrat e tyre, sikur ata të mos ishin të dehur nga pasuria dhe statuset e larta, sikur kryelartësia dhe mendjemadhësia të mos i pengonte në vërtetimin e kësaj feje, atëherë ata do të hidheshin me shpejtësi drejt Islamit dhe do ta përqafonin atë, ashtu siç e përqafuan të varfrit.

---

[1] Shumë komentuesit kanë komentuar kuptimin e shkronjës *"lam"* në sifjalinë *"lil'ledhine amenu"* - **"atyre që besuan"**. Nga të gjitha supozimet, më i përshtatshmi është se *"lami"* është më kuptimin e *"fi"* – *"në"*. Në bazë të kësaj, fjalia është: Jobesimtarët u thanë besimtarëve. Në këtë situatë, nuk vjen asnjë paradoks nga ana e të qenit të foljes *"sebekuna"* - *"përqafonin para nesh"* për atë që mungon. Disa e kanë konsideruar *"lamin"* si *lami* i justifikimit. Disa të tjerë thanë se "ata që besuan" janë ata që flasin, kurse fjalia *"sebekuna"* është me kuptimin *"sebektumuna"* - *"përqafuan para nesh"*.

Përgjigjja për këtë gjendet në fundin e ajetit: **"E përderisa ata nuk e pranojnë udhëzimin e tij, ata thonë: 'Ky është një trillim i lashtë.'"**.[1] Kuptohet se mohuesit nuk deshën që të drejtoheshin nga argumentet e Kur'anit.

Fraza **"trillim i lashtë"** i ngjason një akuze tjetër, që është treguar edhe në ajetet e tjera të Kur'anit, në të cilat thuhet: **"Janë legjenda të të parëve..."**.[2]

Togfjalëshi **"ata thonë"** tregon se ata akuzonin Kur'anin dhe këtë akuzë e përdornin si mbulesë për mosbesimin e tyre.

Më pas, ajeti merr një argument tjetër për të vërtetuar se Kur'ani është i vërtetë dhe për të ndaluar akuzat e idhujtarëve, të cilët thoshin se ky është një trillim i vjetër, ajeti thotë: **"Para Kur'anit është shpallur Libri i Musait, një udhërrëfyes dhe mëshirë për gjithë njerëzimin. Ky Libër** (Kur'ani) **e vërteton atë. Ai është shpallur në gjuhën arabe për t'i paralajmëruar ata që bëjnë të këqija dhe për t'u sjellë lajme të mira punëdrejtëve."**.

Nga shenjat e sinqeritetit dhe të vërtetësisë së këtij Libri të madh, është se Libri i Musait, i cili konsiderohet prijës, model dhe mëshirë për njerëzit, ka lajmëruar për këtë Profet dhe për cilësitë e tij, ka lajmëruar edhe se ky Kur'an, gjithashtu, është një Libër i

---

[1] *(idh)* në këtë ajet është kushtore. Disa mendojnë se ajo është lidhëz e fjalës *"se jekulune"* - *"do të thonë"* dhe thonë se prania e shkronjës *"fa"* nuk ka problem. Disa të tjerë, si Zamkhasheriju në veprën "El Kesh'shaf", mendojnë se përderisa folja pas saj, është në të shkuarën, dhe se folja *"se jekukune"* - *"do të thonë"*, është në të tashmen, ajo nuk ka mundësi që të jetë lidhëza e saj, por lidhëza e saj është e fshehur. Vlerësimi është: "Nëse nuk udhëzohen, me të shfaqet kokëfortësia e tyre." Supozimi i parë është më i harmonizuar me kuptimin e ajetit.

[2] Sure "El Furkan", ajeti 5.

harmonizuar në argumentet e tij dhe në të ka shenja të përmendura në Teurat.

Kur çështja është e tillë, atëherë përse thoni se ky është një trillim i hershëm?

Kur'ani ka përsëritur shpesh në ajetet e tij vërtetimin e Teuratit dhe të Ungjillit. Kur'ani bie dakord me shenjat dhe cilësitë që janë përmendur për Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* në këto dy libra qiellorë. Këto shenja ishin të përpikta, të hollësishme, aq sa edhe Kur'ani thotë: **"Atyre që u kemi dhënë librin, e njohin atë,** (Muhammedin)**, siç i njohin bijtë e tyre."**.[1]

I njëjti kuptim i ajetit që po komentojmë, përmendet edhe në ajetin e 17 të sures "Hud": **"E ai që është i mbështetur në argument nga Zoti i tij dhe atë që e përforcon dëshmia nga Ai, e para tij,** (Kur'anit), **ishte** (dëshmitar) **libri i Musait,** (Teurati), **që ishte udhërrëfyes e mëshirë. Të tillët,** (që janë në Rrugë të Drejtë), **e besojnë atë,** (Kur'anin)**."**.

Fjalia **"udhërrëfyes dhe mëshirë"** tregon se të qenit prijës është një detyrë e vështirë, kurse përmendja e fjalës *"mëshirë"* krijon idenë e qetësisë. Ajeti thotë se ky prijës është binjaku i mëshirës dhe i shoqëruar nga mëshira. Edhe sikur t'ju vijë juve me detyrime dhe urdhëresa, ato përsëri janë mëshirë. Atëherë, cila mëshirë është më universale dhe më e lartë se sa edukimi i shpirtrave të këtij populli?!

Pas kësaj thotë: **"në gjuhën arabe"**, të cilën e kuptojnë të gjithë dhe përfitojnë prej tij.

[1] Sure "El Bekare", ajeti 146.

Në fund, ajeti, nëpërmjet dy fjalive të shkurtra, qartëson qëllimin kryesor të zbritjes së Kur'anit: **"...për t'i paralajmëruar ata që bëjnë të këqija dhe për t'u sjellë lajme të mira punëdrejtëve."**.

Në qoftë se vërejmë me kujdes, shohim se paskajorja **"për t'i paralajmëruar"** përdoret për të treguar vazhdimësinë, tregon se ajo ndodh përherë. Pra, qartësohet se paralajmërimi i Kur'anit është një përgëzim i përhershëm dhe i vazhdueshëm. Kjo gjë u tërheq vërejtjen zullumqarëve dhe kriminelëve, i frikëson, i paralajmëron ata, kurse punëmirët i përgëzon për vazhdimësinë e tyre.

Ajo që tërheq vëmendjen, është se ajeti i ka vënë zullumqarët përpara atyre që bëjnë vepra të mira, sepse për padrejtësinë, këtu, ka një kuptim të gjerë. Ajo përfshin çdo vepër të keqe, çdo kundërshtim.

Ajeti që vijon, është komentim i punëmirëve. Punëmirët janë përmendur në ajetin para këtij, i cili thotë: **"Ata që thanë: 'All'llahu është Zoti ynë dhe qëndruan të palëkundur, për ta nuk ka frikë dhe ata nuk do të pikëllohen.'"**.

Në këto dy fjali janë bashkuar të gjitha nivelet e besimit dhe të gjitha veprat e mira, sepse Teuhidi është baza e të gjitha besimeve të vërteta. Të gjitha rrënjët dhe shtyllat e besimit, i referohen bazës së Teuhidit. Disa prej këtyre bazave janë: qëndrimi besnikërisht, durimi, përballimi dhe qëndresa. Këto janë bazat e të gjitha veprave të mira, sepse ne e dimë se përmbledhja e të gjitha punëve të mira bëhet në tri gjëra: durimi në bindje ndaj All'llahut, durimi ndaj mëkatit dhe durimi në fatkeqësi.

Pra, punëmirët janë ata që ecin në vijën e Teuhidit për nga ana e bindjes dhe në vijën e qëndrimit besnik në durim, për nga ana e veprimit.

Njerëz të tillë nuk kanë frikë nga ndodhitë e të ardhmes dhe nuk dëshpërohen për atë që ka ndodhur në të kaluarën.

Në ajetin e 30 të sures "Fussilet" është përmendur një kuptim i njëjtë me këtë. Në këtë ajet thuhet: **"E s'ka dyshim se ata që thanë: 'All'llahu është Zoti ynë' dhe ishin të paluhatshëm, atyre u vijnë engjëjt,** (në prag të vdekjes dhe u thonë)**: 'Të mos frikësoheni, të mos pikëlloheni, keni përgëzim Xhennetin që u premtohej.'"**.

Ky ajet shton dy çështje:

E para: Ata u përgëzuan nga engjëjt, që të mos kenë frikë dhe pikëllim, ndërsa ajeti që po diskutojmë, ka heshtur për këtë.

E dyta: Ndalimi i frikës dhe i pikëllimit është shtuar prej tyre dhe është përmendur përgëzimi me Xhennet. Ky përgëzim është përmendur edhe në ajetin e sures "Fussilet", siç është përmendur në ajetin vijues.

Sidoqoftë, duhet të themi se të dy ajetet diskutojnë të njëjtën çështje, por njëra prej tyre është më e hollësishme se tjetra.

Në tefsirin e "Ali ibn Ibrahim" rreth thënies: **"Ata që thanë: 'All'llahu është Zoti ynë dhe qëndruan besnikërisht...'"** autori ka thënë: Ata qëndruan të palëkundur ndaj vilajetit të Prijësit i besimtarëve, Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*. E gjitha kjo sepse vazhdimësia e vijës së Prijësit të besimtarëve në dituri, në vepër, në drejtësisë, dhe në përkushtim, veçanërisht në periudha

shumë të errëta, kjo është një çështje që nuk mund të vërtetohet pa qëndrimin të palëkundshmëm ndaj saj. Mbi këtë arsyetim, ajo llogaritet si një nga miratimet e qarta të ajetit që po komentojmë, jo se kuptimi i tij është i kufizuar dhe nuk përfshin qëndrimin në xhihad, bindjen ndaj All'llahut të Madhëruar dhe luftimin e egos e të shejtanit.

Në fundin e ajetit të 30 të sures "Fussilet"[1] kemi përmendur një shpjegim të hollësishëm, rreth çështjes së qëndrimit besnik.

Ajeti 14 i përgëzon punëmirët me lajmin më të rëndësishëm dhe më të çmuar: **"Ata do të jenë banorë të Xhennetit, ku do të qëndrojnë përgjithmonë, si shpërblim për atë që kanë punuar."**.

Disa thonë se fillimi i ajetit duket sikur kufizon numrin e atyre që do të jenë banorë të Xhennetit. Sipas tyre, banorët e Xhennetit janë vetëm njerëzit njehsues dhe ata që qëndrojnë besnikë në të, kurse ata që kanë bërë mëkate, nuk janë prej banorëve të Xhennetit, që prej fillimit të çështjes.

Përdorimi i fjalës *"el as'hab"*, tregon bashkimin e tyre të përhershëm në Xhennet dhe shijimin e përhershëm të mirësive të Xhennetit.

Sifjalia: **"si shpërblim për atë që kanë punuar"**, tregon, nga njëra anë, se Xhenneti nuk jepet falas, përkundrazi ai ka një çmim që duhet të paguhet, kurse, nga ana tjetër, tregon lirinë e njeriut dhe zgjedhjet e tij.

[1]Lexo komentimin e ajetit 30 të, sures "Fussilet", nga ky komentim.

Ajetet 15 – 16

وَوَصَّيْنَا ٱلْإِنسَٰنَ بِوَٰلِدَيْهِ إِحْسَٰنًا ۖ حَمَلَتْهُ أُمُّهُۥ كُرْهًا وَوَضَعَتْهُ كُرْهًا ۖ
وَحَمْلُهُۥ وَفِصَٰلُهُۥ ثَلَٰثُونَ شَهْرًا ۚ حَتَّىٰٓ إِذَا بَلَغَ أَشُدَّهُۥ وَبَلَغَ أَرْبَعِينَ سَنَةً
قَالَ رَبِّ أَوْزِعْنِىٓ أَنْ أَشْكُرَ نِعْمَتَكَ ٱلَّتِىٓ أَنْعَمْتَ عَلَىَّ وَعَلَىٰ وَٰلِدَىَّ وَأَنْ
أَعْمَلَ صَٰلِحًا تَرْضَىٰهُ وَأَصْلِحْ لِى فِى ذُرِّيَّتِىٓ ۖ إِنِّى تُبْتُ إِلَيْكَ وَإِنِّى مِنَ
ٱلْمُسْلِمِينَ ١٥ أُو۟لَٰٓئِكَ ٱلَّذِينَ نَتَقَبَّلُ عَنْهُمْ أَحْسَنَ مَا عَمِلُوا۟ وَنَتَجَاوَزُ عَن
سَيِّـَٔاتِهِمْ فِىٓ أَصْحَٰبِ ٱلْجَنَّةِ ۖ وَعْدَ ٱلصِّدْقِ ٱلَّذِى كَانُوا۟ يُوعَدُونَ ١٦

"Njeriun e kemi porositur të jetë i sjellshëm ndaj prindërve të vet. Nëna e mbart atë me mund dhe me mund e lind. Ai mbartet dhe ushqehet me gji për tridhjetë muaj dhe, kur arrin në moshën e burrërisë e i mbush dyzet vjet, ai thotë: 'O Zoti im! Më frymëzo që të të falënderoj për begatitë që Ti më ke dhënë mua dhe prindërve të mi dhe që të bëj vepra të mira, me të cilat Ti do të jesh i kënaqur! Më dhuro pasardhës të mirë! Tek Ty kthehem i penduar dhe Ty të dorëzohem!'."

"Këta janë ata njerëz, të cilëve do t'ua pranojmë veprat e tyre më të mira e nuk do t'ua vëmë re veprat e tyre të këqija. Ata do të jenë banorë të Xhennetit; ky është premtimi i vërtetë, që u është premtuar."

Komentimi

O ti, njeri, bëju mirë prindërve të tu!

Këto ajete dhe ato që vijnë më pas, sqarojnë gjendjet e dy grupeve: të zullumqarëve dhe të punëmirëve, për të cilët është folur në mënyrë të përmbledhur në ajetet e kaluara.

Ajeti 15 trajton situatën e punëmirëve. Ai fillon me kërkesën për t'u sjellë mirë me prindërit dhe me falënderimin e tyre për përpjekjet dhe lodhjet që kanë bërë për rritjen e fëmijëve. Kjo konsiderohet si falënderim i All'llahut të Madhëruar.

Ajeti thotë: **"Njeriun e kemi porositur të jetë i sjellshëm ndaj prindërve të vet."**.

Fjalët *"el vesijjetu"* dhe *"et teusijetu"* janë përdorur me kuptimin e pakufizuar të porosisë dhe nuk kufizohet me porositë e pasvdekjes. Edhe këtë e kanë komentuar dhe kanë pranuar se ato fjalë janë përdorur me kuptimin e urdhrit dhe të legjislacionit.

Më pas ajeti vazhdon me shkakun, pse duhet të njihet e drejta e nënës. Ajeti thotë: **"Nëna e mbart atë me mund dhe me mund e lind. Ai mbartet dhe ushqehet me gji për tridhjetë muaj."**.

Gjatë kësaj kohe nëna bën sakrificat më të mëdha për rritjen e të birit.

Gjendja e nënës ndryshon që në ditët e para të ngjizjes së pikës së ujit. Ndryshimi vazhdon pa ndërprerje, ashtu edhe vështirësitë. Nëna përjeton një gjendje që quhet 'gjendja e dëshirës me gjithë shpirt të diçkaje', që është nga situatat më të vështira me të cilat përballet ajo. Mjekët thonë se kjo gjendje lind si rezultat i pakësimit të lëndëve në trupin e nënës dhe si rezultat i altruizmit të saj për fëmijën.

Zhvillimi i embrionit thith shumë lëndë ushqyese nga trupit i nënës. Kjo lë gjurmë te kockat dhe nervat e saj. Ndonjëherë merr nga ajo gjumin e saj, ushqimin, rehatinë dhe qetësinë e saj. Në periudhën e fundit të shtatzënisë, vështirësohet për të edhe e ecura, qëndrimi ulur dhe në këmbë, por ajo i përballon të gjitha këto vështirësi me durim, dashamirësi dhe dashuri për foshnjën, e cila do të vijë shumë shpejt në dynja dhe do t'i buzëqeshë nënës së saj.

Koha e lindjes së foshnjës është momenti më i vështirë i jetës së nënës, e cila ndonjëherë sakrifikon edhe jetën e saj për hir të shëndetit të foshnjës.

E sido që të jetë, nëna e lind foshnjën e saj. Që këtu nis një fazë tjetër vështirësie, faza e kujdesit të vazhdueshëm për fëmijën, ditë e natë, faza e përkushtimit maksimal për t'ia plotësuar të gjitha nevojat fëmijës, sepse foshnja nuk ka asnjë fuqi për të treguar, nëse i dhemb diçka, nuk di të tregojë vendin ku i dhemb, nuk di të tregojë kur ka uri, kur ka etje, kur ka vapë dhe ftohtë. Është nëna ajo që përkushtohet dhe ia plotëson të gjitha nevojat fëmijës së saj me durim dhe këmbëngulje.

Edhe kujdesi për pastërtinë e fëmijës, në këtë fazë, është një problem rraskapitës, ashtu siç është i lodhshëm edhe sigurimi i

ushqimit të tij, të cilin e thith nga esenca e nënës së tij dhe që është një altruizëm i madh.

Sëmundjet e ndryshme që e prekin fëmijën në këtë fazë, janë një problem tjetër, të cilat nëna duhet t'i përballojë me durimin e saj të mahnitshëm.

Kur'ani flet për vështirësitë e shumta të nënës dhe nuk ka përmendur gjë për babanë, jo se ai nuk ka rëndësi. Dihet se edhe ai merr pjesë, bashkë me nënën, në shumë prej këtyre problemeve, por pjesa e vështirësive të nënës është më e madhe, prandaj është përqendruar tek ajo.

Këtu duhet të diskutohet një problem. Koha e gjidhënies, në ajetin e 233 të sures "El Bekare" është përmendur dy vite të plota, pra, 24 muaj: **"Nënat, ato që duan të plotësojnë gjidhënien, janë të detyruara t'u japin gji fëmijëve të vet dy vjet të plota."**, ndërsa në ajetin që ne po komentojmë, thuhet se e gjithë koha e barrës dhe e gjidhënies është tridhjetë muaj. A ka mundësi që periudha e barrës të jetë gjashtë muaj?!

Dijetarët e jurisprudencës fetare dhe komentuesit e Kur'anit i janë përgjigjur kësaj pyetjeje, duke u mbështetur edhe në historitë islame. Ata kanë thënë se periudha më e shkurtër e barrës është gjashtë muaj dhe periudha më e gjatë që plotëson gjidhënien, është 24 muaj. Kjo është mbështetur edhe nga një grup mjekësh të vjetër, si Xhalinusi dhe Ibn Sina, të cilët kanë thënë se kanë qenë dëshmitarë dhe e kanë parë me sytë e tyre foshnjën që ka lindur gjashtë muajsh, por duhet theksuar se sa herë që shkurtohet periudha e barrës, duhet të plotësohet periudha e gjidhënies, derisa të bëhen 30 muaj.

Nga Ibn Abasi është transmetuar se, nëse periudha e barrës është 9 muaj, fëmijës duhet t'i jepet gji për 21 muaj, nëse barra ka qenë gjashtë muaj, fëmija duhet të ushqehet me gji 24 muaj.

Më pas ajeti thotë se jeta e këtij njeriu vazhdon, **"kur arrin në moshën e burrërisë e i mbush dyzet vjet."**.[1]

Disa komentues mendojnë se pjekuria është e harmonizuar bashkë me moshën e të dyzetave. Në këtë moshë harmonizohet pjekuria trupore dhe ajo mendore e logjike. Komentuesit thonë se edhe Profetët u dërguan si të tillë në këtë moshë.

Më pas, diskutimi ka vazhduar lidhur me moshën, kur plotësohet pjekuria e fuqisë trupore. Disa e konsiderojnë atë moshën e pjekurisë, për të cilën është folur në ajetin 34 të sures "El Isra", në lidhje me jetimët, kurse disa transmetime e kanë bërë të qartë se ajo është, përgjithësisht, mosha rreth të tetëmbëdhjetave.

Në një hadith thuhet: "*Shejtani e vendos dorën e tij mbi fytyrën e atij që i ka kaluar të dyzetat dhe nuk është penduar dhe thotë: 'Betohem se kjo fytyrë nuk do të shpëtojë.'*".[2]

[1] Fjala *(hatta)* këtu është qëllim i fjalisë së aluduar dhe vlerësimi është: jeton njeriu dhe vazhdon të jetojë derisa të arrijë pjekurinë e vet. Disa e kanë konsideruar si qëllim të fjalës "*vessajna*", ose të mbikqyrejs së prindërve ndaj fëmijës së tyre. Që të dy këto mendime janë të largëta me kuptimin e ajetit, sepse urdhërimi i All'llahut të Madhëruar për mirësjellje ndaj prindërit nuk ndalon në moshën e të dyzetave, dhe se nuk vazhdon mbikqyrja e prindërve ndaj fëmijës së tyre derisa të arrijë të dyzetat.

[2] Tefsiri "Ruhul Meanij", vëll. 26, f. 17.

Nga Ibn Abasi transmetohet: *"Kush i arrin të dyzetat dhe të mirat e tij nuk ua kalojnë punëve të këqija, le të përgatitet për zjarrin."*[1]

Megjithatë, Kur'ani, në vazhdim të këtij hadithi, thotë: "Pa dyshim se njeriu me logjikë dhe besimtar, kur arrin të dyzetat, ka tri kërkesa për Zotin e tij. Në fillim thotë: **'O Zoti im! Më frymëzo që të të falënderoj për begatitë që Ti më ke dhënë mua dhe prindërve të mi...'"**.[2]

Kjo mënyrë të shprehuri tregon se njeriu në këtë moshë e kupton thellësinë dhe gjerësinë e mirësive të All'llahut të Madhëruar dhe po kështu e kupton që prindërit e tij kanë përballuar dhe përballojnë mundime rraskapitëse, derisa ai të arrinte në këtë moshë. Ai i kupton plotësisht këto, sepse, në shumicën e rasteve, në këtë moshë bëhet prind vetë dhe i përjeton të gjitha përpjekjet që prindërit e tij kanë bërë për ta rritur dhe për ta edukuar atë. Kjo e bën që t'i falënderojë prindërit për sa kanë bërë, por të falënderojë edhe më shumë All'llahun e Madhëruar për mirësitë që i dha.

Kërkesa e tij e dytë është: **"...të bëj vepra të mira, me të cilat Ti do të jesh i kënaqur."**.

Kërkesa e tij e fundit është: **"Më dhuro pasardhës të mirë!"**.

Fjala *"lii"* - *"mua"* tregon se prindi kërkon për fëmijët e tij më të mirat që atyre do t'u nevojiten.

---

[1] "Irshadul Kulub", vëll. 1, f. 185.

[2] Fjala *"euzi'ni"* rrjedh nga fjala *"el ijzau"*, e cila përmendet me shumë kuptime: frymëzimi dhe ndalimi ndaj shmangies, të bërit ekzistuese të dhembshurisë, të dashurisë dhe suksesit.

Togfjalëshi **"pasardhës të mirë"**, tregon se punët e mira do të vazhdojnë në të gjithë pasardhësit e tij.

E veçanta është se ai, në fillim, lutet për prindërit e tij, për vete lutet në lutjen e dytë, kurse për fëmijët në të tretën. Kështu është njeriu i mirë, i cili me një sy shikon veten e tij dhe me syrin tjetër shikon të tjerët, që kanë bërë mirë për të.

Ajeti në fund sqaron mirë dy kërkesa. Secila prej tyre është një tregues i një programi pune. Ajeti thotë: **"Tek Ty kthehem i penduar"**, sepse unë kam arritur në një fazë, kur duhet të kujdesem për vazhdimin e jetës sime dhe të eci në Rrugën Tënde, sa të jem gjallë.

Po, unë i kam arritur të dyzetat dhe është e shëmtuar për një rob si unë të vijë tek Ti dhe të mos e ketë larë shpirtin e tij me ujin e pendimit, të mos e ketë pastruar shpirtin e tij me kthimin në Rrugën e Zotit të tij dhe të mos trokasë në derën e mëshirës së Tij.

Dhe e fundit: **"Ty të dorëzohem!"**.

Këto dy fjali janë mbështetje e tri lutjeve. Ato tregojnë se, pasi njeriu pendohet tek All'llahu i Madhëruar, u dorëzohet urdhëresave të Tij, sepse All'llahu është Ai që bën dhurata me mëshirën e Tij. O All'llah, më përfshi mua në mirësitë dhe begatitë e Tua!

Në fillim tregon për tri shpërblime të rëndësishme: **"Këta janë ata njerëz, të cilëve do t'ua pranojmë veprat e tyre më të mira"**, domethënë se përgëzimi më i madh është që All'llahu, i Forti, Dhuruesi, të pranojë veprën e një robi të dobët, që nuk ka fuqi. Vetëm ky pranim, pa folur për ndikimet e tjera të tij, është një krenari e madhe dhe një dhuratë shpirtërore e lartë.

All'llahu i Madhëruar i pranon të gjitha veprat e mira: **"...do t'ua pranojmë veprat e tyre më të mira."**.

Për përgjigjen e kësaj pyetjeje, një pjesë e komentuesve thotë se me veprat e mira duhet të kuptohen detyrimet dhe veprat e pëlqyeshme, të cilat janë përballë veprave të pranuara, janë punët e mira. Mirëpo kur veprat e mira nuk janë në vendin e pranimit, shpërblimi nuk ka lidhje me të.[1]

Përgjigjja tjetër është: All'llahu i Madhëruar i bën veprat më të mira të tyre si standard të pranimit. Edhe veprat që llogariten si më pak të rëndësishme, Ai i bën si veprat më të mira me mirësinë dhe mëshirën e Tij. Kjo i ngjan shitësit që ekspozon mallra me çmime të ndryshme dhe blerësi e ble mallin me një çmim më të lartë dhe më të mirë, për respekt dhe mirësi të tij. Prandaj, çfarëdo që të thuhet për butësinë e All'llahut dhe mirësinë e Tij, nuk është çudi.

Dhurata e dytë është pastrimi i tyre. Ajeti thotë: **"...nuk do t'ua vëmë re veprat e tyre të këqija."**.

Dhurata e tretë është: **"Ata do të jenë banorë të Xhennetit."**.

Ata pastrohen nga gabimet që kanë bërë dhe vihen në krah të punëmirëve, të të pastërve, si dhe të atyre që janë të afërt me All'llahun e Madhëruar.

---

[1] Et Tabersiju në tefsirin "Mexhmaul Bejan", vëll. 9, f. 132; Eruditi Tabatabaij në tefisirin "El Mijzan", vëll. 18, f. 203 dhe Fakhru Rrazij, në tefsirin "El Kebijr" etj., në fundin e ajetit që po komentojmë.

Nga ky argumentim kuptohet se *"banorë të Xhennetit"* janë robtë e afërt, të cilët nuk kanë mëkate. Bashkohen me ta dhe besimtarët e penduar, pasi të marrin faljen e All'llahut dhe kënaqësinë e Tij.

Në fundin e tij, për të mbështetur mirësitë që u përmendën më parë, ajeti shton: **"Ky është premtimi i vërtetë, që u është premtuar."**.

A mund të mos jetë premtim i sigurt, kur mosmbajtja e premtimit vjen, ose si shkak i pendimit, ose nga injoranca, ose nga dobësia dhe pafuqia? All'llahu i Madhëruar është larg të gjitha këtyre çështjeve.

Hulumtime

1- Këto ajete simbolizojnë njeriun besimtar, banor i Xhennetit, i cili përqafon në fillim fazën e plotësimit trupor, më pas fazën e plotësimit logjik, e më pas arrin drejt pozitës së falënderimit të mirësive të All'llahut të Lartësuar. Falënderon prindërit dhe pendohet për mëkatet që ka bërë. Kryen vepra të mira. Njëra prej tyre është edukimi i fëmijëve. Së fundi, i dorëzohet plotësisht All'llahut të Madhëruar dhe urdhëresave të Tij. Kjo e fut atë në mëshirën e All'llahut, në faljen e Tij dhe në mirësitë e Tij të ndryshme, që nuk numërohen dot.

2- Fjalia **"Njeriun e kemi porositur",** tregon bamirësinë për dy prindërit, e cila është prej themeleve njerëzore. Ata njerëz që e kundërshtojnë zbatimin e kësaj detyre, nuk janë myslimanë të vërtetë, madje nuk e meritojnë as emrin njeri.

3- Fjala *"ihsanen" -"të bësh mirë"*, përdoret për të treguar se njeriu, me urdhrin e All'llahut, duhet të sillet mirë me të dy prindërit. Kjo është një mirësi e bukur, në këmbim të shërbimeve të mëdha.

4- Dhimbjet dhe kujdesi i nënës në rrugën e edukimit të fëmijës janë më shumë të ndjeshme dhe të prekshme, sepse mundimi i nënës është më i rëndësishëm, nëse krahasohet me mundimin e babait, prandaj në historitë islame përkushtimi i nënës është vënë në qendër të vëmendjes.

Në një hadith thuhet se një njeri vjen tek i Dërguari i All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe i thotë: "Kush e meriton më tepër respektin?"

I Dërguari i All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* tha: "Nëna jote."

I ardhuri tha: "Po pastaj?"

I Dërguari i All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* tha: "Nëna jote."

I ardhuri e pyeti përsëri: "Po pastaj?"

I Dërguari i All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i tha përsëri: "Nëna jote."

I ardhuri e pyeti sërish: "Po pastaj?"

I Dërguari i All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*i tha: "Babai yt."[1]

Në një hadith tjetër thuhet se një njeri e mbante në krahë nënën e tij shumë të moshuar dhe bënte tauafin me të. Ky njeri shkon te Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e i thotë: "A ia kam dhënë hakun nënës?"

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i tha: "Jo, as edhe për një ofshamë të vetme.".[2]

5- Ajetet kur'anore i konsiderojnë lidhjet familjare, respektimin, nderimin e prindërve dhe kujdesin për edukimin e fëmijëve çështje shumë të rëndësishme, sepse familjen e vlerësojnë si qelizën e shoqërisë njerëzore, si themelin e saj.

Sa më të lidhura të jenë ato, aq më e fortë dhe më e qëndrueshme do të jetë shoqëria. Një nga faktorët e prishjes së shoqërisë njerëzore, në kohët moderne, është shkatërrimi i sistemit familjar, humbja e respektit për prindërit, nëpërkëmbja e dashurisë bashkëshortore.

Në kohët moderne, pamja më e dhimbshme është humbja e kujdesit për të moshuarit, të cilët shpesh përfundojnë të përzënë edhe nga shtëpitë. Kjo është një nga dëshmitë më të hidhura, sepse të moshuarit, pasi sakrifikuan gjithë jetën për fëmijët e tyre, pikërisht kur tashmë kanë nevojë për përkrahjen e fëmijëve të tyre, braktisen.

[1] Tefsiri "Ruhul Meanij", vëll. 26, f. 16.
[2] Tefsiri "Fi Dhilalil Kur'an", vëll. 7, f. 415.

Këto pamje të hidhura janë portreti i qytetërimit modern, të cilit i është larguar besimi dhe i është prishur feja.

6- Sifjalia: **"të bëj vepra të mira, me të cilat Ti do të jesh i kënaqur"**, përdoret për të treguar se punë e mirë është ajo që bëhet për kënaqësinë e All'llahut të Madhëruar. Sifjalia: **"do t'ua pranojmë veprat e tyre më të mira"**, është përmendur në shumë ajete të Kur'anit të Lavdishëm. Kjo fjali përdoret për të treguar qartë mirësinë e All'llahut, e cila është aq e madhe, saqë nuk mund të llogaritet në pozitën e shpërblimit të robëve. All'llahu i Madhëruar, punët e tyre më të mira, i bën një standard për të gjitha punët e tjera të mira të tyre, për llogaridhënien dhe shpërblimin.

Ajetet 17 – 19

وَٱلَّذِى قَالَ لِوَٰلِدَيۡهِ أُفٍّ لَّكُمَآ أَتَعِدَانِنِيٓ أَنۡ أُخۡرَجَ وَقَدۡ خَلَتِ ٱلۡقُرُونُ مِن قَبۡلِي وَهُمَا يَسۡتَغِيثَانِ ٱللَّهَ وَيۡلَكَ ءَامِنۡ إِنَّ وَعۡدَ ٱللَّهِ حَقّٞ فَيَقُولُ مَا هَٰذَآ إِلَّآ أَسَٰطِيرُ ٱلۡأَوَّلِينَ١٧ أُوْلَٰٓئِكَ ٱلَّذِينَ حَقَّ عَلَيۡهِمُ ٱلۡقَوۡلُ فِيٓ أُمَمٖ قَدۡ خَلَتۡ مِن قَبۡلِهِم مِّنَ ٱلۡجِنِّ وَٱلۡإِنسِۖ إِنَّهُمۡ كَانُواْ خَٰسِرِينَ١٨ وَلِكُلّٖ دَرَجَٰتٞ مِّمَّا عَمِلُواْۖ وَلِيُوَفِّيَهُمۡ أَعۡمَٰلَهُمۡ وَهُمۡ لَا يُظۡلَمُونَ١٩

"Mirëpo ndonjëri u thotë prindërve të vet: 'Uf ju! A po më premtoni se do të ringjallem, ndonëse para meje kanë kaluar shumë brezni?!'. Kur ata i drejtohen All'llahut për ndihmë, (duke i thënë djalit)**: 'Mjerë për ty! Beso, sepse premtimi i All'llahut është i vërtetë!', ai përgjigjet: 'Këto janë vetëm përrallat e popujve të lashtë!'"**

"Ata janë të cilët do të përsojnë fatin e kombeve të kaluara prej xhindeve dhe njerëzve, ndaj të cilëve u përmbush Fjala (e dënimit)**. Vërtet, ata janë përherë të humburit."**

"Për të gjithë do të ketë shkallë të caktuara, sipas asaj që kanë punuar, në mënyrë që All'llahu t'i shpërblejë për veprat e tyre. Askujt nuk do t'i bëhet padrejtësi."

Komentimi

Ata që i shkelin të drejtat e prindërve

Në ajetet e kaluara, u diskutua për besimtarët që zgjodhën rrugën e afrimit me All'llahun. Ata që e arritën qëllimin, jo vetëm mëshira e All'llahut i përfshiu ata, por mirësia e Tij i nderoi. E gjitha kjo u arrit nën hijen e besimit dhe veprës së mirë, nga falënderimi i All'llahut të Madhëruar për begatitë e Tij, nga kujdesi për të drejtat e prindërve dhe pasardhësve.

Në këtë ajet, do të diskutojmë për jobesimtarët, mohuesit e të bukurës, për të pabindurit ndaj prindërve të tyre. Ajeti thotë: **"Mirëpo ndonjëri u thotë prindërve të vet: 'Uf ju! A po më premtoni se do të ringjallem, ndonëse para meje kanë kaluar shumë brezni?!'"**.[1]

Por dy prindërit e tij besimtarë nuk u dorëzuan përpara fëmijës së tyre të pabindur dhe të humbur. Ajeti thotë: **"Kur ata i drejtohen All'llahut për ndihmë,** (duke i thënë djalit)**: 'Mjerë për ty! Beso, sepse premtimi i All'llahut është i vërtetë!'"**.

Por ai refuzon dhe ecën në rrugën e humbjes dhe të kokëfortësisë, të cilën e ka zgjedhur për veten e tij. Ai u përgjigjet gjithë mendjemadhësi e kryeneçësi dhe nuk i vjen ndot prej tyre: **"Ai përgjigjet: 'Këto janë vetëm përrallat e popujve të lashtë!'"**.

---

[1] "**ndonjëri u thotë**" është kryefjala. Kallëzuesi, sipas mendimit të shumë komentuesve, është: "**Ata janë të cilët**"... që thuhet në ajetin tjetër. Nuk ka kundërshti midis të qenit të kryefjalës në njëjës dhe kallëzuesit **"janë"** në shumës, sepse ajo që synohet prej saj, është tipi, lloji.

Edhe ajo që thoni për Ahiretin dhe llogaridhënien nuk është gjë tjetër, veçse trillim dhe histori e gënjeshtërt, që ju ka ardhur juve prej atyre që kanë qenë në të kaluarën para jush. Nuk është e besueshme dhe nuk duhet të udhëzohesh me të.

Nga ky ajet mund të nxjerrim disa mësime, të cilat janë:

Mungesa e respektit të prindërve dhe lëndimi i tyre. Do të mjaftonte vetëm një "*uf*" i tyre për të qenë i humbur.[1]

Mësimi tjetër: Ata nuk besojnë në Ditën e Kiametit, nuk besojnë Ringjalljen dhe shpërblimin, tallen me to, i përqeshin dhe i konsiderojnë si legjenda dhe fantazi të kota trilluese.

Mësimi i tretë: Ata nuk dëgjojnë dhe nuk i binden të vërtetës. Shpirtrat e tyre janë të mbushur me kryeneçësi, kryelartësi dhe egoizëm.

Prindërit e përkushtuar shpenzojnë të gjithë mundin e tyre, për ta ndihmuar fëmijën e tyre të shkëputet nga injoranca, hutimi, që të mos sprovohet me ndëshkimin e dhimbshëm të All'llahut. Megjithëkëtë, ai refuzon dhe vazhdon të ecë në rrugën e gabuar të mohimit dhe këmbëngul në të. Në fund, dy prindërit e tij e lënë atë në punën e tij, pasi janë mërzitur e janë dëshpëruar prej tij.

Ajetet e kaluara treguan për sevapin që fitojnë besimtarët që kryejnë vepra të mira, kurse këto ajete qartësojnë dënimin e veprave të jobesimtarëve të humbur, guximtarë të paturpshëm para All'llahut.

[1] Kemi përmendur komentime të tjera rreth kuptimit të pasthirrmës "uff" në suren "El Isra", ajeti 23.

Ajeti thotë: **"Ata janë të cilët do të pësojnë fatin e kombeve të kaluara prej xhindeve dhe njerëzve, ndaj të cilëve u përmbush Fjala** (e dënimit)**. Vërtet, ata janë përherë të humburit."**.[1] A ka humbje më të madhe se sa të të përfshijë zemërimi dhe inati i All'llahut?!

Këto ajete krahasojnë banorët e Xhennetit me banorët e Xhehennemit. Nga ky krahasim dallohen këta tregues:

Banorët e Xhennetit udhëzohen dhe përsosen vazhdimisht, ndërsa banorët e Xhehennemit kanë humbur besimin dhe çdo gjë që kishin, prandaj ata janë të humbur.

Të parët vlerësojnë të bukurën dhe falënderojnë edhe prindërit e tyre, kurse të dytët mohojnë të bukurën me armiqësi, pa asnjë lloj kulture. Ngrihen edhe kundër prindërve të tyre.

Banorët e Xhennetit janë më afër All'llahut në Xhennet, kurse banorët e Xhehennemit janë bashkë me jobesimtarët në zjarr dhe secili prej tyre shoqërohet me atë që merr si shembull, me atë që është në anën e tij.

Banorët e Xhennetit pendohen nga lëshimet që kanë bërë dhe i binden të vërtetës, kurse banorët e Xhehennemit janë zullumqarë, arrogantë, rebelë, egoistë dhe mendjemëdhenj.

Banorët e Xhehennemit mbështesnin shmangiet e tyre në shmangiet e popujve të kaluar, por do të tubohen bashkë me ata në zjarr.

---

[1] Togfjalëshi: "**u përmbush Fjala**", tregon Fjalën e All'llahut, për dënimin e jobesimtarëve dhe të kriminelëve. Vlerësimi është: Ka marrë fund vendimi për ta, sepse ata janë banorë të Xhehenemit...

Ajeti i fundit thotë: **"Për të gjithë do të ketë shkallë të caktuara, sipas asaj që kanë punuar"**[1], sepse nuk janë në të njëjtën shkallë të gjithë banorët e Xhennetit apo të gjithë banorët e Xhehennemit. Përkundrazi, për secilin prej tyre ka shkallë dhe nivele të ndryshme, të cilat ndryshojnë me ndryshimin e veprave të tyre, sipas nijetit të sinqertë dhe peshores së njohurisë së tyre. Baza e drejtësisë është gjykatësi.

Fjala *"ed derexhatu"* është shumësi i fjalës *"derexhe"* dhe përdoret për të treguar shkallët në të cilat ngjitet njeriu duke u kacavjerrë, kurse fjala *"ed derekatu"* është shumësi i fjalës *"derekun"* dhe tregon shkallën nga e cila njeriu zbret më poshtë. Prandaj, për Xhennetin përdoret fjala *"derexhat"*, kurse për zjarrin përdoret fjala *"derekat"*. Por, meqë ajeti që po komentojmë, ka folur edhe për rëndësinë e pozitës së banorëve të Xhennetit, edhe për atë të banorëve të Xhehennemit, është përdorur fjala *"ed derexhatu"*. Kjo është thënë në kapitullin e triumfit.[2]

Më pas ajeti shton: **"All'llahu t'i shpërblejë për veprat e tyre."**. Kjo mënyrë të shprehuri është një tjetër tregues i çështjes së bashkëveprimit të veprave, ku veprat e birit të Ademit do të jenë bashkë me të atje dhe bëhen kërkuese të mëshirës dhe qetësisë së tij, kurse veprat e tij të këqija, bëhen shkak i fatkeqësisë dhe i ndëshkimit të dhimbshëm.

---

[1] "*min*" te togfjalëshi "**për veprat e tyre**" është për pikën e nisjes – apo siç quhet si pikë kulmore, ose me kuptimin e shkakores, domethënë: për shkak të asaj që kanë vepruar.

[2] Fjala "*dirkun*"– me sukunin (heshtjen) e shkronjës së mesit dhe *"dereke"*– me zanoren *"e"* të mesit, është me kuptimin pika më e thellë e thellësisë. Ndonjëherë vjen *"ed dereku"*, me zanoren *"e"*, me kuptimin "dështim", kurse "*ed derku*", me heshtjen e mesit, tregon kuptimin e një gjëje dhe perceptimi i saj, me përshtatjen e tij, arritjen në thellësinë dhe të vërtetën e tij.

Në fund, si një garanci për këtë, ajeti thotë: **"Askujt nuk do t'i bëhet padrejtësi."**, sepse ata do të shikojnë veprat e tyre dhe shpërblimin e merituar. Atëherë, si mund të mendohet padrejtësia dhe tirania?!

Duke shtuar edhe se shkallët në ngjitje të këtyre dhe shkallët në zbritje të atyre, janë përcaktuar me përpikëri, deri edhe në veprat më të vogla, të mira apo të këqija qofshin, as nuk mund të imagjinohet padrejtësia.

Hulumtim

Si e devijoi Beni Umeje këtë ajet?

Në një transmetim thuhet se Muavije i dërgoi një letër Mervanit që ishte guvernator në Medine. Në atë letër e urdhëronte që t'u merrte besën njerëzve për djalin e tij, Jezidin. Abdurrahman ibn Ebu Bekri, që ishte i pranishëm në mbledhje, tha: "Muavija dëshiron ta bëjë këtë punë si Herkuli dhe Kisraja (mbretërit e Romës dhe të Persisë). Pra, kur të vdesin baballarët, vendin e tyre e marrin fëmijët e tyre, edhe nëse nuk janë të denjë për atë, apo të jenë shumë të shthurur.

Mervani thirri me zë të lartë në mimber: "Hesht, se për ty ka zbritur ajeti: **"Mirëpo ndonjëri u thotë prindërve të vet: "Uf ju!"**.

Aishja, e cila ishte e pranishme, tha: "Gënjeshtar, unë e di mirë se përse ka zbritur ky ajet dhe po të duash, ta them edhe emrin e tij, edhe familjen e tij. I Dërguari i All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)* e ka mallkuar babanë tënd, kur ti ishe në kurrizin e tij, prandaj ti je përfundimi i mallkimit të të Dërguarit të All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)*."[1]

Mëkati i Abdurrahmanit ishte dashuria dhe respekti i tij për Prijësin e besimtarëve, Imam Aliun *(Paqja qoftë mbi të!)*. Kjo ishte një çështje që, nga njëra anë, i bënte të ndiheshin shumë keq Beni Umejet, kurse, nga ana tjetër, ai kundërshtonte këmbënguljen për trashëgiminë e kalifatit dhe konvertimin e tij në sulltanat. Prandaj, marrja e besës për Jezidin konsiderohej një lloj shmangieje e llojit të Kisrasë dhe të Herkulit. Kjo është arsyeja se pse armiqtë e rrezikshëm e luftonin Islamin, domethënë familja e Umejeve, të cilët falsifikuan ajetet kur'anore që lidheshin me këtë çështje.

Përgjigjja që i dha Aishja, duke i kujtuar se All'llahu i Madhëruar ia kishte mallkuar babanë, kur ai e mbante në kurriz, ishte mjaft e goditur. Kjo është treguar edhe në ajetin e 60 të sures "El Isra": **"... dhe pemën e mallkuar të përmendur në Kur'an ... "**.[2]

[1] Tefsiri "El Kebijr", në komentimin e tij, vëll. 10, f. 159. Ky tregim është transmetuar me një ndryshim të vogël në tefsirin e "Kurtubijjut", vëll. 9, f. 6017.

[2] Kjo temë përsëritet në komentimin e fundit të ajetit 60 të sures "El Isra". Duhet të kemi kujdes se Mervan ibn Hakemi është i biri i Ebu Asit dhe ky, është i biri i Umejes.

Ajeti 20

وَيَوْمَ يُعْرَضُ ٱلَّذِينَ كَفَرُواْ عَلَى ٱلنَّارِ أَذْهَبْتُمْ طَيِّبَٰتِكُمْ فِى حَيَاتِكُمُ ٱلدُّنْيَا وَٱسْتَمْتَعْتُم بِهَا فَٱلْيَوْمَ تُجْزَوْنَ عَذَابَ ٱلْهُونِ بِمَا كُنتُمْ تَسْتَكْبِرُونَ فِى ٱلْأَرْضِ بِغَيْرِ ٱلْحَقِّ وَبِمَا كُنتُمْ تَفْسُقُونَ۝٢٠

"Ditën, kur ata që kanë mohuar do të vihen para Zjarrit (do t'u thuhet)**: 'Ju keni shfrytëzuar gjithë të mirat në jetën tuaj tokësore dhe jeni kënaqur me to, ndërsa sot do të ndëshkoheni me dënim poshtërues, sepse keni qenë arrogantë në Tokë pa kurrfarë të drejte dhe nuk i jeni bindur All'llahut.'"**

Komentimi

Përkorja (zuhdi) dhe kursimet për Jetën Tjetër

Këto ajete vazhdojnë diskutimin rreth ndëshkimit të jobesimtarëve dhe kriminelëve. Këtu përmendin njërën anë të llojeve të ndëshkimit trupor dhe shpirtëror, që do të marrin jobesimtarët. Ajeti thotë: **"Ditën, kur ata që kanë mohuar do të**

vihen para Zjarrit (do t'u thuhet)**: 'Ju keni shfrytëzuar gjithë të mirat në jetën tuaj tokësore dhe jeni kënaqur me to...'"**.[1]

Po, sepse keni qenë të zhytur në pasione dhe nuk pyesnit për gjë tjetër, përveç kënaqësive dhe të mirave të kësaj bote materiale. Që të ishit të çliruar nga të gjithë zinxhirët, e mohuat Ahiretin dhe u treguat mendjemëdhenj ndaj dhuratave.

Ajeti thotë: **"...ndërsa sot do të ndëshkoheni me dënim poshtërues, sepse keni qenë arrogantë në Tokë pa kurrfarë të drejte dhe nuk i jeni bindur All'llahut."**.

Sot do të merrni shpërblimin për të gjitha kënaqësitë e kota, për pasionet e verbra, për adhurimin e dëshirës, të mendjemadhësisë, të shthurjes e të imoralitetit dhe do të shijoni ndëshkimin nënçmues dhe të përbuzur, për shkak të atyre veprave.

Hulumtime

1- Ky ajet thotë se jobesimtarët dërgohen pranë zjarrit në Kiamet. E njëjta gjë është përmendur në ajetin 46 të sures "El Mu'minun", kur flitet për ndëshkimin e faraonëve në jetën e ndërmjetme. Ajeti thotë: **"Ata i nënshtrohen zjarrit mëngjes e**

[1] Fjala *"jeumun"* është ndajfolje dhe është e lidhur me foljen e papërmendur prej fjalisë vijuese. Vlerësimi është: Ditën kur të paraqiten para zjarrit ata që nuk besuan dhe u thuhet atyre, i shfrytëzuat të mirat tuaja...

mbrëmje...”. Në disa ajete të tjera të Kur’anit, lexojmë se Xhehennemi u paraqitet jobesimtarëve: **“Atë Ditë, ua paraqesim Xhehennemin jobesimtarëve me një paraqitje të hapët.”**.[1]

Prandaj disa komentues kanë thënë se në Kiamet ka dy lloje paraqitjesh: Para llogarisë u paraqitet Xhehennemi kriminelëve, që t’u mbushet shpirti me frikë dhe tmerr. Kjo, në vetvete, është një dënim dhe ndëshkim vetjak. Pastaj, sipas llogarisë dhe hedhjes së tyre në Xhehennem, ata paraqiten para ndëshkimit të All’llahut.[2]

Disa komentues të tjerë thanë se jobesimtarët nuk paraqiten para zjarrit, por paraqitet zjarri para jobesimtarëve. Kjo duket se nuk është e logjikshme. Si u paraqitka vetë zjarri para jobesimtarëve?

Mirëpo, mund të përmendet edhe kjo si përgjigje, sepse disa ajete e kanë përmendur se All’llahu i Madhëruar i flet zjarrit dhe ai përgjigjet. All’llahu i Madhëruar thotë: **“A u mbushe?”** Zjarri përgjigjet: **“A ka më tepër?”**.[3]

E vërteta e paraqitjes është heqja e pengesave midis dy gjërave, derisa ata të takohen dhe të jenë ballë për ballë. E njëjtë është edhe situata në lidhje me jobesimtarët dhe zjarrin. Me të vërtetë që pengesat hiqen mes atyre dhe mund të themi se jobesimtarët paraqiten para zjarrit, ashtu siç paraqiten para tyre. Secila prej shprehjeve është e saktë.

---

[1] Sure “El Kehf”, ajeti 100.
[2] Tefsiri “El Mijzan”, vëll. 18, f. 223, fundi i ajeteve, në fjalë.
[3] Sure “El Kaf”, ajeti 30.

Sidoqoftë, nuk ka nevojë që ta konsiderojmë të njëjtë paraqitjen me hyrjen në zjarr, ashtu siç e përmend Tabrasiju në veprën "Mexhmaul Bejan". Madje, nuk ka dyshim se kjo paraqitje, në vetvete, është një dënim i dhimbshëm, i tmerrshëm, të cilin jobesimtarët e shikojnë me sytë e tyre, në të gjitha anët e Xhehennemit, nga jashtë, para se të hidhen në të. Jobesimtarët shikojnë vendin e tyre të përbuzur, në të cilin do të ndëshkohen dhe do të ndiejnë dhimbjet.

2- Sifjalia: **"Ju keni shfrytëzuar gjithë të mirat në jetën tuaj tokësore..."** tregon kënaqësinë me shijet e dynjasë, kurse folja **"keni shfrytëzuar"** tregon se këto shijime dhe mirësi mbarojnë me kënaqjen me to.

Të kënaqurit me dhuratat e All'llahut dhe mirësitë e Tij në këtë botë, nuk është çështje e përbuzur dhe e shëmtuar, përkundrazi, i përbuzur është ai që zhytet në kënaqësitë materiale dhe harron të përkujtojë All'llahun dhe Kiametin.

Kjo mënyrë të shprehuri është përmendur vetëm në këtë ajet të Kur'anit. Ajo tregon se njeriu largohet ndonjëherë nga kënaqësitë e dynjasë, ose tregon se ai merr prej saj vetëm atë që mban në Rrugën e Drejtë pasardhësit e tij dhe që forcojnë qëndrimin e drejtë në detyrat e caktuara nga All'llahu. Në këtë mënyrë, i ka ruajtur këto të mira për Ahiretin e tij.

Edhe pse shumica përpiqen të marrin sa më shumë nga kënaqësitë e kësaj dynjaje dhe t'i shijojnë ato, nuk arrijnë të ruajnë diçka për Ahiretin. Për këta Kur'ani thotë: **"Ju keni shfrytëzuar gjithë të mirat në jetën tuaj tokësore dhe jeni kënaqur me to."**.

Në disa tekste gjuhësore, transmetohet se fjalia: **"Ju keni shfrytëzuar gjithë të mirat në jetën tuaj tokësore dhe jeni kënaqur me to."**, duhet të kuptohet: Ju nuk i shpenzuat për kënaqësinë e All'llahut.[1]

3- Fjala *"tajjibati" - "të mirat"* ka një kuptim të gjerë. Ky kuptim përfshin të gjitha dhuratat e dynjasë. Një pjesë e komentuesve e kanë komentuar atë vetëm si forca e rinisë, por e vërteta është se rinia mund të jetë vetëm një miratim dhe asgjë tjetër.

4- Grupi emëror **"dënim poshtërues"** është i barasvlershëm me kundërpërgjigjen e mendjemadhësisë së tyre në Tokë, sepse ndëshkimi hyjnor përshtatet plotësisht me llojin e mëkatit dhe të kundërshtimit. Ata tregohen kryelartë jo vetëm ndaj krijesave të All'llahut, por edhe ndaj Profetëve të Tij. Ata nuk i janë përulur asnjë ligji hyjnor, duhet të marrim shpërblimin e tyre me nënçmim, përbuzje dhe përulje.

5- Në fundin e këtij ajeti janë përmendur dy mëkate të banorëve të Xhehennemit. Mëkati i parë është mendjemadhësia dhe i dyti, shthurja. Ka mundësi që e para të tregojë mungesën e besimit të tyre ndaj argumenteve të All'llahut, ndaj dërgimit të Profetëve dhe ndaj Kiametit. Kurse e dyta tregon llojet e mëkateve dhe të kundërshtimeve. Në qoftë se njëra prej tyre flet për lënien e bazave të fesë, tjetra flet për humbjen e degëve të fesë.[2]

6- Shprehja **"pa kurrfarë të drejte"**, nuk do të thotë se mendjemadhësia është dy llojesh: me të drejtë dhe pa të drejtë.

---

[1] "Mexhmaul Bahrejn", Lënda "dhehebe".
[2] Tefsiri "El Mijzan", vëll. 18, f. 224.

Përkundrazi, këto mënyra shprehjesh thuhen, zakonisht, si miratim. Shembujt të tillë janë të shumtë.

7- Përkorja e Imamëve të mëdhenj është përmendur në burime të ndryshme të haditheve, komentimeve dhe transmetimeve të shumta. Për përkorjen e Imamëve të mëdhenj të Islamit janë mbështetur në mënyrë të veçantë në ajetin që po komentojmë. Njëri prej tyre është: Në një hadith thuhet se një ditë Omeri erdhi tek i Dërguari i All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* në burimin e nënës së Ibrahimit. Një vend afër Medines. I Dërguari i All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ishte mbështetur mbi një rrogoz prej degësh palme. Një pjesë e trupit të tij ishte mbi të, kurse poshtë kokës se tij ishte një jastëk prej gjethe palmash. Omeri i dha selam, u ul dhe i tha: "Ti je Profeti i All'llahut dhe krijesa më e mirë e Tij. Kisraja dhe Cezari flenë mbi krevate prej ari dhe dyshekë të veshur me mëndafsh, kurse ti je në këtë gjendje?"

I Dërguari i All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i tha: "*Atyre u janë dhënë të mirat para kohe. Ajo është një ndarje e shpejtë, e përkohshme, por të mirat tona na janë ruajtur për më vonë.*".[1]

Në një hadith tjetër, të transmetuar nga Imam Bakiri, lexojmë: Një ditë atij i sollën ëmbëlsira. Ai u frenua që t'i hante. I thanë: "A mos janë haram?".

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 9, f. 88.

Ai tha*: "Jo, por unë kam frikë se mos shpirti im bëhet më i uritur dhe e kërkon atë."*. Më pas lexoi këtë ajet: **"Ju keni shfrytëzuar gjithë të mirat në jetën tuaj tokësore..."**.[1]

Në një hadith tjetër thuhet: "Prijësi i besimtarëve donte të hante mëlçi të skuqura në bukë të butë.". Ai kishte një vit që e dëshironte këtë. Kjo gjë iu tha Hasanit. Ai ishte agjërueshëm, por një ditë ia gatoi ato. Kur po hapte iftarin, një nevojtar trokiti në derë. Imami i tha: "O biri im, jepja atij që nesër të mos lexohet në librin tonë: **'Ju keni shfrytëzuar gjithë të mirat në jetën tuaj tokësore.'"**.[2]

[1] Tefsiri "El Burhan", vëll. 4, f. 175, fundi i ajetit, në fjalë.; "Biharul Anuar", vëll. 34, f. 353.

[2] "Sefijnetul Bihar", vëll. 2, Lënda "kebede".

Ajetet 21 – 25

۞وَٱذۡكُرۡ أَخَا عَادٍ إِذۡ أَنذَرَ قَوۡمَهُۥ بِٱلۡأَحۡقَافِ وَقَدۡ خَلَتِ ٱلنُّذُرُ مِنۢ بَيۡنِ يَدَيۡهِ وَمِنۡ خَلۡفِهِۦٓ أَلَّا تَعۡبُدُوٓاْ إِلَّا ٱللَّهَ إِنِّيٓ أَخَافُ عَلَيۡكُمۡ عَذَابَ يَوۡمٍ عَظِيمٖ٢١ قَالُوٓاْ أَجِئۡتَنَا لِتَأۡفِكَنَا عَنۡ ءَالِهَتِنَا فَأۡتِنَا بِمَا تَعِدُنَآ إِن كُنتَ مِنَ ٱلصَّٰدِقِينَ٢٢ قَالَ إِنَّمَا ٱلۡعِلۡمُ عِندَ ٱللَّهِ وَأُبَلِّغُكُم مَّآ أُرۡسِلۡتُ بِهِۦ وَلَٰكِنِّيٓ أَرَىٰكُمۡ قَوۡمٗا تَجۡهَلُونَ٢٣ فَلَمَّا رَأَوۡهُ عَارِضٗا مُّسۡتَقۡبِلَ أَوۡدِيَتِهِمۡ قَالُواْ هَٰذَا عَارِضٞ مُّمۡطِرُنَاۚ بَلۡ هُوَ مَا ٱسۡتَعۡجَلۡتُم بِهِۦۖ رِيحٞ فِيهَا عَذَابٌ أَلِيمٞ٢٤ تُدَمِّرُ كُلَّ شَيۡءِۭ بِأَمۡرِ رَبِّهَا فَأَصۡبَحُواْ لَا يُرَىٰٓ إِلَّا مَسَٰكِنُهُمۡۚ كَذَٰلِكَ نَجۡزِي ٱلۡقَوۡمَ ٱلۡمُجۡرِمِينَ٢٥

"Kujtoje vëllanë e fisit Ad (Hudin)**, kur e paralajmëroi popullin e vet në Ahkaf, ndërsa ka pasur paralajmërues edhe para tij, edhe pas tij** (kur u tha)**: 'Adhuroni vetëm All'llahun! Unë, me të vërtetë, kam frikë se do t'ju godasë dënimi i Ditës së Madhe!'"**

"Ata u përgjigjën: 'Vallë, a ke ardhur të na largosh ne prej hyjnive tona. Sillna atë (dënim) **që po na premton dhe të shohim nëse thua të vërtetën!'"**

"Ai u tha (atyre)**: 'Vetëm All'llahu e di** (se kur do të vijë dënimi)**. Unë kam për detyrë vetëm që t'ju përcjell mesazhin për të cilin jam dërguar, por unë po shoh se ju jeni popull i zhytur në padije.'"**

"Dhe kur panë një ré që u duk se vinte në drejtim të luginave të tyre, ata thanë: 'Kjo re po sjell shiun!'. 'Jo!' – u përgjigj ai – 'kjo është ajo që ju e keni shpejtuar: një erë që mbart një dënim të dhembshëm.'"

"'që, me urdhrin e All'llahut, shkatërron çdo gjë'. E në mëngjes u panë vetëm shtëpitë e tyre të zbrazëta; ja, kështu e ndëshkojmë Ne popullin keqbërës."

Komentimi

Populli i Adit dhe era shkatërruese

Kur'ani i përkujtonte çështjet të plota e më pas i sqaronte dhe i qartësonte, që të zbatoheshin ato. Edhe në këtë rast, zgjedh të njëjtën metodologji. Pasi na ka njohur me situatën e mendjemëdhenjve rebelë, troket në përkujtimin e historisë së popullit të Adit, të cilët janë një panoramë e qartë e arrogancës. Ajeti thotë: **"Kujtoje vëllanë e fisit Ad..."**.

Përdorimi i fjalës **"vëllanë"** tregon sinqeritetin e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, tregon kujdesin e tij për popullin. Kjo mënyrë të shprehuri

është përmendur edhe në Kur'anin e Lavdishëm. Është përdorur prej Profetëve më të mëdhenj, të cilët i quanin vëllezër të tyre popujt e ndryshëm, për të cilët nuk kursyen asnjë lloj altruizmi dhe sakrifice.

Kjo shprehje mund të jetë tregues i lidhjes së gjakut dhe farefisnisë midis këtyre Profetëve dhe popujve të tyre.

Më pas, ajeti shton: **"...kur e paralajmëroi popullin e vet në Ahkaf, ndërsa ka pasur paralajmërues edhe para tij..."**.

Fjala *"el ahkafu"* siç e thamë edhe më lart, ka kuptimin e dunave prej rëre që formohen në forma të ndryshme, të zgjatuara, zigzage, me vija të lakuara nga erërat e shkretëtirës. Edhe toka e popullit të Adit ishte tokë e madhe me zhavorr e me duna rëre.

Disa komentues kanë thënë se ajo është në zemrën e Gadishullit Arabik, mes tokave të Ahasaut, (tokat në lindje të Gadishulli Arabik, që janë ranore dhe me përbërje zhavorri poshtë tyre) dhe qytetet e civilizuara janë në grahmat e vdekjes dhe Omanit.[1] Por ky kuptim duket larg, sepse në ajetet e tjera të Kur'anit, pikërisht në suren "Esh Shuara" thuhet se populli i Adit ka jetuar në një vend me shumë ujëra dhe pemë të bukura dhe gjendet shumë larg zemrës së Gadishullit.

Komentues të tjerë thanë se ai gjendet në pjesën jugore të Gadishullit, afër Jemenit, apo në brigjet e detit të Arabisë.[2]

[1] "A'lamul Kur'an", f. 94.
[2] Tefsiri "Fi Dhilalil Kur;ani", vëll. 7, f. 420, fundi i ajeteve në fjalë.

Disa të tjerë supozuan se Ahkafi ishte një zonë në tokën e Irakut, në zonat jo të ashpra, pa gurë dhe babilit.[1]

Nga Taberiju transmetohet se Ahkafi është emri i një mali në Sham.[2]

Supozimi se kjo zonë bie në jug të Gadishullit Arabik, afër me tokën e Jemenit, është më i përafërt, sepse përshkrimi i saj si tokë e rrethuar me ujëra të bollshme dhe pemë të shumta dhe jo me duna rëre, është më i pranueshëm.

Sifjalia: **"ka pasur paralajmërues edhe para tij",** tregon Profetët që ishin dërguar para tij dhe një pjesë e këtyre të dërguarve kanë qenë afër me kohën e tij. Për këtë fakt, Kur'ani thotë: **"edhe para tij",** kurse për Profetët e tjerë që erdhën pas tij, Kur'ani thotë: **"edhe pas tij"**.

Supozimi se nga kjo fjali kuptohen Profetët që erdhën para Hudit dhe pas tij, duket shumë larg kontekstit dhe nuk harmonizohet me fjalën **"megjithëse"**, e cila kupton kohën e shkuar.

Le të shohim tani se çfarë përmbajtje kishte thirrja e këtij Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Kur'ani thotë: **"Adhuroni vetëm All'llahun!"**. Më pas i kërcënoi ata: **"Unë, me të vërtetë, kam frikë se do t'ju godasë dënimi i Ditës së Madhe!"**.

---

[1] Sipas të ndjerit, Sha'ranijut, në shënimet në fund të faqes së tefsirit "Ruhul Xhinan", vëll. 10, f. 165.

[2] Burimi i mëparshëm.

Megjithëse togfjalëshi **"Ditës së Madhe"**, përdoret për Ditën e Kiametit, ndonjëherë ajo, në ajete kur'anore, përdoret për ditët e ashpra e të tmerrshme që kaluan këta popuj. Kjo është ajo çfarë kuptohet këtu, sepse në vazhdimësinë e këtyre ajeteve, ne lexojmë se populli i Adit është sprovuar me dënimin e All'llahut dhe në një ditë të vështirë e të tmerrshme, përfundoi dhe çështja e tyre.

Por ky popull rebel e kundërshtoi thirrjen hyjnore dhe i foli Hudit: **"Ata u përgjigjën: 'Vallë, a ke ardhur të na largosh ne prej hyjnive tona. Sillna atë** (dënim) **që po na premton dhe të shohim nëse thua të vërtetën!'"**.[1]

Këto dy fjali e sqarojnë shmangien dhe mendjengushtësinë e këtij populli. Këtë e vërteton fjalia e parë: Mos vallë, thirrja jote është e gënjeshtërt, sepse ajo kundërshton zotat tanë, me të cilët ne jemi mësuar t'i adhurojmë? Ata i kemi trashëguar nga të parët tanë.

Në fjalinë e dytë shohim se ata i kërkojnë që të ndodhë ndëshkimi. Ata kërkojnë atë dënim, i cili, nëse zbret mbi ta, në mënyrë absolute, nuk ka kthim prapa. Po cili është ai i mençur që uron që t'i vijë një dënim i tillë, edhe sikur të mos ketë besim se mund të ndodhë?!

Por Hudi *(Paqja qoftë mbi të!)*, duke iu përgjigjur kësaj kërkese të çuditshme, e cila tregon për çmendurinë e tyre, u tha: **"Vetëm All'llahu e di** (se kur do të vijë dënimi)**."**, vetëm Ai e di se kur dhe si zbret dënimi i çrrënjosjes, i cili nuk lidhet fare me kërkesën dhe dëshirën tuaj dhe as me dëshirat e mia.

[1] Fjala *"li te'fikena"* rrjedh nga fjala *"ifkun"*, që do të thotë *"gënjeshtra"* dhe *"shmangie nga e vërteta"*.

Përkundrazi, duhet të plotësohet dhe të vërtetohet qëllimi. A nuk është ky plotësimi i justifikimit kundër jush? Kur ta shikojë All'llahu të arsyeshme, Ai gjykon dhe vendos për të.

Më pas ajeti shton: **"Unë kam për detyrë vetëm që t'ju përcjell mesazhin për të cilin jam dërguar..."**, sepse kjo është detyra dhe përgjegjësia ime kryesore. Vendimi për bindjen ndaj All'llahut dhe urdhrave të Tij lidhet me ju, kurse zbritja e dënimit ka lidhje me All'llahun e Madhëruar.

Vijimi i ajetit: **"...por unë po shoh se ju jeni popull i zhytur në padije."**, tregon se injoranca është shkaku i vuajtjes së tyre. Injoranca, e shoqëruar me mendjemadhësi dhe kryeneçësi, ju pengon ju të mësoni thirrjen e të Dërguarve të All'llahut dhe nuk ju lejon që ta pranoni atë. Ajo injorancë ju bën të kërkoni zbritjen e dënimit shkatërrues të All'llahut. Sikur të logjikonit pak, do të kishit supozuar, të paktën, një hipotezë pozitive përballë gjithë atyre hipotezave negative, të cilat, nëse ndodhin, nuk do të mbetej asnjë gjurmë e juaja.

Këshillat e Hudit *(Paqja qoftë mbi të!)* nuk bënë dobi fare, nuk zbutën dot ashpërsinë e zemrave të tyre. Ata nuk e pranuan të vërtetën, por e kundërshtuan atë dhe ngulën këmbë në gabimin e tyre. Ata kundërshtuan me kryeneçësi. Këtë veprim e mbështetën në kërkesën e pabazë: Nëse je i sinqertë në atë që thua, ku e ke premtimin që ke dhenë? Me të njëjtin argument të pabazë e përgënjeshtroi edhe Nuhun *(Paqja qoftë mbi të!)* populli i tij.

Justifikimi i kotë i tyre, pafuqishmëria për të qëndruar, mosmeritimi i tyre për jetën, bënë që All'llahu i Madhëruar të

dërgojë mbi ta dënimin shfarosës, dënimin që çrrënjosi çdo gjë dhe nuk la gjë prej gjëje prej tyre.

Papritur ata panë re në horizont, të cilat u përhapën me shpejtësi: **"Dhe kur panë një ré që u duk se vinte në drejtim të luginave të tyre, ata thanë: 'Kjo re po sjell shiun!'"**.[1]

Komentuesit kanë thënë se shiu u ndërpre për një farë kohe për popullin e Adit dhe ajri u bë i nxehtë, i thatë e mbytës, prandaj, kur panë retë e errëta të vinin drejt tyre, u gëzuan shumë. Ata u afruan pranë luginave të ujërave të shikonin zbritjen e shiut të bekuar, që do të gjallëronte tokat e zhuritura dhe të kënaqnin me të shpirtrat e tyre.

Por atyre iu tha se kjo nuk është re shiu: **"'Jo!' – u përgjigj ai – 'kjo është ajo që ju e keni shpejtuar: një erë që mbart një dënim të dhembshëm...'"**.

Disa komentues thonë se ai që flet këtë fjalë, është All'llahu i Madhëruar. Disa të tjerë thonë se Hudi, sapo dëgjoi ulërimat e gëzimit dhe të kënaqësisë së tyre, ua tha atyre këtë gjë.

Po, ajo është një erë shkatërruese: **"...një erë që mbart një dënim të dhembshëm, që, me urdhrin e All'llahut, shkatërron çdo gjë."**.

Disa komentues kanë thënë se me togfjalëshin **"çdo gjë"** kuptohen njerëzit, kafshët dhe pasuritë e tyre, sepse fjalia tjetër thotë: **"E në mëngjes u panë vetëm shtëpitë e tyre të zbrazëta..."**.

---

[1] Fjala *"aridun"* rrjedh nga fjala *"arede"*. Kuptimi është: erë që përhapet në gjerësinë e qiellit. Mbase kjo ka qenë një nga shenjat e resë së shiut, kur ajo përhapet në atë horizont e më pas ngjitet. Fjala *"el eudijetu"* është shumësi i fjalës *"uadin"* dhe ajo është rrjedha e ulët e përrenjve dhe e ujërave.

Kjo tregon se banesat e tyre ishin të paprishura, kurse ata ishin shkatërruar plotësisht. Erërat e forta i kishin hedhur trupat e tyre në shkretëtirën e largët, ose në det.

Komentues të tjerë kanë thënë se ata nuk e panë se këto re të zeza janë erëra të forta me pluhur. Vetëm kur ato arritën afër shtëpive të tyre dhe i ngritën lart nga toka dhe i hodhën në ajër kafshët dhe barinjtë e tyre, e panë mirë se ato erëra po shkatërronin çdo gjë.

Kur panë këtë pamje, u larguan dhe u mbyllën në banesat e tyre, por shtrëngatat ua shkulën portat dhe i hodhën në tokë. Erërat i hodhën edhe trupat e tyre në Ahkaf.

Në ajetin e 7 të sures "El Hakka" thuhet: **"All'llahu ua dërgoi atyre shtatë net dhe tetë ditë pareshtur. Atëherë mund t'i vëreje njerëzit të përmbysur si trungjet e hurmave të kalbura."**.

Ky popull mbeti i mbuluar nën kodrat e rërës dhe të dheut. Më pas erërat e forta e larguan rërën dhe trupat e tyre i hodhi në det.[1]

Në fund ajeti na tregon se ky dënim nuk është vetëm për këtë popull të humbur, por është: **"...ja, kështu e ndëshkojmë Ne popullin keqbërës."**.

Ky është një qortim dhe një paralajmërim për të gjithë kriminelët kundërshtarë, për jobesimtarët dhe kokëfortët egoistë, për të gjithë ata që zgjedhin rrugën e kundërshtimit. Përfundimi i jobesimtarëve mohues nuk do të jetë më i mirë se i këtyre, sepse

[1] Tefsiri "El Kebijr", vëll. 28, f. 28, fundi i ajeteve në fjalë. Është përmendur ky kuptim, gjithashtu, edhe në tefsirin e "Kurtubijjut", vëll. 9, f. 6026.

All'llahu i Madhëruar i urdhëron erërat që t'i shkatërrojnë. Për ato erëra na flet edhe Kur'ani. Ato erëra Kur'ani i quan: **"...si myzhde pranë mëshirës** (shiut) **të Tij."**.[1]

Kështu Toka, e cila është djepi i qëndrimit të njeriut dhe i qetësisë së tij, mund të shndërrohet në varr për të, përmes një tërmeti të fuqishëm.

Edhe shiu, që është baza e jetës për të gjithë gjallesat, mund të vërshojë rrëmbyeshëm dhe të mbysë çdo gjë.

All'llahu i Madhëruar, ushtarët e jetës i shndërron në ushtarë të vdekjes dhe të shkatërrimit. Sa e dhimbshme është vdekja si e popullit të Adit, të cilët u kënaqën dhe u gëzuan në fillim, por më pas erdhi ai sulm i fuqishëm, ai dënim i fortë dhe i dhimbshëm.

Ajeti thotë se këto erëra, në thelb, janë dallgë atmosferike të buta, që shndërrohen në ciklone që shkatërrojnë gjithçka me urdhrin e All'llahut.[2]

[1] Sure "El A'raf", ajeti 57 dhe sure "El Furkan", ajeti 48.
[2] Fjala *"tudemmiru"* rrjedh nga fjala *"tedmirun"* dhe ajo është shkatërrimi dhe asgjësimi.

Ajetet 26 – 28

وَلَقَدْ مَكَّنَّٰهُمْ فِيمَآ إِن مَّكَّنَّٰكُمْ فِيهِ وَجَعَلْنَا لَهُمْ سَمْعًا وَأَبْصَٰرًا وَأَفْـِٔدَةً فَمَآ أَغْنَىٰ عَنْهُمْ سَمْعُهُمْ وَلَآ أَبْصَٰرُهُمْ وَلَآ أَفْـِٔدَتُهُم مِّن شَىْءٍ إِذْ كَانُوا۟ يَجْحَدُونَ بِـَٔايَٰتِ ٱللَّهِ وَحَاقَ بِهِم مَّا كَانُوا۟ بِهِۦ يَسْتَهْزِءُونَ ﴿٢٦﴾ وَلَقَدْ أَهْلَكْنَا مَا حَوْلَكُم مِّنَ ٱلْقُرَىٰ وَصَرَّفْنَا ٱلْـَٔايَٰتِ لَعَلَّهُمْ يَرْجِعُونَ ﴿٢٧﴾ فَلَوْلَا نَصَرَهُمُ ٱلَّذِينَ ٱتَّخَذُوا۟ مِن دُونِ ٱللَّهِ قُرْبَانًا ءَالِهَةً ۖ بَلْ ضَلُّوا۟ عَنْهُمْ ۚ وَذَٰلِكَ إِفْكُهُمْ وَمَا كَانُوا۟ يَفْتَرُونَ ﴿٢٨﴾

“Ne i kishim bërë ata më të fuqishëm se ju dhe u kishim dhënë atyre dëgjimin, shikimin dhe zemrën, por as dëgjimi i tyre, as shikimi i tyre e as zemra e tyre, nuk u sollën kurrfarë dobie, sepse mohuan Shpalljet e All’llahut; ata i goditi ajo me të cilën talleshin.”

“Edhe më parë Ne kemi shkatërruar vendbanime rreth jush e u kemi shpjeguar atyre Shpalljet Tona, që ata të mund të ktheheshin (në Rrugën e Drejtë)**.”**

“Përse nuk u erdhën në ndihmë atyre idhujt, që i adhuruan si zota krahas All’llahut, për t’u afruar tek Ai?! Vërtet, idhujt i lanë në baltë ata. Këto ishin vetëm gënjeshtrat dhe shpifjet e tyre (idhujtarëve)**.”**

Komentimi

Nuk jeni kurrë më të fuqishëm se populli i Adit

Këto ajete janë të njëjta me ajetet e kaluara, që flisnin për dënimin e dhimbshëm të popullit të Adit. Këta ajete u thonë idhujtarëve të Mekës: **"Ne i kishim bërë ata më të fuqishëm se ju..."**[1], sepse ata ishin më të fuqishëm se ju si fizikisht, ashtu edhe nga ana ekonomike. Edhe nëse fuqia trupore dhe ekonomike do të ndihmonin ndokënd të afrohej me shpërblimin hyjnor, atëherë i pari do të ishte populli i Adit, që do të qëndronte fort përpara cikloneve dhe jo të katandisej si kashtë që e merr era dhe e zhduk pa gjurmë, duke lënë pas vetëm gërmadhat e banesave të tyre.

Ky ajet është i ngjashëm me atë që është përmendur në suren "El Fexhr" për popullin e Adit. Ajeti thotë: **"A nuk e di ti se ç'bëri Zoti yt me Adin? Me banorët e Iremit me ndërtesa të larta? Që si ata** *(populli Ad)* **nuk është krijuar askush në Tokë!"**.[2]

Ky ajet është i ngjashëm edhe me ajetin 36 të sures "Kaf": **"Sa e sa brezni para tyre i kemi shkatërruar e që ishin shumë më të fortë e më të shkathët se këta** *(idhujtarët kurejsh)***."**.

Si përfundim, mund të themi edhe ata që ishin më të fuqishëm se ju, ishin të dobët përpara stuhisë së dënimit të All'llahut. Atëherë, si është puna me ju, vallë?

---

[1] "*in*" në fjalinë "*in mekkennakum fihi*" - "*atë që nuk u mundësuam juve*" është ndaluese. Kemi shumë dëshmi nga ajetet e Kur'anit që përmenden në tekst. Mirëpo, disa e kanë konsideruar atë kushtore, apo e shtuar dhe këtë nuk e shohim të saktë.

[2] Sure "El Fexhr", ajetet 6-8.

Më pas ajeti shton: **"...u kishim dhënë atyre dëgjimin, shikimin dhe zemrën..."**[1], sepse i kuptonin të vërtetat dhe analizat e tyre, sepse i perceptonin gjërat mirë dhe i shfrytëzonin këto dhurata hyjnore për të garantuar nevojat dhe kërkesat e tyre materiale në mënyrën më të mirë: **"...por as dëgjimi i tyre, as shikimi i tyre e as zemra e tyre, nuk u sollën kurrfarë dobie, sepse mohuan Shpalljet e All'llahut; ata i goditi ajo me të cilën talleshin."**.

Ata ishin të përgatitur me lloje të ndryshme materialesh dhe me metoda të perceptimit të së vërtetës, mirëpo, kur u sollën me mendjemadhësi dhe kokëfortësi me argumentet e All'llahut dhe talleshin me fjalët e Profetëve, nuk u bëri dobi asgjë: as dituria e as logjika. Ata u dënuan dhe u nënçmuan.

Kur ky popull nuk i rezistoi zemërimit të All'llahut, mjerë ju që jeni edhe më të pafuqishëm se ata.

Nuk është e vështirë për All'llahun e Lartësuar, që t'ju dënojë me ndëshkimin më të ashpër, si rezultat i veprave dhe krimeve tuaja. All'llahu i Madhëruar nuk e ka të vështirë, që faktorët e jetës suaj t'ua bëjë shkaktarë të shkatërrimit tuaj. Ky është paralajmërim jo vetëm për idhujtarët e Mekës, por për të gjithë njerëzit kryeneçë, zullumqarë, tiranë të të gjithë historisë, të të gjitha kohëve dhe vendeve.

---

[1] Duhet të vërehet mirë se fjalët "*shikimet dhe zemrat*" - "*el ebsaru uel ef'idetu*", janë përmendur në numrin shumës, ndërkohë që fjala "*dëgjimi*" - "*sem'un*" është përmendur në numrin njëjës. Ka mundësi që ky ndryshim të jetë për shkak se për fjalan "*sem'un*" – "*dëgjim*", në gjuhën arabe, ka kuptimin e rrënjës "*el masdar*", dhe se "*el masdaru*", përdoret gjithmonë në numrin njëjës, ose për unikalitetin e shqisës së dëgjimeve përballë ndryshimit të gjërave që shikohen dhe atyre që perceptohen.

Çështja është ashtu siç thotë Kur'ani, sepse nuk jemi të parët që e kemi shkelur Tokën. Para nesh ka pasur shumë popuj që kanë jetuar në të, të cilët kishin shumë fuqi. Është mirë, që historitë e popujve të mëparshëm, t'i bëjmë pasqyrë për veten tonë, që të nxjerrim mësime prej tyre.

Më pas ajeti u flet idhujtarëve të Mekës dhe e shton qortimin dhe këshillën për të përforcuar këtë kuptim. Ajeti thotë: **"Edhe më parë Ne kemi shkatërruar vendbanime rreth jush..."**.

Ata popuj nuk janë shumë larg vendit tuaj. Vendbanimi i tyre ishte në skajet e Gadishullit Arabik. Populli i Adit jetonte në tokat e Ahkafit, në jug të Gadishullit, kurse populli i Themudit në tokën Hixhr, në veri të tij. Kurse populli i Sebeit, që mori atë dënim të dhimbshëm, jetonte në tokat e Jemenit, populli i Shuajbit në tokën e Medjenit, gjatë rrugës për në Sham. Edhe populli i Lutit jetonte në këtë zonë. Të gjithë këta popuj u sprovuan me lloje të ndryshme dënimesh, për shkak të mëkateve të shumta dhe mohimin që bënin.

Secili popull ishte mësim dhe përvojë dhe, njëherësh ishte edhe dëshmitar. Lind pyetja: Si nuk zgjohen këta popuj dhe nuk u japin rëndësi gjithë këtyre paralajmërimeve?!

Më pas ajeti shton: **"...u kemi shpjeguar atyre Shpalljet Tona, që ata të mund të ktheheshin** (në Rrugën e Drejtë)**."**.

Herë u treguam atyre mrekullitë dhe traditat e pazakonta, herë u dhamë të mira, e herën e tretë i sprovuam me fatkeqësi e gjëra të rënda. Herën e katërt u përshkruam njerëzit punëmirë, kurse herë të tjera u përshkruam kriminelët. Në raste të tjera i qortuam dhe i paralajmëruam me ndëshkimin e shfarosjes, me të cilin Ne shkatërruam të tjerët. Por, edhe pas të gjitha këtyre, mendjemadhësia, kryeneçësia dhe vetëkënaqësia e tyre nuk u la rrugë për të zgjedhur udhëzimin.

Ajeti 28 i qorton ashpër këta kundërshtarë: **"Përse nuk u erdhën në ndihmë atyre idhujt, që i adhuruan si zota krahas All'llahut, për t'u afruar tek Ai?!"**.[1]

Nëse është e vërtetë se ato objekte që ata i adhuronin, në vend të All'llahut të Madhëruar mund t'u ndihmonin atyre, atëherë, përse nuk i ndihmuan në ato situata delikate, përse nuk i shpëtuan nga dënimi i tmerrshëm? Ky fakt është një argument i fortë për shkatërrimin e besimit të atyre që mendonin se këta zota të shpikur, ishin strehimi dhe mbrojtësit e tyre në ditën e hidhërimit dhe të vështirësisë së tyre.

Pastaj ajeti shton: **"Vërtet, idhujt i lanë në baltë ata."**, sepse këto qenie të pavlera dhe pa rëndësi nuk sjellin asnjë dobi në vështirësi. Ata janë qenie, objekte të verbra e memecë. Atëherë, si e merituakan hyjninë dhe të jenë të mirëpritur në të?

Së fundi, ajeti thotë: **"Këto ishin vetëm gënjeshtrat dhe shpifjet e tyre** (idhujtarëve)**."**, sepse, pa dyshim, se ky shkatërrim dhe vuajtje e madhe, ky ndëshkim i dhimbshëm ishte rezultat i gënjeshtrave, i mendimeve dhe i mashtrimeve të tyre.[2]

---

[1] Kundrinori i parë *"ittekhadhu"* është i deduktuar, kurse *"alihetun"* është kundrinori i dytë dhe *"kurbanen"* është gjendje. Vlerësimi është: I morën ato për zota, pos All'llahut, është situata e të qenit të afërt me ta. Supozohet, gjithashtu, që *"kurbanen"* të jetë kundrinor në rasën kallëzore; janë bërë edhe supozime të tjera në ndërtimin e fjalisë, mirëpo nuk ia vlen t'u jepet rëndësi.

[2] Në bazë të kësaj, pa dyshim se për ajetin ka një deduksion. Vlerësimi është: Ajo është rezultati i trillimit tuaj. Supozohet se ajeti nuk ka nevojë për deduksion e në këtë situatë, kuptimi bëhet: Kjo ishte gënjeshtra juaj dhe trillimi juaj. Mirëpo kuptimi i parë duket më i përshtatshëm.

Ajetet 29 – 31

وَإِذْ صَرَفْنَآ إِلَيْكَ نَفَرًا مِّنَ ٱلْجِنِّ يَسْتَمِعُونَ ٱلْقُرْءَانَ فَلَمَّا حَضَرُوهُ قَالُوٓاْ أَنصِتُواْۖ فَلَمَّا قُضِىَ وَلَّوْاْ إِلَىٰ قَوْمِهِم مُّنذِرِينَ٢٩ قَالُواْ يَٰقَوْمَنَآ إِنَّا سَمِعْنَا كِتَٰبًا أُنزِلَ مِنۢ بَعْدِ مُوسَىٰ مُصَدِّقًا لِّمَا بَيْنَ يَدَيْهِ يَهْدِىٓ إِلَى ٱلْحَقِّ وَإِلَىٰ طَرِيقٍ مُّسْتَقِيمٍ٣٠ يَٰقَوْمَنَآ أَجِيبُواْ دَاعِىَ ٱللَّهِ وَءَامِنُواْ بِهِۦ يَغْفِرْ لَكُم مِّن ذُنُوبِكُمْ وَيُجِرْكُم مِّنْ عَذَابٍ أَلِيمٍ٣١

"Kur Ne dërguam te ty një grup xhindesh për të dëgjuar Kur'anin, ata, kur erdhën, i thanë njëri-tjetrit: 'Heshtni!' Dhe kur përfundoi (leximi), **ata u kthyen te populli i tyre si këshillues."**
"Ata thanë: 'O populli ynë! Ne dëgjuam një Libër të shpallur pas Musait, i cili vërteton Shpalljet para tij, udhëzon nga e vërteta dhe tregon Rrugën e Drejtë.'"

"O populli ynë, përgjigjjuni thirrësit të All'llahut dhe besojini Atij! Ai do t'jua falë gjynahet tuaja dhe do t'ju shpëtojë prej dënimit të dhembshëm."

"Ndërsa ata që nuk i përgjigjen thirrësit të All'llahut, nuk do të mund t'i ikin Atij në Tokë; për ata s'ka mbrojtës tjetër, përveç Tij. Ata janë në humbje të madhe."

Shkaku i zbritjes

Janë përmendur transmetime të ndryshme për shkakun e zbritjes së këtyre ajeteve. Njëri prej tyre është: "I Dërguari i All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* doli nga Meka për në tregun e Ikadhit në Taif. Bashkë me të ishte Zejdi, i biri i Harithit. Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i ftonte njerëzit në Islam, por askush nuk e ndiqte atë. Ai u detyrua të kthehej në Mekë. Në kthim arriti në një vend që quhej Lugina e xhindëve. Aty nis të lexojë Kur'an, në mes të natës. Një grup xhindësh po kalonin andej. Ata e dëgjuan me vëmendje leximin e Kur'anit nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe i thanë njëri–tjetrit: "Heshtni dhe dëgjoni.".

Kur i Dërguari i All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* përfundoi leximin e tij, ata i besuan atij dhe erdhën te populli i tyre si të dërguar që t'i ftonin ata në Islam. Një grup u besoi atyre dhe erdhën të gjithë te Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. I Dërguari i All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ua mësoi atyre Islamin. Me këtë rast, zbritën këto ajete, si dhe ajetet e sures "El Xhind".[1]

Në një transmetim nga Ibn Abasi flitet për një shkak tjetër të zbritjes, i cili përafrohet me shkakun e mësipërm të zbritjes. Shkaku tjetër është ky: Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i*

[1] Tefsiri i "Ali ibn Ibrahimit", sipas transmetimit të tefsirit "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, f. 19, me një shkurtim të lehtë.

All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), gjatë faljes së namazit të sabahut, po lexonte Kur'an. Një grup xhindësh donin të kërkonin e të vërtetonin ndërprerjen e lajmeve qiellore për ta. Në këtë kohë ata dëgjuan zërin e leximit të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe thanë: "Ky është shkaku i ndërprerjes së lajmeve ndaj nesh.". Ata u kthyen te populli i tyre dhe i ftuan ata në Islam.[1]

Dijetari Tabersiju, në veprën "Mexhmaul Bejan" ka sjellë një shkak të tretë të zbritjes, i cili lidhet me historinë e udhëtimit të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* drejt Taifit.

Përmbledhja e tij është: Pas vdekjes së Ebu Talibit, u vështirësua çështja për Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Ai udhëtoi drejt Taifit, me shpresën që të gjejë mbështetës. Atij i dolën përpara fisnikët e Taifit, të cilët e përgënjeshtruan dhe e gjuajtën me gurë, derisa i doli gjak nga këmbët. Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* u ul në anë të një kopshti, nën hijen e një palme. Gjaku vazhdonte t'i rridhte nga këmbët.

Ky kopsht ishte i Atabe ibn Rebiatu dhe i Shejbe ibn Rebiatu, të cilët ishin pasanikë kurejsh. Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* u ndje keq, kur i pa ata të dy, sepse e dinte armiqësinë e tyre ndaj Islamit. Ata, dërguan te Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi*

[1] Ky hadith është përmendur në "Sahihun" e Buhariut dhe të Muslimit; në "Senedin" e Ahmedit, në mënyrë të hollësishme, sipas transmetimit të tefsirit "Fi Dhilalil Kur'an", vëll. 7, f. 429.

të dhe mbi familjen e tij!) një fëmijë të tyre, Adasin, i cili ishte i krishterë. Ai shkoi me një tabaka me hurma. Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i tha Adasit: "Prej cilit vend je ti?"

Adasi tha: "Nga Nejneva. Profeti i tha: nga qyteti i robit të mirë, Junuzit, të birit të Metasë." Adasi i tha: Po ku e di ti se kush është Junuzi, i biri i Metasë?"

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i tha: "*Unë jam i Dërguari i All'llahut (Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe All'llahu më ka lajmëruar mua me lajmin e Junuzit, të birit të Metasë."*. Adasi e njohu sinqeritetin e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe ra menjëherë në sexhde për All'llahun e Lartësuar, ra mbi këmbët e Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, duke i puthur ato.

Kur u kthye, Atabeja dhe Shejbetu e fajësuan për atë që bëri, por ai u tha: "Ky njeri i mirë më tregoi për atë që populli i këtij vendi nuk ka njohuri, më tregoi për çështjen e Profetit tonë, Junuzit. Ata të dy qeshën dhe i thanë se po të manipulon edhe ty, sepse ai është njeri mashtrues.

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* u kthye në Mekë. Në këtë udhëtim të tij i besoi vetëm një besimtar. Profeti arriti në mes të natës. Sapo arriti, u bë gati për namaz. Një grup xhindësh nga populli Nasibejni, ose

Jemeni, po kalonin andej. Ata dëgjuan leximin e Kur'anit në namazin e sabahut, e dëgjuan me vëmendje dhe e besuan atë.[1]

Komentimi

Besimi i një grupi xhindësh

Në këto ajete, siç u tregua edhe në shkakun e zbritjes, bëhet një diskutim i shkurtër rreth besimit të një grupi prej xhindëve me Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe librit të tij qiellor, për t'ua qartësuar idhujtarëve të Mekës këtë të vërtetë: Si mund të besojë një grup prej xhindëve të largët këtë Profet që është prej njerëzve dhe është dërguar në mesin tuaj, kurse ju ngulni këmbë në mosbesim dhe vazhdoni në kokëfortësinë dhe kundërshtimin tuaj?!

Do të kemi një diskutim më të hollësishëm rreth (xhindëve) dhe veçorive të tyre në tefsirin e sures "El Xhind". Këtu do të trajtojmë vetëm komentimin e ajeteve që po diskutojmë.

Historia e popullit të Adit ishte paralajmërim për idhujtarët e Mekës. Edhe historia e besimit të një grupi xhindësh ishte një tjetër paralajmërim. Ajeti në fillim thotë: **"Kur Ne dërguam te ty një grup xhindesh për të dëgjuar Kur'anin."**.

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 9, f. 92. Këtë histori, me një ndryshim të vogël, e ka thënë ibn Hisham, në historinë e tij "Es Sijretu en Nebeuijeh", vëll. 2, f. 62-63.

Fjala *"sarrefna"* do të thotë transformimi i diçkaje dhe shndërrimi i saj nga një gjendje në një tjetër. Mbase tregon që xhindët i dëgjonin lajmet e Qiellit nëpërmjet përgjimit dhe, me shfaqjen e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* u kthyen tek ai dhe u drejtuan nga Kur'ani.

Fjala *"en neferu"* përdoret për të treguar disa burra që mund të arratisen, të ikin, me kuptimin e emigrimit nga një vend në tjetrin.

Më pas ajeti shton: **"...ata, kur erdhën, i thanë njëri-tjetrit: 'Heshtni!'."**. Kjo ndodhi kur Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ishte duke lexuar ajetet e Kur'anit në mes të natës, ose në namazin e sabahut.

Fjala *"ensitu"* tregon heshtjen së bashku me dëgjimin dhe kujdesin.

Më në fund, drita e besimit i ndriçoi zemrat e këtyre dhe preku në thellësitë e qenies së ajeteve të Kur'anit një të vërtetë, prandaj: **"Kur përfundoi** (leximi)**, ata u kthyen te populli i tyre si këshillues."**.

Kjo është gjithmonë praktika e besimtarëve, përmes të cilës u mësojmë të tjerëve të vërtetat, duke ua treguar edhe origjinat e besimit të tyre.

Ajeti tjetër sqaron mënyrën me të cilën ata thirrën popullin e vet, kur u kthyen te ata. Një thirrje harmonike, e përpiktë dhe me kuptim përmbledhës e të thellë: **"Ata thanë: 'O populli ynë! Ne dëgjuam një Libër të shpallur pas Musait...'"**.

Prej cilësive të atij libri, është se ne pamë se ai vërteton librat e mëparshëm qiellorë dhe përshtatet me to, me përmbajtjet e tyre. Në të janë shenjat: **"vërteton Shpalljet para tij"**.[1]

Cilësia tjetër e tij është se ai: **"udhëzon nga e vërteta"**.

Çdokush që mbështetet në logjikën dhe natyrën e tij, do të shohë argumente të vërteta, të qarta si kristali.

Cilësia e tij e fundit është se i udhëzon në të drejtë: **"tregon Rrugën e Drejtë"**.

Thirrja në të vërtetën dhe në Rrugën e Drejtë shihet qartë. E para është treguese e besimeve të vërteta, kurse e dyta tregon procesin e drejtë e të vërtetë të programeve.

Grupi emëror **"të shpallur pas Musait"** dhe fjalia: **"vërteton Shpalljet para tij"** mbështesin dhe sigurojnë se ky grup ishin besimtarë që kërkonin të vërtetën në librat e kaluar qiellorë dhe sidomos në librin e Musait *(Paqja qoftë mbi të!)*.

Mospërmendja e librit të Isait, i cili ka zbritur pas Musait *(Paqja qoftë mbi të!)*, nuk ka lidhje me atë që transmetohet nga Ibn Abasi se xhindët nuk dinin gjë, në mënyrë absolute, për zbritjen e Ungjillit, sepse xhindët ishin njohës të lajmeve qiellore. Por, si mund të ishin të pavëmendshëm, deri në atë shkallë rreth lajmeve të Tokës? Përkundrazi, nga Teurati që ishte libri kryesor, bazë, edhe të krishterët kishin marrë dhe marrin prej tij ligjet e kushtetutës së tyre.

[1] Komentimin e kësaj fjalie, e kemi përmendur të detajuar në fundin e ajetit 41 të sures "El Bekare".

Më pas shtuan: **"O populli ynë, përgjigjjuni thirrësit të All'llahut dhe besojini Atij!"**, sepse do të shpërbleheni me dy shpërblime të mëdha**: "Ai do t'jua falë gjynahet tuaja dhe do t'ju shpëtojë prej dënimit të dhembshëm."**.[1]

Prej grupit emëror: **"thirrësit të All'llahut"** kuptohet se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, është ai që i udhëzonte ata drejt All'llahut të Madhëruar. Frika më e madhe e njeriut lidhej me mëkatet dhe dënimin e dhimbshëm të Kiametit. Ata u përmendën atyre sigurinë, përballë këtyre dy çështjeve, që t'u zgjonte kujdesin për gjithçka.

Një grup komentuesish e kanë konsideruar fjalën *"min"* në *"min dhunubikum"* - *"gjynahet tuaja"*. Ata thonë se ajo është garanci për faljen e të gjitha mëkateve, nën hijen e besimit. Disa komentues të tjerë e kanë konsideruar si treguese të atyre mëkateve që ata kanë bërë para besimit të tyre, ose si mëkatet që kanë lidhje me All'llahun dhe jo me të drejtën e njerëzve.

Më i përshtatshëm është kuptimi që lidhet me *"min"* - *"shtesë"* dhe *"siguri"*. Ajeti i bekuar i përfshin të gjitha mëkatet.

Ajeti 32, përmend kumtin e fjalës së xhindit: **"Ndërsa ata që nuk i përgjigjen thirrësit të All'llahut, nuk do të mund t'i ikin Atij në Tokë; për ata s'ka mbrojtës tjetër, përveç Tij. Ata janë në humbje të madhe."**.

[1] Fjala *"juxhirkum"* rrjedh nga fjala *"ixharetun"* dhe është përmendur me kuptime të ndryshme: ndihmë, ruajtje nga dënimi, mikpritje dhe mbrojtje.

Cila humbje është më e madhe, më e keqe dhe më e qartë se sa humbja e të vërtetës nga njeriu, se largimi nga rruga e vërtetë, nga Rruga e All'llahut të Madhëruar?!

Kemi thënë shpesh se fjala *"mu'xhizun"* tregon pafuqinë e ndjekjes, komentimin dhe shpërblimin dhe jo arratisjen nga dënimi.

Fjala *"Tokë"* tregon se ju, kudo që të shkoni në Tokë, ta dini mirë se ajo është pronë e All'llahut dhe është nën autoritetin e Tij. Prandaj nuk mund të jeni jashtë kufijve të fuqisë së Tij dhe kapjes së Tij. Ajetet nuk flasin për Qiellin, sepse vendi i njerëzve dhe xhindëve është Toka.

Dy hulumtime

1- Informacioni ndikues

Siç kemi thënë më parë, diskutimi rreth xhindeve, mënyrës së tyre të jetesës dhe karakteristikave të tjera që lidhen me ta, do të bëhet në komentimin e sures "El Xhind". Prej këtyre ajeteve përfitohet se xhindet janë krijesa me logjikë, që kanë perceptim dhe ndjenja, që janë të ngarkuara me detyra nga ana e All'llahut. Në ta ka besimtarë dhe jobesimtarë. Ata kanë dijen e mjaftueshme për thirrjet hyjnore.

Tërheq shikimin mënyra se si këto ajete ndjekin përcjelljen e kumtit në popullin e tyre, në favor të Islamit, sepse, pasi erdhën

te Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe dëgjuan prej tij ajetet kur'anore dhe përmbajtjen e tyre, nxituan për te populli i tyre, për t'i treguar për thirrjen e tyre.

Në fillim folën për vërtetësinë e Kur'anit, të cilën e vërtetuan me tri argumente. Më pas treguam interesin e tyre dhe i përgëzuan ata me shpëtimin dhe çlirimin nga ndëshkimi i Ahiretit, nën hijen e besimit me këtë Libër qiellor. Kjo ishte siguri për çështjen e Ahiretit, për kthimin e interesit te vlerat origjinale të Ahiretit përballë vlerave të shkatërruara dhe të shteruara të dynjasë.

Më pas, në fazën e tretë vëmendja përqendrohet në rreziqet që vijnë nga lënia e besimit. I paralajmëruan ata me argumentim dhe përkujdesje. Në fund u sqaruan atyre dënimin që merr nga shmangia e kësaj rruge. Kjo shmangie është humbje e qartë.

Një përcjellje e tillë e kumtit dhe e informacionit ndikon te çdo njeri dhe çdo grup.

2- Argumenti më i mirë i madhështisë së Kur'anit është përmbajtja e tij

Nga ajetet e mësipërme dhe nga ajetet e sures "El Xhind" duket qartë se ky grup xhindësh u mahnit nga Kur'ani, vetëm duke dëgjuar ajetet e tij dhe nuk ka asnjë argument, që të tregojë se ata të kenë kërkuar nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ndonjë mrekulli tjetër.

Xhindët i konsideruan si argumente të mjaftueshme vërtetësinë e Kur'anit, harmonizimin e tij me argumentet e librave qiellorë, ftesën drejt së vërtetës dhe qëndrimin e drejtë të programeve të tij.

Reflektimi mbi përmbajtjen e Kur'anit dhe vërtetimi i vërtetësisë së tij na mjafton ne, më shumë se çdo argumentim tjetër.

Ky libër i një njeriu analfabet, përballë një oqeani të mbushur me injorancë dhe trillime, ka këtë përmbajtje të nivelit të lartë dhe besime të pastra e të kulluara, me Teuhid të sinqertë, me ligje të harmonizuara të gjykatës dhe me argumente të prera e të forta, me programe të plotësuara e ndërtuese, me këshilla dhe udhërrëfime të larta e të pastra, me forcë tërheqëse e të fuqishme dhe me bukurinë e mahnitshme, formon, në vetvete, argumentin më të mirë për vërtetësinë e këtij libri qiellor, sepse shfaqja e Diellit është argument që tregon dukjen e tij, siç thotë një proverb.[1]

[1] Kemi pasur një komentim të hollësishëm rreth mrekullisë së Kur'anit në këtë tefsir, fundi i ajetit 23, i sures "El Bekare".

Ajetet 33 – 35

أَوَ لَمۡ يَرَوۡاْ أَنَّ ٱللَّهَ ٱلَّذِي خَلَقَ ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَٱلۡأَرۡضَ وَلَمۡ يَعۡيَ بِخَلۡقِهِنَّ بِقَٰدِرٍ عَلَىٰٓ أَن يُحۡۦِيَ ٱلۡمَوۡتَىٰۚ بَلَىٰٓ إِنَّهُۥ عَلَىٰ كُلِّ شَيۡءٖ قَدِيرٞ٣٣ وَيَوۡمَ يُعۡرَضُ ٱلَّذِينَ كَفَرُواْ عَلَى ٱلنَّارِ أَلَيۡسَ هَٰذَا بِٱلۡحَقِّۖ قَالُواْ بَلَىٰ وَرَبِّنَاۚ قَالَ فَذُوقُواْ ٱلۡعَذَابَ بِمَا كُنتُمۡ تَكۡفُرُونَ٣٤ فَٱصۡبِرۡ كَمَا صَبَرَ أُوْلُواْ ٱلۡعَزۡمِ مِنَ ٱلرُّسُلِ وَلَا تَسۡتَعۡجِل لَّهُمۡۚ كَأَنَّهُمۡ يَوۡمَ يَرَوۡنَ مَا يُوعَدُونَ لَمۡ يَلۡبَثُوٓاْ إِلَّا سَاعَةٗ مِّن نَّهَارِۭ بَلَٰغٞۚ فَهَلۡ يُهۡلَكُ إِلَّا ٱلۡقَوۡمُ ٱلۡفَٰسِقُونَ٣٥

“A nuk e shohin ata se All’llahu, i Cili krijoi qiejt dhe Tokën pa u lodhur aspak në krijimin e tyre, është i Fuqishëm t’i ngjallë të vdekurit? Po, Ai është vërtet i Fuqishëm për çdo gjë.”

“Ditën, kur ata që kanë mohuar do të përballen me zjarrin (do t’u thuhet)**: ‘Vallë, a nuk është kjo e vërtetë?’. Ata do të thonë: ‘Po, për Zotin tonë!’. Ai do t’u thotë: ‘Atëherë, shijoni dënimin për mohimin që keni bërë!’.”**

“Prandaj, ti bëhu i durueshëm (o Muhammed)**, ashtu siç kanë duruar me këmbëngulje të Dërguarit e vendosur dhe mos kërko shpejtimin e dënimit për ata! Ditën, kur të përjetojnë atë që u është premtuar, atyre do t’u duket se kanë qëndruar** (në Tokë)

vetëm një çast të ditës. Kjo është Shpallje e qartë. E kush do të shkatërrohet tjetër, përveç popullit të pabindur!?"

Komentimi

Duro, ashtu sikurse duruan të Dërguarit e vendosur

Këto janë ajetet e fundit të sures "El Ahkaf", të cilat vazhdojnë diskutimin rreth Ahiretit. Këto ajete na tregojnë mesazhin e xhindëve. Kjo është njëra anë.

Nga anën tjetër, surja "El Ahkaf" në pjesët e para flet për Teuhidin, për madhështinë e Kur'anit të lavdishëm dhe vërtetimin e profecisë së Profetit Muhammed. Kjo sure, në pjesën e fundit, diskuton edhe çështjen e Ahiretit dhe kështu, plotëson diskutimin rreth tri shtyllave të besimit.

Ajeti 33 thotë: **"A nuk e shohin ata se All'llahu, i Cili krijoi qiejt dhe Tokën pa u lodhur aspak në krijimin e tyre, është i Fuqishëm t'i ngjallë të vdekurit? Po, Ai është vërtet i Fuqishëm për çdo gjë."**.

Krijimi i qiejve, i Tokës dhe i krijesave të ndryshme e të shumëllojshme, janë shenjë e fuqisë së All'llahut të Lartësuar. Çdo gjë që gjendet në këtë botë, është krijesë e All'llahut. Nëse është kështu, atëherë si është e mundur që të jetë i pafuqishëm në rikthimin e jetës së njerëzve? Ky është njëherësh, edhe një argument vendimtar në favor të çështjes së Ahiretit. Argumenti

më i mirë, që tregon se një gjë e krijuar, është ekzistenca e saj. Atëherë, si mund të vëmë në dyshim fuqinë absolute krijuese të All'llahut për çështjen e Ahiretit, kur ne shohim lindjen e krijesave të gjalla dhe formimin e tyre nga krijesat e vdekura?

Kjo është një nga argumentet e shumta, që vërtetojnë Kur'anin. Këto argumente mbështeten në ajete të ndryshme. Njëri prej tyre është ajeti 81 i sures "Ja Sin".[1]

Ajeti që pason, tregon pamje të ndëshkimit të dhimbshëm që përfshin kriminelët dhe mohuesit e Ahiretit. Ajeti thotë: **"Ditën, kur ata që kanë mohuar do të përballen me zjarrin."**.

Një herë zjarri paraqitet para jobesimtarëve, kurse herën tjetër paraqiten jobesimtarët para zjarrit. Secila nga dy paraqitjet ka një qëllim, për të cilin është folur në ajetet e mëparshme.[2]

Kur jobesimtarët paraqiten para zjarrit dhe shohin gjuhët e mëdha, përvëluese dhe tmerruese, atyre u thuhet: **"Vallë, a nuk është kjo e vërtetë?"**.

A mundeni ju, sot, të mohoni Ringjalljen, gjykatën e drejtësisë së All'llahut, shpërblimin dhe dënimin e Tij dhe të thoni, ashtu siç keni thënë atëherë, se kjo nuk është tjetër,veçse legjendë e të parëve?

Ata që nuk kishin dyshim: **"Ata do të thonë: 'Po, për Zotin tonë!'"**, kurse All'llahu i Madhëruar, ose engjëjt e dënimit thonë:

[1] Për këtë temë janë dhënë argumente në fundin e ajeteve të fundit të sures "Ja Sin".
[2] Sure "El Ahkaf", ajeti 20.

"Ai do t'u thotë: 'Atëherë, shijoni dënimin për mohimin që keni bërë!'".

Ata, atë Ditë, me sytë e tyre shikojnë të gjitha të vërtetat dhe njihen me vendimin e dënimit të tyre. Ky dënim do të shkaktojë te ata shqetësim, keqardhje, brejtje ndërgjegje dhe vuajtje shpirtërore.

Në ajetin 35, i cili është edhe ajeti i fundit i sures "El Ahkaf" All'llahu i Madhëruar urdhëron Profetin e Tij (në bazë të shënimeve që u përmendën në ajetet e kaluara rreth Ahiretit dhe dënimit të jobesimtarëve): **"Prandaj, ti bëhu i durueshëm** (o Muhammed), **ashtu siç kanë duruar me këmbëngulje të Dërguarit e vendosur."**, sepse nuk je i vetmi që je përballur me kundërshtimin e këtij populli dhe me armiqësinë e tyre.

Me kundërshtimet dhe armiqësitë e tyre janë përballur edhe më parë Profetët, të cilët qëndruan fort. Profeti i madh i All'llahut, Nuhu *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* e ka ftuar popullin e tij 950 vjet radhazi dhe ai nuk i besoi atij. Atij i besoi vetëm një grup i vogël, kurse populli i tij e lëndonte dhe tallej përherë me të.

Ibrahimin *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* e hodhën në zjarr, kurse Musain *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)*, pasi e torturuan shumë, e kërcënuan me vrasje, por All'llahu i Madhëruar e shpëtoi prej tyre.

Në fund mund të themi se këto probleme do të jenë gjithmonë të pranishme në shoqërinë njerëzore. Këto probleme mund të kapërcehen vetëm me durim dhe vendosmëri.

Cilët janë Profetët më të vendosur?

Për këtë çështje ka diskutime të shumta mes komentuesve.

Cilët janë të vendosurit?

Para se të vërtetojmë këtë, duhet të sqarojmë kuptimin e fjalës *"azmit" - "vendosmëri"*, sepse fjala (ulul azmi) përdoret me kuptimin "të jesh i vendosur."

Fjala *"el azmu"* është përdorur me kuptimin *"dëshirë e fortë, e palëkundur."*.

Fjala *"vendosmëria"*, është përdorur në ajetet e Kur'anit të Lavdishëm që flasin për durimin: **"Kush bën durim dhe fal, s'ka dyshim se ky është virtyti më i lartë."**.[1]

Ndonjëherë është përdorur me kuptimin e përmbushjes, kryerjes së detyrës, si në Fjalën All'llahut të Madhëruar: **"Ne e patëm urdhëruar edhe Ademin** (të mos i afrohej pemës)**, po ai harroi, pra, tek ai nuk gjetëm vendosmëri."**.[2]

Por autorët e ligjeve dhe feve të reja janë sprovuar me më shumë probleme dhe vështirësi se Profetët e mëparshëm. Këta kishin nevojë për vendosmëri dhe dëshirë më të madhe për përballimin e vështirësive, prandaj ky grup Profetësh u quajt me emrin *"ulul azmi" - "të vendosurit fort"*. Ajeti që po komentojmë, e tregon qartë këtë. Ajeti përfshin në këtë grup të vogël edhe Profetin e Islamit, sepse ajeti thotë: **"...ti bëhu i durueshëm** (o Muhammed)**, ashtu siç kanë duruar me këmbëngulje të Dërguarit e vendosur."**.

[1] Sure "Esh Shura", ajeti 43.
[2] Sure "Ta Ha", ajeti 115.

Sipas këtij kuptimi, fjala *"min"* në *"mine err rrusuli"* tregon një grup të veçantë të Profetëve, të cilët ishin autorët e Sheriatit, (ligjit të All'llahut). Për ata na ka treguar ajeti i 7 i sures "El Ahzab": **"**(Përkujto) **Kur Ne e morëm** (me betim) **prej Profetëve premtimin e tyre, edhe prej teje, prej Nuhut, Ibrahimit, Musait, Isait, birit të Merjemes, pra, morëm prej tyre besë të fortë."**.

Ajeti ka folur për këta pesë Profetë, pasi ka përmendur të gjithë Profetët në formë të përgjithshme. Ky është një argument që flet për karakteristikat e tyre të veçanta.

Për ta flet, gjithashtu, edhe ajeti 13 i sures "Es Shura", kur thotë: **"Ai ju përcaktoi ju për fe atë që i pati përcaktuar Nuhut dhe atë që Ne ta Shpallëm ty dhe atë me çka i patëm porositur Ibrahimin, Musain dhe Isain."**.

Në këtë kapitull janë përcjellë shumë transmetime, si nga burimet shi'a, ashtu edhe syni, të cilët tregojnë se Profetët e vendosur ishin pesë. Kështu thuhet edhe në një hadith të dy Imamëve, Bakirit dhe Sadikut *(Paqja qoftë mbi ta!)*: *"Prej tyre janë pesë: i pari i tyre është Nuhu, pastaj Ibrahimi, pastaj Musai, pastaj Isai, pastaj Muhammedi."*.[1]

Në një hadith tjetër, të transmetuar nga Imam Aliu, i biri i Hysejnit *(Paqja qoftë mbi të!)*, thuhet: *"Profetët e vendosur fort kanë qenë pesë: Nuhu, Ibrahimi, Musai, Isai dhe Muhammedi.". Kur transmetuesi pyet se përse janë quajtur "ulul azmi", Imam Aliu (Paqja*

[1] Tefsiri "Mexhmaul", vëll. 9, f. 143, fundi i ajeteve është burimi i komentimit.

qoftë mbi të!) përgjigjet: "Sepse ata janë dërguar nga Lindja në Perëndim, edhe te xhindet, edhe te njerëzit.".[1]

Po kështu thuhet edhe në një hadith të Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*: *"Më të nderuarit e Profetëve dhe të Dërguarve janë pesë. Ata janë më të vendosurit nga të Dërguarit: Nuhu, Ibrahimi, Musai, Isai dhe Muhammedi."*.[2]

Ky kuptim përmendet edhe në komentimin "Ed Durrul Menthur" në të cilin transmetohet një hadith nga Ibn Abasi i cili ka thënë se Profetët më të vendosur janë këta të pestë.[3]

Por disa komentues mendojnë se fjala *"ulul azmi"* tregon se Profetët janë urdhëruar të luftojnë armiqtë dhe luftën e tyre e bëjnë në Rrugë të All'llahut.

Disa kanë thënë se numri i Profetëve është 313 vetë[4], kurse disa të tjerë mendojnë se të gjithë Profetët janë *"ulul azmi"*, domethënë "poseduesit e dëshirës[5] së vendosur", sipas kësaj thënieje, sepse fjala *"min"* është sqaruese dhe jo ndarëse.

Por komentimi i parë është më i vërtetë se gjithë komentet e tjera dhe atë e mbështesin edhe transmetimet islame.

Më pas Kur'ani shton: **"mos kërko shpejtimin e dënimit për ata!"**, pra, për jobesimtarët, sepse Kiameti po afrohet shpejt

---

[1] "Biharul Anuar", vëll 11, Hadithi 61, f. 58; Hadithi 55, f. 56, vëllimi i përmendur me qartësi në këtë kapitull.
[2] "Usulul Kafij", vëll. 1, Libri "Argumenti", kreu "Gradat e Profetëve dhe të të Dërguarve", Hadithi 3, f. 175.
[3] "Ed Durrul Menthur", vëll. 6, f. 45; tefsiri i "Keshafit", fundi i ajetit është kapitulli i diskutimit.
[4] Burimi i mëparshëm.
[5] Burimi i mëparshëm.

dhe ata do të shikojnë me sytë e tyre se çfarë kanë thënë kundër tij dhe do të shpërblehen me dënimin më të ashpër. Në atë çast do të shikojnë mirë gabimet e tyre, do të njohin se në ç'humbje dhe mashtrim kanë qenë.

Jeta e kësaj bote është shumë e shkurtër në krahasim me Jetën e Ahiretit, saqë: **"Ditën, kur të përjetojnë atë që u është premtuar, atyre do t'u duket se kanë qëndruar** (në Tokë) **vetëm një çast të ditës."**.

Ndjesia e jetës së shkurtër të dynjasë në krahasim me Ahiretin, krijohet ose ngaqë kjo jetë duket sikur është veçse një orë, përpara Jetës së Vërtetë e të Përhershme, ose sepse dynjaja u kalon atyre aq shpejt sa u duket sikur kanë jetuar vetëm një orë, ose nga fakti se ata e shikojnë rezultatin e jetës së tyre, të cilën nuk e shfrytëzuan dhe nuk përfituan prej saj përfitimin e vërtetë, përveç se një orë të vetme dhe asgjë më shumë.

Këtë çast ata i mbulon dëshpërimi dhe pikëllimi, por është vonë për t'u penduar, pasi nuk ka rrugë kthimi prapa.

Për këtë është pyetur Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: "Sa largësi ka mes dynjasë dhe Ahiretit?"

Ai është përgjigjur: "Sa hap e mbyll sytë."

Më pas thotë: "All'llahu i Lartësuar thotë: **'Atyre do t'u duket se kanë qëndruar** (në Tokë) **vetëm një çast të ditës.'"**[1] Nga

[1] "Reudatul Uaidhijn", vëll. 2, f. 448, sipas transmetimit të veprës "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, f. 25.

kjo nënkuptohet se përdorimi i fjalës *"es saatu"* nuk tregon kohën e zakonshme, por tregon për një kohë shumë të shkurtër.

Më pas ajeti shton si një paralajmërim për të gjithë njerëzit: **"Kjo është Shpallje e qartë."**.[1] Ky paralajmërim është mesazh i mjaftueshëm për të gjithë banorët e kësaj bote të vdekshme e të shkatërruar.

Fjalia e fundit përmban një pyetje me kuptim të thellë, që përfshin edhe kërcënimin: **"E kush do të shkatërrohet tjetër, përveç popullit të pabindur?"**.

Hulumtim

Profeti i Islamit ishte shembulli i durimit dhe i qëndrimit të fortë në Rrugën e Drejtë

Jeta e Profetëve të mëdhenj, sidomos e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është tregues i përballimit të pakufishëm të ngjarjeve të vështira, të fatkeqësive të rënda dhe furtunave të mëdha, sepse rruga e të vërtetës ishte e mbushur gjithmonë me probleme. Ata që e zgjedhin këtë rrugë, duhet të marrim mësime prej këtij shembulli.

[1] Fjala *"belagun"* është kallëzues i kryefjalës së fshehur. Vlerësimi është: Ky Kur'an është kumtues i mjaftueshëm, ose kjo këshillë dhe paralajmërim është kujtesë e mjaftueshme.

Nga kjo pikë rrezatuese, ne shikojmë gjithë historinë e Islamit, gjithë ditët e vështira dhe të errëta që kanë kaluar, vështirësitë nëpër të cilat ka kaluar Islami dhe Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Nga ky këndvështrim ne duhet ta shikojmë të ardhmen. Ne e kemi këtë model të përkryer, Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, kurse ai ishte një njeri i vetëm dhe nuk shikonte në horizontin e jetës asnjë shenjë mbështetjeje.

Armiqtë e tij përgatitën mbështetësit e tyre për ta vrarë atë, saqë edhe të afërmit dhe fisi i tij ishte në vijën e parë të kësaj lufte.

Ai shkonte gjithmonë te fiset arabe dhe i ftonte ata, mirëpo askush nuk i përgjigjej.

Ata e qëllonin atë me gurë, derisa i dilte gjak nga këmbët, por nuk ndaloi, nuk e la punën e tij. Ata i bënë atij edhe bllokadë shoqërore, ekonomike dhe politike, ia mbyllën të gjitha dyert dhe rrugët në fytyrë, derisa një pjesë e ndjekësve të tij vdiqën nga uria dhe u sëmurën njëri pas tjetrit.

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka kaluar ditë aq të vështira, sa nuk i shkruan dot asnjë laps, nuk mund t'i tregojë asnjë libër. Kur ai erdhi në Taif, që të ftonte njerëzit në Islam, ata nuk u mjaftuan vetëm me refuzimin e thirrjes së tij, por e qëlluan me gurë, derisa i doli gjak nga këmbët e tij.

Jobesimtarët i nxisnin njerëzit injorantë, që të ulërinin me të madhe dhe ta lëndonin atë me fjalë të këqija. Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* detyrohej të strehohej në një kopsht dhe nën hijen e një palme

t'i kërkonte shpëtim Zotit të tij. Ajeti thotë: "O Zoti im, po ankohem tek ti për fuqinë time të dobët dhe dredhinë, marifetin tim të pakët dhe degradimin tim ndaj njerëzve. O Mëshirues i Mëshiruesve, Ti je Zoti i njerëzve të dobët, të pafuqishëm. Ti je Zoti im! Ku më ke dorëzuar mua? Tek ata që më shikojnë me zemërim? Apo tek armiku që çështja ime e ka pushtuar? Në se Ti nuk je i zemëruar me mua, atëherë nuk e kam problem se ç'më kanoset mua...".[1]

Mohuesit e quanin një herë magjistar, herën tjetër budalla.

Herë i hidhnin pluhurin dhe dheun mbi kokë, herë tjetër bashkoheshin për ta vrarë. E rrethonin shtëpinë e tij me shpata dhe heshta.

Por ai, pavarësisht të gjitha këtyre kushteve të vështira, duroi dhe qëndroi me vendosmëri në Rrugën e Drejtë.

Më në fund, u poq fryti i mirë i kësaj peme të bekuar. Feja e tij u bë universale, nga Lindja në Perëndimin e botës dhe jo vetëm në Gadishullin Arabik. Edhe sot kumbon zëri i triumfit të tij, mëngjes e mbrëmje në të gjitha anët e botës dhe në të pesë kontinentet e botës. Ky është kuptimi i ajetit: **"...ti bëhu i durueshëm** (o Muhammed), **ashtu siç kanë duruar me këmbëngulje të Dërguarit e vendosur."**.

Kjo është mënyra e luftimit të shejtanëve, rruga e triumfit mbi ta dhe e arritjes së qëllimeve të larta.

[1] "Sijretu ibn Hisham", vëll. 2, f. 61.

Nëse është e vërtetë kjo, atëherë si kërkojnë qetësi dhe paqe, si kërkojnë të arrijnë te qëllimet e tyre të mëdha, pa treguar durim ndaj dënimeve dhe dhimbjeve?

Si shpresojnë myslimanët të triumfojnë sot mbi të gjithë këta armiq, të cilët kanë bashkuar të gjitha llojet e fuqive të tyre në luftën kundër shfarosjes së myslimanëve, pa patur frymëzim nga feja e Profetit Muhammed?

Në një hadith nga Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* thuhet: "Durimi për udhëheqësit është obligim, sipas Fjalës së All'llahut për të Dërguarin e Tij: **'...ti bëhu i durueshëm** (o Muhammed), **ashtu siç kanë duruar me këmbëngulje të dërguarit e vendosur.'**". Përgjigjja e Tij për miqtë dhe njerëzit e bindur të Tij, është: **"Ju e kishit shembullin më të lartë në të Dërguarin e All'llahut."**.[1]

O Zot, na jep këtë dhuratë të madhe, këtë dhuratë qiellore, durimin dhe vendosmërinë, qëndrimin e drejtë përballë problemeve!

O Zot, na bëj të suksesshëm në ruajtjen e pishtarit të dritës, të cilin e kanë mbajtur Profetët e Tu të vendosur, sidomos vula e Profetëve, Profeti Muhammed (Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), për të udhëzuar njerëzimin, për të përballuar vuajtjet rraskapitëse!

Zoti ynë! Armiqtë e të vërtetës janë të njësuar dhe janë grupuar kundër saj. Ata nuk ndalen para asnjë krimi e mëkati. O Zot, na jep durim dhe vendosmëri më të madhe se ata, që të mos përkulemi përpara vërshimit të problemeve.

---

[1] "El Ihtixhaxh" i Tabersijut, sipas transmetimit të tefsirit "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, f. 23, fundi i ajetit 21 i sures "El Ahzab".

O Zoti ynë, na jep sukses, që dallgët dhe furtunat jo vetëm t'i kalojmë, por t'i lëmë pas. Kjo nuk plotësohet ndryshe, veçse me ndihmën dhe mirësinë Tënde të pakufishme!

Amin, o Zoti i gjithë botëve!

Fundi i sures " El Ahkaf

SURE "MUHAMMED"

Zbritur në Medine, ajete 38

Përmbajtja e sures

Kjo sure është quajtur "Muhammed", sepse ky emër i bekuar është përmendur në ajetin e dytë të kësaj sureje. Kjo sure ka edhe një emër të dytë e ai është surja e luftimit *(suretul kitali)*. Në realitet çështja e xhihadit dhe luftimi i armiqve të Islamit është tema më kryesore që trajton kjo sure. Ajetet e tjera krahasojnë gjendjen e besimtarëve dhe të jobesimtarëve, karakteristikat, cilësitë dhe shpërblimin që merr secili prej tyre në Jetën Tjetër.

Përmbajtja e sures mund të ndahet në këto çështje:

1- Çështja e besimit, mohimit dhe e krahasimi të situatave të besimtarëve dhe dhe të jobesimtarëve në këtë botë dhe në Botën Tjetër.

2- Hulumtime të qarta dhe të dobishme rreth çështjes së xhihadit, të luftimit të idhujtarëve si dhe mësime të veçanta në lidhje me robërit e luftës.

3- Shpjegimi i situatave të hipokritëve, të cilët kishin aktivitete të shumta shkatërruesë kur zbritën këto ajete në Medine.

4- Një pjesë e sures flet për çështjen e rrugëtimit në tokë**,** marrja mësim e këshilla nga përfundimi i popujve të kaluar dhe nga dënimi i tyre.

5- Në një pjesë të ajeteve të kësaj sureje përmendet çështja e sprovimi, në përshtatje me temën e luftës dhe të xhihadit.

6- Në pjesën e fundit bëhet fjalë për çështjen e shpenzimt, i cili konsiderohet në vetvete, një lloj xhihadi. Flitet edhe për çështjen e koprracisë që është e kundërta e shpenzimit.

7- Disa ajete të kësaj sureje, në përshtatje me tematikën e tyre, flasin për çështjen e paqes me jobesimtarët, e cila u bë shkaku i mposhtjes dhe i poshtërimit të myslimanëve, dhe ajetet e ndalojnë këtë gjë.

Përgjithësisht pranohet se kjo sure ka zbritur në Medine, në kohën kur përplasja mes myslimanëve dhe armiqve të Islamit ishte e fortë. Sipas disa komentuesve, ajo ka zbritur gjatë Betejës së Uhudit, ose pak kohë pas saj. Çështja më e rëndësishme që trajton kjo sure, është çështja e xhihadit dhe e luftës. Çështjet e tjera sillen rreth kësaj çështjeje, rreth kësaj lufte vendimtare. Kjo luftë dallon besimtarët nga jobesimtarët dhe hipokritët. Kjo luftë forconte shtyllat e Islamit dhe i kundërpërgjigjej kurthit të armiqve, të cilët nxituan të shkatërrojnë Islamin dhe myslimanët.

Mirësia e leximit të sures

Në një hadith të transmetuar nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* thuhet: "*Kush e lexon suren 'Muhammed' All'llahu do t'i japë të pijë nga lumenjtë e Xhennetit.*".[1]

Në librin "Theuabul A'mal" transmetohet nga Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)*, se ka thënë: "*Kush e lexon suren 'Muhammed', nuk do të bjerë kurrë në dyshime për fenë e tij, All'llahu nuk do ta sprovojë me varfëri dhe as nuk do të frikësohet nga sundimtarët. Sa të jetë gjallë, do të jetë i ruajtur nga shirku. Nëse vdes, All'llahu i dërgon në varrin e tij një mijë engjëj që ta ruajnë, që të falen te varri i tij. Shpërblimi i namazit të tyre shkon për të. Engjëjt e*

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 9, f. 144, fillimi i sures "Muhammed".

shoqërojnë atë, derisa ta çojnë në një vend të sigurt, tek All'llahu. Aty është në sigurinë e All'llahut dhe të Muhammedit.".[1]

Është e qartë se ata që e përjetojnë këtë sure, janë të ashpër në xhihadin kundër armiqve. Lufta kundër armiqve është një nga bazat e fesë dhe e besimit të tyre të vendosur. Ata nuk i kap as frika e as poshtërimi, nuk përjetojnë varfëri. Në Ahiret ata janë të begatuar me mirësi, afër mëshirës së All'llahut.

Në një hadith tjetër thuhet se Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: *"Kush dëshiron të dijë gjendjen tonë dhe gjendjen e armiqve tanë, le të lexojë suren 'Muhammed', sepse ai do të shohë në ajet për ne dhe ajet për ata."*.[2]

Këtë hadith e kanë transmetuar edhe komentuesit e synetit, si: Alusij në veprën "Ruhul Meanij"[3] dhe Sujuti në "Ed Durrul Menthur".[4]

Kjo sure është sqarim i të vërtetës se Ehli Bejti i Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ishin një model i besimit, ndërsa Beni Umeje ishte një shembull i dukshëm i mohimit dhe i hipokrizisë.

Është e vërtetë se në këtë sure nuk është përmendur emri i Ehli Bejtit dhe as emri i Beni Umejes, por, meqenëse në këtë sure diskutohet për besimtarët dhe hipokritët, për karakteristikat e secilit prej tyre, ky fakt tregon se kjo sure pikësëpari tregon për dy të vërteta të qarta. Në të njëjtën kohë, kjo ka kuptim gjithëpërfshirës dhe përfshin të gjithë besimtarët dhe hipokritët.

---

[1] "Theuabul A'mal", sipas transmetimit të tefsirit "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, f. 25.
[2] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 9, f. 144, fillimi i sures "Muhammed".
[3] Tefsiri "Ruhul Meanij", vëll. 26, f. 33.
[4] Tefsiri "Ed Durrul Menthur", vëll. 6, f. 46.

Ajetet 1-3

بِسۡمِ ٱللَّهِ ٱلرَّحۡمَٰنِ ٱلرَّحِيمِ

ٱلَّذِينَ كَفَرُواْ وَصَدُّواْ عَن سَبِيلِ ٱللَّهِ أَضَلَّ أَعۡمَٰلَهُمۡ ١ وَٱلَّذِينَ ءَامَنُواْ وَعَمِلُواْ ٱلصَّٰلِحَٰتِ وَءَامَنُواْ بِمَا نُزِّلَ عَلَىٰ مُحَمَّدٖ وَهُوَ ٱلۡحَقُّ مِن رَّبِّهِمۡ كَفَّرَ عَنۡهُمۡ سَيِّـَٔاتِهِمۡ وَأَصۡلَحَ بَالَهُمۡ ٢ ذَٰلِكَ بِأَنَّ ٱلَّذِينَ كَفَرُواْ ٱتَّبَعُواْ ٱلۡبَٰطِلَ وَأَنَّ ٱلَّذِينَ ءَامَنُواْ ٱتَّبَعُواْ ٱلۡحَقَّ مِن رَّبِّهِمۡۚ كَذَٰلِكَ يَضۡرِبُ ٱللَّهُ لِلنَّاسِ أَمۡثَٰلَهُمۡ ٣

Me emrin e All'llahut, të Gjithmëshirëshmit, Mëshirëplotit!

"All'llahu do t'ua zhvlerësojë veprat atyre që mohojnë dhe i pengojnë njerëzit nga Rruga e Tij."

"Ndërsa atyre që besojnë, kryejnë vepra të mira dhe besojnë në atë që i është shpallur Muhammedit - dhe e cila është e Vërteta prej Zotit të tyre, - Ai do t'ua fshijë gjynahet dhe do t'ua përmirësojë gjendjen."

"Kjo, sepse ata që mohojnë, ndjekin të pavërtetën, kurse besimtarët mbështeten në të Vërtetën e ardhur nga Zoti i tyre. Kështu ua sjell All'llahu njerëzve shembujt e tyre."

Komentimi

Besimtarët janë ndihmësit e të vërtetës, kurse jobesimtarët janë ndihmësit e të kotës

Në të vërtetë këto tri ajete konsiderohen si premisë për çështjen e rëndësishme të luftës, e cila përmendet në fillim të ajetit të katërt të po kësaj sureje. Ajeti i parë, prej ajeteve në fjalë, sqaron gjendjen e jobesimtarëve dhe situatën e tyre, ajeti i dytë gjendjen e besimtarëve, ajeti i tretë i krahason të dyja situatat. E kjo që të përgatitet situata dhe rrethanat për xhihadin fetar kundër armiqve zullumqarë e mizorë.

Ajeti i parë thotë: **"All'llahu do t'ua zhvlerësojë veprat atyre që mohojnë dhe i pengojnë njerëzit nga Rruga e Tij."**

Ky ajet flet për kryesuesit e mohuesve dhe politeistëve të Mekës, të cilët ndiznin zjarrin e luftërave kundër Islamit. Ata nuk u mjaftuan vetëm me mosbesimin e tyre, por pengonin edhe të tjerët nga Rruga e All'llahut, përmes mashtrimeve dhe gënjeshtrave.

Edhe pse disa komentues, si Zamkhasheriju në "El Kesh'shaf", fjalën *"es sad'du"* e kanë komentuar me kuptimin e kundërshtimit të besimit, përballë ajetit që pason, i cili flet për besimin, mirëpo, duke parë përdorimin e kësaj fjale në Kur'an, duhet patur parqasysh ruajtja e kuptimit të saj origjinal që është pengesa, ndalimi *(el men'u)*.

Nga sifjalia: **"All'llahu do t'ua zhvlerësojë veprat atyre"**, kuptohet se All'llahu i Madhëruar i shkatërron ato, i bën pluhur

të shpërndarë, sepse fjalët "*el ihbatu*" dhe "*el idaatu*" janë metaforë për diçka që mbetet pa mbrotje dhe pa mbështetje e kjo çon në zhdukjen e asaj.

Si do që të jetë, një pjesë e komentuesve mendojnë se kjo fjali tregon ata që bënë kurban devenë në Ditën e Bedrit dhe ushqyen njerëzit. Ebu Xhehli theri kurban dhjetë deve. Njësoj si ai edhe Safvani, edhe Suhejl ibn Omeri therën kurbane për të ushqyer ushtrinë e mohimit.[1] Por, përderisa këto vepra ishin për t'u krenuar e për t'u mburrur, ishin kurthe të shejtanit, atëherë veprat e tyre u shkatërruan plotësisht.

Mirëpo duket qartë se përmbajtja e ajetit nuk kufizohet vetëm me këtë kuptim, madje tregon se të gjitha veprat që ata kanë kryer, nga më të dukshmet, deri te më të voglat, se ndihma ndaj të varfërve dhe të dobëtëve, se nderimi i mysafirit e të tjera si këto, do të shkatërrohen për shkak të mungesës së besimit.

Përveç këtyre, All'llahu i Madhëruar i ka shkatërruar edhe të gjitha intrigat dhe të gjitha veprat që kanë kryer për të fshirë Islamin dhe për të ekzekutuar myslimanët, ka shkatërruar edhe përpjekjet e tyre për të realizuar qëllimet e tyre të pista.

Ajeti në vijim përshkruan gjendjen e besimtarëve, të cilët qëndrojnë në rreshtin përballë jobesimtarëve, cilësitë e të cilëve janë përmendur në ajetin e kaluar.

Ajeti thotë: **"Ndërsa atyre që besojnë, kryejnë vepra të mira dhe besojnë në atë që i është shpallur Muhammedit - dhe**

[1] Tefsiri "Ruhul Meanij", vëll. 26, f. 33.

e cila është e Vërteta prej Zotit të tyre, - Ai do t'ua fshijë gjynahet dhe do t'ua përmirësojë gjendjen.".[1]

Përmendja e besimit në atë që i ka zbritur Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, pas përmendjes së besimit në mënyrë të përgjithshme, është pohim për mësimet të këtij Profeti të madh dhe metodave të tij. Ajo është njësoj si përmendja e të veçantës pas të përgjithshmes dhe sqarim i të vërtetës se besimi në All'llahun e Madhëruar nuk plotësohet kurrë pa besimin në atë që i ka zbritur Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Supozohet, gjithashtu, që fjalia e parë të tregojë besimin në All'llahun e Madhëruar dhe se ajo ka anën doktrinore. Kjo fjali tregon besimin në përmbajtjen e Islamit dhe mësimet e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Ajo ka edhe anën praktike.

Me një mënyrë tjetër të shprehuri, pa dyshim se vetëm besimi në All'llahun e Madhëruar nuk është i mjaftueshëm, madje duhet të besojnë edhe atë që ka zbritur te Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, duhet të besojmë Kur'anin, të kemi besim te xhihadi, te namazi dhe agjërimi. Duhet të kemi atë besim që është kryefjalë e lëvizjes dhe siguri e veprës së mirë.

Ajo që meriton kujdes, është vazhdimi i ajetit, pas përmendjes së kësaj fjalie: **"është e Vërteta prej Zotit të tyre"**. Kjo

[1] Një grup komentuesish, fjalinë **"është e vërteta prej Zotit të tyre"**, e kanë konsideruar fjali kundërshtuese.

sifjali, do të thotë se besimi nuk ka qenë me imitim, apo se ai nuk është ngritur mbi argumente dhe fakte, por ata besuan, pasi e panë të vërtetën në të.

Togfjalëshi **"prej Zotit të tyre"** mbështet të vërtetën se e drejta vjen gjithmonë nga All'llahu i Madhëruar, se ajo buron nga Ai dhe i referohet Atij.

Meriton vëmendjen fakti se ajeti sqaron dy shpërblime për besimtarët që bëjnë vepra të mira, përballë dy ndëshkimeve që janë përmendur për jobesimtarët që pengojnë ndaj Rrugës së All'llahut. Spërblimi i parë është **falja e mëkateve**. Asnjë njeri i pagabueshëm nuk mund të shmanget prej tyre, me përjashtim të të mbrojturve *(el ma'sumijne)*. Shpërblimi i dytë është: **përmirësimi i gjendjes**.

Fjala *"el balu"* është përmendur me kuptime të ndryshme. Këtu vjen me kuptimin *"gjendje"*, *"punë"*, *"zemër"* dhe sipas Er Ragibu, vjen edhe me kuptimin e situatave të mëdhaja e të rëndësishme. Bazuar mbi këtë kontekst kuptimor, përmirësimi i gjendjes do të thotë rregullimi i të gjitha problemeve të jetës dhe çështjeve vendimtare. Ky kuptim përfshin edhe fitoren në dynja, edhe shpëtimin në Ahiret. Ky kuptim është e kundërta e rrugës që zgjedhin jobesimtarët, që jo vetëm nuk marrin frytet e mundimeve dhe të përpjekjeve të tyre, por nuk kanë rrugë tjetër, përveç mposhtjes dhe dështimit: **"do t'ua zhvlerësojë veprat atyre"**.

Mund të thuhet se falja e mëkateve të tyre është si rezultat i besimit të tyre dhe se përmirësimi i gjendjes së tyre është si rezultat i punëve të tyre të mira. Pa dyshim se për besimtarët ka qetësi mendore dhe rehati shpirtërore, nga njëra anë dhe sukses e

shpëtim në programet e tyre praktike, nga ana tjetër. A ka mirësi më të madhe për njeriun se të ketë një shpirt të qetë, zemër të sigurt dhe programe të dobishme?

Nëpërmjet një krahasimi të shkurtër, ajeti i tretë sqaron shkakun kryesor të kësaj fitoreje dhe të asaj disfate: **"Kjo, sepse ata që mohojnë, ndjekin të pavërtetën, kurse besimtarët mbështeten në të Vërtetën e ardhur nga Zoti i tyre. Kështu ua sjell All'llahu njerëzve shembujt e tyre."**.

Këtu është sekreti i çështjes. Dy vijat, e besimit dhe e mosbesimit, ndahen nga dy vijat e të vërtetës dhe e të kotës. E vërtetë është ajo që shihet me sy. Shkalla më e lartë e tyre është Uni i Shenjtë i All'llahut. Prandaj, besimin e pasojnë të vërtetat e lidhura me jetën e njeriut, rregullat gjykuese në lidhjen e tij me All'llahun dhe në lidhjen e tij me të tjerët.

Kurse e kota, e pavërteta, është të menduarit dhe përfytyrimet, kurthet dhe mashtrimi, legjendat e trillimet, veprimet e errëta, të cilat nuk kanë qëllim nga pas dhe lloj shmangieje ndaj ligjeve organizative në botën e ekzistencës.

S'ka dyshim se besimtarët ndjekin të vërtetën dhe e ndihmojnë, e mbështesin atë, kurse jobesimtarët ndjekin të pavërtetën dhe e mbështesin atë. Këtu fshihet sekreti i fitores së tyre dhe i disfatës së atyre.

Kur'ani thotë: **"Ne nuk i kemi krijuar kot Qiellin dhe Tokën dhe çka ka ndërmjet tyre."**.[1]

[1] Sure "Sad", ajeti 27.

Disa komentues, fjalën *"el batilu"*, e kanë komentuar me të pavërtetën, të lidhur me shejtanin, kurse të tjerë të lidhur me absurdin. Më sipër treguam se fjala *"el batilu"* ka një kuptim më të gjerë, i cili i përfshin këto dy komentime, si dhe komentime të tjera.

Në fund, ajeti shton: **"Kështu ua sjell All'llahu njerëzve shembujt e tyre."**. Pra, All'llahu i Madhëruar i ka sqaruar planet e përgjithshme të jetës së besimtarëve dhe të jobesimtarëve, të besimeve dhe praktikave të tyre. Ka sqaruar edhe rezultatet e punëve të tyre. Ai e bën të qartë rezultatin e jetës së tyre dhe dënimet për veprat që ata kryejnë.

Ky ajet tregon se All'llahu i Madhëruar e përshkruan gjendjen e njerëzve, siç e ka përshkruar Xhennetin në ajetin e 15 të sures "Muhammed": **"Si Xhenneti që u është premtuar të devotëshmëve..."**.

Nga ky ajet kuptojmë se sa më shumë që të afrohemi me të vërtetën, aq më shumë i afrohemi besimit; sa më shumë i largohemi të vërtetës së besimit, aq më shumë i afrohemi mosbesimit. Bazat e besimit dhe të mosbesimit janë e vërteta *(el hakku)* dhe e pavërteta *(el batilu)*.

Ajetet 4 – 6

فَإِذَا لَقِيتُمُ ٱلَّذِينَ كَفَرُواْ فَضَرۡبَ ٱلرِّقَابِ حَتَّىٰٓ إِذَآ أَثۡخَنتُمُوهُمۡ فَشُدُّواْ ٱلۡوَثَاقَ فَإِمَّا مَنَّۢا بَعۡدُ وَإِمَّا فِدَآءً حَتَّىٰ تَضَعَ ٱلۡحَرۡبُ أَوۡزَارَهَاۚ ذَٰلِكَۖ وَلَوۡ يَشَآءُ ٱللَّهُ لَٱنتَصَرَ مِنۡهُمۡ وَلَٰكِن لِّيَبۡلُوَاْ بَعۡضَكُم بِبَعۡضٖۗ وَٱلَّذِينَ قُتِلُواْ فِي سَبِيلِ ٱللَّهِ فَلَن يُضِلَّ أَعۡمَٰلَهُمۡ ۝ سَيَهۡدِيهِمۡ وَيُصۡلِحُ بَالَهُمۡ ۝ وَيُدۡخِلُهُمُ ٱلۡجَنَّةَ عَرَّفَهَا لَهُمۡ ۝

“Kur të përballeni në luftë me mohuesit, goditini në qafë, derisa t’i rraskapitni e t’i shkatërroni ata dhe pastaj lidhini fort. Mandej ose i lironi me zemërgjerësi, ose me shpërblim, derisa të bëhet armëpushimi. Kështu bëni! Sikur të donte All’llahu, do t’i shkatërronte ata, por Ai dëshiron t’ju sprovojë juve me njëri-tjetrin. Ai nuk ua humb veprat atyre që vdesin në Rrugën e All’llahut.”

“Ai do t’i udhëzojë ata, do t’ua përmirësojë gjendjen.”

“Dhe do t’i shpjerë në Xhennet, të cilin ua ka bërë të njohur më parë.”

Komentimi

Në sheshin e luftës duhet vendosmëri

Siç e thamë edhe më parë, ajetet e kaluara ishin premisë për përgatitjen e myslimanëve, për të dhënë vendimin e rëndësishëm luftarak që përmendet në ajetet në fjalë. Ajeti i parë thotë: **"Kur të përballeni në luftë me mohuesit, goditini në qafë"**.

Është e natyrshme se togfjalëshi **"goditini në qafë"** është shprehje metaforike që nënkupton vrasjen. Këtë ajeti e shpreh qartë. Bazuar në këtë, nuk është e domosdoshme që luftëtarët të shpenzojnë fuqitë e tyre për zbatimin e këtij vendimi, sepse qëllimi është largimi i armikut dhe shfarosja e tij. Përderisa goditja e qafave është një prej të vërtetave të këtij vendimi, ajeti e përforcon atë.

Si do që të jetë, ky gjykim është i lidhur me fushën e betejës, sepse fjala *"lekijtum"* vjen nga fjala *"el likau"*, që do të thotë luftë në këtë rast. Në të njëjtën kohë në ajet ka argumente të shumta që dëshmojnë për kuptime të tjera, përveç vrasjes, si p.sh, kapjen rob, shprehejn luftë dhe martirizim në Rrugën e All'llahut, që përmenden në fund të ajetit.

Përmbledhja e fjalëve: Fjala *"el likau"*, përdoret me kuptimin e takimit me çdo lloj gjëje, në çfarë do lloj forme. Nganjëherë përdoret edhe me kuptimin e përballimit dhe të ballafaqimit në fushëbetejën e luftës. Kjo fjalë është përdorur në Kur'an me të dyja kuptimet. Ajeti që po komentojmë, përdor kuptimin e dytë.

Nga këtu bëhet e qartë se ata që e kanë modifikuar dhe e kanë komentuar këtë ajet se Islami: Kudo që të gjeni një jobesimtar, ta vrisni, ata nuk dëshirojnë gjë tjetër veçse njollosjen e Islamit dhe ajetin me kuptim të devijuar ta kenë si armë kundër fesë së pastër e të drejtë. Ndërkohë që ajeti thekson se bëhet fjalë vetëm për në fushën e luftës, ku përballen palët.

Është e natyrshme se kur njeriu përballet me një armik të ashpër në luftë dhe nuk përballet me vendosmëri, nuk e godet dhe nuk ia provon shijen e armës së tij, ai do të vritet. Ky është një ligj logjik.

Më pas ajeti shton më pas: **"...derisa t'i rraskapitni e t'i shkatërroni ata dhe pastaj lidhini fort."**.

Fjala *"ethekhantumuhum"* vjen nga fjala *"thekhene"* dhe ka kuptimin e ashpërsisë dhe të palëkundshmërisë. Për këtë arsye, kjo fjalë përdoret edhe për fitoren, për triumfin e qartë dhe për mbajtjen nën kontroll të armikut.

Pavarësisht se shumica e komentuesve të Kur'anit e kanë komentuar këtë fjali të lidhur me numrin e të vrarëve të armikut, me fuqinë e dhunën e tij, mirëpo ky kuptim nuk gjendet në rrënjën gjuhësore të kësaj fjale. Kur largimi i rrezikut të armikut, ndonjëherë ka qenë i pamundur, vetëm duke u ndeshur dhe duke vrarë sa më shumë prej tyre, mundet që, në kushte të tilla, çështja e vrasjes të jetë një nga miratimet e kësaj fjalie, por në asnjë rast nuk është një nga kuptimet kryesore të saj.[1]

[1] Autori i "Lisanul Arab", transmeton nga ibn El A'rabij se fjala *"ethkhane"* do të thotë *"triumfon, mposht"*.

Në çdo rast, ajeti i përmendur qartëson një mësim të përpiktë ushtarak, i cili thotë se nuk i duhet dhënë më shumë përparësi kapjes së robërve të luftës se sa shkatërrimit të radhëve të armikut dhe zhdukjes së mjeteve të tij mbrojtëse. Dhënia përparësi kapjes së robërve të luftës, mund të bëhet shkak për lëkundjen e situatës së myslimanëve në luftë dhe mund t'i pengojë ata të zbatojnë detyrën e tyre thelbësore.

Sifjalia: **"pastaj lidhini fort"**, duke parë se fjala *"el uithak"* është për litarin, apo për çdo gjë që përdoret për lidhje, ajo tregon për mënyrën e lidhjes së robërve të kapur, që të mos arratisen dhe të sulmojnë sërish e të dëmtojnë Islamin dhe myslimanët.

Fjalia e dytë sqaron dispozitën e robërve të luftës, e cila duhet të zbatohet ndaj tyre pas mbarimit të luftës. Për këtë ajeti thotë: **"Mandej ose i lironi me zemërgjerësi, ose me shpërblim."**. Ky ajet tregon se nuk lejohet vrasja e robit të luftës, pas përfundimit të luftës. Udhëheqësi i myslimanëve, bazuar në interesin që ai e mendon, ose mund t'i lirojë pa asnjë kusht apo pagesë, ose, nëse gjykohet si e drejtë, mund t'i kërkojë që të paguajnë një kompensim.

Sigurisht që ka edhe një rregull të tretë në Islam, në lidhje me këtë temë. Ky rregull thotë se robërit edhe mund të mbahen si skllevër. Vetëm se skllavërimi nuk është një çështje e detyruar, përkundrazi, atë e vendos udhëheqësi i myslimanëve, i cili e zbaton atë kur e shikon të domosdoshme, në situata të veçanta. Edhe pse kjo nuk është përmendur në Kur'an, sqarohet në transmetimet islame.

Dijetari ynë i njohur, Fadil Makdad, në veprën "Kenzul Urfan", thotë: 'Ajo që ka ardhur nga Ehli Bejti *(Paqja qoftë mbi të!)*

është se nëse robi kapet pas përfundimit të luftës, atëherë Imami, udhëheqësi i myslimanëve duhet të zgjedhë mes tri gjërash: ose lënien e tij të lirë pa asnjë kusht, ose lirimin e tij, duke marrë një shpërblim, ose ta bëjë atë skllav. Vrasja e tij nuk lejohet në asnjë lloj mënyre.'.

Në një vend tjetër të fjalës së tij thotë: 'Çështja e skllavërisë është përftuar nga transmetimet dhe jo nga teksti i ajetit.'.[1]

Kjo çështje është përmendur në shumë libra të jurisprudencës islame.[2]

Për skllavërinë, do të diskutojmë në fundin e këtyre ajeteve.

Pas kësaj, ajeti shton: **"derisa të bëhet armëpushimi"**.[3] Nga kjo shtesë e ajetit kuptojmë se nuk duhet të ndalet lufta, deri në shkatërrimin përfundimtar të forcave të armikut dhe deri a të shuhen vatrat e luftës.

Fjala *"el euzaru"* tregon *"peshën e rëndë"*. Ngandonjëherë kjo fjalë tregon peshën e rëndë të mëkateve, të cila i rëndojnë shumë njeriut.

Është interesante se në ajet këto pesha të rënda i referohen luftës. Ajeti thotë: **"derisa të bëhet armëpushimi"**. Këto pesha të rënda, në mënyrë metaforike, emërtojnë llojet e ndryshme të armëve dhe problemet me të cilat përballen luftëtarët, derisa të përfundojë lufta.

---

[1] "Kenzul Urfan", vëll. 1, f. 365.
[2] "Esh Sheraiu", kreu "El Xhihadu". "Sherhu El Lum'atu", *hukmul ganijmeti*.
[3] Fjala *"hatta"* i adresohet togfjalëshit **"goditini në qafë"**. Janë bërë supozime të tjera që nuk meritojnë t'u jepet rëndësi.

Mirëpo, kur përfundon lufta mes Islamit dhe mosbesimit?!

Kësaj pyetjeje komentuesit i kanë dhënë përgjigje të ndryshme:

Disa komentues, si p.sh. ibn Abasi, ka thënë: "Derisa të mos mbetet asnjë paganizëm mbi sipërfaqen e Tokës, derisa të shkulet politeizmi dhe të çrrënjosen rrënjët e tij.".

Disa të tjerë kanë thënë se lufta mes Islamit dhe mosbesimit është e ngritur derisa myslimanët të triumfojnë ndaj Dexhalit. Kjo thënie mbështetet në një hadith të transmetuar nga i Dërguari i All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: *"Xhihadi do të vazhdojë, që kur më ka dërguar mua All'llahu e derisa ymeti im i fundit të luftojë Dexhalin."*.[1]

Diskutimi rreth *"Dexhalit"* është një diskutim i gjerë. Dihet se *Dexhali* është një njeri mashtrues, ose dexhalët janë disa njerëz mashtrues, të cilët do të aktivizohen në fund të kohës, me qëllim që t'i largojnë njerëzit nga monoteizmi dhe nga drejtësia. Mbi ta do të gjykojë e do të vendosë Mehdiu *(All'llahu ia shpejtoftë ardhjen!)* me forcën e tij të madhe. Prandaj lufta mes të vërtetës dhe të pavërtetës do të jetë e vazhdueshme, derisa të ketë mashtrues mbi sipërfaqen e Tokës.

Islami e lufton mosbesimin me dy lloje luftimi: Lloji i parë janë luftërat e ndara në faza, si betejat që ka bërë Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Shpatat nuk hynin në këllëfet e tyre deri në përfundim të betejës. Lloji i dytë është lufta e vazhdueshme kundër shirkut dhe mosbesimit, padrejtësisë dhe shkatërrimit në Tokë. Kjo është një luftë e vazhdueshme deri në ardhjen e Mehdiut *(All'llahu ia*

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 9, f. 97.

shpejtoftë ardhjen!), deri në përhapjen e qeverisë botërore të drejtësisë mbi sipërfaqen e Tokës.

Më pas ajeti shton: **"...Kështu bëni! Sikur të donte All'llahu, do t'i shkatërronte ata..."**, me rrufe shkatërruese, me tërmete, furtuna e sprova të tjera. Pastaj, ajeti thotë: **"...por Ai dëshiron t'ju sprovojë juve me njëri-tjetrin... "**.

Kjo çështje është filozofia e luftës dhe çështja kryesore në ndeshjen e të vërtetës me të pavërtetën, sepse në këto luftëra do të ndahen radhët e besimtarëve të vërtetë dhe të jobesimtarë. Këto luftëra do të ringjallin forcën dhe qëndrueshmërinë dhe do të vërtetojnë qëllimin kryesor të jetës së dynjasë, zhvillimin e fuqisë së besimit dhe të vlerave të tjera njerëzore.

Nëse besimtarët izolohen në vetvete dhe merren me punët monotone të jetës së përditshme dhe idhujtarët bëjnë padrejtësi, All'llahu i Madhëruar i shkatërron ata me metoda të mrekullueshme, atëherë shoqëria do të bëhet e përgjumur, e dobët dhe e pafuqishme. Si rrjedhim, Islamit e besimit nuk i mbetet gjë tjetër, përveç emrit.

Si përfundim, mund të themi se All'llahu i Madhëruar është i vëmendshëm ndaj përpjekjeve tona, ndaj luftës sonë për të vërtetuar shtyllat e fesë së Tij. Jemi ne që edukohemi në sheshin e luftës kundër armiqve, jemi ne ata që kemi nevojën e kësaj lufte të shenjtë.

Ky kuptim është përmendur, në forma të tjera edhe në ajete të tjera të Kur'anit. Në ajetin 142 të sures "Ali Imran" thuhet: **"A mos menduat ju se do të hynit në Xhennetet e All'llahu pa e**

ditur, (pa u vërtetuar në praktikë) **se cilët prej jush kanë luftuar dhe pa e ditur se cilët prej jush ishin të durueshëm?"**.

Në një ajet para tij thuhet: **"Dhe All'llahu t'i pastrojë besimtarët, ndërsa gradualisht t'i shkatërrojë jobesimtarët."**.

Fjalia e fundit e ajetit që po komentojmë, flet për shehidët, dëshmorët, që ofruan shpirtin e tyre si dhuratë për fenë e tyre në këto luftëra. Për këtë heroizëm, ata kanë fituar mirësi të madhe ndaj shoqërisë islame. Ajeti thotë: **"Ai nuk ua humb veprat atyre që vdesin në Rrugën e All'llahut."**.

Përpjekjet, dhimbjet dhe sakrificat e tyre nuk do të shkojnë kot, përkundrazi, të gjitha ato janë të ruajtura mirë te All'llahu i Madhëruar. Gjurmët e sakrificave të tyre do të mbeten përherë në këtë dynja. Çdo thirrje: "Nuk ka tjetër Zot, veç All'llahut" do të dëgjohet nga njeriu. Ajo thirrje shëmbëllen me sakrificën dhe përpjekjet e dëshmorëve. Çdo sexhde që bën një mysliman para All'llahut, është nga begatitë e sakrificave të tyre, sepse me përpjekjet e tyre janë shkatërruar zinxhirët e poshtërimit dhe të skllavërisë. Forca e myslimanëve dhe ngritja e tyre lart është mundësuar nga sakrificat dhe heroizmi i tyre.

Kjo është një nga dhuratat e All'llahut për dëshmorët.

Por edhe tri dhurata të tjera janë shtuar në ajetet që vijnë më pas.

Ajeti 5 fillon: **"Ai do t'i udhëzojë ata"**, drejt pozitave të ngritura lart, drejt fitores së madhe dhe kënaqësisë së All'llahut të Lartësuar.

Ajeti 5 vazhdon: **"do t'ua përmirësojë gjendjen"**, sepse do t'u japë atyre qetësi shpirtërore, qetësinë e zemrës, aktivizimin

material dhe shpirtëror, harmonizimin me pastërtinë e engjëjve të All'llahut dhe moralin shpirtëror të tyre, duke i bërë ata miqtë dhe shoqëruesit e tyre në mbledhjet e miqësisë dhe të kënaqësisë së tyre. I fton ata në mikpritjen e Tij, afër mëshirës së Tij.

Dhurata e fundit është: **"...dhe do t'i shpjerë në Xhennet, të cilin ua ka bërë të njohur më parë."**.

Disa komentues kanë thënë se All'llahu i Madhëruar nuk ua ka bërë të qartë vetëm cilësitë e përgjithshme të Xhenneteve të larta dhe kopshtet e kënaqësisë, por Ai ua ka bërë të ditur cilësitë e banesave të tyre në Xhennet dhe shenjat e tyre, që, kur ata të futen në Xhennet, të drejtohen menjëherë drejt kështjellave të tyre.[1]

Disa komentues të tjerë kanë thënë se fjala *"arrefeha"*, vjen nga fjala *"urfun"*, është parfumi me aromë të mirë, domethënë se All'llahu i Madhëruar do t'i fusë ata në Xhennetin, të cilin e ka parfumosur për të pritur miqtë e Tij. Mirëpo, komentimi i parë duket më i përshtatshëm.

Komentues të tjerë kanë thënë se, nëse i bashkojmë këto ajete me ajetin: **"Kurrsesi të mos mendoni se ata që u vranë në Rrugën e All'llahut, janë të vdekur."**[2], do të bëhet e qartë se qëllimi i përmirësimit të gjendjes, është ringjallja e tyre me një jetë që bëjnë vepra të mira, për të ardhur te Zoti i tyre me zbulimin e perdes.[3]

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 9, f. 98.
[2] Sure "Ali Imran", ajeti 169.
[3] Tefsiri "El Mijzan", vëll. 18, f. 244.

Hulumtime

1- Pozita e lartë e dëshmorëve

Historia tregon se popuj dhe kombe të ndryshëm kalojnë ditë dhe situata të vështira, të cilat nuk mund të largohen pa sakrifica dhe luftë të vendosur. Kështu që besimtarët sakrifikues duhet t'i drejtohen fushëbetejave për të mbrojtur fenë e vërtetë me gjakun e tyre. Sipas Islamit këta persona quhen dëshmorë.

Përdorimi i fjalës *"shehid"*, që vjen nga fjala *"shuhudun"*, ose ka synim praninë e tyre në mejdanin e xhihadit kundër armiqve të së vërtetës, ose, sepse ata shikojnë me sytë e tyre engjëjt e mëshirës, në çastin kur bien dëshmorë, ose, sepse ata shikojnë mirësitë e mëdha që janë përgatitur për ta, ose, sepse shikojnë praninë e tyre tek All'llahu, siç thuhet në ajetin: **"Kurrsesi të mos mendoni se janë të vdekur ata që ranë dëshmorë në Rrugën e All'llahut. Përkundrazi, ata janë të gjallë, duke u ushqyer tek Zoti i tyre."**.[1]

Janë të paktë ata që arrijnë gradën e dëshmorit në Islam. Ata që e fitojnë këtë gradë, janë ata që bien dëshmorë në sheshin e luftës mes të vërtetës dhe të pavërtetës, të kotës, me nijet të sinqertë për të ecur në këtë rrugë.

Në burime të ndryshme islame, vihen re transmetime të çuditshme rreth pozitës së dëshmorëve, që tregojnë madhështinë e punës së dëshmorëve në Rrugë të All'llahut dhe vlerës së tij unike.

[1] Sure "Ali Imran", ajeti 169.

Në një hadith të të Dërguarit të All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, lexohet: "*Mbi çdo përkushtim të mirë, ka një përkushtim tjetër, derisa njeriu të bjerë dëshmor në Rrugë të All'llahut.*".[1]

Në një hadith tjetër, të transmetuar prej tij, thuhet: "*Luftëtarët në Rrugën e All'llahut janë komandantët e banorëve të Xhennetit.*".[2]

Në një hadith tjetër, të transmetuar nga Imam Bakiri *(Paqja qoftë mbi të!)*, lexojmë: "*Nuk ka pikë gjaku më të dashur te All'llahu se sa pika e gjakut e derdhur në Rrugë të Tij, se një pikë loti që derdhet prej frikës së All'llahut. Nuk ka ecje më të dashur te All'llahu se sa hapi drejt të afërmve, apo një hap që të çon drejt Rrugës së All'llahut.*".[3]

Nëse shfletojmë faqet e historisë së Islamit, do të shohim se dëshmorët në Rrugë të All'llahut janë ata që kanë ofruar gjithçka në këtë drejtim.

Martirizimi nuk ka qenë vetëm në të shkuarën. Kultura e martirizimit është rrugëtim edhe sot me të cilën tmerrohet armiku, çahen radhët e tij, e pengon atë që të depërtojë në Islam dhe dërgon dëshpërim në zemrat e armikut. Sa e begatë që është kultura e martirizmit për myslimanët dhe sa tmerruese është ajo për armikun!

Martirizimi nuk është një qëllim. Qëllimi është të triumfosh mbi armikun dhe të mbrosh fenë e All'llahut. Vetëm se këta rojtarë që mbrojnë fenë e tyre, duhet të jenë të përgatitur dhe, në

[1] "Biharul Anuar", vëll. 100, f. 15 dhe vëll. 74. f. 83.
[2] Burimi i mëparshëm.
[3] "Biharul Anuar", vëll. 100, f. 14.

qoftë se i kërkon detyra për të sakrifikuar edhe jetën, ata nuk hezitojnë asnjë çast. Ata janë të parët që i dalin përpara kësaj të keqeje. Ky është kuptimi i ymmetit të brumosur me martirizimin. Ata nuk e kërkojnë martirizimin si synim final.

Martirizimi në rrugën e Islamit ka dy kuptime të ndryshme: një kuptim të veçantë dhe tjetri, i përgjithshëm, i gjerë.

Kuptimi i veçantë, tregon vrasjen në Rrugë të All'llahut në betejën e xhihadit, e cila ka ligjet e saj të veçanta në jurisprudencën islame. Një prej këtyre ligjeve është se shehidi as nuk lahet dhe as nuk qefinoset. Ai varroset me rrobat dhe gjakun e tij, nëse ka vdekur në sheshin e betejës.

Kuptimi i përgjithshëm, i gjerë i martirizimit tregon njeriun që vritet në rrugën e zbatimit të detyrës hyjnore, sepse kushdo që largohet nga dynjaja, kur është në zbatimin e kësaj detyre, konsiderohet shehid. Prandaj thuhet në transmetimet islame, se disa grupe largohen nga kjo dynja si shehidë:

1- Nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* transmetohet: "*Nëse nxënësit të dijes i vjen vdekja dhe ai është në atë situatë, ai vdes si shehid.*".[1]

2- Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* thotë: "*Ai që vdes në shtratin e vet, njohës i të drejtës së Zotit të vet, i të drejtës së Profetit të Tij dhe të Ehli Bejtit (Paqja qoftë mbi ta!), vdes shehid.*".[2]

[1] "Sefijnetul Bihar", vëll. 1, lënda "*shehide*".
[2] "Nehxhul Belaga", fundi i Hytbes 190.

3- Lexojmë në një hadith tjetër nga Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)*: *"Kush vritet për diçka, përveç pasurisë së tij, ai është shehid."*.[1]

Po kështu edhe të tjerë që vriten në Rrugë të Drejtë, apo vdesin në Rrugën e Drejtë, quhen shehidë.

E përfundojmë këtë diskutim me hadithin e Imam Aliut, të birit të Musa Rizait *(Paqja qoftë mbi të)*, nga të parët e tij, nga i Dërguari i All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: *"I pari që do të futet në Xhennet, është shehidi (dëshmori)."*.[2]

2- Qëllimet e luftës në Islam

Lufta në Islam nuk konsiderohet si vlera e vlerave më të larta. Ajo konsiderohet kundërvlerë përshkak se ajo sjell prishje, shkatërrim, vrasje të njerëzve si dhe shpërdorim të mundësive të cilat njeriu mund t'i përdorë për lumturinë e tij. Prandaj, në disa ajete kur'anore, që tregojnë ndëshkimet hyjnore, si në ajetin 65 të sures "El En'am", thuhet: **"Thuaj: 'Ai ka fuqi** (t'ju shpëtojë por edhe) **t'ju sjellë dënim prej së larti ose prej së poshtmi, nën këmbët tuaja, apo t'ju ndajë në grupe e ta luftoni njëri-tjetrin."**.

Lufta këtu është konsideruar si rrufeja dhe tërmeti, si sprovë tokësore dhe qiellore, prandaj edhe Islami frenohet përballë luftës kur është mundësia e një rruge tjetër përveç luftës.

Në qoftë se ymetin e kërcënon një rrezik, ose qëllimet e tij të shenjta e të larta kërënohen me zhdukje, atëherë lufta në këtë rast konsiderohet vlerë e lartë dhe përfton titullin e xhihadit në

[1] "Sefijnetul Bihar", vëll. 1, lënda *"shehide"*.
[2] "Biharul Anuar", vëll. 71, f. 272.

Rrugë të All'llahut. Prandaj, edhe në Islam ka shumë lloje xhihadesh: xhihadi fillestar, çliruesi i popujve, xhihadi mbrojtës, xhihadi për shuarjen e zjarrit të përçarjes, të shirkut dhe të paganizmit. Këtë analizë e kemi bërë në një vend tjetër.[1]

Sipas këtij kuptimi, xhihadi në Islam, është e kundërta e asaj që thonë armiqtë e Islamit se ai ka kuptimin e besimit të imponuar ndaj të tjerëve. Madje, besimi i imponuar nuk ka asnjë vlerë në Islam. Përkundrazi, xhihadi ka lidhje me situatat kur armiku sulmon ymetin islam, ose kur u hiqen liritë që All'llahu ia ka dhënë atij, ose kur armiku dëshiron të shkelë të drejtat e ymetit, ose kur një i padrejtë ka privuar rëndë myslimanët, atëherë myslimanët duhet të nxitojnë të ndihmojnë të shtypurin edhe sikur çështja të shkojë deri te lufta me popullin zullumqarë.

Ajetet e kaluara e kanë pasqyruar këtë kuptim me një shprehje të butë, të shkurtër, përmbledhëse: **"Kjo është kështu, ngase ata që nuk besuan, ndoqën të pavërtetën, e ata që besuan, ndoqën të vërtetën që u erdhi prej Zotit të tyre."**. Bazuar në këtë, lufta është mes të vërtetës dhe të pavërtetës. Ajo nuk është mjet për formimin e një shteti, as përpjekje për të zgjeruar kufijtë e tij, as mësymje ndaj pasurive të të tjerëve e as për të përhapur përdorimin e forcës e të terrorit.

Kemi lexuar në transmetimin që e kemi përmendur në komentimin e këtij ajeti, se zjarri i përçarjes *(el fitnetu)* nuk do të shuhet kurrë në shoqërinë njerëzore, derisa të zhduken të gjithë dexhalët dhe toka të pastrohet prej tyre.

[1] Shih fundin e ajetit 193 të sures "El Bekare" në këtë komentim.

Këtu duhet vënë theksi se Islami e pohon dhe e përforcon bashkëjetesën paqësore me ndjekësit e feve të tjera qiellore. Në ajete kur'anore, në transmetime dhe në jurisprudencën islame, përmenden diskutime të hollësishme për këtë çështje. Në to ka një kapitull me titull: *Dispozitat e jomyslimanëve*. Nëse Islami mbështet imponimin e besimit dhe përdor forcën dhe shpatën për të arritur qëllimet e tij, atëherë çfarë kuptimi do të kishte ligji për jomyslimanët dhe bashkëjetesa paqësore?

3- Rregullat e të burgosurve të luftës

Më sipër u tha se myslimanët nuk duhet të mendojnë për të kapur rob armikun. Armikun mund ta zësh rob, vetëm pasi të jetë mundur plotësisht. Ndryshe, ky lloj të menduari, në raport me robërit e luftës, mund të sjellë rreziqe.

Ajetet që po komentojmë, tregojnë domosdoshmërinë e afrimit të njerëzve armiq, pas mposhtjes së tyre, Ajeti thotë: **"Kur të përballeni në luftë me mohuesit, goditini në qafë..."**. Më pas shton: **"...derisa t'i rraskapitni e t'i shkatërroni ata dhe pastaj lidhini fort."**. Pra, duhet të kapen rob, në vend që të vriten, pasi të fitoni kundër tyre. Kjo duhet të zbatohet, sepse, nëse armiku lihet të ikë, atëherë është e mundur që ai mund të sulmojë myslimanët edhe një herë tjetër. Pas zënies rob, situata ndryshon. Robërit e luftës janë një amanet i All'llahut në dorën e myslimanëve, pavarësisht krimeve që kanë kryer, prandaj duhet të mbrohen.

Me të vërtetë që Kur'ani i lavdëron ata që favorizojnë robin e luftës ndaj vetes së tyre dhe i shërbejnë atij ushqimin: **"Ata janë që për hir të Tij u japin ushqim të varfërve, jetimëve dhe të**

zënëve rob.".[1] Ky ajet, sipas një transmetimi të njohur, ka zbritur për Aliun, Fatimen, Hasanin dhe Hysejnin *(Paqja qoftë mbi ta!)*, pasi edhe pse ishin agjërueshëm, ua kanë dhënë iftarin e tyre një herë një të varfëri, herën e dytë një jetimi, kurse një herë tjetër, një të zëni rob.

Edhe për ata robër që vriten pas lufte, për shkak të rrezikshmërisë së tyre, ose pse kanë kryer krime të veçanta, Islami ka urdhëruar që të sillet mirë me ta, para se të merret vendimi, duke respektuar të drejtat e tyre. Këtë e shikojmë në një hadith të transmetuar nga Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*, në të cilin thuhet: *"Të ushqesh një rob lufte dhe të sillesh mirë me të, është një e drejtë e detyruar, edhe sikur ti ta vrasësh atë të nesërmen."*.[2]

Në këtë kapitull, haditet për këtë çështje janë të shumta.[3] Në një prej këtyre haditeve, Imam Aliu, i biri i Imam Hysejnit *(Paqja qoftë mbi të!)*, ka thënë: *"Nëse një i zënë rob, nuk ka fuqi të ecë dhe nuk ke me vete ndonjë mjet për ta bartur, atëherë dorëzoje atë dhe mos e vrit, sepse ti nuk mund ta dish se çfarë vendimi do të marrë Imami për të."*.[4]

Historia e Ehli Bejtit tregon se ata i ushqenin të zënët rob nga i njëjti ushqim që hanin vetë.

Vendimi i gjykimit i të zënit rob, pas përfundimit të luftës, është një nga këto: ose lirimi i tij pa asnjë lloj kushti, ose lirimi i tij në këmbim të shpagimit të një sasie parash, ose skllavërimi i tij.

---

[1] Sure "El Insan", ajeti 8.
[2] "Uesailu Shia", vëll. 11, f. 69.
[3] "Furul Kafij", vëll. 5, K. "Mëshirimi i robërve të luftës dhe ushqyerja e tyre", f. 35.
[4] Burimi i mësipërm.

Zgjedhja e njërës prej këtyre tri vendimeve është e kushtëzuar nga mendimi i Imamit të myslimanëve, sepse është ai që e zgjedh atë, bazuar në interesat e Islamit dhe të myslimanëve. Pas kësaj urdhëron zbatimin e asaj që ka zgjedhur.

4- Skllavëria në Islam

Megjithëse çështja e skllavërimit të robërve të luftës nuk është përmendur në Kur'an, si një vendim përfundimtar, por nuk mund të mohohen përmendja e dispozitave në Kur'an që flasin për skllavërimin. Ky fakt tregon se skllavërimi ka ekzistuar edhe në kohën e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe në fillim të Islamit. Në Kur'an përmendet çështja e martesës së skllavit, marrëveshjet që e lirojnë skllavin, etj. Këto dispozita janë përmendur në shumë ajete të Kur'anit, në suret: "En Nisa", "En Nahl", "El Mu'minun", "En Nur", "Er Rum" dhe "Al Ahzab".

Pyetje: Këtu disa e kundërshtojnë Islamin duke thënë: Përse kjo fe e All'llahut, e cila përmban vlera të larta humane, nuk e ka anuluar plotësisht çështjen e skllavërimit? Përse nuk ka shpallur lirimin e të gjithë skllevërve nëpërmjet një vendimi të prerë?!

Është e vërtetë se Islami ka dhënë shumë këshilla për skllavërinë, por lirimi i skllevërve, pa asnjë lloj kushti, është çështje mjaft e rëndësishme. Përse një njeri duhet të ketë nën zotërimin e tij një njeri tjetër si ai? Përse dikush duhet t'ia marrë dikujt lirinë, që është një nga dhuratat më të mëdha të All'llahut të Madhëruar?!

Përgjigjja: Duhet thënë shkurt dhe në formë: Islami ka një program të përpiktë e të studiuar për lirimin e skllevërve, përfundimi i të cilit çon në lirimin e të gjithë skllevërve, gradualisht, pa asnjë kundërpërgjigje negative në shoqëri.

Para se të sqarojmë këtë çështje, e shohim të nevojshme saktësimin paraprak të disa momenteve, si parathënie:

Disa pika:

1- Islami dhe dukuria e skllavërisë

Islami nuk ka qenë shpikësi i skllavërisë. Kur është shfaqur Islami, skllavëria kishte përfshirë të gjitha anët e botës. Skllavëria ishte që para përhapjes së Islamit dhe ka vazhduar deri para njëqind vitesh, kur nisi revolucioni i lirimit të skllevërve, kur skllavëria nuk konsiderohej e pranueshme, si rezultat i ndryshimit të sistemeve shoqërore.

Anulimi i skllavërisë filloi nga Evropa. Më pas u përhap edhe në shtete të tjera, në Amerikë e në Azi. Skllavërimi në Angli ka vazhduar deri në vitin 1840, në Francë deri në vitin 1848, në Holandë deri në vitin 1863, kurse në Amerikë deri në vitin 1865. Më pas u mblodh Konferenca e Brukselit, e cila mori vendimin e anulimit të skllavërisë në të gjitha anët e botës. Kjo ka ndodh në vitin 1890.

2- A është lënë mënjanë dukuria e skllavërisë?

Ndryshimi i formës së skllavërisë në botën e sotme: Është e vërtetë se perëndimorët e anuluan të parët skllavërinë, por nëse vërejmë me kujdes do të shohim se edhe sot rrënjët e saj nuk janë

shkulur. Sot skllavëria shfaqet në forma të tjera, mjaft të rrezikshme. Ajo ka marrë formën e kolonizimit të popujve dhe të skllavërimit të kolonive. Mjafton të sjellim shembullin e Britanisë së Madhe, e cila ishte e para që anuloi skllavërinë, por është përsëri e para në kolonializmin e popujve.

Krimet që kanë bërë kolonialistët perëndimorë, nuk ishin më të pakta se krimet e skllavërimit, madje kanë qenë më të zgjeruara dhe më të ashpra. Edhe pas çlirimit të kolonive, skllavërimi i popujve ka vazhduar, sepse kjo liri ishte një liri politike. Kurse kolonizimi ekonomik dhe kulturor vazhdon të ekzistojnë në shumë koloni, që e kanë lirinë e tyre në aspekte të tjera, veç këtyre.

Shteteve komuniste, të cilat bënë një thirrje të fortë para të gjithëve për anulimin e skllavërimit dhe e përdorën si justifikim të revolucionit të tyre, realizuan një formë të re të skllavërimit të popujve. Skllavëria komuniste ishte një skllavëri e përgjithshme, në të cilën të gjithë popujt ishin kthyer në skllevër. Populli nuk zotëronte asgjë. Po të flisje kundër kësaj mënyre jetese, burgoseshe, internoheshe, mbylleshe në spitalet e psikiatrisë, siç u ndodhi mjaft dijetarëve, shkencëtarëve që ngritën zërin kundër kësaj skllavërie.

Si përfundim, mund të themi se skllavëria është e pranishme në forma të ndryshme edhe sot e kësaj dite. Anulimi i skllavërimit në mbarë botën ishte një formalitet.

3- Rruga e dhimbshme e skllavit në të kaluarën

Gjatë gjithë historisë, skllevërit kanë kaluar nëpër një rrugë shumë të mundimshme. Që nga skllavëria romake e deri te qytetërimi modern jeta tyre ka qenë e mbushur me vështirësi, që nga nëpërkëmbjet, ndëshkimet, torturat e deri te mohimi i jetës. Pronarët e tyre mund të bënin ç'të donin me ta. Jeta e tyre ngjasonte me atë të kafshëve.

Shumica e skllevërve vdisnin nga mundimet nëpër koloni. Ata që mbeteshin, shfrytëzoheshin barbarisht në punë. Tregtarët i ushqenin skllevërit sa për të mbajtur shpirtin gjallë dhe të ishin të aftë për punë. Kur plakeshin, apo sëmureshin, i braktisnin. Ata vdisnin në mënyrë të dhimbshme. Prandaj gjatë historisë, skllavëria identifikohej me numrin e madh të krimeve të tmerrshme.

Për të qartësuar këto çështje, kthehemi te plani i Islamit për lirimin gradual të skllevërve.

4- Plani i Islamit për lirimin gradual të skllavërisë

Nëse një dukuri negative depërton në mesin e shoqërisë, duhet kohë e gjatë për zhdukjen e rrënjeve të saj. Për çdo lëvizje të pastudiuar gjendet një reagim negativ. Kjo është njësoj sikur njeriu të goditet nga një sëmundje e rrezikshme e cila ka pushtuar të gjithë trupin. Apo është si ai person i varuar në përdorimin e drogës për vite me radhë derisa bashkohet në karakterin e tij kjo varësi. Në të tilla situata duhet program kohor për shërimin, i cili mund të zgjasë ose mund të jetë i shkurtër në kohë.

Në formën më të qartë theme: Në qoftë se Islami do të kishte marrë një vendim të përgjithshëm për lirimin e të gjithë skllevërve, dëmi mbase do të kishte qenë më i madh se vetë skllavëria. Mund të vdiste një numër i madh skllevërish, të cilët përbënin gjysmën e shoqërisë, sepse ata nuk kishin as punë, as banesë, as strehë e asnjë mjet për të vazhduar jetesën.

Në qoftë se skllevërit do të liroheshin në një orë të caktuar, në një ditë të caktuar, do të grumbullohej në shesh një grup tepër i madh të papunësh, jeta e të cilëve do të ishte e kërcënuar. Kjo mund të çonte në trazira shoqërore. Skllevërit, tashmë të liruar, por të papunë e të pastrehë do ta gjenin veten e tyre të detyruar të sulmonin pronat e të tjerëve dhe do të derdhej gjak.

Lirimi gradual synon që skllevërit e liruar të mund të integrohen qetësisht në shoqëri, prandaj Islami rekomandon këtë program.

Analiza e zbatimit të këtij programi njerëzor, do të trajtohet në një libër të veçantë.

Lënda e parë: Mbyllja e burimeve të skllavërisë

Historia njerëzore ka treguar se ka pasur shumë shkaqe për të rënë në skllavëri. Skllavëria nuk kufizohej vetëm me robërit e luftës dhe me njerëzit që nuk mund të paguajnë borxhet e tyre, ku të fortët e lejonin robërimin dhe skllavërimin. Madje, edhe një shtet i fuqishëm dërgonte brigada nga ushtria e tij në shtete të tjera, kryesisht afrikane, për të kapur robër popujt e atyre vendeve dhe i dërgonin me anije në tregjet e qyteteve aziatike dhe evropiane.

Islami i ka ndaluar këto metoda. Ai nuk e ka lejuar skllavërinë, veçse në një kuptim të vetëm, në kuptimin e robërve të luftës. Por edhe kjo nuk bëhej, se ato kishin nevojë për robërit. Islami e ka lejuar lirimin e robërve të luftës, siç e kemi thënë në tefsirin e ajeteve të përmendura, në shkëmbim të shpërblimit që paguajnë për interesat e Islamit dhe myslimanëve.

Në ato kohë nuk kishte burgje për robërit e luftës që të sqarohej se ç'do të bëhej me ta. Por, rruga e vetme ishte ndarja e tyre nëpër familje dhe ruajteja e tyre si skllevër. Është e natyrshme se nëse ndryshojnë këto kushte, atëherë nuk ka argument që Imami i myslimanëve të jetë i detyruar të kënaqet me skllavërimin e robërve të luftës, sepse ai ka mundësi t'i lirojë ata, ose me dashamirësi, ose me dëmshpërblim. Islami ia ka lënë të drejtën e zgjedhjes më të mirë Imamit të myslimanëve, për t'i liruar ata. Kurse burimet e skllavërimit të ri janë mbyllur në Islam.

Lënda e dytë: Hapja e një dritareje lirie

Islami ka vendosur një program të gjerë për lirimin e skllavit. Nëse myslimanët do ta zbatonin atë program, do të liheshin të lirë të gjithë skllevërit në një kohë të shkurtër dhe në një mënyrë graduale, shoqëria do t'i pranonte ata dhe do t'u krijonte gradualisht mundësi për t'ua plotësuar nevojat bazë jetësore.

Ja pikat kryesore të këtij programi:

a) Një nga tetë vendet e pagesës së zekatit është blerja e një skllavi dhe lirimi i tij.[1]

b) Për plotësimin e kësaj kërkese, Islami ka vënë ligje, rregulla. Sipas këtyre rregullave, skllevërit kanë mundësi të bëjnë marrëveshje me pronarët e tyre, që t'u paguajnë atyre një shumë të hollash, në këmbim të marrjes së lirisë. Në jurisprudencën islame, ka një shpjegim për këtë kapitull, në adresën 'El Mukatebetu'.[2]

c) Lirimi i skllavit konsiderohet si një nga adhurimet më të rëndësishme dhe nga punët më të mira në Islam. Imamët e Ehli Bejtit kanë qenë të parët në këtë çështje. Në jetëshkrimin e Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)* është shkruar se ai ka liruar njëmijë me dorën e tij.[3]

d) Imamët e Ehli Bejtit e lironin skllavin për arsyen më të vogël. Këtë e bënin për të qenë shembull për të tjerët. Një shembull: Një nga shërbëtorët e Imam Bakirit *(Paqja qoftë mbi të!)* bëri një punë të mirë dhe Imami i tha atij: "*Shko, se je i lirë, se unë e urrej t'i shërbej një njeriu që është banor i Xhennetit.*".[4]

Thuhet se Ali ibn Hysejni *(Paqja qoftë mbi të!)*, rrinte shumë në sexhde. Kur një robëreshë po merrte ujë, i ra ibriku nga dora

[1] Sure "Et Teube", ajeti 60.
[2] Kemi bërë një komentim rreth "El Mukatebetu" dhe rregullave të saj të mrekullueshme, në fundin e ajetit 34 të sures "En Nur".
[3] "Biharul Anuar", vëll. 41, f. 43.
[4] "Uesailu Shia", vëll. 16, f. 38.

dhe u thye. Ai ngriti kokën drejt saj. Ajo tha: "**ata që e shtypin zemërimin**".
Imami i tha: "*E kam shtypur zemërimin tim.*"

Ajo i thotë: "**ata që i falin njerëzit**".

Imami i tha: "*All'llahu të ka falur ty.*"

Robëresha i tha: "**All'llahu i do ata që bëjnë mirë**" .

Imami i tha: " *Shko, se je e lirë, për hir të All'llahut.*".[1]

e) Në disa transmetime islame tregohet se skllevërit liheshin të lirë, pasi kalonin shtatë vite. Në një transmetim nga Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* thuhet: "*Kush është besimtar, lirohet pas shtatë vitesh, e liron atë apo nuk e lë të lirë pronari i tij. Besimtarit nuk i lejohet t'i shërbejë një skllav, pasi të kalojnë shtatë vite.*".[2]

Në këtë kapitull është transmetuar një hadith nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Në këtë hadith ai ka thënë: "*Xhibraili më ka këshilluar aq shumë për skllavin, (memlukin), saqë mendova se ai do të caktojë një takim që ta lirojë atë nga skllavërimi.*".[3]

f) Nëse robi është i ndarë mes dy njerëzve dhe njëri prej atyre të dyve e lë të lirë, ai detyrohet të blejë pjesën e ortakut të tij dhe ta lirojë robin.[4]

[1] Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 1, f. 390.
[2] "Uesailu Shia", vëll. 16, f. 36.
[3] "Uesailu Shia", vëll. 16, f. 60.
[4] "Esh Sheraiu", libri "El Itku"; "Uesailu Shia", vëll. 16, f. 21.

Nëse pronari i robit e liron një pjesë të tij, bëhet e efektshme liria e pjesës së mbetur të tij dhe lihet i tëri i lirë.[1]

g) Nëse dikush ka në pronësi babanë e tij, nënën e tij, gjyshërit e tij, fëmijët e tij, xhaxhanë e tij, hallën e tij, dajën e tij, tezen e tij, vëllanë e tij, motrën e tij, djalin e vëllait të tij, apo djalin e motrës së tij, atëherë ata lirohen menjëherë.

gj) Nëse pronari e lë me barrë robëreshën e tij, atëherë nuk lejohet shitja e saj, por i jepet liria për shkak të fëmijës së saj nga trashëgimia. Kjo çështje ka qenë shkak në lirimin e shumë skllaveve, sepse vajzat skllave janë mburojë në gradën e bashkëshortes së padronit të tyre dhe ata kanë fëmijë prej tyre.

h) Lirimi i një skllavi shlyen shumë mëkate, si: mëkatin e vrasjes gabimisht, të lënies së agjërimit me dashje, të shlyerjes së betimit e të tjera.

i) Nëse padroni e ndëshkon ashpër skllavin e tij, atëherë skllavi është i lirë automatikisht.[2]

Lënda e tretë: Ringjallja e personalitetit të skllavit

Kur skllevërit po e arrinin lirinë, sipas programit korrekt të Islamit, Islami bëri hapa më përpara në ringjalljen e të drejtave dhe të personalitetit të tyre njerëzor. Islami nuk ka bërë dallime mes skllavit dhe atyre që ishin të lirë, në vlerësimin e personalitetit njerëzor, prandaj bëri edhe standardin e dallimit

[1] "Esh Sheraiu", libri "El Itku".
[2] "Esh Sheraiu", libri "El Kadau".

mes tyre, prandaj ia lejoi skllavit të marrë përsipër përgjegjësi dhe të emërohet në poste të rëndësishme shoqërore, deri edhe në postin e gjykatësit.[1]

Në kohën e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, skllevërit janë autorizuar të punojnë në qendra të rëndësishme dhe delikate, duke filluar që nga udhëheqja e ushtrisë dhe deri tek postet e tjera.

Shumica e shokëve më të mëdhenj të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* kanë qenë skllevër, ose skllevër që janë lënë të lirë. Shumica e tyre kryenin detyra si këshilltarë dhe asistentë të të mëdhenjve të Islamit dhe të komandantëve të tij. Mund të përmendim këtu emrat e Selmanit, Bilalit dhe Ammar ibn Jasirit, Kamberi etj.

Pasi mbaroi beteja e Beni Mustalakut, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* u martua me një robëreshë që i ishte dhënë liria prej këtij fisi. Kjo martesë u bë shkak për t'i dhënë lirinë gjithë robërve të fisit.

Lënda e katërt: Marrëdhëniet njerëzore me skllevërit

Islami ka përmendur shumë mësime për mëshirën që duhet të tregohet me skllevërit, për trajtimin e ankesave të tyre, deri atje, sa i ka bërë partnerë në jetën e padronit të tyre.

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* thotë: *"All'llahu i ka bërë vëllezërit tuaj nën kujdesin tuaj dhe ai që e ka nën kujdes vëllanë e tij, duhet ta ushqejë atë*

[1] "Esh Sheraiu", libri "El Kadau".

me atë që ushqen veten e tij, ta veshë atë me rrobat me të cilat vishet vetë, të mos e ngarkojë atë më shumë nga ç'mundet dhe, nëse e ka ngarkuar më shumë se ç'mundet, atëherë le ta ndihmojë atë.".[1]

Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* i thotë shërbëtorit të tij, Kamberit: *"Mua më vjen turp nga All'llahu që të bëj dallimin me ty, sepse i Dërguari i All'llahut (Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) thotë: 'Vishini ata me rrobat që vishni vetë dhe ushqejini ata me ushqimin që hani vetë.'"*.[2]

Sigurisht që marrëdhënia e Islamit me skllevërit ishte në formën më të mirë. Këtë e pohojnë edhe jomyslimanët të cilët e kanë lavdëruar këtë marrëdhënie. Prej atyre është edhe Xhorxh Zejdani, i cili në librin e tij rreth historisë së qytetërimit thotë: "Islami është i mëshirshëm me skllevërit, me kuptimin e plotë të mëshirës, sepse Profeti i Islamit ka këshilluar shumë për skllevërit. Një prej atyre këshillave, është: *'Mos e ngarkoni skllavin më shumë se sa ka mundësi dhe ushqejeni atë me atë që ushqeni veten tuaj.'"*. Në një vend tjetër thotë: *"Mos i thërrisni skllevërit tuaj: 'O shërbëtor, o robëreshë', por thoni: 'O biri im dhe o bija ime."*! Kur'ani ka këshilluar edhe shërbëtorët me këshilla të mrekullueshme. Kur'ani thotë: *"Adhuroni All'llahun dhe mos i vini shok Atij, mos i trajtoni baballarët tuaj, nënat tuaja dhe të afërmit tuaj nga gjaku, jetimët, të varfrit, fqinjët, ata që janë larg dhe ata që janë afër prej tyre, shokët, të pastrehët dhe skllavin vetëm se me mirësi, sepse s'ka dyshim se All'llahu nuk është i kënaqur me vetëkënaqësinë dhe të pëlqyerit e vetes."*.[3]

---

[1] "Biharul Anuar", vëll. 74, Hadithi 11, f. 141.
[2] Burimi i mëparshëm, f. 142, hadithi 13.
[3] "Tarijkhu Temeddun", vëll. 4, f. 54.

Lënda e pestë: Vepra më e shëmtuar është shitja e njeriut

Shitblerja e skllevërve konsiderohet si një nga sjelljet më të urryera në Islam. Përmendet një hadith nga Profeti i Islamit *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: *"Njerëzit më të këqij janë ata që shesin njerëz."*.[1]

Kjo mënyrë të shprehuri e sqaron mirë pikëpamjen e Islamit për çështjen e skllevërve dhe i bën të qarta programet e Islamit dhe atë që dëshiron të vërtetojë e të arrijë.

Islami e ka konsideruar refuzimin e lirisë së njeriut dhe zëvendësimin e saj me kushte të mira që shiten e blihen. E ka konsideruar si një prej gjynaheve që nuk falen. Në një hadith të transmetuar nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* thuhet: *"Me të vërtetë, s'ka dyshim se All'llahu i Madhëruar është falës i çdo mëkati, përveç atij që refuzon pajën, përveç atij që ia merr me forcë punëtorit me mëditje pagën e tij, apo atij që shet një njeri të lirë."*.[2]

Sipas këtij hadithi, edhe nëpërkëmbja e të drejtave të grave dhe të punëtorëve, si dhe refuzimi i lirisë së njeriut, janë tri mëkate që nuk falen.

Islami nuk e lejon skllavërimin, përveç robërve të luftës. Në këtë kapitull do të sqarojmë se skllavërimi nuk është i detyrueshëm. Kjo ka ndodhur, kur u shfaq Islami, megjithëse skllavëria dhe robëria u përhap shumë në Perëndim, disa shekuj

[1] "El Mustedrek", vëll. 13, kreu"Tregtia", K. 19, "Urrejtja e lejimit të blerjes së qefinëve...", hadithi 1, f. 95
[2] "Biharul Anuar", vëll. 103, hadithi 11, f. 168.

pas shfaqjes së Islamit. Kolonizatorët i kapnin njerëzit e lirë dhe i shndërronin në skllevër që shiteshin e bliheshin. Shitblerja e skllevërve në një vit arriti në 200 000 skllevër në Britani. Në fundin e shekullit të tetëmbëdhjetë merrnin çdo vit nga Afrika njëqind mijë njerëz dhe i dërgonin në Amerikë si skllevër.[1]

Si përfundim, mund të themi se ata që e kundërshtojnë programin e Islamit për skllevërit dhe skllavërinë, nuk e njohin mirë programin përkatës dhe qëllimet e tij, lirimin gradual të skllevërve dhe integrimin paqësisht të tyre në shoqëri.

Ata mendojnë se kjo është një pikë e dobët në Islam, por ky është një gjykim i pavërtetë.

[1] Tefsiri "El Mijzan", vëll. 6, f. 368.

Ajetet 7 – 11

يَٰٓأَيُّهَا ٱلَّذِينَ ءَامَنُوٓاْ إِن تَنصُرُواْ ٱللَّهَ يَنصُرۡكُمۡ وَيُثَبِّتۡ أَقۡدَامَكُمۡ ٧ وَٱلَّذِينَ كَفَرُواْ فَتَعۡسٗا لَّهُمۡ وَأَضَلَّ أَعۡمَٰلَهُمۡ ٨ ذَٰلِكَ بِأَنَّهُمۡ كَرِهُواْ مَآ أَنزَلَ ٱللَّهُ فَأَحۡبَطَ أَعۡمَٰلَهُمۡ ٩ ۞أَفَلَمۡ يَسِيرُواْ فِي ٱلۡأَرۡضِ فَيَنظُرُواْ كَيۡفَ كَانَ عَٰقِبَةُ ٱلَّذِينَ مِن قَبۡلِهِمۡۖ دَمَّرَ ٱللَّهُ عَلَيۡهِمۡۖ وَلِلۡكَٰفِرِينَ أَمۡثَٰلُهَا ١٠ ذَٰلِكَ بِأَنَّ ٱللَّهَ مَوۡلَى ٱلَّذِينَ ءَامَنُواْ وَأَنَّ ٱلۡكَٰفِرِينَ لَا مَوۡلَىٰ لَهُمۡ ١١

"O ju që keni besuar, nëse e ndihmoni All'llahun, edhe Ai do t'ju ndihmojë dhe do t'ju bëjë të qëndroni fort në këmbët tuaja."
"Ndërsa ata që nuk besojnë, do të shkatërrohen! Ai do t'ua humbë veprat atyre."

"Kjo për shkak se ata e urrejnë atë që ka Shpallur All'llahu, andaj Ai i ka zhvlerësuar veprat e tyre."

"Vallë, a nuk kanë udhëtuar ata nëpër Tokë, për të parë përfundimin e atyre që qenë përpara tyre!? All'llahu i shfarosi ata plotësisht, e kështu do të përfundojnë edhe mohuesit e tjerë."

"Kjo për shkak se All'llahu është Mbrojtës i atyre që besojnë, kurse për mohuesit nuk ka mbrojtës."

Komentimi

Nëse ju ndihmoni, All'llahun (fenë e Tij)**, Ai ju ndihmon juve**

Këto ajete vazhdojnë të zgjojnë interesin e besimtarëve për xhihadin, për luftimin e armiqve të Rrugës së All'llahut me një metodë të mrekullueshme dhe retorike. Ajeti i parë prej ajeteve në fjalë thotë: **"O ju që keni besuar, nëse e ndihmoni All'llahun, edhe Ai do t'ju ndihmojë dhe do t'ju bëjë të qëndroni fort në këmbët tuaja."**.

Me të drejtë, përqendrimi te çështja e besimit tregon se edhe xhihadi është një ndër shenjat e besimit.

Sifjalia: **"...nëse e ndihmoni All'llahun..."**, do të thotë se kush ndihmon fenë e All'llahut të Madhëruar, kush ndihmon Profetin e Tij, Sheriatin e Tij dhe mësimet e Tij. Prandaj, në disa ajetet përmendet ndihma e All'llahu e shoqëruar me ndihmën e të Dërguarit të Tij. Këtë e lexojmë në disa ajete të Kur'anit, si p.sh, në ajetin 8 të sures "El Hashr": **"...ndihmojnë All'llahun dhe të Dërguarin e Tij, të tillët janë ata të sinqertët."**.

Megjithëse fuqia e All'llahut të Madhëruar është e pakufishme dhe përballë saj, fuqia e krijesave është e papërfillshme, mirëpo përdorimi i ndihmës së All'llahut është për të qartësuar rëndësinë e xhihadit dhe mbrojtjen e fesë së All'llahut. Nuk gjendet shprehje më madhështore se kjo për të sqaruar rëndësinë e kësaj teme.

Le të shohim se cili është premtimi i All'llahut për luftëtarët që mbrojnë Islamin nga armiqtë e Rrugës së Tij.

Në fillim All'llahu thotë: **"Ai do t'ju ndihmojë"**. Por, si realizohet kjo? Mënyrat janë të shumta, sepse All'llahu i Madhëruar hedh dritën e besimit në zemrën tuaj; devotshmërinë dhe vendosmërinë në shpirtin tuaj dhe qetësinë e rehatinë në mendimet tuaja.

Nga ana tjetër, dërgon engjëjt për t'ju ndihmuar ju, ndryshon ecurinë e ngjarjeve në të mirën tuaj dhe i bën zemrat e njerëzve që të anojnë nga ju. Përpjekjet tuaja i bën të suksesshme. Ndihma e All'llahut përfshin trupin dhe shpirtin, nga brenda dhe nga jashtë.

Mirëpo, All'llahu i Madhëruar e përforcon çështjen e forcimit të këmbëve në mesin e të të gjitha mënyrave të fitores të tjera. Ky përforcim është për të treguar se qëndrimi fort para armikut është simboli më i rëndësishëm i fitores. Luftën e fitojnë ata që janë të vendosur dhe qëndrojnë fort. Kjo është arsyeja që në historinë e luftimit të Talutit, komandanti i madh i Beni Israilëve ndaj Xhalutit, mbizotëruesi i fortë zullumqar, lexojmë se besimtarët e paktë në numër që ishin me të, u përballën me ushtrinë gjigante të armikut dhe thanë: **"Zoti ynë! Na dhuro durim! Na i përforco këmbët tona dhe na ndihmo kundër jobesimtarëve."**.[1] Në ajetin që vjen pas tij, lexojmë: **"Me ndihmën e All'llahut i thyen ata."**.[2] Sigurisht, rezultati i qëndrueshmërisë dhe i palëkundhsmërisë është fitorja ndaj armikut.

[1] Sure "El Bekare", ajeti 250.
[2] Sure "El Bekare", ajeti 251.

Meqenëse armiku ishte i madh në numër dhe ishte i armatosur me të gjitha llojet e pajisjeve, kjo mund të çonte që luftëtarët në Rrugën e All'llahut të mendonin rreth kësaj. Mirëpo ajeti në vazhdim thotë: **"Ndërsa ata që nuk besojnë, do të shkatërrohen! Ai do t'ua humbë veprat atyre."**.[1]

Fjala *"ta'sen"* tregon rrëshqitjen dhe rënien përmbys. Disa komentues thonë se tregon shkatërrimin dhe degradimin.

Sidoqoftë, krahasimi mes këtyre dy grupeve ka një kuptim shumë të thellë, sepse Kur'ani, në lidhje me besimtarët, thotë: **"të qëndroni fort në këmbët tuaja"**. Për jobesimtarët, në formë mallkimi, që të jetë më tërheqëse e më ndikuese, thotë: **"Ai do t'ua humbë veprat atyre."**.

Nëse jobesimtarët rrëshqasin dhe këmbët e tyre tronditen, atëherë nuk ka askush që t'i kapë për dore, që t'i shpëtojë nga shkatërrimi. Ata do të degradojnë, do të zbresin me shpejtësi drejt zjarrit, kurse besimtarët, të ndihmuar nga engjëjt e mëshirës, zbresin të qetë dhe të mbrojtur nga shkarjet dhe degradimet, siç e lexojmë në ajetin 30 të sures "Fussilet": **"E s'ka dyshim se ata që thanë: 'Zoti ynë është All'llahu' dhe ishin të paluhatshëm, atyre u vijnë engjëjt."**.

[1] Fjala *"ta'sen"* është kundrinor i foljes së papërmendur dhe aludimi është: i rrëzoi ata të përmbysur. Fjalia **"do t'ua humbë veprat atyre"** është e lidhur me këtë folje të papërmendur. Secila prej tyre është në formën e mallkimit, njësoj si: "All'llahu i vraftë ata!" Është e qartë se mallkimi prej All'llahut, do të vijë së shpejti.

Veprat e besimtarëve janë të bekuara, kurse veprat e jobesimtarëve janë të kota, prandaj ato fshihen dhe shkatërrohen shpejt.

Ajeti që pason, sqaron shkakun e rënies së këtyre dhe bërjes së veprave të tyre si pluhur i përhapur. Ai thotë: **"Kjo për shkak se ata e urrejnë atë që ka Shpallur All'llahu, andaj Ai i ka zhvlerësuar veprat e tyre."**. All'llahu i Madhëruar ka zbritur fenë e Njehsimit para gjithçkaje, por jobesimtarët e mohuan dhe shkuan drejt politeizmit.

All'llahu i Madhëruar ka urdhëruar për të drejtën dhe drejtësinë, virtytin dhe devotshmërinë, por jobesimtarët i kundërshtuan të gjitha ato dhe shkuan drejt padrejtësisë dhe shkatërrimit. Zemrat e tyre neveriteshin, kur përmendej Emri i All'llahut të Lartësuar: **"Kur përmendet All'llahu, zemrat e atyre që nuk besojnë Botën Tjetër, neveriten."**.[1]

Jobesimtarët shmangeshin nga këto çështje, që të mos hidhnin asnjë hap në këtë rrugë. Të gjitha mundimet dhe përpjekjet e tyre kanë qenë në rrugën e të pavërtetës dhe në shërbim të saj, prandaj është më se normale zhdukja e veprave të tyre.

Në një hadith të transmetuar nga Imam Bakiri *(Paqja qoftë mbi të!)* thuhet: *"E urryen atë që zbriti All'llahu, në të drejtën e Aliut."*.[2]

Sifjalia: **"atë që ka Shpallur All'llahu",** ka një kuptim të gjerë dhe çështja e udhëheqësisë së Prijësit të besimtarëve, Imam

[1] Sure "Ez Zumer", ajeti 45.
[2] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", fundi i ajeteve që po komentojmë.

Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*, është një prej të vërtetave të këtij kuptimi dhe nuk është i kufizuar në këtë çështje.

Kur'ani, në shumë vende, u paraqet zullumqarëve kundërshtues modele të prekshme dhe i fton ata të meditojnë për situatat e atyre që kanë qenë më përpara dhe thotë: **"Vallë, a nuk kanë udhëtuar ata nëpër Tokë, për të parë përfundimin e atyre që qenë përpara tyre!? All'llahu i shfarosi ata plotësisht, e kështu do të përfundojnë edhe mohuesit e tjerë."**.

Me këtë tregon se këta të mos mendonin se ky fund i përbuzur, i neveritshëm, ishte vetëm për popujt e mëparshëm zullumqarë. Prandaj ajeti shton: **"...kështu do të përfundojnë edhe mohuesit e tjerë."**.[1]

Ata të mos mendojnë se janë larg dënimit të ngjashëm me atë dënim, sepse ata kanë bërë vepra të ngjashme me veprat e atyre që kanë kaluar, prandaj le të ecin në Tokë dhe le të shikojnë gjurmët e atyre që kanë qenë para tyre. Pastaj le të shohin traditat historike.

Fjala *"dem'mere"* tregon shkatërrimin dhe zhdukjen, por, nëse vjen bashkë me pjesëzën *"ala"*, do të thotë shkatërrimi i çdo gjëje, deri edhe fëmijët, edhe familja, edhe të afërmit, edhe pasuritë e veçanta të njeriut.[2]

Kjo lidhje kuptimore qartëson një fatkeqësi të madhe e të dhimbshme, sidomos kur shoqërohet me pjesëzën *"ala"*. Kuptimi i

[1] Përemri *"ha"* te fraza *"emthaluha"* i referohet dënimit që përftohet nga fjalia e mëparshme.
[2] Tefsiri "Ruhul Meanij", tefsiri "Ruhul Bejan" dhe tefsiri "El Kebijr", vëll. 28, f. 50.

fjalisë bëhet: All'llahu e ka derdhur dënimin e Tij mbi kokat e këtyre popujve dhe shkatërroi gjithçka që lidhet me ta.

Në fundin e ajetit 137 të sures "Ali Imran" dhe të ajetit 45 të sures "Err Rrum" tregohet se Kur'ani, temën e " Të ecurit mbi tokë" e paraqet si një program edukimi.

Ajeti 11 tregon se All'llahu i Madhëruar i ruan dhe i mbron besimtarët, kurse jobesimtarët i shkatërron. Ajeti thotë: **"Kjo për shkak se All'llahu është Mbrojtës i atyre që besojnë, kurse për mohuesit nuk ka mbrojtës."**.[1]

Fjala *"el meula"* ka kuptimin e mbrojtësit dhe ndihmësit. Prandaj, All'llahu i Madhëruar është Sipërmarrësi i çështjes së besimtarëve dhe i fitores së tyre. Kurse jobesimtarët i ka nxjerrë nga hija e mbrojtjes së Tij. Është e qartë se All'llahu i Madhëruar i mbron besimtarët nga katastrofat dhe pengesat, kurse jo besimtarët i lë jashtë mbrojtjes së Tij. Ata, të mbrojtur me hijen e Tij, ua largon katastrofat, ua largon nga rruga e tyre pengesat, ua forcon këmbët dhe në fund, pa dyshim ata do të marrin shpërblimin e tyre me ndihmën dhe mbrojtjen e All'llahut, kurse për sa u përket atyre që janë jashtë mbrojtjes së Tij, ua asgjëson veprat.

Pyetje: Nëse ajeti që po komentojmë, ka përmendur se All'llahu është mbrojtës vetëm për besimtarët, në disa ajete të tjera kur'anore, është përmendur se Ai është mbrojtësi i të gjithëve, edhe i jobesimtarëve. Kjo thuhet në ajetin 30 të sures "Junus":

[1] Ajo që tregohet me fjalën *"dhalike"* është fundi i mirë i besimtarëve dhe fundi i neveritshëm i jobesimtarëve, të cilët janë përmendur në dy në ajetet e mëparshme.

"dhe kthehen te All'llahu, Sundimtari i tyre i vërtetë dhe humbet prej tyre ajo që trillonin (se do t'u bëjnë shefatë)**."**.

Përgjigjja: Kjo pyetje bëhet e qartë vetëm duke parë një pikë të vetme, që është: S'ka dyshim se mbrojtja e All'llahut është e përgjithshme, sepse Ai është Krijues, kontrollues i gjithçkaje. Mbrojtja dhe kujdesi i Tij i veçantë, i shoqëruar me lloje të ndryshme mbrojtjesh e ndihmash, përfshin vetëm besimtarët.[1]

Disa komentues kanë thënë se ky ajet është ajeti më shpresëdhënës në Kur'an, sepse ai i përfshin të gjithë: besimtarin, dijetarin, injorantin, indiferentin, dëshiruesin, të interesuarin, të voglin dhe të madhin, gruan dhe burrin, të riun dhe të moshuarin. Të gjithë i ka futur nën mbrojtjen dhe nën kujdesin e veçantë të All'llahut. Nuk ka përjashtuar as besimtarët mëkatarë, sepse All'llahu i Madhëruar, e shfaq kujdesin e Tij në situata të ndjeshme dhe në çaste të vështira, kritike, në ngjarje, fatkeqësi dhe katastrofa. Secili prej nesh e ka ndier këtë mbrojtje gjatë jetës së tij.

Në një hadith thuhet se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, pas njërës nga betejat e tij, ishte ulur vetëm poshtë një peme. Një idhujtar ia kishte drejtuar shpatën dhe i thotë: "Kush do të të çlirojë ty prej meje?" Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i thotë: "All'llahu."

Jobesimtari filloi të dridhej dhe u rrëzua përtokë. Shpata i ra nga dora. Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi*

[1] Disa komentues, si Alusij në tefsirin "Ruhul Meanij", e kanë komentuar fjalën"*el meula*", në ajetin që po komentojmë, me kuptimin "ndihmësi", kurse në ajetin e sures "Junus" dhe në sure të tjera, ka kuptimin "zotëruesi".

të dhe mbi familjen e tij!) e mori shpatën dhe i tha atij: "Po ty, kush do të të shpëtojë prej meje?"

Idhujtari tha: "Askush." Pas kësaj idhujtari u bë mysliman.[1]

Po, All'llahu është mbrojtësi i atyre që besuan, kurse jobesimtarët nuk ka kush t'i mbrojë, nuk kanë mbrojtës.

[1] Tefsiri "Ruhul Bejan", vëll. 8, f. 503.

Ajetet 12 – 14

إِنَّ ٱللَّهَ يُدۡخِلُ ٱلَّذِينَ ءَامَنُواْ وَعَمِلُواْ ٱلصَّٰلِحَٰتِ جَنَّٰتٖ تَجۡرِي مِن تَحۡتِهَا ٱلۡأَنۡهَٰرُۖ وَٱلَّذِينَ كَفَرُواْ يَتَمَتَّعُونَ وَيَأۡكُلُونَ كَمَا تَأۡكُلُ ٱلۡأَنۡعَٰمُ وَٱلنَّارُ مَثۡوٗى لَّهُمۡ١٢ وَكَأَيِّن مِّن قَرۡيَةٍ هِيَ أَشَدُّ قُوَّةٗ مِّن قَرۡيَتِكَ ٱلَّتِيٓ أَخۡرَجَتۡكَ أَهۡلَكۡنَٰهُمۡ فَلَا نَاصِرَ لَهُمۡ١٣ أَفَمَن كَانَ عَلَىٰ بَيِّنَةٖ مِّن رَّبِّهِۦ كَمَن زُيِّنَ لَهُۥ سُوٓءُ عَمَلِهِۦ وَٱتَّبَعُوٓاْ أَهۡوَآءَهُم١٤

“Pa dyshim, ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, All’llahu do t’i shpjerë në Xhennete, nëpër të cilat rrjedhin lumenj. Ndërsa ata që nuk besojnë dhe kënaqen e hanë ashtu siç gëlltisin bagëtia, do të kenë Zjarrin si vendbanim!”

“Eh, sa shumë qytete, të cilat kanë qenë më të fuqishme se qyteti yt, që të ka përzënë, Ne i kemi shkatërruar dhe nuk kanë pasur asnjë ndihmës!”

“Vallë, a është i njëjtë ai që i përmbahet udhëzimit të Zotit të tij me atë që i zbukurohen punët e veta të shëmtuara dhe lëshohet pas pasioneve të veta?”

Komentimi

Fundi i besimtarëve dhe i jobesimtarëve

Në ajetet e kaluara u diskutua për luftën e përhershme mes të vërtetës dhe të pavërtetës, mes besimit dhe mosbesimit. Ajetet që po komentojmë, tregojnë fundin e besimtarëve dhe të jobesimtarëve nëpërmjet një krahasimi të qartë. Ky krahasim sqaron jo vetëm jetën e kësaj bote. Dallimi më i madh mes tyre do të jetë në Ahiret.

Ajeti i parë, prej ajeteve në fjalë, thotë: **"Pa dyshim, ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, All'llahu do t'i shpjerë në Xhennete, nëpër të cilat rrjedhin lumenj. Ndërsa ata që nuk besojnë dhe kënaqen e hanë ashtu siç gëlltisin bagëtia, do të kenë Zjarrin si vendbanim!"**.

Është e vërtetë se dy grupet kënaqen me mirësitë dhe kënaqësitë e kësaj bote, por me një ndryshim thelbësor. Dallimi mes tyre qëndron te qëllimi që kanë në jetë. Qëllimi i besimtarëve është kryerja e veprave të mira dhe të dobishme, për të merituar kënaqësinë e All'llahut të Madhëruar, kurse jobesimtarët kanë për qëllim ngrënien, pirjen, gjumin dhe shijimin e kënaqësive të jetës.

Besimtarët, çdo lëvizje e bëjnë të menduar mirë dhe me një qëllim, kurse jobesimtarët jetojnë dhe vdesin pa asnjë qëllim, njësoj si kafshët.

Besimtarët e llogarisin me përpikëri si të arrijnë qëllimet e tyre, kurse jobesimtarëve nuk u intereson a është ushqimi i tyre

nga toka e pronarit të tyre apo është grabitur, njësoj si të ishte e drejta e jetimit apo e të moshuarit. E mjerueshme apo jo?

Kur besimtarët kënaqen nga një mirësi, mendojnë për atë që ua ka dhuruar, meditojnë mbi argumentet e Tij dhe e falënderojnë Atë për të gjitha ato të mira, kurse jobesimtarët nuk mendojnë për asgjë, duke shtuar kështu barrën e mëkateve dhe duke shkuar gjithnjë e më shumë drejt shkatërrimit.

Disa komentues kanë thënë se dallimi mes besimtarëve dhe jobesimtarëve vërehet edhe nga sjellja dhe qëndrimi ndaj ushqimit që konsumojnë. Besimtari i përkushtohet ushqimit, tregon respekt dhe e vlerëson atë, kurse jobesimtari e kërkon ushqimin vetëm për të shuar urinë, e ha me nxitim dhe me dëshirë, si i hutuar.

Kur'ani tërheq vëmendjen dhe për besimtarët, thotë: **"ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, All'llahu do t'i shpjerë në Xhennete"**, kurse për jobesimtarët thotë: **"do të kenë Zjarrin si vendbanim"**. Nga fjalia e parë nënkuptohet se për besimtarët flet me respekt dhe vlerësim, kurse fjalia e dytë nënkuptohet për jobesimtarët flet me përbuzje.

Disa komentues të Kur'anit, thonë, se sifjalia: **"do të kenë Zjarrin si vendbanim"**, tregon vendin e jobesimtarëve, që është zjarri, sepse veprat dhe mendimet e tyre janë zjarr në vetvete, prandaj ata i përfshin Xhehennemi. Këtë e lexojmë në ajetin 49 të sures "Et Teube": **"Xhehennemi gjithsesi i përfshin nga të gjitha anët jobesimtarët."**.

Në disa ajete të tjera kur'anore, banorët e zjarrit i ka krahasuar me kafshët, madje i përshkruan edhe më keq se

kafshët: **"Ata janë si kafshët, madje edhe më të humbur, të tillët janë ata, të hutuarit."**.[1] Në fund të këtij ajeti, kemi dhënë një shpjegim të hollësishëm.

Bazuar në këtë kontekst, ajeti që pason, i krahason idhujtarët e Mekës me adhuruesit e mëparshëm të putave. Ky ajet i kërcënon ashpër ata, duke nënkuptuar krime të shëmtuara që kanë kryer, të cilët përbëjnë argumentet që lejojnë luftimin e tyre. Ajeti thotë: **"Eh, sa shumë qytete, të cilat kanë qenë më të fuqishme se qyteti yt, që të ka përzënë, Ne i kemi shkatërruar dhe nuk kanë pasur asnjë ndihmës!"**.

Ata as nuk mund ta mendonin dhe jo më të arrinin deri aty sa të guxojnë të përzënë të Dërguarit më fisnik, më të dashur të All'llahut, nga vendi më i shenjtë. Pa dyshim që çështja nuk vazhdon kështu, sepse ata, në krahasim me popullin e Adit, të Themudit, të faraonëve dhe ushtrinë e Ebrehesë, janë krijesa tepër të dobëta e të pafuqishme. All'llahu është i aftë t'i shkatërrojë lehtësisht ata.

Në një transmetim të ardhur nga Ibn Abasi thuhet se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, sapo doli nga Meka shkoi drejt shpellës së Theurit. Më pas u drejtua nga Meka dhe tha: *"Ti je nga vendet më të dashura të All'llahut, ti je nga vendet më të dashura për mua. Sikur idhujtarët e popullit tënd të mos më nxirrnin, nuk do të dilja kurrë prej aty."*. Me këtë rast zbriti ajeti i mësipërm, i cili e përgëzon Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe i kërcënon armiqtë me dënim dhe ndëshkim.[2]

[1] Sure "El A'raf", ajeti 179.
[2] Tefsiri "El Kurtubijj", vëll. 9, f. 6055.

Nisur nga shkaku i zbritjes, themi se ajeti është mekas, mirëpo duket se shkaku i zbritjes lidhet me ajetin 85 të sures "El Kasas", sepse ai harmonizohet shumë me atë ajet: **"S'ka dyshim se Ai që ta bëri detyrim Kur'anin, Ai do të të kthejë ty aty nga erdhe."**. Këtë e kanë përmendur shumë komentues.

Ajeti i fundit që po komentojmë, paraqet një krahasim tjetër mes besimtarëve dhe jobesimtarëve. Ndryshimi mes tyre është në çdo gjë: Njëri prej tyre është besimtar që kryen punë të mira, kurse tjetri bën një jetë pa qëllime, e ngjashme me jetën e kafshëve. Njëri grup është i sigurt nën mbrojtjen e All'llahut të Madhëruar, kurse tjetri nuk ka as mbrojtës dhe as ndihmës. Ajeti thotë: **"Vallë, a është i njëjtë ai që i përmbahet udhëzimit të Zotit të tij me atë që i zbukurohen punët e veta të shëmtuara dhe lëshohet pas pasioneve të veta?"**.

Grupi i parë e ka zgjedhur rrugën e vet drejt besimit dhe ec i sigurt në atë rrugë. Kurse grupi i dytë, nuk e kupton realitetin, vërtitet pa qëllime në errësirat e rrugëve, është i zhytur në humbje, sepse ndjek dëshirat dhe epshet, të cilat i hutojnë dhe i bëjnë që edhe e mira t'u duket e keqe.

Kjo thuhet në ajetin 103-105 të sures "El Kehf": **"Thuaj: 'A doni t'ju lajmëroj për ata që, më së shumti, humbasin nga punët e veta, për ata, përpjekja e të cilëve ka qenë e kotë në jetën e kësaj bote, ndërkohë që mendonin se po bënin vepra të mira?'. Këta janë ata, që nuk kanë besuar në Shpalljet e Zotit të tyre dhe në takimin me Të. Punët e tyre do të fshihen, andaj Ne nuk do të vëmë kurrfarë peshe për ta** (për veprat e tyre)**, në Ditën e Kiametit."**.

Fjala *"el bej'jinetu"* do të thotë argument i qartë, i pastër. Këtu ajo tregon mrekullitë e Kur'anit, të të Dërguarit më të madh dhe argumentet e tjera logjike.

Është e qartë se pyetja në fjalinë: "**Vallë, a është i njëjtë ai...**", është pyetje mohuese që do të thotë se këto dy grupe nuk mund të krahasohen kurrë.

Por, cili ua zbukuron të keqen adhuruesve të egos? A është All'llahu i Madhëruar? A janë ata vetë, apo janë shejtanët?

Duhet thënë se të gjitha ato janë të vërteta, sepse zbukurimi është cilësi që u referohet të treve në Kur'an. Ajeti 4 i sures "En Neml" thotë: **"E atyre që nuk besojnë Botën e Ardhshme, Ne ua kemi hijeshuar veprat."**.

Si në shumë ajete të tjera, në ajetin 38 të sures "Ankebut", thuhet: **"Djalli ua pati zbukuruar veprat e tyre."**.

Aparenca e ajetit që po komentojmë, duke parë edhe fjalinë: **"ndjekin epshet e veta"** tregon se ky zbukurim, buron nga ndjekja e epsheve dhe egos. Është e qartë se ndjekja e egos, e qejfeve dhe e pasionit, ia zhveshin njeriut aftësinë e të ndjerit, të specifikimit dhe të perceptimit të të vërtetave.

T'ia referosh shejtanit zbukurimin, është një gjë e vërtetë, sepse ai i ngre kurthe dhe e cyt njeriun që të hyjë në të, është ai që ia zbukuron atij ndjenjën e epshit.

Disa komentues mendojnë se fjalia: **"i përmbahet udhëzimit të Zotit të tij"**, tregon Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe fjalia që pason, synon jobesimtarët e Mekës. Por ajeti ka një kuptim më të gjerë. Kjo fjali e miraton atë.

Ajeti 15

مَّثَلُ ٱلْجَنَّةِ ٱلَّتِى وُعِدَ ٱلْمُتَّقُونَ ۖ فِيهَآ أَنْهَٰرٌ مِّن مَّآءٍ غَيْرِ ءَاسِنٍ وَأَنْهَٰرٌ مِّن لَّبَنٍ لَّمْ يَتَغَيَّرْ طَعْمُهُۥ وَأَنْهَٰرٌ مِّنْ خَمْرٍ لَّذَّةٍ لِّلشَّٰرِبِينَ وَأَنْهَٰرٌ مِّنْ عَسَلٍ مُّصَفًّى ۖ وَلَهُمْ فِيهَا مِن كُلِّ ٱلثَّمَرَٰتِ وَمَغْفِرَةٌ مِّن رَّبِّهِمْ ۖ كَمَنْ هُوَ خَٰلِدٌ فِى ٱلنَّارِ وَسُقُوا۟ مَآءً حَمِيمًا فَقَطَّعَ أَمْعَآءَهُمْ ١٥

“**Ja përshkrimi i Xhennetit, që u është premtuar të devotshmëve** (ndaj All’llahut)**: një vend, ku ka lumenj me ujë të pandotur, lumenj qumështi me shije të pandryshuar, lumenj vere me shije të këndshme për ata që e pinë dhe lumenj prej mjalti të kulluar. Ata do të kenë aty lloj-lloj frutash dhe falje prej Zotit të tyre. A mund të krahasohet ky shembull me Xhehennemin, ku gjynahqarët do të qëndrojnë përherë në zjarr dhe do t’u jepet ujë i valuar, që ua copëton zorrët?!”**

Komentimi

Një përshkrim tjetër i Xhennetit

Ky ajet është përshkrim i fundit për të gjithë, besimtarët dhe jobesimtarët. Grupi i parë që bëjnë punë të mira dhe grupi i dytë të cilit djalli ua zbukuroi veprat e tyre të këqija.

Ky ajet tregon gjashtë lloje të mirësive të banorëve të Xhennetit. Tregon edhe për dy lloje dënimesh të dhimbshme për banorët e Xhehennemit. Tregon dhe përcakton fundin e secilit grup.

Ajeti na flet për katër lumenj të Xhennetit. Secili prej tyre ka rrjedhën dhe përmbajtjen e tij të veçantë. Më pas flet për frutat e Xhennetit. Më në fund flet për disa dhurata shpirtërore.

Në fillim ajeti thotë: **"Ja përshkrimi i Xhennetit, që u premtohet të përkushtuarve** (ndaj All'llahut)**: një vend, ku ka lumenj me ujë të pandotur..."**.[1]

Fjala *"el ásine"*, do të thotë *"i ndotur"*, kurse togfjalëshi: **"...me ujë të pandotur..."**, do të thotë ujë që nuk i ndryshon shija dhe era.

Më pas ajeti shton: **"...lumenj qumështi me shije të pandryshuar..."**. Kjo fjali tregon se Xhenneti është një vend që

[1] Ka shumë diskutime nga komentuesit rreth formimit të këtij ajeti të bekuar. Më i përshtatshmi është: Togfjalëshi *"shembulli i Xhennetit"* kryen funksionin e kryefjalës, kurse kallëzuesi i tij është i fshehur. Vlerësimi është: shembulli i Xhennetit, që u është premtuar të përkushtuarve, është Xhenneti që ka lumenj. Ky ajet i ngjason ajetit 35 të sures "Err Rra'd": **"Shembulli i Xhennetit që u është premtuar të përkushtuarve, është që nën të rrjedhin lumenj."**.

nuk ndryshon dhe aty asgjë nuk prishet, aty nuk ndryshojnë shijet me kalimin e kohës. Aty ndryshojnë vetëm ushqimet e jetës së kësaj bote, të cilat, që, për shkak të ekzistencës së mikrobeve, prishen.

Më pas ajeti tregon për lumin e tretë të lumenjve të Xhennetit. Ajeti thotë: **"...lumenj vere me shije të këndshme për ata që e pinë..."**.

Në fund tregon për lumin e katërt të Xhennetit. Ai është: **"...lumenj prej mjalti të kulluar..."**.

Përveç lumenjve, ajeti na flet edhe për frutat e Xhennetit, si dhurata e pestë. Ajeti thotë: **"...Ata do të kenë aty lloj-lloj frutash..."** , të cilat janë në dispozicion të tyre.

Në fund, flet për dhuratën e gjashtë, e cila ndryshon nga dhuratat e mëparshme materiale, sepse kjo është dhuratë shpirtërore. Ajeti thotë: **"...falje prej Zotit të tyre..."**.

Mëshira e All'llahut do të fshijë të gjitha lëshimet dhe shkarjet e tyre dhe do t'u japë atyre qetësinë, rehatinë dhe kënaqësinë, do t'i bëjë ata prej të kënaqurve te Ai. Ata do të jenë miratues të Fjalës së All'llahut të Madhëruar: **"All'llahu është i kënaqur me ta dhe ata janë të kënaqur me All'llahun. Ky është shpëtim i madh."**.[1]

Besimtarët e pastër dhe punëmirë do të kënaqen me shumë dhurata materiale dhe shpirtërore në Xhennetet e përhershme dhe afër mëshirës së All'llahut.

[1] Sure "El Maide", ajeti 119.

Le të shohim tani se cili do jetë fundi i jobesimtarëve.

Në vazhdim ajeti thotë: **"...A mund të krahasohet ky shembull me Xhehennemin, ku gjynahqarët do të qëndrojnë përherë në zjarr dhe do t'u jepet ujë i valuar, që ua copëton zorrët?!"**.[1]

Fjala *"el em'au"* është shumësi i fjalës *"me'ije"*. Ka raste që përdoret për gjithçka që ndodhet në bark. Përdorimi i fjalës copëtim tregon për nxehtësinë e madhe të asaj pijeje të Xhehennemit dhe fuqisë së djedies së saj.

Hulumtime

1- Katër lumenjtë e Xhennetit

Nga ajetet e Kur'anit të lavdishëm përfitofet qartë se në Xhennet ka lumenj dhe burime të ndryshme. Secili prej tyre ka një dobi dhe shije të veçantë. Në ajetin e lartpërmendur flitet për katër lumenj. Në suren "Insan" përmenden shembuj të tjerë për Xhennetin.

Përdorimi i fjalës *"el enharu"*, për katër llojet e lumenjve, nënkupton se secili lumë nuk është një lumë i vetëm, por degëzohet në shumë lumenj.

[1] Janë përmendur shumë diskutime rreth ndërtimit të këtij ajeti. Më e përshtatshmja nga të gjitha është se ajeti ka një vlerësim që është: A është njësoj ai që është përherë në Xhennet, me këto cilësi me atë që është i përhershëm në zjarr?

Kemi thënë shpesh se mirësitë e Xhennetit nuk janë diçka që mund të flitet për ato me fjalët që përdorim çdo ditë në bisedat tona në këtë dynja. Këto fjalë nuk mund ta pasqyrojnë ashtu siç duhet Xhennetin. Këto fjalë e shprehje vetëm sa mund të vizatojnë ndonjë imazh, sado pak të përafërt me të vërtetat e mëdhaja të Xhennetit.

Ajeti që po diskutojmë, tregon për lumenjtë e ujit dhe të qumështit, të verës dhe të mjaltit. Lumi i parë ka mundësi të jetë për të larguar etjen, kurse i dyti si ushqim, i treti për të nxitur veprimtarinë dhe gjallërinë dhe i katërti për forcën dhe kënaqësinë.

Është interesante se nga ajetet e tjera të Kur'anit përftohet se jo të gjithë banorët e Xhennetit pinë nga të gjitha këto pije, sepse ata janë të ndarë sipas gradave. Banorët që i përkasin gradës së parë të Xhennetit, pinë pijet që janë të nivelit të tyre. Për këtë flet ajeti 28 i sures "Mutaffifine": **"Burim nga ku do të pinë më të afërmit e Zotit."**.

2- Ujë i mirë për pije

Duhet të theksohet se vera e Xhennetit nuk ka asnjë lidhje me verën e kësaj bote. Ajo është siç e përshkruan Kur'ani: **"Prej asaj nuk ka dhimbje koke e as që ata do të dehen nga ajo."**.[1]

3- Pije që nuk prishen

Në përshkrimin e lumenjve të Xhennetit, një herë thuhet se uji i tij është **"...i mirë për pije..."**, kurse herën tjetër **"...ujë të pandotur..."**. Kjo nënkupton se pijet dhe ushqimet e Xhennetit janë të mira e të freskëta. Përse të mos jetë kështu? Përse ushqimet

[1] Sure "Es Safat", ajeti 47.

ndryshojnë dhe prishen nga mikrobet? Sikur të mos ishin ato mikrobe, ushqimet e dynjasë do të mbeteshin në gjendjen e tyre të parë. Në Xhennet nuk ka mikrobe, prandaj gjërat e tij nuk prishen, por rrinë të pastra, të freskëta e të reja përherë.

4- Përse frutat?

Ajeti që po komentojmë dhe shumë ajete të tjera të Kur'anit, janë përqendruar te frutat me shije të ndryshme, krahas ushqimeve të tjera. Kjo tregon se frutat janë ushqimi më i rëndësishëm në Xhennet, si edhe në këtë botë, sepse frutat janë ushqimi më i parapëlqyer dhe më i shëndetshëm për njeriun.

5- Si do të pinë ujë banorët e Xhehennemit?

Fjala *"sukuu"* përdoret për të treguar se banorëve të Xhehennemit u shuhet etja me ujin e zjarrit, me forcë dhe jo me dëshirën e tyre. Uji i zjarrit që u jepet atyre, në vend që t'ua shuajë etjen, ua copëton zorrët dhe, siç është natyra e Xhehennemit, ata kthehen në gjendjen e tyre fillestare, ku nuk ka fare vdekje.

Ajetet 16 – 19

وَمِنْهُم مَّن يَسْتَمِعُ إِلَيْكَ حَتَّىٰٓ إِذَا خَرَجُواْ مِنْ عِندِكَ قَالُواْ لِلَّذِينَ أُوتُواْ ٱلْعِلْمَ مَاذَا قَالَ ءَانِفًاۚ أُوْلَٰٓئِكَ ٱلَّذِينَ طَبَعَ ٱللَّهُ عَلَىٰ قُلُوبِهِمْ وَٱتَّبَعُوٓاْ أَهْوَآءَهُمْ١٦ وَٱلَّذِينَ ٱهْتَدَوْاْ زَادَهُمْ هُدًى وَءَاتَىٰهُمْ تَقْوَىٰهُمْ١٧ فَهَلْ يَنظُرُونَ إِلَّا ٱلسَّاعَةَ أَن تَأْتِيَهُم بَغْتَةًۖ فَقَدْ جَآءَ أَشْرَاطُهَاۚ فَأَنَّىٰ لَهُمْ إِذَا جَآءَتْهُمْ ذِكْرَىٰهُمْ١٨ فَٱعْلَمْ أَنَّهُۥ لَآ إِلَٰهَ إِلَّا ٱللَّهُ وَٱسْتَغْفِرْ لِذَنۢبِكَ وَلِلْمُؤْمِنِينَ وَٱلْمُؤْمِنَٰتِۗ وَٱللَّهُ يَعْلَمُ مُتَقَلَّبَكُمْ وَمَثْوَىٰكُمْ١٩

“Midis tyre ka që bëjnë sikur të dëgjojnë ty, por, posa largohen prej teje, i pyesin ata të cilëve u është dhënë dituria: ‘Ç’tha ai më parë?!’. Këta janë ata, zemrat e të cilëve ua ka vulosur All’llahu dhe të cilët lëshohen pas epsheve të veta.”

“Sa për ata që ndjekin Rrugën e Drejtë, Ai ua shton udhëzimin dhe u jep devotshmëri e vetëpërmbajtje.”

“A mos vallë mohuesit presin, që t’u vijë befasisht vetëm Ora (e Kiametit)**? Ndërkohë, shenjat e saj kanë ardhur. Po për çfarë do t’u shërbejnë atyre këshillat, kur t’iu ketë ardhur Kiameti?!”**

“Dije se nuk ka zot tjetër të vërtetë përveç All’llahut! Kërko falje për gjynahun tënd dhe për besimtarët e besimtaret! All’llahu e di se si silleni ju dhe ku qëndroni.”

Komentimi

Janë shfaqur shenjat e Kiametit

Këto ajete janë një panoramë e situatës së hipokritëve dhe e mënyrës së sjelljes së tyre me Shpalljen e All'llahut, me fjalët e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe me luftimin e armiqve.

Për munafikët është folur më shumë në suret medinase, kurse në suret mekase nuk flitet asnjëherë për ta. Kjo ndodh sepse hipokrizia është shfaqur pas triumfit të Islamit dhe pasi Islamit iu dorëzua autoriteti dhe fuqia, kur politeistët ranë në pozita denigruese dhe nuk kishin më fuqi të kundërshtonin. Për këtë arsye, u detyruan të mbulohen me Islam, për të qenë të mbrojtur nga zemërimi i myslimanëve të vërtetë. Edhe ashtu, të fshehur, ata nuk i ndalën asnjëherë komplotet kundër Islamit, ndërsa çifutët e Medines, të cilët kënaqeshin me forcën ushtarake dhe ekonomike, nuk i nënvlerësuan ato. Këta konsiderohen si mbështetës të hipokritëve.

Megjithatë, këta depërtuan në mesin e myslimanëve të sinqertë, vinin te Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe merrnin pjesë në namazin e xhumasë, por sjellja e tyre përballë ajeteve kur'anore ua hiqte maskën dhe ua zbulonte atë që kishin brenda zemrave të tyre të sëmura.

Ajeti 16 thotë: **"Midis tyre ka që bëjnë sikur të dëgjojnë ty, por, posa largohen prej teje, i pyesin ata të cilëve u është dhënë dituria: 'Ç'tha ai më parë?!...'"**. Qëllimi i tyre me atë njeri

ishte për Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Fjalët me të cilat shpreheshin për Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ishin të shëmtuara e të pista. Ata nuk besuan kurrë në Shpalljen qiellore.

Fjala "*anifen*" vjen nga fjala "*enfun*". Meqenëse hunda ka një shfaqje të dallueshme në fytyrën e njeriut, kjo fjalë është përdorur për të mëdhenjtë e popullit. Po ashtu përdoret për kohën që kalon siç është në ajetin në fjalë.

Togfjalëshi: **"...u është dhënë dituria..."**, përdoret për të treguar se një nga shenjat e besimtarit, është zotërimi i diturisë së mjaftueshme, sepse dituria është burimi i besimit.

Kur'ani u ka dhënë atyre një përgjigje të prerë dhe ka thënë se fjala e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nuk ka qenë e paqartë dhe e ndërlikuar, përkundrazi: **"...Këta janë ata, zemrat e të cilëve ua ka vulosur All'llahu dhe të cilët lëshohen pas epsheve të veta."**.

Fjalia e dytë do të thotë se ndjekja e pasioneve e bën njeriun të humbasë aftësinë e konceptimit të të vërtetave dhe të bëhet si zarf i mbyllur, i vulosur, ku nuk mund të futet gjë e as nuk mund të dalë gjë prej tyre.

Besimtarët e vërtetë qëndrojnë përballë këtyre, në kahun tjetër. Për ta flet ajeti 17: **"Sa për ata që ndjekin Rrugën e Drejtë, Ai ua shton udhëzimin dhe u jep devotshmëri e vetëpërmbajtje."**.

Po, këta e hodhën vetë hapin e parë dhe përdorën logjikën dhe zemrën e tyre në këtë rrugë. Më pas All'llahu i mori ata për dore dhe ashtu siç ua pati premtuar më parë atyre, ua shtoi edhe më udhëzimin e tyre, u hodhi dritën e besimit në zemrat e tyre, u hapi gjokset dhe i furnizoi me idenë dhe mendimin e mirë. Kjo është nga ana ideologjike.

All'llahu i Madhëruar ngjalli brenda tyre shpirtin e përkushtimit, saqë ata neveriten nga mëkati dhe kundërshtimi dhe dashurojnë bindjen dhe veprën e mirë.

Këta qëndrojnë në të dy anët, në krahun përballë hipokritëve, për të cilët është treguar më parë, sepse ua ka vulosur zemrat e tyre dhe nuk kuptojnë asgjë, kurse nga ana tjetër, ata ndjekin pasionet e tyre. Besimtarëve u rritet udhëzimi dhe përkushtimi çdo ditë e më shumë.

Ajeti 18 vijon me paralajmërimin për ata që tallen, për ata që nuk kanë pikë besimi: **"A mos vallë mohuesit presin, që t'u vijë befasisht vetëm Ora** (e Kiametit)**? Ndërkohë, shenjat e saj kanë ardhur. Po për çfarë do t'u shërbejnë atyre këshillat, kur t'iu ketë ardhur Kiameti?!"**.

Jobesimtarët nuk iu bindën të vërtetës, kur besimi ishte detyrë dhe i dobishëm për ta. Ata janë endur kot, janë tallur me argumentet e All'llahut. Ata do të shohin fillimin e ngjarjeve të tmerrshme, fillimin e Kiametit, që do të dredhë tokën dhe ata, nga frika, do të besojnë, por atë Ditë nuk do t'u bëjë dobi as besimi dhe as përulja e tyre.

Kjo situatë ngjason me të sëmurin, i cili nuk kujdeset dhe nuk mjekohet, derisa i vjen vdekja. Kur e shikon veten në prag të

vdekjes, nxiton të pijë ilaçe, por tashmë, është tepër vonë. Atij nuk i bën dobi asnjë ilaç. Prandaj njeriu duhet të kujdeset në kohën e duhur.

Fjala *"el eshraťu"* tregon një shenjë. Sipas kësaj, shenjat e Kiametit tregojnën se ai po afrohet.

Ka shumë thënie të komentuesve për shenjat e afrimit të Kiametit. Në këtë kapitull janë shkruar detaje të hollësishme. Shumica e tyre mendojnë se ajo që nënkuptohet nga fraza *"ishratu es saati"*, në këtë ajet, është shfaqja e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Kjo vërteton atë që thotë hadithi i transmetuar prej tij: *"'Jemi dërguar unë dhe Kiameti kështu' dhe bashkoi dy gishtat e tij të mesit dhe treguesin."*.[1]

Disa komentues konsiderojnë "çarjen e hënës" si parashenjë të Kiametit, kurse një pjesë tjetër konsiderojnë si të tilla ngjarjet e kohës së Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Në këtë kapitull janë përmendur shumë hadithe, të cilat konsiderojnë përhapjen e shumë mëkateve mes njerëzve, si parashenja të afrimit të Kiametit. Në hadithin e ardhur nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, që përcjell Fetal Nejsaburij *(All'llahu qoftë i kënaqur prej tij!)*, në librin "Reudatul Uaidhijne" lexojmë: *"Prej parashenjave të Kiametit*

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", tefsiri "El Kurtubijj", tefsiri "Fi dhilalil Kur'an" dhe tefsire të tjerë, në fundin e ajeteve që po komentojmë, me një ndryshim të lehtë në mënyrën e të shprehurit.

janë zhdukja e diturisë dhe përhapja e injorancës, pirja e alkoolit dhe përhapja e zinasë (kurvëllëkut).".[1]

Madje, edhe ngjarje të rëndësishme, si dalja e Mehdiut *(All'llahu ia shpejtoftë ardhjen!)*, janë konsideruar si parashenja të Kiametit.

Duhet përmendur se ndonjëherë ne i studiojmë parashenjat e Kijametit në formë të përgjithshme dhe pyesim: Cilat janë shenjat që tregojnë se Kiameti po afron? Herë tjetër hulumtojmë në atë që ka ardhur në ajet dhe çështja që gjendet në ajet e thamë. Përsa i përket shenjave të përgjithshme të afrimit të Kijametit, për këtë gjenden studime dhe transmetime të shumat në literaturat islame. Këto do t'i cekim më pas.[2]

A është shfaqja e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* një prej shenjave të afrimit të Kiametit?

Këtu mund të shtrohet pyetja: Si e konsiderojnë shfaqjen e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* si njërën nga shenjat e Kiametit, kur kanë kaluar deri tani katërmbëdhjetë shekuj dhe nuk ka asnjë shenjë të Kiametit?

---

[1] Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, f. 37.

[2] Nga ajo që thamë bëhet e qartë te fjalia: "janë afruar parashenjat" nuk është qëllimi i realizimit të të gjitha shenjave të Kiametit dhe shfaqja e tyre në kohën e Profetit *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Përkundrazi, ajo që nënkuptohet është: Një pjesë prej tyre janë shfaqur dhe ato lajmërojnë për afrimin e Kiametit. Disa parashenja do të vërtetohen dhe do të qartësohen më mbrapa.

Përgjigjja për këtë pyetje lidhet me qartësimin e kohës që ka jetuar dynjaja dhe kohës që i ka mbetur të jetojë. Nga ky këndvështrim krahasues, do të duket se dynjasë i ka mbetur edhe pak kohë për të jetuar. Kjo është thënë në një hadith të transmetuar nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Ai po u fliste shokëve të tij pak para perëndimit. Gjatë asaj bisede, ai tha: "*Pasha Atë që ka në dorë shpirtin e Muhammedit, nuk i ka mbetur shumë jetë kësaj dynjaje, po të krahasojmë sa ka kaluar dhe sa i ka mbetur. Dynjasë i ka mbetur veçse shumë pak kohë.*".[1]

Ajeti i fundit prej ajeteve në fjalë, si një përkufizim i komenteve që bëmë rreth besimit dhe mohimit dhe fundit të besimtarëve dhe të jobesimtarëve, thotë: **"Dije se nuk ka zot tjetër të vërtetë përveç All'llahut..."**. Pra, qëndro fort në vijën e Teuhidit, sepse ai është ilaçi shërues dhe dije se rruga më e mirë e shpëtimit është Teuhidi, për të cilin diskutuam në ajetet e mëparshme.

Kjo fjalë nuk do të thotë se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nuk kishte njohuri për Teuhidin. Ajo që nënkuptohet, është vazhdimësia në këtë rrugë. Kjo ngjan me komentin e ajetit 6 të sures "El Hamd" dhe nuk do të thotë mungesë udhëzimi, por: **"Udhëzona për në rrugën e drejtë"**, do të thotë na forco në vijën e udhëzimit.

Supozohet që nënkuptohet edhe meditimi për Teuhidin, për ngjitjen në pozitat më të larta, për leximin e argumenteve të All'llahut. Të gjitha këto përgatisin terrenin për ngjitjen në nivele

[1] Tefsiri "Ruhul Meanij", vëll. 26, f. 48.

më të larta. Meditimi konsiderohet si faktor që shton ose pakëson nivelin e besimit dhe të mosbesimit.

Komentimi i tretë nënkupton anët praktike të Teuhidit. Ky ajet sqaron praktikisht se vendstrehimi dhe vendbanimi i vetëm në Botë është All'llahu i Lartësuar, prandaj strehohu tek All'llahu dhe kërko zgjidhjen e problemeve të tua vetëm prej Atij. Mos ki frikë prej shtimit të problemeve, mos ki frikë numrin e madh të armiqve.

Nuk ka asnjë kundërthënie midis këtyre tri komentimeve dhe këta mund të bashkohen kuptimisht.

Pas kësaj çështjeje ideologjike, ajeti rikthehet te çështja e përkushtimit dhe e përunjësisë ndaj mëkatit. Ajeti thotë: **"...Kërko falje për gjynahun tënd dhe për besimtarët e besimtaret...!"**.

Dihet se Profeti Muhammed kurrë nuk ka bërë mëkat sepse ai është i pagabueshëm. Të tilla shëmbëllime janë që kurrë të mos e mendojmë të keqen ashtu siç ishte Profeti dhe atë ta kemi shemmbullin tonë.

Në një hadith tregohet se Hudhejfe ibn Jemani thotë: *"Kam qenë një njeri me gjuhë të mprehtë në familjen time dhe thashë: 'O i dërguari i All'llahut, unë kam frikë se kjo gjuhë do të më fusë në zjarr.'"*. Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* thotë: *"Po ku je ti me të kërkuarit e faljes ndaj All'llahut? Unë i kërkoj falje All'llahut njëqind herë në ditë."*.[1]

Në disa transmetime të tjera thuhet se ai kërkonte falje shtatëdhjetë herë në ditë.

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 9, f. 102, fundi i ajeteve në fjalë.

Nëse të tjerë kanë kërkuar falje për mëkatet që kanë kryer, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i kërkon falje All'llahut për çastet që e zunë me punë atë dhe nuk iu përkushtua sa duhet përkujtimit të Tij ose la punën më të mirë dhe verpoi atë të mirën.

Këtu duhet përmendur një pikë e rëndësishme që është: All'llahu i Madhëruar bën shefaat për besimtarët dhe besimtaret dhe e ka urdhëruar Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, që të kërkojë falje për ta, me qëllim që ata t'i përfshijë mëshira e Tij. Kjo e bën të qartë rëndësinë e ndërmjetësimit në dynja dhe në Ahiret. Po kështu sqarohet mirë edhe rëndësia e ndërmjetësimit.

All'llahu i Madhëruar, në fundin e ajetit, sqaron shkakun: **"...All'llahu e di se si silleni ju dhe ku qëndroni."**, sepse Ai e di atë që ju tregoni së jashtmi, siç di edhe atë që keni në mendje dhe në brendësinë tuaj. Ai di atë që fshihni dhe atë që tregoni, di sekretet dhe gjithçka të fshehtë tuajën. Madje Ai di edhe nijetet tuaja, edhe atë që ju nxit, edhe atë që ju vjen ndërmend, edhe çfarë keni në shpirtin tuaj. Ai di lëvizjet dhe qëndrimet tuaja. Prandaj e keni për detyrë, që të ktheheni drejt Tij, të ngrini duart drejt Atij dhe të kërkoni faljen dhe mëshirën prej Tij.

Fjala *"el mutakal'libu"*, tregon vendin ku shtohet rikthimi te All'llahu, kurse fjala *"el methva"*, tregon vendin e qëndrimit.

Këto dy fjalë kanë një kuptim të gjerë, që përfshin të gjitha lëvizjet e të birit të Ademit dhe pasivitetet e tij, si ato në dynja, edhe ato në Ahiret, si në kohën kur ka qenë embrion, ashtu edhe

kur është prej banorëve të varreve. Shumë komentues kanë thënë se këto dy kuptime janë të kufizuara.

Komentues të tjerë kanë thënë se ajo që nënkuptohet, është lëvizja e njeriut gjatë ditës dhe qetësimi i tij gjatë natës.

Të tjerët kanë thënë se ajo që nënkuptohet, është rrugëtimi i njeriut në jetën e dynjasë dhe stabilizimi i tij në Ahiret.

Të tjerë thonë se ajo që nënkuptohet, është lëvizja e njeriut në shtyllat kurrizore të baballarëve, në mitrat e nënave dhe qëndrimi i tij në varr.

Në fund, disa komentues thanë se nënkuptohen lëvizjet e tij në udhëtim, si dhe qetësimi kur nuk është në udhëtim.

Mirëpo, siç thamë, ajeti ka një kuptim të zgjeruar, i cili i përfshin të gjithë këto kuptime.

Hulumtime

Cilat janë parashenjat e Kiametit?

Kemi thënë më parë se fjala *"eshratun"*, tregon një shenjë që tregon afrimin e Kiametit, apo parashenjat e tij. Shenjat e Kiametit janë përmendur në burimet shi'ite dhe ato sunite. Në Kur'ani nuk përmeden veçse në këtë ajet.

Prej haditheve, më gjithëpërfshirësi dhe më i hollësishëm në këtë kapitull, është hadithi që transmeton Ibn Abasi nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, lidhur me çështjen e Haxhit të Lamtumirës. Ai na mëson shumë gjëra dhe përmban shumë hollësi. Këtë do ta shtjellojmë të plotë.

Ibn Abasi ka thënë: "Shkuam për të bërë Haxhin bashkë me të Dërguarin e All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Ky ishte Haxhi i fundit që i Dërguari i All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka bërë. Ai mori një hallkë të portës së Qabes, pastaj u kthye me fytyrë nga ne dhe tha: "*A t'ju lajmëroj për parashenjat e Kiametit?*".

Njeriu më afër me atë ishte Selmani *(Mëshira e All'llahut qoftë mbi të!)* i tha: "Po, o i Dërguari i All'llahut."

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* tha: "*Prej parashenjave të Kiametit janë: humbja e namazit, ndjekja e pasioneve, prirja nga epshet, respektimi dhe madhërimi i pasanikëve, shitja e fesë për dynjanë. Kështu zemra e besimtarit do të shkrihet në brendësinë e tij, ashtu siç shkrihet kripa në ujë, saqë e sheh veprën e urryer dhe nuk do të mund ta ndryshojë atë.*"

Selmani tha: "Me të vërtetë do të ndodhë kjo, o i Dërguari i All'llahut?"

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* tha: "*Po, pasha Atë që ka shpirtin tim, në dorën e Tij, o Selman. Në atë kohë ata i qeverisin prijës zullumqarë dhe ministra të shthurur, autoritarë, të padrejtë dhe besnikët mashtrues.*"

Selmani tha: "Me të vërtetë do të ndodhë kjo, o i Dërguari i All'llahut?"

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* tha: "*Po, pasha Atë që ka shpirtin tim, në dorën e Tij, o Selman. Me të vërtetë, në atë kohë vepra e urryer do të jetë e mirë dhe vepra e mirë do të jetë e urryer dhe do të besohet mashtruesi, do të akuzohet për mashtrim i sinqerti, do t'i besohet gënjeshtarit dhe do të përgënjeshtrohet i sinqerti.*"

Selmani tha: " Edhe kjo do të ndodhë, o i Dërguari i All'llahut?"

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* tha: "*Po, pasha Atë që ka në dorë, shpirtin tim, o Selman. Në atë kohë, do të ketë gra në pozitën e prijësit dhe gënjeshtra do të bëhet një kusht, kurse zekati borxh, plaçka e grabitur përfitim, burri do të sillet ashpër me prindërit e tij dhe mirë me shokët e tij dhe shfaqet ylli, planeti mëkatar.*".

Selmani tha: "Vërtet, do të ndodhë kjo, o i Dërguari i All'llahut?"

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* tha: "*Po, pasha Atë që ka në dorë, shpirtin tim, o Selman. Në atë kohë, gruaja do të jetë ortake me burrin e saj në tregti dhe secili prej tyre shpenzon të gjithë mundin e tij jashtë shtëpisë për të përfituar pasurinë. Shiu do të jetë me pakicë, do të pakësohen shumë vreshtat. Njeriu do të përbuzë atë që nuk ka mundësi të paguajë. Në atë kohë do të afrohen tregjet. Njëri thotë: 'nuk kam shitur gjë', tjetri do të thotë: 'nuk kam fituar gjë' dhe nuk shikon veçse ata që qortojnë dhe shajnë All'llahun.*".

Selmani tha: "Me të vërtetë, do të ndodhë kjo, o i Dërguari i All'llahut?"

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* tha: *"Po, pasha Atë që ka në dorë shpirtin tim, o Selman. Në atë kohë do t'i drejtojë një popull, që, nëse flasin, do t'i vrasin, nëse heshtin, ua lejojnë. Do të shqetësohen me gojët e tyre dhe do të kryejnë marrëdhënie me të ndaluarat e tyre, do të derdhin gjakun e tyre dhe do t'ua mbushin zemrat e tyre me mistere dhe frikë. Nuk i shikon ata ndryshe, veçse të frikësuar, të tmerruar e të terrorizuar."*

Selmani tha: "Me të vërtetë do të ndodhë kjo, o i Dërguari i All'llahut?"

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* tha: *"Po, pasha Atë që ka në dorë, shpirtin tim, Selman. Në atë kohë do të sillet një gjë nga Lindja dhe një gjë nga Perëndimi, (pra ligjet e vendeve lindore dhe ligjet e vendeve perëndimore) dhe i japin ngjyra ymetit tim. Mjerë për njerëzit që nuk mëshirojnë të voglin dhe nuk respektojnë të madhin, që nuk janë të ashpër ndaj keqbërësit. Kufomat e tyre janë trupa njerëzorë, kurse zemrat e tyre janë zemra të shejtanëve."*

Selmani e pyeti: "Me të vërtetë, do të ndodhë kjo, o i Dërguari i All'llahut?"

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* iu përgjigj: *"Po, pasha Atë që ka në dorë, shpirtin tim, o Selman. Në atë kohë do të kenë kënaqësi burrat me burrat dhe gratë me gratë, do të ketë xhelozi për skllavin, shërbëtorin, ashtu siç do të ketë xhelozi për shërbëtoren në shtëpinë e familjes së saj. Burrat u përngjasin grave, kurse gratë u përngjasin burrave. Femrat do të ngasin vetë shalën (kalin etj) dhe të tregojnë veten e tyre. Mallkimi i All'llahut qoftë mbi ata prej ymetit tim."*

Selmani tha: "Edhe kjo do të ndodhë, o i Dërguari i All'llahut?"

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* tha: "*Po, pasha Atë që kanë dorë shpirtin tim, o Selman. Me të vërtetë, në atë kohë do të zbukurohen xhamitë dhe kishat, do të zbukurohen Kur'anet (pa vepruar fare me të), do të zgjaten minaret, do të shtohen safet, do të shtohen rreshtat, do të shtohen edhe zemra të urryera me njëra-tjetrën, edhe gjuhë të ndryshme.*"

Selmani tha: "Edhe kjo do të ndodhë, o i Dërguari i All'llahut?"

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* tha: "*Po, pasha Atë që ka ne dorë, shpirtin tim, o Selman. Në atë kohë, meshkujt e ymetit tim do të zbukurohen me flori, do të veshin mëndafsh dhe rroba prej mëndafshi dhe do t'i përdorin lëkurat e leopardit si veshje.*"

Selmani tha: "Edhe kjo do të ndodhë, o i Dërguari i All'llahut?"

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* tha: "*Po, pasha Atë që ka në dorë, shpirtin tim, o Selman. Në atë kohë do të shfaqet zinaja, do të bashkëpunohet me rushfet e me korrupsion, do të poshtërohet feja dhe do të ngrihet lart dynjaja.*"

Selmani tha: "Me të vërtetë, do të ndodhë kjo, o i Dërguari i All'llahut?"

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* tha: "*Po, pasha Atë që ka në dorë, shpirtin tim, o Selman. Në atë kohë do të shtohen divorcet dhe nuk ruhet asnjë kufi i All'llahut, por ata nuk e dëmtojnë All'llahun, dëmtojnë veten e tyre.*"

Selmani tha: "Vërtet, do të ndodhë kjo, o i Dërguari i All'llahut?"

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* tha: "*Po, pasha Atë që ka në dorë, shpirtin tim, o Selman. Në atë kohë do të shfaqen femrat këngëtare me instrumentet muzikore dhe njerëzit e këqij të ymetit tim do t'u shkojnë pas.*"

Selmani tha: "Vërtet, do të ndodhë kjo, o i Dërguari i All'llahut?"

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* tha: "*Po, pasha Atë që ka në dorë, shpirtin tim, o Selman. Në atë kohë, të pasurit e ymetit tim do të bëjnë Haxhin si ekskursion, për qejf, kurse shtresa e mesme do ta bëjë Haxhin për tregti, kurse të varfrit do ta bëjnë për sy e faqe dhe për emër. Në atë kohë, do të ketë njerëz që e mësojnë Kur'anin për të tjerë, veç All'llahut dhe e përdorin atë si bilbila, do të ketë njerëz që do të mësojnë dituri për të tjerë, veç All'llahut, do të shtohen fëmijët e kurvërisë, do të mburren se kush e këndon më bukur Kur'anin dhe do të ndjekin në sukseset e dynjasë.*"

Selmani tha: "Vërtet, do të ndodhë kjo, o i Dërguari i All'llahut?"

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* tha: "*Po, pasha Atë që ka në dorë, shpirtin tim, o Selman. Kjo ndodh, kur të dhunohen, të përdhosen gjërat e shenjta dhe të përfitojnë mëkatet, kur njerëzit e këqij të kenë autoritet ndaj njerëzve të mirë dhe të përhapet gënjeshtra, të shfaqet kokëfortësia, të përhapet në masë varfëria, të mburren me veshjet, kur reshjet e shiut të bien jo në kohën e tyre, kur të shprehen në favor të lojës me letra dhe instrumenteve muzikore dhe të injorojnë urdhërimin në të mirë dhe ndalimin në veprat e urryera, kur besimtari të jetë më i përbuzuri, kur të shfaqin lexuesit e Kur'anit dhe adhuruesit e tyre të mallkojnë njëri-tjetrin dhe, kur njerëz të papastër dhe pisa ftojnë për të arritur drejt mbretërive të qiejve.*"

Selmani tha: "Vërtet, do të ndodhë kjo, o i Dërguari i All'llahut?"

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* tha: "*Po, pasha Atë që ka në dorë, shpirtin tim, o Selman. Në atë kohë, i pasuri nuk do të ketë frikë nga i varfëri. Askush nuk i jep gjë lypësit që lyp nga njerëzit mes dy xhumave.*"

Selmani tha: "Edhe kjo do të ndodhë, o i Dërguari i All'llahut?"

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* tha: "*Po, pasha Atë që ka në dorë, shpirtin tim, o Selman. Në atë kohë flet (rubejda).*"

Selmani tha: "E çfarë është *rubejda*, o i Dërguari i All'llahut, qofshin kurban për ty babai im dhe nëna ime?"

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* tha: "*Rubejda do të thotë: Dikush flet për situatën e përgjithshme, atë që nuk e ka thënë, flet vetëm për pak kohë se Toka lëngon. Çdo popull mendon se ka ndodhur në anën e tyre dhe rri aty aq sa do All'llahu. Toka, nga brendësia e saj, u hedh atyre copa, pjesë dhe u thotë: 'Flori dhe argjend" Më pas tha: 'Atë ditë nuk bën dobi as ari dhe as argjendi dhe çështja i lihet All'llahut. Ky është ai kuptimi i fjalës së Tij:* **"shenjat e saj kanë ardhur"**.[1]

[1] Tefsiri i "Ali ibn Ibrahimit", vëll. 2, f. 307, sipas transmetimit të tefsirit "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, f. 34 dhe tefsirit të "Safiut", fundi i ajetit në fjalë.

Ajetet 20 – 24

وَيَقُولُ ٱلَّذِينَ ءَامَنُواْ لَوۡلَا نُزِّلَتۡ سُورَةٞۖ فَإِذَآ أُنزِلَتۡ سُورَةٞ مُّحۡكَمَةٞ وَذُكِرَ فِيهَا ٱلۡقِتَالُ رَأَيۡتَ ٱلَّذِينَ فِي قُلُوبِهِم مَّرَضٞ يَنظُرُونَ إِلَيۡكَ نَظَرَ ٱلۡمَغۡشِيِّ عَلَيۡهِ مِنَ ٱلۡمَوۡتِۖ فَأَوۡلَىٰ لَهُمۡ ٢٠ طَاعَةٞ وَقَوۡلٞ مَّعۡرُوفٞۚ فَإِذَا عَزَمَ ٱلۡأَمۡرُ فَلَوۡ صَدَقُواْ ٱللَّهَ لَكَانَ خَيۡرٗا لَّهُمۡ ٢١ فَهَلۡ عَسَيۡتُمۡ إِن تَوَلَّيۡتُمۡ أَن تُفۡسِدُواْ فِي ٱلۡأَرۡضِ وَتُقَطِّعُوٓاْ أَرۡحَامَكُمۡ ٢٢ أُوْلَٰٓئِكَ ٱلَّذِينَ لَعَنَهُمُ ٱللَّهُ فَأَصَمَّهُمۡ وَأَعۡمَىٰٓ أَبۡصَٰرَهُمۡ ٢٣ أَفَلَا يَتَدَبَّرُونَ ٱلۡقُرۡءَانَ أَمۡ عَلَىٰ قُلُوبٍ أَقۡفَالُهَآ ٢٤

“Ata që kanë besuar thonë: Sikur të ishte shpallur një sure! Por, kur shpallet një sure e qartë dhe në të përmendet lufta, i sheh ata me zemra të sëmura, si të vështrojnë ty me shikim si të agonisë së vdekjes! Ndërkohë, më e përshtatshme do të ishte për ata;”

“bindja dhe fjala e mirë! Madje, kur çështja (e luftës) **është vendosur, do të ishte më mirë për ata që të tregohen të sinqertë ndaj All’llahut.”**

“Nëse ju (o hipokritë) **i ktheni shpinën besimit, atëherë do të bënit ngatërresa në Tokë dhe do t’i shkatërronit lidhjet farefisnore.”**

"Këta janë ata, të cilët All'llahu i ka mallkuar, i ka bërë të shurdhër dhe ua ka verbuar shikimin."

"Vallë, a nuk përsiatin ata për Kur'anin apo i kanë zemrat të kyçura?!"

Komentimi

Ata kanë frikë edhe nga fjala "xhihad"

Këto ajete sqarojnë situata të ndryshme të besimtarëve dhe hipokritëve, në lidhje me urdhrin për xhihad dhe janë plotësues të hulumtimeve që janë bërë në ajetet e kaluara për këto dy grupe.

Ajeti i parë, prej ajeteve në fjalë, thotë: **"Ata që kanë besuar thonë: Sikur të ishte shpallur një sure!..."**, një sure që të urdhërojë për xhihad dhe të qartësojë detyrimin tonë përballë armiqve të ashpër xhelatë, të cilët nuk kanë fare logjikë; një sure që me argumentet e saj, të dërgojë dritën e udhëzimit në zemrat tona dhe të ndriçojë shpirtrat tanë. Kjo është situata e besimtarëve.

Kurse hipokritët: **"...Por, kur shpallet një sure e qartë dhe në të përmendet lufta, i sheh ata me zemra të sëmura, si të vështrojnë ty me shikim si të agonisë së vdekjes!..."**.

Kur hipokritët dëgjojnë për luftën, frikësohen shumë dhe ndalojnë së menduari, sytë e tyre gozhdohen dhe shikojnë drejt

teje si të jenë pranë vdekjes. Kjo është situata e hipokritëve frikacakë.

Sjellja e ndryshme e besimtarëve dhe e hipokritëve ndaj urdhrit të luftës *(xhihadit)* buron nga raporti që kanë me All'llahun e Madhëruar. Grupi i parë i lidhën shpresat e tyre te All'llahu i Madhëruar për shkak të besimit të tyre të fortë. Ata shpresojnë në mbrojtjen e Tij, në mirësinë dhe në ndihmën e Tij. Ata nuk i frikësohen martirizimit në Rrugën e All'llahut.

Për besimtarët, sheshi i luftës është sheshi i shfaqjes së dashurisë së tyre për të dashurin e tyre, sheshi i fisnikërisë dhe i nderimit, sheshi i shpërthimit të përgatitjeve dhe i fuqive të tyre, sheshi i qëndresës dhe i përballimit, sheshi i triumfit. Për ta frika nuk ka asnjë kuptim.

Kurse për grupin e dytë, hipokritët, sheshi i luftës është sheshi i vdekjes, i shkatërrimit dhe i keqardhjes, sheshi i disfatës dhe i ndarjes me shijet e dynjasë. Një shesh i errët që e pret një e ardhme e tmerrshme dhe e paqartë!

Me togfjalëshin *"suretun muhkemetun"*, sipas mendimit të disa komentuesve, nënkuptohen suret ku është përmendur çështja e luftës. Por për këtë nuk ka asnjë argument. Fjala *"el muhkem"* këtu është me kuptimin i palëvizshëm, i prerë, i qartë dhe larg çdo paqartësie.

Fjalia: **"i sheh ata me zemra të sëmura"**, në ligjërimin kur'anor, përdoret për hipokritët. Disa komentues supozojnë se tregon ata me besim të dobët, por ky supozim nuk harmonizohet me ajetet e Kur'anit, madje as me ajetet e kaluara të kësaj sureje dhe as me ajetet që janë pas tyre, të cilat flasin për hipokritët.

E megjithatë, ajeti shton në fund një fjali të shkurtër: **"...Ndërkohë, më e përshtatshme do të ishte për ata."**.

Fjalia: **"...Ndërkohë, më e përshtatshme do të ishte për ata"**, në edukatën arabe, shpreh kërcënim, mallkim dhe uron pikëllimin dhe shkatërrimin për tjetrin.[1]

Disa e kanë komentuar se vdekja është më e mirë për ju. Këto kuptime edhe mund të bashkohen, pa asnjë pengesë, siç e kemi përmendur në komentimin e ajetit.

Ajeti që vjen më pas, shton: **"bindja dhe fjala e mirë..."**.

Kjo mënyrë të thëni: **"...fjala e mirë..."**, ka mundësi të jetë përdorur për të treguar se është më mirë të përdorni fjalë të mira, se fjalë të frikshme, të urryera, të cilat i shqiptonin hipokritët pas zbritjes së ajetit të luftës. Hipokritët një herë thoshin: **"Mos dilni** (në luftë) **në vapë."**.[2] Herë tjetër thoshin: **"Por hipokritët dhe ata me zemra të sëmura e të dobëta, thanë: 'All'llahu dhe i Dërguari i Tij nuk na kanë premtuar asgjë, pos mashtrimit.'"**.[3] Së treti, thoshin: **"Ejani me ne."**[4] , me qëllim që të dobësonin besimtarët dhe t'i pengonin ata nga lufta.

Por hipokritët nuk u mjaftuan vetëm me pengimin e njerëzve nga lufta. Ata u përpoqën shumë që t'i ndalojnë besimtarët nga lufta, ose të paktën të demoralizojnë shpirtin dhe vendosmërinë e tyre.

---

[1] Një grup mendon se kuptimi i fjalisë bëhet: i vjen një e keqe dhe ajo është e barasvlershme me thënien i gjettë e keqja, mjerë për ata.
[2] Sure "Et Teube", ajeti 81.
[3] Sure "El Ahzab", ajeti 12.
[4] Sure "El Ahzab", ajeti 18.

Më pas ajeti shton: **"...Madje, kur çështja** (e luftës) **është vendosur, do të ishte më mirë për ata që të tregohen të sinqertë ndaj All'llahut."**.

Kjo do t'ua ngrejë lart kokën atyre në dynja, do t'u japë atyre forcë e begati dhe do të vazhdojë, derisa të marrin shpërblimin dhe fitoren e madhe në Ahiret.

Sifjalia: **"çështja** (e luftës) **është vendosur",** tregon për konsolidimin e diçkaje. Por ajo që nënkuptohet prej saj këtu, është lufta, e krahasuar me ajetet që e paraprinë atë dhe me ajetet që pasojnë.

Ajeti tjetër shton: **"Nëse ju** (o hipokritë) **i ktheni shpinën besimit, atëherë do të bënit ngatërresa në Tokë dhe do t'i shkatërronit lidhjet farefisnore."**.[1] Nëse ju e kundërshtoni Kur'anin dhe Teuhidin, pa dyshim se ju do të ktheheni në injorancën tuaj të parë. Në kohën e injorancës, ka pasur shkatërrime, bastisje, vrasje, gjakderdhje, shkëputje farefisnore dhe groposje gjallë të vajzave. Ky është kuptimi i fjalës *"teuel'lejtum"*.

Shumë komentues thonë se fjala *"vilajetun"* tregon qeverisjen, sundimin. Atëherë, sipas këtij mendimi, kuptimi bëhet: Nëse ju e merrni komandën e autoritetit, atëherë nuk pritet prej jush asgjë tjetër përveç humbjes dhe shkatërrimit, gjakderdhjes dhe ndërprerjes së lidhjeve të gjakut.

[1] Megjithëse vetëm një pakicë komentuesish ka diskutuar për ndërtimin e këtij ajeti, duket se (nëse merrni sundimin) është fjali kushtore që është mes emrit *"asaj"* dhe kallëzuesit të tij. Rezultati i *(in)* i kushtores, është pjesë e fjalisë: A pritet prej jush të bëni trazira në Tokë? Vlerësimi është: Nëse ju shmangeni nga Libri i All'llahut, a pritet gjë tjetër prej jush, përveç trazirës në Tokë?

Një grup hipokritësh morën leje për t'u larguar nga lufta, duke thënë se nuk mund të vrasim të afërmit e tyre, sepse do të bëheshim shkatërrues në Tokë.

Kur'ani u përgjigjet atyre duke u thënë: A nuk i keni vrarë njerëzit e gjakut (të afërmit) tuaj? A nuk keni derdhur gjakun e tyre? A nuk keni shkaktuar shkatërrime në Tokë në kohën e qeverisjes suaj? Argumenti juaj për t'u larguar nga lufta është vetëm justifikim dhe shmangie, sepse synimi i luftës në Islam është zhdukja e çrregullimit, zhdukja e trazirave në Tokë, çrrënjosja e padrejtësisë.

Në disa transmetime të ardhura nga Ehli Bejti i Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* thuhet se ky ajet është për Beni Umeje, të cilët nuk kanë respektuar as të vogël e as të madh, kanë derdhur gjakun e të gjithëve, edhe të të afërmve të tyre, sapo morën në dorë qeverisjen.[1]

Siç dihet, të gjithë Beni Umejet, duke filluar nga Ebu Sufjani deri te fëmijët dhe nipërit e tij, ishin miratim i qartë i këtij ajeti. Ky është qëllimi i tregimit, kurse ajeti ka një kuptim më të gjerë. Ai përfshin të gjithë hipokritët, zullumqarët dhe çrregulluesit.

Ajeti që vjen më pas, e sqaron përfundimisht qëndrimin e këtij populli hipokrit, çrregullues e justifikues: **"Këta janë ata, të cilët All'llahu i ka mallkuar, i ka bërë të shurdhër dhe ua ka verbuar shikimin."**.

[1] Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, f. 40.

Këta mendojnë se xhihadi islam, i cili është ngritur mbi të vërtetën dhe drejtësinë, i ndalon lidhjet e gjakut dhe sjell çrregullime në Tokë, kurse krimet që hipokritët kanë kryer në kohën e injorancës, gjakun e të pafajshmëve që ata kanë derdhur në ditët e sundimit të tyre, vrasjet e fëmijëve të pafajshëm, varrosjet për së gjalli, qenkëshin ngritur mbi bazën e të vërtetës dhe të drejtësisë. All'llahu i mallkoftë ata që nuk u kanë lejuar syçeltësinë atyre!

Në një transmetim nga Imam Aliu, i biri Hysejnit, lexojmë se ai i ka thënë djalit të tij, Imam Bakirit *(Paqja qoftë mbi ta!)*: *"Kujdes dhe largohu nga shoqërimi i atij që i ka këputur lidhjet e gjakut, sepse unë e kam gjetur atë të mallkuar në Librin e All'llahut në tri vende. All'llahu ka thënë:* **'do t'i shkatërronit lidhjet farefisnore...'"**.[1]

Fjala *"err rrahmu"*, tregon vendin e vendosjes së embrionit në barkun e nënës. Por kjo fjalë është përdorur edhe për të treguar të gjithë të afërmit, të cilët kanë lindur nga një embrion i vetëm. Në një hadith tjetër nga i Dërguari i All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, lexojmë: *"Tre njerëz nuk futen në Xhennet: ai që është i dhënë pas alkoolit, ai që është i dhënë pas magjisë dhe ai që i këput lidhjet familjare."*.[2]

---

[1] "Usulul Kafij", vëll. 2, f. 641, K. "Ai që urren shoqërimin e tij", Hadithi 7, i transmetuar nga tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, f. 41. Për sa u përket dy ajeteve që përmenden në pjesën e mbetur të hadithit, njëri prej tyre është ajeti 25 i sures "Err Rra'd", kurse tjetri është ajeti 27 i sures "El Bekare"; në njërin prej tyre, mallkimi është përmendur në mënyrë të qartë, kurse te tjetri në formë metaforike.

[2] Tefsiri "El Emthel", fundi i ajetit 77 të sures "El Maide", marrë nga "El Khisalu", vëll. 1, f. 179 dhe tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, f. 41.

Është i qartë se mallkimi i All'llahut të Lartësuar ndaj këtij populli dhe dëbimi i tyre nga mëshira e Tij, është shpërblimi për veprat e tyre dhe kundërpërgjigjja për sjelljen e tyre.

Ajeti 24 trajton shkakun e vërtetë të shmangies së këtij populli fatkeq dhe thotë: **"Vallë, a nuk përsiatin ata për Kur'anin apo i kanë zemrat të kyçura?!"**.

Shkaku i poshtërimit dhe i humbjes së tyre është njëri nga të dy: ose ata nuk e studiojnë me vëmendje Kur'anin, programin e udhëzimit hyjnor, ose ata e studiojnë me vëmendje atë, por zemrat e tyre janë të kyçura e nuk depërton asnjë e vërtetë.

Thënë ndryshe: Ata janë njësoj si ai që ka humbur rrugën në errësirë dhe nuk ka as pishtar. Nëse do të kishte një pishtar dhe do të shihte me sy, atëherë do ta gjente rrugën e udhëzimit.

Hulumtim

Kur'ani është libri i mendimit dhe i veprës

Ajetet e ndryshme të Kur'anit përqendrohen në një të vërtetë të madhe se ky Libër madhështor qiellor nuk është vetëm për t'u lexuar, por sipas mësimeve të tij, njeriu duhet të përkujtojë dhe të meditojë për të gjitha çështjet. Ai e paralajmëron njerëzimin për të dalë nga errësirat, për t'u shëruar, për t'u pranuar në mëshirën e All'llahut të Madhëruar dhe për t'u udhëzuar.

Në ajetin 50 të sures "El Enbija" lexojmë: **"Edhe ky,** (Kur'ani) **është këshillë, është i bekuar që Ne e shpallëm."**.

Në ajetin 29 të sures "Sad" thuhet: **"**(Ky është) **Libër i begatë, Ne ta shpallëm ty këtë, që t'i studiojnë argumentet e tij."**.

Në ajetin 19 të sures "El En'am" thuhet: **"... e mua më është shpallur ky Kur'an që me të t'ju tërheq vërejtjen juve dhe atij që i komunikohet."**.

Ajeti i parë i sures "Ibrahim" thotë: **"**(ky është) **Libër, Ne ta shpallëm ty, që me urdhrin e Zotit t'i nxjerrësh njerëzit prej errësirave në dritë."**.

Së fundi, në ajetin 82 të sures "Isra" thuhet: **"Ne të shpallim Kur'anin që është shërim dhe mëshirë për besimtarët."**.

Prandaj Kur'ani duhet të zërë vendin e tij në jetën e myslimanëve dhe të jetë i lidhur drejtpërdrejt me përditshmërinë e tyre. Është detyra e myslimanëve që ta bëjnë modelin e jetës së tyre në të gjitha aspektet.

Fatkeqësisht, një grup myslimanësh e trajtojnë Kur'anin si një seri me pjesë dhe me përkujtime. Ata e lexojnë atë thjesht si një lexim dhe i japin rëndësinë më të madhe intonacionit, shqiptimit të shkronjave dhe zërit të bukur. Ata e kanë nxjerrë Kur'anin nga të qenit e tij kushtetutë e përgjithshme e jetës së njeriut dhe janë mjaftuar vetëm me përsëritjen e shprehjeve të tij e janë kënaqur me aq.

Duhet përmendur se ajetet në fjalë thonë qartasi se këta hipokritë, me zemra të sëmura, nuk e kanë studiuar mirë Kur'anin, prandaj dhe kanë këtë fat të zi.

Fjala *"et tedebbur"*, vjen nga fjala *"debrun"* që do të thotë studim dhe hulumtim i rezultatit të diçkaje dhe pasojat e tij. Është e kundërta e *"et tefekkur"* që në të shumtën e rasteve përdoret për shkakqet e diçkaje.

Përfitimi prej Kur'anit ka nevojë për një edukim të nefsit dhe luftimin e tij. Vetë Kur'ani ndihmon në edukimin e tij, sepse, nëse zemrat janë të mbyllura me kycat e pasionit dhe të epsheve, janë të mbyllura ndaj mendjemadhësisë dhe kryeneçësisë, ndaj imponimit dhe kokëfortësisë, atëherë drita e të vërtetës nuk mund të futet në të. Ajetet që po komentojmë, e kanë treguar këtë kuptim.

Sa e mrekullueshme është fjala e Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)* në hytben e tij, rreth cilësive të njerëzve të përkushtuar. Përvec të tjerave, në këtë hytbe thuhet: *"Netëve ata qëndrojnë në këmbë duke lexuar pjesë nga Kur'ani, duke e recituar me maturi dhe në mënyrë harmonike. Me këtë i mallëngjejnë shpirtrat e tyre dhe kërkojnë ilaç për ligështimin e vet. Kur hasin në ndonjë ajet, i cili nxit dëshirën e madhe (për Xhennet), përkulen mbi të me pasion dhe shpirtrat e tyre orientohen drejt tij me ngazëllim. Kështu e ndiejnë se ai ndodhet para syve të tyre. Ndërsa, kur hasin në ndonjë ajet, i cili u fut drithërimat, i tendosin veshët dhe zemrat e tyre drejt tij dhe u bëhet se oshtima e Xhehennemit dhe britmat e tij arrijnë gjer tek veshët e tyre."*.[1]

[1] "Nehxhul Belaga", Hytbe 193, (Hytbeja e Hamanit, el mutekijne)

Një hadith të ardhur nga Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)*, në komentimin e fjalisë: **"Vallë, a nuk përsiatin ata për Kur'anin apo i kanë zemrat të kyçura?!"**, thuhet: "Ti ke një zemër dhe veshë. S'ka dyshim se, nëse All'llahu dëshiron të udhëzojë një rob, ia hap veshët e zemrën e tij. Nëse nuk e dëshiron atë udhëzim, ia vulos veshët e zemrën e tij dhe kurrë nuk funksionojnë. Kjo është thënia e All'llahut të Madhëruar: **'...apo i kanë zemrat të kyçura?!'"**.[1]

[1] Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, f. 41.

Ajetet 25 – 28

إِنَّ ٱلَّذِينَ ٱرۡتَدُّواْ عَلَىٰٓ أَدۡبَٰرِهِم مِّنۢ بَعۡدِ مَا تَبَيَّنَ لَهُمُ ٱلۡهُدَى ٱلشَّيۡطَٰنُ سَوَّلَ لَهُمۡ وَأَمۡلَىٰ لَهُمۡ ٢٥ ذَٰلِكَ بِأَنَّهُمۡ قَالُواْ لِلَّذِينَ كَرِهُواْ مَا نَزَّلَ ٱللَّهُ سَنُطِيعُكُمۡ فِي بَعۡضِ ٱلۡأَمۡرِ وَٱللَّهُ يَعۡلَمُ إِسۡرَارَهُمۡ ٢٦ فَكَيۡفَ إِذَا تَوَفَّتۡهُمُ ٱلۡمَلَٰٓئِكَةُ يَضۡرِبُونَ وُجُوهَهُمۡ وَأَدۡبَٰرَهُمۡ ٢٧ ذَٰلِكَ بِأَنَّهُمُ ٱتَّبَعُواْ مَآ أَسۡخَطَ ٱللَّهَ وَكَرِهُواْ رِضۡوَٰنَهُۥ فَأَحۡبَطَ أَعۡمَٰلَهُمۡ ٢٨

"Vërtet, ata që kthehen në mosbesim, pasi u është treguar Rruga e Drejtë, djalli i ka joshur dhe i ka ushqyer me shpresa të rreme."

"Kjo për shkak se u thoshin atyre që nuk e donin atë, që e ka shpallur All'llahu: 'Ne do t'ju bindemi juve në disa gjëra' – por All'llahu i di mirë fshehtësitë e tyre."

"E çfarë do të bëjnë ata, kur engjëjt do t'ua marrin shpirtin, duke i rrahur në fytyrat dhe shpinat e tyre?!"

"Kjo, sepse ata pasuan atë që shkakton zemërimin e All'llahut dhe urryen pëlqimin e Tij e kështu, Ai ua zhvlerësoi atyre veprat."

Komentimi

A nuk e lexojnë me vëmendje Kur'anin?

Këto ajete e vazhdojnë diskutimin për hipokritët dhe qëndrimin e tyre. Ajeti i parë prej ajeteve në fjalë thotë: **"Vërtet, ata që kthehen në mosbesim, pasi u është treguar Rruga e Drejtë, djalli i ka joshur dhe i ka ushqyer me shpresa të rreme."**.

Disa komentues supozuan se ky ajet flet për një grup jobesimtarësh nga ithtarët e librit, të cilët përmendnin shumë shenjat e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, para ardhjes së tij, duke u mbështetur në atë që thuhej në librin e tyre qiellor. Ata po e prisnin atë me padurim, por, kur ai erdhi, ata e kundërshtuan dhe shkuan pas pasioneve dhe interesave të tyre.

Megjithëkëtë, shembujt e përmendur në ajetet e kaluara dhe në vazhdim, e sqarojnë mirë se ky ajet flet, gjithashtu, për hipokritët, që erdhën dhe i panë me sytë e tyre faktet që argumentonin vërtetësinë e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, i dëgjuan argumentet e tij, por i kthyen shpinën, duke ndjekur pasionet dhe epshet e tyre dhe duke iu bindur cytjeve të shejtanit.

Fjala *"seu'uele"*, ka kuptimin e nevojës ndaj të cilës njeriu kujdeset shumë.[1] Dhe fjala *"tesuilun"*, ka kuptimin e ngjalljes së interesit dhe motivimit për gjëra që jepet shumë pas tyre. Kjo fjalë

[1] Disa e kanë komentuar atë me kuptimin e shpresës, siç mund ta lexojmë në ajetin 36 të sures "Ta Ha : **"O Musa, t'u dha ajo që kërkove."**.

përdoret edhe për shejtanin për shkak të cytjeve që ai i bën njeriut, me qëllim që ta pengojë atë nga udhëzimi.

Sifjalia: **"...i ka ushqyer me shpresa të rreme..."**, do të thotë mbjellja e shpresës së largët tek ata. Këto shpresa të largëta e hutojnë dhe e pengojnë njeriun të njohë të vërtetën dhe udhëzimin.

Ajeti që vjen më pas, e shpjegon shkakun e kësaj shprese të gënjeshtërt dhe zbukurimin djallëzor. Ajeti thotë: **"Kjo për shkak se u thoshin atyre që nuk e donin atë, që e ka shpallur All'llahu: 'Ne do t'ju bindemi juve në disa gjëra' – por All'llahu i di mirë fshehtësitë e tyre."**.

Ky është zakon i hipokritëve, kur diskutojnë me mëkatarët dhe kundërshtarët. Edhe pse nuk janë pjesëmarrës, janë dakord bashkë me ta në të gjitha qëndrimet dhe, nëse e kërkon nevoja, edhe u binden atyre.

Hipokritët e Medines u drejtuan nga çifutët e Medines, që ishin Beni Nedhijru dhe Beni Kurejdhetu, të cilët përgëzonin për Islamin para se të dërgohej Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Mirëpo pas ardhjes së tij dhe pas dërgimit të mesazhit, kur interesat e tyre u rrezikuan, për shkak të zilisë dhe të mendjemadhësisë së tyre, ata e konsideruan Islamin fe të pavërtetë dhe jo të mirë. Kishte një bashkëpunim midis hipokritëve dhe çifutëve për të kundërshtuar Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe për të ngritur komplote kundër Islamit. Ata kishin bërë marrëveshje me çifutët, për të punuar së bashku kundër Islamit dhe myslimanëve.

Togfjalëshi: **"në disa gjëra"**, tregon se bashkëpunimi bëhet vetëm për këtë pjesë, sepse e kundërshtonin adhurimin e putave, besonin në Ringjallje dhe Kiamet, prandaj nuk jemi dakord me ju në këto çështje.[1]

Kjo është e ngjashme me atë që thuhet në ajetin 11 të sures "El Hashr": **"A nuk e ke ditur se ata që u bënë hipokritë, u thoshin vëllezërve të vet nga ithtarët e librit që nuk kishin besuar: 'Nëse ju dëboheni, edhe ne do të dalim me ju, për çështjen tuaj, ne kurrë nuk do t'i bindemi askujt, e, nëse luftoheni prej dikujt, ne do ju ndihmojmë."**.

Në fund ajeti i kërcënon këta dhe u thotë: **"...All'llahu i di mirë fshehtësitë e tyre"**, sepse Ai është i Gjithëdituri. Ai e di mohimin e tyre të brendshëm, e di hipokrizinë e tyre dhe komplotet e tyre me çifutët. All'llahu i Madhëruar do t'i ndëshkojë ata dhe do t'u japë shpërblimin në kohën e përshtatshme. Ai është i Gjithdituri. Ai di atë që fshihnin çifutët. Ai e di se ata ishin ziliqarë dhe kokëfortë. Ata i kanë pas ditur shenjat e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, por i fshehën, sapo ai u shfaq. All'llahu e di mirë për këtë fshehje dhe përpjekjen për të bllokuar përhapjen e së vërtetës.

Sipas një hadithi të transmetuar nga dy Imamët, Imam Bakiri dhe Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi ta!)* sifjalia: **"nuk e donin atë, që e ka shpallur All'llahu"**, nënkupton Beni Umeje, të cilët e

[1] Ka shumë mendime të tjera për komentimin e këtij ajeti. Asnjë mendim nuk harmonizohet me ajetet e kaluara dhe as me ato që vijnë më pas, prandaj e refuzuam përmendjen e tyre.

urryen zbritjen e urdhrit të All'llahut për vilajetin (udhëheqësinë) e Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*.[1]

Është e qartë se ky është zbatim, sqarim dhe miratim i ajetit dhe jo përkufizim i kuptimit të tij.

Ajeti që pason, është i barasvlershëm me sqarimin e këtij kërcënimi të paqartë. Ajeti thotë: **"E çfarë do të bëjnë ata, kur engjëjt do t'ua marrin shpirtin, duke i rrahur në fytyrat dhe shpinat e tyre?!"**.[2]

Këta engjëj janë urdhëruar, që ata ta shijojnë dënimin, kur të jenë në prag të vdekjes, ta shijojnë mohimin, hipokrizinë dhe kokëfortësinë e tyre. Ata i godasin fytyrat e tyre, sepse ato qenë drejtuar nga armiqtë e All'llahut, i godasin shpinat e tyre, sepse ua kthyen shpinën argumenteve të All'llahut dhe të Profetit të Tij.

Ky kuptim është njësoj me atë që përmendet në ajetin 50 të sures "El Enfal", i cili flet për jobesimtarët dhe hipokritët: **"Sikur t'i kishe parë engjëjt, kur ua marrin shpirtin atyre që mohuan,** (do shihje tmerr**), u binin fytyrave dhe shpinave të tyre** (para, prapa)**: Shijoni dënimin e djegies!"**.

Ajeti i fundit prej ajeteve në fjalë sqaron shkakun e dënimit të All'llahut që përjetojnë ata në çastet e fundit të vdekjes. Ajeti thotë: **"Kjo, sepse ata pasuan atë që shkakton zemërimin e All'llahut dhe urryen pëlqimin e Tij e kështu, Ai ua zhvlerësoi atyre veprat."**.

---

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 9, f. 105

[2] Fjala *"kejfe"* është kallëzuesi i kryefjalës së papërmëndur dhe aludimi është: **si do të jetë puna e tyre**...

Kushti i pranimit të veprave është fitimi i kënaqësisë së All'llahut të Madhëruar. Prandaj është normale që të asgjësohen veprat e atyre që vazhdojnë me këmbëngulje në rrugën që e urren All'llahu i Madhëruar, e cila shkakton zemërimin e Tij. Ata e kundërshtojnë atë që e kënaq All'llahun dhe largohen nga kjo botë duarzbrazët. Atyre u rëndojnë aq shumë mëkatet, sa i ulin poshtë nga pesha e rëndë.

Situata e këtij populli ndryshon plotësisht nga situata e besimtarëve. Kur besimtarëve u afrohet vdekja, engjëjt i presin me fytyra të gëzuara dhe i përgëzojnë me atë që ua ka premtuar atyre All'llahu: **"...duke qenë të pastër, engjëjt ua marrin shpirtin, duke u thënë: 'Selam alejkum', gjetët shpëtimin, hyni në Xhennet, për hir të asaj që vepruat."**.[1]

Tërheq shikimin sifjalia: **"shkakton zemërimin e All'llahut"**, e cila tregon zemërimin e All'llahut të Lartësuar; sifjalia: **"Ai e pëlqen"**, tregon kënaqësinë e Tij. Disa komentues kanë thënë se ky dallim tregon se zemërimi i All'llahut mund të ndodhë, por edhe mund të mos ndodhë, ndërsa pëlqimi dhe mëshira e Tij janë gjithmonë e vazhdueshme.

Është e qartë se zemërimi i All'llahut të Madhëruar, inatosja dhe kënaqësia e Tij nuk do të thotë se janë ndikim vetjak. Këtë e sqaron Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* në hadithin e tij, kur thotë: *"Zemërimi i All'llahut është ndëshkimi i Tij, kurse pëlqimi i Tij është shpërblimi i tij."*.[2]

---

[1] Sure "En Nahl", ajeti 32.

[2] "Teuhijd Es Saduk", f. 170, është marrë nga transmetimi i tefsirit "El Mijzan", vëll. 18, f. 266.

Ajetet 29 – 31

أَمۡ حَسِبَ ٱلَّذِينَ فِي قُلُوبِهِم مَّرَضٌ أَن لَّن يُخۡرِجَ ٱللَّهُ أَضۡغَٰنَهُمۡ ٢٩ وَلَوۡ نَشَآءُ لَأَرَيۡنَٰكَهُمۡ فَلَعَرَفۡتَهُم بِسِيمَٰهُمۡۚ وَلَتَعۡرِفَنَّهُمۡ فِي لَحۡنِ ٱلۡقَوۡلِۚ وَٱللَّهُ يَعۡلَمُ أَعۡمَٰلَكُمۡ ٣٠ وَلَنَبۡلُوَنَّكُمۡ حَتَّىٰ نَعۡلَمَ ٱلۡمُجَٰهِدِينَ مِنكُمۡ وَٱلصَّٰبِرِينَ وَنَبۡلُوَاْ أَخۡبَارَكُمۡ ٣١

"Vallë, a mendojnë ata që kanë sëmundje në zemrat e tyre, se All'llahu nuk do t'ua nxirrte në shesh urrejtjen e tyre?"

"Sikur të donim, Ne do të t'i tregonim ty ata dhe ti, me siguri, do t'i njihje sipas shenjave të tyre. Por, ti do t'i njohësh ata sipas mënyrës së shprehjes së tyre. All'llahu i di veprat tuaja."

"Ne do t'ju vëmë në provë ju, derisa t'i njohim ata midis jush, që luftojnë (në Rrugën e Drejtë) **dhe durojnë, e derisa të provojmë ato që thuhen për veprat tuaja."**

Komentimi

Hipokritët njihen nga mënyra e të folurit të tyre

Këto ajete na tregojnë anën tjetër të cilësive të hipokritëve dhe shenjat e tyre. Ajetet tregojnë se ata mendojnë se mund t'i fshehin veprimet e tyre nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe nga besimtarët dhe në këtë mënyrë të shpëtojnë prej skandaleve të mëdha. Ajeti i parë prej ajeteve në fjalë thotë: **"Vallë, a mendojnë ata që kanë sëmundje në zemrat e tyre, se All'llahu nuk do t'ua nxirrte në shesh urrejtjen e tyre?"**.[1]

Fjala *"el edganu"*, është shumësi i fjalës *"dignun"* dhe tregon urrejtje të madhe.

Po, zemrat e këtyre kanë qenë të mbushura me urrejtje të madhe ndaj Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe besimtarëve. Ata prisnin rastin që t'i godisnin ata, prandaj Kur'ani i paralajmëron ata që të mos mendojnë se do të mund të fshehin gjithmonë fytyrat e tyre të vërteta. Prandaj edhe ajeti që vjen më pas, shton: **"Sikur të donim, Ne do të t'i tregonim ty ata dhe ti, me siguri, do t'i njihje sipas shenjave të tyre..."**, sepse Ne bëjmë në fytyrat e tyre shenja që t'i njohësh, kur t'i shikosh.

[1] Disa e kanë konsideruar *"em"* në ajetin e mësipërm pyetëse, kurse një pjesë tjetër e ka konsideruar atë ndërprerëse, me kuptimin e *"bel"*. Mendimi i parë duket më i përshtatshëm.

Ajeti shton: **"...Por, ti do t'i njohësh ata sipas mënyrës së shprehjes së tyre..."** Pra, mund t'i njohësh ata nëpërmjet mënyrës së fjalës së tyre.

Sipas Ragibit në librin "El Mufredatu", fjala *"el lahnu"*, përdoret në disa kuptime. Një prej kuptimeve është se hipokritët, me zemra të sëmura, mund të njihen nëpërmjet fjalëve dhe shprehjeve lënduese që përmbajnë hipokrizi.

Kur është fjala për luftë, ata nxitojnë të dobësojnë dëshirën e njerëzve, shpirtin e tyre. Kur është fjala për të vërtetën dhe drejtësinë, ata e manipulojnë atë me stërhollime të pakuptimta sintaksore. Kur flitet për njerëzit e mëparshëm punëmirë dhe të përkushtuar në Islam, ata nxitojnë të deformojnë reputacionin e tyre.

Ebi Seid El Khuderij transmeton: *"Antipatia e tyre për Aliun, të birin e Ebu Talibit, shprehet qartë përmes mënyrës së fjalëve të tyre. Ne i patëm njohur hipokritët që në kohën e të Dërguarit të All'llahut, që kishin antipati Aliun, të birin e Ebu Talibit."*.[1]

Një nga shenjat e dukshme të hipokritëve ishte se ata e trajtonin si armik dhe e urrenin të parin njeri që besoi, të parin sakrifikues në Rrugën e All'llahut.

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", fundi i ajeteve që po komentojmë. Më pas, një grup prej të mëdhenjve të përgjithshëm e kanë transmetuar përmbajtjen e këtij hadithi në librat e tyre. Ata janë: Ahmed ibn Hanbeli, në librin "El Fadailu"; Ibn Abul Berri, në librin "El Istiabu"; Dhehebiju, në librin "Tarijkhu evelul Islam"; Ibn Ethiri, në librin "Uniteti i bazave"; dijetari Kenxhi, në librin "Kifajetu et Talib"; Muhibbu din Taberiju, në librin "Rijadu Nadiretu"; Sujutiju, në librin "Ed Durrul Menthur"; Alusij, në librin "Ruhul Bejan". E ka përmendur atë një grup tjetër në librat e tyre. Kjo e bën të qartë se ajo është një nga transmetimet myslimane nga i Dërguari më i madh. Për më shumë sqarim, shiko veprën "Ihakakul Hakk", vëll. 3, f. 110 e pas saj.

Njeriu, zakonisht, nuk mund të fshehë për një kohë të gjatë atë që përmban brenda shpirti i tij, nuk mund të rrijë pa e shfaqur atë në mënyrat metaforike të fjalës së tij. Prandaj në një hadith nga Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* lexojmë: *"... nuk ka fshehur njeri në brendësi të tij diçka, vetëm se është shfaqur me gabimet e gjuhës së tij dhe me pamjet e fytyrës së tij."*.[1]

Ajetet e tjera të Kur'anit kanë përmendur se hipokritët përdorin fjalë lënduese, të cilat miratojnë këtë mënyrë të foluri, miratojnë lëvizjet e tyre të dyshimta. Mbase për këtë shkak, një pjesë e komentuesve kanë thënë se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, pasi zbriti ky ajet, i ka njohur mirë hipokritët nëpërmjet shenjave të tyre dalluese.

Dëshmi për këtë është se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është urdhëruar që të mos falej për asnjë prej tyre që vdisnin dhe as të qëndronte te varri i tyre duke iu lutur All'llahut për të: **"Asnjërit prej tyre, kur të vdesë, mos ia fal kurrë namazin** (e xhenazes)**, e as mos qëndro pranë varrit të tij** (për lutje e vizitë)**."**.[2]

Shumë ajete kur'anore, veçanërisht ajetet e sureve "Et Teube" dhe "El Ahzab", tregojnë qëndrimet e hipokritëve para betejës, në fushën e betejës dhe pas saj kur ndaheshin plaçkat e luftës, derisa edhe myslimanët e thjeshtë i njohën ata siç ishin në të vërtetë.

[1] "Nehxhul Belaga", Fjalët e shkurtra, Fjala 26.

[2] Sure "Et Teube", ajeti 84.

Edhe sot nuk është e vështirë t'i njohësh hipokritët. Edhe sot ata njihen nga mënyra se si flasin, nga qëndrimet e tyre jokorrekte ndaj çështjeve të rëndësishme shoqërore e në mënyrë të veçantë nga detyrimet dhe lufta. Është mirë që myslimanët t'i njohin dhe t'i kuptojnë sjelljet dhe veprimet e tyre, që të mos mashtrohen prej tyre. Myslimanët duhet të frymëzohen nga ky ajet, i cili i demaskon këta njerëz të rrezikshëm.

Në fund ajeti shton: **"...All'llahu i di veprat tuaja."**. Ai i di veprat e besimtarëve, atë që duket dhe atë që nuk duket. A i di edhe veprat e hipokritëve. Nëse supozojmë se hipokritët janë të aftë të fshehin realitetin e tyre të vërtetë nga njerëzit, a mund t'ia fshehin atë All'llahut, i Cili di gjithçka, di edhe sekretet me të thella të tyre?!

Ajeti që vjen më pas, shton mundësi të tjera, që miratojnë dhe sqarojnë dallimin e besimtarëve me hipokritët: **"Ne do t'ju vëmë në provë ju, derisa t'i njohim ata midis jush, që luftojnë** (në Rrugën e Drejtë) **dhe durojnë, e derisa të provojmë ato që thuhen për veprat tuaja.",** të vërtetët ndaj shtirësve, me luftë dhe durim.

Pra, kuptojmë se sprovimi është në arenën e luftës. Kjo harmonizohet edhe me kuptimin e fjalës *"el muxhahidune"*. Edhe ajetet e kaluara e ato që vijnë më pas, e miratojnë këtë. E vërteta është se fushëbeteja është sprova më e vështirë dhe më e ashpër, në të cilën njeriu rrallë mund të fshehë realitetin e tij.

Me togfjalëshin: **"veprat tuaja"**, nënkuptohen veprat e njerëzve, sepse çdo punë që kryen njeriu, përhapet si lajm mes njerëzve.

Të tjerë kanë thënë se me fjalën *"ahbarun"*, nënkuptohen sekretet e brendshme. Veprat e njerëzve i miratojnë këto sekrete.

Supozohet se fjala *"akhbarun"* të jetë përdorur me kuptimin e lajmeve, të cilat lajmërojnë njerëzit për situatën e tyre, për paktet dhe marrëveshjet e tyre. P.sh, hipokritët i kishin dhënë besën Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, që të mos kthehej nga lufta, se edhe ata do të qëndronin aty, por ata e prishën premtimin e tyre: **"E ata ishin që i patën dhënë më parë besën All'llahut, se nuk do të kthehen prapa** *(nuk do të ikin)***."**.[1]

I shikojmë ata në një situatë tjetër: **"Një grup prej tyre kërkonin lejen e Profetit, duke thënë: 'Shtëpitë tona janë të pambrojtura!'. Edhe pse ata ishin të pambrojtur, në realitet, ata nuk donin tjetër, por vetëm të iknin."**.[2]

All'llahu i Madhëruar i sprovon veprat e njerëzve, ashtu siç i sprovon fjalët dhe lajmet e tyre. Sipas këtij komentimi, këto dy fjali, në ajetin që po komentojmë, kanë dy kuptime të ndryshme, edhe pse njëri prej tyre miraton tjetrin, sipas komentimeve të mëparshme.

E megjithatë, kjo nuk është hera e parë që All'llahu i Madhëruar lajmëron njerëzit se i sprovon për të dalluar radhët e tyre, për të dalluar besimtarët e vërtetë nga ata me besim të dobët, për të njohur hipokritët. Sprovimi i njerëzve është përmendur në shumë ajete të Kur'anit.

[1] Sure "El Ahzab", ajeti 15.
[2] Sure "El Ahzab", ajeti 13.

Kemi diskutuar çështjet që lidhen me sprovimin e All'llahut. Në fund të ajetit 155 të sures "El Bekare" dhe në suren "El Ankebut" kemi diskutuar për sprovimin e All'llahut.

Fjalia: **"...derisa të provojmë ato që thuhen për veprat tuaja."**, nuk do të thotë se All'llahu nuk i njeh, nuk i di ata. Përkundrazi, kjo fjali synon ta vërtetojë këtë informacion me fakte dhe të vërtetojë diturinë e All'llahut të Madhëruar. Pra, të dëshmohet diturria e All'llahut dhe të dallohen radhët.

Ajetet 32 – 34

إِنَّ ٱلَّذِينَ كَفَرُواْ وَصَدُّواْ عَن سَبِيلِ ٱللَّهِ وَشَآقُّواْ ٱلرَّسُولَ مِنۢ بَعۡدِ مَا تَبَيَّنَ لَهُمُ ٱلۡهُدَىٰ لَن يَضُرُّواْ ٱللَّهَ شَيۡـٔٗا وَسَيُحۡبِطُ أَعۡمَٰلَهُمۡ ٣٢ ۞يَٰٓأَيُّهَا ٱلَّذِينَ ءَامَنُوٓاْ أَطِيعُواْ ٱللَّهَ وَأَطِيعُواْ ٱلرَّسُولَ وَلَا تُبۡطِلُوٓاْ أَعۡمَٰلَكُمۡ ٣٣ إِنَّ ٱلَّذِينَ كَفَرُواْ وَصَدُّواْ عَن سَبِيلِ ٱللَّهِ ثُمَّ مَاتُواْ وَهُمۡ كُفَّارٞ فَلَن يَغۡفِرَ ٱللَّهُ لَهُمۡ ٣٤

“Me të vërtetë, ata që nuk besojnë, i pengojnë (të tjerët) **nga Rruga e All’llahut dhe kundërshtojnë të Dërguarin, pasi u është shpjeguar qartë Rruga e drejtë, nuk do t’i sjellin All’llahut kurrfarë dëmi; Ai do t’i zhvlerësojë veprat e tyre.”**

“O ju që keni besuar! Bindjuni All’llahut dhe bindjuni të Dërguarit dhe mos i çoni dëm veprat tuaja!”

“Pa dyshim, ata që nuk besojnë, i pengojnë (të tjerët) **nga Rruga e All’llahut dhe vdesin si jobesimtarë, All’llahu kurrsesi nuk do t’i falë.”**

Komentimi

Ata që vdesin duke qenë jobesimtarë, All'llahu kurrsesi nuk do t'i falë

Pas shumë diskutimeve që u bënë rreth hipokritëve, në ajetet e mëparshme, këto ajete diskutojnë situatën e një grupi tjetër jobesimtar. Ajeti thotë: **"Me të vërtetë, ata që nuk besojnë, i pengojnë** (të tjerët) **nga Rruga e All'llahut dhe kundërshtojnë të Dërguarin, pasi u është shpjeguar qartë Rruga e Drejtë, nuk do t'i sjellin All'llahut kurrfarë dëmi; Ai do t'i zhvlerësojë veprat e tyre.",** edhe sikur të kenë bërë vepra të mira, sepse ato vepra nuk kanë qenë të shoqëruara me besim.

Këta mund të jenë idhujtarët e Mekës, ose jobesimtarët prej çifutëve të Medines, ose mund të jenë të dy grupet, sepse mënyra e shprehjes me **"el kufru"** dhe **"es saddu an sebijlil'lahi"**, si dhe me **"shakkuu er resule"** është përmendur për të të dy grupet në ajetet e Kur'anit.

Ndërsa **"është shpjeguar qartë Rruga e Drejtë"**, u bë nëpërmjet mrekullivë për politeistët mekas dhe për ithtarët e librit nëpërmjet librave qiellorë.

Kurse sifjalia: **"Ai do t'i zhvlerësojë veprat e tyre"**, mund të jetë ose tregues i veprave të mira që mund t'i bëjnë ndonjëherë, si: mikpritja, shpenzimi dhe të ndihmuarit e rrugëtarëve, ose mund të jetë tregues i mosndikimit të planeve dhe kurtheve të tyre kundër Islamit.

E megjithatë, ky grup ishte i përshkruar me tri cilësi: mosbesimi, pengimi në Rrugën e All'llahut dhe kundërshtimi i Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Pra, njëra prej këtyre kishte lidhje me All'llahun e Madhëruar, tjetra me robtë e All'llahut, kurse e treta me të Dërguarin e All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Pasi u sqarua situata e hipokritëve dhe planet e përgjithshme të tyre, ajeti që vjen më pas, e drejton bisedën te besimtarët. Ajeti tregon qartë hapat dhe situatën e tyre. Ajeti thotë: **"O ju që keni besuar! Bindjuni All'llahut dhe bindjuni të Dërguarit dhe mos i çoni dëm veprat tuaja!"**.

Mënyra e jetës së besimtarëve dhe programi i tyre është i kundërt në çdo gjë, me mënyrën dhe programin e jobesimtarëve dhe të hipokritëve, sepse hipokritët dhe jobesimtarët e kundërshtojnë urdhrin e All'llahut të Madhëruar, kurse besimtarët i binden Atij. Hipokritët e kundërshtojnë Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, kurse besimtarët i binden urdhrit të tij. Jobesimtarëve dhe hipokritëve u asgjësohen veprat e tyre, për shkak të mosbesimit dhe dyfytyrësisë së tyre, kurse veprat e besimtarëve janë të ruajtura te All'llahu i Madhëruar dhe për ato do të shpërblehen.

E megjithatë, ajeti shpall se në mesin e besimtarëve ka njerëz që kanë bërë lëshime në bindjen e All'llahut dhe të të Dërguarit të Tij, kanë bërë lëshime edhe në ruajtjen e veprave të tyre nga ndotja me të pavërtetën. Prandaj All'llahu i Madhëruar i paralajmëron ata përmes këtij ajeti.

Këtë e dëshmon shkaku i zbritjes. Për shkakun e zbritjes së këtij ajeti, disa komentues, kanë thënë se Beni Esedët ishin bërë myslimanë dhe erdhën te i Dërguari i All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe i thanë: "Ne të favorizojmë ty para vetes sonë. Ne e populli ynë jemi në dispozicionin tënd dhe të urdhrit tënd.". Por mënyra e të folurit të tyre dukej më shumë si qëndresë. Prandaj zbriti ajeti i mësipërm, që i paralajmëroi ata.

Disa dijetarë, paralajmërimin e kanë argumentuar me sifjalinë: **"...mos i çoni dëm veprat tuaja!"**.

Mirëpo ajeti që po komentojmë, ai para tij e ai pas tij, dëshmojnë se ata nuk kanë lidhje me këtë çështje, por me paralajmërimin që të mos i çojnë dëm veprat e tyre nëpërmjet shirkut, (vënies shok All'llahut), dyfytyrësisë së tyre dhe përfitimeve e të tjera si këto.

Ajeti i fundit, prej ajeteve në fjalë, sqaron, miraton dhe udhëzon për në Rrugë të Drejtë atë që dëshiron pendimin, udhëzon për në rrugën e kthimit mbrapa dhe thotë: "**Pa dyshim, ata që nuk besojnë, i pengojnë** (të tjerët) **nga Rruga e All'llahut dhe vdesin si jobesimtarë, All'llahu kurrsesi nuk do t'i falë.",** sepse dyert e pendimit do të mbyllen me zbritjen e vdekjes dhe këta do të bartin mëkatet e tyre dhe mëkatet e atyre që humbën. E si t'i falë All'llahu ata?!

Për këtë, ka ardhur një hadith për këtë ajet që flet për këta tre grupe: për jobesimtarët, për hipokritët dhe për besimtarët, për cilësitë e secilit prej tyre dhe për përfundimin e tyre.

Hulumtim

Faktorët e asgjësimit të sevapit të veprës

Ndër çështjet kryesore, në të cilat janë përqendruar disa ajete të Kur'anit, si dhe ajeti që po diskutojmë, është paralajmërimi i besimtarëve që të mos u zhduken veprat e tyre si të jobesimtarëve. Thënë ndryshe, vepra e mirë, e vlefshme dhe e dobishme është ajo vepër, që në fillim është e vlefshme dhe e pastër dhe mbetet e tillë, deri në përfundim të jetës.

Faktorët që çojnë drejt zhdukjes së veprave të njeriut apo i kërcënojnë ato me atë rrezik, janë shumë. Disa prej tyre janë:

1- Dhënia për poshtërim. Kur'ani thotë: **"O ju që besuat, mos i prishni lëmoshat tuaja me krenari e me fyerje, siç bën ai që jep pasurinë e vet sa për sy e faqe të njerëzve, e nuk e beson All'llahun e as Botën Tjetër."**.[1]

Këtu përmenden dy faktorë që zhdukin veprat: njëri është dhënia për poshtërim, kurse tjetri është dyfytyrësia dhe mosbesimi. I pari vjen pas veprës, kurse i dyti është shoqërues i të parit dhe të dy janë zjarri që djeg veprat e mira.

2- Vetëkënaqësia është një faktor tjetër që zhduk gjurmët e veprës, siç thuhet në hadith: "*Vetëkënaqësia i ha të mirat, ashtu si zjarri që djeg drutë.*".[2]

3- Smira është një nga këto shkaqe. Ajo që është thënë për të, është e ngjashme me atë që është thënë për vetëkënaqësinë. Është transmetuar nga i Dërguari i All'llahut *(Paqja e bekimi i*

[1] Sure "El Bekare", ajeti 264.
[2] Tefsiri "Ruhul Bejan", vëll. 8, f. 522.

All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!): *"Ruhuni nga zilia, sepse zilia i ha veprat e mira, ashtu si zjarri i ha drutë."*.[1]

Punët e mira i fshijnë punët e këqija: **"S'ka dyshim se veprat e mira i fshijnë të këqijat"**[2], po ashtu edhe veprat e këqija i fshijnë të gjitha të mirat ndonjëherë.

4- Ruajtja e besimit, deri në çastet e fundit të jetës, është kushti më i rëndësishëm në ruajtjen e gjurmëve të veprave, sepse Kur'ani thotë: **"Pasha All'llahun, ty të është shpallur, edhe atyre para teje: 'Nëse i bën shok** (All'llahut), **veprat e tua janë të asgjësuara dhe ti do të jesh prej të humburve.'"**.[3]

Prej këtu mësojmë rëndësinë dhe vështirësitë e ruajtjes së veprave. Imam Bakiri *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: *"Të mbash vazhdimësinë e veprës, është më e vështirë se vepra."* Transmetuesi tha: *"Çfarë është qëndrimi i vazhdueshëm në punë?"* Imam Bakiri *(Paqja qoftë mbi të!)* tha: *"Njeriu bën një të mirë në emër të All'llahut, Një dhe të Vetëm e të pashoq. Kjo i shkruhet atij si një sekret, por ai e përmend atë, kështu që i fshihet ajo si sekret dhe i shkruhet si vepër e dukshme. Përsëri ai e përmend atë dhe ajo përsëri i fshihet dhe i shkruhet atij si dyfytyrësi."*.[4]

Ajeti që po komentojmë tregon në formë të padukshme për këto çështje dhe thotë: **"mos i çoni dëm veprat tuaja!"**.[5]

---

[1] "Biharul Anuar", vëll. 73, f. 255.
[2] Sure "Hud", ajeti 114.
[3] Sure "Ez Zumer", ajeti 65.
[4] "Usulul Kafij", vëll. 2, kreu "Dyfytyrësia", hadithi 16, f. 296.
[5] Për më tepër sqarim dhe analizë të hollë, rreth çështjes së zhdukjes së veprës, shiko fundin e ajetit 217 të sures "El Bekare".

Ajeti 35

فَلَا تَهِنُواْ وَتَدۡعُوٓاْ إِلَى ٱلسَّلۡمِ وَأَنتُمُ ٱلۡأَعۡلَوۡنَ وَٱللَّهُ مَعَكُمۡ وَلَن يَتِرَكُمۡ أَعۡمَٰلَكُمۡ٣٥

“Dhe mos u bëni të dobët e të kërkoni armëpushim, ndërkohë që jeni më të fuqishmit dhe All’llahu është me ju. Ai nuk do t’jua pakësojë (shpërblimin për) **veprat tuaja.”**

Komentimi

Paqja poshtëruese!!

Në vazhdim të ajeteve të kaluara, që flisnin për çështjet e luftës, ky ajet na tregon për ata me besim të dobët, që shtrojnë çështjen e paqes për t’i shpëtuar përgjegjësisë dhe vështirësive të luftës.

Është e padiskutueshme se paqja është shumë më e mirë kur ajo paqja realizon qëllimet e larta islame, ruan nderin, dinjitetin, pozitën, prestigjin dhe madhështinë e myslimanëve, ajo çon në poshtërimin e tyre, në shkatërrimin e fuqisë së tyre, nuk

pranohet. Prandaj ajeti i nderuar thotë se tani që i keni dëgjuar urdhëresat hyjnore për luftë: **"Dhe mos u bëni të dobët e të kërkoni armëpushim, ndërkohë që jeni më të fuqishmit..."**.[1]

Pra, tani që duken qartë shenjat e triumfit dhe të përparimit tuaj, si poshtëroheni dhe pranoni propozimin për paqe, i cili nuk është gjë tjetër, veçse tërheqje prapa dhe mposhtje? Në të vërtetë, kjo nuk është paqe, përkundrazi, është dorëzim dhe nënshtrim që buron nga dobësia dhe kolapsi. Është një lloj kërkese për qetësi dhe kushte të mira. Është e shëmtuar që ju të bartni dënimet e dhimbshme dhe të rrezikshme.

Për të ngritur lart shpirtrat e besimtarëve luftëtarë, ajeti shton: **"...All'llahu është me ju. Ai nuk do t'jua pakësojë** (shpërblimin për) **veprat tuaja."**, sepse s'ka dyshim se, nëse All'llahu është me të, i nënshtrohen të gjithë faktorët e triumfit dhe nuk e ndien kurrë vetminë, nuk ia lejon vetes dobësinë dhe mposhtjen, nuk i dorëzohet armikut në emër të paqes dhe nuk do të lejojë që të shkojnë kot rezultatet e gjakut të shehidëve dhe shpërblimet e tyre.

Fjala *"len jetirekum"*, vjen nga fjala *"el uitru"*, tek. I thuhet atij që i vritet i afërmi i tij dhe mbeti i vetëm *"el uitru"*. Po ashtu vjen edhe me kuptimin mangësi *(en nuksanu)*. Kurse në ajetin që po diskutojmë, është një metaforë e bukur që tregon se All'llahu i Madhëruar nuk do t'ju lërë ju vetëm, madje do t'jua shtojë sevapin e veprave tuaja, e sidomos kur e dini se ju nuk do të hidhni një hap më tej, përveç sa është shkruar për ju. All'llahu

[1] Fjala *"ted'u"* është pa zanore. Ajo është e lidhur me **"mos u bëni të dobët"**. Kuptimi është: Mos u bëni të dobët, që të kërkoni pajtim.

nuk do t'u pakësojë gjë nga shpërblimi juaj, madje do të shumëfishojë nga mirësia dhe bujaria e Tij.

Nga sa thamë, u bë e qartë se ajeti që po komentojmë, nuk e kundërshton ajetin 61 të sures "El Enfal", kur thotë: **"Në qoftë se ata anojnë nga paqja, apo edhe ti anon nga ajo, mbështetu në All'llahun, Ai është që dëgjon dhe di."**.

Secili prej dy propozimeve, ka një kuptim të veçantë, sepse njëri prej tyre shikon nga paqja e logjikshme, kurse tjetri drejt paqes së gënjeshtërt, sepse njëra prej tyre është paqe që mbron interesat e myslimanëve, kurse tjetra është paqe që e propozojnë myslimanët e dobët, kur janë pranë fitores. Prandaj përfundimi i ajetit të sures "El Enfal" thotë: **"Po, nëse duan të mashtrojnë me të** (me paqen), **ty të mjafton All'llahu."**.

Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*, ka treguar për secilën nga këto dy paqe në periudhën e Maliku El Eshtar dhe ka thënë: *"Mos e shmangni një paqe që ua ofron armiku juaj, se, për Zotin, në të ka kënaqësi."*.[1]

Propozimi i paqes nga ana e armikut, nga njëra anë dhe shoqërimi i saj me kënaqësinë, me pranimin e All'llahut të Madhëruar, nga ana tjetër, e bën të qartë ndarjen e paqes në dy pjesë, për të cilat treguam më sipër. E megjithatë, prijësit e besimtarëve duhet të jenë të kujdesshëm në diagnostikimin e kuptimeve të paqes dhe të luftës, të cilat janë nga çështjet më të ndërlikuara, sepse dyshimi më i vogël në llogaritje, do të shkaktojë dënime të rënda.

[1] "Nehxhul Belaga", shkresa 53.

Ajetet 36 – 38

إِنَّمَا ٱلۡحَيَوٰةُ ٱلدُّنۡيَا لَعِبٞ وَلَهۡوٞۚ وَإِن تُؤۡمِنُواْ وَتَتَّقُواْ يُؤۡتِكُمۡ أُجُورَكُمۡ وَلَا
يَسۡـَٔلۡكُمۡ أَمۡوَٰلَكُمۡ ٣٦ إِن يَسۡـَٔلۡكُمُوهَا فَيُحۡفِكُمۡ تَبۡخَلُواْ وَيُخۡرِجۡ
أَضۡغَٰنَكُمۡ ٣٧ هَٰٓأَنتُمۡ هَٰٓؤُلَآءِ تُدۡعَوۡنَ لِتُنفِقُواْ فِي سَبِيلِ ٱللَّهِۖ فَمِنكُم مَّن
يَبۡخَلُۖ وَمَن يَبۡخَلۡ فَإِنَّمَا يَبۡخَلُ عَن نَّفۡسِهِۦۚ وَٱللَّهُ ٱلۡغَنِيُّ وَأَنتُمُ ٱلۡفُقَرَآءُۚ
وَإِن تَتَوَلَّوۡاْ يَسۡتَبۡدِلۡ قَوۡمًا غَيۡرَكُمۡ ثُمَّ لَا يَكُونُوٓاْ أَمۡثَٰلَكُم ٣٨

"Jeta e kësaj bote nuk është asgjë tjetër, veçse lojë dhe zbavitje. Nëse i besoni (All'llahut) **dhe i ruheni** (Atij)**, Ai do t'ju shpërblejë dhe nuk do të kërkojë prej jush pasurinë tuaj."**

"Sikur ta kërkonte prej jush tërë pasurinë me këmbëngulje, ju do të bëheshit koprracë dhe, Ai do të nxirrte në shesh urrejtjen tuaj."

"Ja, juve ju bëhet thirrje të shpenzoni në Rrugën e All'llahut, por disa prej jush janë koprracë. Kush tregohet koprrac, ta dijë se i bën dëm vetes, sepse All'llahu është i Pasur, ndërsa ju jeni të varfër. E, nëse ju ia ktheni shpinën dhe i largoheni Atij, Ai do t'ju zëvendësojë me një popull tjetër, i cili nuk do ta ndjekë shembullin tuaj."

Komentimi

Nëse ju i ktheni shpinën, All'llahu do t'ia japë kumtin një populli tjetër

Surja "Muhammed" është surja e xhihadit, sepse fillon dhe mbaron me urdhrin për xhihad. Ajetet që po komentojmë, të cilat janë ajetet e fundit të kësaj sureje, trajtojnë një çështje tjetër të jetës njerëzore. Ata tregojnë se jeta e kësaj dynjaje nuk ka asnjë vlerë, në qoftë se nuk ndikon në ngjalljen e interesit të myslimanëve për t'iu bindur All'llahut të Madhëruar, në përgjithësi dhe për të mbajtur qëndrimin e duhur ndaj luftës, në veçanti. Ajetet që po komentojmë, tregojnë se dashuria për jetën e dynjasë dhe magjepsja me të, është një nga faktorët që i pengojnë myslimanët nga lufta. Prandaj ajeti thotë: **"Jeta e kësaj bote nuk është asgjë tjetër, veçse lojë dhe zbavitje..."**.

Fjala *"el leibu"* thuhet punët që përshkruhen me një lloj përfytyrimi, për të arritur qëllimin që do, kurse fjala *"el lehvu"*, përdoret për çdo punë që e bën njeriu dhe e largon atë nga çështjet themelore.

E vërteta është se dynjaja është lojë e dëfrim dhe asgjë tjetër. Prej saj nuk përfitohet as kënaqësi dhe as rehati. Ajo nuk ka vazhdimësi dhe qëndrueshmëri të përhershme. Atë e përbëjnë vetëm disa çaste kënaqësie të përkohshme, të cilat i rrethojnë dhimbjet dhe lodhjet.

Më pas ajeti shton: **"...Nëse i besoni** (All'llahut) **dhe i ruheni** (Atij)**, Ai do t'ju shpërblejë dhe nuk do të kërkojë prej jush**

pasurinë tuaj.". As All'llahu nuk kërkon prej jush shpërblim, në këmbim të udhëzimit dhe drejtimit në Rrugën e Drejtë dhe gjithë atyre dhuratave të mëdha në dynja dhe në Ahiret dhe as Profeti i Tij, sepse All'llahu i Madhëruar është i pasur nga të gjitha botët dhe i Dërguari i Tij, nuk ka nevojë për asgjë, përveç All'llahut.

Nëse nga pasuria është marrë si zekat një e pesta dhe të drejta të ligjshme të tjera, pa dyshim se zekati rikthehet te ju dhe shpenzohet nga ju për mbrojtjen e jetimëve tuaj, të të varfërve tuaj, të të dobëtëve tuaj dhe endacakëve, për mbrojtjen e sigurisë së vendeve tuaja dhe pavarësisë suaj, për ruajtjen e sistemit të sigurisë dhe për ndërtimin e banesave tuaja.

Edhe nëse zekati është i vogël, përsëri është për të mirën dhe dobinë tuaj, sepse All'llahu dhe i Dërguari i Tij nuk kanë nevojë për ju. Ky përfundim nuk bie në kundërshtim me nocionin e këtij ajeti dhe të ajeteve të zekatit dhe të shpenzimit në Rrugë të All'llahut.

Ka shumë supozime të tjera për komentimin e fjalisë: **"nuk do të kërkojë prej jush pasurinë tuaj"**.

Disa kanë thënë se All'llahu i Madhëruar nuk ju kërkon juve asgjë nga pasuria juaj, në këmbim të udhëzimit dhe të shpërblimit.

Të tjerë thonë se All'llahu i Madhëruar nuk kërkon prej jush të gjithë pasurinë tuaj, por kërkon vetëm një pjesë të saj.

Një grup tjetër thotë se kjo fjali tregon se të gjitha pasuritë janë nga All'llahu i Madhëruar, edhe nëse janë për pak ditë të depozituara në duart tona.

Më i mirë nga të gjithë, është komentimi i parë. E megjithatë, nuk duhet të harrohet se një anë e luftës është lufta me pasuritë. Është normale se çdo luftë ndaj armikut dhe përleshje

kundër tij, ka nevojë për pasuri dhe buxhete, që duhet të mblidhen e të përgatiten nga myslimanët indiferentë të dynjasë dhe nga ata që nuk janë të lidhur me të. Ajetet që po diskutojmë, janë një bazë ideologjike dhe kulturore për këtë problem.

Për sqarimin e lidhjes së shumicës së njerëzve me pasuritë dhe me thesaret e tyre vetjake, ajeti që vijon, shton: **"Sikur ta kërkonte prej jush tërë pasurinë me këmbëngulje, ju do të bëheshit koprracë dhe, Ai do të nxirrte në shesh urrejtjen tuaj."**.

Fjala *"juhfikum"*, përdoret për të treguar këmbënguljen në një kërkesë, në një lutje. Ajo rrjedh nga fjala *"hefe'"*, që tregon 'të ecurit zbathur'. Kjo mënyrë të shprehuri është një metaforë për veprat që bën vazhdimisht njeriu, deri në kufij.

Fjala *"el edganu"*, është shumësi i fjalës *"dagnun"* dhe ka kuptimin e urrejtjes së madhe. Për këtë kemi folur më parë.

Si përfundim, mund të themi se ajeti tregon se shumë njerëz kanë lidhje të forta me pasuritë. Kjo prirje përbën një pikë të dobët për ta, për të cilën mund t'i qortojmë. Ndonjëherë kjo lidhje e kalon kufirin dhe shkon deri atje sa, sikur All'llahu i Madhëruar t'u kërkonte diçka nga pasuria e tyre, ata do të zemëroheshin me Të! Me këtë konotacion kuptimor, ajeti dëshiron të paralajmërojë njerëzit, që të largohen nga vargonjtë poshtërues të pasurisë dhe të sakrifikojnë sa munden në Rrugë të All'llahut, të japin nga ajo që kanë dhe të mos shpresojnë asgjë tjetër në këmbim të saj, përveç besimit, përkushtimit dhe kënaqësisë së Tij.

Ajeti i fundit i këtyre ajeteve dhe i fundit edhe i sures "Muhammed" miraton edhe një herë ato që janë thënë në ajetet e kaluara rreth çështjeve materiale dhe lidhjes së njerëzve me to, si dhe për çështjen e shpenzimit në Rrugë të All'llahut. Ajeti thotë:

"Ja, juve ju bëhet thirrje të shpenzoni në Rrugën e All'llahut, por disa prej jush janë koprracë...".

Këtu mund të shtrohet pyetja: Me të vërtetë, ajetet e mëparshme kanë përmendur se All'llahu nuk kërkon prej jush pasurinë tuaj? Po, atëherë, si ka urdhëruar ky ajet për shpenzim në Rrugë të All'llahut?

Përfundimi i ajetit i përgjigjet kësaj pyetjeje në dy mënyra. Në fillim thotë:

"...Kush tregohet koprrac, ta dijë se i bën dëm vetes..."[1], sepse rezultati i shpenzimit ju rikthehet juve në dynja dhe në Ahiret, ku pakësohet diferenca klasore dhe shtohet siguria dhe qetësia. Dashuria e pastërtia zënë vendin e armiqësisë dhe të zemërimit.

Në Ahiret, ju do të shpërbleheni me dhurata e begati të mëdha, të cilat nuk mund t'i përfytyrojë zemra e njeriut, në këmbim të çdo derhemi, (ari) dhe dinari, (argjendi) që e shpenzoni me dhurata e begati të mëdha. Ai që bën koprraci, e bën për veten e vet!

Thënë ndryshe, ky shpenzim është më i rëndësishëm se shpenzimi për luftën. Edhe mënyra e të shprehurit me **"në Rrugën e All'llahut"** harmonizohet, gjithashtu, me këtë kuptim.

Përgjigjja tjetër është: **"... sepse All'llahu është i Pasur, ndërsa ju jeni të varfër..."**. All'llahu i Madhëruar nuk ka nevojë për shpenzimin tuaj në Rrugën e Tij, nuk ka nevojë për bindjen tuaj. Ju jeni të varfër dhe keni nevojë për ndihmën e All'llahut të

[1] Fjala *"el bukhlu"*, një herë shoqërohet me *(an)* dhe herë tjetër me *(ala)*. E para do të thotë ndalesë, frenim, kurse për të dytën do të thotë të bërit keq.

Madhëruar, keni nevojë për mirësitë, mëshirën, shpërblimin, bujarinë e Tij në dynja dhe në Ahiret.

Pa dyshim se gjallesat e krijuara, përveç All'llahut të Madhëruar, janë të zhytura në varfëri. I pasur është vetëm All'llahu i Madhëruar dhe askush tjetër. Nëse për një çast të vetëm ndërpritet kujdesi dhe butësia e Tij, atëherë do të përfundojë ekzistenca dhe trupat e tyre do të binin si kufoma të shkatërruara.

Fjalia e fundit paralajmëron të gjithë myslimanët, që t'ia dinë mirë vlerën kësaj mirësie të madhe. Kjo mirësi e All'llahut të Madhëruar ju ka bërë ju mbrojtësit e fesë së Tij të drejtë dhe ndjekësit e të Dërguarit të Tij dhe të shokëve të tij. Ky paralajmërim bëhet që njerëzit të mos pakësojnë respektimin ndaj këtyre mirësive. Ajeti thotë: **"...E, nëse ju ia ktheni shpinën dhe i largoheni Atij, Ai do t'ju zëvendësojë me një popull tjetër, i cili nuk do ta ndjekë shembullin tuaj."**.

Po, ky kumt madhështor nuk mund të ndalojë rrugën e tij, sepse, nëse ju nuk vazhdoni në pozicionimin tuaj që të mbroni fenë e All'llahut të Madhëruar dhe e gjykoni si të vogël çështjen e këtij kumti madhështor, All'llahu i Madhëruar do të sjellë një popull tjetër, që e përballon peshën e këtij kumti. Ata janë një popull që ua kalon juve disa herë në përpjekje, në sakrifica dhe në shpenzimin e pasurisë në Rrugë të All'llahut!

I njëjti mesazh kërcënues përcillet edhe në ajetin 54 të sures "El Maide": **"O ju që besuat! Kush largohet prej jush nga feja e vet,** (i bën dëm vetes)**, s'ka dyshim se All'llahu do ta sjellë një popull që Ai e do atë** (popull) **edhe ata e duan Atë** (Zotin)**,** (një

popull) **që është i përulur e i butë ndaj besimtarëve, por i ashpër dhe i fortë ndaj mohuesve, që lufton në Rrugën e All'llahut dhe që nuk i frikësohet kërcënimit të asnjë kërcënuesi."**.

Është interesante se në fundin e këtij ajeti që po diskutojmë, shumica e komentuesve kanë transmetuar se një grup nga shokët e të Dërguarit të All'llahut e kanë pyetur atë pas zbritjes së këtij ajeti: "Kush janë këta që i ka përmendur All'llahu në librin e Tij?" Selmani ishte ulur afër me Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, dhe Profeti goditi me dorën e tij kofshën e Selmanit. (Në një transmetim tjetër thuhet e goditi në supe) dhe tha: *"Ky dhe populli i tij. Pasha Atë që ka në dorë, shpirtin tim, sikur të pasurve t'u lihej në dorë besimi, atë do ta përqafonin burrat nga Persia."*

Këtë hadith e kanë thënë edhe muhadithët e njohur të traditës Profetike, Bejhakiju dhe Tirmidhiu në librat e tyre të njohur. Për këtë kanë rënë dakord edhe komentuesit e shi'itëve, edhe autori i tefsirit të "Kurtubijut", edhe autori i "Mexhmaul Bejan", Fakhru Razi, Muragij, Ebu Fetuh Err Razij e të tjerë si këta.

Në tefsirin "Ed Durrul Menthur", në këtë kapitull thuhen disa hadithe, në fund të ajetit që po komentojmë.[1]

Nga Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* është transmetuar një hadith tjetër, që e plotëson hadithin e mëparshëm. Hadithi thotë: *"All'llahu i zëvendësoi ata me më të mirë se ata që janë zbatues të porosive."*.[2]

[1] Tefsiri "Ed Durrul Menthur", vëll. 6, f. 68.
[2] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 9, f. 108.

Nëse shikojmë me kujdes dhe me tolerancë historinë dhe shkencat islame, larg fanatizmit, do të kuptojmë pjesëmarrjen e myslimanëve joarabë, veçanërisht iranianët, në mejdanin e xhihadit dhe në luftimin e armiqve, nga njëra anë, kurse, nga ana tjetër, përhapnin dituritë islame, vetëm atëherë do ta kuptojmë të vërtetën e këtij hadithi. Detajet rreth kësaj çështjeje janë të gjata.

O Zot! Na i forco këmbët tona në rrugën e xhihadit, të altruizmit dhe të sakrificës në rrugën e fesë Tënde të drejtë!

O Zot! Mos na i largo ato që na ke dhënë prej krenarisë së madhe, që na ke bërë thirrës në fenë Tënde të pastër!

O Zoti ynë! Na shto fuqinë dhe besimin tonë, sakrificat tona dhe sinqeritetin tonë në këtë kohë që po fryjnë furtunat dhe ciklonet e Lindjes dhe të Perëndimit, për të fshirë gjurmët e fesë Tënde!

Pranoje lutjen tonë , o Zoti, i gjithë botëve!

Fundi i sures "Muhammed"

Përktheu nga ajeti 33 i sures "Xhathije" deri ne fund të sures"Muhammed": **Edmond ABAZI**

SURE "EL FET'H"

Zbritur në Medine, 29 ajete

Përmbajtja e sures

Ashtu siç duket edhe në kuptimin e saj sipërfaqësor, kjo sure bart mesazhin e çlirimit dhe të triumfit ndaj armiqve të Islamit, të çlirimit të plotë dhe të sigurt, qoftë ky çlirim i lidhur me çlirimin e Mekës, me marrëveshjen për paqe të Hudejbijes, a me çlirimin e Hajberit. Këto kuptime përftohen, edhe nëse do t'i referohemi çlirimit, duke konsideruar kuptimin e tij të përgjithshëm.

Që të kuptojmë përmbajtjen e kësaj sureje, para se gjithash, duhet të dimë se ajo ka zbritur në vitin e gjashtë të Hixhretit (pas emigrimit të myslimanëve), pas ngjarjes së marrëveshjes së Hudejbijes.

Kjo tregon se Profeti i nderuar *(Paqja e bekimi e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* kishte vendosur bashkë me shokët e tij, ensarë, muhaxhirë dhe të gjithë myslimanët e tjerë, që të lëviznin në drejtim të Mekës, për të kryer Umren në vitin e gjashtë të Hixhretit. Ai i kishte njoftuar më parë myslimanët se kishte parë në ëndërr, sikur ishte i zënë së bashku me shokët e tij, me kryerjen e ritualeve te Umres në Qabe. Myslimanët kishin veshur rrobat e ihramit, te një vend i quajtur Dhil Hulejfeh (një zonë shumë pranë qytetit të Medines). Ai kishte parë, gjithashtu, sikur kishin lëvizur në drejtim të Mekës së nderuar nëpërmjet deveve që ishin për t'u therur atje, ditën e Hedjit.

Gjendja në të cilën kishte lëvizur Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* zbulon dhe tregon në mënyrë të qartë, se ai nuk kishte asnjë qëllim tjetër, përveçse kryerjen e këtij rituali adhurimi, derisa Profeti mbërriti

në vendin e quajtur Hudejbije (një fshat që ndodhej jo më shumë se njëzet kilometra, në afërsi të Mekës).

Kurejshët e kishin marrë vesh mbërritjen e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* në Hudejbije, ndaj ata ua mbyllën rrugët në fytyrë dhe e ndaluan atë të hynte në Mekën e nderuar.

Kështu, nëpërmjet kësaj nisme, kurejshët zhvleftësuan dhe shkelën me këmbë të gjitha traditat që lidheshin me sigurinë e Xhamisë së Qabes, me miqtë e vizitorët e All'llahut dhe me ligjet e lidhura me muajt (e ndalesës) haram. Kurejshët besonin te shenjtëria e muajve (të ndalesës) haram, duke përfshirë bashkë me të edhe Dhil Kaideh, muajin në të cilin Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* kishte vendosur të kryente ritualin e Umres. Ata besonin gjithashtu, se kur njerëzit të kenë veshur rrobat e ihramit, nuk duhet të cenohen. Pra, edhe sikur i veshuri "muhrimi', të ketë vrarë më parë dikë prej burrave të tyre, ai nuk mund të preket, të dëmtohet apo të cenohet në, asnjë rast.

Ndodhi çfarë ndodhi, prej fjalëve e replikave ndërmjet Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe kurejshëve, në vendin e quajtur Hudejbije, derisa më në fund vendosën të nënshkruanin marrëveshjen e paqes ndërmjet myslimanëve dhe idhujtarëve, banorë të Mekës. Kjo marrëveshje u quajt Marrëveshja e Hudejbijes, për të cilën do të flasim më hollësisht në faqet e mëposhtme.

Në të gjitha rastet e parashikuara në marrëveshje, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* u ndalua të hynte në Mekë, për të kryer ritualet e Umres.

Kështu, i gjendur në vështirësi, u detyrua të urdhëronte shokët e tij, që të thernin devetë, të qethnin kokat e tyre, të zhvishnin rrobat e ihramit dhe më pas të ktheheshin në Medine.

Përballë kësaj situate të nderë, myslimanët u gjendën nën trysninë e një zemërate të thellë dhe të një furtune ankthi, deri në atë pikë, sa dyshimet filluan të lindnin te zemrat e disa personave me besim të dobët.

Transmetohet që Abdullah ibn Mes'udi të ketë thënë: "Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* u drejtua nga Hudejbija, derisa deveja e tij filloi të rëndohej. Kur u afruam tek ai, All'llahu i zbriti ajetin: **'Ne të dhamë ty një fitore të qartë.'**. E dalluam lumturinë që e përshkonte fytyrën e tij. Ai na njoftoi se ajeti sapo i ishte zbritur."[1]

Nisur nga sa thamë më sipër, duket qartë kjo gjendje e veçantë mbizotëron në të gjithë suren. Duke iu kthyer një rishikimi të përgjithshëm të saj, mund të themi se ajo është e përbërë nga shtatë pjesë:

1- Surja fillon me çështjen e sihariqit të çlirimit, sikurse edhe ajetet e tjera të sures kanë lidhje me të njëjtën çështje. Ne këtë sure theksohet dhe vërtetohet realizimi i ëndrrës së Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, e cila kishte si objekt hyrjen e Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe të shokëve të tij në Mekë dhe kryerjen e ritualeve të Umres atje.

[1] Shkurtim nga tefsiri "Mexhmaul Bejan", komentimi i Kum'mit dhe nga tefsiri "Fi Dhilalil Kur'an".

2- Një tjetër pjesë e kësaj sureje flet për ngjarjet e lidhura me marrëveshjen e paqes së Hudejbijes, zbritja e qetësisë mbi zemrat e besimtarëve, *"bej'at err'rrid'uan"*, etj.

3- Një pjesë e tretë e sures flet për pozitën e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe qëllimin e tij të lartë.

4- Pjesa e katërt e ngre perden ndaj tradhtisë së hipokritëve, shkeljes dhe prishjes nga ana e tyre të marrëveshjes, sikurse jepen të tjerë shembuj nga justifikimet e tyre të kota e të sajuara, që lidhen me mospërfshirjen e tyre te lufta e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* me idhujtarët dhe me jobesimtarët.

5- Në një pjesë tjetër hidhet dritë mbi kërkesat e kota të hipokritëve.

6- Në pjesën e gjashtë bëhet e qartë se cilët janë ata persona që konsiderohen të justifikuar.

7- Në fund, pra, në pjesën e shtatë, flitet për veçoritë e shokëve dhe të pasuesve të Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* në rrugën, traditën e tij, si cilësitë nëpërmjet të cilave veçohet secili prej tyre. Përgjithësisht, ajetet e kësaj sureje janë shumë të ndjeshme, sikurse janë vendimtare dhe mësimdhënëse, veçanërisht për myslimanët e sotëm, të cilët përballen me ngjarje dhe zhvillime të ndryshme në shoqëritë e tyre.

Mirësia e leximit të sures "El Fet'h"

Vihen re transmetime të çuditshme te burimet islame, për sa u përket vlerave të kësaj sureje. Një hadith që e transmeton Enesi, thuhet: *"Kur po ktheheshim nga Hudejbija, pasi kurejshët na kishin ndaluar të hynim në Mekë, për të kryer ritualet e Umres dhe kishim shumë ankth e mërzi, All'llahu i Madhëruar zbriti ajetin*: **'Ne të dhamë ty një fitore të qartë.'"**.

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: *"Mua mu shpall një ajet që është më i dashur për mua se e gjithë bota."*. Te disa transmetime të tjera, thuhet: *"Mua mu shpall një sure, më e dashur për mua se e gjithë bota."*.[1]

Abdullah Ibn Mes'udi thotë: *"Kur po ktheheshim nga Hudejbija dhe Profetit Muhammed (Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) i zbriti ajeti*: **'Ne të dhamë ty një fitore të qartë.'**, ai u përfshi nga një gëzim, të cilin vetëm All'llahu mund ta dijë e ta vlerësojë.".[2]

Në një hadith tjetër të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, lexojmë: *"Ai që e lexon atë, do të konsiderohet sikur të ketë qenë me Muhammedin, ditën e çlirimit të Mekës."*. Në një transmetim tjetër lexojmë: *"Do të konsiderohet sikur të ketë qenë duke i dhënë besën Profetit Muhammed (Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) nën pemë."*.[3]

---

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 9, f. 108.
[2] Burimi i mëparshëm, f. 109.
[3] Burimi i mëparshëm, f. 109.

Në fund, lexojmë një hadith të Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*: *"Mbrojini paratë, gratë dhe robërit e robëreshat tuaja prej shkatërrimit, duke lexuar (Ina fetahna). Për të gjithë ata që e lexojnë atë në vazhdimësi, në Ditën e Gjykimit do të thërrasë një thirrës, aq sa do ta dëgjojnë të gjitha krijesat: 'Ti je prej robve të sinqertë të All'llahut! Merreni dhe bashkojeni me të ndershmit e të devotshmit prej njerëzve, futeni në Xhennetet e begata, jepini të pijë nga Rahiki Makhtumi (pije e shijshme në Xhennet) me shijen e kafurit."*.[1]

Është e qartë se e gjithë kjo mirësi dhe krenari, nuk mund të realizohet nëpërmjet një këndimi të zhveshur prej mendimit dhe meditimit. Përkundrazi, qëllimi i vërtetë prej leximit të kësaj sureje është zbatimi i veprave të cituara prej lexuesit, i natyrës dhe i edukimit të tij, ashtu siç i parashikon edhe përmbajtja e sures.

[1] "Theuabul A'mal", siç është përmendur në tefsirin "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, f. 46.

Ajeti 1

بِسۡمِ ٱللَّهِ ٱلرَّحۡمَٰنِ ٱلرَّحِيمِ

إِنَّا فَتَحۡنَا لَكَ فَتۡحًا مُّبِينًا١

Me emrin e All'llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

"Ne të dhamë ty një fitore të qartë."

Komentimi

Çlirimi, ndihma, fitorja e madhe

Tek ajeti i parë i kësaj sureje, shfaqet një sihariq shumë i madh për Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Ky lajm, sipas disa transmetimeve përfaqëson dashurinë më të madhe për Profetin se sa bota dhe çfarë gjendet në të. Ajeti thotë: **"Ne të dhamë ty një fitore të qartë."**.

Fraza **"...fitore të qartë..."** shfaq ndikimet e saj (të ndihmesës, çlirimit) afatshkurtra dhe afatgjata në jetën e myslimanëve. Kjo konsiston në mënyrën e përhapjes së Islamit, si një rast shumë i rrallë, ose fare i paprecedent përgjatë gjithë historisë së Islamit dhe shtrirjes së tij në kohë.

Lidhur me këtë rast, mund të thuhen shumë fjalë dhe mund të bëhen shumë punë kërkimore prej komentuesve të Kur'anit, për atë çka nënkuptohet me (çlirimin, ndihmesën) llojin dhe natyrën e saj. Ç'lloj ndihmese ishte ajo?

Pjesa më e madhe e komentuesve e konsiderojnë atë si një tregues për atë pjesë të ndihmesës së madhe të Zotit, që ua rezervoi myslimanëve në kohën e Marrëveshjes së Hudebijes.[1] Të tjerë ishin të mendimit se ajeti flet për çlirimin e Mekës. Disa të tjerë thanë se ajeti flet për çlirimin e Khajberit.

Një grup tjetër komentuesish thanë se ajeti nënkupton zbulimin e të gjitha dijeve që Zoti bëri për Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Pavarësisht gjithçkaje, ekzistojnë shumë supozime të tjera, të cilat vërtetojnë se çlirimi apo ndihma në fjalë, është e lidhur me ngjarjen e Hudejbijes.

[1] Këtë komentim e kanë përzgjedhur një grup komentuesish si: Ebul Futuh Err Rrazi tek tefsiri i tij, El Alusij tek "Ruhul Mea'anij", El Fejdul Kashanij tek tefsiri "Es Safi" dhe eruditi Tabatabai tek "Mizan" Ndërkohë që të tjerë komentues preferojnë t'i japin të drejtë mendimit se ajo që kuptohet me këtë çlirim, është çlirimi i Mekës, ashtu siç është përmendur te tefsiri "Et Tibjan" i Et Tusij, "El Kesh'shaf" i Zemekhsheriut, tefsiri i Fekhr Rrazit dhe të tjerë tefsire. Ndërsa eruditi Tabrasij ka bashkuar dy mendime te vepra "Mexhmaul Bejan", duke theksuar se anon më shumë te mendimi i grupit të dytë.

Përpara se të depërtojmë te komentimi i ajeteve të tjera, është mirë të paraqesim qoftë dhe në mënyrë të përmbledhur historinë e Marrëveshjes së paqes së Hudejbijes, në mënyrë që ky rast të qartësohet dhe përmbledhja e shkurtuar e tij të jetë edhe në vend të arsyes apo shkakut të zbritjes së ajetit.

Historia e paqes së Hudejbijes

Në muajin Dhil Kaideh të vitit të gjashtë të hixhretit, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* iu drejtua Mekës për të kryer ritualet e Umres, pasi kjo ishte edhe dëshira e madhe e të gjithë myslimanëve. Ndërkohë, pjesa më e madhe e ensarëve, e muhaxhirëve dhe një pjesë e banorëve të fshatrave në shkretëtirë vendosën ta kryenin Umren[1] dhe u nisën bashkë me Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, përveç një pjese tjetër, që u ndalën dhe u stepën.

Myslimanet që shkuan me Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, numri i të cilëve ishte përafërsisht një mijë e katërqind (1400), veshën rrobat e ihramit dhe nuk mbanin me vete asnjë lloj armatimi, përveç shpatave që konsideroheshin në atë kohë si armë udhëtarësh.

[1] Fjala *"el i'timar"* buron nga fjala *"i'temere"* dhe *"el umretu"* ose origjina, burimi i emrit Umër. Te dyja rrënjët kanë të njëjtin kuptim nga ana gjuhësore: vizitë e veçantë. Në këto dy raste, kemi të bëjmë me vizitën e Shtëpisë së All'llahut, në veçanti.

Kur Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* mbërriti në *"Isfan"* (një vend jo shumë larg Mekës) u lajmërua se kurejshët kishin vendosur dhe kishin planifikuar, që ai të mos hynte në Mekë. Kur Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* mbërriti në Hudejbije (fshat i ndodhur njëzet kilometra në afërsi të Mekës. U quajt ashtu, sepse aty gjendej një pemë e caktuar, a një burim), i urdhëroi shokët e tij të zbarkonin dhe nëpërmjet një mrekullie, ai nxori ujë për ta prej burimit të ndodhur aty. Më pas, ambasadorët dhe përfaqësuesit e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* filluan të kontaktojnë me ambasadorët dhe përfaqësuesit e kurejshëve, në mënyrë që ta zgjidhnin këtë çështje me çdo lloj mënyrë të mundshme. Më në fund, te Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* erdhi Urvetu ibn Mes'ud Eth Thekafij, një burrë serioz e i vendosur.

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i tha atij: "*Ne nuk kemi ardhur për të luftuar askënd, por kemi ardhur për të kryer Umren.*". Ndërkaq Urvetu Thekafij kishte vënë re shokët e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, teksa merrte abdes, si e kishin marrë atë në patronazh dhe nuk lejonin asnjë pikë uji prej abdesit të tij të binte në tokë.

Kur Urvetu u kthye te kurejshët, u tha: "Kam shkuar tek pallatet e Kisras, të Kajzerit dhe të Nexhashiut dhe nuk kam parë një lider kaq madhështor si Muhammedi, ndërmjet shokëve të tij. Ai, gjithashtu, i tha një burri nga kurejshët: Nëse e imagjinoni se shokët e Muhammedit mund ta lenë vetëm atë, duhet ta dini se gaboheni rëndë. Ju keni përballë njerëz të atillë që sakrifikojnë

veten e tyre, kështu që duhet ta dini mirë se me cilët do të përballeni.”.

Më pas, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All’llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e urdhëroi Amrin të shkonte në Mekë, që ta njoftonte parinë dhe fisnikët vendas për qëllimet e udhëtimit të tij, por ai i kërkoi ndjesë Profetit, duke e informuar atë se ndërmjet tij dhe kurejshëve kishte një armiqësi të madhe, prej të cilës ai duhet të ruhej vazhdimisht dhe të bënte kujdes. Ndërkohë, ai i sugjeroi Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All’llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* se do të ishte më mirë të dërgonte Uthman ibn Afanin për ta kryer këtë mision. Uthmani shkoi në Mekë.

Pa kaluar shumë kohë, pasi Uthmani kishte shkuar në Mekë, ndërmjet myslimanëve u përhap lajmi se Uthmani ishte vrarë. Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All’llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* u përgatit të përballej fuqimisht me kurejshët! Ai i kërkoi shokëve të tij rinovim të bej’atit (besëlidhjes) dhe ata ia dhanë besëlidhjen nën pemë dhe kjo besëlidhje u quajt *Bej’atu er Riduan*, Besëlidhja e Riduanit. Ata lidhën besën për të vazhduar luftën dhe përpjekjet deri te njeriu i fundit. Nuk kaloi shumë kohë dhe Uthmani u kthye shëndoshë e mirë. Kurejshët kishin dërguar Suhejl ibn Amrin për të kryer marrëveshjen e paqes me Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All’llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Në atë marrëveshje theksohej se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All’llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nuk do të mund të hynte fare në Mekë atë vit.

Pas bisedimeve të zgjatura, u nënshkrua marrëveshja e paqes ndërmjet dy palëve. Prej neneve të kësaj marrëveshjeje,

ishin ato që i përmendëm edhe më sipër, se myslimanët duhet të hiqnin dorë prej kryerjes së Umres për atë vit dhe të ktheheshin në vitin e ardhshëm, me kusht që të mos qëndronin në Mekë më shumë se tri ditë, të mos mbanin armë të tjera, përveç atyre që konsiderohen si armë udhëtimi, sikurse kishte edhe nene të tjera të cilat trajtonin dhe përcaktonin çështje të lidhura me ruajtjen e jetës, pasurisë që u përkiste myslimanëve që vinin në Mekë nga Medina.

Të tjera nene përcaktonin, gjithashtu, ndalimin e luftimeve ndërmjet myslimanëve dhe kurejshëve për një periudhë kohore dhjetëvjeçare, sikurse ishte vendosur gjithashtu që myslimanët e Mekës të lejoheshin të kryenin ritualet, adhurimet dhe obligimet e tyre fetare.

Ky nënshkrim, apo kjo marrëveshje, ndalonte përkohësisht hyrjen në luftë ndërmjet idhujtarëve (mushrikëve) dhe myslimanëve, si dhe betejat e vazhdueshme ndërmjet tyre.

Përmbajtja e marrëveshjes ishte në këtë formë:

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i tha Aliut të shkruante: "Me emrin e All'llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit!".

Suhejl ibn Amri, i cili ishte përfaqësuesi i kurejshëve tha: "Nuk e njoh këtë fjalë, ndaj le të shkruhet: 'Në emrin Tënd, Zoti ynë!'".

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i tha Aliut: "Shkruaj o Ali: 'Në emrin Tënd, Zoti ynë.' Më pas i tha sërish Aliut: "Shkruaj: 'Këto janë çështjet

për të cilat i Dërguari i All'llahut, Muhammedi, ka nënshkruar marrëveshje paqeje me Suhejl ibn Amrin.'".

Suhejli tha: "Po ta dinim se je i Dërguari i All'llahut, nuk do të kishim luftuar e për këtë arsye, shkruaj vetëm emrin tënd dhe të babait.".

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* tha: "Asnjë pengesë nuk ka për këtë. Shkruaj: Këto janë çështjet, për të cilat Muhammedi, i biri i Abdullahit, ka nënshkruar marrëveshje me Suhejl ibn Amrin. Të ndalet lufta për një periudhë dhjetëvjeçare, që njerëzit të rigjejnë sigurinë e tyre të humbur. Gjithashtu, në rast se dikush prej kurejshëve vjen pa lejen e të parëve të tij për të pranuar Islamin te Muhammedi, ai duhet të kthehet mbrapsht te familja e tij, ndërsa, nëse shokët e Muhammedit kthehen te kurejshët, nuk është e detyrueshme t'i kthehen mbrapsht atij.

Të gjithë janë të lirë, ndaj kush të dëshirojë, mund të hyjë në mbrojtjen e Muhammedit dhe kush të dëshirojë, mund të hyjë në mbrojtjen e kurejshëve.

Të dyja palët zotohen që anëtarët e tyre të mos tradhtojnë njëri-tjetrin dhe të respektojnë shenjtërinë e jetës dhe të pasurisë së secilit.

Më pas, në marrëveshje përcaktohet, gjithashtu, se Muhammedi nuk ka të drejtë të hyjë në Mekë për këtë vit, por ai mund të hyjë vitin e ardhshëm. Pasi të kenë dalë kurejshët nga Meka, për tri ditë, mund të hyjë Muhammedi dhe shokët e tij për të kryer ritualet e Umres, me kusht që të mos qëndrojnë aty më shumë se tri ditë dhe më pas mund të vizitojnë familjet e tyre në

Mekë, me kusht që të mos mbajnë me vetë asnjë armë, përveç atyre të klasifikuara si armë të ushtarit, por edhe këto të jenë të mbuluara dhe të mos demonstrohen.".

Ali ibn Ebu Talibi *(Paqja qoftë mbi të!)* ishte shkruesi i deklaratës. Dëshmitarë të saj ishin një grup prej kurejshëve dhe një grup prej myslimanëve.[1]

Eruditi El Maxhlisij përmend disa nene të tjera të kësaj marrëveshjeje te libri i tij "Biharul Anuar", ndër të cilat, janë:

- Islami në Mekë të mos zbatohet më në gjendje të fshehur.

- Askush nuk duhet të detyrohet me dhunë të zgjedhë fenë e tij.

- Myslimanët nuk duhet të keqtrajtohen prej mushrikëve.[2]

Në këtë situatë, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* urdhëroi të thereshin devetë, të cilat myslimanët i kishin sjellë me vete, sikurse i urdhëroi ata që të qethnin kokat e tyre dhe të zhveshin rrobat e ihramit.

Për disa myslimanë, kjo ishte një situatë e dhimbshme, e papranueshme, e cila nuk mund të kapërdihej lehtë, sepse, sipas tyre, zhveshja e rrobave të ihramit, pa i kryer ritualet e Umres ishte e pamundur. Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* filloi vetë i pari dhe e theri *(hedjin)* kurbanin e tij, zhveshi rrobat e ihramit dhe myslimanët kuptuan dhe nisën të ndiejnë se ky rast përbën një përjashtim në

[1] Transmetohet nga "Tarikhu" i Tabariut, vëll. 2, f. 281.
[2] "Biharul Anuar", vëll. 20, f. 352.

rregulloren dhe kushtet e ihramit, i përcaktuar nga vetë Zoti për të Dërguarin e tij.

Sapo myslimanët dëshmuan sjelljen e Profetit të tyre, u nënshtruan ndaj realitetit të ri. Ata i zbatuan me përpikëri udhëzimet e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe vendosën që prej atje t'i drejtoheshin Medines. Disa prej tyre ndienin sikur një mal i madh dhimbjeje dhe keqardhjeje shtrëngonte gjokset e tyre, pasi në pamje të parë e gjithë historia e udhëtimit të tyre rezultoi e pasuksesshme dhe ishte një situatë dështimesh të mëdha. Të gjithë këta njerëz dhe ata që mendonin njëlloj me ta, nuk i dinin fitoret dhe sukseset që e prisnin Islamin dhe myslimanët pas paqes se Hudejbijes. Kjo ishte koha kur zbriti surja "Fet'h", e cila e njoftoi Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* me sihariqin e madh, ndihmën e madhe të All'llahut.[1]

Ndikimet politike, shoqërore dhe fetare të paqes së Hudejbijes

Gjithçka qartësohet, nëse krahasojmë gjendjen e myslimanëve në vitin e gjashtë të Hixhretit (pra, në kohën e marrëveshjes se Hudejbijes) dhe gjendjen e tyre pas dy vitesh, kur myslimanët vërshuan drejt Mekës për ta çliruar atë me dhjetë mijë luftëtarë dhe për t'ju kundërpërgjigjur fort tradhtisë së kurejshëve

[1] Shih "Sijretu Ibn Hashim", vëll. 3, f. 321-324 dhe tefsiri "Mexhmaul Bejan", tefsiri "Fi Dhilalil Kur'an", "El Kamil" i Ibnil Ethir, vëll. 3 dhe burime të tjera (me pak shkurtim sigurisht).

dhe prishjes së marrëveshjes nga ana e tyre, pa asnjë lloj konfrontimi e beteje, pasi kurejshët nuk e panë veten të aftë të zhvillojnë asnjë lloj rezistence.

Në një krahasim të përgjithshëm të situatave, vihet re, gjithashtu, rrezja e gjerë e kundërpërgjigjes, e shkaktuar prej marrëveshjes së Hudejbijes.

Shkurtimisht mund të themi se, për shkak të marrëveshjes se Hudejbijes, myslimanët përfituan shumë privilegje dhe fitore të madhe. Ato ishin:

1- I treguan praktikisht çorientuesve të Mekës, që përhapnin gënjeshtra e panik se ata nuk kishin asnjë qëllim lufte apo derdhjen e gjakut, se ata e nderojnë dhe e respektojnë Mekën dhe Qaben e saj të shenjtë. Kjo e fundit u bë shkak që të çliroheshin dhe të hapeshin drejt Islamit shumë prej zemrave të banorëve të Mekës.

2- Për herë të parë kurejshët e njohën zyrtarisht Islamin dhe myslimanët, aspekt ky që ndihmoi në forcimin e pozitës së tyre në Gadishullin Arabik.

3- Pas Marrëveshjes së Hudejbijes, myslimanët arritën të udhëtonin sa herë dëshironin dhe ku të dëshironin, pa pasur frikë se do t'i cënohej jeta dhe pasuria e tyre. Kjo nxiti rritjen e afrimitetit të tyre me idhujtarët *(mushrikët)*, njohjen e tyre më nga afër me Islamin dhe promovimin e tij ndër ta.

3- Marrëveshja e Hudejbijes përgatiti terrenin për përhapjen masive të Islamit në Gadishullin Arabik. Qëndrimi pozitiv i Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ndaj pajtimit të fiseve arabe ndikoi shumë në

ndryshimin e qëndrimeve dhe të pikëpamjeve të tyre ndaj fesë islame dhe ndaj Profetit të nderuar, sikurse u dha myslimanëve liri dhe hapësira aq të nevojshme thirrëse e propagandistike lidhur me këtë aspekt.

4- Marrëveshja e Hudejbijes përgatiti, gjithashtu, terrenin e nevojshëm për çlirimin e Khajberit, që konsiston në shkuljen dhe çrrënjosjen e kësaj gjëndre kancerogjene (të përfaqësuar prej çifutëve). Ata përfaqësonin një rrezik real të konkretizuar me vepër dhe forcë kundër Islamit dhe myslimanëve.

5- Droja e kurejshëve nga përballja me egërsinë e një numri modest luftëtarësh, e përcaktuar në marrëveshjen e Hudejbijes, ishte, në vetvete, një faktor shumë i rëndësishëm për të ngritur lart moralin e myslimanëve dhe për të thyer vendosmërinë e armiqve të Islamit, deri në atë shkallë, sa nuk mund ta fshihnin frikën nga përballja ushtarake me myslimanët.

6- Pas marrëveshjes së Hudejbijes, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* shkroi dhe dërgoi disa letra për krerët e shteteve të mëdha të kohës (Iran, Perandoria Romake, Habeshe), si dhe për mbretërit më të spikatur të botës, duke i ftuar ata në fenë islame. Ky është një tjetër tregues se Marrëveshja e Hudejbijes i armatosi myslimanët me besim te vetvetja, duke mos e lënë thirrjen e tyre vetëm në rang të Gadishullit Arabik, por në të gjithë botën.

Le t'u kthehemi tani komentimit të ajeteve.

Nga gjithçka u përmend më lart, mund të kuptojmë më mirë, se Marrëveshja e Hudejbijes ishte, me të vërtetë, një triumf për Islamin, një çlirim e ndihmesë e madhe për Islamin dhe

myslimanët, ç'ka e përjashton mundësinë e habisë nga përshkrimi që Kur'ani i bën, duke e konsideruar si një fitore të madhe dhe ndihmë të qartë, që nuk përmban asnjë dyshim.

1- Fjala *"fetahna"*, e cila është përdorur si folje në kohën e shkuar, tregon se ndihma e Zotit ka ardhur që kur Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i zbritën ajetet, paçka se deri në atë kohë, asgjë nuk kishte ndodhur, përveç Marrëveshjes së Hudejbijes.

2- Koha e zbritjes së ajeteve, që i përmendëm më lart dhe të ajeteve të tjera të sures, të cilat vlerësonin dhe lavdëronin besimtarët dhe kritikonin ashpër hipokritët, në kohën e Marrëveshjes se Hudejbijes, janë gjithashtu një tregues tjetër që lidhet ngushtë me këtë kuptim. Ajeti 27 i sures "Fet'h" vjen për të përforcuar realizimin e ëndrrës që kishte parë Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Ajeti thotë**: "All'llahu e përmbushi me të vërtetë vizionin e të Dërguarit të Tij, i cili kishte thënë: 'Me siguri, ju do të hyni në Xhaminë e Shenjtë, dashtë All'llahu, të sigurt, kokërruar dhe flokëshkurtuar, pa kurrfarë frike.'. Ai e dinte atë që nuk e dinit ju dhe, veç kësaj, ju dhuroi një fitore të afërt."**. Kjo është dëshmi e qartë, gjithashtu, se kjo sure ka zbritur pas Marrëveshjes së Hudejbijes dhe para çlirimit të Mekës.

3- Ekzistojnë shumë transmetime të tjera, të cilat e konsiderojnë Marrëveshjen e Hudejbijes si (Fitore të madhe) çlirim dhe ndihmë e madhe e të qartë. Ndër këto transmetime përmendim: tefsirin "Xheuamiul Xhami'i", ku tregohet se gjatë kohës kur Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* po kthehej nga Hudejbija dhe i zbriti kjo

sure, ai i tha njërit prej shokëve të tij: "Ç'është ky Fet'h (fitore)?! U përzumë nga Shtëpia e All'llahut dhe u ndalua kurbani ynë.". Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* tha: "*Sa fjalë e ulët është kjo. Në të vërtetë, ai ishte një çlirim i madh dhe i qartë, pasi idhujtarët u kënaqën, kur ju larguan ju prej vendeve të tyre drejt periferive dhe ishin ata që e kërkuan marrëveshjen prej jush; kërkuan prej jush sigurinë, ndërkohë që kishin përjetuar prej jush atë që e urrejnë.*".[1]

Pastaj, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* u rikujtoi atyre (besimtarëve) ngjarjen më të cilën u përballën idhujtarët mbrëmjen e Betejës së Bedrit dhe në ditën e Betejës Ahzab. Myslimanët e besuan të Dërguarin e Zotit dhe ranë dakord me të, për faktin se kjo ishte njëra nga ndihmat më të mëdha të Zotit dhe nuk kishin pasur njohuri të mjaftueshme, kur ishin shprehur ndryshe më parë.[2]

Ez Zuhrij, një prej tabi'inëve, thotë: "Nuk ka pasur kurrë më parë sukses, fitore dhe ndihmë më të madhe se sa ajo e Hudejbijes, pasi bashkimi, bashkëjetesa dhe përzierja e besimtarëve me mushrikët e Mekës u dha këtyre të fundit mundësinë që të dëgjojnë për fenë islame, ta përvetësojnë atë për zemrat e tyre. Kjo rezultoi që brenda tre vjetësh njerëzit ta pranojnë Islamin masivisht dhe të shtojnë radhët e tij në të ardhmen.".[3]

Te këto hadithe, përveç privilegjeve të shumta, të cilat i përfituan myslimanët, ka tregues të qartë edhe për bereqetin dhe mirësinë që përfaqësonte Marrëveshja e Hudejbijes.

---

[1] "Xheuamiul Xhami'i", sipas tefsirit "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, f. 48, Hadithi 9

[2] Tefsiri "Ed Durrul Menthur", vëll. 6, f. 67.

[3] Burimi i mëparshëm, f. 109.

Ekziston një hadith i vetëm i transmetuar nga Imam Rizai *(Paqja qoftë mbi të!)* ku thuhet: **"Ne të dhamë ty një fitore."**, ka zbritur pas çlirimit të Mekës.[1]

Gjithashtu, mundet që këtë transmetim të fundit, ta orientojmë thjesht drejt kuptimit që Marrëveshja e Hudejbijes i parapriu çlirimit të Mekës dhe kështu shmangim problematikën e tij.

E thënë ndryshe, Marrëveshja e Hudejbijes ishte shkaku i çlirimit të Hajberit për një kohë të shkurtër (në vitin e shtatë të hixhretit). Ajo, për më tepër, ishte shkak për çlirimin e Mekës (viti i tetë i hixhretit), si dhe për triumfin e Islamit në aspekte të ndryshme të lidhura me ndikimin në rritje të Islamit te zemrat e njerëzve.

Duke iu referuar asaj që u përmend më lart, mund të bashkojmë ndërmjet katër tefsireve, kushtëzuar prej faktit se Marrëveshja e Hudejbijes ka qenë boshti thelbësor i të katër tefsireve.

[1] Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, f. 48.

Ajetet 2 – 3

لِّيَغْفِرَ لَكَ ٱللَّهُ مَا تَقَدَّمَ مِن ذَنۢبِكَ وَمَا تَأَخَّرَ وَيُتِمَّ نِعْمَتَهُۥ عَلَيْكَ
وَيَهْدِيَكَ صِرَٰطًا مُّسْتَقِيمًا ۝ وَيَنصُرَكَ ٱللَّهُ نَصْرًا عَزِيزًا ۝

"Për të t'i falur ty All'llahu gabimet e mëparshme dhe të ardhshme, për ta plotësuar dhuntinë e Vet ndaj teje dhe për të të udhëzuar në Rrugën e Drejtë."

"Dhe që All'llahu të të japë ndihmë të madhe."

Komentimi

Rezultatet e mëdha të fitores së madhe

Te ajeti në fjalë paraqiten rezultatet e bekuara të fitores së madhe (Marrëveshja e Hudejbijes), e cila është përmendur edhe tek ajetet e mësipërme, ku citohet: Kështu, All'llahu i Madhëruar i ofroi Profetit të tij të nderuar katër dhurata të rralla: *El magfireh - faljen*, *Itmamun'ni'meh - plotësimin e mirësive*, *El hidajeh - udhëzimin* dhe *En nusreh -ndihmën*.

Dy hulumtime

1- Përgjigje për disa pyetje të rëndësishme

Janë shumë pyetje, të cilat i kanë ngacmuar komentuesit e Kur'anit prej një kohe të gjatë e deri në ditët e sotme, duke i shtyrë ata të ofrojnë përgjigjet e tyre rreth këtyre pyetjeve.

Prej këtyre pyetjeve, janë tri pyetjet e mëposhtme, rreth Fjalës së Zotit të Lartësuar, me të cilën iu drejtua Profetit të Tij: **"Për të t'i falur ty All'llahu gabimet e mëparshme dhe të ardhshme."**. Ato pyetje janë:

1- Meqennëse Profeti i nderuar konsiderohet i pagabueshëm, atëherë çfarë qëllimi ka thënia: **"Për të t'i falur ty All'llahu"**?!

2- Edhe sikur të vendosim ta tejkalojmë këtë problematikë, cila mund të jetë lidhja ndërmjet faljes, çlirimit, dhe Marrëveshjen së Hudejbijes?!

3- Nëse ajo që All'llahu i Lartësuar synon të thotë me: **"...dhe të ardhshme."** është treguese për mëkatet e tij të ardhshme, atëherë mëkatet e të ardhmes, si mund të jenë objekt i faljes dhe i tolerimit? A nuk jepet leja e kryerjes së mëkatit nëpërmjet kësaj thënieje?

Secili komentues i Kur'anit ka dhënë një përgjigje të veçantë, lidhur me secilën prej problematikave të hasura te këto kuptime, por për të përftuar një përgjigje të plotë e të përmbledhur rreth këtyre problematikave, si dhe komentimin e

detajuar të këtyre ajeteve, duhet të bëjmë një hyrje për këtë punë kërkimore, e cila paraqitet si më poshtë:

Është e rëndësishme të gjejmë lidhjen e fshehtë ndërmjet Marrëveshjes së Hudejbijes dhe faljes së mëkatit, pasi ky është edhe çelësi kryesor që ofron përgjigje për tri pyetjet e mësipërme.

Nëpërmjet studimit të hollësishëm të historisë dhe asaj çfarë rezulton prej tij, mbërrijmë te ky përfundim:

Sa herë që në ekzistencë janë shfaqur fe të drejta e të vërteta, të gjithë "pronarët" e besëtytnive dhe traditave të kota, të cilët e shikojnë të rrezikuar ekzistencën e tyre, nisin ta sulmojnë dhe të fabrikojnë akuza të rreme kundrejt tyre. Përhapin ngado thashetheme degraduese dhe përpiqen t'i implikojnë ata (përfaqësuesit e atyre feve) me mëkate të sajuara dhe presin më pas se si do të jetë përfundimi i tyre.

Nëse feja e re që vjen, do të shpartallohet gjatë rrugëtimit të saj, ata do të marrin shkas për të vërtetuar pohimet dhe akuzat e tyre të rreme kundër saj dhe do të nxitojnë t'u tregojnë njerëzve duke ulëritur: A nuk ju kemi thënë se ata janë kështu e ashtu?!

Ndërsa, kur ajo fe arrin të afirmohet dhe metodat e saj rezultojnë të suksesshme, të gjitha akuzat e tyre zhduken, sikur të ishin të shkruara mbi ujë. Ata i këmbejnë të gjitha pohimet e tyre të mëparshme me dhimbje e pendesë, duke thënë se në atë kohë nuk kishin dijeni.

Veçanërisht për Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* sajesat, mëkatet, gënjeshtrat dhe dobësitë ishin akoma më të mëdha. E

konsideruan atë si një njeri që kërkonte luftë, që do të ndizte zjarrin e ngatërresave ndërmjet njerëzve, mendjemadh, që nuk dëgjonte njeri tjetër veç vetes etj…

Marrëveshja e Hudejbijes tregoi se feja me të cilën ai erdhi, ishte katërçipërisht ndryshe nga akuzat dhe shpifjet që fabrikuan armiqtë e tij, pasi ajo ishte një fe përparimtare hyjnore. Shumë ajete kur'anore, në thelbin e tyre, përmbajnë edukimin e shpirtit njerëzor, mbyllin të gjitha faqet e historisë së shtypjes, luftës, dhunës, gjakderdhjes dhe padrejtësisë.

Ai e respektoi dhe e nderoi Qaben, Shtëpinë më të vjetër të All'llahut. Nuk sulmonte kurrë pa arsye fiset e tjera. Ai ishte një burrë i logjikshëm, të cilin e dashuronin deri në flijim të gjithë pasuesit e tij, që ftonte njerëzimin për tek i Dashuri i tyre All'llah. Nëse nuk e detyrojnë kundërshtarët e tij, duke e tërhequr në luftë, ai do të thërriste vetëm për paqe dhe pajtim.

Marrëveshja e Hudejbijes u bë shkak për pastrimin e të gjitha mëkateve, me të cilat u etiketua Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* para dhe pas hixhretit (emigrimit) apo e atyre mëkateve me të cilat ishte etiketuar në atë kohë, apo që mund të etiketohej hipotetikisht në të ardhmen. Ky çlirim (fet'h) ishte një ofertë e veçantë e All'llahut për Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Për këtë arsye, mund të thuhet se All'llahu i Madhëruar i fali të gjitha mëkatet e të Dërguarit të Tij.

Përfundimisht, këto mëkate të supozuara, nuk ishin të vërteta, por kanë qenë mëkate të rrënjosura vetëm tek imagjinata e njerëzve dhe te hamendësimet e tyre, ashtu siç e lexojmë në ajetin 14 të sures "Esh Shuaraa", te historia e Musait, teksa fliste

me Zotin e tij dhe i thoshte: **"Unë jam edhe përgjegjës ndaj tyre për një krim, andaj kam frikë se do të më vrasin."**.

Mëkati i tij nuk ishte asgjë tjetër përveçse mbështetja që ai u kishte ofruar të shtypurve prej bijve të Izraelit nga padrejtësia dhe shpartallimi i padrejtësisë së Faraonit, që rëndonte mbi ta.

Është natyrshëm e pakundërshtueshme se ky veprim nuk konsiderohet mëkat. Ai është mbrojtje ndaj të shtypurve, kësisoj ai konsiderohet mëkat sipas gjykimit të faraonëve dhe mbështetësve të tyre.

E thënë ndryshe, fjala "*edh dhenbu*" – "*mëkat*", në kuptimin e saj gjuhësor, është: Tërësia e ndikimeve negative dhe pasojat që rezultojnë prej një vepre të papranueshme. Kështu, dalja në skenë e Islamit, fillimisht, përbënte shkatërrim për jetën e idhujtarëve, por fitoret e tij të njëpasnjëshme dhe të vazhdueshme u bënë shkak për t'i harruar ato pasoja.

Le ta ilustrojmë këtë rast me shembullin e një shtëpie që ka qenë shumë pranë rrënimit, por që e frekuentojmë dhe kemi lidhje të ngushtë me të. Vjen dikush dhe e shkatërron përfundimisht atë. Në fillim do të trishtohemi dhe do ta gjykojmë si të gabuar veprimin e tij, por, pasi ai të ketë ndërtuar për ne një shtëpi të re, të fortë dhe të qëndrueshme, gjykimin tonë të parë do ta marrë era dhe është i pavlefshëm.

Po kështu është edhe me idhujtarët e Mekës, qoftë përpara, qoftë pas emigrimit të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, të cilët kishin mendime negative rreth fesë islame, por edhe rreth vetë Profetit. Mirëpo, kur erdhi triumfi i Islamit dhe fitoret e tij të vazhdueshme, ato i

hoqën këto mendime të këqija dhe përfytyrime nga mendjet e politeistëve kurejshit.

Është e vërtetë se, nëse do t'i referohemi çështjes së marrëdhënies së faljes së këtyre mëkateve me ndihmën e All'llahut gjatë Marrëveshjes së Hudejbijes, duke e marrë atë në konsideratë, çështja do të qartësohej tërësisht. Kështu e përfituam marrëdhënien që kanë të dyja, prej *"Lam-it"* tek *"lijegfire leke llah"* si një çelës (simbol) që shërben për të hapur kuptimin e mbyllur të ajetit.

Në rast se nuk do t'i referohemi trajtimit të mësipërm, do ta vendosim pagabueshmërinë e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* në pozitë pikëpyetjeje dhe do të pohojmë *(All'llahu na ruajtë!)*: Profeti ka pasur mëkate që i janë falur gjatë Marrëveshjes së Hudejbijes, duke e komentuar ajetin me të kundërtën e përmbajtjes së kuptimit të tij qartë dhe duke pohuar se qëllimi janë (mëkatet në përgjithësi).

Disa të tjerë thanë se aty bëhet fjalë për mëkatet që njerëzit i kanë bërë në dëm të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, siç ishin keqbërja dhe keqtrajtimi i tij, ndaj All'llahu ua fali atyre këto mëkate gjatë Marrëveshjes së Hudejbijes.

Disa të tjerë e komentuan atë, duke e konsideruar falje të detyrueshme dhe thanë: Do të falë All'llahu mëkatin që mund të kesh bërë në të shkuarën apo që mund të bëjë në të ardhmen. Kush?

Por është e qartë se të tilla komentime janë të pabaza dhe të paargumentuara, sepse, nëse do të prekim e gërvishtim

pagabueshmërinë e Profetëve, kemi mohuar filozofinë e ekzistencës së tyre, pasi Profeti duhet të jetë shembull në çdo aspekt. Për rrjedhojë, si mundet që mëkatari dhe gabimtari ta zbatojë këtë metodologji dhe t'i japë asaj atë që ajo meriton?!

Mund të shtojmë këtu faktin se mëkatari, në vetvete, ka nevojë për një lider që ta drejtojë dhe të udhëzohet nëpërmjet tij.

Ekzistojnë të tjera komentime që e kundërshtojnë kuptimin e drejtpërdrejtë të ajetit. Problematika më e rëndësishme e tyre konsiston në faktin se ato e shkëpusin lidhjen ndërmjet faljes së mëkatit dhe ndihmesës, çlirimit në Marrëveshjen e Hudejbijes.

Komentimi më i mirë është ai që përmendëm në fillim. Është ai, që jep përgjigje për të tri pyetjet e ngritura më sipër në të njëjtin vend dhe qartëson lidhjen e fjalive në ajet.

Të gjitha këto janë të lidhura vetëm me njërën prej katër dhuratave me të cilat All'llahu i Madhëruar e furnizoi Profetin e tij të nderuar gjatë Marrëveshjes së Hudejbijes.

Për sa i përket plotësimit të mirësisë për Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, udhëzimit të tij për te Rruga e Drejtë dhe mbështetja me triumf të lavdishëm pas ndihmesës në Hudejbije, këto janë çështje të qarta dhe të dukshme për të gjithë. Islami u përhap me shpejtësi dhe atij iu nënshtruan zemrat e gatshme për të. Madhështia e mësimeve të tij u bë e prekshme për të gjithë dhe neutralizoi efektin e helmeve dhe vrerit që villnin kundërshtarët. Kësisoj u plotësua mirësia e All'llahut për Profetin e Tij dhe për myslimanët, duke u treguar atyre udhëzimet e drejta për tek fitoret e njëpasnjëshme deri në atë shkallë, sa ushtritë e

myslimanëve nuk u përballën me asnjë formë rezistence gjatë çlirimit të Mekës, që ishte edhe fortesa me e madhe e idhujtarëve.

2- Qëllimi i përmendjes së "ma tekademe" dhe "ma teekhere"

Tek ajeti i mëparshëm lexuam Fjalën e All'llahut të Lartësuar: **"Lijegfire lekell'llahu ma tekad'deme min dhenbike ue ma teekh'khere"**. Cili është qëllimi i këtij teksti **"ma tekad'deme ue ma teekh'khere"**?

Komentuesit kanë qëndrime të ndryshme, lidhur me këto njoftime të ajetit:

Disa prej tyre thanë se *"ma tekad'deme"* i referohet mëkatit të Ademit dhe Havasë. Ndërsa *"ma teekh'khere"* i referohet mëkateve të bashkësisë së Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Disa të tjerë thanë se *"ma tekad'deme"* tregon çështjet e lidhura me periudhën përpara profetësisë dhe *"ma teekh'khere"* tregon çështjet e lidhura me periudhën pas saj.

Disa të tjerë thanë se *"ma tekad'deme"* i është referuar periudhës përpara Marrëveshjes së Hudejbijes dhe *"ma teekh'khere"* i referohet gjithçkaje që do të ndodhë më vonë, pra, të gjitha çështjet dhe ngjarjet pas Hudejbijes.

Me gjithë sinjalet e komentimeve, që i sqaruam te origjina e kuptimit të ajetit, veçanërisht, lidhjen ndërmjet faljes së mëkatit dhe Marrëveshjes së Hudejbijes, duket qartë se bëhet fjalë për

akuzat dhe shpifjet e pabaza që idhujtarët, sipas pretendimeve të tyre, ia dedikonin Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* në fillim dhe më vonë, ndaj, po të mos kishte ndodhur ky triumf madhështor, do të përfytyronin se të gjitha këto mëkate ishin të pakundërshtueshme.

Pra, ky triumf, që iu dha Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* palosi faqet e shpifjeve dhe të akuzave (të mëparshme) të adresuara ndaj Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe të atyre që do ta akuzonin në të ardhmen, në rast se triumfi nuk do të kishte ndodhur.

Një tjetër tregues për këtë komentim, është hadithi i transmetuar nga Imam Rizai *(Paqja qoftë mbi ta!)*, të cilin, kur e pyeti Me'muni për komentin e këtij ajeti, tha: "Askush prej banorëve idhujtarë të Mekës nuk besonte se ekzistonte një mëkatar më i madh se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, pasi ata adhuronin treqind e tridhjetë puta dhe, kur ai u erdhi duke i thirrur për tek fjala e sinqertë (e Njësimit), u gjendën në vështirësi dhe thanë: 'Si është e mundur që gjithë ato zota, Muhammedi, i bëri një Zot të vetëm?! Kjo është vërtet për t'u habitur.' Më pas, thanë: 'Kurrë nuk kemi dëgjuar për këtë më parë, ndaj kjo nuk është asgjë tjetër përveçse një sajesë.'".[1]

Kur All'llahu i Lartësuar e çliroi Mekën për Profetin e tij, tha: "Ne të dhamë ty një fitore të qartë. Për idhujtarët e Mekës, me thirrjen tënde për tek Njësimi i All'llahut, për atë që ka kaluar dhe

[1] Shih suren "Sad", ajetet 4-7 në këtë komentim; Tefsirin "Es Safij", i cili e ka marrë nga "Ujunul Akhbar"; Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, f. 56.

për atë që do të vijë më vonë, pasi disa idhujtarë të Mekës e pranuan Islamin, disa të tjerë dolën prej Mekës dhe ata që mbetën prej tyre, nuk kishin mundësi ta mohonin Njësimin e All'llahut, pasi Profeti i ftoi njerëzit për tek All'llahu. Kësisoj pas shfaqjes së tij, mëkatet e tyre të mëparshme u konsideruan të falura.".

Kur e dëgjoi Me'muni fjalën e Rizait, i tha atij: "Sa mirë e the! Të bekoftë Zoti, o babai i Hasanit!".

Ajeti 4

هُوَ ٱلَّذِىٓ أَنزَلَ ٱلسَّكِينَةَ فِى قُلُوبِ ٱلْمُؤْمِنِينَ لِيَزْدَادُوٓاْ إِيمَٰنًا مَّعَ إِيمَٰنِهِمْ ۗ وَلِلَّهِ جُنُودُ ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَٱلْأَرْضِ ۚ وَكَانَ ٱللَّهُ عَلِيمًا حَكِيمًا ۝

"Është Ai, që zbriti qetësi në zemrat e besimtarëve, për t'ua forcuar besimin, krahas besimit që patën. Të All'llahut janë ushtritë e qiejve dhe të Tokës; All'llahu është i Gjithëdijshëm dhe i Urtë."

Komentimi

Zbritja e qetësisë në zemrën e besimtarëve

Ajetet e mëparshme treguan për dhuratat e mëdha, që All'llahu i Madhëruar e furnizoi Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* me fitoren e qartë (gjatë Marrëveshjes se Hudejbijes). Për sa i përket ajetit të mësipërm, aty flitet për dhuratën e madhe, me të cilën All'llahu i Madhëruar i bekoi të gjithë besimtarët. Në ajet thuhet: **"Është Ai, që zbriti qetësi në zemrat e besimtarëve, për t'ua forcuar besimin, krahas besimit që patën."**. E përse të mos zbresë paqja

dhe qetësia në zemrën e besimtarëve, ndërkohë që: **"Të All'llahut janë ushtritë e qiejve dhe të Tokës; All'llahu është i Gjithëdijshëm dhe i Urtë."**?

Çfarë ishte kjo qetësi?!

Këtu është e nevojshme t'i kthehemi edhe njëherë (Marrëveshjes së Hudejbijes), ta imagjinojmë veten brenda rrethanave dhe situatave të krijuara gjatë saj, që të mundemi të depërtojmë thellësive të këtij ajeti.

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* kishte parë një ëndërr (hyjnore dhe të paqtë), sikur kishte hyrë bashkë me shokët e tij në xhaminë e shenjtë (Qabe), ndaj, i ndikuar prej kësaj ëndrre, ai vendosi, që bashkë me shokët e tij, t'i drejtoheshin Mekës, për të vizituar xhaminë e shenjtë (Qaben). Shokët e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* mendonin se kjo ëndërr e bukur do të realizohej gjatë të njëjtit udhëtim, por caktimi i All'llahut ishte diçka krejt ndryshe. Ky ishte vetëm njëri prej aspekteve.

Ndërsa aspekti tjetër ishte: Myslimanët kishin veshur rrobat e ihramit dhe kishin sjellë me vete edhe devetë që do të thereshin dhe do të ofroheshin si kurban, por ndodhi që në të kundërt të pritshmërisë së tyre, atyre të mos u mundësohej vizita në Shtëpinë e All'llahut. Kështu, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* urdhëroi që të thereshin devetë dhe të çliroheshin (të zhvishnin) prej rrobave të ihramit në Hudejbije, aty ku ishin ndaluar. Kjo situatë e krijuar

ishte shumë e dhimbshme dhe e pabesueshme për besimtarët, pasi të gjitha udhëzimet, mësimet dhe traditat e fesë islame përcaktojnë se kthimi dhe zhveshja e rrobave të ihramit nuk mund të bëhen pa u kryer ritualet e përcaktuara për Umren.

Parë nga një këndvështrim i tretë, vëmë re se një nen prej neneve të Marrëveshjes së Hudejbijes, përcaktonte dorëzimin dhe kthimin mbrapsht të të gjithë atyre idhujtarëve mekas që pranonin Islamin dhe shkonin në Medine, pa e kushtëzuar në të njëjtën kohë të kundërtën e kësaj. Kjo ishte njëra nga çështjet më të dhimbshme për myslimanët.

Parë nga një këndvështrim i katërt, kurejshët nuk dëshironin që në marrëveshje të përdorej fjala (i Dërguari i All'llahut) me të cilën njihej në atë kohë Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, aq sa përfaqësuesi i tyre, Suhejl ibni Amri, nguli këmbë që ky term të mos përfshihej në marrëveshjen e paqes. Ai nuk pranoi, gjithashtu, që të shkruhej fjalia: "Me emrin e All'llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit" dhe nguli këmbë që në vend të saj të shkruhej: "Në emrin tënd, Zoti ynë", e cila i përshtatej më shumë zakoneve të banorëve të Mekës. Secila prej këtyre çështjeve ishte e papranueshme për ta, ndaj ç'mund të themi, nëse do të bëhej fjalë për të gjitha së bashku?

Kjo ishte arsye e mjaftueshme që të lëkundeshin zemrat e disa prej shokëve besimdobët të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, aq sa kur zbriti ajeti **"...të dhamë një fitore të qartë."**, thanë: "Ç'fitore ishte kjo?".

Këtu, lindi nevoja që All'llahu i Madhëruar të përfshinte me qetësinë dhe sigurinë e Tij, për të mos krijuar dobësi dhe ftohje, jo vetëm zemrat e besimdobtëve, por (për t'ua forcuar besimin, krahas besimit që patën), në mënyrë që ajeti t'i përshtatej gjendjes së tyre, pasi ai u zbrit për të trajtuar këtë situatë të krijuar.

Fjala "*es sekijnetu*" rrjedh prej fjalës "*es sukun*" dhe kuptimi i saj është "*qetësia*", "*paqja*", "*siguria*" dhe "*vendosmëria*", të cilat shërbejnë për të kuruar dyshimin, dhimbjen, egërsinë dhe luhatjen te njerëzit dhe e furnizojnë atë me qëndresë gjatë furtunave të ngjarjeve.

Mundet, gjithashtu, që kjo qetësi të përfaqësojë një aspekt të rëndësishëm, të lidhur me besimin, duke larguar kësisoj dobësinë dhe lëkundjen e besimit, ose e parë nga një këndvështrim praktik, ajo e furnizon njeriun me vendosmëri, rezistencë, udhëzim e durim.

Natyrshëm, analizat e mëparshme, por edhe mënyra se si është shprehur ajeti, shkojnë më shumë për shtat me kuptimin e saj të parë.

Ndërkohë, qetësia përmendet, gjithashtu, në ajetin 248 të sures "El Bekare", te historia e (Talutit dhe Xhalutit), që i referohet dhe nënkupton bazat e dijes.

Një grup tjetër i komentuesve, edhe pse i kanë dhënë kuptime të tjera fjalës "*qetësi*", i kthehen të njëjtit kuptim, në fund fare.

Është e këndshme të shikosh se te disa transmetime fjala "*es sekijnetu*" është komentuar me besimin.[1] Te disa të tjerë u komentua me freskinë e Xhennetit, që shfaqet në formën e një njeriu dhe i furnizon besimtarët me qetësi.[2]

Të gjitha këto komentime vijnë për të mbështetur atë që e thamë më lart, pasi qetësia është gjeneruese e besimit dhe ajo dhuron paqen në zemër, si të ishte freski Xhenneti.

Duhet t'i kthehemi, gjithashtu, kësaj urtësie të bukur, të lidhur me qetësinë, pasi ajo u përmend në formën e zbritjes: **"Është Ai, që zbriti qetësinë."**. Dimë se kjo shprehje kur'anore mund të nënkuptojë ndonjëherë krijimin, gjetjen dhe ofrimin e mirësisë. E ardhur nga lart-poshtë, kushtëzoi citimin e saj në formën e zbritjes.

Hulumtime

1- Qetësia e pashembullt

Edhe sikur besimi të mos kishte asnjë fryt tjetër, përveç qetësisë, njeriu duhet ta pranonte atë. Atëherë, çfarë mund të themi, kur preken ndikimet, frytet dhe mirësitë e tij?!

[1] Tefsiri "El Burhan", vëll. 2, f. 114.
[2] Burimi i mësipërm.

Po të analizojmë gjendjen e besimtarëve dhe atë të jobesimtarëve gjatë shfaqjes së kësaj të vërtete, do të vëmë re se grupi i dytë është i pushtuar prej një gjendje ankthi dhe lëkundshmërie të vazhdueshme, ndërkohë që grupi i parë përjetonte një gjendje qetësie të pakrahasueshme me asnjë tjetër. Nën efektin e qetësisë**: "ata nuk i druhen askujt tjetër përveç All'llahut."**.[1]

Gjithashtu, sharjet dhe kërcënimet nuk ndikojnë fare tek ata gjatë rrugëtimit të tyre. **"Dhe nuk kanë frikë askënd, përveç All'llahut."**.[2]

Për ta ruajtur këtë qetësi, ata kapen fort pas dy parimeve shumë të rëndësishme, që janë: largimi i mërzisë për atë që ka kaluar dhe vetëpëlqimi nga ajo që kanë arritur, ashtu siç thotë All'llahu i Madhëruar në ajetin kur'anor **"…që të mos trishtoheni për atë që ka kaluar dhe të mos lumturoheni më atë që Ai ju ka dhënë."**.[3]

Përfundimisht, ata nuk dobësohen përballë asnjë vështirësie, nuk gjunjëzohen përballë armiqve të tyre dhe i mbështeten thirrjes: **"Kurrë mos u dobësoni e as mos u trishtoni, sepse ju jeni më të lartët, nëse jeni prej besimtarëve."**.[4]

Besimtari kurrë nuk e sheh veten të vetmuar në fushat e betejave dhe të ngjarjeve, por ndien dorën e All'llahut sipër kokës së tij.

---

[1] Sure "El Ahzab", ajeti 39.
[2] Sure "El Maide", ajeti 54.
[3] Sure "El Hadid", ajeti 23.
[4] Sure "Ali Imran", ajeti 139.

Ai prek ndihmesën e engjëjve dhe mbështetjen e tyre për të. Ndërkohë, duket shumë qartë se jobesimtarët i mbizotëron lëkundja në sjelljet gjatë ndodhive të tyre, sa herë përballen me furtunat dhe tufanet e ngjarjeve.

2- Seria e shkallëve të besimit

Qoftë sipas kuptimit të dijes dhe informacionit, apo sipas kuptimit të dorëzimit dhe nënshtrimit ndaj të vërtetës, besimi ka një seri nivelesh dhe gradash. Dorëzimi dhe nënshtrimi janë dy nivele të ndryshme, gjithashtu. Edhe dashuria me admirimin që janë binjakët e besimit, ndryshon nga njëra-tjetra.

Ajeti në fjalë thotë: **"...për t'ua forcuar besimin, krahas besimit që patën."**, e vërteton këtë, gjithashtu. Nisur nga kjo, besimtari nuk duhet të ndalet vetëm te njëra prej shkallëve të besimit, por duhet të lartësohet për te shkallët më të larta të tij, nëpërmjet ndërtimit të një personaliteti të tillë, që bazohet te dija dhe vepra.

Tek një hadith, i transmetuar prej Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*, thuhet: *"Besimi përbëhet prej dhjetë nivelesh, që ngjasojnë me dhjetë shkallë, të cilat njeriu i ngjit njëra pas tjetrës."*.[1]

Në një tjetër hadith, që transmetohet prej Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*, thuhet: *"I Lartësuari All'llah e ka vendosur besimin në shtatë nivele: mirësia, sinqeriteti, besimi i zhveshur prej çdo mase dyshimi, kënaqësia, besnikëria, dija, urtësia. Ai që i arrin të gjitha*

[1] "Biharul Anuar", vëll. 69, f. 165.

bashkë, është hipotetikisht i plotë. Për disa njerëz e ndau besimin në dy shkallë dhe për të tjerë në tre, derisa përfunduan te shkalla e shtatë.".

Më pas, Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* shton: "*Mos e ngarkoni besimtarin e nivelit të parë me nivelin e dytë, sepse do ta rëndoni."*. Pastaj, vijoi duke i përmendur të gjitha shkallët, derisa mbërriti tek e shtata.[1]

Këtu qartësohet, gjithashtu, se transmetimet e disa të tjerëve, të cilët gjykojnë se besimi as nuk shtohet e as nuk pakësohet, nuk ka asnjë bazë, pasi nuk përputhet me bazat e dijes dhe me transmetimet e tjera islame.

3- Dy shtyllat e qetësisë

Në fund të ajetit në fjalë, vumë re dy fjali, ku secila prej tyre përbën njërën prej këtyre shtyllave të qetësisë dhe të sigurisë për zemrat e besimtarëve.

E para është fjalia: **"Të All'llahut janë ushtritë e qiejve dhe të Tokës."**.

Ndërsa tjetra është fjalia: **"All'llahu është i Gjithëdijshëm dhe i Urtë."**.

E para i thotë njeriut: Nëse do të jesh me All'llahun, gjithkush në Tokë e në qiell do të jetë me ty.

Ndërsa e dyta i thotë: All'llahu është i Mirinformuar rreth nevojës tënde, problemeve të tua, ashtu siç është i Mirinformuar rreth përpjekjeve dhe adhurimeve të tua. Duke besuar te këto dy baza, si mund të mos e pushtojë qetësia dhe paqja zemrën e njeriut?!

[1] "Usulul Kafij", vëll. 2, kreu "Derexhatul Ijman", Hadithi 1.

Ajetet 5 – 7

لِّيُدۡخِلَ ٱلۡمُؤۡمِنِينَ وَٱلۡمُؤۡمِنَٰتِ جَنَّٰتٖ تَجۡرِي مِن تَحۡتِهَا ٱلۡأَنۡهَٰرُ خَٰلِدِينَ فِيهَا وَيُكَفِّرَ عَنۡهُمۡ سَيِّـَٔاتِهِمۡۚ وَكَانَ ذَٰلِكَ عِندَ ٱللَّهِ فَوۡزًا عَظِيمٗا ٥ وَيُعَذِّبَ ٱلۡمُنَٰفِقِينَ وَٱلۡمُنَٰفِقَٰتِ وَٱلۡمُشۡرِكِينَ وَٱلۡمُشۡرِكَٰتِ ٱلظَّآنِّينَ بِٱللَّهِ ظَنَّ ٱلسَّوۡءِۚ عَلَيۡهِمۡ دَآئِرَةُ ٱلسَّوۡءِۖ وَغَضِبَ ٱللَّهُ عَلَيۡهِمۡ وَلَعَنَهُمۡ وَأَعَدَّ لَهُمۡ جَهَنَّمَۖ وَسَآءَتۡ مَصِيرٗا ٦ وَلِلَّهِ جُنُودُ ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَٱلۡأَرۡضِۚ وَكَانَ ٱللَّهُ عَزِيزًا حَكِيمًا ٧

"(Ai e bëri këtë) **për t'i çuar besimtarët dhe besimtaret në kopshte nëpër të cilat rrjedhin lumenj e ku do të qëndrojnë përherë, si dhe që t'ua falë gjynahet atyre. Kjo, në sytë e All'llahut, është fitorja më e madhe. "**

"Gjithashtu, (Ai e bëri këtë) **për t'i ndëshkuar hipokritët dhe hipokritet, idhujtarët e idhujtaret, që mendojnë keq për All'llahun. Radha e fatkeqësisë le t'i godasë ata! All'llahu është zemëruar me ata, i ka mallkuar dhe u ka përgatitur Xhehenemin; eh, sa vend i shëmtuar që është ai! "**

"Të All'llahut janë ushtritë e qiejve dhe të Tokës; All'llahu është i Plotfuqishëm dhe i Urtë!"

Komentimi

Një tjetër rezultat i fitores së qartë

Disa komentues prej Ehli Synetit dhe prej shi'itëve transmetojnë se, kur Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* u njoftua për fitoren e qartë, plotësimin e mirësisë (udhëzimit) dhe triumfin, disa besimtarë u ndjenë keq prej Marrëveshjes së Hudejbijes dhe thanë: *"Urime, o i Dërguari i All'llahut! All'llahu ta tregoi ty se çfarë do të bësh me veten tënde."*. Kur i thanë: *"Na trego tani, çfarë do të bëhet me ne."*, zbriti ajeti: **"**(Ai e bëri këtë) **për t'i çuar besimtarët dhe besimtaret..."**.[1]

Sido që të jetë, këto ajete flasin për lidhjen që ekziston ndërmjet ndikimeve të Marrëveshjes së Hudejbijes, rezultatet dhe frytet që ajo dha te mendjet e njerëzve dhe fundin e secilit grup, të cilët e kaluan këtë pengesë dhe sprovë të madhe. Për këtë, ajeti i parë prej ajeteve në fjalë, thotë: **"**(Ai e bëri këtë) **për t'i çuar besimtarët dhe besimtaret në kopshte nëpër të cilat rrjedhin lumenj e ku do të qëndrojnë përherë..."**. Kjo mirësi e madhe nuk do t'u pengohet e as nuk do t'u mohohet kurrë atyre.

Përveç të tjerave, All'llahu do t'i falë ata: **"...si dhe që t'ua falë gjynahet atyre. Kjo, në sytë e All'llahut, është fitorja më e madhe."**.[2]

---

[1] Tefsir "El Meragij", vëll. 26, f. 85. Tefsir "Ruhul Xhinan", vëll. 10, f. 26 dhe tefsiri "Ruhul Meanij", vëll. 26, f. 86.

[2] Sipas kësaj deklarate, dy fjalët: *"për të çuar"* dhe *"të dënojë"* janë të ndërlidhura me fjalën *"të falë"*. Disa komentues të Kur'anit, si Et Tusij te tefsiru "Et Tibjan",

Me këtë, All'llahu, gjatë fitores së madhe, u ka dhënë besimtarëve, të njëjtat gjëra që i ka dërguar Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar*!) prej katër dhuratave të mëdha, dy prej të cilave, janë: Xhenneti (kopshtet ku do të qëndrojnë përherë, falja e gjynaheve të tyre), si dhe zbritja e qetësisë mbi zemrat e besimtarëve. Të mbledhura bashkë, këto tri dhurata konsiderohen fitore e madhe, për të gjithë ata që dolën me sukses prej sprovës dhe vështirësisë.

Fjala "*el feuzu*" – "*fitore*", në Kur'an, shoqërohet më së shumti me fjalën "*el adhijmu*" – "*madhështore*", në raste të tjera, me fjalën "*el mubijnu*" – "*e qartë*" ose "*el kebijru*" – "*e madhe*". Po t'i referohemi asaj që thotë Err Rragibu te "El Mufredatu", kuptimi i saj është triumfi dhe përfitimi i begative të lidhura ngushtë me mirësinë. Ajo është paraqitur, sikur të jetë suksesi në Ahiret, edhe nëse lidhet me humbjen e disa dhuratave të All'llahut, në këtë botë.

Sipas transmetimit të mirënjohur nga Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*, kur i mallkuari Abdurrahman bin Mulxhem, e goditi me shpatë në mes të kokës, te mihrabi i adhurimit, tha me një zë buçitës: "*Fitova, pasha Zotin e Qabesë!*". Me këtë thënie ai sikur donte të thoshte fitova, sepse e vulosa me gjakun e kokës, librin tim të Ditës së Kiametit.

Et Tabrasij te tefsiri "Mexhmaul Bejan", Ebul Futuh Err Rrazi te tefsiri i tij, zgjodhën këtë mendim, ndërsa disa të tjerë thanë se ajo që ka kaluar, është e lidhur me togfjalëshin: *"për t'ua forcuar besimin"*. Kjo nuk është në harmoni me shkakun e zbritjes së ajetit dhe as me ndëshkimin e jobesimtarëve.

Ndodh, që sprovat e All'llahut të mbërrijnë deri në atë shkallë, sa mund të trazojnë besimin e dobët dhe t'i ndryshojnë zemrat, por zemrat e besimtarëve të sinqertë do të mbulohen me qetësi, siguri dhe kënaqësi. Rezultatet e tyre do t'i shijojnë në Ditën e Gjykimit. Nuk ka asnjë dyshim, se kjo është fitore madhështore.

Përveç këtyre, është edhe grupi i hipokritëve e i idhujtarëve, fundin e të cilëve, e përshkruan ajeti i mëposhtëm: **"Gjithashtu,** (Ai e bëri këtë) **për t'i ndëshkuar hipokritët dhe hipokritet, idhujtarët e idhujtaret, që mendojnë keq për All'llahun."**.

Kur Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!)* bashkë më besimtarët u drejtuan drejt Medines, hipokritët menduan se nuk do të ktheheshin më të gjallë, ashtu siç përshkruhen edhe në ajetin 12 të së njëjtës sure: **"Jo! Ju menduat se i Dërguari dhe besimtarët nuk do të kthehen kurrë te familjet e tyre..."**.

Referuar numrit të paktë të njerëzve dhe të armatimeve, gjithashtu, edhe idhujtarët menduan, gjithashtu, se Muhammedi nuk do të kthehej shëndoshë e mirë në Medine dhe ylli i Islamit do të shuhej shpejt. Kur'ani e shtjellon imtësisht natyrën e vuajtjes dhe të dënimit të tyre, duke e radhitur atë në katër tituj kryesorë.

I pari: All'llahu i Madhëruar thotë: **"Radha e fatkeqësisë le t'i godasë ata!"**.

Në aspektin gjuhësor, fjala *"ed dairetu"* është tërësia e ngjarjeve dhe gjithçka që vërtitet rreth tyre, ose gjërat për të cilat njeriu ka rënë dakord në jetën e tij. Ajo është më e përgjithshme se

mundësia për të qenë e mirë apo e keqe, por e shoqëruar nga fjala *"es su'u"* që nënkupton gjërat e padëshiruara.

I dyti: "All'llahu është zemëruar me ata."

I treti: "i ka mallkuar."

I katërti: "u ka përgatitur Xhehenemin; eh, sa vend i shëmtuar që është ai!"[1]

Vëmendjen tonë duhet ta përqendrojmë te fakti se në Hudejbije, pjesa më e madhe e myslimanëve të pranishëm ishin burra. Burra ishin, gjithashtu, edhe pjesa e përbërë prej hipokritëve dhe idhujtarëve, por, nëse do t'i referohemi ajeteve të para, do të vëmë re se të përfshirë në fitore dhe në vuajtje ishin burrat bashkë me gratë. Arsyeja është se besimtarët dhe hipokritët që luftonin në fushëbetejë, nuk mund t'i arrinin qëllimet e tyre pa mbështetjen që u nevojitej prej grave nga prapavija.

Në fakt, Islami nuk është fe vetëm e burrave, ku injorohet personaliteti i gruas, përkundrazi, ai i jep rëndësi të madhe asaj. Sa herë që përmenden burrat dhe shmanget përmendja e grave, duhet ta kujtojmë e ta dëshmojmë praninë e saj dhe ta bëjmë të ditur se Islami është feja e të gjithëve, pa përjashtim, burra edhe gra.

Tek ajeti i fundit, ndër ata që i hulumtuam, gjendet një tjetër tregues i rëndësishëm për madhështinë e fuqisë së All'llahut. Ajeti thotë kështu: **"Të All'llahut janë ushtritë e qiejve dhe të Tokës; All'llahu është i Plotfuqishëm dhe i Urtë!"**.

---

[1] Fjala *"mesijrun" - "fund"*, ka ardhur në kuptime të ndryshme. Ajo që njeriu mbërrin njëra pas tjetrës.

Kjo shprehje është përmendur një herë në fund të diskutimit për nivelet, shkallët dhe aftësitë e besimtarëve. Një herë tjetër, është përmendur këtu, në fund të ajetit që flet për ndëshkimin e hipokritëve dhe të idhujtarëve. Duhet të jetë e qartë për të gjithë se, All'llahu, të Cilit i përkasin ushtritë e qiejve dhe të Tokës, i ka të dyja mundësitë. Ai e ka të mundur, që me mëshirën e Tij, të mbështjellë merituesshëm robtë e tij të ndershëm, të cilët iu bindën e iu nënshtruan, sikurse e ka mundësinë, që të zbresë të gjithë mërzinë dhe hakmarrjen e Tij me zjarr për kriminelët.

Prej çështjeve që tërheqin vëmendjen, është, gjithashtu, fakti se sa herë besimtarët përmenden në Kur'an, All'llahu cilësohet si i Dijshëm dhe i Urtë. Të dyja këto cilësi i shkojnë mëshirës së pakufishme të All'llahut. Ndërsa, sa herë përmendën hipokritët dhe idhujtarët, All'llahu cilësohet i Rreptë dhe i Urtë. Të dyja këto cilësi i përshtaten tërësisht ndëshkimit.

Cili është qëllimi i përmendjes së ushtarëve të qiejve dhe të Tokës?

Kjo shprehje ka një kuptim shumë të gjerë, pasi ajo përfshin edhe engjëjt (ato radhiten prej ushtarëve të Qiellit). Ajo përfshin, gjithashtu, edhe të tjerë ushtarë, siç janë: vetëtimat, tërmetet, uraganet, përmbytjet, dallgët, të tjera forca ekzistuese, por të padukshme, për të cilat ne nuk kemi informacion. Të gjitha këto, radhiten prej ushtarëve të All'llahut dhe zbatojnë me përpikëri urdhrat e tij.

Hulumtim

Cilët janë ata që mendojnë keq për All'llahun?

Ndonjëherë, ndodh që të mendojmë keq për veten dhe herë të tjera mund të mendojmë keq për të tjerët. Mund të ndodhë që të mendojmë, gjithashtu, keq për All'llahun. Sipas të njëjtës logjikë dhe radhitje, mund të klasifikojmë edhe të menduarit.

Për sa i përket të menduarit keq për veten, nëse nuk e ekzagjerojmë, mund të konsiderohet një shkallë e rëndësishme drejt përsosmërisë dhe mund ta shtyjë njeriun, që të monitorojë imtësisht veprat e tij dhe nivelin e sinqeritetit të tij. Kjo, mund ta ndalojë individin të degjenerojë në vetëpëlqim dhe mendjemadhësi gjatë kryerjes së veprave të mira.

Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* i cilësonte të devotshmit, teksa i përgjigjej Hemamit: "*Ata e akuzojnë dhe e qortojnë vazhdimisht veten e tyre. Nuk janë të kënaqur kurrë prej veprave të tyre. Sa herë dikush prej tyre përballet me ndonjë lëvdatë, e mbërthente frika prej asaj që kishte dëgjuar dhe thoshte: 'Unë e njoh veten time më mirë se të tjerët dhe Zoti im më njeh mua më mirë nga sa e njoh unë veten. O All'llah, të lutem mos më gjyko mua për atë që ata e thonë. Më bëj mua më të mirë nga ç'më pandehin ata dhe m'i fal mua ato gjynahe, për të cilat ata nuk kanë dijeni.'*".[1]

Të mendosh keq për njerëzit, është e ndaluar, përveç atyre rasteve, kur e keqja e ka përfshirë të gjithë shoqërinë. Në këtë rast, kurrsesi, nuk duhet të mendohet mirë (do ta sqarojmë këtë

[1] "Nehxhul Belagah", Hytbe 193 (Hemami).

çështje, me lejen e All'llahut, kur të vijmë në fund të ajetit 12 të sures "El Huxhurat").

Ndërsa, të mendosh keq për All'llahun, pra, të mendosh keq për premtimin, mëshirën dhe bujarinë e Tij pa kufi, është e urryer dhe tërësisht e papranueshme. Ky mund të jetë tregues i dobësisë së besimit dhe ndonjëherë mund të jetë tregues për mungesën e plotë të besimit.

Në Kur'an është folur shpeshherë për mendimet e këqija të besimdobtëve dhe të atyre që nuk besojnë fare, veçanërisht kur janë shfaqur ngjarje të vështira shoqërore dhe furtunat e mëdha të sprovave. Aty është përmendur, gjithashtu, qëndresa e besimtarëve gjatë këtyre ngjarjeve me mendime plotësisht të mira për All'llahun dhe me qetësinë që i ofronte butësia e Tij. Ata që kishin besim të dobët, ankoheshin vazhdimisht, ashtu siç ndodhi në kohën e Hudejbijes, kur hipokritët dhe të ngjashmit e tyre, menduan keq dhe thanë se Muhammedi dhe shokët e tij nuk do të mund të kthehen prej këtij udhëtimi. Ky pohim tregoi se ata kishin harruar premtimin e All'llahut ose me keq, e gjykuan negativisht atë.

Shembulli i dytë, janë ndodhitë në fushëbetejën e Ahzabit, pikërisht atëherë kur myslimanët u lëkundën fuqimisht dhe u gjendën nën trysninë e një sprove shumë të vështirë. Në këtë rast, All'llahu i Madhëruar i kritikoi rëndë ata që menduan keq për të, duke thënë: **"Ata ju sulmuan nga lart dhe nga poshtë, kështu që sytë tuaj u errësuan, zemrat ju erdhën në fyt dhe besimi juaj tek**

All'llahu u lëkund. Aty besimtarët u vunë në provë dhe u tronditën nga një tronditje e fuqishme.".[1]

Tek ajeti 154 i sures "Ali Imran" janë përmendur, gjithashtu, të tilla mendime të këqija për All'llahun. (menduat si në kohën e injorancës)

Përfundimisht, mendimi i mirë për All'llahun, për mëshirën e Tij, për premtimin e Tij, për bujarinë e Tij, për butësinë dhe përkujdesjen e Tij, janë prej shenjave të rëndësishme të besimit dhe prej shkaqeve që ndikojnë në shpëtimin dhe lumturinë e njeriut.

Tek disa hadithe të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* lexojmë: *"Nuk ka një njeri që mendon mirë për All'llahun, përveçse All'llahu do të jetë sipas të njëjtave konsiderata që robi i Tij ka për të."*.[2]

Është transmetuar prej Imam Ali Ibn Riza *(Paqja qoftë mbi të!)*: "Mendo mirë për All'llahun, sepse All'llahu i Lartësuar thotë: *'Unë jam ashtu siç robi im mendon për Mua. Nëse mendon mirë për Mua, i mirë do të jem dhe, nëse mendon keq për Mua, ashtu do të jem për të.'"*.[3]

Në fund, vjen një tjetër hadith nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: *"Të mendosh mirë për All'llahun e Lartësuar, është çmimi i Xhennetit."*.[4]

---

[1] Sure "El Ahzab", ajetet 10-11.
[2] "Biharul Anuar", vëll. 70, f. 384.
[3] Burimi i mësipërm.
[4] Burimi i mësipërm.

E ku ka çmim më të lirë se ky dhe ku ka lumturi më të vlefshme se kjo?!

Ajetet 8 – 10

إِنَّآ أَرۡسَلۡنَٰكَ شَٰهِدٗا وَمُبَشِّرٗا وَنَذِيرٗا ٨ لِّتُؤۡمِنُواْ بِٱللَّهِ وَرَسُولِهِۦ وَتُعَزِّرُوهُ وَتُوَقِّرُوهُۚ وَتُسَبِّحُوهُ بُكۡرَةٗ وَأَصِيلًا ٩ إِنَّ ٱلَّذِينَ يُبَايِعُونَكَ إِنَّمَا يُبَايِعُونَ ٱللَّهَ يَدُ ٱللَّهِ فَوۡقَ أَيۡدِيهِمۡۚ فَمَن نَّكَثَ فَإِنَّمَا يَنكُثُ عَلَىٰ نَفۡسِهِۦۖ وَمَنۡ أَوۡفَىٰ بِمَا عَٰهَدَ عَلَيۡهُ ٱللَّهَ فَسَيُؤۡتِيهِ أَجۡرًا عَظِيمَۢا ١٠

“Me të vërtetë, Ne të kemi dërguar ty (Muhammed) **dëshmitar, sjellës të lajmeve të mira dhe paralajmërues.”**

“Që t’i besoni All’llahut dhe të Dërguarit të Tij, që ta ndihmoni e ta nderoni atë (Muhammedin) **dhe që ta lavdëroni Atë me namaz në mëngjes dhe mbrëmje.”**

“Ata që të janë betuar për besnikëri, në të vërtetë, i janë betuar për besnikëri All’llahut. Dora e All’llahut është mbi duart e tyre! Ai që e prish betimin, e prish në dëm të vetes, por, nëse e mban besën ndaj All’llahut, Ai do t’i japë atij shpërblim të madh.”

Komentimi

Pozita e Profetit dhe detyrimet e njerëzve kundrejt tij

Thamë se disa injorantë e kundërshtuan fuqishëm Marrëveshjen e Hudejbijes, deri në atë shkallë sa disa prej tyre, përdorën një fjalor të papërshtatshëm për Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Të gjitha këto zhvillime do ta bënin të detyrueshme ndërhyrjen e Kur'anit, për të shpalosur madhështinë, lartësinë e pozitës së Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Kjo është edhe arsyeja përse ajeti i parë, prej ajeteve në fjalë, i drejtohen Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, duke thënë kështu*:* **"Me të vërtetë, Ne të kemi dërguar ty** (Muhammed) **dëshmitar, sjellës të lajmeve të mira dhe paralajmërues."**.

Këto janë tri nga cilësitë dhe pozitat më të njohura dhe ndër më të rëndësishmet, me të cilat është pajisur Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: dëshmitar, sjellës i lajmeve të mira, paralajmërues.

Fjala *"shahiden"* – *"dëshmitar"*, për të gjithë ymetin mysliman. Madje, ai do të dëshmojë edhe për të gjithë popujt e tjerë, siç është përshkruar tek ajeti 41 i sures "En Nisa", ku All'llahu i Madhëruar thotë: **"Ne do të sjellim për secilin popull nga një dëshmitar dhe do të të sjellim Ty** (Muhammed) **dëshmitar për të gjithë ata të marrë bashkë."**.

Edhe tek ajeti 105 i sures "Et Teube" lexojmë, gjithashtu: **"Thuaju atyre,** (o Muhammed) **punoni, sepse All'llahu, i Dërguari i tij dhe besimtarët do të dëshmojnë për veprat tuaja."**.

Në fakt, çdo njeri, ka shumë dëshmitarë.

I pari ndër këta dëshmitarë, është All'llahu i Lartësuar, i Cili është i Mirinformuar rreth të panjohurave dhe dëshmive. Është Ai, që kontrollon veprat dhe qëllimet e njeriut.

Pas All'llahut, janë engjëjt e urdhëruar të mbajnë shënim dhe të regjistrojnë veprat e njeriut, ashtu siç bëhet e qartë edhe tek ajeti 21 i sures "Kaf": **"Ditën e Gjykimit, çdo njeri do të ketë me vete një shoqërues dhe një dëshmitar."**.

All'llahu i Madhëruar, në Kur'anin Famëlartë, thotë se jo vetëm organet e trupit të njeriut, por edhe lëkura, do të dëshmojë kundër tij: **"Atë Ditë që do të dëshmojnë kundër tyre gjuhët, duart dhe këmbët e tyre për çfarë kanë bërë."**.[1]

Tek ajeti 21 i sures "Fusilet", lidhur me këtë kontekst, thuhet: **"Ata do t'i pyesin lëkurat e tyre: 'Përse dëshmuat kundër nesh?!'. Lëkurat e tyre do t'u përgjigjen duke u thënë: 'All'llahu është Ai që i bëri ato të flasin. Ai mund ta bëjë gjithçka të flasë.'"**.

Toka do të jetë, gjithashtu, prej atyre që do të dëshmojnë në Ditën e Gjykimit, ashtu sikurse është përmendur në ajetin 4 të sures "Ez Zelzeleh": **"Në atë Ditë** (Ditën e Gjykimit)**, ajo** (Toka) **do të nxjerrë lajmet e saj."**.[2]

Koha, gjithashtu, do të jetë një prej dëshmitarëve, sipas disa transmetimeve. Tek disa prej transmetimeve të Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)* thuhet kështu: "Nuk ka ditë që kalon për birin

[1] Sure "En Nur", ajeti 24.
[2] Sure "Zelzele", ajeti 24.

e Ademit, që ajo të mos i thotë atij: 'Unë jam një ditë e re. Unë do të dëshmoj për ty. Ti duhet të kryesh sa më shumë vepra të mira tek unë, që unë të dëshmoj për ty në Ditën e Gjykimit, ngase ti nuk do të më shohësh më deri në Ditën e Gjykimit, pasi të kem ikur.'".[1] , [2]

Nuk ka dyshim se dëshmia e All'llahut është e mjaftueshme, por larmia e dëshmitarëve bëhet plotësuese për vetë dëshminë dhe argumentin. Ato kanë gjithashtu, një rol edukativ për njerëzit.

Në të gjitha rastet, All'llahu i Madhëruar i përmendi këto tri cilësi: dëshmitar, sjellës i lajmeve të mira, paralajmërues, pasi ato janë cilësitë kryesore të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Këto cilësi erdhën për të paraprirë atë që do të citohej tek ajetet më pas.

Tek ajeti i mëposhtëm, ceken pesë çështje shumë të rëndësishme. Ato shërbejnë për të qartësuar qëllimet e pajisjes së Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* me cilësitë e përmendura më sipër. Dy prej atyre çështjeve, janë të lidhura me adhurimin e All'llahut, kujtesën dhe lavdërimin e Tij.

Tri çështjet e tjera janë: bindja e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, mbrojtja ndaj tij dhe lartësimi i pozitës së tij. All'llahu i Madhëruar thotë në Kur'an: **"...që t'i besoni All'llahut dhe të Dërguarit të Tij, që ta ndihmoni e ta nderoni atë** (Muhammedin /*Paqja e bekimi i*

[1] Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, f. 112.
[2] Është përmendur te studimi i dëshmitarëve te Gjykata e Ditës së Gjykimit, fundi i ajeteve 20-22 të sures "Fusilet".

All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) **dhe që ta lavdëroni Atë** (All'llahun e Madhëruar) **me namaz në mëngjes dhe mbrëmje."**.

Fjala *"tuvekkiruhu"* – *"ta ndihmoni"*, në gjuhën arabe, e ka origjinën te fjala *"ta'azir"*, që do të thotë *"ndalesë"*. Po të zgjerohemi te kuptimet e saj, do të vërejmë se ajo merr gjithashtu, kuptimin e mbrojtjes, të ndihmesës, të mbështetjes për një person ndaj armiqve të tij. Kjo fjalë përdoret, gjithashtu, për të nënkuptuar një prej formave të dënimeve të caktuara, si pasojë e gjynaheve të caktuara.

Fjala *"ta nderoni"*, e ka origjinën nga fjala *"teukir"* dhe rrënja e saj është *"el uekr"*, që ka kuptimin *"rëndesë"*. Referuar kuptimeve të mësipërme, ajo nënkupton respektin, nderimin dhe madhërimin e tij.

Sipas këtij komentimi, përemrat dëftorë te fjalët *"ta nderoni"* dhe *"ta lavdëroni"* kthehen te Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Qëllimi prej kësaj është ndihma e dhënë kundër armiqve të tij, respekti dhe lavdërimi. Këtë komentim e përzgjodhi, gjithashtu, shejh Et Tusi te "Et Tibjan", Et Tabarsi tek "Mexhmaul Bejan" dhe disa të tjerë.

Të tjerë komentues të Kur'anit[1] janë të mendimit se të gjithë përemrat e përmendur në ajet kthehen mbi All'llahun. Ndihmesa dhe respekti, në këtë rast, janë të lidhura me mbështetjen, vlerësimin, lartësimin dhe respektin për Fenë e All'llahut. Ata e argumentojnë komentimin e tyre, duke thënë se

[1] Prej tyre Ez Zemekhsheri, te tefsiri "El Kesh'shaf"; El Alusij, te tefsiri "Ruhul Meani"; El Fejd El Kashani, te tefsiri "Es Safij"; eruditi Et Tabatabai, te tefsiri "El Mizan".

të gjithë përemrat e përmendur në ajet janë në harmoni të plotë me njëri-tjetrin.

Duket qartë se komentimi i parë është më pranë kuptimit të ajetit, sepse ndihmesa, sipas kuptimit të saj gjuhësor, vjen fillimisht në kuptimin e ndalesës, të mbrojtjes prej armiqve dhe mbrojtjen e personit të tij. Kjo nuk mund të përshtatet me All'llahun, përveçse e kuptuar në formën e një metafore.

Më e rëndësishme se kjo, është shkaku i zbritjes së ajetit, pasi ka zbritur pas Marrëveshjes së Hudejbijes, atëherë kur disa prej tyre nuk u sollën hijshëm me Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, nuk e respektuan pozitën e tij të nderuar. Ajeti zbriti për të qartësuar disa prej detyrave që dilnin për myslimanët, në raport me sjelljet e tyre karshi Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Nuk duhet të harrojmë, gjithashtu, se ajeti ishte rezultat dhe vazhdimësi e ajetit të mëparshëm tek i cili Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* u cilësua si: dëshmitar, sjellës i lajmeve të mira dhe paralajmërues. Kjo përgatiti infrastrukturën kuptimore për zbritjen e ajetit vijues.

Në fund të ajetit, tek ajetet që ishin objekt hulumtimi, është një tregues që lidhet me (Bej'at er Riduan) Besëlidhjen e Riduanit. Një sqarim më i hollësishëm, lidhur me këtë çështje, vjen tek ajeti 18 i së njëjtës sure.

Sqarimi i saj vijon kështu: Ashtu siç e kemi përmendur më parë, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe*

mbi familjen e tij!), sipas librave të historisë, kishte parë një ëndërr, sikur kishte hyrë në Mekë, bashkë me shokët e tij. Ai, bashkë me njëmijë e katërqind shokë të tij, nisën rrugëtimin për në Mekë, por siç e thamë edhe më lart, kurejshët vendosën të mos e lejonin Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe shokët e tij. I ndaluan ata në afërsi të Mekës. Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, bashkë me shokët e tij, u ndalën në Hudejbije. Më pas, u shkëmbyen të deleguarit ndërmjet kurejshëve dhe Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, derisa e arritën përfundimisht Marrëveshjen e Hudejbijes.

Gjatë procesit të shkëmbimit të përfaqësuesve dhe të të deleguarve, Uthmani u urdhërua prej Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* të njoftonte banorët e Mekës, në emrin e tij, se ai nuk donte përballje dhe as luftë, por synonte vetëm kryerjen e ritualeve të Umres. Idhujtarët, banorë të Mekës, e ndaluan përkohësisht Uthmanin. Kjo u bë shkak që ndërmjet myslimanëve të përhapej lajmi i vrasjes së Uthmanit.

Nëse kjo ngjarje do të ishte e vërtetë, ajo do të bëhej shkak që kurejshët t'i shpallnin luftë Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe ta tërhiqnin atë drejt saj. Për këtë arsye, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* tha: *"Nuk luajmë vendit (nga Hudejbija), derisa të marrim besën prej popullit tonë."*.

Kërkoi të përsëritej besëlidhja. Kështu që, myslimanët u mblodhën dhe i dhanë besën Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* poshtë një peme që

ndodhej atje, që të mos e braktisnin atë, të luftonin bashkë me të kundër armiqve të tij, si dhe ta mbronin për aq kohë sa do të mundeshin dhe do të kishin fuqi ta bënin.

Ky lajm u mbërriti kurejshëve, aq sa frika i mbërtheu menjëherë. Ky ishte shkaku kryesor që i shtyu ata të bënin marrëveshjen e paqes me Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Për këtë arsye, besa që myslimanët i dhanë Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* poshtë pemës, u quajt Besëlidhja e Riduanit (Bej'atur Riduan). Ky rast është përmendur tek ajeti 18 i së njëjtës sure, ku All'llahu i Madhëruar thotë: **"U kënaq All'llahu me besimtarët, teksa të japin ty besën, poshtë pemës."**.

Gjithsesi, All'llahu i Madhëruar ka folur në Kur'an rreth besëlidhjes së myslimanëve, tek ajeti që është edhe objekti ynë i studimit dhe ka thënë: **"Ata që të janë betuar për besnikëri, në të vërtetë, i janë betuar për besnikëri All'llahut. Dora e All'llahut është mbi duart e tyre!"**.

Në këtë rast, betimi vjen në kuptimin e besëlidhjes, të premtimit për ta ndjekur, për ta pasuar dhe për t'ju bindur. Ishte e njohur në atë kohë, se, kur njerëzit i jepnin besën njëri-tjetrit, zgjasnin duart drejt njëri-tjetrit dhe nëpërmjet kësaj forme, ata shprehnin të gjithë besnikërinë.

Këto lloj marrëveshjesh janë quajtur besëlidhje, ose dhënie e besës. Dhënia e besës përfaqëson sakrifikimin e shpirtrave të tyre për hir të personit që i japin besën.

Këtu qartësohet kuptimi i thënies së All'llahut: **"Dora e All'llahut është mbi duart e tyre."**. Ky ajet tregon, gjithashtu, se

besa e dhënë Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është besë e dhënë All'llahut dhe duke qenë se dora e All'llahut është mbi duart e tyre, kur i japin besën Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, ajo nuk është vetëm për Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, por edhe për All'llahun. Të tilla raste janë të shumta në gjuhën arabe.

Po t'i mbështetemi këtij komentimi, do të vëmë re se ata, kuptimin e ajetit: **"Dora e All'llahut është mbi duart e tyre"**, e shpjegojnë me: *mundësia e All'llahut mbi mundësitë e tyre* apo *me ndihmesa e All'llahut është më e vlefshme se ndihmesa e njerëzve,* do të dallojmë se tjetërsimi i kuptimit të drejtpërdrejtë të fjalës me kuptime të ngjashme apo të përafërta, bie ndesh me shkakun e zbritjes së sures, që do të thotë, nëse do të ishte e vërtetë kjo çështje, në vetvete.

Te një tjetër ajet kur'anor thuhet: **"Ai që e prish betimin, e prish në dëm të vetes, por, nëse e mban besën ndaj All'llahut, Ai do t'i japë atij shpërblim të madh."**.

Fjala *"nekethe" - "prishi"*, buron prej fjalës *"nekth"*, kuptimi i të cilës është *"fitore"*, por që është përdorur më pas te prishja e betimit.

Në këtë ajet, paralajmërohen të gjithë ata që i kanë dhënë besën Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, që të qëndrojnë të palëkundur. Nëse ata e respektojnë këtë besë dhe rezistojnë deri në fund, do të marrin shpërblimin e madh prej Zotit të tyre. Ata që e prishin besën e dhënë, do të dëmtojnë veten e tyre, sepse All'llahun nuk mund ta dëmtojnë. Prishja e besës e ekspozon ekzistencën e shoqërisë,

nderin dhe madhështinë e saj ndaj rreziqeve dhe kërcënimeve të mëdha.

Transmetohet që Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*, ka thënë: "Në zjarrin e Xhehenemit është një qytet që quhet El Hasineh. A nuk më pyesni se çfarë ka në të?!"

Ata i thanë: "E çfarë ka në të, o Prijësi i myslimanëve?!"

Ai tha: "Aty janë duart e atyre që e prishin besën."[1]

Këtu bëhet akoma më e qartë poshtërsia e prishjes së besës, sipas fesë islame. Lidhur me këtë çështje, janë disa hulumtime që trajtojnë çështjen e besës në Islam dhe para Islamit. Aty bëhet fjalë për besën, mënyrën e dhënies dhe vlerësimin e saj në Islam. Të gjitha këto do të vijnë të përmendura te fundi i ajetit 18, i të njëjtës sure.

Ajetet 11 – 14

سَيَقُولُ لَكَ ٱلۡمُخَلَّفُونَ مِنَ ٱلۡأَعۡرَابِ شَغَلَتۡنَآ أَمۡوَٰلُنَا وَأَهۡلُونَا فَٱسۡتَغۡفِرۡ لَنَاۚ يَقُولُونَ بِأَلۡسِنَتِهِم مَّا لَيۡسَ فِي قُلُوبِهِمۡۚ قُلۡ فَمَن يَمۡلِكُ لَكُم مِّنَ ٱللَّهِ شَيۡـٔا إِنۡ أَرَادَ بِكُمۡ ضَرًّا أَوۡ أَرَادَ بِكُمۡ نَفۡعَۢاۚ بَلۡ كَانَ ٱللَّهُ بِمَا تَعۡمَلُونَ

[1] "Biharul Anuar", vëll. 67, f. 186.

خَبِيرًا ١١ بَلْ ظَنَنتُمْ أَن لَّن يَنقَلِبَ ٱلرَّسُولُ وَٱلْمُؤْمِنُونَ إِلَىٰٓ أَهْلِيهِمْ أَبَدًا وَزُيِّنَ ذَٰلِكَ فِى قُلُوبِكُمْ وَظَنَنتُمْ ظَنَّ ٱلسَّوْءِ وَكُنتُمْ قَوْمًۢا بُورًا ١٢ وَمَن لَّمْ يُؤْمِنۢ بِٱللَّهِ وَرَسُولِهِۦ فَإِنَّآ أَعْتَدْنَا لِلْكَٰفِرِينَ سَعِيرًا ١٣ وَلِلَّهِ مُلْكُ ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَٱلْأَرْضِ ۚ يَغْفِرُ لِمَن يَشَآءُ وَيُعَذِّبُ مَن يَشَآءُ ۚ وَكَانَ ٱللَّهُ غَفُورًا رَّحِيمًا ١٤

“Do të të thonë ty arabët e shkretëtirës, të cilët ngelën pas jush: ‘Ne ishim të zënë me bagëtitë dhe familjet tona, prandaj lutju All’llahut që të na falë ne!’. Ata thonë me gjuhën e tyre atë që nuk e kanë në zemrat e tyre. Thuaju: ‘Kush mund ta pengojë All’llahun ndaj jush, nëse Ai kërkon t’ju godasë ose, nëse synon t’ju bëjë ndonjë të mirë?’. All’llahu e di atë që ju bëni.”

“Jo! Ju menduat se i Dërguari dhe besimtarët nuk do të kthehen kurrë te familjet e tyre dhe zemrat tuaja ishin të kënaqura me këtë trill. Ju ushqyet mendime shumë të këqija dhe kështu u bëtë popull i pavlefshëm i nisur drejt shkatërrimit.”

“Kush nuk beson në All’llahun dhe në të Dërguarin e Tij, ta dijë se Ne kemi përgatitur për mohuesit një Zjarr flakërues!”

“I All’llahut është pushteti i qiejve dhe i Tokës. Ai fal kë të dojë e dënon kë të dojë. All’llahu është Falës i madh dhe Mëshirëplotë.”

Komentimi

Tek komentimi i ajeteve të mëparshme, përmendëm se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, bashkë më njëmijë e katërqind burra, prej shokëve të tij, u drejtuan nga Medina për në Mekë për të kryer ritualet e Umres.

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, gjithashtu, u dërgoi lajm banorëve të shkretëtirës, që t'i bashkoheshin atij dhe të bëheshin pjesë e këtij udhëtimi. Ndodhi, që një pjesë e atyre që e kishin besimin të dobët, të ulnin kokat e tyre dhe ta refuzonin ftesën e tij. Justifikimi i tyre ishte se myslimanët e kishin të pamundur të mbronin jetët e tyre gjatë këtij udhëtimi, sepse kurejshët ishin në luftë me myslimanët. Ata ishin përballur me ta në Betejën e Uhudit dhe të Ahzabit, shumë pranë Medines. Duke qenë kështu, ata menduan se, po të nisej ky grup kaq i vogël myslimanësh, tërësisht i çarmatosur në drejtim të Mekës, duke e ekspozuar veten ndaj rrezikut të armikut të armatosur gjer në dhëmbë, atëherë, si do të mund të ktheheshin gjallë në shtëpitë e tyre?!

Më pas, kur ata e panë se myslimanët u kthyen duarplot në Medine dhe arritën të përfitonin privilegje të shumta, të sanksionuara te Marrëveshja e Hudejbijes, pa u derdhur prej tyre as edhe një pikë e vetme gjaku, e kuptuan gabimin e tyre të madh dhe erdhën te Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* për të kërkuar falje, për të justifikuar

mungesën e pjesëmarrjes së tyre në këtë udhëtim, si dhe për të kërkuar prej tij që t'i lutej All'llahut t'i falte.

Tashmë e dimë se ajetet e para zbritën për t'i demaskuar ata dhe për t'ua hequr mundësinë e justifikimit.

Nisur nga kjo, ajetet e mësipërme tregojnë gjendjen e dezertorëve me besim të dobët, pasi ajetet e mëparshme kishin përshkruar gjendjen e hipokritëve dhe të idhujtarëve. Kështu plotësohen të gjitha hallkat e hulumtimit tonë dhe lidhen me njëra-tjetrën.

Këto ajete thonë: **"Do të të thonë ty arabët e shkretëtirës, të cilët ngelën pas jush: 'Ne ishim të zënë me bagëtitë dhe familjet tona, prandaj lutju All'llahut që të na falë ne!'. Ata thonë me gjuhën e tyre atë që nuk e kanë në zemrat e tyre..."**.

Ata nuk ishin të sinqertë as në pendimin e tyre.

Kumtoi atyre, o i Dërguari i All'llahut: **"...Thuaju: 'Kush mund ta pengojë All'llahun ndaj jush, nëse Ai kërkon t'ju godasë ose, nëse synon t'ju bëjë ndonjë të mirë?'. All'llahu e di atë që ju bëni."**.

All'llahu nuk e ka aspak të vështirë t'ju godasë ju me të gjitha llojet e fatkeqësive dhe të vuajtjeve, edhe nëse ju do të qëndroni aty ku pretendoni se jeni të sigurt, pranë familjeve dhe fëmijëve tuaj, ashtu siç nuk e ka të vështirë t'ju marrë nën mbrojtjen e Tij, nëse jeta juaj do të cenohet prej armiqve, edhe sikur të jeni te vendet e tyre, ku ata janë më të fuqishëm.

Është injoranca juaj ajo që ju shtyu ju, të imagjinoni dhe të besoni në këtë formë të gabuar.

Është e vërtetë, se **"...All'llahu e di atë që ju bëni."**.

Për më tepër, All'llahu është i Mirinformuar rreth të fshehtave dhe qëllimeve tuaja dhe Ai e di më së miri se këto hile e dredhi janë sajesa e justifikime tërësisht të pavërteta. Realiteti është se ju jeni të pavendosur dhe e keni besimin të dobët. Të gjitha këto justifikime të kota nuk mund t'i përdorni për të mashtruar All'llahun dhe ato nuk mund t'ua shmangin ndëshkimin, kurrsesi.

Interesantja e kësaj qasjeje është se këtu përfitohet prej melodisë dhe prej datave, gjithashtu, sepse këto ajete kanë zbritur teksa Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* po kthehej në Medine. Kjo do të thotë se gjithçka ka ndodhur përpara se dezertorët të vinin te Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* për të kërkuar falje. Kësisoj, ajeti i demaskoi ata dhe e zbuloi hilenë e tyre, përpara se ata të vinin.

Që ky realitet të bëhet më i qartë dhe që situata të bëhet më e kuptueshme, vjen Kur'ani, për të ulur të gjitha perdet dhe thotë: **"Jo! Ju menduat se i Dërguari dhe besimtarët nuk do të kthehen kurrë te familjet e tyre dhe zemrat tuaja ishin të kënaqura me këtë trill..."**.

Nuk ka dyshim se shkaku që ju shtyu të mos i bashkëngjiteni Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe shokëve të tij në këtë udhëtim historik, nuk ishte ajo që ju pretenduat se ishit të zënë me bagëtitë dhe familjet tuaja, por faktori kryesor ishte se ju menduat keq për All'llahun. Ky ishte shkaku kryesor. Ju, gabimisht menduat se ky ishte udhëtimi i fundit i Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i*

All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe i shokëve të tij dhe për këtë arsye, ai duhej shmangur.

Kjo është ajo që zemrat tuaja, ju kanë pështpëritur në vesh: **"...zemrat tuaja ishin të kënaqura me këtë trill..."**.

Ju menduat ligësisht, se All'llahu i Madhëruar e dërgoi Profetin e Tij për te ky udhëtim dhe e la atë tërësisht të pambrojtur në duart e armiqve të tij: **"...Ju ushqyet mendime shumë të këqija dhe kështu u bëtë popull i pavlefshëm i nisur drejt shkatërrimit."**.

Cila mund të jetë ajo humbje, më e keqe dhe më e madhe se mospjesëmarrja juaj në atë udhëtim historik të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*?! Mospjesëmarrja juaj te besëlidhja e Riduanit (Bej'atu Err Rriduan) ishte vërtet një turp i madh. Pas gjithë kësaj, ju pret një dënim i madh në Botën e Përtejme. Ky është realiteti. Ju kishit zemra të vdekura, të dobëta dhe ndaj u sprovuat me një përfundim si ky.

Duke qenë se këta njerëz, besimdobët dhe hipokritë, janë frikacakë që preferojnë qetësinë, largohen dhe i bëjnë dredhi luftës, betejave e sakrificës, janë të prirur të bëjnë analiza që nuk kanë kurrfarë lidhje me realitetin. Megjithatë, ata mendojnë se analiza dhe justifikimi i tyre ishin të pranueshme.

Sipas kësaj radhitjeje, vëmë re se frika, dëshira e tyre për të qenë të qetë dhe shmangia e përgjegjësive, e bën mendimin e tyre të keq për All'llahun, pasi ata mendojnë keq për gjithçka, madje edhe për All'llahun dhe të Dërguarin e Tij *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Këtë e vëmë re, po të

lexojmë këshillën e Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)* për Malik El Eshtër, te libri "Nehxhul Belaga", teksa thotë: "*Me të vërtetë që koprracia, frika dhe rehatia janë instinkte dhe epshe që i bashkon me njëra-tjetrën për të menduar keq për All'llahun.*".[1]

Ngjarja e Hudejbijes, bashkë me ajetet që ishin objekt hulumtimi, të orientojnë saktësisht drejt këtij kuptimi. Ato argumentojnë, gjithashtu, se burimi i të menduarit keq për All'llahun është një faqe e errët, që e bën njeriun plotësisht të ngjashëm me koprracin, frikacakun dhe dembelin, që kërkon vetëm rehati.

Duke qenë se shkaku i formimit të këtyre cilësive është mungesa e besimit, në Kur'an thuhet: **"Kush nuk beson në All'llahun dhe në të Dërguarin e Tij, ta dijë se Ne kemi përgatitur për mohuesit një Zjarr flakërues!"**.[2] Fjala *"es sei'jir"* nënkuptohen flakët e mëdha.

Ndërsa tek ajeti i fundit, ndër ato që jemi duke i studiuar, All'llahu i Madhëruar tregon për mundësinë që Ai ka për t'i ndëshkuar mosbesimtarët dhe hipokritët: **"I All'llahut është pushteti i qiejve dhe i Tokës. Ai fal kë të dojë e dënon kë të dojë. All'llahu është Falës i madh dhe Mëshirëplotë."**.

Një fakt tjetër që tërheq vëmendjen, është çështja e faljes, që, në këtë rast, përmendet përpara ndëshkimit, sikurse kemi në fund të ajetit, rëndësinë që i jepet faljes dhe mëshirës. Kjo, për

[1] "Nehxhul Belaga", "Err Rrisaleh", Nr. 59.

[2] Forma e fjalisë dhe mënyra se si është ndërtuar ajo, tregon se duhet të ishte: "Thuaj: 'Ne kemi përgatitur për ta një zjarr të madh.'", por Kur'ani e hoqi përemrin vetor dhe vendosi në vend të tij emrin e qartë: mosbesimtarët. U bë kështu, që të tregohet se arsyeja e këtij përfundimi të keq, është vetë kufri (mohimi).

arsye se të gjitha kërcënimet, në këtë rast, kanë qëllime edukative. Një mënyrë e mirë e edukative e bën të detyrueshme që rruga e kthimit prej gjynahut të jetë e hapur për gjynahqarët dhe jobesimtarët, pasi në themel të shumë prej këtyre sjelljeve negative qëndron injoranca dhe mungesa e dijes. Për këtë arsye, duhet të përcillet shpresë për falje, edhe për njerëz të kësaj kategorie, ku nëpërmjet lutjes dhe kërkimit të faljes t'i kthehen Rrugës së Drejtë.

Hulumtim

Justifikimi dhe mbulimi i gjynahut, sëmundje e përgjithshme

Sado i madh të jetë gjynahu, nuk është kurrë më i madh se përpjekja për ta justifikuar e për ta mbuluar atë, pasi ai që e pranon gjynahun, zakonisht i kthehet pendesës, por fatkeqësia më e madhe fillon kur gjynahqari nis e justifikon dhe i vesh me natyrë normaliteti gjynahet e tij. Kështu, ai jo vetëm që e mbyll derën e pendesës, por e shtyn veten akoma më shumë drejt ushtrimit të gjynahut. Ky lloj justifikimi ndodh ndonjëherë, me qëllim mbrojtjen e nderit dhe për të shmangur demaskimin apo

fëlliqjen. Më e keqja e të gjithave, është kur mashtron nëpërmjet kësaj personalitetin dhe qenien e tij.

Ky lloj justifikimi nuk është diçka e re, ndaj mund të takojmë të ngjashmit e tij përgjatë gjithë historisë së njerëzimit. Sa shumë kriminelë për gjatë historisë kanë mbuluar krimet e tyre, duke mashtruar vetveten me justifikime qesharake, të cilat e zhysin mendjen e njeriut në huti e habi?!

Duke qenë se Kur'ani ka për qëllim të edukojë dhe të ndërtojë njeriun pozitiv, i kuron sërish çështjet e kësaj natyre, paçka se një pjesë të madhe të tyre e kemi prekur edhe tek ajetet e mëparshme, objekte të studimit tonë.

Nuk ka asnjë problem sikur të ndalemi tek ajete të tjera, me qëllim plotësimin e studimit që lidhet me këtë aspekt.

1- Për t'i dhënë të drejtë politeizmit dhe idhujtarisë së tyre, arabët idhujtarë justifikoheshin shpesh me historitë e të parëve të tyre, duke thënë kështu: **"Ne i gjetëm baballarët tanë me këto tradita, kështu që edhe ne, do të vazhdojmë të ndjekim traditat që trashëguam prej tyre."**.[1]

Ata justifikohen, gjithashtu, duke e paraqitur gjendjen sikur të ishin nën trysninë e një detyrimi dhe thonë: **"Po të dëshironte All'llahu, as ne dhe as baballarët tanë nuk do të ishim prej idhujtarëve."**.[2]

2- Disa besimdobët vinin ndonjëherë te Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, për të

[1] Sure "Ez Zukhruf", ajeti 23.
[2] Sure "El En'am", ajeti 148.

justifikuar mosdaljen në luftë, duke thënë se shtëpitë e tyre ishin të pambrojtura. Një grup nga ata i kërkoi leje të Dërguarit të All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, duke thënë: **"Në të vërtetë, shtëpitë tona janë të pambrojtura, por ato nuk ishin të pambrojtura. Ata donin vetëm të iknin."**.[1]

3- Një tjetër justifikim, për të shmangur luftën, ishte pretendimi i tyre se gratë e romakëve ishin aq të bukura, sa mund t'i rrëmbenin zemrat e tyre dhe mund t'i sprovonin rëndë ata. Disa hipokritë thanë: **"Më lejo** (të mungoj në luftë) **dhe mos më vër në sprovë."**.[2]

4- Ndoshta janë justifikuar, duke thënë se ishin të zënë me punët, paratë, familjet dhe gratë e tyre, vetëm për t'ju shmangur bindjes ndaj urdhëresave të All'llahut dhe të Dërguarit të Tij *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, siç u paraqit tek ajetet e para.

5- Shejtani i mallkuar e justifikoi mosbindjen e tij ndaj All'llahut të Madhëruar, duke bërë një krahasim tërësisht të gabuar dhe tha: **"Unë jam më i mirë se ai** (njeriu)**, pasi mua më krijove prej zjarrit dhe ndërsa atë e ke krijuar prej balte."**.[3]

6- Gjatë kohës së injorancës (paditurisë), ata përpiqeshin, gjithashtu, të justifikonin vrasjen e vajzave të porsalindura duke thënë: "Kemi frikë se mos në kohë lufte do t'i kapin vajzat robina, kështu, për të mbrojtur nderin, ne i varrosim ato.". Herë të tjera janë justifikuar, duke thënë se varfëria dhe pamundësia për t'i

[1] Sure "El Ahzab", ajeti 13.
[2] Sure "Et Teube", ajeti 49.
[3] Sure "El A'raf, ajeti 12.

ushqyer është arsyeja e vrasjes së tyre, ashtu siç është përmendur te surja "Isra" dhe në sure të tjera të Kur'anit.[1]

Po ashtu, te disa ajete të tjera, vëmë re se kriminelët justifikohen me parinë e tyre, duke pretenduar se nuk mund t'i kundërshtojnë urdhrat e tyre: **"Ata thanë: 'Zoti ynë, ne iu bindëm urdhrave që na dhanë të mëdhenjtë tanë dhe paria jonë, ndaj janë ata që na shtynë drejt rrugës së të humburve.'"**.[2]

Përfundimisht, sëmundja e justifikimit të gjynaheve ka përmasa shumë të mëdha dhe ka prekur njerëzit e thjeshtë dhe të tjerët. Rreziku i madh i saj konsiston në faktin se ajo i mbyll dyert e korrigjimit dhe të kthesës nga rruga e gabuar. Ndodh, gjithashtu, që ajo t'i japë realitetit të gjynahqarëve një tjetër orientim.

Janë të shumë njerëzit, që frikën e justifikojnë me të qenit i kujdesshëm.

Kujdesin e justifikojnë, duke thënë se ai është siguri për jetën dhe për të ardhmen.

Aventurën, e justifikojnë me guximin.

Dobësinë, e justifikojnë me turpin.

Neglizhencën, e justifikojnë me asketizmin.

Kryerjen e haramit, e justifikojnë me dredhitë e ligjshme.

Largimin nga përgjegjësitë, e justifikojnë duke thënë se nuk është vendosur ende për këtë çështje.

---

[1] Sure "El Isra, ajeti 31.
[2] Sure "El Ahzab, ajeti 67.

Dembelizmin dhe shpërdorimin, e justifikojnë me vendimin dhe përcaktimin e All'llahut.

Kjo është mënyra me të cilën njeriu ia mbyll vetes dyert e shpëtimit.

Edhe pse secili prej këtyre kuptimeve mund të jetë i saktë dhe i përshtatshëm në raste dhe situata të caktuara, këto kuptime u shmangën dhe u përdorën për së prapthi. Sa shumë njerëz dhe shoqëri njerëzore, familje dhe individë kanë vuajtur e janë dëmtuar prej interpretimeve të tilla. Lusim All'llahun e Madhëruar të na marrë nën mbrojtjen e Tij prej këtyre fatkeqësive të mëdha!

Ajetet 15 – 17

سَيَقُولُ ٱلۡمُخَلَّفُونَ إِذَا ٱنطَلَقۡتُمۡ إِلَىٰ مَغَانِمَ لِتَأۡخُذُوهَا ذَرُونَا نَتَّبِعۡكُمۡۖ
يُرِيدُونَ أَن يُبَدِّلُواْ كَلَٰمَ ٱللَّهِۚ قُل لَّن تَتَّبِعُونَا كَذَٰلِكُمۡ قَالَ ٱللَّهُ مِن قَبۡلُۖ
فَسَيَقُولُونَ بَلۡ تَحۡسُدُونَنَاۚ بَلۡ كَانُواْ لَا يَفۡقَهُونَ إِلَّا قَلِيلٗا ١٥ قُل لِّلۡمُخَلَّفِينَ
مِنَ ٱلۡأَعۡرَابِ سَتُدۡعَوۡنَ إِلَىٰ قَوۡمٍ أُوْلِي بَأۡسٖ شَدِيدٖ تُقَٰتِلُونَهُمۡ أَوۡ يُسۡلِمُونَۖ
فَإِن تُطِيعُواْ يُؤۡتِكُمُ ٱللَّهُ أَجۡرًا حَسَنٗاۖ وَإِن تَتَوَلَّوۡاْ كَمَا تَوَلَّيۡتُم مِّن قَبۡلُ

يُعَذِّبۡكُمۡ عَذَابًا أَلِيمَا١٦ لَّيۡسَ عَلَى ٱلۡأَعۡمَىٰ حَرَجٞ وَلَا عَلَى ٱلۡأَعۡرَجِ حَرَجٞ وَلَا عَلَى ٱلۡمَرِيضِ حَرَجٞۗ وَمَن يُطِعِ ٱللَّهَ وَرَسُولَهُۥ يُدۡخِلۡهُ جَنَّٰتٖ تَجۡرِي مِن تَحۡتِهَا ٱلۡأَنۡهَٰرُۖ وَمَن يَتَوَلَّ يُعَذِّبۡهُ عَذَابًا أَلِيمَا١٧

"Ata që ngelën pas jush, do t'ju thonë, kur të niseni për të marrë plaçkën e luftës: 'Na lejoni edhe neve që të vijmë pas jush!'. Ata do të donin t'i ndërronin Fjalët e All'llahut. Thuaju: 'Ju kurrsesi nuk do të vini pas nesh, këtë e ka thënë All'llahu qysh më parë!'. E ata do të thonë: 'Nuk është ashtu, por ju na keni zili.'. Ah, sa pak që kuptojnë!"

"Thuaju atyre arabëve të shkretëtirës, që ngelën pas jush: 'Ju do të thirreni për të luftuar kundër një populli shumë luftarak, nëse ata nuk dorëzohen. Nëse bindeni, All'llahu do t'ju japë shpërblim të mirë, por, nëse shmangeni, ashtu siç keni bërë edhe më parë, Ai do t'ju ndëshkojë me dënim të dhembshëm.'"

"Nuk është gjynah për të verbrin, as për të çalin, as të sëmurin. Kush i bindet All'llahut dhe të Dërguarit të Tij, do të shkojë në Xhennete, nëpër të cilat rrjedhin lumenj, kurse ai që shmanget, do të ndëshkohet me dënim të dhembshëm."

Komentimi

Të mbeturit pas si përfitues nga rasti

Pjesa më e madhe e komentuesve të Kur'anit mendojnë se ky ajet flet për (triumfin e Khajberit) që ka ndodhur në fillim të vitit të shtatë të Hixhretit, pas Marrëveshjes së Hudejbijes. Këtë e sqarojnë disa transmetime, ku tregohet se, kur Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* po kthehej nga Hudejbija, myslimanëve që morën pjesë në Hudejbije, u dha lajmin e All'llahut për fitore në Khajber. Ai deklaroi se në këtë betejë do të merrnin pjesë vetëm ata që kishin qenë në Hudejbije. Ata që nuk kishin marrë pjesë në luftë, nuk do të merrnin asgjë prej plaçkës së luftës.

Kur robtë e kësaj dynjaje dhe ata që zemrat i kishin lidhur me të, e kuptuan se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* do të triumfonte, në mënyrë të padiskutueshme, në këtë betejë; kur e kuptuan, gjithashtu, se ushtarët e Islamit do të fitonin shumë plaçkë lufte, përfituan prej rastit dhe erdhën te Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, për të kërkuar prej tij leje, që të merrnin pjesë në Luftën e Khajberit. Justifikimi i radhës ishte se donin të shlyenin gabimet e tyre të mëparshme, t'i shërbenin me sinqeritet Islamit dhe Kur'anit dhe t'i bashkoheshin Profetit të All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* në fushëbetejën e kësaj lufte. Ata e harruan faktin se kishin zbritur disa ajete më parë, që e zbulonin të vërtetën e tyre. Këtë e lexojmë tek ajeti i parë i ajeteve që janë objekt i studimit tonë. **"Ata që ngelën pas jush, do t'ju thonë, kur të niseni për të marrë plaçkën e luftës: 'Na lejoni edhe neve që të vijmë pas jush...!'"**.

Ky aspekt nuk përmendet vetëm këtu, por edhe në shumë raste të tjera, ku këta vrapojnë pas çapës së yndyrshme, pa sakrifikuar aspak dhe largohen me shpejtësi prej fushëbetejave dhe prej çdo vendi ku ka rrezik. Këtë e lexojmë tek ajeti 42 i sures "Et Teube": **"Sikur fitorja të ishte e afërt dhe udhëtimi i shkurtër, ata do të të pasonin ty. Por iu duk rrugë e largët. Dhe ata do të betohen në All'llahun: 'Sikur të kishim mundur, do të dilnim bashkë me ju.'".**

Gjithsesi, Kur'ani Fisnik i kundërpërgjigjet këtyre përfituesve dhe gjuetarëve të rasteve: **"...Ata do të donin t'i ndërronin Fjalët e All'llahut..."**. Më pas shton duke i thënë Profetit të tij: **"...Thuaju: 'Ju kurrsesi nuk do të vini pas nesh...'"**.

Thuaju, o Muhammed se kjo nuk është fjala ime. **"...këtë e ka thënë All'llahu qysh më parë...!"** dhe na ka treguar edhe për të ardhmen tuaj, gjithashtu.

Vendimi i All'llahut është që plaçka e luftës, e përfituar në Khajber është vetëm për ata që kanë marrë pjesë në Hujdejbije dhe nuk do ta ndajnë atë me askënd tjetër. Por këta që mbetën pas, vazhduan të ngulin këmbë te babëzia e tyre, duke e akuzuar Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe të gjithë ata që ishin me të se ishin ziliqarë, ashtu siç thotë All'llahu i Madhëruar në Kur'an: **"...E ata do të thonë: 'Nuk është ashtu, por ju na keni zili...'"**.

Nëpërmjet kësaj fjale, ata përgënjeshtrojnë edhe Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, duke e konsideruar zilinë, si arsyen që Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nuk i

lejoi të merrnin pjesë në Luftën e Khajberit. Në fund të ajetit, Kur'ani e qartëson gjendjen e tyre dhe thotë: **"...Ah, sa pak që kuptojnë!"**.

Nuk ka asnjë dyshim se thelbi i vuajtjeve dhe i mungesës së fatit ishte injoranca e tyre dhe kjo injorancë do të jetë shoqëruesja e përhershme e tyre. Ata nuk e njihnin All'llahun e Madhëruar dhe as pozitën e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Ata nuk e dinin përfundimin e njeriut dhe as nuk e dinin se pasuria e kësaj bote është e përkohshme dhe e paqëndrueshme.

Vërtet që ata u treguan të zgjuar, për sa i përket çështjeve materiale dhe interesave personale, por nuk ka injorancë më të madhe se sa kur njeriu shet gjithçka, e bashkë me të, të gjithë qenien e tij në këmbim të pasurisë.

Përfundimisht, po t'i referohemi transmetimeve që vijnë nga lëmi i historisë, do të vëmë re se Profeti i nderuar *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e shpërndau plaçkën e Luftës së Khajberit vetëm për ata që morën pjesë në Hudejbije, madje edhe për ata që nuk u përfshinë në luftën e Khajberit, por që kishin marrë pjesë në Hudejbije, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* caktoi një pjesë të plaçkës së Luftës së Khajberit. Ky lajm vërtetohet vetëm prej thënies së njërit prej tyre, prej Xhabir ibn Abdilah El Ensarit.[1]

Në vazhdimësi të këtij studimi, do të vëmë re se ajeti i ardhshëm ofron një propozim konkret për ata që nuk kishin

[1] "Sijretu"i Ibn Hashim, vëll. 3, f. 364.

marrë pjesë në Hudejbije, duke hapur për ta derën e kthimit. Aty thuhet kështu: **"Thuaju atyre arabëve të shkretëtirës, që ngelën pas jush: 'Ju do të thirreni për të luftuar kundër një populli shumë luftarak, nëse ata nuk dorëzohen. Nëse bindeni, All'llahu do t'ju japë shpërblim të mirë, por, nëse shmangeni, ashtu siç keni bërë edhe më parë, Ai do t'ju ndëshkojë me dënim të dhembshëm.'"**.

Sapo të pendoheni për veprat dhe historinë tuaj të mëparshme, sapo të hiqni dorë nga adhurimi i kësaj bote, duhet të vërtetoni sinqeritetin tuaj gjatë vështirësive të ardhshme dhe të jepni kontributet tuaja atje. Në rast të kundërt, duhet ta dini se shmangia e vështirësive dhe kërkesa e plaçkës së luftës, pa asnjë sakrificë, është tërësisht e papranueshme. Ky është një argument i qartë, që tregon hipokrizinë, frikën dhe besimin tuaj të dobët.

Bukuria e kësaj pjese qëndron te fakti se Kur'ani e ka përsëritur tek ajetet e tij disa herë, përmendjen e atyre që mbetën pas dhe në vend që të përdorej përemri dëftor, është përdorur emërtimi i plotë i tyre.

Kjo shprehje ka ardhur në formën e emrit mbi të cilin bie veprimi *"el mukhal'lefine" – "ata që mbetën pas"*, pra, ata që latë nga pas. Këtu tregohet se myslimanët besimtarë, kur dëgjonin justifikimet dhe hiletë e tyre, nuk ua vinin veshin, nuk u jepnin asnjë rëndësi fjalëve të tyre dhe i linin nga pas, duke vazhduar vetë përpara, pa e kthyer kokën prapa, duke vazhduar rrugëtimin e tyre për te fushëbetejat që i prisnin.

Por, cilët janë ata që në ajet përmenden si popull shumë luftarak? Çfarë përfaqësojnë ata? Është folur shumë prej komentuesve të Kur'anit rreth tyre.

Sifjalia: **"nëse ata nuk dorëzohen"**, tregon se ata nuk kanë qenë prej ithtarëve të Librit (hebrenj apo të krishterë), pasi ithtarët e Librit nuk detyrohen ta pranojnë Islamin. Ata lihen të lirë dhe u jepet mundësia të zgjedhin ndërmjet Islamit, dhënies së xhizjes (taksës) dhe bashkëjetesës me myslimanët, sipas kushteve të përcaktuara për *(Ehlu Dhimmeh)* të krishterët apo hebrenjtë që banojnë në shtetin islam.

Kategoria e njerëzve që prej tyre nuk pranohet asgjë tjetër, përveç Islamit, janë vetëm idhujtarët dhe adhuruesit e putave. Kjo, sepse Islami nuk e njeh si fe adhurimin e putave dhe gjykon se ata duhet të detyrohen të heqin dorë prej adhurimit të tyre. Duke qenë se gjatë kohës së Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, pas Hudejbijes, nuk ka ndodhur ndonjë betejë e rëndësishme me idhujtarët, përveç çlirimit të Mekës dhe Betejës së Hunejnit, ajeti i mëparshëm mund të jetë tregues pikërisht për këtë, veçanërisht për Betejën e Hunejnit, pasi kjo ishte beteja në të cilën morën pjesë ata që u quajtën popull shumë luftarak. Ata ishin Heuazin dhe Beni Sa'ad.

Disa komentues të tjerë mendojnë se ekziston mundësia që ajeti të jetë tregues për Betejën e Mu'tes, që u zhvillua kundër romakëve, por ky mendim qëndron larg të vërtetës, pasi romakët ishin prej ithtarëve të Librit.

Ekziston mundësia, gjithashtu, që ajeti të jetë tregues për betejat që kanë ndodhur pas ndarjes nga jeta të Profetit

Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Prej këtyre betejave, ishin: beteja e persëve dhe e jemames. Por kjo është akoma më larg të vërtetës se e para, pasi melodia dhe ndjesia që përcjellin ajetet, të bën të kuptosh se lufta do të ndodhë në kohën e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Për këtë arsye, kuptimin e ajeteve nuk mund ta lidhim me betejat që kanë ndodhur pas Profetit. Arsyetime si këto, tregojnë se komentuesit kanë qenë të shtyrë dhe të motivuar politikisht, lidhur me çështjen në fjalë.

Këtu përballemi me një moment që duhet të ndalemi dhe të meditojmë. Ai është fakti se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nuk u premton atyre gjë, duke u thënë se do të fitojnë plaçkë lufte në betejat e ardhshme, pasi qëllimi i luftës nuk është plaçka e luftës, por diçka më e rëndësishme, që është përfitimi i shpërblimit të madh të All'llahut. Ky shpërblim, zakonisht merret në Ahiret (në Jetën e Përtejme).

Këtu lind një tjetër pyetje, pasi ajeti 83 i sures "Et Teube", i kundërpërgjigjet, në mënyrë të prerë, këtyre (të vonuarve që mbetën pas). Aty thuhet kështu: **"Kurrë nuk do të vini me mua në luftë dhe kurrë nuk do të luftoni me mua kundër armikut. Ju ishit të kënaqur kur nuk erdhët me mua herën e parë, prandaj rrini me ata që ngelën pas."**. Ndërkohë, ajeti që jemi duke e studiuar, u bën thirrje atyre për luftë e përpjekje gjatë vështirësive të mëdha: **"Ju do të thirreni për të luftuar kundër një populli shumë luftarak."**. Çfarë tregon e gjitha kjo?

Nëse do t'i kthehemi ajetit 83 të sures "Et Teube", do të vëmë re se ai është i lidhur me të mbeturit pas, prej të cilëve, i

hoqi tërësisht shpresat në Luftën e Tebukut, ndërsa ajeti që jemi duke e studiuar, flet për ata që mbetën pas dhe nuk morën pjesë në Hudejbije, prej të cilëve Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* vazhdonte të kishte shpresa se mund të merrnin pjesë.

Kështu qartësohet edhe kjo situatë, duke qenë se prej atyre që mbetën pas, kishte njerëz të justifikuar, pasi u mungonte ndonjë gjymtyrë në trupin e tyre, apo për shkak të ndonjë sëmundjeje dhe arsye të ngjashme me këto. Këto arsye, e bënin të pamundur pjesëmarrjen e tyre në luftë, ndaj nuk duhet ta mohojmë të drejtën e tyre, pasi ajeti i fundit, objekt i studimit tonë, i bën të qarta justifikimet e tyre, shto këtu mendimin e disa komentuesve që thanë se një grup invalidësh erdhi te Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* menjëherë pas zbritjes së këtij ajeti dhe kërcënimit që bart ai për të mbeturit pas dhe i thanë: "O i Dërguari i All'llahut, cila është përgjegjësia jonë në këtë rast?".

Menjëherë zbriti ajeti kur'anor, tek i cili All'llahu i Madhëruar thotë: **"Nuk është gjynah për të verbrin, as për të çalin, as të sëmurin..."**.

Nuk është vetëm lufta *(xhihadi)* e kushtëzuar me mundësinë. Të gjitha detyrimet e tjera hyjnore janë të lidhura me një varg të gjatë kushtesh të përgjithshme, pjesë e të cilave është aftësia dhe mundësia për t'i kryer ato. Këto kuptime janë përmendur te shumë ajete kur'anore. Një rast i qartë, i lidhur me këtë rregull, është ajeti 286 i sures "El Bekare", ku thuhet: **"All'llahu nuk i ngarkon njerëzit përtej mundësive të tyre."**. Ky

është prej kushteve konstante bazuar te argumentet tesktore dhe njëkohësisht atyre logjik.

Natyrshëm, ata duhet të japin kontributet e tyre nëpërmjet formave të tjera, me aq sa të munden, që qëllimet hyjnore të shkojnë përpara dhe të forcohet sa më shumë Islami. Këtë e lexojmë tek ajeti 91 i sures "Et Teube": **"Nuk është gjynah të mos shkojnë në luftë të dobëtit, as të sëmurët, as ata që nuk mund të sigurojnë shpenzimet, nëse janë të sinqertë ndaj All'llahut dhe të Dërguarit të Tij."**.

Pra, nëse ata nuk kanë mundësi që ta kryejnë një punë me duart e tyre, duhet të bëjnë të gjitha përpjekjet e tjera, brenda mundësive dhe të mos sjellin justifikime për atë që kanë mundësi ta bëjnë. Kjo shprehje e bukur tregon se nuk duhet të nënvlerësohet kurrë asnjë lloj mundësie. E thënë ndryshe, nëse ata nuk e kanë të mundur të marrin pjesë në frontin e parë të luftës, le të marrin pjesë, duke e dhënë më së pakti, ndihmesën e tyre në prapavijë.

Është e mundur që tek ajeti i fundit, prej ajeteve në fjalë, të ketë një tjetër tregues që lidhet me këtë kuptim: **"...Kush i bindet All'llahut dhe të Dërguarit të Tij, do të shkojë në Xhennete, nëpër të cilat rrjedhin lumenj, kurse ai që shmanget, do të ndëshkohet me dënim të dhembshëm."**.

Ekziston një tjetër mundësi, gjithashtu. Janë disa persona, të cilët e justifikojnë veten nga pjesëmarrja dhe ndihmesa në raste të veçanta (duke mos e kuptuar tekstin kur'anor). Kur'ani i kërcënon këta, duke i kujtuar se, nëse nuk janë të justifikuar, All'llahu do të rezervojë për ta një dënim të dhembshëm. Për sa i përket mbrojtjes ndaj Islamit, tokës islame dhe ndaj vetvetes, secili

duhet t'i mbrojë këto me të gjitha mundësitë e tij, pasi në këtë rast nuk ka asnjë përjashtim.

Ajetet 18 – 19

۞لَّقَدۡ رَضِيَ ٱللَّهُ عَنِ ٱلۡمُؤۡمِنِينَ إِذۡ يُبَايِعُونَكَ تَحۡتَ ٱلشَّجَرَةِ فَعَلِمَ مَا فِي قُلُوبِهِمۡ فَأَنزَلَ ٱلسَّكِينَةَ عَلَيۡهِمۡ وَأَثَٰبَهُمۡ فَتۡحَا قَرِيبَا١٨ وَمَغَانِمَ كَثِيرَةَ يَأۡخُذُونَهَاۗ وَكَانَ ٱللَّهُ عَزِيزًا حَكِيمَا١٩

"All'llahu është i kënaqur me ata besimtarë, kur t'u betuan për besnikëri nën hijen e pemës. Ai e dinte se ç'kishte në zemrat e tyre, prandaj u dha atyre qetësi dhe i shpërbleu me një fitore të afërt."
"E me një plaçkë të madhe që do ta fitojnë. All'llahu është i Plotfuqishëm dhe i Urtë."

Komentimi

All'llahu është i kënaqur me ata që morën pjesë te Besëlidhja e Riduanit

Është përmendur edhe më parë dialogu që ndodhi në Hudejbije ndërmjet përfaqësuesve të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe atyre të kurejshëve. Ndërmjet të deleguarve që përfaqësonin Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, ishte Uthman ibn Afani, i cili kishte lidhje të ngushta me Ebu Sufjanin. Kjo marrëdhënie e tij mund të ketë qenë njëra prej arsyeve që e përzgjodhën atë të jetë përfaqësuesi i Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Ai u delegua te paria e Mekës dhe banorët idhujtarë të kurejshëve, për t'u treguar atyre se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nuk kishte për qëllim luftën, as përballjen e armatosur, por të vizitonte Shtëpinë e Shenjtë të All'llahut, bashkë me shokët e tij.

Kurejshët e ndaluan përkohësisht Uthmanin, derisa ndërmjet myslimanëve u përhap lajmi se Uthmani ishte vrarë. Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* tha: "Nuk kam për t'u larguar nga ky vend, pa luftuar me armikun tim.".

Më pas, ai iu drejtua një peme aty pranë dhe kërkoi prej myslimanëve që t'i jepnin sërish besën atij nën hijen e saj. Ai kërkoi prej tyre të luftonin fuqimisht idhujtarët dhe të mos tërhiqeshin prej fushëbetejave.[1]

Jehona e kësaj besëlidhjeje mbërriti deri në Mekë dhe kurejshët u trembën aq shumë, sa u detyruan ta lironin Uthmanin.

Është tashmë e ditur se kjo besëlidhje u quajt Besëlidhja e Riduanit. Ajo injektoi frikë te radhët e idhujtarëve, kësisoj, ajo ishte një kthesë shumë e rëndësishme për historinë islame.

Të dyja ajetet që jemi duke studiuar, flasin për këtë histori. Aty thuhet kështu: **"All'llahu është i kënaqur me ata besimtarë, kur t'u betuan për besnikëri nën hijen e pemës..."**.

Qëllimi kryesor i kësaj besëlidhjeje ishte harmonizimi më i madh ndërmjet forcave, ngritja e moralit, rimobilizimi ushtarak, njohja me mendimet, matja e nivelit të sakrificës te të sinqertët dhe besnikët.

Kjo besëlidhje e ngriti shumë moralin e besimtarëve, sepse ata ua zgjatën duart e tyre Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i*

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", fundi i ajeteve që jemi duke studiuar.

All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe treguan edhe njëherë besnikërinë që buronte nga thellësitë e zemrave të tyre.

All'llahu i Madhëruar u dha këtyre besimtarëve të sinqertë, që ishin të gatshëm të sakrifikonin veten e tyre, të njëjtin shpërblim që i dha Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* në këtë çast delikat. Ai u dha atyre që i dhanë besën Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* katër lloje shpërblimesh. Më i rëndësishmi i tyre ishte (kënaqësia e All'llahut) ashtu siç përmendet tek ajeti 72 i sures "Et Teube", ku All'llahu i Madhëruar thotë kështu: **"Por, kënaqësia e All'llahut është shpërblimi më i madh."**.

Më pas, në ajet thuhet: **"...Ai e dinte se ç'kishte në zemrat e tyre, prandaj u dha atyre qetësi...".**

Paqe shpirtërore dhe qetësi pa kufi për zemrat e tyre, pasi ata ishin në mes të armiqve e shumë larg familjeve dhe vendit të tyre. Përballë tyre qëndronte një armik i armatosur gjer në dhëmbë, ndërsa myslimanët ishin tërësisht të paarmatosur (pasi ata kishin ardhur për të kryer ritualet e Umres, jo për të luftuar) e megjithatë, ata qëndruan të fortë si një mal shtatlartë dhe frika nuk mundi ta gjente një rrugë për te zemrat e tyre.

Ky ishte shpërblimi dhe dhurata e dytë nga ana e All'llahut, me të cilën All'llahu i Madhëruar i furnizoi ata. Është e natyrshme që mirësitë, begatitë dhe furnizimi hyjnor kanë qenë vazhdimisht shtylla kryesore e mbështetjes që u është dhënë njerëzve të sinqertë dhe besnikë.

Tek një hadith i Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)* thuhet: *"Kur një rob i varfër dhe i pafuqishëm i All'llahut, e shpreh qëllimin e tij dhe thotë: 'O Zoti im, ma jep mundësinë ta bëj këtë apo atë të mirë dhe sapo All'llahu ta dëgjojë lutjen e tij të sinqertë, regjistron për të një shpërblim të ngjashëm me atë që do të merrte, sikur ta kishte kryer në të vërtetë atë vepër të mirë, me të vërtetë, All'llahu është Bujar i madh.'"*.[1]

Në fund të këtij ajeti, flitet edhe për shpërblimin e tretë. Në ajet thuhet kështu: **"...i shpërbleu me një fitore të afërt."**.

Po, është e vërtetë. Kjo fitore e shpejtë ishte triumfi i myslimanëve në Luftën e Hajberit, ashtu siç ka thënë pjesa më e madhe e komentuesve (edhe pse disa prej tyre mendojnë se bëhet fjalë për çlirimin e Mekës). Kjo fitore ishte shpërblimi i tretë që All'llahu i Madhëruar u dha besimtarëve, të sinqertëve që sakrifikuan veten e tyre, për hir të Islamit.

Fraza *"karijben" – "të afërt"*, është tregues i qartë se këtu bëhet fjalë për çlirimin e Khajberit, pasi kjo fitore e myslimanëve ndodhi disa muaj (tre deri në shtatë) pas Marrëveshjes së Hudejbijes, në fillim të vitit të shtatë të Hixhretit.

Për sa i përket shpërblimit apo mirësisë së katërt, me të cilën All'llahu i Madhëruar i begatoi myslimanët gjatë Besëlidhjes së Riduanit, ishte ajo që përmendet tek ajeti tjetër: **"E me një plaçkë të madhe që do ta fitojnë..."**.

Një pjesë e plaçkës së luftës, që ra në duart e myslimanëve, shumë pak kohë pas Marrëveshjes së Hudejbijes, ishte plaçka e

[1] "Biharul Anuar", vëll. 70, f. 199.

Luftës së Kajberit. Po t'i referohesh pasurisë së madhe që kishin hebrenjtë, do të kuptosh rëndësinë e plaçkës së luftës në këtë rast.

Mirëpo, nuk është se kemi ndonjë argument të formës së prerë, që vërteton se në këtë rast kemi të bëjmë më plaçkën e Luftës së Khajberit. Për këtë arsye, mund ta konsiderojmë të gjithë plaçkën e luftës që ra në duart e myslimanëve pas çlirimit të Mekës, pjesë të plaçkës së luftës që përmendet në ajet.

Myslimanët duhet të kishin qetësi të plotë, lidhur me këtë aspekt dhe për këtë arsye erdhi edhe ajeti kur'anor, në fund të të cilit, thuhet kështu: **"...All'llahu është i Plotfuqishëm dhe i Urtë."**.

Fakti, që All'llahu i Madhëruar ju urdhëroi në Hudejbije të nënshkruani Marrëveshjen e paqes, ishte një element i lidhur me thelbin e urtësisë e të vendimeve të Tij. Sekretet e kësaj urtësie u qartësuan me kalimin e kohës. Duke qenë se All'llahu ju premtoi një fitore të shpejtë dhe plaçkë të shumtë lufte, Ai tregoi më pas se i kishte të gjitha mundësitë për të realizuar dhe për të vërtetuar premtimet e Tij.

Kështu, myslimanët e sinqertë, të devotshëm, besnikë e sakrifikues përfituan prej rezultateve të Besëlidhjes së Riduanit, një fitore për këtë botë dhe një fitore për Ahiretin në ato momente aq delikate për myslimanët. Ndërkohë, hipokritët injorantë e besimdobët, u dogjën prej zjarrit të dhimbjes së tyre.

Bisedën tonë e përfundojmë me një fjalë të Prijësit të myslimanëve, Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*, teksa përshkruan trimërinë, besnikërinë, luftën, përpjekjet dhe sakrificat e pakrahasueshme dhe të pazakonta të myslimanëve të parë. Ai u

drejtohet atyre që e kanë besimin e dobët, duke i kritikuar për pozitën e tyre poshtëruese, duke thënë: "All'llahu hodhi përmbi armiqtë tanë frikë e humbje dhe na dhuroi ne fitore, kur e pa sinqeritetin tonë, derisa Islami mbërriti te popujt që na rrethojnë, i sigurt dhe i qëndrueshëm në vatanin e tij. Pasha Zotin, sikur të kishim bërë ashtu si keni bërë ju, nuk do të ngrihej asnjë shtyllë e fesë dhe as do të gjelbërohej ndonjë degë e besimit! Betohem në All'llah, se me gjak e pendesë keni për ta paguar këtë.".[1]

Hulumtim

Besa dhe veçoritë e saj

Fjala *"el bej'atu" - "besa"* vjen prej fjalës *"bej'un" – "shitje",* që në origjinë ka kuptimin e dhënies së dorës në përfundim të marrëveshjes. Më pas, me këtë shprehje u quajt zgjatja e dorës në fund të marrëveshjes. Kështu ndodhte, sa herë që dikush donte t'i bënte me dije personit tjetër besnikërinë dhe bindjen e tij. Kështu,

[1] "Nehxhul Belaga", Hytbja 56.

nëpërmjet zgjatjes së dorës, ai e njeh zyrtarisht marrëveshjen. Përdorimi i kësaj fjale bëhej për të nënkuptuar që secila palë zotohej, ashtu siç japin fjalën dhe bien dakord ndërmjet tyre nënshkruesit e një marrëveshjeje. Ndodhte ndonjëherë, që kjo lloj bese të bëhej shkak që njëra prej palëve të sakrifikonte tjetrën, pasurinë dhe fëmijën e vet, për hir të besës së dhënë. Ai që e pranon këtë besë, zotohet se do ta respektojë e do ta mbrojë atë.

Lidhur me këtë aspekt, Ibn Khalduni thotë te pjesa e parë e historisë së tij: "Sa herë që prijësi i tyre u kërkonte besën, i vendoste duart e tyre përmbi dorën e tij për t'u siguruar, ndaj e ngjasonte atë me sjelljen e shitësit dhe të blerësit.".[1]

Të tjera raste të ngjashme, tregojnë se besëlidhja nuk ishte prej zakoneve të myslimanëve, por ishte një traditë e arabëve përpara Islamit. Për këtë arsye, në fillimet e Islamit erdhi një grup prej fisit El Eus dhe El Khazrexh gjatë sezonit të Haxhit, nga Medina në Mekë, për t'i dhënë besën Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* në Akaba. Mënyra se si ata u sollën gjatë procesit të besëlidhjes, tregon se ato veprime nuk ishin të huaja e të panjohura për ta. Pas saj, (Akabasë) Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e përsëriti besëlidhjen me myslimanët në kohë dhe vende të ndryshme, njëra prej të cilave ishte ajo që u quajt si Besëlidhja e Riduanit në Hudejbije. Besëlidhja që ndodhi gjatë çlirimit të Mekës, ishte akoma më e zgjeruar. Këtë do ta sqarojmë gjatë komentimit të sures "El Mumtehin".

Si plotësohet besëlidhja? Përgjithësisht, besëlidhja plotësohet si më poshtë:

[1] Ibn Khaldun "Mukadimetu", f. 174.

Personi që e jep besën, e zgjat dorën drejt personit, prej të cilit e kërkon besën, duke kërkuar të deklarojë besnikërinë dhe bindjen ndaj tij. Ndodh që ai të përmendë kushte dhe kufi të lidhura me besëlidhjen, si psh: të japë besën se do të shpenzojë pasurinë, ose do të japë jetën e tij dhe bashkë me to nuk do të kursejë as sakrifikimin e babait apo të gruas së tij.

Ndodh që besëlidhja të jetë e atillë që, personi i cili e jep besën, të mos çlirohet prej efekteve të saj deri në fund të jetës së tij, kur t'i vijë vdekja. Të dyja këto kuptime, ishin të pranishme te Besëlidhja e Riduanit, ashtu siç është deklaruar te burimet e ndryshme të historisë.

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e pranonte edhe besën e grave, gjithashtu, por duke mënjanuar vënien e dorës së tyre përmbi dorën e tij të nderuar, por urdhëronte që t'i sillnin një enë të madhe të mbushur me ujë. Kështu, ai e fuste dorën e tij te njëra anë e enës dhe gratë e fusnin tek ana tjetër e saj. Prej kushteve të besëlidhjes, përcaktohej ndonjëherë kryerja e ndonjë veprimi të caktuar dhe lënia e një tjetri, ashtu si kushti që Profeti i nderuar Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* u vendosi grave që i dhanë besën atij pas çlirimit të Mekës.

All'llahu i Madhëruar thotë në Kur'anin Famëlartë: **"O Profet, nëse vijnë te ti besimtaret e të betohen se nuk do t'i shoqërojnë All'llahut asgjë** (në adhurim)**, nuk do të vjedhin, nuk do të kurvërojnë, nuk do t'i vrasin fëmijët e tyre, nuk do të**

sjellin ndonjë shpifje lidhur me atësinë e fëmijës, të sajuar nga ato vetë...”.[1]

Në të gjitha rastet, gjykimet e lidhura me besëlidhjen janë të përfshira në hulumtime të ndryshme, një pjesë të të cilave do t'i përmendim shkurtimisht gjatë këtij hulumtimi, edhe pse ato janë të përfshira prej një gjendjeje të mungesës së informacionit në jurisprudencën islame.

1- Natyra (forma) e besëlidhjes është një lloj i caktuar i lidhjes dhe i besës ndërmjet atij që e jep besën, nga njëra anë, dhe atij që e miraton atë, nga ana tjetër. Ajo përmban ndjekjen, mbrojtjen dhe bindjen ndaj urdhrave të personit që i është dhënë besa. Ajo ka disa forma e nivele, të lidhura me natyrën e kushteve që përcaktohen në secilën marrëveshje dhe, në lidhje me këtë aspekt, përfitojmë prej frymës së ajeteve kur'anore dhe thënieve profetike, ku ajo përcaktohet si një marrëveshje detyruese për besëdhënësin që e detyron atë të veprojë sipas rregullave dhe kushteve të përcaktuara në të. Kjo përfshihet edhe te ligji i përgjithshëm, i cili përmendet në Kur'an, ku All'llahu i Madhëruar thotë: **“Qëndroni besnikë dhe zbatoni marrëveshjet tuaja.”**.[2] Nisur nga ky fakt, besëdhënësit nuk i lejohet prishja e marrëveshjes, por prishja e saj i lejohet personit që e kërkon besën, nëse sheh te kjo prishje e marrëveshjes një interes më të madh të përbashkët. Në këtë rast, besëdhënësi mund të çlirohet prej besës së dhënë.[3]

---

[1] Sure “El Mumtehin”, ajeti 12.

[2] Sure “El Maide”, ajeti 1

[3] Tek ngjarja e Kerbelasë, lexojmë se, kur Imam Hysejni *(Paqja qoftë mbi të!)* u ligjëroi shokëve të tij në natën e dhjetë të muajit Muharrem, i çliroi ata prej besëlidhjes, pasi e kishte vënë re vlerësimin e tyre për të dhe, duke i

2- Disa të tjerë mendojnë se besëlidhja është një formë e caktuar e zgjedhjeve, por ajo ka kuptime diametralisht të kundërta me zgjedhjet. Zgjedhjet janë gjetja e një lloj përgjegjësie, pozite dhe pune për të zgjedhurin apo në një formë tjetër ajo është autorizimi që i lëshohet të zgjedhurit për kryerjen e një punë, edhe pse zgjedhja përcakton detyrat edhe për zgjedhësin, gjithashtu (ashtu si te të gjitha llojet e tjera të autorizimeve), ndërkohë që besëlidhja ka këtë natyrë. Me fjalë të tjera, zgjedhjet janë dhënie e pozitës dhe zgjedhja ngjason me autorizimin, ndërkohë që besëlidhja është zotim për bindje ndaj urdhëresave. Zgjedhjet dhe besëlidhja mund të takohen me njëra-tjetrën në disa pika të përbashkëta kuptimore, por kjo nuk do të thotë se janë të ngjashme në formë. Për këtë arsye, besëdhënësi nuk mund ta prishë marrëveshjen e besëlidhjes, ndërkohë që zgjedhësit kanë të drejtë ta prishin marrëveshjen, si në ato raste, kur një grup i zgjedhësve vendosin ta rrëzojnë nga pushteti të zgjedhurin e tyre. (Vini re me kujdes!)

3- Për sa i përket Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe Imamëve të imunizuar prej gabimeve, të emëruar prej All'llahut të Madhërishëm, ata nuk kanë nevojë të kërkojnë besën. Kjo do të thotë se bindja ndaj Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe Imamit të imunizuar prej gabimeve (të emëruar prej All'llahut) është e detyrueshme për atë

falënderuar ata për mbështetjen që i kishin dhënë, i lejoi të shkonin ku të dëshironin, duke u thënë kështu: "Mund të shkoni ku të dëshironi. Ju jeni tashmë të çliruar prej detyrimeve dhe nuk keni më asnjë pengesë prej meje.". Por ata nuk e lanë Imam Hysejnin *(Paqja qoftë mbi të!)* vetëm, duke i qëndruar besnikë deri në fund. (Ibnu Ethir, "El Kamil", vëll. 4, f. 57.)

që ka dhënë besën, por edhe për ata që nuk e kanë dhënë një të tillë. E thënë ndryshe, pozita e profetësisë dhe ajo e Imamit të imunizuar prej gabimeve e bën të detyrueshme bindjen, ashtu siç thotë All'llahu i Madhëruar në Kur'an: **"Bindjuni All'llahut, të Dërguarit të Tij dhe parisë suaj."**.[1]

Këtu lind një pyetje tjetër. Nëse çështja do të ishte kështu, atëherë cila është arsyeja, se përse Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e kërkoi besën prej shokëve të tij apo prej myslimanëve të rinj, disa herë njëra pas tjetrës? Për dy prej këtyre rasteve është folur qartë në Kur'anin Famëlartë. Njëra prej tyre është Besëlidhja e Riduanit, objekti i studimit tonë dhe rasti tjetër është Besëlidhja me banorët e Mekës, për të cilën flitet në suren "El Mumtehin".

Për t'ju përgjigjur kësaj pyetjeje mund të themi: Nuk ka dyshim se këto besëlidhje ishin një formë e caktuar e përforcimit të besnikërisë, e ndodhur kjo, në rrethana të veçanta gjatë përballjes me vështirësitë dhe krizat e shumta. Ato kishin për qëllim të rilindnin moralin te individët, ashtu siç e pamë ndikimin e jashtëzakonshëm gjatë Besëlidhjes së Riduanit, te studimi i mëparshëm.

Për sa i përket besës që lidhet me pasuesit e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, kjo ishte një besëlidhje e bazuar mbi pranimin e pozitës së Kalifatit, edhe pse ne nuk besojmë te kalifati i atij që e pasoi Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, besa e të cilës merret nëpërmjet njerëzve, por që, në të vërtetë, është e lidhur me All'llahun dhe vihet në zbatim

[1] Sure "En Nisa", ajeti 59

nëpërmjet tekstit të përcaktuar prej Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* apo prej Imamit për pasardhësin e tij.

Nisur nga sa thamë më sipër, mund të themi se besëlidhja që myslimanët i dhanë Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)* apo Hasanit dhe Hysejnit *(Paqja qoftë mbi ta!)* vjen si vërtetim i besës së dhënë dhe është e ngjashme me besën që ka lidhur Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

4- A mund të themi se besëlidhja në ditët e sotme pranohet si një aplikim me baza islame, apo e thënë ndryshe, a mund të përgjithësohet besëlidhja? A është e mundur që një grup i caktuar njerëzish të përzgjedhin një person të përshtatshëm, i cili i plotëson kushtet fetare, si për shembull, drejtuesin e përgjithshëm të forcave të armatosura, drejtuesin e një shoqate, kreun e një qeverie dhe t'i japë besën?! A i përfshin kjo lloj besëlidhje kushtet që ligjvënësi (All'llahu) ka vendosur për besëlidhjen?!

Përgjigjja për këtë çështje është:

Nuk gjejmë në asnjë rast, as në Kur'an, as në traditën profetike, përgjithësim absolut, për sa i përket çështjes së besëlidhjes. Përgjithësimi i kësaj çështjeje është problematike, edhe pse mund të vijë si përgjithësim në rastin e ajetit kur'anor, ku All'llahu i Madhëruar thotë: **"Zbatoni marrëveshjet tuaja…"**. Për sa i përket kësaj paqartësie, te çështjet e besëlidhjes, mund të themi se kemi një pengesë për t'ju referuar absolutizmit te rasti **"Zbatoni marrëveshjet tuaja"**, paçka se te jurisprudenca islame nuk gjejmë asnjë rast tjetër të besëlidhjes përveç rastit të Profetit

Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe të Imamit të pagabueshëm.

Duhet të kuptojmë se bukuria e këtij momenti qëndron te fakti se pozita e zëvendësit të prijësit, fekih, sipas nesh, është e përcaktuar prej Imamëve të pagabueshëm, kështu që ata nuk e kanë të nevojshme besëlidhjen. Natyrshëm, pasimi që njerëzit i bëjnë prijësit dhe bindja ndaj urdhrave të tij, i jep atij mundësinë, që të përfitojë prej kësaj pozite. Gjithashtu, i jep atij mundësinë e shtrirjes së dorës, por kjo nuk do të thotë aspak se pozita e tij është e lidhur me besën e dhënë prej njerëzve. Kështu, edhe ndjekja që njerëzit i bëjnë atij, nuk ka lidhje me besëlidhjen, por me zbatimin dhe vënien në praktikë të një urdhërese të qartë që vjen nga All'llahu lidhur me prijësin. (Vini re me kujdes!)

5- Në të gjitha rastet, besëlidhja është e lidhur me çështjet praktike dhe nuk ka lidhje me gjykimin fetar, që do të thotë se besëlidhja nuk i jep askujt të drejtën e ligjvënies (urdhëresës) apo të ndalesës, sepse të gjitha çështjet duhet të merren nga Libri i All'llahut dhe nga tradita profetike dhe më pas, të zbatohen në kufijtë e realitetit. Këtë gjykim askush nuk e kundërshton.

6- Mund të përfitojmë prej transmetimeve, se besa e dhënë prijësit të pagabueshëm, duhet të jetë e sinqertë, për hir të All'llahut. E thënë me fjalë të tjera, ajo është prej çështjeve, nëpërmjet kryerjes së të cilës, synohet afrimi me All'llahun. Është transmetuar prej Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: "*Janë tri kategori njerëzish, të cilëve All'llahu i Madhëruar nuk do t'u flasë, nuk do të shikojë tek ata, nuk do t'i falë në Ditën e Gjykimit dhe ata do të përjetojnë një ndëshkim të dhimbshëm. I pari është ai njeri që i jep besën prijësit të tij, vetëm për*

qëllime të kësaj bote. Nëse i jep atë që kërkon, i qëndron besnik. Në rast të kundërt, i kthen kurrizin. I dyti është një njeri që i shet një tjetri mallin e tij pas namazit të ikindisë. Ai betohet në All'llahun e Lartësuar se atë mall e ka blerë me këtë apo atë çmim dhe e shet me çmimin që e ka blerë. Ai tjetri e beson, ndërkohë që ai nuk e ka blerë me atë çmim, për të cilin u betua. I treti, është ai njeri, të cilit i ka mbetur një sasi uji në shkretëtirë dhe nuk i jep prej tij një nevojtari.".[1] Ndoshta, namazi i ikindisë është përmendur prej vlerës së madhe të kësaj kohe, apo se shumë prej tregtarëve, kur vinte koha e ikindisë, e shisnin mallin e tyre me të njëjtin çmim që e kishin blerë.

7- Prishja e besës konsiderohet prej gjynaheve të mëdha. Këtu lexojmë një hadith të transmetuar nga Imam Musa ibn Xha'ferri *(Paqja qoftë mbi të!)* në të cilin thuhet: *"Tri janë mëkatet e mëdha: prishja e marrëveshjes, lënia e traditës profetike dhe përçarja e myslimanëve."*.[2]

8- Besëlidhja te fjalët e Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*. Tek libri "Nehxhul Belagah", besëlidhja përmendet shpesh prej Imam Aliut, gjë që vërteton se ai i ka dhënë një rëndësi të veçantë asaj dhe se njerëzit i kanë dhënë besën. Prej këtyre rasteve është thënia e tij te disa prej hytbeve të mbajtura: *"O ju njerëz! Unë kam të drejta mbi ju dhe ju keni të drejta mbi mua. Të drejtat tuaja mbi mua janë: t'ju këshilloj, t'ju siguroj ushqimin dhe dijen tuaj, që të mos mbeteni injorantë, si dhe t'ju edukoj, sa herë veproni në mënyrë të gabuar."*. Më pas vijon: *"…ndërsa e drejta ime mbi ju është: t'i qëndroni besnikë*

[1] "El Khisal", kreu. 3, Hadithi 70.
[2] "Biharul Anuar", vëll. 67, f. 185.

besëlidhjes suaj, të më këshilloni për atë që duket dhe atë që nuk duket, të më përgjigjeni, kur t'ju bëj thirrje dhe të më bindeni kur t'ju urdhëroj.".[1]

Në një vend tjetër, ai thotë: *"Besa që më dhatë mua, nuk ishte diçka e pavlerë.".*[2]

Në hytben e tij, të mbajtur para Luftës së Xhemelit, teksa ishte drejtuar nga Medina për në Basra, tregoi për besën që njerëzit i kishin dhënë, duke i ftuar ata të tregohen të vendosur për besën e dhënë. Ai tha: *"Njerëzit nuk ishin të detyruar, kur ma dhanë besën, por ma dhanë me bindjen dhe vullnetin e tyre të lirë.".*[3]

Në fund, lexojmë disa letra që ai i ka nisur Muavijes, gjatë kohës kur ky i fundit nuk ia dha besën Imam Aliut dhe dëshironte hakmarrje ndaj Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*: *"Ma dhanë besën ata njerëz që i dhanë besën Ebu Bekrit, Umerit dhe Uthmanit, për të njëjtën gjë që ua dhanë edhe atyre, ndaj dëshmitarët nuk kishin mundësi të zgjidhnin dhe ata që mungonin, nuk kanë mundësi të kundërshtojnë.".*[4]

Prej disa termave të përdorura te libri "Nehxhul Belagah", kuptohet se besëlidhja nuk ndodh më shumë se një herë. Nuk ka mundësi që ajo të rishikohet dhe askush nuk ka mundësi ta prishë. Ai që del prej saj, është tradhtar dhe ata që mendohen gjatë dhe janë të lëkundur në pranimin e saj, janë hipokritë. *Ajo është një besë e vetme: as nuk rishikohet e as nuk mund të shtyhet*

[1] "Nehxhul Belaga", Hytbe 34.
[2] "Nehxhul Belaga", Hytbe 136.
[3] "Nehxhul Belaga", Letra 1.
[4] "Nehxhul Belaga", Letra 6. Duhet t'i kthehemi rastit, kur kërkimi i argumentit dhe mbështetja kërkohet te besëlidhja e tre kalifëve të mëparshëm. Kjo, për arsye se Muavija ishte emëruar prej tyre dhe i mbronte ata. Pra, nuk kemi ndonjë përjashtim ndërmjet këtij rasti dhe hytbes që u njoh si Esh Shakshakijeh.

vendimmarrja për të. Dalja prej saj është tradhti, ndërsa vonesa në dhënien e saj është dredhi.[1]

Prej këtyre fjalëve mund të përfitojmë faktin që Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*, u argumentoi atyre që nuk e pranonin, se drejtimi i tij ishte përmendur te thëniet e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij)*, atyre që kapeshin pas pretekseve të kota, atyre që besëlidhjen e kishin prej çështjeve të pranuara tek ta. Ata nuk e kishin kurajën e duhur për ta kundërshtuar Imam Aliun *(Paqja qoftë mbi të!)* dhe t'i bindeshin Muavijes dhe të ngjashmëve me të. Ashtu siç e kishin pranuar legjitimitetin e kalifatit për tre prijësit e mëparshëm, në të njëjtën mënyrë, duhet të besonin te legjitimiteti i kalifatit të Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)* dhe t'i bindeshin atij. (Për më tepër, besëlidhja e Imam Aliut e kishte legjitimitetin më të madh, sepse ajo u krye sipas kërkesës dhe dëshirës së njerëzve dhe pjesëmarrja e tyre ishte më e gjerë se te besëlidhjet e mëparshme.)

Nisur nga kjo, mund të themi se nuk ka përjashtim ndërmjet argumentimit për besëlidhjen dhe çështjes së emërimit të Imamit nëpërmjet All'llahut, të Dërguarit dhe vërtetësisë së besëlidhjes.

Për këtë arsye, Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*, te "Nehxhul Belagah", kur flet për *Hadithin Eth Thakalejn*, tregon në një vend që është prej teksteve të prijësisë,[2] ashtu siç flet në një vend tjetër për çështjen e amanetit dhe të trashëgimisë.[3]

[1] "Nehxhul Belaga", Letra 7.
[2] "Nehxhul Belaga", Letra 87
[3] "Nehxhul Belaga", Letra 2.

Ai, te disa shprehje të tjera të tij, tregon për detyrimin e bindjes ndaj besëlidhjes, pamundësinë e prishjes, rishikimin e saj dhe mungesën e nevojës për t'u përsëritur. Këto çështje janë të pranueshme për besëlidhjen.

Nëpërmjet këtyre shprehjeve, nënkuptohet qartë se, nëse besëlidhja është marrë nëpërmjet detyrimit me anë të dhunës, apo prej një grupi të vogël njerëzish, ajo nuk ka asnjë vlerë dhe nuk konsiderohet e tillë, përkundrazi, besëlidhja e vërtetë është ajo që ndodh në kushte të lirisë së mendimit, të meditimit, të vendosurit dhe më pas, të të zgjedhurit.

Ajetet 20 – 21

وَعَدَكُمُ ٱللَّهُ مَغَانِمَ كَثِيرَةً تَأۡخُذُونَهَا فَعَجَّلَ لَكُمۡ هَٰذِهِۦ وَكَفَّ أَيۡدِيَ ٱلنَّاسِ عَنكُمۡ وَلِتَكُونَ ءَايَةً لِّلۡمُؤۡمِنِينَ وَيَهۡدِيَكُمۡ صِرَٰطٗا مُّسۡتَقِيمٗا٢٠

وَأُخۡرَىٰ لَمۡ تَقۡدِرُواْ عَلَيۡهَا قَدۡ أَحَاطَ ٱللَّهُ بِهَاۚ وَكَانَ ٱللَّهُ عَلَىٰ كُلِّ شَيۡءٖ قَدِيرٗا ٢١

"All'llahu ju premtoi plaçkë të pasur, të cilën do ta fitoni e jua shpejtoi këtë juve. Ai i largoi duart e njerëzve prej jush, me qëllim që (fitorja juaj) **të jetë një shenjë për besimtarët e vërtetë dhe që t'ju udhëzojë në Rrugën e Drejtë."**
"All'llahu e di edhe për të tjera (fitore e plaçka lufte)**, të cilat ju ende nuk i keni fituar. All'llahu është i Fuqishëm për çdo gjë."**

Komentimi

Edhe njëherë për mirësitë e Marrëveshjes së Hudejbijes

Ashtu si ajetet e mëparshme, tematika e të cilave ishte Marrëveshja e Hudejbijes, këto dy ajete flasin rreth të njëjtës

çështje. Aty tregohet mirësia e madhe e All'llahut dhe përfitimet e mëdha që myslimanët arritën në këtë rrugëtim të tyre, duke fituar, përveç të tjerave, edhe plaçkë lufte.

Në ajetin e parë thuhet: **"All'llahu ju premtoi plaçkë të pasur, të cilën do ta fitoni e jua shpejtoi këtë juve..."**.

Fryma e përgjithshme e këtyre dy ajeteve, të lidhura me Marrëveshjen e Hudejbijes, tregon se përfitimet e myslimanëve, të përmendura në ajet, përfshijnë të gjitha llojet e përfitimeve, me anë të të cilave, All'llahu i Madhëruar i ka bekuar myslimanët, qoftë në planin afatshkurtër, qoftë në atë afatgjatë. Madje, disa komentues thonë se këto përfitime, përfaqësojnë çdo mirësi të All'llahut për ta, jo vetëm në të shkuarën, por edhe për të ardhmen, deri në Ditën e Gjykimit.

Shumë komentues kanë thënë se sifjalia: **"...jua shpejtoi këtë juve..."**, flet për plaçkën e Luftës së Khajberit, të cilën myslimanët e përfituan brenda një kohe shumë të shkurtër, pas ngjarjes së Hudejbijes.

Ndryshe nga të parët, një pjesë tjetër e komentuesve mendojnë se fjala *"hadhihi" - "këto"* tregon qartë Fitoren e Hudejbijes, e cila konsiderohet si triumfi më i madh, në aspektin moral.

Pastaj, Kur'ani tregon për një mirësi tjetër prej mirësive të All'llahut për myslimanët, te kjo ngjarje. Ai thotë: **"...Ai i largoi duart e njerëzve prej jush..."**.

Këtu kemi të bëjmë me një mirësi të madhe të All'llahut, pasi myslimanët, edhe pse ishin të paktë në numër e armatim, të

ndodhur shumë larg vatanit të tyre dhe shumë pranë armikut të tyre, zemrat e tyre i mbuloi qetësia, pasi All'llahu i Madhëruar hodhi në zemrat e idhujtarëve frikën prej myslimanëve. Për këtë arsye, ata nuk guxuan t'u afroheshin atyre e as t'i ngacmonin.

Disa komentues të tjerë mendojnë se kjo fjali nënkupton atë që ka ndodhur në Khajber, pasi disa prej fiseve të Beni Esed dhe Beni Gatfan kishin planifikuar të sulmonin Medinen, gjatë mungesës së myslimanëve, të grabisnin pasuritë dhe të zinin robina gratë e tyre.

Mundet që ajo të nënkuptojë edhe planifikimin e një grupi prej këtyre fiseve, që të ngriheshin të ndihmonin hebrenjtë e Khajberit, ndaj këtu ndodhi edhe ndërhyrja e All'llahut të Madhëruar, i Cili i mbushi zemrat e tyre me frikë, gjë që i shtyu ata të ktheheshin prej vendimit të tyre.

E parë në këndvështrimin sipërfaqësor, komentimi i parë është më i përshtatshëm. Vëmë re, se pas disa ajeteve, shfaqet një tjetër shprehje, që e kushtëzon të parën. Ajo është e lidhur me çështjen e banorëve të Mekës, ashtu siç flitet edhe në ajetin që jemi duke studiuar. Është në harmoni të plotë edhe me metodologjinë e përdorur në Kur'an, që është trajtimi përgjithësues dhe ai specifik i çështjeve.

E rëndësishme është se, duke u bazuar te transmetimet e njohura, e gjithë surja "Fet'h" ka zbritur pas ngjarjes së Hudejbijes dhe gjatë kthimit të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nga Meka në Medine.

Në vazhdimësi të këtij ajeti, Kur'ani përmend dy mirësi dhe dy dhurata të tjera të mëdha, të cilat All'llahu i Madhëruar ua dhuroi myslimanëve. Aty thuhet: **"...me qëllim që** (fitorja juaj) **të jetë një shenjë për besimtarët e vërtetë dhe që t'ju udhëzojë në Rrugën e Drejtë."**.

Edhe pse disa komentues mendojnë se përemri te shprehja **"që të jetë"**, tregon plaçkën e madhe të luftës, që atyre u ishte premtuar, disa të tjerë mendojnë ndryshe, pasi ata thonë se ky përemër nënkupton mbrojtjen e All'llahut për myslimanët prej duarve të liga që synojnë t'i dëmtojnë ata. Më i përshtatshëm nga këto dy gjykime është mendimi se përemri, në këtë rast, nënkupton të gjitha ngjarjet e Hudejbijes dhe ato që e pasuan atë. Ky këndvështrim mbështetet në faktin se secili prej dy ajeteve tregon sinqeritetin e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, sikurse është mjet për udhëzimin e njerëzve për te Rruga e Drejtë. Te disa prej këtyre lajmeve, ka njoftime për ngjarje dhe çështje tërësisht të panjohura dhe disa prej tyre nuk ishin aspak në harmoni me situatat normale. Në fund të fundit, ato konsiderohen mrekulli të qarta prej mrekullive që i kanë ndodhur Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Në ajetin që vijon, All'llahu i Madhëruar dërgon një tjetër sihariq për myslimanët, kur thotë: **"All'llahu e di edhe për të tjera** (fitore e plaçka lufte)**, të cilat ju ende nuk i keni fituar. All'llahu është i Fuqishëm për çdo gjë."**.

Është folur shumë prej komentuesve të Kur'anit rreth kësaj çështjeje dhe është ngritur pyetja se për cilën plaçkë lufte dhe për cilin triumf bën fjalë ky premtim.

Disa prej tyre mendojnë se këtu bëhet fjalë për çlirimin e Mekës dhe plaçkën e luftës së Hunejnit. Disa të tjerë janë të mendimit se në këtë rast, kemi të bëjmë me plaçkën e luftës, të cilën myslimanët e fituan pas Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, si: fitorja ndaj persëve, romakëve dhe Egjiptit. Ata mendojnë, gjithashtu, se nuk përjashtohet mundësia që ajeti të bëjë fjalë për të gjitha rastet e lartpërmendura.[1]

Sifjalia: **"të cilat ju ende nuk i keni fituar",** tregon se myslimanët nuk e kishin parashikuar aspak se do të mund t'i arrinin këto fitore të mëdha dhe këtë sasi të madhe të plaçkës së luftës, por ishte bereqeti i Islamit dhe mirësia e Zotit, që në mënyrë të pandërprerë i furnizuan myslimanët me fuqi dhe mundësi. Disa komentues, prej kësaj fjalie, kuptuan se gjatë asaj kohe, ndërmjet myslimanëve diskutohej rreth këtyre fitoreve të mëdha, por në të njëjtën kohë, ata e shikonin se mundësitë reale për të arritur të tilla fitore ishin të paqenësishme. Këtë aspekt, e vëmë re tek historia e Luftës së Ahzabit, teksa All'llahu i Madhëruar i jepte sihariq Profetit të Tij për çlirimin e Persisë, të Jemenit dhe triumfin ndaj romakëve dhe hipokritët talleshin dhe vinin në lojë këto premtime (sipas tyre të pabaza) të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

[1] Fjala *"ukhra" - "të tjera"* është cilësim për diçka të papërmendur, kuptimi i të cilës është: *plaçka të tjera lufte që nuk keni mundur t'i fitoni*. Kjo është ngushtësisht e lidhur me Fjalën e All'llahut: **"All'llahu ju ka premtuar ju plaçkë të shumtë lufte."**.

Sifjalia: **"All'llahu e di edhe për të tjera"**, tregon përse këto fitore dhe këto plaçka lufte ishin nën sundimin, dijen, mbikëqyrjen e autoritetit hyjnor të All'llahut. Disa komentues të tjerë mendojnë se këtu bëhet fjalë për përfshirjen te dija e All'llahut, të kësaj plaçke lufte dhe të këtyre fitoreve. Mund të themi se këndvështrimi i parë është më pranë të vërtetës, pasi ai është në harmoni edhe me shprehjet e ajeteve vijuese. Natyrshëm, nuk ka asnjë pengesë që ndalon bashkimin ndërmjet dy këndvështrimeve.

Përfundimisht, fjalia e fundit e ajetit: **"All'llahu është i Fuqishëm për çdo gjë."**, përcakton shkakun për ajetin e mëparshëm, që do të thotë se me mbështetjen e All'llahut dhe fuqinë e Tij për çdo përpjekje, shmanget mundësia e habisë, që myslimanët të arrijnë fitore të këtyre përmasave.

Gjithsesi, në të gjitha rastet, ajeti është njoftim kur'anor rreth çështjeve të panjohura dhe ngjarjeve të ardhshme, pasi këto fitore të mëdha ndodhën brenda një periudhe shumë të shkurtër dhe zbuluan qartë madhështinë e këtyre ajeteve.

Hulumtimi

Historia e luftës së Khajberit

Kur Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* u kthye nga Hudejbija në Medine, e kaloi aty të gjithë muajin Dhul Hixheh dhe disa ditë prej muajit Muharrem. Më pas, bashkë me njëmijë e katërqind myslimanë, të cilët kishin marrë pjesë në Hudejbije, u nis në drejtim të Khajberit. Gjatë asaj kohe, Khajberi mendohej të ishte qendër e rëndësishme e lëvizjeve dhe e thurjes së planeve për goditjen e Islamit, ndaj Profeti i Zotit *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* studionte mundësitë për ta shpartalluar një herë e përgjithmonë atë qendër intrigash.

Në fillim, ishte fisi Gatfan që kishte projektuar mbrojtjen e hebrenjve të Khajberit, por më pas ata u trembën dhe i zuri frika prej pasojave që mund të vinin pas këtij veprimi, ndaj hoqën dorë prej mbrojtjes së hebrenjve.

Teksa Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* po i afrohej kalave të Khajberit, ai i urdhëroi shokët e tij të ndalonin. Më pas ngriti kokën lart drejt qiellit, duke bërë këtë lutje: *"O All'llah, Ti je Zoti i qiejve dhe i gjithçkaje që mbulojnë ato! Ti je Zot i Tokës dhe çfarë ka mbi të. Të kërkojmë Ty prej të mirave të këtij fshati dhe prej të mirës së banorëve të tij. O All'llah, kërkojmë prej Teje mbrojtje prej të këqijave të këtij fshati, të këqijave të banorëve të tij dhe prej të gjitha të këqijave që fshihen aty!"*.

Më pas, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* tha: *"Vërshoni drejt tyre me Emrin e All'llahut!"* Kështu ata mbërritën në Khajber natën dhe në mëngjes, kur banorët e Khajberit e morën lajmin, ishin të rrethuar nga të gjitha anët prej ushtarëve të Islamit. Profeti i Zotit *(Paqja e*

bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) i çliroi kalatë e tyre njëra pas tjetrës, derisa mbërriti te kalaja e fundit, që ishte njëkohësisht më e madhja dhe më e mbrojtura. Aty ishte udhëheqësi i njohur i hebrenjve, Mirhabi.

Gjatë këtyre ditëve, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* kishte një dhimbje të fortë koke, që e kapte ndonjëherë, aq sa nuk e kishte të mundur të dilte prej çadrës së tij, një ose dy ditë. Ashtu siç është përmendur edhe te historia e Islamit, gjatë kësaj kohe, drejtimin dhe flamurin e betejës e mori Ebu Bekri. Ai u nis në drejtim të armikut, por shumë shpejt u kthye pa asnjë rezultat. Pas tij, drejtimin e luftës dhe flamurin e betejës e mori Umeri, i cili, edhe pse ishte më i ashpër se i pari, edhe ai u kthye pa ndonjë rezultat konkret.

Kur i mbërriti ky lajm Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, tha: "*Betohem në All'llah! Nesër do t'ia jap drejtimin e betejës një burri që e do All'llahun dhe të Dërguarin e tij dhe All'llahu bashkë me të Dërguarin e Tij e duan atë. Ai do ta fitojë dhunshëm betejën.*".

U rrotulluan qafat e myslimanëve gjithandej për të parë se cili ishte ky burrë që fliste Profeti i Zotit *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Disa prej tyre pëshpëritën se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nënkuptonte Aliun *(Paqja qoftë mbi të!)*. Gjatë asaj kohe, Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* kishte një dhimbje në sy e nuk ishte aty. Të nesërmen, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* kërkoi prej shokëve të tij që t'ia thërrisnin Imam Aliun. Ai erdhi i hipur mbi një deve, derisa u ul afër tendës së mbyllur të Profetit Muhammed *(Paqja e*

bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!). Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* ishte i armatosur dhe me sy të lidhur.

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e pyeti: *"Çfarë të ka ngjarë, o Ali?"*

Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* tha: *"Më dhembin sytë, o i Dërguari i All'llahut."*

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* tha: *"Ulu pranë meje."*

Kur u ul, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i fryu syrit të tij dhe nga ai çast, nuk kishte më dhimbje. E mori flamurin e betejës dhe u nis.

Bashkë me ushtrinë e myslimanëve, Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* shkoi në drejtim të kalasë më të madhe të Khajberit. Kur e pa një burrë hebre që qëndronte mbi një mur të kalasë, e pyeti: "Kush je ti?"

Ai tha: "Unë jam Ali Ibn Ebu Talib."

Burri thirri: "O ju njerëz, na erdhi fundi."

Më pas erdhi, Mirhabi (prijësi i kalasë së hebrenjve) dhe nisi dyluftimin me Imam Aliun. Mirhabi ra përdhe i shpartalluar prej goditjes së Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*. Teksa lufta ashpërsohej ndërmjet myslimanëve dhe hebrenjve, nga dera e kalasë erdhi Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*, derisa e shkuli, e shkatërroi dhe e hodhi tutje atë, me një fuqi të jashtëzakonshme. Kështu, kalaja e fundit e hebrenjve u hap dhe myslimanët e çliruan atë.

Hebrenjtë e mbetur gjallë, u dorëzuan dhe kërkuan prej Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* të mbronte gjakun e tyre, sepse ata u dorëzuan. Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* pranoi që ta mbronte jetën e atyre që u dorëzuan dhe myslimanët nisën të merrnin plaçkën e transportueshme të luftës, ndërsa tokat dhe pemët Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i la në duart e hebrenjve, me kusht, që gjysma e prodhimit të tyre t'u jepej myslimanëve.[1]

Ajetet 22 – 25

[1] E sjellë shkurtimisht prej ngjarjes së plotë, e përmendur te "Tarijkh" i Ibn Ethirit, vëll. 2, f. 216-221.

وَلَوْ قَٰتَلَكُمُ ٱلَّذِينَ كَفَرُواْ لَوَلَّوُاْ ٱلْأَدْبَرَ ثُمَّ لَا يَجِدُونَ وَلِيًّا وَلَا نَصِيرًا٢٢ سُنَّةَ ٱللَّهِ ٱلَّتِى قَدْ خَلَتْ مِن قَبْلُ ۖ وَلَن تَجِدَ لِسُنَّةِ ٱللَّهِ تَبْدِيلًا٢٣ وَهُوَ ٱلَّذِى كَفَّ أَيْدِيَهُمْ عَنكُمْ وَأَيْدِيَكُمْ عَنْهُم بِبَطْنِ مَكَّةَ مِنۢ بَعْدِ أَنْ أَظْفَرَكُمْ عَلَيْهِمْ ۚ وَكَانَ ٱللَّهُ بِمَا تَعْمَلُونَ بَصِيرًا٢٤ هُمُ ٱلَّذِينَ كَفَرُواْ وَصَدُّوكُمْ عَنِ ٱلْمَسْجِدِ ٱلْحَرَامِ وَٱلْهَدْىَ مَعْكُوفًا أَن يَبْلُغَ مَحِلَّهُۥ ۚ وَلَوْلَا رِجَالٌ مُّؤْمِنُونَ وَنِسَآءٌ مُّؤْمِنَٰتٌ لَّمْ تَعْلَمُوهُمْ أَن تَطَـُٔوهُمْ فَتُصِيبَكُم مِّنْهُم مَّعَرَّةٌۢ بِغَيْرِ عِلْمٍ ۖ لِّيُدْخِلَ ٱللَّهُ فِى رَحْمَتِهِۦ مَن يَشَآءُ ۚ لَوْ تَزَيَّلُواْ لَعَذَّبْنَا ٱلَّذِينَ كَفَرُواْ مِنْهُمْ عَذَابًا أَلِيمًا٢٥

“Nëse mohuesit nisen në luftë kundër jush, me siguri që ata do të ikin dhe pastaj nuk do të gjejnë as mbrojtës, as ndihmës.”

“I tillë ka qenë ligji i All’llahut edhe më parë, e ti kurrë nuk do të gjesh ndryshime në ligjin e All’llahut.”

“Është Ai që i ka penguar duart e tyre ndaj jush dhe duart tuaja ndaj tyre brenda në Mekë, pasi ju dha fitoren mbi ata. All’llahu i sheh të gjitha çfarë bëni ju.”

“Jobesimtarët ju penguan t’i afroheni Xhamisë së Shenjtë dhe (penguan) **kafshët për kurban, që të arrinin në vend. Po të mos kishte qenë për disa besimtarë e besimtare** (në Mekë) **që ju nuk i njihnit e kështu mund t’i merrnit nëpër këmbë, duke bërë**

gjynah kundrejt tyre pa e ditur, All'llahu do t'ju kishte urdhëruar t'i luftonit ata. Sikur ata të ishin veç, Ne do t'i ndëshkonim me dënim të dhembshëm ata (banorë të Mekës)**, që nuk besuan."**

Komentimi

Po sikur lufta të kishte ndodhur në Hudejbije?!

Këto ajete flasin rreth disa dimensioneve të tjera për ato që ndodhën në Hudejbije, si dhe tregojnë për çështje të tjera interesante e të rëndësishme, që janë të lidhura me këtë çështje.

E para: As mos e imagjinoni, se në rast se do të kishte ndodhur një betejë ndërmjet jush dhe jobesimtarëve, idhujtarë të Mekës në Hudejbije, ata do të kishin triumfuar. **"Nëse mohuesit nisen në luftë kundër jush, me siguri që ata do të ikin dhe pastaj nuk do të gjejnë as mbrojtës, as ndihmës."**. Kjo nuk është e veçantë për ju, sepse: **"I tillë ka qenë ligji i All'llahut edhe më parë, e ti kurrë nuk do të gjesh ndryshime në ligjin e All'llahut."**.

Ky është një ligj i përhershëm i All'llahut. Sa herë besimtarët do të përballen me armiqtë e tyre, me qëllim të sinqertë dhe me zemra të pastra, pa u treguar të dobët në çështjet që lidhen me luftën, All'llahu i Madhëruar do t'i ndihmojë ata kundër armiqve të tyre. Ka mundësi që ky ngadalësim apo përshpejtim, ka ndodhur për t'i sprovuar myslimanët,

apo edhe për qëllime të tjera, por ajo që mund të themi me siguri, është se në përfundim, fitorja dhe triumfi janë aleatët e besimtarëve.

Në disa raste, siç është për shembull, rasti i Luftës së Uhudit, një grup prej tyre nuk e ndoqën Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe një grup tjetër e kishin mendjen te bukuritë e kësaj bote. Kështu, ata e njollosën qëllimin e tyre dhe synim kryesor kishin mbledhjen e plaçkës së luftës. Kjo ishte edhe arsyeja përse ata shijuan një humbje dhe një dështim shumë të hidhur.

E dyta: Ajo që sqarojnë ajetet e mësipërme, është ideja që kurejshët të mos rrinë duke thënë se ne nuk e luftuam atë grup të vogël njerëzish. Fatkeqësisht, e kishim (gjahun) në dorë dhe na shpëtoi. Çështja nuk është kështu. Kurrë të mos mendohet. Edhe pse myslimanët ishin të paktë në numër, larg vatanit të tyre dhe shumë larg të qenit të sigurt, tërësisht të paarmatosur dhe pa furnizime, me mirësinë dhe begatinë e besimit tek All'llahu i Lartësuar, ata do të fitonin me ndihmën e Tij, edhe në rast se do të kishte ndodhur një betejë ndërmjet besimtarëve dhe idhujtarëve të Mekës gjatë asaj kohe. A nuk ishin myslimanët të paktë në numër gjatë Luftës së Bedrit dhe të Ahzabit, ndërsa armiqtë e tyre ishin shumë? Atëherë, si u shpartalluan armiqtë e tyre dhe u larguan nga sytë këmbët gjatë këtyre dy betejave?!

Megjithatë, shpalosja e kësaj të vërtete u bë shkak për forcimin e gjendjes shpirtërore dhe ngritjen e moralit të besimtarëve dhe dobësimin e moralit dhe të gjendjes shpirtërore të armiqve, pasi hipokritët kishin fabrikuar shumë thashetheme. Ky është tregues i qartë, se edhe në rast se do të kishte ndodhur

një luftë ndërmjet tyre, në këto kushte jo të mira (në pamje të parë), nuk ka asnjë dyshim se fitorja do të shkonte në favor të besimtarëve të sinqertë.

Te këto ajete na shpaloset një tjetër mirësi, teksa All'llahu i Madhëruar thotë: **"Është Ai që i ka penguar duart e tyre ndaj jush dhe duart tuaja ndaj tyre brenda në Mekë, pasi ju dha fitoren mbi ata. All'llahu i sheh të gjitha çfarë bëni ju."**.

Gjithçka që ndodhi atëherë, vërtetoi qartë fitoren e madhe. Sa i mrekullueshëm ishte ky cilësim që Kur'ani Famëlartë i bëri triumfit të myslimanëve. Edhe pse armiqtë e Islamit vërshuan disa herë me ushtritë e tyre në drejtim të Medines dhe u përpoqën maksimalisht për t'i mposhtur myslimanët, këtë herë myslimanët kishin ardhur me këmbët e tyre në fushën e armikut. Megjithatë, edhe pse ndodhi kështu, ata i kapi tmerri dhe i zuri frika prej myslimanëve dhe kjo i detyroi që të ofronin marrëveshje paqeje me ta. Cila fitore mund të jetë më e madhe se kjo, ku myslimanët fituan aq shumë terren ndaj armiqve të tyre, nga pozita (në dukje të disfavorshme), pa u derdhur asnjë pikë e vetme gjaku prej tyre?!

Nuk ka dyshim se ajo që kishte ndodhur në Hudejbije, konsiderohej si fitore e myslimanëve dhe humbje e kurejshëve, ndër të gjithë banorët e Gadishullit Arabik.

Lidhur me këtë, një grup komentuesish kanë folur rreth shkakut të zbritjes së ajetit dhe kanë thënë se idhujtarët e kurejshëve kishin përgatitur (në mënyrë të fshehtë gjatë Hudejbijes) dyzet burra për të sulmuar myslimanët, por me zgjuarsinë e tyre, ata ua prishën planin dhe ua dështuan kurthin. Ata i zunë pritë dhe i morën peng dhe, pasi ia dërguan Profetit

Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, ai dha urdhër të lirohen, të lejohen dhe të kthehen andej nga kishin ardhur.

Disa të tjerë kanë thënë se ata ishin tetëdhjetë vetë që deshën të sulmonin myslimanët dhe t'u shkonin atyre tinëzisht nga ana e malit të Ten'imit. Ata kishin zgjedhur kohën e faljes së mëngjesit dhe duke përfituar nga errësira, synonin t'i zinin në befasi myslimanët. Disa të tjerë thanë se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ishte duke qëndruar nën hijen e një peme dhe po përgatiste tekstin e Marrëveshjes së Hudejbijes, bashkë me përfaqësuesin e kurejshëve, ndërsa Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* ishte i zënë me shkrimin e saj. Në këtë moment, atë sulmojnë të armatosur tridhjetë djem të rinj mekas, por një mrekulli e jashtëzakonshme ndodhi dhe e prishi planin e tyre. Ata u zunë robër të gjithë. Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i liroi ata më pas.[1]

Duke u bazuar te shkaku i zbritjes së ajetit, mund të themi se sifjalia: **"pasi ju dha fitoren mbi ata"**, tregon fitoren e myslimanëve ndaj këtij grupi, ndërkohë që po t'i referohemi komentimit të mëparshëm, ai nënkupton fitoren e përgjithshme të myslimanëve ndaj idhujtarëve. Ky mendim është më i harmonizuar me përmbajtjen e ajetit.

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 9, f. 123, me pak ndërhyrje, ashtu siç është përmendur prej El Kurtubiut, lidhur me këtë çështje, me një ndryshim të vogël. Tek Ebul futuh Err-Rrazi në tefsirin "Ruhul Xhinan". Tek El Alusij në tefsirin "Ruhul Meanij". E ka përmendur, gjithashtu, sheh Et Tusi te tefsiri "Et Tibjan", El Meragij dhe të tjerë.

Bie në sy fakti, se Kur'ani i ndalon luftimet brenda në Mekë. Ky aspekt mund të jetë tregues i dy mirësive të rëndësishme:

E para: Meka ishte qendra, ku përqendroheshin forcat e armikut dhe, sipas logjikës, banorët idhujtarë të Mekës, duhet të përfitonin nga rasti i përshtatshëm dhe t'i sulmonin myslimanët, pasi ata kishin kohë që ishin vënë në kërkim të një rasti të tillë, që kishte për qëllim shfarosjen përfundimtare të myslimanëve. Duke qenë se myslimanët ishin në duart dhe në fushën e idhujtarëve mekas, pritej që ata të mos e lejonin t'u ikte nga dora aq lehtë një mundësi e tillë, por ishte All'llahu i Lartësuar Ai që i paralizoi mundësitë e tyre dhe ua bëri të pamundur të merreshin me myslimanët.

E dyta: Meka konsiderohej Shtëpia e sigurt e All'llahut. Për këtë arsye, nëse aty do të ndodhte një betejë dhe do të derdhej gjak, do të prekej shenjtëria e Shtëpisë së All'llahut, nga njëra anë dhe nga ana tjetër, do të konsiderohej si e turpshme për myslimanët që të preknin dhe të shkelnin shenjtërinë e Tokës së Shenjtë. Për këtë arsye, ishte prej mirësive të All'llahut për të Dërguarin e Tij *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe për myslimanët, që Meka të çlirohej me duart e tyre, fare pa gjakderdhje, vetëm dy vjet më pas.

Në fund të ajetit, prej ajeteve objekt të studimit tonë, flitet për një tjetër mirësi të lidhur me Marrëveshjen e Hudejbijes dhe urtësinë e saj. Në këtë ajet thuhet: **"Jobesimtarët ju penguan t'i**

afroheni Xhamisë së Shenjtë dhe (penguan) **kafshët për kurban, që të arrinin në vend...”**.[1]

Njëri gjynah, ishte mohimi i tyre, ndërsa gjynahu i dytë, ishte pengesa që ju bënë për të kryer ritualet e Umres dhe për të vizituar Shtëpinë e All’llahut. Ata nuk ju lejuan, gjithashtu, të therni kurbanet tuaja në vendin e duhur (në Mekë), (gjatë Umres kurbanet theren në Mekë dhe gjatë Haxhit ato theren në Mina), ndërkohë që Shtëpia e All’llahut duhet të jetë e hapur dhe e lirë për t’u vizituar prej të gjithëve. Të ndalosh besimtarët të vizitojnë Shtëpinë e All’llahut, është prej gjynaheve të mëdha, ashtu siç bëhet e ditur edhe në ajetin ku’anor, te një moment i dytë i kësaj sureje: **“E ku ka padrejtësi më të madhe se të ndalosh që në xhamitë e All’llahut të përkujtohet Emri i Tij?!”**.[2]

Gjynahe si këto, e bëjnë të detyrueshme që All’llahu i Madhëruar t’ju japë pushtet mbi ata dhe t’i ndëshkoni ashpër për veprën e tyre, por, përse All’llahu i Madhëruar nuk e bëri këtë?! Fundi i ajetit e bën të qartë arsyen. Aty thuhet: **“...Po të mos kishte qenë për disa besimtarë e besimtare** (në Mekë) **që ju nuk i njihnit e kështu mund t’i merrnit nëpër këmbë, duke bërë gjynah kundrejt tyre pa e ditur...”**.[3]

Ky ajet flet për një grup (burrash dhe grash) myslimanë, të cilët e pranuan Islamin në Mekë, por për arsye të veçanta, nuk emigruan për në Medine. Nëse myslimanët do të zhvillonin luftë

---

[1] Fjala *“ma’kufen”* rrjedh nga fjala *“el akufu”* që do të thotë ndalim nga lëvizja dhe qëndrim në vend.

[2] Sure “El Bekare”, ajeti 114.

[3] Përgjigjja për shprehjen *“leu la”* – *“po të mos kishte qenë”,* te fjalia e mësipërme, është e padukshme dhe kuptimi i saj është: *Në kohën kur Ai i pengoi duart e tyre ndaj jush;* ose *Ju do të mund t’i shtypnit idhujtarët, me ndihmën Tonë.*

në Mekë, jetët e këtyre njerëzve të dobët do të ekspozoheshin ndaj rrezikut dhe idhujtarët do të përhapnin fjalë duke thënë se ushtarët e Islamit, jo vetëm që nuk deshën t'ia dinin për armiqtë e tyre, por ata nuk deshën t'ia dinin as për pasuesit e tyre myslimanë. Ky do të ishte, natyrshëm, një turp i madh për ta.

Disa të tjerë thanë, gjithashtu, se ky lloj turpi e bën të detyruar shpagesën fetare të gjakut të derdhur gabimisht, por kuptimi i parë është në dukje më i përshtatshëm.

Fjala *"el mearr'rretu"*, buron nga fjala *"arr'rrun"*, me formë të njëjtë me fjalën *"sherr'rrun"*. Fjala *"el arr'rru"*, ka formë të njëjtë me fjalën *"el harru"* dhe në origjinën e saj, ka kuptimin e sëmundjes së zgjebes, një sëmundje e lëkurës që prekte kafshët, por ndonjëherë edhe njerëzit. Më pas, kuptimi i kësaj fjale u zgjerua dhe thanë se ajo nënkuptonte të gjitha llojet e dëmtimeve që e prekin njeriun.

Për ta plotësuar të njëjtën çështje, në ajet thuhet: **"...All'llahu mbështjell me mëshirën e Tij kë të dëshirojë..."**. Nuk ka dyshim se All'llahu dëshiron që mëshira e Tij të mbështjellë besimtarët e shtypur prej banorëve të Mekës dhe ata të mos preken nga asnjë lloj dëmtimi.

Një tjetër mundësi që shfaqet këtu, është se një prej qëllimeve të Marrëveshjes së Hudejbijes, ishte fakti se kishte prej atyre idhujtarëve që ishin të prirur për t'u udhëzuar, kështu, bereqeti i Marrëveshjes së Hudejbijes mund të bëhej shkak që All'llahu t'i përfshinte ata te mëshira e Tij.

Sifjalia: **"kë të dëshirojë Ai"**, nënkupton të gjithë ata që kanë prirjen, meritën dhe elokuencën e duhur, sepse vendimet e

All'llahut burojnë gjithmonë prej urtësisë së Tij, ndaj themi se vendimet që burojnë prej urtësisë, janë gjithmonë të mirargumentuara dhe të llogaritura saktë.

Për të mbështetur më shumë këtë pikëpamje, All'llahu i Madhëruar thotë kështu: **"...Sikur ata të ishin veç, Ne do t'i ndëshkonim me dënim të dhembshëm ata** (banorë të Mekës)**, që nuk besuan."**, që do të thotë se, nëse do të kishte ndodhur një ndarje dhe veçim ndërmjet besimtarëve dhe idhujtarëve në Mekë dhe të mos kishte rrezik për besimtarët, do t'i ndëshkonim rëndë mohuesit e Mekës, me duart tuaja.

Është e vërtetë se All'llahu i Madhëruar i ka të gjitha mundësitë që, nëpërmjet një mrekullie, ta ndajë njërin grup nga grupi tjetër, por është prej traditës së All'llahut, duke përjashtuar rastet e veçanta, që të gjitha ndodhitë të jenë të varura prej shkaqeve normale.

Farza: *"tezej'jeluu"*, e ka origjinën te fjala *"zeual"* - *"zhdukje"*, por në këtë ajet ajo nënkupton veçimin dhe ndarjen prej të tjerëve.

Nga transmetimet e ardhura prej shi'itëve dhe synive, të lidhura me kuptimin e fundit të këtij ajeti, përftohet se ajeti nënkupton disa besimtarë që jetonin në një vend me idhujtarët dhe ata u bënë shkak që All'llahu të mos e ndëshkonte edhe pjesën tjetër prej mohuesve.

Prej atyre transmetimeve i lexojmë hadithin e ardhur nga Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)*, kur tek ai erdhi një burrë dhe e

pyeti: "A nuk ishte Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* i fortë në fenë e All'llahut?!"

Imami tha: "Patjetër."

Ai tha: "Atëherë, përse ai nuk u tregua i ashpër me armiqtë e tij (në luftën e Xhemelit), edhe pse i kishte të gjitha mundësitë? Çfarë e pengoi Imam Aliun *(Paqja qoftë mbi të!)* të ndalet?"

Imami tha: "Një ajet kur'anor e ndaloi."

Burri tha: "Cili ajet, o Imam?"

Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* lexoi ajetin e Kur'anit, ku All'llahu i Madhëruar thotë: **"Sikur ata të ishin veç, Ne do t'i ndëshkonim me dënim të dhembshëm ata** (banorë të Mekës)**, që nuk besuan."**.

Më pas, Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* shton: *"Një grup besimtarësh që jetonin në mesin e idhujtarëve dhe hipokritëve në Mekë, ishin amanet tek All'llahu i Madhëruar, ndaj Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) nuk mund të vriste baballarët e tyre, derisa të dilte jashtë saj pjesa tjetër (që ishin amanet). Kështu veprojmë edhe ne pjesëtarët e Ehli Bejtit. Nuk kryejmë asnjë veprim, përpara se të dallojmë amanetet e All'llahut të Lartësuar."*.[1]

Pra, All'llahu i Lavdëruar e di se prej atyre idhujtarëve dhe hipokritëve do të lindnin njerëz që do ta besonin Atë me vullnetin dhe zgjedhjen e tyre të lirë. Kjo ishte arsyeja përse All'llahu i

[1] Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, f. 70, Hadithi 59, si dhe shumë transmetime të tjera, që e trajtojnë këtë çështje.

Madhëruar nuk i ndëshkoi baballarët e tyre. Këtë çështje e ka përmendur Kurtubiu te tefsiri i tij, në një formë tjetër.

Nuk përjashtohet, gjithashtu, që ajeti të tregojë për besimtarët që ishin të bashkuar me mohuesit në Mekë dhe për ata besimtarë që do të lindnin prej mohuesve në të ardhmen.

Ajeti 26

إِذْ جَعَلَ ٱلَّذِينَ كَفَرُواْ فِي قُلُوبِهِمُ ٱلْحَمِيَّةَ حَمِيَّةَ ٱلْجَٰهِلِيَّةِ فَأَنزَلَ ٱللَّهُ سَكِينَتَهُۥ عَلَىٰ رَسُولِهِۦ وَعَلَى ٱلْمُؤْمِنِينَ وَأَلْزَمَهُمْ كَلِمَةَ ٱلتَّقْوَىٰ وَكَانُوٓاْ أَحَقَّ بِهَا وَأَهْلَهَاۚ وَكَانَ ٱللَّهُ بِكُلِّ شَيْءٍ عَلِيمًا٢٦

"Dhe, kur në zemrat e mohuesve u shfaq zelltaria pagane, All'llahu zbriti qetësinë e Tij në zemrën e të Dërguarit të Tij dhe të besimtarëve e i bëri ata të mbështeten fort në fjalën e përkushtimit (ndaj All'llahut)**. Ata kishin më të drejtë e qenë më të denjë për të. All'llahu është i Gjithëdijshëm për çdo gjë."**

Komentimi

Arroganca dhe fanatizmi ndaj injorancës, pengesa më e madhe në rrugën e mohuesve

Ky ajet flet edhe njëherë tjetër rreth Marrëveshjes së Hudejbijes dhe përfaqëson të tjera aspekte të kësaj çështjeje madhore. Fillimisht, ai flet për njërin prej faktorëve më të rëndësishëm që i ndalon mohuesit ta besojnë All'llahun dhe të Dërguarin e Tij dhe i ndalon ata t'i nënshtrohen e t'i dorëzohen të

vërtetës dhe drejtësisë. Në ajet thuhet: **"Dhe, kur në zemrat e mohuesve u shfaq zelltaria pagane…"**.[1]

Për këtë arsye, ata e ndaluan Profetin e All'llahut dhe besimtarët të hynin te Shtëpia e All'llahut dhe të kryenin ritualet e Umres dhe të thernin kurbanet në Mekë, duke thënë: "Nëse do t'i lejojmë këta, që kanë vrarë baballarët dhe vëllezërit tanë në luftë, të hyjnë në tokën dhe vendbanimet tona (në Mekë), atëherë çfarë do të thonë arabët për ne?! E si do të na mbetet më autoritet, pas kësaj?!"

Kjo mendjemadhësi, kjo vetëkënaqësi dhe ky fanatizëm, fanatizmi i kohës së injorancës, i ndaloi ata të pranonin që të shkruanin mbi letrën e Marrëveshjes se Hudejbijes: *Me Emrin e All'llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit*, në formën e saj të plotë dhe të vërtetë, edhe pse zakonet dhe ritet e tyre e lejonin për të gjithë Umren dhe vizitën e Shtëpisë së All'llahut, pasi Meka për ta konsiderohej vend i shenjtë dhe i sigurt, deri në atë shkallë, sa, edhe sikur dikush të luftonte babanë e tij gjatë Umres apo gjatë qëndrimit të tij aty, nuk i vinte asnjë e keqe prej tij, për hatër të shenjtërisë që Shtëpia e All'llahut kishte. Pra, nga njëra anë, nëpërmjet kësaj sjelljeje, mekasit e shkelën shenjtërinë e Shtëpisë së All'llahut dhe sigurinë brenda saj dhe nga ana tjetër, ata ranë në kundërshtim me ritet dhe zakonet e tyre të mëparshme vrastare.

---

[1] Folja në gjuhën arabe "*xheale*", që ndodhet në këtë ajet, përfshin ndonjëherë një kallëzues të vetëm. Kjo ndodh në ato raste kur ajo shfaqet në kuptimin e gjetjes, sikurse është në ajetin objekt i studimit tonë. Kryefjala e saj **"***el ledhijne keferu* **- të cilët mohuan"** dhe kallëzuesi (*el hamijetu*, **zelltaria**). Ajo që nënkuptohet me gjetjen këtu, është qëndrimi në të njëjtën gjendje dhe kapja pas tij. Mundet, gjithashtu, që folja "*u shfaq*" të përfshijë dy kallëzues, në rast se ajo ka kuptimin "*sare*" - "*ndodhi ashtu*".

Fjala *"el hamijetu"*, në origjinë buron nga fjala me të njëjtën formë *"hamije"*. Kuptimi i saj është nxehtësia e rrezeve të Diellit, apo zjarri që mund të prekë trupin e njeriut dhe gjithçka e ngjashme me të. Për këtë arsye, u quajt edhe sëmundja *"el hum'ma" – "të nxehtët e madh"*. Ajo përdoret, gjithashtu, për të përshkruar gjendjen e nxehjes prej krenarisë, mendjemadhësisë dhe mërzisë prej fanatizmit të madh.

Shkaktarë të kësaj gjendjeje të përgjithshme te të gjithë popujt, është pikërisht injoranca, dritëshkurtësia, rrënimi kulturor (veçanërisht ndërmjet injorantëve). Kjo gjendje bëhej shpesh shkaktare për luftëra dhe gjakderdhje.

Më pas, në këtë ajet kur'anor thuhet: **"...All'llahu zbriti qetësinë e Tij në zemrën e të Dërguarit të Tij dhe të besimtarëve..."**.

Kjo qetësi, e cila buron te besimi, te mbështetja dhe te mirësia e All'llahut, i shtyu ata që të ruanin qetësinë dhe të përjetonin një paqe shpirtërore, e cila i shoi zjarret e mërzisë së tyre deri në atë shkallë, sa pranuan, për hir të mbrojtjes së qëllimeve të tyre madhore, heqjen e fjalisë: *"Me Emrin e All'llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit"*, është simbolika kryesore e Islamit në fillimin e punëve - dhe të vendosnin në vend të saj: *Me Emrin Tënd, o Zoti ynë*, e cila ishte prej zakoneve dhe traditave të arabëve të mëparshëm. Ata pranuan, gjithashtu, të mos e shkruanin titullin më të lartë - *I Dërguari i All'llahut* - në krah të emrit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Ata pranuan të ktheheshin mbrapsht nga Meka në Medine, pa e pasur mundësinë t'u bindeshin nevojave të dashurisë së tyre

të madhe për Shtëpinë e All'llahut, për të kryer aty ritualet e Umres. Ata u detyruan t'i thernin kurbanet e tyre, në kundërshtim me traditën profetike (në Haxh njëlloj si në Umre) dhe i zhveshën rrobat e ihramit pa i kryer ritualet.

Është e vërtetë, ata pranuan të përballeshin me hidhësinë që u shkaktonte e gjithë kjo situatë. Në rast se ata do të kishin qenë nën ndikimin e fanatizmit të kohës së injorancës, do të mjaftonte njëra prej ngjarjeve të mësipërme, si shkak që ata të nisnin luftën ndërmjet tyre në atë tokë.

Sigurisht, është kultura e kohës së injorancës ajo që e nxit mendjemadhësinë, kryeneçësinë, fanatizmin, ndërsa kultura islame bën ftesë për qetësi, paqe shpirtërore dhe vetëpërmbajtje.

Lidhur me këtë aspekt, në Kur'an thuhet, gjithashtu: **"...e i bëri ata të mbështeten fort në fjalën e përkushtimit** (ndaj All'llahut)**. Ata kishin më të drejtë e qenë më të denjë për të. All'llahu është i Gjithëdijshëm për çdo gjë."**.

Fraza *"kelimetun"* këtu vjen në kuptimin e shpirtit. Kuptimi i ajetit është: All'llahu është Ai që hodhi shpirtin e përkushtimit te zemrat e atyre besimtarëve, duke e bërë atë shoqëruese të tyre të përhershme. Të njëjtin kuptim e lexojmë tek ajeti 171 i sures "En Nisa", teksa flitet për çështjen e Isait, të birit të Merjemes *(Paqja qoftë mbi ta!)*. Në atë ajet thuhet: **"Mesihu** (Isai)**, i biri i Merjemes, është vetëm i Dërguar i All'llahut dhe Fjala e Tij, të cilën ia ka dërguar Merjemes, si dhe shpirt i krijuar nga Ai."**.

Disa komentues menduan se togfjalëshi: **"në fjalën e përkushtimit"**, nënkupton urdhrin që All'llahu i Madhëruar ka dhënë për besimtarët, lidhur me çështjen në fjalë.

Kuptimi më i përshtatshëm është shpirti i përkushtimit, që bart në vetvete kuptimin e formësimit dhe, që në rastin konkret, është rezultante e besimit, e qetësisë shpirtërore dhe e nënshtrimit të zemrës ndaj urdhëresave të All'llahut të Lartësuar. Për këtë arsye, te disa transmetime të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* vëmë re se fjala "*përkushtim*" nënkupton thënien: *Nuk ka Zot tjetër të adhuruar me të drejtë, përveç All'llahut.*[1] Ndërsa në një transmetim tjetër, nga Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)*, thuhet se ai e ka komentuar fjalën "*përkushtim*" me besimin.[2]

Në disa prej hytbeve të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* lexojmë: "*Ne jemi fjala e përkushtimit dhe rruga e udhëzimit.*".[3]

E ngjashme me këtë shprehje, është edhe ajo që transmetojmë prej Imam Ali ibn Musa Riza *(Paqja qoftë mbi të!)*: "*Ne jemi fjala e përkushtimit dhe lidhja më e sigurt.*".[4]

Është e qartë, se besimi te profetësia dhe te prijësi janë prej plotësuesve të besimit me origjinën e Njësimit dhe njohjen e All'llahut, pasi të gjitha së bashku të orientojnë për tek All'llahu dhe bëjnë ftesë për Njësim.

Sipas të gjitha rasteve, duket qartë se myslimanët nuk u sprovuan me këtë arrogancë dhe me këtë kryeneçësi gjatë këtyre momenteve delikate dhe e ardhmja e tyre e ndritur, që All'llahu e

[1] Tefsiri "Ed Durrrrul Menthur", vëll. 6, f. 80.
[2] "Usulul Kafij", njëlloj siç është përmendur te tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, f. 73.
[3] "Khisalus Saduk", vëll. 2, f. 432; tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, f. 73.
[4] "Biharul Enuar", vëll. 23, f. 35; tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, f. 74.

kishte caktuar për ta në Hudejbije, nuk u prek nga këto dukuri. Ndodhi kështu, sepse All'llahu i Madhëruar tha: **"...e i bëri ata të mbështeten fort në fjalën e përkushtimit** (ndaj All'llahut**). Ata kishin më të drejtë e qenë më të denjë për të..."**.

Është e qartë se nuk mund të ketë pritshmëri të madhe, që një grusht injorantësh prej adhuruesve të putave, përveç fanatizmit dhe kryeneçësisë së kohës së injorancës, sikurse është e qartë, nuk mund të presësh prej myslimanëve që u rritën dhe u edukuan për vite më radhë te shkollat e Islamit, sjellje të kësaj natyre, që i përket kohës së injorancës. Ajo që pritet prej tyre, është qetësia shpirtërore, paqja e brendshme, autoriteti dhe përkushtimi. Këto ishin cilësi që ata i shfaqën gjatë Marrëveshjes së Hudejbijes, edhe pse disa myslimanë, me personalitet të ashpër dhe humor të keq, për pak sa nuk e thyen këtë barrikadë të fortë, duke bërë disa sjellje prej mbeturinave të së shkuarës dhe prej rrëmujës, edhe pse qetësia dhe maturia e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ishin mbizotëruese. Ata ngjanin me ujin, të cilin, kur e hedh mbi zjarrin, e fik atë.

Ajeti përfundon me thënien e All'llahut të Madhëruar: **"...All'llahu është i Gjithëdijshëm për çdo gjë."**. All'llahu i Lartësuar ka dijeni të plotë për qëllimet negative të mohuesve dhe për pastërtinë e zemrave të besimtarëve. Kështu, All'llahu zbret në zemrat e tyre qetësinë, përkushtimin, duke i lënë ata të tjerë në makthin, fanatizmin dhe kryeneçësinë e tyre të injorancës. All'llahu përfshin secilin prej grupeve me atë që meritojnë, prej mirësisë e mëshirës a prej hidhërimit dhe ndëshkimit të Tij.

Hulumtim

Çfarë është zelltaria pagane e kohës së injorancës?

Thamë më parë, se fjala *"el hamijetu"*, në origjinën e saj vjen nga fjala*"hamije"* dhe kuptimi i saj është nxehtësia. Më pas u përdor në kuptimin e zemërimit sikurse u përdor më pas si një formë e krenarisë apo e fanatizmit të përzier me zemërim.

Kjo fjalë mund të përdoret ndonjëherë në kuptimin e keq të saj (edhe nëse shoqërohet prej injorancës, edhe nëse nuk shoqërohet), siç mund të përdoret herë të tjera për të lavdëruar. Në këtë rast, ajo vjen në kuptimin e fanatizmit apo zellit për çështjet pozitive dhe produktive.

Kur disa nga shokët e tij kryeneçë e kritikuan Prijësin e myslimanëve, Imam Aliun *(Paqja qoftë mbi të!)*, ai tha: *"Jam rrethuar prej njerëzve, që nuk më binden sa herë i urdhëroj; nuk më përgjigjen, sa herë i thërras të vijnë. A nuk e keni një fe që t'ju bashkojë?! A nuk e keni nxehtësinë që t'ju nxisë?!"*.[1]

Më së shumti, kjo fjalë është përdorur për të qortuar dhe për të sharë, ashtu siç shpeshherë e ka përdorur Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* te ligjëratat e tij të ashpra, kur shante nëpërmjet saj Iblisin, Imamin e kryeneçëve dhe të mendjemëdhenjve: *"I besuan*

[1] "Nehxhul Belaga", Ligjërata 39.

atij (të mallkuarit Iblis) kryeneçët, vëllezërit e fanatizmit dhe kalorësit e mendjemadhësisë dhe të injorancës.”.[1]

Në një tjetër moment, të së njëjtës ligjëratë, ai u bën ftesë atyre të bëjnë kujdes dhe të ruhen prej zelltarisë së kohës së injorancës, duke thënë: *“Fikni në zemrat tuaja zjarret e kryeneçësisë dhe urrejtjet e kohës së injorancës, pasi ato janë prej veseve, frymëzimit, ngacmimit dhe sjelljeve të djallit të mallkuar.”*.[2]

Në të gjitha rastet, nuk ka asnjë dyshim se prania e këtyre simptomave dhe shenjave tek individët dhe shoqëritë, është burim prapambetjeje për ato shoqëri. Ato bëhen shkaktarë të mbylljes së trurit, të prangosjes së mendimit njerëzor dhe të ndalimit të tij, për të konstatuar drejt dhe për të diagnostikuar saktë. Kjo situatë, mund të shkaktojë, gjithashtu, që interesat e tij t’i marrë era.

Në fakt, transmetimi i traditave të gabuara nga njëri brez te tjetri dhe nga njëri popull te tjetri, nuk ka ekzistuar, përveçse gjatë kohës së kësaj zelltarie dhe kryeneçësie të poshtër.

Rezistenca e popujve ndaj Profetëve dhe ndaj udhëheqësve të tyre ka si burim të njëjtën natyrë dhe sjellje njerëzore.

Transmetohet nga Imam Ali Ibn El Hysjen *(Paqja qoftë mbi të!)* se, kur është pyetur për zelltarinë dhe kryeneçësinë, ai është përgjigjur: *“Zelltaria dhe fanatizmi që quhet gjynah për njeriun, është të konsiderosh të këqijtë e popullit tënd më të mirë se të mirët e popullit*

[1] “Nehxhul Belaga”, Ligjërata 192.
[2] Burimi i mëparshëm.

tjetër. Nuk është prej fanatizmit që njeriu të dojë popullin e tij, por prej fanatizmit është të ndihmosh njerëzit e tu, kur ata bëjnë padrejtësi.".[1]

Mënyra e duhur për të shpëtuar prej kësaj humbjeje të madhe dhe për t'u përballur me këtë dukuri negative është angazhimi dhe përpjekja për të ngritur nivelin kulturor, atë të mendimit dhe të besimit te çdo grup njerëzor dhe te çdo popull.

Në të vërtetë, Kur'ani e mjekoi këtë plagë dhe këtë sëmundje të shoqërive nëpërmjet ajetit të mësipërm, pasi ai flet për qetësinë shpirtërore dhe për përkushtimin e besimtarëve, aty ku gjendet devotshmëria dhe mungon zelltaria e kohës së injorancës. Kësisoj, aty ku gjendet zelltaria e kohës së injorancës, mungon paqja shpirtërore dhe qetësia.

[1] Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, Hadithi 70, f. 73.

Ajeti 27

لَّقَدْ صَدَقَ ٱللَّهُ رَسُولَهُ ٱلرُّءْيَا بِٱلْحَقِّ ۖ لَتَدْخُلُنَّ ٱلْمَسْجِدَ ٱلْحَرَامَ إِن شَآءَ ٱللَّهُ ءَامِنِينَ مُحَلِّقِينَ رُءُوسَكُمْ وَمُقَصِّرِينَ لَا تَخَافُونَ ۖ فَعَلِمَ مَا لَمْ تَعْلَمُواْ فَجَعَلَ مِن دُونِ ذَٰلِكَ فَتْحًا قَرِيبًا ٢٧

"All'llahu e përmbushi me të vërtetë vizionin e të Dërguarit të Tij, i cili kishte thënë: 'Me siguri, ju do të hyni në Xhaminë e Shenjtë, dashtë All'llahu, të sigurt, kokërruar dhe flokëshkurtuar, pa kurrfarë frike.'. Ai e dinte atë që nuk e dinit ju dhe, veç kësaj, ju dhuroi një fitore të afërt."

Komentimi

Ëndrra e vërtetë e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*

Ky ajet, gjithashtu, përshkruan një aspekt tjetër të historisë së rëndësishme të Hudejbijes, e cila ishte: Gjatë qëndrimit të tij në Medine, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* pa në ëndërr, sikur po hynte në Mekë, bashkë me shokët e tij, për të kryer ritualet e Umres. Kur ia tregoi

ëndrrën që kishte parë shokëve të tij, ata u gëzuan shumë, por, teksa një grup prej shokëve të tij imagjinonin se ëndrra e tij do të realizohej në të njëjtin vit, u ndaluan nga idhujtarët për të hyrë në Mekë. Ata nisën të dyshonin dhe të lëkundeshin. Si është e mundur që ëndrra e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* të jetë e parealizueshme?! A nuk ishte udhëzimi se do të kryenin Umren në atë vit?! Ku shkoi premtimi i Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe çfarë ndodhi me këtë ëndërr kaq të bukur?!

Përgjigjja e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* për ta ishte kjo: *"A ju thashë unë se kjo ëndërr do të realizohej këtë vit?!"*.

Në ato momente, kur Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* po kthehej nga Hudejbija për në Medine, zbriti ajeti kur'anor, për ta sqaruar këtë çështje, duke e bërë të qartë se kjo ëndërr që Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* kishte parë, ishte e realizueshme dhe domosdoshmërish e qenë. Në ajet thuhet kështu: **"All'llahu e përmbushi me të vërtetë vizionin e të Dërguarit të Tij..."**,[1] sepse gjithçka që sheh në ëndërr Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, është e vërtetë.

[1] Fjala *"sadeka"* është një folje e kohës së kryer së thjeshtë. Ajo mund të tregojë për dy kryefjalë, në të njëjtën kohë, ashtu si tek ajetet e mëparshme. *I Dërguari i Tij* është kryefjala e parë dhe *vizioni* është kryefjala e dytë. Kjo folje mund të përfshijë gjithashtu një kryefjalë të vetme, e cila i bashkëngjitet kryefjalës së dytë nëpërmjet shprehjes (fi- në), sikur të thuash: *e besova atë në fjalën e tij*.

Më pas, në të njëjtin ajet thuhet: **"...i cili kishte thënë: 'Me siguri, ju do të hyni në Xhaminë e Shenjtë, dashtë All'llahu, të sigurt, kokërruar dhe flokëshkurtuar, pa kurrfarë frike.'. Ai e dinte atë që nuk e dinit ju..."**. Te kjo vonesë kishte një urtësi të madhe, e cila duket te vazhdimi i të njëjtit ajet, ku thuhet kështu: **"...veç kësaj, ju dhuroi një fitore të afërt."**.

Hulumtime

Tek ajeti i mësipërm ka disa çaste të rëndësishme që bien në sy:

1- Duhet të kuptojmë fillimisht se *lami* - shkronja *l* te folja **"le tedkhulunne" – "do të hyni"**, është *lami – l* i betimit dhe se *nuni - n* në fund të foljes është *n* e sigurisë. Kjo sqaron se nuk ka dyshim që ky është një premtim i padiskutueshëm hyjnor, si dhe një parashikim shumë i qartë, në formën e mrekullisë për kryerjen e ritualeve të Umres në gjendje të plotë sigurie dhe qetësie shpirtërore. Ashtu siç do ta sqarojmë më pas, ky parashikim dhe hamendësim ishte i vërtetë për të njëjtin muaj, Dhil Kaideh të një viti më pas. Kështu myslimanët e kryen Umren sipas këtij përfytyrimi.

2- Shprehja **"in shaae All'llahu" – "dashtë All'llahu"**, në këtë rast, mund të jetë një mënyrë e përzgjedhur prej All'llahut që t'i edukojë robtë e Tij me besimin te vullneti i Tij, sa herë flitet për të ardhmen, që të mos e harrojnë atë dhe të mos e shohin kurrë veten të shkëputur prej tij dhe larg nevojës për të. Në këtë rast,

mund të tregohet për kushtet që All'llahu i Lartësuar i përgatit për këtë sukses: "Ndihma e All'llahut për myslimanët, që vizita e tyre për te Shtëpia e Tij të realizohet me sukses në të ardhmen e afërt dhe në të njëjtën kohë, qëndrimi i tyre në linjën e qetësisë shpirtërore dhe të Njësimit të Tij.

Mundet, gjithashtu, që kjo fjali të jetë duke nënkuptuar disa myslimanë, jeta e të cilëve do të ndërpritet gjatë kësaj periudhe të ndërmjetme kohore dhe nuk do të mund ta kryejnë vizitën në Shtëpinë e All'llahut. Nuk ekziston asnjë lloj pengese, për t'i bashkuar këto kuptime.

3- Marrëveshjen e Hudejbijes, Kur'ani Famëlartë e konsideroi si një fitore të madhe. Tashmë e dimë se kjo fitore hapi rrugën për të hyrë në Xhaminë e Shenjtë, në vitin pasues. Ndërkohë, një grup tjetër komentuesish besojnë se *fitore e shpejtë*, në këtë rast, është tregues për çlirimin e Khajberit. Është e natyrshme që fjala *e shpejtë* në ajet, t'i përshtatet më shumë çlirimit të Khajberit, pasi ai u konkretizua menjëherë pas kësaj ëndrre të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, pra, në një kohë më të afërt dhe më të shpejtë se çlirimi i Mekës. Pas gjithë kësaj, Kur'ani Famëlartë tregon në ajetin 18 të kësaj sureje, kur flitet për Besëlidhjen e Riduanit: **"Prandaj u dha atyre qetësi dhe i shpërbleu ata më një fitore të afërt."**. Ashtu siç e thamë edhe më parë, ky është mendimi i pjesës më të madhe të komentuesve, e gjithashtu, çlirimi dhe fitorja për të cilën flitet në këtë ajet, është çlirimi i Khajberit. Ka edhe tregues të tjerë në ajet, që e vërtetojnë këtë pretendim. Ajo që vihet re, është edhe harmonia e plotë ndërmjet këtij ajeti – objekt i studimit tonë - dhe ajetit tjetër, ndaj duket qartë se të dy ajetet

kanë të njëjtin kuptim.[1] Te tefsiri i Ali ibn Ibrahimit është një transmetim, i cili bën fjalë për të njëjtin kuptim.

4- Fjala **"kokërruar"** dhe **"flokëshkurtuar"** tregon qartë për njërin prej ritualeve të Umres dhe rregullave të saj, i cili është shkurtimi i flokëve, nëpërmjet të cilit njeriu çlirohet prej veshjes së ihramit. Lidhur me këtë, disa komentues kanë argumentuar lirinë e zgjedhjes ndërmjet shkurtimit, për sa i përket thonjve dhe rruajtjes së kokës gjatë çlirimit prej veshjes së ihramit, pasi bashkimi ndërmjet të dyjave, në asnjë rast, nuk bëhet i detyrueshëm.

5- Fjalia: **"Ai e dinte atë që nuk e dinit ju"**, tregon për çështje të rëndësishme të mbyllura gjatë Marrëveshjes së Hudejbijes, të cilat u zbuluan me kalimin e kohës, pikërisht atëherë kur themelet e Islamit u forcuan, zëri i tij u përhap ngado dhe oshtimat e tij mbërritën në çdo vend. Atëherë kur ndaloi dhe prirja e myslimanëve për luftë dhe arritën ta çlironin Khajberin me shumë qetësi. Atë kohë kur myslimanët nisën të dërgonin përfaqësuesit e tyre skajeve të Gadishullit Arabik dhe, kur Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* u shkroi letra të mëdhenjve dhe kryetarëve të shteteve të atyre kohëve. Këto ishin prej atyre çështjeve, të cilat myslimanët nuk i dinin në atë kohë, por All'llahu i Madhëruar i dinte shumë mirë.

[1] Shprehja "*veç kësaj*", ose vjen në kuptimin "para saj", që do të thotë: para se të shkoni në Mekë për të kryer ritualet e Umres, All'llahu i Madhëruar do t'ju dhurojë një fitore të shpejtë gjatë vitit të ardhshëm. Ose, në kuptimin "*përveç asaj*", që do të thotë se myslimanët do të arrijnë një fitore të shpejtë, përveç fitores së lidhur me vizitën e Shtëpisë së All'llahut dhe kryerjen e Umres.

6- Në këtë ajet përballemi me çështjen e ëndrrës apo të zbulesës dhe ajo është ëndrra e vërtetë e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, e cila mund të konsiderohet një degë prej degëve të Zbulesës hyjnore. Ajo është e ngjashme me ëndrrën e Profetit Ibrahim *(Paqja qoftë mbi të!)*, kur iu shfaq therja e birit të tij, Ismailit *(Paqja qoftë mbi të!)*, e përmendur në ajetin 102 të sures "Es Saffat". (Për më tepër sqarim, lidhur me ëndrrat dhe kuptimet e tyre, është mirë t'i ktheheni komentimit të sures "Jusuf", tek ky tefsir.)

7- Ajeti 27 është një prej çështjeve të panjohura, për të cilat na ka njoftuar Kur'ani. Ai dëshmon se ky Libër (Kur'ani) është me burim qiellor dhe ai përfaqëson, në të njëjtën kohë, një prej mrekullive më të mëdha të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Nëpërmjet tij vjen lajmi i prerë dhe i padiskutueshëm, për kryerjen e ritualeve të Umres dhe vizitën e Xhamisë së Shenjtë në të ardhmen e afërt. Ai njofton, gjithashtu, fitoren e shpejtë përpara vizitës së Mekës. Tashmë jemi të mirinformuar se këto dy parashikime u realizuan. Më lart përmendëm historinë e çlirimit të Khajberit. Ndërsa tani do flasim për kryerjen e Umres kaza.

Umreja kaza

Umreja kaza është Umreja, të cilën Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e kreu bashkë me shokët e tij, një vit pas Marrëveshjes së Hudejbijes, pra, në muajin Dhil Kaideh të vitit të shtatë të Hixhretit. (Për të qenë më të saktë, themi se ajo u krye një vit, pasi idhujtarët e ndaluan

Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe shokët e tij të hynin në Mekë.)[1]

Umreja kaza, apo plotësuese, e mori këtë emërtim, sepse ajo ishte plotësim i Umres që myslimanët nuk mundën ta kryenin vitin paraardhës.

Sqarim:

Sipas njërit prej neneve të Marrëveshjes së Hudejbijes, u sanksionua që myslimanët të kryenin ritualet e Umres dhe të vizitonin Shtëpinë e All'llahut gjatë vitit pasardhës, me kusht që të mos qëndronin në Mekë më shumë se tri ditë. Në të njëjtën kohë, krerët dhe paria e idhujtarëve të Mekës duhet të dilnin jashtë saj, gjatë kësaj kohe, në mënyrë që të shmangej një përplasje e mundshme dhe të mos i shikonin myslimanët duke kryer ritualet e Umres, që të mos ndikoheshin prej ritualeve me natyrë monoteiste të myslimanëve.

Te disa burime historike transmetohet se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe shokët e tij i veshën rrobat e ihramit një vit më pas dhe bashkë me devetë që kishin marrë për t'i bërë kurban, udhëtuan, derisa mbërritën tek periferitë e Dhahranit. Nëpërmjet një shoku të tij, të quajtur Muhammed bin Meslemetu, ai i largoi armët dhe kuajt që binin në sy. Kur idhujtarët e panë këtë, u trembën dhe i kaploi një frikë e madhe, pasi ata menduan se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* synonte t'i luftonte ata, duke e prishur kësisoj marrëveshjen dhjetëvjeçare,

[1] Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, Hadithi 84, f. 76.

të firmosur prej tij. Ata shkuan të njoftonin banorët e Mekës lidhur me këtë.

Ndërkohë, kur Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* mbërriti në një vend pranë Mekës, urdhëroi që të çarmatoseshin prej shigjetave, shtizave dhe armëve të tjera, te një vend i quajtur Jaxhixh. Më pas, ai dhe shokët e tij hynë në Mekë me shpata të mbuluara. Idhujtarët u gëzuan shumë me këtë lëvizje të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, pasi ai e mbajti premtimin e dhënë. Dukej sikur nëpërmjet kësaj strategjie, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* kishte për synim t'u tregonte banorëve të Mekës se, nëse ata do ta prishnin marrëveshjen dhe do t'i sulmonin myslimanët, atëherë edhe ai bashkë me ta do të ishte plotësisht i gatshëm për t'ju kundërpërgjigjur.

Prijësit e idhujtarëve nisën të dilnin prej Mekës, që ndjenjat dhe zemrat e tyre të mos ndikoheshin prej këtyre pamjeve (kryerja e ritualeve të Umres prej Profetit Muhammed dhe shokëve të tij). Pjesa tjetër e banorëve të Mekës, burra, gra e fëmijë, u mblodhën tarracave rreth e qark Qabes dhe rrugëve rreth saj, për të parë se si i kryenin myslimanët ritualet e tyre.

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* hyri në Mekë i shoqëruar nga flladi i kësaj atmosfere të veçantë. Me vete kishte shumë deve të sjella për kurban dhe u soll me shumë butësi dhe dashuri me banorët e Mekës. Ai i urdhëroi shokët e tij që të shpejtonin pak, gjatë rrotullimit rreth Qabes dhe të ngrinin pak rrobën e ihramit prej shpatullave të tyre, duke bërë kështu një demonstrim të forcës

dhe të mundësive të tyre. Kjo lëvizje, kishte për qëllim që kjo panoramë të ngulitej mirë në thellësitë e kujtesës së banorëve të Mekës dhe të linte pas ndikimet e saj te zemrat e tyre, duke treguar kështu edhe njëherë tjetër urtësinë dhe fuqinë e myslimanëve.

Gjithsesi, Umreja e fundit apo Umreja plotësuese, ishte shprehje e fuqisë së muskujve të zbuluar. Duhet ta citojmë edhe faktin që çlirimi i Mekës, i cili u realizua një vit më vonë, erdhi si fryt i kësaj fare të mbjellë një vit më parë, e cila e shtroi, gjithashtu, terrenin për dorëzimin e banorëve të Mekës ndaj çlirimtarëve myslimanë. Kjo situatë e krijuar, ngacmoi krerët e Mekës, deri në atë shkallë, sa u detyruan që pas tri ditësh të dërgonin një përfaqësues të tyre te Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, për ta njoftuar atë se ai dhe shokët e tij duhet të largoheshin menjëherë prej Mekës, pas skadimit të afatit treditor të sanksionuar në marrëveshje.

E bukura këtu, qëndron te fakti se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* u martua me një grua prej grave vejusha të idhujtarëve. Ajo ishte e afërt me disa prej udhëheqësve të njohur të Mekës. Kjo lëvizje e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* kishte për qëllim të nxiste afrimin me ta, sikurse kishte për qëllim që ta zbuste nivelin e urrejtjes dhe të armiqësisë te zemrat e tyre.

Sapo Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i mbërriti propozimi i tyre për t'u

larguar, tha: *"Ç'të keqe mund të ketë për ju, sikur ta bëj dasmën në mesin tuaj, të përgatis ushqim dhe të ushqeheni edhe ju prej tij?!"*

Ata thanë: *"Ne nuk kemi nevojë për ushqimin tënd, ndaj dil menjëherë që këtu."*

Nëse ata do të kishin lejuar që kjo të ndodhte, sigurisht që sjellja e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* do të kishte ndikimet e saj të mëdha te mendjet dhe zemrat e tyre, por ata nuk e lejuan këtë të ndodhte.

Ajetet 28 – 29

هُوَ ٱلَّذِىٓ أَرۡسَلَ رَسُولَهُۥ بِٱلۡهُدَىٰ وَدِينِ ٱلۡحَقِّ لِيُظۡهِرَهُۥ عَلَى ٱلدِّينِ كُلِّهِۦۚ وَكَفَىٰ بِٱللَّهِ شَهِيدٗا٢٨ مُّحَمَّدٞ رَّسُولُ ٱللَّهِۚ وَٱلَّذِينَ مَعَهُۥٓ أَشِدَّآءُ عَلَى ٱلۡكُفَّارِ رُحَمَآءُ بَيۡنَهُمۡۖ تَرَىٰهُمۡ رُكَّعٗا سُجَّدٗا يَبۡتَغُونَ فَضۡلٗا مِّنَ ٱللَّهِ وَرِضۡوَٰنٗاۖ سِيمَاهُمۡ فِي وُجُوهِهِم مِّنۡ أَثَرِ ٱلسُّجُودِۚ ذَٰلِكَ مَثَلُهُمۡ فِي ٱلتَّوۡرَىٰةِۚ وَمَثَلُهُمۡ فِي ٱلۡإِنجِيلِ كَزَرۡعٍ أَخۡرَجَ شَطۡـَٔهُۥ فَـَٔازَرَهُۥ فَٱسۡتَغۡلَظَ فَٱسۡتَوَىٰ عَلَىٰ سُوقِهِۦ يُعۡجِبُ ٱلزُّرَّاعَ لِيَغِيظَ بِهِمُ ٱلۡكُفَّارَۗ وَعَدَ ٱللَّهُ ٱلَّذِينَ ءَامَنُواْ وَعَمِلُواْ ٱلصَّٰلِحَٰتِ مِنۡهُم مَّغۡفِرَةٗ وَأَجۡرًا عَظِيمَۢا٢٩

“Është Ai që e ka çuar të Dërguarin e Vet me Udhëzimin dhe fenë e vërtetë, për ta ngritur atë mbi të gjitha fetë. All’llahu mjafton si dëshmitar.”

“Muhammedi është i Dërguar i All’llahut. Ata që janë me të, janë të ashpër ndaj jobesimtarëve e të mëshirshëm midis tyre. I sheh ata si përkulen dhe bien në sexhde, duke kërkuar dhuntinë dhe kënaqësinë e All’llahut. Në fytyrat e tyre shihen shenjat e sexhdes. Ky është përshkrimi i tyre në Teurat. Ndërsa në Ungjill, shembulli i tyre përshkruhet si një farë e mbjellë që lëshon filiza e forcohet e pastaj ngrihet e fortë me kërcellin e

vet, duke i gëzuar mbjellësit. (Kështu përshkruhen ata) **me qëllim që, nëpërmjet tyre, Ai t'i zemërojë mohuesit. Për ata midis tyre që besojnë dhe kryejnë vepra të mira, All'llahu ka premtuar falje dhe shpërblim të madh."**

Komentimi

"Të ashpër ndaj jobesimtarëve e të mëshirshëm midis tyre"

Te këto dy ajete, të cilët shënojnë dhe fundin e sures "El Fet'h", flitet për dy çështje të rëndësishme, njëra prej tyre është Marrëveshja e Hudejbijes, si një fitore e madhe, që shpalos natyrën mbarëbotërore të Islamit dhe e dyta është e lidhur me cilësitë e shokëve të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, me veçoritë e secilit prej tyre dhe me premtimin e madh të All'llahut.

Në ajetin e parë, prej këtyre dy ajeteve, thuhet: **"Është Ai që e ka çuar të Dërguarin e Vet me Udhëzimin dhe fenë e vërtetë, për ta ngritur atë mbi të gjitha fetë. All'llahu mjafton si dëshmitar."**.

Këtu kemi të bëjmë me një premtim të formës së prerë dhe shumë të qartë nga ana e All'llahut të Lartësuar, tek i cili tregohet për triumfin e Islamit dhe për supermacinë e tij ndaj të gjitha feve të tjera. Kjo do të thotë gjithashtu: O ju myslimanë, mos u habisni, nëse All'llahu ju njofton nëpërmjet ëndrrës që i zbuloi Profetit të Tij, fitoren tuaj të madhe, se do të hyni të sigurt në Xhaminë e

Shenjtë, do të kryeni atje ritualet e Umres, pa guxuar askush t'ju trazojë. Mos u habisni, gjithashtu, teksa All'llahu i Madhëruar ju njofton rreth fitores së shpejtë, çlirimin e Khajberit. Në të vërtetë, fillimi i mirësisë është një pikë dhe më pas Islami do ta shtrijë freskinë e hijes së tij në të gjithë botën dhe do të triumfojë mbi të gjitha fetë e tjera.

Si mund të ndodhte ndryshe? Thelbi i përmbajtjes së thirrjes së Muhammedit *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ishte udhëzimi për në Rrugën e All'llahut, pasi Ai e dërgoi atë me udhëzim dhe me fenë e Tij (fenë e vërtetë). Çdo hulumtues i paanshëm, e ka të lehtë ta dallojë vërtetësinë e ajeteve kur'anore dhe të platformave individuale, shoqërore, gjyqësore dhe politike të tij. Ai e ka të lehtë, gjithashtu, të njihet me raportet dhe marrëdhëniet e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* me All'llahun, me njoftimet dhe parashikimet rreth çështjeve të panjohura që Ai i dërgonte të Dërguarit të Tij *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe që realizoheshin në të ardhmen, në mënyrë të padiskutueshme.

Është e vërtetë, se logjika e shëndoshë e Islamit dhe përmbajtja e tij shumë e pasur, do ta pastrojnë Tokën prej feve të papastra politeiste. Atij (Islamit) do t'i nënshtrohen fetë e transformuara qiellore dhe me metodën e tij elegante do të bëjë për vete zemrat e njerëzisë. Por, çfarë nënkuptohet me ngritjen e Islamit mbi të gjitha fetë?! A do të jetë kjo një supermaci logjike e tij?! Apo bëhet fjalë për supermacinë dhe triumfin ushtarak?!

Komentuesit e Kur'anit kanë mendime të ndryshme lidhur më këtë aspekt.

Disa prej tyre mendojnë se, në këtë rast, kemi të bëjmë vetëm me supermaci logjike dhe argumentuese të fesë islame ndaj feve të tjera. Kjo është tashmë një çështje që ka ndodhur. Në fakt, është i pakundërshtueshëm fakti se Islami gëzon një supermaci të padiskutueshme argumentuese dhe logjike ndaj të gjitha feve të tjera.

Disa të tjerë e komentuan duke thënë se, në këtë rast, kemi të bëjmë me triumfin, fitoren e dukshme dhe supermacinë e fuqisë. Burimet gjuhësore tregojnë se të gjitha përdorimet e fjalës "*dhahere*" dhe i të gjitha fjalëve që burojnë prej saj, të çojnë te kuptimi i lidhur me supermacinë sipërfaqësore dhe asaj të forcës. Për këtë arsye, mund të themi se, përveç ndikimit që Islami kishte shtrirë në hapësira të mëdha të Lindjes e të Perëndimit (të cilat gjenden edhe në ditët e sotme nën flamurin e tij, në formën e më shumë se dyzet shteteve islame të banuara prej më shumë se një miliardë banorësh), do të vijë dita kur Islami do të shtrihet (zyrtarisht) në të gjithë botën. Kjo panoramë do të plotësohet me shfaqjen e Mehdiut.

Transmetohet prej disa haditheve të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: *"Nuk do të mbetet mbi sipërfaqen e Tokës asnjë shtëpi e vetme dhe asnjë copë tokë, që All'llahu i Lartësuar të mos dërgojë atje fjalën e Islamit."*.[1]

Këtë rast, e kemi studiuar edhe më parë, tek i njëjti tefsir, në fundin e ajetit 33 të sures "Et Teube", e ngjashme me ajetin 28, që po studiojmë.

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 5, f. 25. Tefsiri "El Kurtubi", vëll. 7, f. 692. Ky transmetim u krye edhe nga Profeti Muhammed, fundi i ajetit 55, sure "En Nur".

Këtu shfaqet një vërejtje që bie në sy. Është fakti që disa komentues janë të mendimit se fjala *"el huda"* – *"udhëzimin"*, tregon forcimin e çështjeve të besimit islam, ndërkohë që togfjalëshi *"dijnul hakki"* – *"fenë e vërtetë"*, tregon vërtetësinë e degëve të fesë, edhe pse nuk kemi asnjë argument për këtë ndarje dhe klasifikim. I qartë është fakti se udhëzimi dhe vërtetësia janë të lidhura edhe me çështjet e origjinës, edhe me degët.

Për sa i përket trajtës së shkurtër të përemrit vetor te paskajorja *"për ta ngritur"* – *"li judhhirehu"*, a kthehet ai tek Islami apo te Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, komentuesit e Kur'anit flasin për dy mundësi të lidhura me këtë rast, edhe pse ka precedentë të tjerë që tregojnë qartë se, në këtë rast, nënkuptohet feja e vërtetë, sepse ajo është shumë pranë përemrit në fjali. Ky është një komentim që i referohet rregullave dhe radhitjes gjuhësore të fjalëve, sikurse mund të themi se qasja më e përshtatshme, në këtë rast, është: Ngritja është e një feje ndaj një tjetre, jo e një personi ndaj një feje.

Çështja e fundit që duam të tërheqim vëmendjen, lidhur me këtë ajet, është fjalia: **"...All'llahu mjafton si dëshmitar."** Kjo fjali tregon se ky parashikim i Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nuk ka nevojë për dëshmitarë, pasi dëshmitari i tij është vetë All'llahu i Madhëruar. Profetësia e Muhammedit *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, nuk ka nevojë për dëshmitarë të tjerë, sepse dëshmitar është All'llahu, gjithashtu. Edhe pse, i deleguari i kurejshëve, Suhejl ibn Amri dhe të ngjashmit me të, nuk pranuan, që krahas emrit të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, të vendosej titulli më i lartë i

akorduar atij prej All'llahut (I Dërguari i All'llahut), ky fakt nuk ngjall e as nuk ngacmon asnjë lloj ndikimi.

Tek ajeti i fundit, vjen një përshkrim shumë elokuent për shokët e sinqertë të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, për ata shokë që ndoqën rrugën e tij dhe që u përmendën në Teurat dhe në Ungjill, çka përbën dhe një arsye serioze krenarie për ta. Ishin ata që demonstruan nderin dhe burrërinë e tyre në Hudejbije, por edhe përgjatë etapave të tjera të rëndësishme, sikurse ishte një mësim dhe sprovë për të gjithë myslimanët përgjatë shekujve dhe etapave historike.

Në fillim të ajetit thuhet: **"Muhammedi është i Dërguar i All'llahut..."**, e pranojnë lakuriqët e natës, siç ishte Suhejl ibn Amri, edhe nëse nuk e pranojnë këtë fakt?! A e fshehën ata veten e tyre ndaj dritës së këtij Dielli, i cili lindi për të ndriçuar mbarë botën, apo nuk e fshehën?! All'llahu është Dëshmitar i profetësisë së tij dhe bashkë me të janë ata që e njohin dhe e pranojnë ekzistencën e All'llahut.

Më pas, ajeti përshkruan cilësitë e tyre sipërfaqësore dhe ato të fshehurat, duke i përmbledhur ato në pesë të tilla: **"...Ata që janë me të, janë të ashpër ndaj jobesimtarëve..."**. Cilësia e dytë është: **"...të mëshirshëm midis tyre..."**.

Kjo është e vërteta. Ata janë pikënisja e dashurisë dhe e mëshirës ndërmjet tyre, ashtu siç janë pikënisja e zjarrit, e flakëve dhe një pengesë e fortë për armiqtë e tyre jobesimtarë.

Në të vërtetë, të gjitha ndjenjat dhe mendimet e tyre përmblidhen shkurtimisht te këto dy cilësi, që janë: mëshira dhe ashpërsia. Pikësëpari, nuk ka kundërshti te bashkimi ndërmjet të

dyja këtyre cilësive dhe së dyti, as mëshira e qarkulluar ndërmjet njëri-tjetrit, as ashpërsia ndaj jobesimtarëve nuk e bëjnë të detyrueshëm devijimin e tyre prej Rrugës së Drejtë.

Më pas, në ajet përmendet cilësia e tyre e tretë: **"...I sheh ata si përkulen dhe bien në sexhde..."**. Kjo shprehje përfaqëson dy prej shtyllave kryesore të adhurimit, që janë: rukuja dhe sexhdja, si gjendje e vazhdueshme e tyre. Adhurimi është simbolika më e rëndësishme e gjunjëzimit përballë urdhëresave të All'llahut, mposhtja e mendjemadhësisë e kryeneçësisë dhe e egoizmit te qeniet e tyre.

Ndërsa cilësia e katërt, që e përmend ajeti kur'anor, lidhur me shokët e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është përshkrimi që i bëhet qëllimeve të tyre të pastra. Në ajet thuhet: **"...duke kërkuar dhuntinë dhe kënaqësinë e All'llahut..."**.

Ata nuk e njohin hipokrizinë, as dyfytyrësinë dhe as nuk presin ndonjë shpërblim prej njerëzve, por qëllimi i tyre i vetëm dhe madhor është kënaqësia e All'llahut. Qëllimi i ekzistencës dhe i të gjitha lëvizjeve në jetën e tyre është pikërisht, ky.

Edhe fjala *"fadlen" – "dhuntinë",* tregon se ata i pranojnë mangësitë dhe i shikojnë veprat e tyre më të vogla se të jenë të meritueshme për shpërblimin e All'llahut. Me gjithë veprat e tyre të mira, adhurimet dhe përkushtimin e tyre, ata vazhdojnë të thonë: Mjerë ne, po të mos ishte dhuntia jote, o All'llah!

Ndërsa cilësia e pestë është e lidhur me shenjat që ndriçojnë te fytyrat e tyre. Në ajet thuhet: **"...Në fytyrat e tyre shihen shenjat e sexhdes..."**.

Fjala *"sijma"*, në origjinë, ka kuptimin e shenjës dalluese dhe të pamjes, edhe në rast se kjo shenjë gjendet në fytyrë, por edhe nëse gjendet në një vend tjetër, por që te përdorimet e saj të njohura e të përhapura nënkupton shenjën në fytyrë dhe gjurmën e dukshme të saj aty. Me fjalë të tjera, paraqitja e tyre e jashtme tregon qartë se ata janë njerëz të nënshtruar ndaj All'llahut, ndaj të vërtetës, ndaj ligjit dhe drejtësisë. Kjo shenjë nuk duket vetëm te fytyrat e tyre, por tek e gjithë qenia, jeta dhe ekzistenca e tyre. Edhe pse disa komentues janë të mendimit se shenja është gjurma e dukshme që formon sexhdja në ballë, ose shenja e dheut prej sexhdes në ballë, duket qartë se ajeti përfaqëson një kuptim më të gjerë, tiparet e të cilit shpalosen te fytyrat e këtyre burrave të nënshtruar ndaj Krijuesit të tyre. Disa të tjerë janë të mendimit se ajeti flet për ndriçimin e fytyrave të tyre si një hënë e plotë në Ditën e Gjykimit, për shkak të sasisë dhe të cilësisë së lartë të sexhdeve të tyre në këtë botë. Natyrshëm, që balli dhe fytyra e tyre të shfaqen në këtë formë në Ditën e Gjykimit, por, në këtë rast, ajeti flet për gjendjen e tyre të dukshme në këtë botë.

Te një hadith i Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)* transmetohet të ketë thënë: *"Këtu bëhet fjalë për faljen e natës."*.[1]

Bashkimi ndërmjet këtyre kuptimeve nuk përbën asnjë kundërshti.

Gjithsesi, pas përmendjes së këtyre cilësive, Kur'ani shkon edhe më tej, duke thënë kështu: **"...Ky është përshkrimi i tyre në Teurat..."**. Pra, kjo e vërtetë dhe këto cilësi janë përmendur edhe më parë, te një Libër qiellor, i zbritur para dymijë vjetësh, por nuk

[1] "Men la jehderuhul Fakijhudatul Uaidhijne", sipas asaj që është përmendur tek tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, f. 78.

duhet të harrojmë se sifjalia: **"Ata që janë me të"**, tregon për praninë shpirtërore dhe fizike të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* te çdo çështje e tyre. Ai ishte i pranishëm te mendimet, besimi, veprat dhe morali i shokëve të tij, por nuk ishte i tillë për ata që ishin në kundërshtim me praktikat e tij.

Më pas, Kur'ani flet për atë që u është bërë atyre te një tjetër Libër qiellor (Ungjilli), duke thënë: **"...Ndërsa në Ungjill, shembulli i tyre përshkruhet si një farë e mbjellë që lëshon filiza e forcohet e pastaj ngrihet e fortë me kërcellin e vet, duke i gëzuar mbjellësit..."**.[1]

Fjala *"esh shata'a"*, nënkupton sythet dhe filizat e njoma që dalin prej kërcellit; fjala *"azerehu"* buron nga fjala "*ndihmë*", pra, e ndihmoi atë. Ndërsa fjala *"istegladha"* buron nga fjala *"el gildhatu"*, që në këtë rast nënkupton "*qëndrueshmërinë*".

Sifjalia: **"duke i gëzuar mbjellësit"**, nënkupton se këto të mbjella, ishin aq të forta, sa kishin qëndrueshmëri në treg. Fjala *"suk"* është shumësi i fjalës *"sak"* dhe shprehja **"duke i gëzuar mbjellësit"**, nënkupton se këto të mbjella rriten shpejt, kanë shumë degë e fryte. Ky fakt, padyshim që i gëzon dhe i lumturon mbjellësit e tyre. Një tjetër aspekt i këndshëm këtu, është fakti se Ungjilli i përshkroi ata nëpërmjet këtyre pesë cilësive: 1. Farë e mbjellë 2. Lëshon filiza 3. Forcohet 4. Ngrihet e fortë 5. Gëzon mbjellësit.

---

[1] Komentuesit, për sifjalinë: "**shembulli i tyre përshkruhet",** kanë thënë se kjo sifjali është e pavarur dhe është një përshkrim tjetër i shokëve të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, ndryshe nga ai i përmendur në Teurat.

E vërteta është se cilësitë e tyre të përmendura në Teurat, nga njëra anë, përshkruajnë dimensionet e ekzistencës së tyre dhe, nga ana tjetër, ndjenjat, qëllimet, veprat dhe pamjen e tyre të jashtme.

Ndërsa cilësitë e përmendura në Ungjill, përshkruajnë trajektoren e lëvizjes së tyre, rritjen e tyre dhe përsosmërinë e tyre, në aspekte të ndryshme jetike. (Vini re me kujdes!)

Mos vallë, është e lidhur me frazën "shembulli i tyre" në Teurat? Pra, që të dyja cilësitë janë të përmendura te dy Libra qiellorë. Ajo që duket sipërfaqësisht, është se ajeti përmendi dy cilësi, secilën më vete te një Libër qiellor. Për këtë arsye, është përsëritur togfjalëshi "*shembulli i tyre*". Nëse kjo cilësi do të ishte e lidhur me tjetrën, korrektësia gjuhësore do ta bënte të detyrueshme që shprehja të jetë: Ai ishte shembulli i tyre, në Teurat dhe Ungjill.

E vërteta është se ata janë njerëz që kanë cilësi të larta dhe nuk shkëputen për asnjë moment prej atyre cilësive. Degët e cilësive të tyre njohin vetëm rritje, forcohen çdo ditë e më shumë dhe i shtojnë frytet e tyre. Ata e përhapin Islamin nëpër botë me fjalët dhe veprat e tyre në shoqërinë islame. Numri i tyre rritet çdo ditë e më shumë. Ata nuk i prek lodhja gjatë rrugëtimit të tyre përpara. Gjendja e tyre adhuruese është përpjekje. Përpjekjet e tyre janë adhurim. Imazhi i tyre është i ndritur. Fshehtësia e tyre është e ndershme. Ndjenjat e tyre janë të vërteta. Qëllimet e tyre janë të sinqerta. Ata janë mishërimi i zemëratës së All'llahut ndaj armiqve të së vërtetës dhe shpalosje e mëshirës për vëllezërit e tyre besimtarë.

Më pas, ajeti plotëson kuptimin e vetvetes, duke shtuar se këto cilësi të larta, ky zhvillim dhe kjo përmbushje e shpejtë e përsosmërisë, nga njëra anë, kënaq e lumturon dashamirësit dhe përkrahësit dhe, nga ana tjetër: **"**(Kështu përshkruhen ata) **me qëllim që, nëpërmjet tyre, Ai t'i zemërojë mohuesit..."**.[1]

Më pas, në përfundim të këtij ajeti, Kur'ani Famëlartë shton: **"...Për ata midis tyre që besojnë dhe kryejnë vepra të mira, All'llahu ka premtuar falje dhe shpërblim të madh."**.

Është e natyrshme që cilësitë e shokëve të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, të përmendura në fillim të ajetit 29, përmenden të bashkuara ndërmjet dy cilësive më kryesore, siç është besimi dhe vepra e mirë. Përsëritja e këtyre dy termave, është tregues i vazhdimësisë dhe i përhershmërisë së tyre, që do të thotë se All'llahu u ka premtuar atyre, që treguan vendosmëri në rrugëtimin e tyre të besimit e të veprave të mira dhe të ndjekjes së metodologjisë së Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Përndryshe, ata që një ditë janë me Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe një ditë me dikë tjetër, që nuk ka asnjë lidhje me të, nuk janë aspak të përfshirë në këtë premtim.

---

[1] Shumë komentues mendojnë se *(El lam) - shkronja lam*, te fjalia **"Me qëllim që nëpërmjet tyre Ai t'i zemërojë mohuesit."**, është *"lami-i"* i arsyetimit, kështu që kuptimi i fjalisë vjen: Kjo forcë dhe këto mundësi të mëdha, të cilat All'llahu ua dha shokëve të Muhammedit *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* janë posaçërisht për t'i zemëruar mohuesit e fesë. Pra, edhe nëse do të vazhdojnë ta ndjekin rrugën e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* gjatë gjithë jetës së tyre, edhe nëse do ta ndjekin atë përkohësisht dhe do të heqin dorë më pas.

Shprehja *"minhum" – "midis tyre"*, duke iu kthyer kësaj çështjeje, tregon se origjina e fjalës *"min"* nënkupton fjalën *pjesërisht* në të tilla raste. Kuptimi sipërfaqësor i ajetit ofron të njëjtin kuptim, gjithashtu. Kjo shprehje tregon se disa prej shokëve të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, ndahen në dy pjesë: Të parët, janë ata që e vazhdojnë besimin dhe veprën e tyre të mirë, kësisoj përfshihen prej mëshirës së gjerë të All'llahut dhe shpërblimit të Tij të madh, ndërsa pjesa tjetër devijojnë prej rrugës së tij (Profetit) dhe për rrjedhojë, u mohohet ky shpërblim i madh i All'llahut.

Nuk bëhet e ditur arsyeja e këmbënguljes së disa komentuesve se pjesa *"min" - prej*, te fjala *"minhum" - "midis tyre"*, është vetëm treguese dhe sqaruese dhe nuk ka asnjë kuptim tjetër. Ndërkohë, nëse do ta marrim kuptimin e ajetit në të kundërtën e kuptimit të tij sipërfaqësor dhe do të themi se *"min" – "midis"*, në këtë rast është sqaruese, atëherë si është e mundur që të neglizhojmë krahasimet logjike, në këtë rast?!

Në fakt, askush nuk pretendon se të gjithë shokët e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* janë të pagabueshëm. Ndaj nga kjo pikëpamje, zhvlerësohet mundësia që secili prej tyre të ketë mbetur deri në fund në Rrugën e Drejtë të besimit dhe të veprave të mira dhe duke qenë kështu, si është e mundur që All'llahu t'u premtojë falje dhe shpërblim të madh, pa asnjë kriter e asnjë kusht?!

E bukura e këtij aspekti, meriton vëmendjen për te një aspekt tjetër shumë i rëndësishëm, i cili është: **"Për ata midis tyre që besojnë dhe kryejnë vepra të mira..."**.

Kjo do të thotë se në këtë ajet, nuk nënkuptohet vetëm shoqërimi fizik i Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, pasi shoqërues të tij fizikë ishin edhe hipokritët, por ajo që nënkuptohet në këtë rast është qenësia tërësore me të gjitha kuptimet e besimit.

Nisur nga ky fakt, nuk e kemi të mundur që të përftojmë prej ajetit të mësipërm një gjykim gjithëpërfshirës, i cili përfshin të gjithë bashkëkohësit e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Dy hulumtime

Hulumtimi i parë: Tregimi i të qënit të sahabëve pa të meta!

Është i njohur ndërmjet dijetarëve të Ehli Synetit fakti se shokët e Profetit të All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* veçohen prej pjesës tjetër të njerëzve të ymetit të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Ata konsiderohen të pastër, të kulluar, të pagabueshëm, të palëkundur. Ne nuk kemi të drejtë ta nënvlerësojmë asnjërin prej tyre dhe as ta kritikojmë atë. Të gjitha këto konsiderohen prej harameve, madje disa të tjerë mendojnë se kritika e shokëve të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është kufër (mohim), duke e

argumentuar pretendimin e tyre me ajetin në të cilin All'llahu i Madhëruar ka thënë: **"Për ata midis tyre që besojnë dhe kryejnë vepra të mira, All'llahu ka premtuar falje dhe shpërblim të madh."**.

Ata e argumentojnë këtë pretendim, duke iu referuar ajetit 100 të sures "Et Teube", ku sahabët e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, prej ensarëve dhe muhaxhirëve, përmenden me superlativa, në këtë mënyrë: **"All'llahu është i kënaqur prej tyre dhe ata janë të kënaqur prej Tij."**.

Në rast se do të largohemi prej gjykimeve të mëparshme arbitrare, do të përballemi me supozime që shkaktojnë tërmet te ky lloj pretendimi:

I pari: Fjalia e përmendur te një ajet në suren "Et Teube": **"All'llahu është i kënaqur prej tyre dhe ata janë të kënaqur prej Tij."**, nuk nënkupton vetëm muhaxhirët dhe ensarët, sepse në ajet ka një fjali tjetër, e cila thotë: **"...dhe ata që i pasuan me mirësi."**, e cila përfshin të gjithë ata që i ndjekin me mirësi, përkushtim dhe devotshmëri deri në Ditën e Gjykimit.

Ashtu si pasardhësit e sahabëve *(tabi'inët)*, të cilët ishin herë në linjën e imanit e herë të tjera në linjën e mohimit dhe të keqbërjes, jashtë çadrës së kënaqësisë së All'llahut, e njëjta dukuri është e lidhur, gjithashtu, edhe me shokët e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, pasi në fund të sures "El Fet'h", certifikimi i historisë së tyre është i kushtëzuar me besimin dhe veprat e mira, gjithashtu, në mënyrë të atillë, që, nëse heqin dorë nga plotësimi i këtij kushti, qoftë dhe

një ditë të vetme, kjo do të thotë se kanë dalë prej rrethit të përfshirjes prej kënaqësisë së All'llahut të Lartësuar.

Me fjalë të tjera: Fjala *"bi ihsani"*, është e lidhur me tabi'inët dhe pasuesit e tyre, që do të thotë se kushdo prej tyre, që del prej linjës së mirësisë, nuk përfshihet prej kënaqësisë dhe begatisë së All'llahut.

I dyti: Prej transmetimeve të ndryshme islame mund të përftojmë faktin se shokët e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, edhe pse konsiderohen të privilegjuar për arsye të bashkëkohësisë së Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe bashkëjetesës me të, mund të ketë prej atyre që vijnë në kohët e mëvonshme me besim, përkushtim dhe vepra më të mira se ata.

Nga njëra anë, shokët e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* janë prej atyre që i kanë dëshmuar të gjitha llojet e mrekullive që i kanë ndodhur Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe nga ana tjetër, kemi një grup tjetër besimtarësh, të cilët e kanë pasuar rrugën e tij, e ndoqën udhëzimin e tij pa i dëshmuar këto mrekulli, por duke u mbështetur te dëshmitë e të tjerëve.

Te disa hadithe të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* lexojmë se ai është pyetur prej shokëve të tij: *"A jemi ne vëllezërit e tu, o i Dërguari i All'llahut?!"*

Ai tha: *"Jo, ju jeni shokët e mi. Vëllezërit e mi janë ata që do të vijnë pas meje, do të më besojnë mua pa më parë. Ai që kryen prej tyre*

një vepër të mirë, do të shpërblehet me shpërblimin e pesëdhjetë njerëzve prej jush."

Ata thanë: *"Prej pesëdhjetë njerëzve prej tyre, o i Dërguari i All'llahut?!"*

Ai tha: *"Prej jush.", duke e përsëritur atë tri herë. Më pas tha: "Sepse ju ka kush t'ju ndihmojë."*[1]

Transmetohet te "Sahihu" Myslim se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: *"Sa do të dëshiroja që t'i kishim dëshmuar vëllezërit tanë."*

Ata thanë: *"A nuk jemi vëllezërit e tu, o i Dërguari i All'llahut?"*

Ai tha: *"Ju jeni shokët e mi, ndërsa vëllezërit tanë janë ata që nuk kanë ardhur ende."*[2]

Këtë thënie e mbështet mendja dhe logjika, gjithashtu, pasi të gjithë ata që nuk e kanë jetuar kohën e Profetit dhe nuk kanë marrë mësime drejtpërdrejt prej tij dhe në të njëjtën kohë, janë ata që i ngjasojnë shokëve të tij për nga cilësia e besimit dhe e veprave të mira dhe mund të themi se ata janë më të mirë se sahabët.

I treti: Kjo fjalë, për nga pikëpamja e saj historike, është e kritikueshme, sepse disa nga sahabët, pas kohës së Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, madje dhe në kohën e tij, devijuan prej Rrugës së Drejtë.

Si është e mundur që të gjejmë justifikime për ata që i ndezën zjarret e fitnes (ngatërresës) në Luftën e Xhemelit dhe

[1] Tefsiri "Ruhul Bejan", vëll. 9, f. 61.
[2] "Sahihu" i Muslimit, vëll. 1, K. "Pastërtia", Hadithi 39.

vranë aq sa vranë, dolën me shpatat e tyre kundër pasuesit (kalifit) të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe të mos i konsiderojmë mëkatarë?!

Ose, të themi se ata që u mblodhën në Nehravan dhe Sifin dhe u rebeluan ndaj pasuesit të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, i cili ishte zgjedhur prej myslimanëve, duke derdhur lumë gjakun e myslimanëve, do të përfshihen te kënaqësia e All'llahut dhe nuk ka përmbi ta asgjë prej pluhurit të gjynaheve?!

Me e madhja çudi prej të gjithave, është justifikimi për ata që i kryen të gjitha këto gjynahe, që bënë e ç'nuk bënë, se ata ishin përpjekur për ta gjetur gjykimin e drejtë dhe se muxhtehidi është, gjithsesi, i justifikuar. Ky ishte orientimi që i dhanë çështjes.

Nëse do ta marrim të mirëqenë faktin se të gjitha këto gjynahe të mëdha mund të mbulohen vetëm duke i konsideruar ato thjesht si një rezultat i përpjekjes për të gjykuar drejt, atëherë nuk mbetet më asnjë hapësirë për të gjykuar vrasësin dhe nuk ka më asnjë arsye apo nevojë për të zbatuar sanksionet e ligjit të All'llahut, të lidhur me vrasësin. Mbase ai është përpjekur të gjykojë më të mirën, por ka gabuar!

E thënë ndryshe, dy grupe u përballën me njëri-tjetrin në betejën e Xhemelit, të Sifinit, të Nehreuanit dhe e sulmuan njëri-tjetrin. Është prej çështjeve elementare të logjikës, pamundësia që të dyja grupimet të kenë të drejtë, sepse bashkimi ndërmjet dy të kundërtave është i pamundur.

Nisur nga ky vlerësim, si mund të gjykojmë se të dy grupimet janë të përfshira nga kënaqësia e All'llahut? Çështja nuk ishte e lidhur me probleme të paqarta dhe të ndërlikuara, sikurse edhe dallimi ndërmjet të vërtetës dhe së pavërtetës, në këtë rast, nuk ishte shumë i vështirë. Të gjithë e kanë ditur se Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* ishte prijës, referuar dëshmive të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* për të. Ai ishte i përzgjedhuri dhe i besuari i myslimanëve, ishte pasardhësi i denjë i Kalifatit e megjithëkëtë, ata i ngritën shpatat e tyre kundër tij. Si është e mundur që e gjithë kjo histori të konsiderohet thjesht çështje e ixhtihadit?!

Si është e mundur që çështjen e atyre që hoqën dorë prej Islamit në kohën e Ebu Bekrit *(Ehlurr-rrideh)* nuk e trajtuan me ixhtihad, por i quajtën zyrtarisht mohues të fesë, të dalë prej saj?! Si është e mundur që pjesëmarrësit në Luftën e Xhemelit, të Sifinit dhe të Nehreuanit të fitojnë pafajësinë prej çdo mëkati e gjynahu?!

Gjithsesi, duket qartë se çështja e "përsosmërisë së sahabëve" nëpërmjet një gjykimi absolut, ishte një gjykim politik, i cili hapi rrugën për marrjen në mbrojtje të këtij grupimi pas Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, të konsolidonte pushtetin dhe të përballej me stuhinë e kritikave.

Kjo çështje nuk takohet gjëkundi me gjykimin e një mendjeje të shëndoshë dhe as me tekstet e historisë islame të pranuara prej të gjitha palëve pjesëmarrëse në këtë kundërshti.

E ku ka më mirë se lidhur më çështjen e gjykimit të sahabëve, shokëve të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, të cilët i nderojmë e i respektojmë, t'i referohemi peshores së të vërtetës, e cila vendos

drejtësinë nëpërmjet peshës së besimit dhe veprave gjatë jetës së tyre, nga fillimi deri në fund. Kjo është peshorja për të cilën ka treguar Kur'ani dhe kjo është peshorja më të cilën Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka gjykuar shokët e tij.

Hulumtimi i dytë: Shkëmbimi i dashurisë islame midis tyre

Vëmë re te transmetimet e gjendura te komentimi i ajetit të fundit të sures "El Fet'h", janë përforcim dhe jo shtesë, për sa i përket kuptimit të ajetit kur'anor, në të cilin All'llahu i Madhëruar thotë: **"të mëshirshëm midis tyre"**.

Prej këtyre transmetimeve, gjithashtu, është një prej thënieve të Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*: "*Myslimani është vëlla i myslimanit. Ai nuk i bën atij padrejtësi kurrsesi, as nuk e tradhton, as nuk e poshtëron. Është detyrë për secilin prej tyre, që të përpiqen për t'u afruar, për të qëndruar pranë dhe për të bashkëpunuar ngushtë me njëri-tjetrin. Vetëm kështu do të jeni ashtu si kërkon All'llahu i Lartësuar, të mëshirshëm dhe mëshirues për njëri-tjetrin. Të përfitojnë atë që e kanë humbur, duke mos e pasur të mundur të jenë pranë në kohët e shkuara për ta ndihmuar Profetin Muhammed (Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe për të qenë prej mbështetësve të tij.*".[1]

Çudia më e madhe, në këtë rast, qëndron te fakti se myslimanët e kësaj kohe nuk i marrin parasysh udhëzimet dhe mësimet e këtij ajeti kaq ndikues, tek i cili shpalosen cilësitë e shokëve të Profetit të All'llahut dhe të besimtarëve të sinqertë.

[1] "Usulul Kafij", njëlloj me tefsirin "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, Hadith 91, f. 77.

Shpesh ata u vërsulën kundër njëri-tjetrit, madje e derdhën gjakun e njëri-tjetrit, duke bërë ndonjëherë atë që nuk e kishin bërë as armiqtë e Islamit.

Ndonjëherë u lidhën aq ngushtë me jobesimtarët, sa të mendosh se prej dashurisë së madhe janë vëllezër me origjinë dhe prejardhje të njëjtë.

Ata nuk duan t'ia dinë për përkuljen, për sexhden, për sinqeritetin e qëllimit, për kërkimin e kënaqësisë së All'llahut e as për shenjat e sexhdes te fytyrat e tyre, as për farën e mbjellë që lëshon filiza e forcohet e pastaj ngrihet e fortë me kërcellin e vet.

Është i çuditshëm, gjithashtu, fakti se sa më shumë t'u largohemi këtyre parimeve kur'anore, aq më shumë do të na pushtojë dështimi dhe humbjet e njëpasnjëshme. Megjithëkëtë, nuk e kthejmë kokën pas të shohim, përse ka ndodhur kështu dhe ku duhet të mbështetemi. Fanatizmi i kohës së injorancës vazhdon të ketë ndikimin e tij të fortë dhe të na ndalojë të mendojmë dhe t'i kthehemi Kur'anit Famëlartë.

O All'llah, na zgjo prej gjumit të paditurisë! O All'llah, na e mundëso ne që ta jetojmë jetën sipas shembullit të shokëve të Profetit Muhammed (Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe nëpërmjet cilësive të tyre, të cilat i përmendi All'llahu i Madhëruar në këto ajete të qarta!

O All'llah, na e mundëso ne të jemi të ashpër me armiqtë tanë, të mëshirshëm ndërmjet njëri-tjetrit, të dorëzuar ndaj urdhëresave të Tua! Na e bëj të mundur që t'i japim rëndësi përpjekjeve tona të veçanta, sakrificave dhe përkushtimit tonë, për ta ngritur sa më lart shoqërinë islame, drejt mirësisë dhe zhvillimit!

O All'llah, të lutemi Ty, që të mundësosh për ne një fitore të madhe, nën hijen e të cilës të freskohet shoqëria islame! Na e bëj të mundur, o All'llah, t'i përhapim mësimet e kësaj feje të madhe, e cila u fal njerëzve jetë në këtë kohë, ku më së shumti kemi nevojë për ngritjen e moralit dhe na bëj ne prej atyre që në çdo ditë të re të hapim dyer të reja zemrash për te drita e Islamit!

Amin, o Zot i botëve!

Fundi i sures "El Fet'h"

SURE "EL HUXHURAT"

Zbritur në Medine, ajete 18

Përmbajtja e sures "El Huxhurat"

Kjo sure, edhe pse ka 18 ajete, është tejmbushur me çështje të rëndësishme, që lidhen me personalitetin e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe me marrëdhëniet ndërmjet anëtarëve të shoqërisë islame. Pjesa më e rëndësishme e çështjeve që trajton kjo sure, është e lidhur me moralin. Pikërisht, për këto arsye, këtë sure mund ta quajmë, surja e edukatës dhe e moralit.

Përmbajtjen e saj, në përgjithësi, mund ta ndajmë si më poshtë:

Pjesa e parë: Ajetet e fillimit të sures tregojnë mënyrën e sjelljes dhe të edukatës me Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Ato njëkohësisht përcaktojnë rregullat dhe sjelljet për të cilat myslimanët duhet të jenë të kujdesshëm, që t'i përmbushin me korrektësi, sidomos gjatë pranisë së Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* mes tyre.

Pjesa e dytë: Në këtë sure përfshihet zinxhiri i gjatë i parimeve më të rëndësishme të edukatës dhe moralit shoqëror. Nëse këto parime vihen në jetë, vetëm atëherë nis puna, që, nën dritën e udhëzimit të tyre, mes njerëzve dhe anëtarëve të shoqërisë islame të ruhet dashuria, çiltërsia, sinqeriteti, siguria dhe uniteti. Mosrespektimi i këtyre parimeve bëhet shkak për vuajtje, hipokrizi, mungesë sigurie, përçarje e ndasi, pra, e kundërta kthehet në bumerang.

Pjesa e tretë: Përfshin urdhëresat këshilluese, që lidhen me format e përballjes së ngatërresave, konflikteve e luftërave, që

ndodhin rëndom mes njerëzve në përgjithësi dhe myslimanëve në veçanti.

Pjesa e katërt: Flet për njësinë matëse të vlerës që ka njeriu tek All'llahu i Madhëruar, për rëndësinë e përkushtimit.

Pjesa e pestë: Trajton çështjen e besimit, duke theksuar se besimi nuk është thjesht dhe vetëm një deklaratë, por, duhet domosdoshmërish të spikasin qartë gjurmët e tij në veprimtarinë e njeriut, si dhe përpjekjet e gjithanshme ndaj vetes e pasurisë, sigurisht, përveç besimit që duhet të ruhet i palëkundur në shpirt.

Pjesa e gjashtë: Tregon se besimi dhe Islami janë dy dhurata hyjnore për besimtarët, kështu, në vend që ata të krenohen për merita personale në përqafimin e Islamit, duhet të falënderojnë All'llahun e Madhëruar që i përfshiu në mëshirën e Tij, për këtë dhuratë të vyer.

Pjesa e shtatë dhe e fundit: Këtu flitet për dijen e All'llahut dhe informacionin e Tij të plotë për ekzistencën e të gjithë mistereve, të fshehtave dhe veprave të njeriut. Kjo pjesë, vjen si siguri për zbatimin e të gjitha çështjeve të mësipërme që përfshihen në sure.

Kjo sure, e mori emrin "El Huxhurat", për shkak të përmendjes së kësaj fjale tek ajeti i katërt i saj. Komentimin e së cilës do ta sjellim për ju me anë të shpjegimeve të mëposhtme.

Mirësitë e leximit të kësaj sureje

Për të kuptuar rëndësinë dhe mirësinë e kësaj sureje, mjafton t'i kthehemi një hadithi të ndriçuar prej Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: "*Kush e lexon suren 'El Huxhurat', do të marrë si shpërblim dhjetë të mira të barabarta me numrin e krijesave që i janë bindur All'llahut dhe e kanë refuzuar Atë!*".[1]

Një tjetër hadith, lidhur me mirësinë dhe vlerën e kësaj sureje, vjen i deklaruar prej Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*: "*Ai që e lexon suren 'El Huxhurat', çdo natë apo çdo ditë qoftë, merr prej shpërblimit dhe mirësisë, sikur të ketë vizituar Profetin Muhammed (Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.".[2]

Është më se e natyrshme, që këto mirësi dhe shpërblime të kenë numër të barabartë midis besimtarëve të ndershëm dhe gjynahqarëve. Por, duke marrë në konsideratë natyrën e veprave të secilës palë e duke medituar mbi to, arrijmë në përfundimin, se deviza e rrugëtimit duhet të jetë në harmoni të plotë me metodikën e besimtarëve të nënshtruar ndaj All'llahut, që të distancohen ndjeshëm prej rrugës së atyre që kanë zgjedhur të kundërtën.

Të përfitosh vizitën e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, sigurisht që është një arritje e rëndësishme në përpjekjet dhe vendosmërinë për t'u sjellë me etikë e edukatë, kur jemi pranë tij. Leximi i Kur'anit i paraprin të gjitha punëve, kudo e kurdoherë qofshin.

---

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll 9, fundi i ajeteve, objekt i studimit tonë.
[2] Burimi i mëparshëm.

Ajetet 1 - 5

بِسۡمِ ٱللَّهِ ٱلرَّحۡمَٰنِ ٱلرَّحِيمِ

يَٰٓأَيُّهَا ٱلَّذِينَ ءَامَنُواْ لَا تُقَدِّمُواْ بَيۡنَ يَدَيِ ٱللَّهِ وَرَسُولِهِۦۖ وَٱتَّقُواْ ٱللَّهَۚ إِنَّ ٱللَّهَ سَمِيعٌ عَلِيمٞ ١ يَٰٓأَيُّهَا ٱلَّذِينَ ءَامَنُواْ لَا تَرۡفَعُوٓاْ أَصۡوَٰتَكُمۡ فَوۡقَ صَوۡتِ ٱلنَّبِيِّ وَلَا تَجۡهَرُواْ لَهُۥ بِٱلۡقَوۡلِ كَجَهۡرِ بَعۡضِكُمۡ لِبَعۡضٍ أَن تَحۡبَطَ أَعۡمَٰلُكُمۡ وَأَنتُمۡ لَا تَشۡعُرُونَ ٢ إِنَّ ٱلَّذِينَ يَغُضُّونَ أَصۡوَٰتَهُمۡ عِندَ رَسُولِ ٱللَّهِ أُوْلَٰٓئِكَ ٱلَّذِينَ ٱمۡتَحَنَ ٱللَّهُ قُلُوبَهُمۡ لِلتَّقۡوَىٰۚ لَهُم مَّغۡفِرَةٞ وَأَجۡرٌ عَظِيمٌ ٣ إِنَّ ٱلَّذِينَ يُنَادُونَكَ مِن وَرَآءِ ٱلۡحُجُرَٰتِ أَكۡثَرُهُمۡ لَا يَعۡقِلُونَ ٤ وَلَوۡ أَنَّهُمۡ صَبَرُواْ حَتَّىٰ تَخۡرُجَ إِلَيۡهِمۡ لَكَانَ خَيۡرٗا لَّهُمۡۚ وَٱللَّهُ غَفُورٞ رَّحِيمٞ ٥

Me emrin e All'llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

"O ju që keni besuar! Mos nxitoni para (urdhrit të) **All'llahut dhe të Dërguarit të Tij dhe kijeni frikë All'llahun! Vërtet, All'llahu dëgjon gjithçka dhe është i Gjithëdijshëm. "**

“O ju që keni besuar! Mos e ngrini zërin tuaj mbi zërin e Profetit dhe mos i flisni atij me zë të lartë, siç bëni me njëri-tjetrin, në mënyrë që të mos ju humbin veprat tuaja pa e ndier ju fare. “

“Vërtet, ata që ulin zërin në prani të të Dërguarit të All’llahut janë njerëzit, zemrat e të cilëve All’llahu i ka kalitur për besim e përkushtim. Për ata ka falje dhe shpërblim të madh.”

“Vërtet, ata që të thërrasin ty (o Muhammed) **me zë të lartë nga jashtë dhomave të tua, shumica e tyre nuk marrin vesh. “**

“E sikur të duronin derisa ti të dilje jashtë tek ata, do të ishte më mirë për ata. Por All’llahu është Falës dhe Mëshirues. “

Shkaku i zbritjes

Të shumta janë mendimet që kanë dhënë komentuesit e Kur’anit, lidhur me arsyen e zbritjes së këtyre ajeteve.

Disa prej çështjeve të përmendura, mbi arsyen e zbritjes së ajetit të parë janë: Së pari, kur, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All’llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* vendosi t’i drejtohej Khajberit, mendoi që të linte një njeri si pasues të tij në Medine, pra, të emëronte zëvendësin e tij, atje. Por, Umeri i propozoi Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All’llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* një tjetër njeri nga ai që Profeti vetë kishte menduar.

Prandaj dhe zbriti ajeti 1, tek i cili: **"O ju që keni besuar! Mos nxitoni para** (urdhrit të) **All'llahut dhe të Dërguarit të Tij..."**.[1]

Të tjerë kanë thënë se ka pasur disa myslimanë që, herë pas here, thoshin: "Sikur të kishte zbritur edhe për ne një ajet, do të ishte më mirë! Ndaj, për këtë arsye, zbriti ajeti: **"Mos nxitoni para** (urdhrit të) **All'llahut dhe të Dërguarit të Tij..."**.[2]

Ndërsa disa të tjerë thoshin: "Ajeti flet për veprat e disa myslimanëve që i kryenin adhurimet e tyre para kohës së përcaktuar! Për këtë arsye, zbriti ky ajet, me qëllim që t'i ndalojë ata në kryerjen e veprimeve të tilla…"[3]

Për sa i përket ajetit të dytë, komentuesit thonë se një grup prej Beni Temimit dhe parisë së tyre, erdhën në Medine. Kur hynë te Xhamia e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* thirrën me zë të lartë, që jashtë, pas dhomave të tij: "O Muhammed, dil pak jashtë!".

Këto thirrje, pa edukatë, e mërzitën Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Kur doli jashtë, ata i thanë: "Kemi ardhur të tregojmë për krenarinë e fisit, ndaj të lutemi, t'i japësh leje poetit dhe ligjëruesit tonë të flasë për këtë!".

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ua dha lejen. Por, ligjëruesi i tyre filloi të flasë për vlera përrallore dhe imagjinare.

---

[1] Tefsiri "Kurtubij", vëll. 9, f. 6121.
[2] Burimi i mëparshëm.
[3] Tefsiri "Kurtubijj", vëll. 9, f. 6121.

Kështu që Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* urdhëroi Thabit Ibn Kajsin, t'ua kthente përgjigjen me të njëjtën monedhë.[1]

Thabiti ligjëroi me shprehje të qarta, sa mundi t'i fshijë të gjitha gjurmët e ligjëratës së tyre.

U ngrit, sërish, një tjetër poet i tyre dhe recitoi një poezi të re, përsëri për të lavdëruar të vetët. Hasan Bin Thabiti nuk duroi dhe u ngrit, që nëpërmjet një poezie u ktheu atyre një përgjigje plotësisht të merituar.

Si përfundim, u ngrit një prej burrave të parisë së Beni Temimit, me emrin, El Ekra dhe tha: "Ky burrë, (nënkuptoi Muhammedin) ka një ligjërues më të aftë se ligjëruesi ynë, ka një poet shumë më të zotë se poeti ynë! Jehona e zërit të tij shkon shumë më larg se zëri ynë!".

Për të fituar e gëzuar zemrat e tyre, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* urdhëroi t'u shpërndaheshin dhurata të shumta. Veprimi i tij bëri që gëzimi të hynte thellë në zemrat e miqve. Ata u emocionuan aq shumë, sa dhe pranuan profetësinë e tij.

Ajetet 1-5 tregojnë, pikërisht, për këtë çështje, pra, për ato zëra që erdhën nga jashtë dhomës së Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

[1] Thabit Ibn Kajsi ka qenë ligjëruesi i ensarëve dhe ligjëruesi personal i Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, ashtu siç ishte Hasan Ibn Thabiti, poeti i tij. "Usdul Gabeh", vëll. 1, f. 229.

Ka edhe një shkak tjetër për zbritjen e ajetit, i cili lidhet me ajetin e parë dhe atë që e pason. Ai thotë, se në vitin e nëntë të Hixhretit, kur fiset arabe vizitonin Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* për ta përshëndetur dhe për të nënshkruar marrëveshje me të, vit që u quajt si viti i delegacioneve apo i përfaqësive, kur te Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* arritën përfaqësuesit e fisit Temin, Ebu Bekri, tha: "Le të jetë Ka'aka', një prej parisë së burrave të atij fisi, prijësi i tyre.".

Umeri propozoi që prijësi i fisit të tyre të jetë një tjetër, El Habis Bin Ekra'a. Më pas, Ebu Bekri iu drejtua Umerit: "A mos ke ndërmend të më kundërshtosh?!".

Umeri iu përgjigj se nuk kishte qëllim ta kundërshtonte atë. Kështu filloi zhurma dhe u ngritën zërat ndaj njëri-tjetrit. Atëherë zbriti ajeti kur'anor, që nënkupton: Mos jepni sugjerime e as këshilla mbi këshillat dhe mendimet e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*! Mos flisni para se ai të flasë! Mos e ngrini zërin tuaj në prani të Tij![1]

[1] Tefsiri "Kurtubijj", vëll. 9, f. 6121. Tefsiri "Fi Dhilalil Kur'an", vëll. 7, f. 524. Siret "Ibn Hashim", vëll. 4, f. 206 dhe pas saj, me një ndryshim dhe dallim të vogël, ashtu siç është përmendur te "Sahihu" i Bukhariut, vëll. 6, f. 172, te komentimi i sures "El Huxhurat".

Komentimi

Normat e sjelljes në prani të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*

Ashtu si bëmë të ditur më parë, në brendësi të kësaj sureje kemi një pjesë të hulumtimeve që trajtojnë çështje të rëndësishme edukative e morale, si dhe një rregullore që përfshin këshilla dhe urdhëresa, të cilat na shtyjnë ta quajmë këtë sure si suren e moralit të lartë dhe të edukatës shembullore. Këto rregulla janë të përqendruara tek ajetet e para të sures dhe mund të themi se këto ajete përfshijnë dy lloje udhëzuesish.

Udhëzimi i parë: Të mos shpejtojmë të japim gjykim para gjykimit të All'llahut dhe të Dërguarit të Tij, të mos e ngremë zërin në prani të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Lidhur me këtë çështje, në ajetin e parë të kësaj sureje, All'llahu i Madhëruar, thotë: **"O ju që keni besuar! Mos nxitoni para** (urdhrit të) **All'llahut dhe të Dërguarit të Tij dhe kijeni frikë All'llahun! Vërtet, All'llahu dëgjon gjithçka dhe është i Gjithëdijshëm."**.

Ajo që nënkuptohet nga mosnxitimi para All'llahut dhe të Dërguarit të Tij, është: Të mos u jepet atyre mendim, lidhur më çështje të caktuara, por të dorëzohemi para këshillave dhe detyrimeve që vijnë prej All'llahut dhe të Dërguarit të Tij.

Edhe pse, disa komentues kërkonin të përcaktonin kuptimin e ajetit, duke e kufizuar në kryerjen e adhurimeve para kohës së tyre, apo të folurën para Profetit dhe çështjeve të ngjashme me to, duket qartë që ajeti ka kuptim shumë më të gjerë,

përfshin të gjitha format e tejkalimit të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, nga strategjitë deri te planet e tij.[1]

Përgjegjësia e disiplinës së njerëzve ndaj udhëheqësve të tyre, veçanërisht ndaj udhëheqësve hyjnorë, bën të detyrueshëm mostejkalimin e tyre me vepra dhe fjalë. Shkurt, askush të mos nxitojë të japë gjykime në prani të tyre.

Sigurisht, është e natyrshme, që këto fjalë, nuk nënkuptojnë refuzimin e këshillimit me Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, nëse vërtet ka diçka të rëndësishme që duhet të sqarohet dhe të diskutohet, por nëpërmjet kësaj, synohet të sqarohet fakti, se askush nuk ka të drejtë të shpejtojë në gjykim dhe në planifikimin përfundimtar të çështjeve, para se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* të përcaktojë variantin përfundimtar të gjykimit dhe të miratimit të tij.

Kjo nënkupton, gjithashtu, faktin, se nuk duhet, në asnjë mënyrë, të ngacmohen apo të nxiten pyetje dhe diskutime më shumë sa duhet, për çështjet e diskutuara, por ato duhet t'i lihen udhëheqësit për gjykim dhe ai, vetë, të japë urdhrin përfundimtar në kohën e duhur, veçanërisht, kur udhëheqësi është i pagabueshëm dhe asgjë nuk mund t'i fshihet vëmendjes së tij. Edhe nëse pyetet i Pagabueshmi, të tjerët nuk lejohen t'i

[1] Folja **"**(mos) **nxitoni"** vjen në formën e foljes kalimtare, përveçse në këtë rast, kallëzuesi është i padukshëm dhe kuptimi i tij është: Mos e tejkaloni All'llahun dhe të Dërguarin e Tij në asnjë çështje. Disa të tjerë thonë se kjo këtu është një folje e plotë dhe kuptimi i saj është: Mos dilni (mos gjykoni) para All'llahut. Paçka se të dyja foljet ndryshojnë në formë, kuptimi apo përfundimi i tyre është i njëjtë.

përgjigjen pyetësit para se Ai të flasë. Në mënyrë të përgjithshme, ajeti i ka përfshirë të gjitha këto kuptime.

Ndërsa tek ajeti i dytë flitet për çështjen e mënyrës së komunikimit: **"O ju që keni besuar! Mos e ngrini zërin tuaj mbi zërin e Profetit dhe mos i flisni atij me zë të lartë, siç bëni me njëri-tjetrin, në mënyrë që të mos ju humbin veprat tuaja pa e ndier ju fare."**.

Fjalia e parë: **"Mos e ngrini zërin tuaj mbi zërin e Profetit..."**, tregon qartë se nuk duhet të ngrihet zëri mbi zërin e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, pasi kjo, në vetvete, është një formë e shëmtuar e mungesës së edukatës në praninë e tij të nderuar. Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka pozitën e tij të veçantë dhe të nderuar, por kjo sjellje, gjithashtu, nuk është e denjë edhe përballë babait, nënës apo mësuesit, pasi kjo është një sjellje që bie ndesh me normat bazë të moralit dhe të edukatës.

Fjalia: **"mos i flisni atij me zë të lartë"**, mund të theksojë një përforcim për kuptimin që mbart fjalia e mësipërme. Ajo është tregues i një tjetër kërkese: Mos e thirrni më në emër Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: "O, Muhammed!", por, që tani e tutje duhet ta thërrisni: "O i Dërguari i All'llahut!".

Një grup komentuesish është i mendimit se ka një ndryshim të dukshëm midis fjalive të përmendura më lart. Ndryshimi qëndron në faktin se fjalia e parë është e lidhur me kohën, kur njerëzit flisnin me Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi*

i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), si rrjedhim askush nuk duhet ta ngrinte zërin mbi zërin e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Ndërsa fjalia e dytë i referohet kohës kur Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është i heshtur dhe shokët e tij janë duke folur, pra, edhe në këtë rast, nuk duhet kurrsesi të ngrihet zëri, pasi ai është i pranishëm.

Bashkimi ndërmjet këtij kuptimi dhe kuptimit të mëparshëm, nuk është i pamundur, pasi ai është në harmoni edhe me shkakun e zbritjes së ajetit. Në të gjitha rastet, kuptimi sipërfaqësor i ajetit synon të përçojë dy kuptime të ndryshme.

Është e natyrshme se këto vepra të pahijshme, nëse nënkuptohet me to fyerja dhe përçmimi ndaj shenjtërisë së Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe pozitës së tij, atëherë nuk ka dyshim se kufiri i mohimit këtu bëhet i detyrueshëm, përndryshe sjellja dëmton Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe pozitën e tij, për rrjedhojë kemi të bëjmë me një gjynah.

Këtu, **së pari**, sqarohet arsyeja e rënies dhe fshirjes së të gjitha veprave, pasi kufiri i mohimit i fshin të gjitha veprat, duke i zeruar ato. Pra, ai zeron edhe shpërblimin për veprat e mira që janë kryer.

Së dyti, nuk përjashtohet, gjithashtu, mundësia që veprat e këqija të bëhen shkak jo vetëm për fshirjen e veprave të mira, por edhe të shpërblimit të tyre.

Kemi thënë, sidomos te studimi rreth veprave që fshijnë punët e mira, se nuk ka asnjë pengesë që fshirja e shpërblimit të disa punëve të mira të bëhet për shkak të gjynaheve të veçanta, sikurse dhe zhdukja e gjurmëve të disa gjynaheve të bëhet për shkak të veprave të mira. Ky është, gjithashtu, një fakt i padiskutueshëm.

Ka argumente të shumta tek ajetet kur'anore dhe te hadithet profetike, që i përforcojnë këto kuptime, edhe pse kjo paraqitje nuk është përcaktuar në formën e një ligji të përgjithshëm, që të përfshijë të gjitha veprat, qofshin të këqija, apo dhe të mira. Në fakt, lidhur me disa lloje të rëndësishme veprash të mira e të këqija, ka plot argumente që nuk mund t'i kundërshtojë asnjë argument logjik.[1]

Është bërë me dije, gjithashtu, se, kur ka zbritur ajeti i mëparshëm, Thabit Ibn Kajsi, ligjëruesi i Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, që kishte një zë kumbues e të lartë, ka thënë: "Unë jam ai që e kam ngritur zërin tim mbi zërin e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, për këtë arsye më janë zhvleftësuar veprat e mira, ndaj unë do të jem prej banorëve të zjarrit.".

Sapo i mbërritën këto fjalë, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* tha: *"Ai është prej banorëve të Xhennetit"*,[2] sepse, kur e ka kryer këtë veprim, e ka

[1] Për më shumë informacion, lidhur me çështjen e rrëzimit të veprave, shiko fundin e ajetit 217 të sures "El Bekare".

[2] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 9, f .130. Ky hadith ka ardhur nga transmetime të ndryshme të shumë komentuesve, me ndryshime te disa fjalë,

bërë për hir të myslimanëve, përballë fytyrës së kundërshtarëve të tyre, çka do të thotë se ka qenë duke kryer një detyrë islame.

Gjithashtu, edhe Ibn El Abbas bin Abdul Mutalibi ka thirrur me zë të lartë, me urdhër të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, ata që ia mbathën nga sytë këmbët gjatë Luftës së Hunejnit, duke u kërkuar atyre të rikthehen në fushën e betejës.

Në ajetin tjetër, kemi një përforcim akoma më të qartë të shpërblimit dhe mirësisë, që All'llahu i Madhëruar ka premtuar për ata që i respektojnë këto rregulla dhe kujdesen për edukatën në prani të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Në ajet thuhet: **"Vërtet, ata që ulin zërin në prani të të Dërguarit të All'llahut janë njerëzit, zemrat e të cilëve All'llahu i ka kalitur për besim e përkushtim. Për ata ka falje dhe shpërblim të madh."**.[1]

Fjala *"jegudune" - "e ulin"*, e ka prejardhjen nga fjala *"gad'dnu"*, në formën e fjalës *"hadh'dhun"*. Kuptimi i saj është *"pakësimi i shikimit"*, ose ulja e zërit. Sinonimet e këtyre dy fjalëve janë: *"i nguli sytë"* dhe *"i ngriti zërin"*.

Ndërsa fjala: *"imtehane"*, e ka prejardhjen nga fjala *"el imtihanu"*. Origjina e përdorimit të dy fjalëve është nga *"shkrirja e floririt"* dhe ndarja e tij prej papastërtive, sikurse veprohet për lëkurën, kur shtrihet dhe bëhet gati për t'u rrashinuar. Më pas,

veçanërisht El Buhari te "Sahihu" i tij dhe Sejid Kutubi te tefsiri i tij "Fi Dhilalil Kur'an", etj.

[1] *"El lam"* te fjala *"et'tekua"*, është *lami* i qëllimit jo *lami* i kushtit, që do të thotë se All'llahu i përgatit zemrat e tyre që ta pranojnë Atë dhe t'i përkushtohen vetëm Atij, sepse, nëse zemra nuk është e sinqertë dhe e kulluar, ajo nuk mund të jetë vendi i përkushtimit dhe i devotshmërisë.

është përdorur për të nënkuptuar sprovën dhe vetëm atë, ashtu si është edhe kuptimi lidhur me ajetin, objekt i studimit tonë. Rezultati është *"sinqeriteti i zemrës"*, pra, hapja dhe shtrirja e saj për pranimin e devocionit dhe të përkushtimit.

Ajo çka tërheq vëmendjen, është fakti, se ajeti i mëparshëm e quan Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) "nebijj" - "lajmëtar"*, ndërsa te ky ajet përmendet, si: *"resulil'lah" - "I Dërguari i All'llahut"*. Të dy ajetet tregojnë qartë se kjo mirësi, pra, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, nuk kishte asgjë prej vetes së tij, ishte i Dërguari i All'llahut dhe Lajmëtari i Tij, kësisoj, sjellja e keqe ndaj tij konsiderohet sjellje e keqe me vetë All'llahun, ndërsa përkujdesja e sjelljes me të, është përkujdesje për vetë All'llahun.

Fjala *"magfiretun" - "falje"*, është përmendur si e panjohur për t'i rritur vlerën asaj që thotë se All'llahu i Madhëruar, ka rezervuar për ta një falje të madhe e të plotë, menjëherë pas pastrimit prej gjynaheve, të cilëve u dhuron edhe një shpërblimin të madh. Pra, më parë, duhet të pastrohen gjynahet dhe më pas përfitimi i shpërblimit të madh prej All'llahut të Madhëruar.

Për sa i përket ajetit tjetër, aty flitet rreth injorancës dhe pavetëdijes së atyre që hedhin pas shpine Urdhëresat e All'llahut. Në ajet thuhet: **"Vërtet, ata që të thërrasin ty** (o Muhammed) **me zë të lartë nga jashtë dhomave të tua, shumica e tyre nuk marrin vesh."**.

Cili mund të jetë ai tru njeriu, që jep urdhër të ngrihet më lart zëri i tij, përballë më të madhit ambasador hyjnor, duke

nëpërkëmbur tërësisht parimet themelore të etikës së thirrjes, si bëri fisi i Beni Temimit, duke thirrur Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* me zë të çjerrë e bezdisës: "O Muhammed! O Muhammed, dil pak jashtë!", ndërkohë që, ai është epiqendra e dashurisë dhe ndjenjës hyjnore?!

Në fakt, sa më shumë të lartësohet mendja e njeriut, aq më shumë rritet edhe cilësia e edukatës së tij, kështu dhe ai i njeh më mirë vlerat e edukatës dhe të moralit. Nisur nga kjo, mund të themi se mungesa e edukatës tregon mungesën e mendjes dhe të logjikës. Thënë ndryshe, mungesa e edukatës është vepër me natyrë kafshërore, ndërsa ruajtja e etikës dhe e edukatës është vepër me natyrë njerëzore.

Fjala *"el ektheru"* – *"shumica"*, te sifjalia: **"shumica e tyre nuk marrin vesh"**, në gjuhën arabe përdoret për t'i përmbledhur të gjithë. Në këtë rast, si term, përdoret për të shmangur rënien në përgjithësim dhe rezervën në edukatë, çka do të thotë, nëse një njeri i vetëm nuk përfshihet në këtë përgjithësim, me anë të kësaj fjale arrin të mbrohen të drejtat e tij. Pra, duket sikur All'llahu i Madhëruar thotë: "Unë jam All'llahu, i cili përfshin me dijen e Tij, gjithçka. Dhe, kur flitet për çështje si këto, unë tregohem i sjellshëm, duke përzgjedhur me kujdes terminologjinë për të mos ju lënduar. Atëherë ç'ju shtyn ju të mos keni të njëjtën përkujdesje dhe edukatë, sa herë që flisni?!".

Në përgjithësi, gjenden mes tyre njerëz me logjikë e mendje të shëndoshë, por që u është bërë zakon të ngrenë zërin, madje pa u bërë përshtypje kjo gjë. Për këtë arsye vjen Kur'ani, t'u tërheqë vëmendjen dhe t'i paralajmërojë që të tregojnë kujdes, të heqin

dorë prej këtij zakoni, të përkujdesen për edukatën e tyre, të përsosin etikën dhe logjikën, sa herë që të flasin.

Fjala *"el huxhurat"*, është shumësi i fjalës *"huxhretun"*, që në rastin konkret nënkupton *"shtëpitë*[1] *e shumta"*, që përdoreshin prej bashkëshorteve të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, të cilat banonin në krah të xhamisë.

Kjo fjalë e ka origjinën tek fjala *"el haxhr"*, njëlloj si fjala *"el exhr"*, që nënkupton ndalimin, pasi fjala *"el huxhretu" - "dhoma"*, ndalon hyrjen e të tjerëve në jetën private të njeriut. Ndërsa shprehja *"min uera'a" - "nga pas"*, nënkupton *"territorin jashtë shtëpisë"*, dhomës, nga cilado anë qoftë. Ndonjëherë, dyert e këtyre dhomave, hapeshin në brendësi të xhamisë, e injorantët ngriheshin duke thirrur: "O Muhammed, dil pak!".

Kjo është arsyeja përse, Kur'ani Famëlartë, i ndaloi rreptësisht këto lloj sjelljesh.

Në vazhdim të logjikës së mësipërme, Kur'ani plotëson kuptimin. Në fund të ajetit thuhet: **"E sikur të duronin derisa ti të dilje jashtë tek ata, do të ishte më mirë për ata..."**. Është e vërtetë se shpejtësia e çon më shpejt njeriun drejt destinacionit që kërkon të arrijë, por është durimi dhe qetësia, në raste si këto, që bëhen shkak për faljen e madhe të All'llahut të Lartësuar.

Duke qenë se disa prej tyre këtë veprim e kryen gabimisht, prej mosdijes apo injorancës, e më pas ndien dhimbjen që u

[1] Fjala *"bujut"* është shumësi i fjalës *"bejt"*. Kjo fjalë përdoret për të quajtur një dhomë të vetme, ose disa dhoma në të njëjtin vend, që i përkasin një familje të caktuar. Origjina e kësaj fjale vjen nga fjala *"mebijt" - "gjumi i natës"*.

shkaktoi sjellja e nxituar, duke i kërkuar vetes llogari, pas zbritjes së ajetit kur'anor, i cili vjen për t'u kujtuar atyre, se për arsye të pendesës, mëshira e All'llahut ka për t'i përfshirë. Prandaj në fund të këtij ajeti, thuhet: **"...All'llahu është Falës dhe Mëshirues."**.

Hulumtime

1- Edukata, vlera më e çmuar

Feja islame i jep një rëndësi të dorës së parë çështjes së përkujdesjes ndaj edukatës dhe mirësjelljes me njerëzit e tjerë, lidhur këto me respektin dhe etikën njëlloj, si ndaj individit, ashtu edhe ndaj shoqërisë. Këtu do të përmendim disa hadithe të nderuara, si dëshmi e shembull për këtë çështje:

Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* thotë: *"Sjelljet e mira janë gurë të çmuar, kur i ndërron herë pas here."*.[1]

Në një tjetër vend, ai, gjithashtu thotë: *"Edukata e mirë është më e vlefshme se origjina fisnike."*.[2]

Në një hadith, Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: *"Janë pesë cilësi që, nëse nuk i praktikon, nuk keni për të shijuar kurrë kënaqësi!"*. Pyetën: "Cilat janë ato, o i biri i të Dërguarit të

[1] "Nehxhul Belaga", Fjalët e shkurtra, Fjala 5.
[2] Burimi i mëparshëm, f. 67.

All'llahut?!" Ai tha: "*Feja, mendja, turpi, morali i lartë dhe edukata e mirë.*".[1]

Te një tjetër burim, lexojmë një hadith të transmetuar prej Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*: "*Mendjemëdhenjtë të mos i lakmojnë lëvdatat, as mashtruesit të mos lakmojnë, që t'u besojnë shumë njerëz, as i paedukuari të mos lakmojë, që ta nderojnë njerëzit.*".[2]

Kur lexojmë jetëshkrimet e udhëheqësve myslimanë përgjatë historisë e meditojmë rreth tyre, vëmë re se ata përkujdeseshin për të qenë të përpiktë deri në imtësi dhe detaje, sidomos në imtësitë e mrekullueshme të mirësjelljes dhe edukatës, edhe ndaj njerëzve të thjeshtë. Në të vërtetë, feja nuk është gjë tjetër përveçse një tërësi sjelljesh. Sjellja me All'llahun, sjellja në prani të Profetit dhe Imamëve të pagabueshëm, sjellja në prani të mësuesit apo edukatorit, sjellja në prani të Imamit, dijetarit dhe mendimtarit. Nëse përqendrohemi tek ajetet e Kur'anit Famëlartë, do të zbulojmë se All'llahu i Lartësuar, edhe pse komunikon nga pozita hyjnore, është shumë i sjellshëm me krijesat dhe robtë e Tij.

Meqë çështja paraqitet në këtë formë, bëhet plotësisht e qartë se cila është detyra e njerëzve përkundrejt All'llahut, se cilat janë detyrat e tyre.

Lexojmë në disa hadithe islame se, kur kanë zbritur ajetet e para të sures "El Mu'minun", për besimtarët sollën një varg të gjatë të normave të edukatës islame, siç ishte: çështja e përkushtimit në namaz. Kjo transmetohet prej Profetit

[1] "Biharul Enuar", vëll. 75, f. 68.
[2] Burimi i mëparshëm.

Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, ku gjatë namazit shihte herë në qiell e herë në tokë, pa e luajtur kokën poshtë e lart.[1]

Nga çështjet e rëndësishme, për të cilat na ka nxitur, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, është deklarata e qartë kur'anore, që ndalon thashethemet, fjalët e këqija, zhurmën dhe ngritjen e zërit në prani të tij, pasi të gjitha këto bëhen shkak për fshirjen e veprave të mira dhe heqjen e shpërblimit.

Është e qartë se përkujdesja për sjelljen dhe edukatën, në prani të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, nuk është e mjaftueshme, pasi ka edhe çështje të tjera të rëndësishme, për të cilat duhet të bëjmë kujdes në prani të tij, ashtu si dhe kanë thënë dijetarët e jurisprudencës islame, që duhet ta zhvlerësojmë personalizimin, duke e rishikuar dhe duke e rivlerësuar atë në raport me rastet e mëparshme.

Te surja "En Nur", ajeti 63, All'llahu i Madhëruar, ka thënë: **"Mos ia drejtoni thirrjen të Dërguarit, njësoj si thirrjen që ia bëni njëri-tjetrit!"**.

Disa komentues e kanë shpjeguar ajetin: "Kur ta thërrisni Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, thirreni me edukatën dhe mirësjelljen që i përshtatet shkallës së tij, jo ashtu si bëni kur thërrisni njëri-tjetrin!".

[1] Kthehu te tefsiri "Mexhmaul Bejan" dhe te tefsiri "El Kebijr", fundi i ajetit të dytë të sures "El Mu'minun".

Bukuria e kësaj qëndron në faktin se Kur'ani Famëlartë i cilëson, si njerëz me zemër të pastër, të gatshëm për të pranuar devocionin, të gjithë ata që ulin zërin dhe përkujdesen për sjelljen e tyre në prani të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Ai dëshmon, gjithashtu, se këta njerëz janë plotësisht të meritueshëm për faljen dhe shpërblimin e madh të All'llahut. Ndërkohë, të gjithë ata që e thërrasin atë me zë të lartë, pa etikë, edukatë e mirësjellje, nga jashtë mjediseve të tij, konsiderohen njëlloj si kafshët që nuk logjikojnë.

Disa komentues të tjerë u zgjeruan edhe më shumë në komentin e ajeteve, objekt i studimit tonë, duke e zbritur edhe më tej nivelin e shtresave të përfshira prej kuptimit të ajetit, për të mbërritur te dijetarët, mendimtarët dhe udhëheqësit e myslimanëve. Është, pra, detyrë e myslimanëve, që të jenë të kujdesshëm me sjelljen, edhe në prani të tyre.

Natyrshëm, kur bëhet fjalë për Imamët e pagabueshëm, çështja është akoma më e qartë. Kanë mbërritur disa transmetime prej Ehli Bejtit *(Paqja qoftë mbi ta!)*, të cilat thonë se, kur njëri prej shokëve të Imamit hyri në dhomën e tij, Imami ia ktheu pa fjalë hyrëse, duke thënë: "*A nuk e di ti, se nuk është e lejueshme të hysh te shtëpitë e Profetëve, kur je xhunub?!*".[1]

Për ta përmbledhur këtë çështje, mund të themi se mirësjellja dhe edukata me të madhin dhe me të voglin përfshin një pjesë të madhe të udhëzimeve islame, deri në atë masë, sa po t'i radhisim të gjitha një e nga një në këtë studim, do të largohemi shumë prej komentimit të ajeteve. Për ta mbyllur këtë studim, sjellim për vëmendjen e lexuesit një hadith të Imam Ali Ibn

[1] "Biharul Anuar", vëll. 27, f. 255.

Hysejn, Es Sexhad *(Paqja qoftë mbi të!)*, përmendur te vepra "Risaletul Hukuk", te kapitulli "Mirësjellja dhe edukata në prani të mësuesit", ku thuhet: "*Është prej të drejtës së atij që të jep dije, që ta lartësosh atë, ta respektosh e ta nderosh praninë e tij, duke e dëgjuar me vëmendje e përkushtim! Të mos e ngresh zërin në fytyrë të tij! Të mos japësh përgjigje në vend të tij, për një pyetje që i është drejtuar atij, në mënyrë që ta japë ai përgjigjen. Mos flit me njeri, kur ai të jetë duke folur! Mos përgojo njeri në prani të tij, ta mbrosh, kur e përgojojnë ligësisht të tjerët në mungesë të tij! Fshihi të metat e tij, nëse gjenden dhe vë në dukje të mirat e tij! Mos u shoqëro me armiqtë e tij dhe mos u armiqëso me miqtë e tij! Nëse vepron kështu, engjëjt e All'llahut do të dëshmojnë për ty se dija që kishe për qëllim të marrësh prej tij, ishte për hir të All'llahut dhe jo për sy të njerëzve!*".[1]

2- Ngritja e zërit tek varri i Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*

Disa dijetarë dhe komentues kanë thënë se ajetet e mësipërme, objekt i studimit tonë, ashtu si e ndalojnë ngritjen e zërit në prani të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, përgjatë jetës së tij, gjithashtu, e ndalojnë edhe pas ndarjes së tij nga jeta.[2]

Nëse qëllimi i pohimit të tyre të mësipërm, është gjithëpërfshirja e shprehjes së përmendur në ajet, mund të themi se kuptimi sipërfaqësor i ajetit përcakton qartësisht kohën kur ka jetuar Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, sepse në ajet thuhet: **"Mos e ngrini zërin tuaj**

[1] "El Mehexhetul Bejda'a", vëll. 3, kreu"Edukata e miqësisë dhe e shoqërisë", f. 450.
[2] Tefsiri "Ruhul Meanij", vëll. 26, f. 125.

mbi zërin e Profetit", që do të thotë se kemi të bëjmë me një gjendje të caktuar fizike e trupore gjatë jetës së Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Pra, kur ai është duke folur me dikë, nuk lejohet ngritja e zërit mbi zërin e tij.

Ndërsa, nëse qëllimi i tyre është gjithëpërfshirja, është e qartë se ajo është përftuar prej filozofisë së këtij gjykimi. Njohësit e mëdhenj të All'llahut, përjashtojnë mundësinë që çështja të jetë e lidhur vetëm me kohën kur ka jetuar Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, për rrjedhojë, përgjithësimi është lehtësisht i mundur, pasi konsiderohet i mirëqenë fakti, që qëllimi i këtij ajeti është respekti dhe mirësjellja e përgjithshme rreth shenjtërisë së tij. Për këtë arsye, nëse ngritja e zërit e cenon këtë shenjtëri, atëherë nuk ka dyshim që është rreptësisht e ndaluar, përveç rasteve kur kemi të bëjmë më thirrjen e ezanit, me këndimin e Kur'anit, mbajtjen e hytbes apo çështjeve të ngjashme me to. Për këto çështje nuk ka asnjë problem, as përgjatë jetës së Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe as pas ndarjes së tij nga jeta.

Në librin "Usulul Kafij", lexojmë një hadith të transmetuar prej Imam Bakirit *(Paqja qoftë mbi të!),* i cili bën fjalë për ngjarjen që i ka ndodhur Hasanit *(Paqja qoftë mbi të!)*, pas vdekjes së tij, pikërisht atëherë, kur Aishja nuk lejoi, që ai të varrosej pranë Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Kur zërat filluan të ngrihen, Imam Hysejni *(Paqja qoftë mbi të!)* e argumentoi ndalesën me ajetin: **"O ju që keni besuar! Mos e ngrini zërin tuaj mbi zërin e Profetit..."**.

Në një tjetër hadith të ardhur nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: "Atë që All'llahu ua ka bërë haram (të ndaluar) ndaj njëri-tjetrit në këtë jetë, ua ka bërë edhe pas ndarjes nga jeta. (Pra, kur vdes njeri dhe tjetri vazhdon të jetojë).".[1]

Ky hadith është një tjetër dëshmi për gjithëpërfshirjen e kuptimit të këtij ajeti.

3- Disiplina islame është për çdo punë dhe për çdo vend

Çështja e drejtimit, nuk mund të arrihet pa u përkujdesur për disiplinën, ndaj po të lihet puna në dorë të njerëzve, në dorë të dëshirave e të tekave të tyre, punët nuk do të mund të kryheshin, edhe sikur drejtuesit të jenë shumë të zotë.

Janë të shumta ngjarjet e mangësitë që kemi vërejtur në këtë rrugëtim. Sa herë ka ndodhur, që ushtri të mëdha e të forta të humbnin luftën, për arsye të mangësive të prijësve të tyre dhe mungesës së disiplinës siç e përmendëm më lart. Ka ndodhur që, dhe myslimanët ta kenë shijuar hidhësinë e pasojave nga mosrespektimi i këtyre rregullave, si në kohën e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, ashtu edhe pas tij. Ngjarja më e qartë, lidhur me këtë çështje, është humbja e myslimanëve në Luftën e Uhudid, për shkak të mungesës së disiplinës nga një pjesë e vogël e luftëtarëve.

Kur'ani i jep një rëndësi të veçantë kësaj ngjarjeje dhe shkurtimisht afron një panoramë të plotë për atë që realisht ndodhi në atë betejë, duke thënë: **"O ju që keni besuar! Mos nxitoni para** (urdhrit të) **All'llahut dhe të Dërguarit të Tij."**.

[1] "Usulul Kafij", vëll. 1, f. 302, marrë nga tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, f. 80.

Siç e kemi përmendur edhe më lart, kuptimi i këtij ajeti është aq i gjerë, sa mund të përfshijë të gjitha llojet dhe format e nxitimit apo të vonesës, si edhe fjalët apo veprimet personale që ndodhin jashtë kuadrit orientues të lidershipit.

Nga kjo gjendje, vërejmë, se gjatë historisë së jetës së Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka ndodhur shpesh që persona të caktuar të kenë tejkaluar urdhrat e tij, të mos i kenë zbatuar ato, duke u vonuar, apo duke ulur kokën, duke u bërë kështu objekt kritikash dhe ofendimesh të madha.

Disa prej këtyre rasteve, po i përmendim si më poshtë:

1- Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* po udhëtonte drejt Mekës, në vitin e tetë të Hixhretit, ishte muaji i Ramazanit. Bashkë me të ishin shumë njerëz, prej tyre kishte kalorës, por edhe këmbësorë. Kur mbërriti te shtëpia e Kerraul Gamimit, urdhëroi t'i sillnin një enë me ujë. Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* piu në atë enë, duke çelur iftarin bashkë me ata që e shoqëronin. Disa prej shokëve nuk e çelën iftarin bashkë me të, por vendosën të vazhdojnë të qëndrojnë agjërueshëm. Këta njerëz, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i quajti gjynahqarë.[1]

2- Një shembull tjetër është ngjarja që ka ndodhur gjatë Haxhit të Lamtumirës, në vitin e dhjetë të Hixhretit, teksa Profeti

[1] Këtë hadith e kanë transmetuar shumë historianë dhe dijetarë të hadithit. Ata janë përmendur te libri "Uesailu Shia", vëll. 7, K. "Prej të cilit pranohet agjërimi?", f. 125, (me pakëz shkurtim).

Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i dha urdhër një thirrësi të thërrasë, duke thënë: *"Ata që nuk kanë sjellë me vete bagëti për t'i therur, le të zhveshin rrobat e ihramit dhe ta konsiderojnë Umre, ndërsa ata që kanë sjellë bagëti për të therur për kurban, le të vazhdojnë t'i mbajnë veshur rrobat e ihramit!"*.

Pastaj Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* shtoi: *"Po të mos i kisha sjellë bagëtitë për kurban, do t'i kisha zhveshur edhe unë rrobat e ihramit dhe do ta quaja Umre. Kështu që të gjithë ata që nuk kanë sjellë bagëti me vete duhet të zhveshin rrobat e ihramit!"*. Një pjesë e shokëve, nuk iu bindën këtij urdhri, duke thënë: "Si mund t'i zhveshim rrobat e ihramit dhe Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nuk i ka zhveshur ato?! A nuk është e turpshme, që të nisemi për të kryer Haxhin, pas kryerjes së Umres e të rrjedhë prej nesh uji i pastrimit?!". (Larja nga xhunubllëku). Profeti u lëndua nga ajo që thanë dhe i qortoi ata.[1]

3- Një tjetër histori e njohur është çështja e *kundërshtimit të ushtrisë së Usamës*, kur Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* desh të ngrihej (të ndahej nga jeta) për në lartësitë e afrimitetit pranë Krijuesit të Tij. Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i urdhëroi myslimanët të ndjekin ushtrinë e Usama bin Zejdit dhe të udhëtonin bashkë me të në luftë kundër romakëve, kështu urdhëroi edhe ensarët me muhaxhirët, që t'i bashkoheshin kësaj ushtrie.

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, me sa dukej, nuk dëshironte që të ndodhin

[1] "Biharul Anuar", vëll. 21, f. 386. (me pakëz shkurtim).

probleme me zgjedhjen e pasardhësit, pas largimit të tij nga kjo jetë, probleme siç dhe ndodhën. Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i mallkoi ata që nuk do të shkonin me Usamën, megjithatë, një grup i vogël i tyre nuk iu bashkuan ushtrisë së Usamës, me pretekstin se nuk mund ta linin Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* në atë gjendje.[1]

4- Gjithashtu, është e njohur edhe historia e *"El Kalem ue Deuat"* (e Lapsit dhe e Letrës). Ajo ka ndodhur përgjatë orëve të fundit të jetës së Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Kjo është një ngjarje shumë prekëse, kështu që sjellim tekstin e saj, përcjellë nga "Sahihu" i Muslimit. Historia është: "Në shtëpi të të Dërguarit të All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* erdhën disa burra, mes të cilëve ishte edhe Umer Ibn Hatabi. Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* kishte thënë: *"Ejani t'ju shkruaj një letër, që të mos humbni kurrë pas saj!"*. Umeri tha: "Dhimbja e ka pushtuar Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, por ne kemi Librin e All'llahut, na mjafton ai.". Menjëherë nisën kundërshtitë dhe konfliktet mes familjarëve. Disa prej tyre thanë: "Afrojani një letër të Dërguarit të All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, t'jua shkruajë letrën, pas së cilës të mos humbni kurrë.". Disa të tjerë përsëritën atë që tha Umeri. Kur debatet dhe shamata nisen të shtohen në sy të

[1] Këtë ngjarje e kanë përmendur shumë historianë te librat e historisë islame. Ajo është një prej ngjarjeve të rëndësishme të historisë islame (Për më shumë të dhëna, mund t'i ktheheni librit "Kitabul Muraxheaa't, El Muraxheatu (Letërkëmbimi) 90).

Profetit të All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, ai tha: "*Çohuni!*".[1]

Ajo çka vlen për t'u përmendur në këtë rast, është fakti se të njëjtin hadith e ka transmetuar edhe Buhariu, tek i vërteti i tij, "Sahihul Buhari", me shumë pak ndryshime në tekst. ("Sahihul Buhari", vëll. 6, kreu "Sëmundja e Profetit", f. 11.) Kjo çështje mbetet nga ngjarjet më të rëndësishme të historisë islame, e cila ka nevojë të analizohet imtësisht, edhe pse nuk është vendi këtu, por ky është rasti më i qartë i vonesës ndaj Urdhëresës së Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe i kundërshtisë ndaj ajetit, objekt i studimit tonë: **"O ju që keni besuar! Mos nxitoni para** (urdhrit të) **All'llahut dhe të Dërguarit të Tij!"**.

Ajo çfarë na intereson në këtë kontekst, është zbatimi i disiplinës islame dhe asaj hyjnore, që kanë absolutisht nevojë për një shpirt të dorëzuar në pranimin e udhëheqësit hyjnor, për të gjitha çështjet e jetës dhe besimit të fortë në pozitën e udhëheqësit të madh.

[1] "Sahihul Muslim", vëll. 3, K. "Uesije", Hadithi 22, f. 1259.

Ajetet 6 - 8

يَٰٓأَيُّهَا ٱلَّذِينَ ءَامَنُوٓاْ إِن جَآءَكُمۡ فَاسِقُۢ بِنَبَإٖ فَتَبَيَّنُوٓاْ أَن تُصِيبُواْ قَوۡمَۢا بِجَهَٰلَةٖ فَتُصۡبِحُواْ عَلَىٰ مَا فَعَلۡتُمۡ نَٰدِمِينَ ٦ وَٱعۡلَمُوٓاْ أَنَّ فِيكُمۡ رَسُولَ ٱللَّهِۚ لَوۡ يُطِيعُكُمۡ فِي كَثِيرٖ مِّنَ ٱلۡأَمۡرِ لَعَنِتُّمۡ وَلَٰكِنَّ ٱللَّهَ حَبَّبَ إِلَيۡكُمُ ٱلۡإِيمَٰنَ وَزَيَّنَهُۥ فِي قُلُوبِكُمۡ وَكَرَّهَ إِلَيۡكُمُ ٱلۡكُفۡرَ وَٱلۡفُسُوقَ وَٱلۡعِصۡيَانَۚ أُوْلَٰٓئِكَ هُمُ ٱلرَّٰشِدُونَ ٧ فَضۡلٗا مِّنَ ٱللَّهِ وَنِعۡمَةٗۚ وَٱللَّهُ عَلِيمٌ حَكِيمٞ ٨

“O ju që keni besuar! Nëse ndonjë njeri i pandershëm ju sjell ndonjë lajm, sigurohuni mirë (në është i vërtetë)**, për të mos i bërë dëm ndokujt padashje, e të pendoheni pastaj për atë që keni bërë.”**

“Dhe ta dini se midis jush gjendet i Dërguari i All’llahut! Sikur ai t’ju bindej juve në shumë gjëra, ju do ta kishit pësuar. Por All’llahu jua ka bërë të dashur besimin dhe jua ka zbukuruar atë në zemrat tuaja, ashtu siç jua ka bërë të urryer mosbesimin, shthurjen dhe mosbindjen. Pikërisht ata janë të udhëzuarit drejt.”

“Me mirësinë dhe hirin e All’llahut. All’llahu është i Gjithëdijshëm dhe i Urtë.”

Shkaku i zbritjes

Disa komentues, si Et Tabarsij te "Mexhmaul Bejan", kanë thënë, se ka dy mendime lidhur me arsyen e zbritjes së ajeteve të cituara më sipër. Disa të tjerë u mjaftuan veç me njërin prej dy mendimeve, siç janë El Kurtubij, Sejjid Kutbij dhe Nuruth Thekalejni.

Mendimi i parë, është komenti i pjesës më të madhe të komentuesve: Sifjalia: **"Nëse ndonjë njeri i pandershëm ju sjell ndonjë lajm"**, ka zbritur për Uelid bin Ukbetu. Po përmendim historinë: Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e dërgoi atë për të mbledhur zekatin prej fisit Beni Mustalakut. Kur këta e morën vesh se i dërguari i Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ishte nisur drejt tyre, u gëzuan shumë dhe u ngritën në këmbë për ta pritur. Meqenëse, Uelidi kishte pasur hasmëri të madhe me ta, në kohën e paditurisë, para Islamit, mendoi dhe përfytyroi se donin ta vrisnin. Pa e vërtetuar, më parë, këtë mendim që kishte në mendje, u kthye te Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe i tha: "O i Dërguari i All'llahut! Ata nuk pranuan ta japin zekatin.".

Siç është e ditur nga të gjithë, ndalimi i pagesës së zekatit është një lloj rezistence dhe kundërshtie ndaj qeverisë islame. Si rrjedhim, pretendimi apo deklarata e Uelidit nënkuptonte se ata ishin *"murted'dune" - "të dalë prej feje"*. Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, kur e dëgjoi

këtë lajm, u mërzit shumë e vendosi t'u shpallë luftë atyre. Pikërisht, për këtë arsye zbriti ajeti i mësipërm.[1]

Disa komentues të tjerë kanë shtuar se, kur Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* mori lajmin prej Uelid bin Ukbetu, që fisi Beni Mustalak kishte hequr dorë nga dhënia e zekatit, për rrjedhojë edhe nga Islami, urdhëroi Khalid bin Uelid bin Mugiratu të nisej drejt atij fisi, por të mos kryente asnjë veprim, derisa të hetohej mirë dhe të merrej vesh e vërteta. Khalidi u nis natën, kur u afrua pranë vendit ku jetonte fisi beni Mustalak, dërgoi informatorët e tij për të kuptuar dhe për të hetuar ç'kishte ndodhur saktësisht me ta. Ata, kur u kthyen, i thanë se anëtarët e fisit vazhdonin të ishin myslimanë, besnikë të fesë së tyre, se kishin dëgjuar atje zërin e ezanit dhe namazin, kur faleshin. Mëngjesin e të nesërmes, Khalidi, shkoi vetë për të saktësuar lajmet që kishin sjellë njerëzit e tij. Pasi pa se gjithçka ishte në rregull, u kthye te Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe e njoftoi për çfarë kishte parë. Në atë moment, zbriti ajeti i mësipërm kur'anor. Menjëherë pas zbritjes se ajetit, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e komentoi duke thënë: *"Ngadalësia dhe kujdesi janë dy prej punëve të All'llahut, ndërsa shpejtësia me ngutjen janë prej punëve të shejtanit."*.[2]

Ka komentues të tjerë që përmendin një tjetër mendim, lidhur me shkakun e zbritjes së ajetit 6, duke iu mbështetur vetëm atij. Ata thonë se ky ajet ka zbritur për gruan e Profetit, Marije El

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 9, f. 132.
[2] Tefsiri "Kurtubijj", vëll. 9, f. 6131.

Kubtijetu, që ishte nëna e djalit të Profetit, Ibrahimit *(Paqja qoftë mbi të!)*. Profetit i kishin thënë se gruaja e tij, kishte një djalë xhaxhai, që e quanin Xherih. Ajo e vizitonte herë pas here atë, madje, thoshin se ndërmjet tyre kishte një marrëdhënie të paligjshme. Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* kërkoi t'i sillnin Aliun, të cilit i tha: "*O, vëllai im, merre shpatën dhe shko! Nëse e gjen atë tek ajo, pritja atij kokën!*".

Prijësi i myslimanëve, Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*, mori shpatën dhe tha: "*Ti, o i Dërguari i All'llahut, për mua, je më i shtrenjtë se nëna dhe babai im! Betohem për urdhrin Tënd, si një rrugë e mbrojtur! Shkoj ta zbatoj urdhrin tënd, deri sa dëshmitari të shohë atë që nuk mundet ta shohë i munguari!*".

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* foli: "*Përkundrazi, të munguarit të shohin atë që nuk mund ta shohin dëshmitarët!*".

Më vonë, Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* pohoi: "*Me shpatë në dorë, si një egërsirë, u vërsula në drejtim të tij. Kur arrita, e gjeta Xherihun, aty. Ngrita shpatën për ta goditur. Kur e kuptoi që desha ta vras, u shtri përmbys nën një palmë dhe drejtoi këmbët. Ishte i trembur e i tmerruar. Kur e pashë që nuk kishte cilësi burrash, as më shumë e as më pak, u ktheva të njoftoj Profetin Muhammed (Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), i cili tha: "Falënderimet i takojnë All'llahut, që e largoi të keqen prej familjes sime!"*".[1]

Kjo çështje është përmendur, gjithashtu, te tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëllimi 5, me pak ndryshime në termat e përzgjedhur.

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 9, f. 132, ashtu siç është përmendur te tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, f. 81.

Komentimi

Mos i jep rëndësi lajmeve të njerëzve të shthurur

Tek ajetet e mësipërme folëm e shtjelluam normat morale dhe edukative që myslimanët duhet të përqafojnë, në raport me udhëheqësin dhe Profetin e tyre, Muhammedin *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Në ajetet e mësipërme, dallojmë lehtësisht, dy çështje shumë të rëndësishme.

Çështja e parë, është të mos gjykojmë përpara tij.

Ç**është ja e dytë,** është përkujdesja për edukatën, sjelljen dhe mosngritjen e zërit në prani të Tij.

Për sa u përket ajeteve që po komentojmë, ato përcaktojnë qartë detyra të tjera të ymetit islam ndaj Profetit të tyre. Ato tregojnë nevojën dhe domosdoshmërinë e hetimit të lajmit, para se ta dërgojnë te Profeti i All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, për këtë arsye, edhe këshilla e përmendur në ajet është e qartë: "Nëse një njeri i prishur dhe i shthurur, ju sjell një lajm të caktuar, më parë duhet ta vërtetoni dhe ta hetoni atë! Mos e nxisni Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* të pranojë lajm, përpara se të vërtetohet ai. Kështu, në ajet, fillimisht, thuhet: **"O ju që keni besuar! Nëse ndonjë njeri i pandershëm ju sjell ndonjë lajm, sigurohuni mirë** (në është i vërtetë)**..."**.

Më pas, për të qartësuar arsyen, thotë: **"...për të mos i bërë dëm ndokujt padashje, e të pendoheni pastaj për atë që keni bërë."**.

Nëse Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* do ta kishte besuar lajmin që i solli Uelid bin Ukbetu, duke e konsideruar fisin Beni Mustalak të dalë prej feje, ai do t'u shpallte luftë atyre. Kjo do të përbënte një fatkeqësi të madhe.

Prej frymës së ajetit në vijim, kuptohet se një grup prej shokëve të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ngulën këmbë t'i shpallnin luftë fisit Beni Mustalak, ndaj zbriti Kur'ani, për t'i paralajmëruar dhe për t'u treguar, se kjo sjellje është injorancë, fundi vetë, pas së cilës vjen vetëm pendesa.

Disa dijetarë të usulit (parimet e jurisprudencës), me anë të këtij ajeti, justifikojnë fuqinë argumentuese të një lajmi të vetëm, ku thuhet: **"Nëse ndonjë njeri i pandershëm ju sjell ndonjë lajm, sigurohuni mirë** (në është i vërtetë)**."**.

Sipas tyre, kjo do të thotë se, nëse një njeri i ndershëm sjell një lajm, nuk është e nevojshme që të hetojmë apo të sigurohemi, sepse lajmi i tij është i pranueshëm dhe konsiderohet i mirëqenë, por natyra e këtij argumenti has në disa problematika, prej të cilave më të rëndësishmet janë dy:

E para: Mendimi i mësipërm është ngushtësisht i lidhur dhe i kushtëzuar me pranimin e fuqisë imponuese të argumentimit, nëpërmjet konceptit të cilësimit.[1]

[1] Disa përfytyrojnë se çështja, në këtë rast, është një formë e kuptimit të kushtit dhe kuptimi i kushtit është argument, ndërkohë që nuk ka asnjë lidhje me kuptimin e kushtit. Për më tepër, fjalia kushtëzuese vjen për të shpjeguar çështjen. Siç është e ditur, në të tilla raste, (vini re me kujdes) as fjalia kushtëzuese, nuk ka kuptim.

E dyta: Arsyeja e përmendur në fund të ajetit, e ka të gjithë gjerësinë e duhur për të përfshirë lajmin e të ndershmit dhe të pandershmit, sepse veprimi i nxitur prej një lajmi hipotetik, sado e sido që të jetë, e përmban mundësinë e pendesës.

Të dyja këto çështje apo problematika mund të zgjidhen, sepse koncepti i cilësimit e çdo kufizim tjetër, sa herë që nevojitet shpjegimi i konceptit nga pozita e të qenit të rezervuar, është argument. Përmendja e këtij kufizimi, kufizimi i të pandershmit, te ajeti i mësipërm, nuk ka asnjë vlerë për t'u përmendur, po t'i referohemi kuptimeve gjerësisht të pranuara prej zakonit gjuhësor, përveçse për të përforcuar argumentin nëpërmjet lajmit të sjellë prej të ndershmit.

Për sa i përket arsyetimit që ndodhet në fund të ajetit, ajo që vërehet, në pamje të parë, është fakti, se ai nuk përfshin të gjitha veprat me argumente hipotetike, por rrok vetëm ato momente, kur vepra kryhet për shkak të injorancës, papërgjegjshmërisë dhe padijes, pasi ajeti vetë e vendos theksin mbi injorancën.

Siç e dimë, pjesa më e madhe e argumenteve, mbi të cilat mbështeten të gjithë të mençurit e botës, për çështjet e përditshmërisë, janë argumente hipotetike, si p.sh: kuptimet sipërfaqësore të fjalëve, fjala e të pranishmit, fjala e ekspertëve, si dhe fjala e atij që ka diçka në dorë, etj.

Është më se e ditur se asnjë prej rasteve të përmendura më lart, nuk mund të konsiderohet injorancë, edhe në rast se nuk përputhet me realitetin, si rrjedhim, në këtë rast, nuk mund të

realizohet çështja e pendesës prej saj, pasi ajo është rrugë e përgjithshme.

Gjithsesi, ne besojmë se ky ajet është prej ajeteve të qarta, nëpërmjet të cilave vërtetohet autoriteti argumentues i një lajmi të vetëm, edhe për çështje të zakonshme. Lidhur me këtë çështje, ka shumë hulumtime, por është e pamundur të përmenden të gjitha këtu.

Dëshmojmë që e kemi të pamundur të mohojmë se mbështetja te lajmet e hetuara apo të saktësuara ka qenë themeli i historisë dhe i jetës njerëzore. Për këtë arsye, nëse do të heqim autoritetin e argumentimit nëpërmjet një lajmi të vetëm, të hetuar dhe të saktësuar prej shoqërisë njerëzore, atëherë një pjesë shumë e madhe e trashëgimisë shkencore, lidhur me shoqërinë e vjetër njerëzore, do të zhvlerësohej, madje jo vetëm ato, por edhe shumë prej çështjeve bashkëkohore në dritën e të cilave punojmë sot. Kjo problematikë, jo vetëm që e kthen njeriun prapa, por ndalon plotësisht ecurinë e jetës. Për këtë arsye, të gjithë të mençurit e pranojnë autoritetin argumentues, prandaj gjithë plejada e shenjtorëve e ka firmosur këtë gjë me fjalë dhe vepra.

Edhe pse vetëm lajmi i jep rregullin dhe sigurinë jetës, mund të themi se mbështetja te lajmet e paverifikuara është shumë e rrezikshme. Ato shkaktojnë turbulenca në rregullin e përgjithshëm të shoqërisë, madje përhapin fatkeqësi të ndryshme, duke i kërcënuar rrezikshëm rrethanat, të drejtat e njerëzve, pse jo, duke i orientuar ato drejt shmangies dhe humbjes. Kjo përmendet bukur e këndshëm në Kur'anin Famëlartë, ku, All'llahu, në ajetin 6, thotë: **"E të pendoheni pastaj për atë që keni bërë!"**.

Një moment i rëndësishëm që tërheq vëmendjen këtu, është se përhapja e lajmeve të rreme dhe mbështetja te lajmet e pasaktësuara janë metoda të vjetra, të cilat i përdorin regjimet koloniale dhe diktatoriale, për të krijuar situata dhe frymë të përgjithshme mashtrimi, duke gënjyer kështu njerëzit injorantë e të paditur, duke u grabitur atyre paratë dhe pasurinë nëpërmjet formave të mashtrimit masiv.

Nëse myslimanët punojnë e veprojnë në përputhje me frymën që përcjell këshilla e All'llahut në këtë ajet, duke mos besuar lajmet e njerëzve të pandershëm, pa u saktësuar më parë, atëherë do të ishin të imunizuar prej të gjitha fatkeqësive të mëdha apo të vogla qofshin.

Vlen të theksojmë se çështja e rëndësishme këtu është saktësimi dhe mbështetja tek i njëjti lajm. Pjesa më delikate këtu është se saktësimi dhe vërtetimi i lajmit mund të realizohet herë nëpërmjet dërgimit të informatorëve dhe herë duke e krahasuar atë me të tjera lajme që vijnë nga burime të jashtme. Kjo është dhe arsyeja që ne e konsiderojmë të pranueshëm një lajm dhe i besojmë atij, edhe kur informatori nuk është i ndershëm.

Duke u mbështetur mbi këto teza, mund të themi se cilado qoftë metoda e përzgjedhur për të kryer saktësimin dhe vërtetimin e një lajmi, pra, qoftë duke u mbështetur te drejtësia, përkushtimi dhe sinqeriteti i rrëfyesit, apo edhe duke bërë krahasimin me lajmet e ardhura nga burime të treta të jashtme, ai është i pranueshëm për ne, sepse edhe rruga që kanë përshkuar myslimanët e mençur është ndërtuar mbi këto themele.

Kjo është dhe arsyeja pse në shkencën e jurisprudencës islame përballemi me shumë lajme që vijnë prej transmetimeve të dyshimta, por meqenëse u konsideruan të mirënjohura dhe u krahasuan me transmetime të caktuara, u shndërruan në lajme me transmetim të dobët që vlejnë, kështu që dijetarët, duke u mbështetur në to, mund të ndërtojnë fetvatë dhe gjykimet islame.

Në të kundërt, ndodh që të vijnë lajme prej një njeriu që konsiderohet i pranueshëm për ne, por krahasimet me lajmet që vijnë nga burime të jashtme, nuk e ligjërojnë pranimin e tyre. Në këtë rast, s'na mbetet rrugë tjetër, përveçse t'i kundërshtojmë këto lajme, edhe pse lajmëtari mund të jetë i ndershëm dhe prej atyre që mund t'ia besojmë dëshminë.

Nisur për sa u tha më sipër, njësia matëse në këto raste është mbështetja në çdo rast te lajmi vetë. Edhe pse ajo që konsiderohet më së shumti, është drejtësia dhe sinqeriteti i sjellësit të lajmit, megjithatë, kjo nuk përbën ndonjë ligjësi të përgjithshme.

Ajeti që vjen më pas, si përforcues dhe miratues i çështjes së rëndësishme të trajtuar në ajetin 6, thotë: **"Dhe ta dini se midis jush gjendet i Dërguari i All'llahut! Sikur ai t'ju bindej juve në shumë gjëra, ju do ta kishit pësuar..."**.[1]

Ashtu siç ka thënë një grup komentuesish, kjo fjali tregon se, kur Uelidi njoftoi daljen prej Islamit të fisit Beni Mustalak, një grup myslimanësh të thjeshtë, me logjikë të kufizuar dhe me

[1] Fjala *"leanit'tunm"* - *"do ta kishit pësuar"*, rrjedh nga fjala *"el anet"*. Kuptimi i saj është veprimi i një vepre, pasojat e të cilës i ka frikë, apo një ngjarje që i ndodh njeriut. Për këtë arsye, dhimbja që shkakton thyerja e një kocke në trup pas goditjes, është quajtur *"el anet"*.

aftësi analitike sipërfaqësore, nguli këmbë te Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* për t'i shpallur luftë këtij fisi.

Kur'ani thotë se është fati i madh për ju, që Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është pranë jush, pasi ai është i lidhur me botën e zbulesës hyjnore, kështu që sa herë të ketë mes jush shenja shmangie, ai do t'ju këshillojë dhe do t'ju udhëzojë për në Rrugën e Drejtë, prandaj as mos e imagjinoni që ai të presë këshillat e ardhura prej mendjeve tuaja, as mos ngulni këmbë t'i imponoheni me mendimet tuaja, për më tepër ta mësoni atë, pasi një sjellje e tillë do të ketë pasoja dhe nuk është në interesin tuaj!

Më pas, All'llahu i Madhëruar sjell në vëmendjen e të gjithëve, një tjetër dhuratë dhe një tjetër mirësi prej mirësive të Tij të mëdha: **"...Por All'llahu jua ka bërë të dashur besimin dhe jua ka zbukuruar atë në zemrat tuaja, ashtu siç jua ka bërë të urryer mosbesimin, shthurjen dhe mosbindjen..."**.

Në të vërtetë, të gjitha këto shprehje janë shenja të mira, që flasin për ligjin e mirësisë të formësimit.

Kuptimi i kësaj është: Kur një njeri i mençur dëshiron të realizojë diçka, ai përgatit kushtet dhe rrethanat e gjithanshme për realizimin e saj. Ky është një parim realist dhe shumë origjinal, lidhur me çështjet e njerëzve dhe sjelljen e tyre, në raport me to.

All'llahu i Madhëruar synon t'i përfshijë të gjithë njerëzit në Rrugën e Drejtë, pa qenë kurrsesi nën ndikimin e llojeve të imponimit, por me dëshirën dhe vullnetin e tyre të lirë. Për këtë

arsye, nga njëra anë, Ai dërgon Profetë dhe libra qiellorë, kurse, nga ana tjetër, e bën besimin të dashur për zemrat, thellësive të tyre ndez pishtarin e dashurisë, për të kërkuar të vërtetën, kështu që vihet në kërkim të thellësive të qenies, duke ia bërë asaj të urryer mosbesimin, shthurjen dhe mosbindjen.

Kësisoj, është në natyrën e njeriut, që nga gjeneza, dashuria për besimin, pastërtinë, përkushtimin dhe largimin prej mohimit dhe gjynahut.

Ndodh që ujërat e moralit, në fytyrat e njerëzve të ndershëm, të pësojnë ndotje gjatë periudhave të ndryshme të jetës. Kjo ndodh për shkak të përzierjes dhe përfshirjes së tyre në mjedise të infektuara. Për rrjedhojë, njeriu e humb kthjelltësinë e pastërtisë së karakterit të tij dhe nis të ketë aromë të njëjtë me atë të gjynahut, të mohimit dhe të mosbindjes.

Kjo dhuratë e ngjizur në natyrën e njeriut, që nga krijimi, i fton njerëzit të ndjekin të Dërguarin e All'llahut dhe të mos gjykojnë përpara tij në asnjë çështje.

Duhet të kthejmë vëmendjen te një tjetër mirësi, ajo është përmbajtja e ajetit, i cili, në asnjë rast, nuk ia ul vlerat institucionit të këshillimit, pasi qëllimi i këshillimit është që cilido të shprehë pikëpamjet e tij për atë çka beson si të vërtetë, por, duke mbajtur parasysh se mendimi i fundit dhe gjykimi përfundimtar i përket ekskluzivisht Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Këtë e gjejmë të qartë, gjithashtu, edhe tek Ajeti i Këshillimit *(ajetu esh shura)*.

E thënë ndryshe, këshilla është çështje më vete, ndërsa imponimi i mendimit është një çështje krejt tjetër. Për këtë arsye,

mund të themi se ajeti 7, mohon vetëm imponimin e mendimit, por kurrsesi këshillimin.

Çfarë nënkupton fjala *"el fusuk"* në këtë ajet?! Disa komentues kanë thënë se ajo nënkupton gënjeshtrën, por duke qenë se kjo fjalë ka një kuptim shumë më të gjerë gjuhësor, përfshin njëkohësisht edhe mosbindjen e të gjitha natyrave. Për këtë arsye, menjëherë pas kësaj fjale vjen fjala *"isjan"*, që do të thotë *mosbindje*, për të vërtetuar dhe për ta plotësuar atë. Sifjalia: **"jua ka zbukuruar atë në zemrat tuaja"** vërteton dhe mbështet sifjalinë pararendëse: **"jua ka bërë të dashur besimin"**.

Disa komentues kanë thënë se fjala *"el fusuk"* nënkupton gjynahet e mëdha, ndërkohë që mosbindja është më gjithëpërfshirëse se ajo, edhe pse për këtë pretendim nuk ka ndonjë argument.

Gjithsesi, në fundin e këtij ajeti, Kur'ani përcakton një rregull të përgjithshëm dhe gjithëpërfshirës, për të gjithë njerëzit që i kanë këto cilësi: **"Pikërisht ata janë të udhëzuarit drejt."**.

Nëse ju, o njerëz, do ta merrni në mbrojtje këtë dhuratë hyjnore, dashurinë për besimin dhe largimin prej mohimit e shthurjes dhe do t'i ruani këto cilësi natyrore të pandotura, të cilat lindin së bashku me njeriun, nuk ka dyshim se udhëzimi në Rrugën e Drejtë do të jetë e ardhmja juaj. Fjalitë e përmendura tek ajeti i mëparshëm, tërheqin vëmendjen, sepse u drejtohen besimtarëve. Fjalia: **"Pikërisht, ata janë të udhëzuarit, drejt..."**, i përmend ata në mungesë, kështu që këto ndryshime, ndërmjet shprehjeve, vijnë për të argumentuar se ky gjykim nuk është posaçërisht për shokët e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, por është ligjësi e përgjithshme dhe gjithëpërfshirëse. Kjo do të thotë se të gjithë ata që e ruajnë kthjelltësinë, pastërtinë dhe dëlirësinë e

natyrshmërisë, për çdo kohë e periudhë, do të jenë prej të udhëzuarve në rrugën e shpëtimit.

Ndërsa ajeti 8 përcakton qartësisht se dashuria për besimin dhe largimi prej mohimit dhe mosbindjes, janë disa prej dhuratave hyjnore për njeriun. Në këtë ajet thuhet: **"Me mirësinë dhe hirin e All'llahut. All'llahu është i Gjithëdijshëm dhe i Urtë."**.

Dituria dhe urtësia e All'llahut, e bëjnë të detyrueshme që Ai të krijojë në qeniet tuaja faktorët, arsyet e udhëzimit dhe të lumturisë, duke i plotësuar më pas me dërgimin e Profetëve vetëm për ju, me qëllimin e arritjes suaj te destinacioni i synuar, që është Xhenneti.

Duket qartë se mirësia dhe hiri i All'llahut, në këtë rast, janë tregues për të njëjtën të vërtetë, që nënkupton dhuratat hyjnore për krijesat e Tij. Por ajo çka është më e rëndësishme, është fakti se fjala *"fadlun"* - *"mirësi"*, u quajt e tillë, ngaqë All'llahu nuk ka nevojë për të dhe *"ni'metun"* - *"begati"*, u quajt e tillë, sepse njerëzit kanë nevojë për të. Kështu që këto fjalë mund të konsiderohen si dy anët e të njëjtës medalje.

Nuk ka asnjë dyshim se dija e All'llahut është nevojë e njerëzve dhe urtësia e Tij vjen për të plotësuar edukimin e krijesave, ndaj këto dy mirësi i bëjnë të detyrueshme dhuratat e Tij morale për krijesat e veta, që janë: dashuria për besimin dhe largimi prej mohimit e mosbindjes.

Hulumtime

1- Udhëzimi i All'llahut dhe liria e zgjedhjes

Ajetet e mësipërme përcaktojnë qartë pikëpamjen e Islamit rreth çështjes së detyrimit dhe lirisë për të zgjedhur mes udhëzimit dhe humbjes, pasi ato venë në dukje një urtësi të madhe, që konsiston në faktin se All'llahu i Madhëruar e përgatit që në gjenezë terrenin e përshtatshëm për udhëzimin. Nga njëra anë, Ai, dërgon nga mesi i njerëzve, Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, të armatosur me Kur'anin e zbritur prej All'llahut, që është dritë dhe udhërrëfyes, ndërsa, nga ana tjetër, Ai hedh te zemrat e njerëzve dashurinë e madhe për besimin, largimin dhe arratisjen prej mohimit e mosbindjes, duke ia lënë njeriut lirinë për të zgjedhur çfarë të dëshirojë me vullnetin e tij të plotë. Për këtë çështje, All'llahu i Madhëruar vendosi legjislacionin e Tij.

Po t'i referohemi ajeteve pararendëse, do të vëmë re se dashuria për besimin dhe largimi prej mohimit dhe mosbindjes janë të pranishme në zemrat e të gjithë njerëzve, pa përjashtim. Kjo do të thotë se, edhe nëse ato nuk gjenden në zemrat e disa njerëzve, kjo ndodh për arsye të sjelljeve dhe veprave të tyre të gabuara, pasi All'llahu i Madhëruar, në mënyrë kategorike, nuk ka hedhur në zemrën e askujt dashurinë për mohimin dhe mosbindjen.

2- Udhëheqësi dhe bindja ndaj tij

Këto ajete tregojnë qartë se udhëheqësi i zgjedhur nga All'llahu është i domosdoshëm për udhëzimin e një grupi të caktuar shoqëror, me kushtin që ata t'i binden atij dhe jo ai t'u bindet atyre. Pra, nevojitet që shokët, miqtë dhe pasuesit e udhëheqësit ta ndjekin e ta pasojnë atë, jo t'ia mërzitin jetën, duke i dhënë mend e duke i imponuar atij mendimet e tyre, për interesat e tyre të ngushta personale.

Kjo çështje, në mënyrë të veçantë, nuk është e lidhur vetëm me udhëheqësit hyjnorë, por ajo duhet të zbatohet, gjithashtu, në të gjitha llojet e organizimeve, për çdo kohë e çdo vend. Ky rregull, në asnjë mënyrë, nuk licencon autoritarizmin dhe diktaturën, sikurse nuk mënjanon këshillimin, siç dhe e kemi bërë të qartë më lartë.

3- Besimi është një formë e dashurisë dhe jo vetëm perceptim i trurit

Këto ajete tregojnë, në mënyrë të nënkuptuar, pikërisht, këtë të vërtetë, se besimi është një formë intensive e marrëdhënies morale hyjnore, edhe pse mund të jetë në të njëjtën kohë rezultante e trurit dhe e logjikës. Kështu, lexojmë një hadith të transmetuar prej Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*, kur e pyetën: *"A është dashuria dhe urrejtja prej besimit?!"*.

Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* u përgjigj: *"E si mund të jetë besimi diçka tjetër veç urrejtjes dhe dashurisë?!"*. Më pas lexoi këtë ajet kur'anor: **"Por All'llahu jua ka bërë të dashur besimin dhe**

jua ka zbukuruar atë në zemrat tuaja, ashtu siç jua ka bërë të urryer mosbesimin, shthurjen dhe mosbindjen.”.[1]

Kur Imam Bakiri *(Paqja qoftë mbi të!)* është pyetur: “A është feja diçka tjetër veç dashurisë?!”, përgjigjen e tij e argumentoi me anë të disa ajeteve kur’anore. Njëri prej tyre është dhe ajeti 8: **“Por All’llahu jua ka bërë të dashur besimin dhe jua ka zbukuruar atë në zemrat tuaja, ashtu siç jua ka bërë të urryer mosbesimin, shthurjen dhe mosbindjen.”** Më pas tha: “Feja është vetë dashuria dhe dashuria është vetë feja!”.[2]

Nuk ka asnjë dyshim se kjo dashuri, për të qenë frytdhënëse, duhet t’i bashkëngjitet, siç e përmendëm dhe më lart, formave të tjera të argumentimit e të logjikës.

[1] “Usulul Kafij”, vëll. 2, kreu “Dashuri dhe urrejtje për hir të All’llahut”, Hadithi 5.
[2] Tefsiri “Nuruth Thekalejn”, vëll. 5, f. 83-84.

Ajetet 9 – 10

وَإِن طَآئِفَتَانِ مِنَ ٱلۡمُؤۡمِنِينَ ٱقۡتَتَلُواْ فَأَصۡلِحُواْ بَيۡنَهُمَاۖ فَإِنۢ بَغَتۡ إِحۡدَىٰهُمَا عَلَى ٱلۡأُخۡرَىٰ فَقَٰتِلُواْ ٱلَّتِي تَبۡغِي حَتَّىٰ تَفِيٓءَ إِلَىٰٓ أَمۡرِ ٱللَّهِۚ فَإِن فَآءَتۡ فَأَصۡلِحُواْ بَيۡنَهُمَا بِٱلۡعَدۡلِ وَأَقۡسِطُوٓاْۖ إِنَّ ٱللَّهَ يُحِبُّ ٱلۡمُقۡسِطِينَ٩ إِنَّمَا ٱلۡمُؤۡمِنُونَ إِخۡوَةٞ فَأَصۡلِحُواْ بَيۡنَ أَخَوَيۡكُمۡۚ وَٱتَّقُواْ ٱللَّهَ لَعَلَّكُمۡ تُرۡحَمُونَ١٠

"Nëse dy palë besimtarësh bëjnë luftë midis tyre, pajtojini ata. Por, nëse njëra palë sulmon tjetrën, atëherë luftoni kundër sulmuesit, derisa të kthehet në urdhrat e All'llahut. E, nëse kthehet, atëherë pajtojini ata midis tyre, me drejtësi dhe paanësi, sepse All'llahu i do ata që veprojnë me drejtësi."

"Në të vërtetë, besimtarët janë vëllezër, prandaj pajtojini vëllezërit tuaj midis tyre dhe kijeni frikë All'llahun, në mënyrë që ju të mëshiroheni."

Shkaku i zbritjes

Si shkak i zbritjes së këtyre dy ajeteve, kanë qenë kontradiktat dhe konflikti i hapur midis dy fiseve Eus dhe Hazrexh, që ishin dy fise të mëdha e të njohura në Medine. Konflikti u bë shkak që ata jo vetëm të grindeshin me hunj, shkopinj dhe sende rrethanore, por të luftonin kundër njëri-tjetrit. Për këtë qëllim, zbritën dy ajetet e sipërpërmendura, që t'i mësojë myslimanët si të përballen me situata të tilla të ngjashme.[1]

Disa komentues e studiues kanë thënë se ka ndodhur një konflikt dhe grindje ndërmjet dy ensarëve. Njëri prej tyre i thotë tjetrit: "Hakun tim, do ta marr prej teje me anë të forcës, sepse fisi im është i madh dhe më i shumtë në numër!".

Ndërsa tjetri ia ktheu me qetësi: "Le të shkojmë te i Dërguari i All'llahut, të gjykojë ai për këtë!".

Por, përfaqësuesi i fisit të parë nuk e pranoi këtë propozim. Kështu që përmasat e konfliktit u zmadhuan, sa grindja nisi me shkopinj e deri këpucët që kishin veshur. Pastaj i erdhi radha përdorimit të shpatave. Pikërisht, për këtë zbritën dy ajetet e mësipërme, që të sqarojnë myslimanët për detyrat që u dalin jo vetëm për këtë, por edhe për raste të tjera.[2]

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 9, f. 132.
[2] Tefsiri i "Kurtubijjut", vëll. 9, f. 6136.

Komentimi

Besimtarët janë vëllezër

Në këtë ajet kur'anor përmendet një rregull, i cili ka fuqinë e një ligji gjithëpërfshirës për të gjitha kohërat dhe vendet. All'llahu i Madhëruar thotë: **"Nëse dy palë besimtarësh bëjnë luftë midis tyre, pajtojini ata..."**.[1]

Është e vërtetë se fjala *"iktetelu"*, buron prej lëndës *"el kitalu"* dhe kuptimi i saj është lufta. Por, siç tregojnë edhe argumente, ajo përfshin të gjitha llojet e konflikteve, edhe nëse nuk mbërrijnë në nivelin e luftës, të vrasjes apo përballjes ushtarake. Ky kuptim gjen mbështetje, gjithashtu, te një pjesë e shkakut të zbritjes se ajetit.

Mund të thuhet se, në rast që plotësohen parakushtet e konfliktit, siç janë zënkat me fjalë, të cilat tërheqin më vonë në konflikte shkatërrimtare, siç përmendet edhe në ajet, duhet të bëhen përpjekje për pajtim ndërmjet palëve të përfshira në konflikt, sepse ky kuptim përftohet prej ajetit të mëparshëm, nëpërmjet anulimit të veçorisë.

Gjithsesi, është detyrë e të gjithë myslimanëve, që të pajtojnë palët e përfshira në konflikt, me qëllim që të shmangin gjakderdhjen e të kuptojnë përgjegjësinë e tyre, lidhur me këtë aspekt. Kështu që nuk lejohet për raste të tilla të rrimë duarkryq e të bëjmë sehir, siç bëjnë shumë injorantë, të cilët, kur hasin në

[1] Edhe pse fjala *"taifetan"* është shumësi i fjalës *"taifeh"*, folja e saj erdhi në shumës *"iktetelu"*, pasi secili grup është i përbërë prej disa grupe njerëzish.

situata të tilla, nuk shqetësohen fare. Pra, pajtimi është detyra parësore e myslimanëve, sa herë që përballen me të tilla konflikte.

Më pas, ajeti kur'anor qartëson detyrën e dytë, që del në të tilla raste për myslimanët: **"...Por, nëse njëra palë sulmon tjetrën, atëherë luftoni kundër sulmuesit, derisa të kthehet në urdhrat e All'llahut..."**.

Është e natyrshme që, në rast të derdhjes së gjakut nga pala zullumqare dhe sulmuese, ajo është përgjegjëse dhe fajtore për gjakun e saj, apo siç themi ndryshe, gjaku i tyre shkon dëm, edhe nëse janë myslimanë, pasi mendohet që konflikti dhe lufta ndodhën ndërmjet dy grupeve besimtarësh.

Islami e ndalon padrejtësinë, edhe nëse ajo të shpie te lufta kundër të padrejtit, sepse çmimi i drejtësisë është shumë më i shtrenjtë sa vetë gjaku i myslimanëve, por kjo nuk duhet të ndodhë, përveçse kur janë konsumuar të gjitha mundësitë paqësore për pajtim.

Më pas, ajeti përmend detyrën e tretë: **"...E, nëse kthehet, atëherë pajtojini ata midis tyre, me drejtësi..."**. Pra, myslimanët nuk duhet të pajtohen me anë të gjykimit të fuqisë, dhunës së imponuar prej fuqisë së sektit apo grupit, por, më parë, duhet të përpiqen t'i pajtojnë. Pajtimi është faktori më i rëndësishëm për shkuljen e arsyeve dhe rrënjëve të konfliktit. Në të kundërt, me kalimin e kohës, zullumqari e ndien fuqinë te vetja dhe hidhet sërish në sulm, për të shkaktuar kështu një konflikt të ri, më dramatik se i pari.

Disa komentues kanë thënë se prej fjalës *"bil adl"* - *"me drejtësi"*, mund të kuptojmë, nëse do të kemi të bëjmë me një të

drejtë të humbur ndërmjet dy grupeve, apo me gjak të derdhur e çështje të ngjashme me to, të cilat përbëjnë burim konflikti. Këto duhet t'i rregullojmë, përndryshe nuk mund të quhet rregullim, korrigjim, riparim apo paqtim me drejtësi.[1]

Duke qenë se ekzistojnë disa shtysa të brendshme, të cilat burojnë nga thellësia e ndërgjegjes, që i shtyn disa njerëz të jenë të njëanshëm, kur gjykojnë mes dy grupeve, zbriti Kur'ani, për t'i paralajmëruar myslimanët, duke pohuar kështu edhe rregullin e katërt: **"...me drejtësi dhe paanësi, sepse All'llahu i do ata që veprojnë me drejtësi."**, sepse All'llahu i do ata që veprojnë me drejtësi."[2]

Ajeti tjetër, vjen për të përcaktuar arsyen e për ta përforcuar këtë çështje: **"Në të vërtetë, besimtarët janë vëllezër, prandaj pajtojini vëllezërit tuaj midis tyre..."**.

Ashtu si përpiqeni për të pajtuar mes tyre dy vëllezër të një gjaku, ashtu duhet të mos leni përpjekje pa bërë, por ama, me drejtësi të plotë, për t'i futur besimtarët e përfshirë në konflikt, në rrugën e pajtimit.

Sa e bukur dhe sa shprehëse vjen kjo shprehje, teksa Kur'ani përmend e kujton se të gjithë besimtarët janë vëllezër, se konflikti ndërmjet tyre është konflikt ndërmjet vëllezërish, kështu

[1] Tefsiri "El Mizan", vëll. 18, f. 342.

[2] Fjala *"muksitinë"* buron nga fjala *"el kist"*. Kuptimi i saj, në origjinë, është ndarja e barazisë. Sa herë vjen në formën e foljes, me tri shkronja *"kist"*, të ngjashme me foljen *"derebe"*, nënkupton padrejtësinë dhe tejkalimin e pjesës së të tjerëve padrejtësisht. Kur ajo vjen me tri shkronja të shtuara, si p.sh: *"eksata"*, nënkupton dhëniën e pjesës me drejtësi. A kanë *"el kistu"* dhe *"el adlu"* të njëjtin kuptim?! Lidhur me këtë, është bërë një studim, në fundin e ajetit 29 të sures "El A'raf".

që në vend të konfliktit, duhet të angazhohemi që të mbjellim paqen dhe pajtimin mes tyre.

Në shumë raste, (lidhjet) zgjidhja e konflikteve nëpërmjet këtyre metodave, është më efikase sa vetë rregullat e njohura prej palëve, ndaj dhe Kur'ani Famëlartë thotë: **"...Kijeni frikë All'llahun, në mënyrë që ju të mëshiroheni."**.

Në këtë mënyrë, qartësohet njëra prej përgjegjësive më të mëdha që myslimanët kanë ndaj njëri-tjetrit, duke vendosur dhe duke zbatuar drejtësinë shoqërore në të gjitha dimensionet e saj.

Dy hulumtime

Hulumtimi i parë: Kushtet për shpalljen e luftës ndaj sulmuesve *(el bugat)*

Në jurisprudencën islame, kur trajtohet çështja e xhihadit, gjendet një kapitull, i titulluar "Lufta ndaj sulmuesve". Kjo nënkupton luftën e shpallur ndaj të gjithë zullumqarëve, të cilët kundërshtojnë Imamin e drejtë të myslimanëve. Për ta, në këtë kapitull, ekzistojnë shumë gjykime juridike islame.

Çështja që trajton ajeti i mësipërm, përbën një tjetër problematikë. Ajo është e lidhur me konfliktin ndërmjet dy grupimeve besimtare, kështu që në këtë rast, nuk kemi të bëjmë me kundërshti apo refuzim të pushtetit të Imamit të drejtë apo

qeverisë së ndershme islame. Disa juristë dhe komentues myslimanë u përpoqën të përfitojnë prej këtij ajeti, për çështje të mëparshme, por, ky argumentim, ashtu si thotë edhe El Fadilu, (El Mikdad) te libri "Kenzul Irfan", është një gabim i dukshëm,[1] sepse kundërshtia ndaj Imamit të drejtë e bën mohimin të detyrueshëm, ndërkohë që konfliktin mes besimtarëve, e bën të detyrueshëm vetëm shthurja dhe jo mohimi. Për këtë arsye, ata u quajtën dy grupe besimtarësh dhe në Kur'anin Famëlartë u konsideruan vëllezër, prandaj nuk lejohet përgjithësimi i gjykimeve ndaj "*ehli el begij" - "sulmuesve*".

Mund ta konsiderojmë fatkeqësi faktin, se në jurisprudencën islame nuk mund të gjejmë një studim për gjykimet islame, lidhur me këtë kategori njerëzish, por, prej ajetit të mësipërm, duke përfshirë edhe supozime të tjera, veçanërisht, ato të përmendura te kapitulli i "Urdhëresës për të mirën dhe ndalimin e të keqes", mund të arrijmë në gjykimet e mëposhtme:

1- Pajtimi ndërmjet dy grupeve myslimane të konfliktuara, është *vaxhib Kifai*. Detyrim për të gjithë**,** derisa të dalë dikush e ta bëjë. Atëherë ngrihet detyrimi prej të tjerëve.

2- Për realizimin e kësaj çështjeje duhet, së pari, përkujdesja për normalitetin e masave, duke filluar nga masat e lehta, sipas rregullit që thotë: më të lehtën dhe më të lehtën. Ndërsa, në rastet, kur kjo metodë nuk funksionon, atëherë ndërhyrja me forcë përmes luftës, përveçse e lejueshme, bëhet ndonjëherë edhe e detyrueshme.

[1] "Kenzul Irfan fi Fikhil Kur'an", Libri "Xhihadi", kreu "Llojet e tjera të xhihadit", vëll. 1, f. 386.

3- Gjaku i derdhur dhe pasuria e humbur e sulmuesve shkojnë dëm, sepse gjykimi i sheriatit, në këtë rast, është realizuar, kështu që detyra është kryer. Në situata të tilla, parimi është mungesë e sigurisë.

4- Nuk nevojitet leja e pushtetarit të sheriatit për kryerjen e asnjërës prej masave të lehta të pajtimit, siç janë bisedimet dhe negociatat me palët respektive. Por, është e domosdoshme leja e tij, kur puna vështirësohet, veçanërisht kur çështja nis të marrë përmasa të konfliktit të përgjakshëm. Në këtë rast, nuk lejohet, në asnjë mënyrë, ndërmarrja e ndonjë hapi, pa u pajisur më parë me lejen e qeverisë islame dhe të pushtetarit të sheriatit, përveç atyre rasteve kur mbërritja te pushtetari islam, është tërësisht e pamundur. Në këto raste, janë të ndershmit, të drejtët dhe profesionisët e besimtarëve, ata që duhet të marrin një vendim, ashtu siç ata, e shohin të përshtatshëm.

5- Në ato raste, kur grupi zullumqar i sulmuesve derdh gjakun apo grabit pasurinë e ndërmjetësuesve, atëherë Ligji i Sheriatit i siguron këta të fundit, që ndaj zullumqarëve të veprojë ligji islam, sipas dispozitave për çdo rast, që do të thotë, vrasje me paramendim, ose grabitje. Situata është e ngjashme, edhe në rastet kur derdhet gjaku i grupit mbi të cilin ka vepruar padrejtësia, apo grabitet pasuria e tyre. Edhe në këtë rast, kemi sigurinë e veprimit të ligjit të sheriatit. Pretendimi i atyre që mendojnë, se pas arritjes së pajtimit ndërmjet palëve, pala zullumqare nuk mban përgjegjësi për gjakun e derdhur dhe pasurinë e shpërdoruar, me pretekstin se kjo çështje nuk përmendet në ajet, është i pavërtetë, pasi ajeti nuk merr përsipër të sqarojë të gjitha çështjet e këtij rasti. Për këtë arsye, duhet t'u referohemi rregullave të qarta dhe të

mirëpërcaktuara te kapitulli i Kisasit, dënimit sipas ligjit të sheriatit dhe shpërdorimit.

6- Duke qenë se qëllimi i kësaj lufte, është detyrimi i grupit zullumqar, për të pranuar të vërtetën, në këtë rast, nuk kemi të bëjmë me robër dhe me plaçkë lufte, pasi të dyja grupet pjesëmarrëse në konflikt janë myslimanë. Për sa i përket ndalimit, marrjes peng të përkohshëm, me qëllim shuarjen e zjarrit të ngatërresës, nuk ka ndonjë ndalesë, por menjëherë pas shuarjes së konfliktit, ata duhet të lirohen me shpejtësi.

7- Ndonjëherë, mund të ndodhë që të dyja palët në konflikt, të jenë zullumqare, si për shembull: njëra palë zullumqare ka sulmuar një grup të palës tjetër, duke derdhur gjak dhe duke grabitur pasurinë e tyre. Pala tjetër ka derdhur gjakun dhe ka grabitur pasurinë e të parës, por, të dyja palët, nuk janë të bindura se kanë derdhur aq gjak e kanë grabitur aq pasuri, sa të përcaktojnë qartë, se cila prej tyre ka bërë zullumin më të madh apo më të vogël. Natyrshëm, që nuk gjendet në Kur'anin Famëlartë një ajet, i cili mund të përcaktojë qartë gjykimin islam, lidhur me situatën në fjalë, por këtë gjykim mund ta përftojmë nëpërmjet pezullimit të veçorisë, në ajetin objekt të studimit tonë, duke thënë se është detyrë e myslimanëve, që të pajtohen ndërmjet dy grupeve. Në rast se grupet nuk bien në ujdi me propozimin për pajtim, atëherë ato duhet të luftohen në tërësi, derisa secili prej tyre të kthehet tek urdhri dhe Rruga e All'llahut. Pra, mbi ata të gjithë, rëndojnë gjykimet islame, të përmendura më lart, që lidhen me Dispozitat islame dhe dënimet përkatëse për secilin prej sulmuesve apo zullumqarëve të palëve respektive. Përfundimisht, këto komente përforcojnë edhe njëherë, se gjykimi për këta zullumqarë, ndryshon nga gjykimi për ata që ngrihen në

fytyrë të Imamit të Pagabueshëm apo qeverisë së drejtë islame. Kjo kategori njerëzish, gjendet nën trysninë e gjykimeve akoma më të rënda dhe më të ashpra, që përmenden te kapitulli i xhihadit në librat e jurisprudencës islame.

Hulumtimi i dytë: Rëndësia e vëllazërisë islame

Fjalia: **"Në të vërtetë, besimtarët janë vëllezër"**, përmendur në ajetin 10, është një prej parullave më të rëndësishme, që i ka rrënjët në Islam. Është një parullë e thellë, elokuente, ndikuese dhe mbart në vetvete një kuptim të madh simbolik.

Kur njerëzit dëshirojnë të tregojnë lidhjet e tyre të ngushta, apo të gjithë ato, që u bashkohen në metodikë dhe punë, këta i quajnë thjesht *shokë* ose *shok*, në numrin njëjës. Në të vërtetë, Islami ka shkuar më tej në këtë drejtim. Nivelin e lidhjes dhe të marrëdhënies e ngriti, duke e konsideruar si nivelin e lidhjes më të ngushtë, që mund të ekzistojë midis dy njerëzve. Kjo është marrëdhënia vëllazërore, marrëdhënie që ndërtohet mbi baza të mirëfillta barazie.

Duke u mbështetur në këtë bazë të rëndësishme të Islamit, arrijmë në përfundimin se të gjithë myslimanët, pavarësisht përkatësive fisnore, kombëtare dhe gjuhësore, pavarësisht edhe moshës të tyre, e ndiejnë thellë lidhjen vëllazërore mes vetes, pavarësisht se disa jetojnë në Lindje dhe disa të tjerët në Perëndim.

Shembull i qartë për këtë është bashkimi i myslimanëve nga pika të ndryshme të botës dhe kryerja e përbashkët e ritualeve të Haxhit në Qendrën e Njësimit Botëror. Aty shpaloset qartë kjo marrëdhënie e ngushtë, kjo lidhje e harmoni mes ritualit dhe ndjenjave të tyre. Të gjitha këto bashkë, e bëjnë realitet këtë ligjësi të rëndësishme të Islamit.

Me fjalë të tjera, Islami i sheh të gjithë myslimanët si një familje e vetme dhe u drejtohet të gjithë atyre, duke i konsideruar vëllezër e motra, jo vetëm me fjalë e parulla, por edhe me vepra e aksione të përbashkëta e të ngjashme, si vëllezër e motra që janë.

Te transmetimet e ndryshme islame, gjejmë raste të shumta që e vërtetojnë dhe e mbështesin këtë parim, veçanërisht për sa i përket pjesës praktike të kësaj tabloje. Për ta ilustruar tablonë, po sjellim disa shembuj konkretë, shkëputur prej haditheve të mëposhtme:

1- Transmetohet prej me bujarit të Profetëve, Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, se ka thënë: *"Myslimani është vëlla për myslimanin! Ai nuk i bën padrejtësi atij, as nuk e poshtëron dhe as nuk e dorëzon tek armiku!"*.[1]

2- Transmetohet prej Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* se ka thënë: *"Shembulli i dy vëllezërve, është si shembulli i dy duarve, të cilat e lajnë njëra-tjetrën!"*.[2]

3- Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: *"Besimtari është vëlla për besimtarin! Shembulli i tyre është si shembulli i trupit të*

[1] "El Mehaxhetul Bejda", vëll. 3, Libri "Shoqërimi dhe miqësia", K. 2, f. 332.
[2] Burimi i mëparshëm, f. 319.

njeriut. Sa herë ndien dhimbje një pjesë e tij, ndiejnë dhimbje edhe pjesët e tjera të trupit. Shpirtrat e tyre janë si një shpirt i vetëm!".[1]

4- Në një tjetër hadith të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* lexojmë: *"Besimtari është vëlla për besimtarin! Ai është syri i tij, udhërrëfyesi i tij, nuk e tradhton atë, nuk i bën padrejtësi, nuk e mashtron dhe, kur i premton diçka, e mban fjalën!"*.[2]

Ekzistojnë edhe shumë transmetime në librat e njohur islamë të haditheve, që lidhen me të drejtat e besimtarit ndaj vëllait të tij mysliman, me të drejtat e besimtarëve ndaj njëri-tjetrit, me shpërblimin që rezervohet për vizitën e vëllezërve besimtarë, përshëndetja dhe përqafimi, kur kujtojnë njëri-tjetrin, kur fusin lumturi në zemrat e njëri-tjetrit, kur zgjidhin hallet e njëri-tjetrit, kur bëjnë të pamundurën për t'ia hequr njëri-tjetrit ankthin, trishtimin dhe mërzinë, kur ushqejnë të paushqyerin, kur veshin të zhveshurin, kur nderojnë dhe respektojnë varfërinë. Të gjitha këto çështje mund t'i gjeni te kapitujt që lidhen me titujt e mësipërm, në librin "Usulul Kafij".

5- Në fund të këtij udhëtimi, sjellim për lexuesin, një prej transmetimeve më gjithëpërfshirëse, që trajton çështjen e të drejtave të besimtarit ndaj vëllait të tij besimtar, që të mbledhura bashkë, arrijnë në tridhjetë të drejta.

I Dërguari i All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: *"Myslimani ka tridhjetë të drejta te vëllai i tij. Nuk mund të çlirohet prej tyre, përveçse duke i zbatuar ato,*

[1] "Usulul Kafij, vëll. 2, K. "Vëllazëria e myslimanëve me njëri-tjetrin", Hadithet 3-4, f. 133.
[2] Burimi i mëparshëm.

apo të falet për moszbatimin e tyre. Ai ia fal gabimin atij. Ia respekton atij veçorinë. E mbron atë. E viziton, kur sëmuret. E përcjell xhenazen e të afërmit të tij. I përgjigjet thirrjes së tij, e pranon dhuratën e tij. Mban lidhje me të. E falënderon për të mirën që i bën. E ndihmon atë me sa të mundet. E merr në mbrojtje gruan e tij, sa herë nevojitet. E zgjidh hallin e tij. Ia fal atë që i ka dhënë, nëse mundet. I thotë 'erhamukell'llah', kur teshtin. E udhëzon, kur e sheh të humbur. I kthen selamin. I thotë fjalë të mira. Sillet mirë me kafshën e tij. E beson, kur betohet. Mban miqësi me miqtë e tij. Nuk armiqësohet me të. E ndihmon, kur u bën njerëzve padrejtësi, duke e ndaluar atë prej padrejtësisë së tij, sikurse e ndihmon, kur të tjerët i bëjnë padrejtësi, duke e ndaluar padrejtësinë e tyre të bjerë mbi të dhe duke e ndihmuar t'u kthejë hakun. Nuk e dorëzon atë tek armiku i tij. Nuk e poshtëron. Ia dëshiron atij të gjitha të mirat që dëshiron për veten. Urren t'i ndodhë atij ndonjë e keqe, që nuk dëshiron t'i ndodhë vetes.".[1]

Gjithsesi, njëra prej detyrave dhe të drejtave më të rëndësishme, që myslimanët kanë ndaj njëri-tjetrit, është çështja e ndihmës dhe e pajtimit me njëri-tjetrin, sa herë që ndërmjet tyre ndodh ndonjë konflikt apo ngatërresë, ashtu si përmendet në ajetet dhe transmetimet e mësipërme. Në këtë komentim, kemi pasur edhe një hulumtim, lidhur me pajtimin ndërmjet besimtarëve, saktësisht, në fundin e ajetit të parë, të sures "El Enfal".

[1] "Biharul Anuar", vëll. 74, f. 236.

Ajetet 11 - 12

يَٰٓأَيُّهَا ٱلَّذِينَ ءَامَنُواْ لَا يَسۡخَرۡ قَوۡمٞ مِّن قَوۡمٍ عَسَىٰٓ أَن يَكُونُواْ خَيۡرٗا مِّنۡهُمۡ وَلَا نِسَآءٞ مِّن نِّسَآءٍ عَسَىٰٓ أَن يَكُنَّ خَيۡرٗا مِّنۡهُنَّۖ وَلَا تَلۡمِزُوٓاْ أَنفُسَكُمۡ وَلَا تَنَابَزُواْ بِٱلۡأَلۡقَٰبِۖ بِئۡسَ ٱلِٱسۡمُ ٱلۡفُسُوقُ بَعۡدَ ٱلۡإِيمَٰنِۚ وَمَن لَّمۡ يَتُبۡ فَأُوْلَٰٓئِكَ هُمُ ٱلظَّٰلِمُونَ١١ يَٰٓأَيُّهَا ٱلَّذِينَ ءَامَنُواْ ٱجۡتَنِبُواْ كَثِيرٗا مِّنَ ٱلظَّنِّ إِنَّ بَعۡضَ ٱلظَّنِّ إِثۡمٞۖ وَ لَا تَجَسَّسُواْ وَلَا يَغۡتَب بَّعۡضُكُم بَعۡضًاۚ أَيُحِبُّ أَحَدُكُمۡ أَن يَأۡكُلَ لَحۡمَ أَخِيهِ مَيۡتٗا فَكَرِهۡتُمُوهُۚ وَٱتَّقُواْ ٱللَّهَۚ إِنَّ ٱللَّهَ تَوَّابٞ رَّحِيمٞ١٢

“O ju që keni besuar! Asnjë burrë prej jush të mos tallet me burra të tjerë, se këta mund të jenë më të mirë se ai. Gjithashtu, asnjë grua të mos tallet me gra të tjera, se këto mund të jenë më të mira se ajo. Mos e nënçmoni dhe mos e qesëndisni njëri-tjetrin me nofka (të këqija)**! Sa e shëmtuar është të thirresh me emër të keq pas** (pranimit të) **besimit! Ata që nuk pendohen, janë vërtet keqbërës.”**

“O ju që keni besuar! Mënjanoni shumë dyshime, se, vërtet, disa dyshime janë gjynah. Mos e spiunoni dhe mos e përgojoni njëri-tjetrin! Mos vallë dëshiron ndokush prej jush të hajë

mishin e vëllait të vet të vdekur?! Sigurisht që ju do ta urrenit këtë! Kijeni frikë All'llahun! Me të vërtetë, All'llahu është Pranues i pendimit dhe Mëshirëplotë."

Shkaku i zbritjes

Komentuesit e Kur'anit kanë cituar jo një, por shumë shkaqe dhe arsye për zbritjen e ajetit 11. Një prej tyre thuhet, se fjalia: **"Asnjë burrë prej jush të mos tallet me burra të tjerë"**, ka zbritur për ligjëruesin e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* Thabit ibn Kajsin, i cili kishte vështirësi me dëgjimin, prandaj sa herë hynte në xhami, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i bënte vend të ulej pranë, për të dëgjuar hadithet e tij. Një herë, kur ai hyri në xhami, myslimanët e kishin kryer faljen e namazit dhe secili ishte ulur në vendin e tij. Ndërkohë që ecte, ai, u thoshte besimtarëve që gjendeshin aty, t'i hapnin rrugën, derisa mbërriti te një mysliman, që i tha: "Ulu, ti e ke vendin këtu!". Ai u ul i zemëruar pas tij, por, sa u largua errësira, Thabiti, e pyeti: "Kush je ti?!"

Tjetri u përgjigj: "Unë jam filani."

Thabiti i tha: "Je Thabiti, i biri i filanes?! - duke përmendur me një llagap të shëmtuar emrin e nënës së tij, e cila kishte qenë e njohur në kohën para Islamit. Burrit i erdhi rëndë dhe uli kokën

me dhimbje dhe keqardhje. Për këtë arsye, zbriti ajeti, që i ndalon myslimanët të kryenin sjellje si këto.

Është thënë, gjithashtu, se fjalia: **"Asnjë grua të mos tallet me gratë e tjera!"**, ka zbritur për Ummu Selemen, një prej bashkëshorteve të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, pasi ajo vishte një rrobë të caktuar, por rroba që vishte, ishte disi e shkurtër, kështu që gratë talleshin më të, sa herë e shihnin. Për këtë arsye, zbriti ajeti dhe u ndaloi myslimaneve sjellje të tilla.

Kanë thënë se fjalia: **"Mos e përgojoni njëri-tjetrin!"**, ka zbritur për dy sahabë, të cilët përgojuan shokun e tyre të përbashkët, Selmanin, pasi e kishin dërguar për te Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, që të sillte ushqim për ta. Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e dërgoi Selmanin tek Usama bin Zejdi, i cili ishte përgjegjës për financat e myslimanëve, shtëpia e parasë së myslimanëve. Por, Usama i tha atij: "Nuk kam asgjë për momentin.". Kështu që ata e përgojuan Usamën, duke e cilësuar koprrac, kurse për Selmanin thanë: "Edhe sikur ta kishim dërguar te pusi i Semihes, pus i njohur i kohës për ujin e bollshëm, do ia kishte mbaruar ujin.".

Më pas, ata u nisën në drejtim të Usamës, me qëllim që ta përgjonin. Por Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* u tha: *"Në gojët tuaja, shoh shenjat e mishit, të ngrënë prej jush."*.

Ata iu përgjigjën: *"O i Dërguari i All'llahut, ne nuk kemi ngrënë mish sot."*.

I Dërguari i All'llahut u tha: *"Keni ngrënë, si s'keni ngrënë! Keni ngrënë prej mishit të Selmanit dhe të Usamës!"*. Menjëherë zbriti ajeti që i ndalon myslimanët të përgojojnë njëri-tjetrin.[1]

Komentimi

Tallja, dyshimi, përgojimet, spiunllëku dhe llagapet e shëmtuara janë haram!

Duke qenë se Kur'ani Famëlartë, i ka dhënë rëndësi ndërtimit të shoqërisë islame mbi baza të mirëfillta të mirësjelljes, pas trajtimit të detyrave për raste konfliktesh dhe përplasjesh mes myslimanëve të grupimeve të ndryshme, vjen me dy ajetet, 11-12, për të përcaktuar një pjesë të rëndësishme të rrënjëve të këtyre konflikteve. Kur'ani i orienton myslimanët t'i këpusin këto rrënjë, në mënyrë që të shmangin konfliktet dhe përplasjet ndërmjet tyre.

Te të dyja ajetet e përmendura më sipër, shprehen në mënyrë të qartë dhe elokuente tri çështje, ku secila prej tyre mund të jetë shkëndi, që mund të ndezë konfliktin dhe përplasjen mes myslimanëve. Ajeti 11 thotë: **"O ju që keni besuar! Asnjë burrë prej jush të mos tallet me burra të tjerë, se këta mund të jenë më të mirë se ai. Gjithashtu, asnjë grua të mos tallet me gra të tjera, se këto mund të jenë më të mira se ajo..."**.

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 9, f. 135 dhe Kurtubiu, te tefsiri i tij, e ka cekur këtë çështje me pak ndryshim.

All'llahu i Madhëruar, nëpërmjet këtyre ajeteve, u drejtohet të gjithë besimtarëve, burrave dhe grave, duke i paralajmëruar të gjithë e duke i ftuar ata, që të heqin dorë prej punëve të ndyra, pasi në themelet e talljes, fyerjes dhe poshtërimit, gjendet ndjenja e kryeneçësisë, e vetëpëlqimit, e mendjemadhësisë dhe e të ngjashmeve me to. Cilësi dhe veprime si këto, kanë qenë vazhdimisht shkaktare të shumë luftërave shkatërrimtare përgjatë historisë.

Ky vetëpëlqim e kjo mendjemadhësi, buron kryesisht prej superioritetit material dhe mbivlerësimit të gjendjes ekonomike. Kjo bën që dikush ta konsiderojë veten më të pasur se të tjerët, më të bukur se të tjerët, apo se vjen prej një fisi apo rrethi familjar më i njohur se të tjerët. Ky përfytyrim, mund ta shtyjë atë të besojë, se është më i mirë se një grup i caktuar njerëzish e ka superioritet në dije dhe adhurim ndaj tyre. Kjo ndjenjë, e shtyn atë të tallet me ta e t'i përçmojë, ndërkohë, që njësia matëse për pozicionin e secilit tek All'llahu i Lartësuar, është përkushtimi dhe devotshmëria, të cilat janë në harmoni të plotë më pastërtinë e zemrës, sinqeritetin e qëllimit, modestinë, mirësjelljen dhe edukatën.

Nisur për sa përmendëm më lart, askujt nuk i lejohet të pretendojë, se është më i mirë dhe më i rëndësishëm tek All'llahu, se të tjerët. Për këtë arsye, mendjemadhësia dhe poshtërimi i njerëzve, konsiderohet prej punëve më të poshtra dhe sjelljeve më të këqija, që mund ta reflektojë të keqen në jetën e njerëzve.

Ndërsa, në pjesën e dytë të ajetit, thuhet: **"...Mos e nënçmoni njëri-tjetrin...!"**.

Fjala "*telmizu*", buron nga fjala "*lemz*", e ngjashme me fjalën "*tanz*". Kuptimi i saj është: *ndjekja, survejimi* dhe *etiketimi* i të tjerëve. Disa komentues kanë bërë dallimin mes fjalës "*el hem*" dhe "*el lemz*", duke thënë se fjala "*el lemz*" është të përmendësh *të metat* e njerëzve në praninë e tyre, ndërsa fjala "*el hem*" është të përmendësh *të metat* e të tjerëve, kur ata nuk janë të pranishëm. Është thënë, gjithashtu, se fjala "*el lemz*" është ndjekja e *të metave* të tjetrit me sy dhe me shenjë, ndërkohë që fjala "*el hem*" është përmendja e *të metave* të tjetrit me gojë. Një shpjegim më të detajuar, lidhur me këtë, do ta bëjmë kur të komentojmë suren "El Humezeh".

Është interesant dhe njëkohësisht me rëndësi fakti se nëpërmjet fjalës "*bi enfusikum*" – "*njëri-tjetrin*", Kur'ani Famëlartë tregon për unitetin e myslimanëve dhe se, në thelb, ata kanë përbërje të ngjashme. Këtu bëhet i qartë fakti, se të gjithë besimtarët janë si një shpirt i vetëm, që do të thotë se ai që shan apo ofendon tjetrin, në të vërtetë, ka ofenduar dhe ka nënçmuar veten e tij.

Në fazën e tretë të orientimeve të tij, Kur'ani sjell një tjetër fjali: **"...Mos e qesëndisni njëri-tjetrin me nofka** (të këqija)**...!"**.

Shumë personazhe injorantë e të paformuar, që prej lashtësisë e deri në ditët e sotme, pra, prej të shkuarës e deri në të tashmen, kanë si profesion etiketimin e njerëzve me fjalë të ndyra. Nisur nga kjo, ata poshtërojnë të tjerët, duke shkatërruar kështu, personalitetin e tyre. Shpeshherë i përdorin këto forma, për t'u hakmarrë ndaj tyre. Një person i caktuar mund të ketë bërë në të shkuarën vepra të ndaluara, por më pas është penduar, është përulur me sinqeritet, duke kërkuar falje tek All'llahu i

Madhëruar, megjithëse, për fat të keq, shohim disa njerëz t'u thërrasin atyre me llagape e nofka të këqija, që zbulojnë të shkuarën e tyre.

Islami është shprehur qartë për këtë, ai e ka ndaluar rreptësisht vendosjen e emrave apo të llagapeve të papëlqyera, që ndikojnë në poshtërimin e myslimanit.

Lexojmë në disa hadithe, të flitet për Safijeh bint Hajij bin Akhtabin, gruan çifute, që pranoi Islamin, pas çlirimit të Khajberit, e cila u bë dhe gruaja e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Një ditë, Safija shkoi duke qarë te Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Kur, ai e pyeti për arsyen e përlotjes së saj, ajo i tha: "*Aishja më ka sharë, më ka thënë, 'o bijë çifuti!'*".

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, qetësisht, iu përgjigj: "*Përse nuk i the asaj: 'Babai im është Haruni, xhaxhai im Musai dhe burri im Muhammedi.'?*". Më pas zbriti ky ajet, objekt i studimit tonë.[1]

Ajeti erdhi për të theksuar se sa e shëmtuar është të thirresh me emër të keq, pas pranimit të besimit, që do të thotë se, është shumë e turpshme që, pas hyrjes në linjën e besimit, t'i thërrasësh njerëzit me cilësinë e kohës së kufrit, të mohimit: **"...Sa e shëmtuar është të thirresh me emër të keq pas** (pranimit të) **besimit...!"**.

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 9, f. 136.

Disa komentues ngritën një tjetër hipotezë, lidhur me kuptimin e ajetit të mësipërm, duke thënë se All'llahu i Madhëruar nuk lejon që besimtarët të pranojnë të mbajnë emrat e kohës së shthurjes dhe të injorancës, për të vetmen arsye, për të shmangur talljen e tyre. Por, duke iu kthyer fillimit të ajetit dhe shkakut të zbritjes së tij, mund të themi se komenti i parë është më pranë së vërtetës.

Në fund, ajeti vjen me një tjetër përforcim, për kuptimet e mësipërme dhe thotë: **"...Ata që nuk pendohen, janë vërtet keqbërës."**.

E ku ka zullum dhe padrejtësi më të madhe se të shash, të etiketosh, të poshtërosh njerëzit me fjalë të ulëta, të poshtra, të ndyra, duke sulmuar zemrat e besimtarëve, që konsiderohen si qendrat më të rëndësishme, ku rritet dashuria e tyre për All'llahun?! Ku ka më keq se të shkatërrosh personalitetin e njerëzve e të nëpërkëmbësh nderin e tyre, që është themeli mbi të cilin lulëzon karakteri?! Ai është cipa e fytyrës së tyre, për të cilën jetojnë.

Thamë se në secilin prej dy ajeteve, objekt të studimit tonë, gjenden nga tri gjykime islame, që lidhen me moralin shoqëror. Kështu, tri gjykimet e ajetit të parë, janë: mos tallja, largimi prej nënçmimit, largimi prej vendosjes së llagapeve të shëmtuara.

Ndërsa, tri gjykimet e ajetit të dytë, janë: mënjanimi i dyshimeve, mënjanimi i spiunimit, mënjanimi i përgojimit. Në këtë ajet kur'anor thuhet: **"O ju që keni besuar! Mënjanoni shumë dyshime, se, vërtet, disa dyshime janë gjynah..."**

Nëpërmjet sifjalisë: **"...Mënjanoni shumë dyshime...!"**, nënkuptohen dyshimet dhe mendimet e këqija, që tejkalojnë mendimet e mira mes njerëzve. Për këtë arsye u përmend fjala "*shumë*", përndryshe, mendimi i mirë për njerëzit, jo vetëm që është i lejuar, por është prej veprave të pëlqyera, siç dëshmohet tek ajeti 12 i sures "En Nur": **"Kur e dëgjuat këtë përgojim, përse besimtarët dhe besimtaret nuk menduan mirë për njëri-tjetrin e të thoshin: "Kjo është shpifje e qartë?!"**.

Një tjetër fakt që tërheq vëmendjen, është ndalesa prej shumë dyshimeve, por në pozitën e sqaruesit dhe të arsyetuesit, ajeti, gjithashtu, thotë se disa dyshime janë gjynah. Ky ndryshim dhe kjo diferencë në mënyrën e të shprehurit, lind prej faktit se disa dyshime të këqija përputhen me realitetin, ndërsa disa të tjera, janë në kundërshtim me të. Prandaj, të gjitha dyshimet e të këqijat që bien në kundërshtim me realitetin, nuk ka pikë dyshimi se janë gjynahe. Për këtë arsye, në ajet thuhet: **"...Vërtet, disa dyshime janë gjynah...!"**. Nisur nga kjo, mjafton që një pjesë e dyshimeve të shpallen gjynahe, që të gjitha dyshimet të konsiderohen si gjynahe, me të vetmin qëllim, për të shmangur rënien në gjynah.

Prej këtu lind pyetja: Duke ditur se mendimi i keq dhe mendimi i mirë, përgjithësisht, nuk janë produkt i përzgjedhjes sonë të lirë, por secili prej tyre është rezultat që ndikohet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga një varg i gjatë ngjarjesh e të dhënash, që vijnë përtej lirisë sonë të përzgjedhjes dhe pasqyrohen në mendje, atëherë, si mund të konsiderohet korrekte ndalesa prej tyre?!

Për t'i dhënë përgjigje kësaj pyetjeje, mund të themi:

1- Qëllimi i kësaj ndalese është ruajtja prej sistemimit të ndikimeve, që do të thotë se, sa herë që imagjinata e myslimanit sulmohet prej një mendimi të keq, nuk i duhet dhënë rëndësi, sikurse nuk duhet ta lejojmë këtë mendim, që të na shtyjë të ndryshojmë sjelljen tonë me atë njeri, apo të reformojmë natyrën e lidhjes sonë më një palë të caktuar. Nisur nga kjo, mund të themi se gjynahu ndodh, kur ne ndikohemi dhe i japim rëndësi ndikimit prej ndonjë mendimi. Për këtë qëllim, do të lexojmë një hadith të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: *"Tri janë sjelljet që nuk pëlqehen te besimtari. Këto sjellje e kanë një rrugëdalje. Qëllimi i tyre është të çlirohen prej gjykimit të njëri-tjetrit, duke u bazuar te dyshimi dhe mendimi i keq…"*[1] (deri në fund të hadithit).

2- Është plotësisht e mundur, që besimtari ta largojë mendimin e keq prej mendjes së tij. Këtë mund ta arrijë duke menduar çështje të ndryshme, si për shembull: mendimi rreth konsiderimit të së vërtetës, duke i dhënë formë brenda imagjinatës mundësisë së të vërtetesës. Vetëm kështu, në mënyrë graduale, do të arrijë të triumfojë ndaj mendimit të keq.

Nisur nga sa u tha më sipër, mund të pohojmë se mendimi i keq nuk është detyrimisht produkt i mendjes, apo rezultat i përzgjedhjes që mendja bën. Për këtë arsye, tek një prej ajeteve thuhet: **"Mendo më të mirën për vëllain tënd, derisa të kesh një të dhënë, që të detyron ta ndryshosh atë mendim! Mos e konsidero kurrë, si të keqe, fjalën e vëllait tënd, për sa kohë ke,**

[1] "El Mehaxhetul Bejda", vëll. 5, f. 269.

qoftë dhe një mundësi të vetme, që ta konsiderosh atë si të mirë.”.[1]

Gjithsesi, mund të themi se kjo çështje është një prej çështjeve dhe udhëzimeve më gjithëpërfshirëse dhe më të sakta, për sa u përket marrëdhënieve dhe lidhjeve shoqërore, të cilat sigurojnë harmoni e qetësi të plotë në shoqëri. Kjo do të sqarohet edhe më shumë në studimet e ardhshme.

Më pas, ajeti përmend spiunimin, duke thënë: **“...Mos spiunoni njëri-tjetrin...!”**.

Si fjala *“et texhessus”* edhe fjala *“et tehassus”*, nënkupton: *kërkimin*, *gërmimin* dhe *investigimin,* me ndryshimin e vetëm, se fjala e parë, zakonisht, përdoret për kërkimin e gjërave të panevojshme, ndërsa fjala e dytë është e kundërta e të parës, pasi ajo përdoret për të nënkuptuar kërkimin e gjërave të duhura e të dashura. Ky rast bëhet më i qartë, kur shohim në Kur’an se si Profeti Ja’kub këshillon djalin e tij: **“O bijtë e mi, shkoni e kërkoni lajme për Jusufin dhe vëllain e tij!”**.[2]

Në të vërtetë, mendimi i keq bëhet zakonisht motivues, që ne të arrijmë te spiunimi apo përgjimi. Spiunimi, nga ana e tij, na shtyn të zbulojmë të fshehtat dhe të nxjerrim në publik çështjet e tyre të padukshme apo të mbuluara dhe të fshehura mirë, por Islami nuk e lejon, për asnjë mënyrë, nxjerrjen e të fshehtave personale të njerëzve.

---

[1] “Usulul Kafij”, vëll. 2, K. “Akuza dhe mendimi i keq”, Hadithi 3. Një tekst me kuptim të ngjashëm me këtë, edhe pse me pak ndryshim, gjendet edhe te “Nehxhul Belaga”, Fjalët e shkurtra, Fjala 360.

[2] Sure “Jusuf”, ajeti 87.

Thënë ndryshe, Islami synon të mbrojë dhe të sigurojë plotësisht e nga të gjitha anët, jetën private të njerëzve. Natyrshëm, nëse Islami do të lejonte që secili të spiunojë apo të zbulojë jetën e të tjerëve, atëherë nderi dhe privatësia e tyre do të kërcënohej nga zhdukja. Kjo dukuri e shëmtuar, do ta shndërronte jetën e njerëzve në ferr, do t'i bënte ata të ndiheshin të sulmuar prej ankthit dhe shpërbërjes së vazhdueshme emocionale e psikologjike.

Natyrshëm që kuptime të tilla nuk bien në kundërshtim me idenë e ekzistencës së shërbimeve sekrete në qeverinë islame, me qëllim mbrojtjen e kësaj qeverie prej intrigave që mund të thurin armiqtë e saj. Por, kjo, në asnjë mënyrë, nuk do të thotë, që institucionet e inteligjencës kanë të drejtë të ndërhyjnë në jetën private të njerëzve, siç dhe do ta sqarojmë në vazhdim.

Si rrjedhim, në fund të këtyre udhëzimeve e orientimeve, ajeti shton atë që është rezultante e dy të parave, por njëkohësisht edhe pasojë e tyre. Në ajet thuhet: **"...Mos e përgojoni njëri-tjetrin...!"**.

Kështu pra, mendimi i keq është zanafilla e spiunimit. Spiunimi, në vetvete, detyrimisht bëhet shkak për përhapjen dhe zbulimin e të fshehtave. Kjo e fundit, nga ana e saj, nxit detyrimisht thashethemet dhe përgojimin. Islami i ndalon të gjitha këto, jo vetëm si shkaqe, por edhe si pasoja.

Kur'ani servir një shembull domethënës, në lidhje me këtë çështje. Për të treguar ligësinë e këtij zakoni, thotë: **"...Mos vallë dëshiron ndokush prej jush të hajë mishin e vëllait të vet të vdekur?! Sigurisht që ju do ta urrenit këtë...!"**.

Nuk ka asnjë dyshim se nderi dhe emri i vëllait tënd mysliman, është si mishi i trupit të tij, nëpërkëmbja e nderit dhe e cipës së fytyrës së tij, është sikur të kesh ngrënë prej mishit të tij.

Fjala "*mejten*", është përdorur këtu për të treguar se përgojimi ndodh në mungesë të personave që përfliten. Kështu që shembulli i tyre është si shembulli i të vdekurve, të cilët nuk janë të pranishëm dhe nuk mund të mbrojnë vetveten. Kjo është padrejtësia më e poshtër që mund të bëjë njeriu kundër vëllait të tij.

Në të vërtetë, ky krahasim e tregon qartë poshtërsinë e përgojimit dhe gjynahun e tij të madh. Transmetimet e ndryshme islame, ashtu si do t'i përmendim edhe në vazhdim, i kanë dhënë një rëndësi të veçantë çështjes së përgojimit, për rrjedhojë, rrallë mund të gjejmë vepra të ngarkuara me gjynahe deri në këtë gradë.

Ka shumë njerëz, që janë ndotur prej gjynahesh të tilla, por mund të ndodhë, që sedra dhe ndërgjegjja e tyre t'i zgjojë e t'i nxisë për ta rishikuar këtë gabim të madh, prandaj dhe vjen fundi i ajetit, që të hapë rrugën para tyre. All'llahu i Madhëruar thotë: **"...Kijeni frikë All'llahun! Me të vërtetë, All'llahu është Pranues i pendimit dhe Mëshirëplotë.".**

Pra, fillimisht, duhet të ngjallet shpirti i devotshmërisë e frika ndaj All'llahut të Madhëruar. Pendesa vjen bashkë me faljen dhe butësinë e All'llahut, që është rezultante e natyrshme e tyre.

Hulumtime

1- Siguria e plotë shoqërore

Në të vërtetë, gjashtë urdhëresat dhe udhëzimet e përmendura tek ajetet e mësipërme, siç janë: ndalesa prej talljes, vendosja e llagapeve, mendimi i keq, spiunimi dhe përgojimi, nëse nuk zbatohen në shoqëri, nuk ka dyshim se nderi dhe autoriteti i anëtarëve të asaj shoqërie janë të mbrojtura nga të gjitha anët. Kështu, askush nuk mund të tallet me të tjerët, duke treguar se është më i mirë se ata, apo të nxjerrë gjuhën jashtë, duke i nënçmuar ata. Askush nuk mund ta prekë nderin e tyre, duke përdorur llagape të këqija, ashtu sikurse nuk ka të drejtë të mendojë keq për ta dhe as të spiunojë jetën private të njerëzve, duke zbuluar nëpërmjet përgojimit të metat e tyre të mbuluara e të fshehura.

Thënë ndryshe, njeriu, në jetën e tij, ka në pronësi katër kapitale, të cilat duhet të mbrohen me kujdes nga kështjella e këtij ligji. Ato janë: jeta, pasuria, nderi dhe cipa.

Termat e përzgjedhura tek ajetet, objekt i studimit tonë, bashkë me transmetimet islame, tregojnë se nderi dhe cipa e njerëzve, janë po aq të rëndësishme, sa jeta dhe pasuria e tyre, madje mund të jenë edhe më të rëndësishme se ato, parë në disa aspekte të veçanta.

Islami synon që shoqëria njerëzore të jetojë në siguri e qetësi absolute, për këtë arsye, ai nuk mjaftohet vetëm me ndalimin e njerëzve që të godasin njëri-tjetrin me duar a armë, por

shkon më tej, duke siguruar qetësinë e njerëzve, edhe prej gjuhës e fjalëve të tyre, që ia adresojnë njëri-tjetrit. Islami e tejkalon edhe këtë kufi të kulturës dhe qytetërimit, duke vendosur një standard akoma më madhështor, që është mbrojtja e njerëzve, qoftë edhe prej mendimeve të këqija të të tjerëve. Pra, secili prej tyre ta ndiej njëri-tjetrin, të mos e sulmojë me breshëri shpifjesh, qoftë edhe në hapësirat e mendjes dhe të imagjinatës.

Ky është niveli më i lartë i sigurisë së imagjinuar ndonjëherë. Ajo nuk mund të realizohet, kurrsesi, përveçse në një shoqëri besimtare, e projektuar prej zbulesës hyjnore. Profeti i Mëshirës, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimet e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, lidhur më këtë aspekt, thotë: *"All'llahu i Madhëruar e ka bërë haram për myslimanin, gjakun e vëllait të tij mysliman, pasurinë e tij, nderin e tij, si dhe të mendojë keq, për të!"*.[1]

Mendimi i keq, përveçse e dëmton palën e shënjuar prej tij, duke e rrezikuar seriozisht atë, mbetet, gjithashtu, një e keqe e madhe edhe për vetë të zotin, pasi bëhet shkak për largimin e tij prej njerëzve dhe ndërprerjen e bashkëpunimit me ta. Gjithashtu, mendimi i keq, e shtyn personin, në fjalë, të krijojë botën e tij të egër, të vetmuar e të mënjanuar, iluzive, ashtu siç është përmendur edhe te hadithi i Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*: *"Ata që nuk kanë mendime të mira për njerëzit, do t'i urrejnë të gjithë njerëzit!"*.[2]

Me fjalë të tjera, veçoria dalluese e jetës njerëzore prej jetës shtazore, ose veçoria që i siguron jetës lëvizshmëri e shkëlqim, është, pa diskutim, shpirti i bashkëpunimit shoqëror. Kjo nuk

[1] "El Mehaxhetul Bejda", vëll. 5, f. 268.
[2] "Gurerul Hikem", f. 697, Hadithi 5333.

mund të realizohet pa u plotësuar ai mjedis shoqëror, në thellësinë e të cilit të sundojë mendimi i mirë për njerëzit. Ndërkohë që mendimi i keq shkatërron themelet e kësaj shtylle mbështetëse e të rëndësishme të shoqërisë, sepse arrin të shkëpusë lidhjet e bashkëpunimit dhe dobëson shpirtin e shoqërisë, motorin e saj lëvizës. E njëjta situatë krijohet edhe nga spiunimi e përgojimi.

Të gjithë ata që mendojnë keq për të tjerët dhe i paragjykojnë negativisht ata, përgjithësisht janë njerëz të vetmuar, nuk duan njeri dhe pushtohen nga një ndjenjë shumë e veçantë frike. Për ata nuk mund të gjendet kurrë një këshillues, që t'u largojë trishtimin dhe hallet, sikurse nuk gjejnë kurrë miqësi dhe partner, që të zhvillojnë në normalitet jetën e tyre sociale. Këta janë prej atyre njerëzve, që nuk gjejnë dikë për t'i ndihmuar në ditë të vështira.

Bëjmë mirë t'i kthehemi kësaj urtësie, e cila konsiston në faktin se përmendja e fjalës "*edh dhan'nu*", në këtë rast, *nënkupton dyshimin që nuk mbështetet në asnjë argument*. Nisur nga kjo, mund të themi se, nëse mendimi apo dyshimi mund të mbështetet në disa raste me argumente, ai bëhet dyshim i konsiderueshëm dhe nuk përfshihet prej këtij gjykimi islam (haram), siç mund të jetë për shembull, dyshimi i ngacmuar prej dëshmisë së dy njerëzve të drejtë e të besueshëm.

2- Mos spiunoni!

Dëshmuam më lart se Kur'ani i ndalon rreptësisht të gjitha llojet e spiunimit. Meqenëse, në ajet nuk përmendet asnjë kusht,

kuptojmë se spiunimi i çështjeve të të tjerëve dhe përpjekja për të përhapur nëpër njerëz të fshehtat e tyre, është pa dyshim gjynah, por supozimet e ndodhura brenda ajetit dhe jashtë tij, tregojnë se ky gjykim është i lidhur me jetën private e personale të njerëzve.

Ky gjykim, është i përshtatshëm edhe për jetën shoqërore të njerëzve, me kusht që të mos ndikojë dhe të mos jetë përcaktues mbi fatet e të ardhmes së shoqërisë.

Është e qartë, se, nëse gjykimi do të ketë lidhje me të ardhmen e shoqërisë, apo me të ardhmen e njerëzve të veçantë, çështja merr një tjetër natyrë. Nisur nga ky fakt, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* përgatiti e ngarkoi disa njerëz, për ta informuar dhe për të mbledhur informacionet e fshehta. Ata kishin detyrë të zbulonin natyrën e ngjarjeve e t'i hetonin ato, por kryesisht sasinë më të madhe të mundshme të ngjarjeve dhe informacioneve, që lidheshin me të ardhmen e shoqërisë.

Duke iu referuar kësaj logjike, themi se është e mundur, madje është e domosdoshme, që qeveria islame të përgatisë njerëz të caktuar, që ta informojë për llogari të saj, apo të ndërtojë struktura të mirorganizuara, që të merren me analizën e zhvillimeve në tërësi, të hetojnë imtësitë e këtyre zhvillimeve, në mënyrë që të shmangin kurthet dhe intrigat e palëve dashakeqe të shoqërisë, të atyre palëve, që synojnë, shpeshherë, të destabilizojnë situatën e rendit dhe të sigurisë në vend. Ky lloj informimi është i lidhur me spiunazhin që kryhet për interesin e përgjithshëm, edhe nëse ai prek, në raste të caktuara, jetën private të personave të ndryshëm.

Gjithsesi, të tilla operacione nuk duhet të prekin shenjtërinë e ligjeve themelore të Islamit. Kjo, nuk duhet ta shtyjë askënd, që t'i lejojë vetes të prekë shenjtërinë e privatësisë së të tjerëve, me pretekstin e ruajtjes së sigurisë së vendit dhe mbrojtjen e tij prej kurtheve dhe planeve të dashakeqëve. Askujt nuk i lejohet të hapë letrat e dikujt, apo të përgjojë bisedat telefonike të njerëzve, që më pas të sulmojë shtëpitë e tyre.

Përfundimisht, mund të themi, se vija ndarëse që qëndron ndërmjet spiunimit, në kuptimin e tij negativ dhe atij lidhur me mbledhjen e informacioneve të rëndësishme, të klasifikuara si shërbim për të ruajtur sigurinë e shoqërisë, është e saktë dhe shumë e dobishme, në të njëjtën kohë. Këtu, lind një detyrë e rëndësishme për drejtuesit e çështjeve shoqërore, që të përkujdesen ta bëjnë të qartë e të dallueshme këtë vijë ndarëse, me qëllim mbrojtjen e shenjtërisë së sekreteve personale të njerëzve, por dhe, që sigurisht, të mbrojnë shoqërinë dhe qeverinë islame prej kërcënimeve.

3- Përgojimi është prej gjynaheve më të rënda dhe më të mëdha

Siç thamë edhe më lart, kapitali më i çmuar i njeriut në jetë, është nderi, cipa dhe qenësia e tij. Për rrjedhojë, çdo gjë që cenon këtë kapital, është si të ketë goditur rrezikshmërisht jetën e tij, madje në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Ndonjëherë, kurthi me përgojim ndaj një personaliteti të caktuar, mund të jetë më i rëndësishëm se sa vetë atentati apo vrasja e personit.

Një prej urtësive, që e konsideron haram përgojimin, është që kapitali moral i njerëzve, ky imazh dhe kjo rëndësi, të mos ekspozohet ndaj rrezikut të shpërbërjes dhe ndotjes. Të mbrohen prej prekjes dhe shkeljes së shenjtërisë, prej ndotjes së qenësisë së tyre. Këto janë nevoja shumë të rëndësishme, prandaj Islami i trajton me përkushtim të madh.

Çështja tjetër lidhet me faktin se përgojimi lind opinione të këqija. Ai dobëson raportet shoqërore, shkatërron kapitalin mbi të cilin njeriu mbështetet, si dhe trondit themelet e bashkëpunimit ndërshoqëror.

Të gjithë e dimë se Islami i ka dhënë një rëndësi të dorës së parë e shumë të madh kësaj çështjeje, me qëllim mbrojtjen e unitetit, harmonisë dhe solidaritetit mes anëtarëve të shoqërisë. Nisur nga ky fakt, mund të themi se të gjithë ato elemente që e forcojnë këtë unitet, janë objekt i pranimit dhe i vlerësimit të Islamit.

Nga ana tjetër, çdo situatë që ndikon në destabilizimin e vazhdimësisë së shoqërisë, është tërësisht e papranueshme dhe e refuzuar, ndaj dhe përgojimi është një faktor i rëndësishëm, që ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë për dobësimin e kësaj vazhdimësie.

Pas gjithë kësaj, përgojimi mbjell në zemër farën e urrejtjes dhe të armiqësisë, madje mund të nxisë, hera-herës, vrasje dhe konflikte të përgjakshme.

Përfundimisht, kur themi se përgojimi është një prej gjynaheve më të mëdha, kjo ndodh për arsye të këtyre ndikimeve negative që ai ka, si në rrafshin individual, ashtu edhe në atë

shoqëror. Në transmetimet islame, gjenden shumë shprehje domethënëse, lidhur me këtë aspekt. Po rendisim disa prej tyre, për të ilustruar tablonë me këta shembuj:

I Dërguari i All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: "*Një dirhem që burri përfiton prej ribasë (kamatës), është më i rëndë tek All'llahu sa tridhjetë e gjashtë akte imoraliteti seksual, që kryen një burrë. Më kamatë se kamata, është nderi i një burri mysliman!*".[1]

Megjithëse imoraliteti-zinaja, është një vepër e shëmtuar dhe e fëlliqur, ai është i lidhur me hakun, të drejtën e All'llahut, ndërsa kamata dhe ajo ç'ka është më e rëndë se ajo, në rastin konkret, është prishja dhe shkatërrimi i cipës së fytyrës dhe sedrës së njeriut, që lidhet me hakun, me të drejtën e njerëzve.

Transmetohet, gjithashtu, se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* të ketë ligjëruar, një ditë me zë të lartë, ku ka thënë: "*O ju, njerëz, që keni besuar me gjuhët, por jo me zemrat tuaja! Mos i përgojoni myslimanët! Mos i zbuloni të fshehtat dhe të metat e tyre, se atij që zbulon të metën e vëllait të vet, All'llahu i zbulon të metat që ka! Cilitdo, që All'llahu i zbulon të metat, ka për t'i fëlliqur njërin prej anëtarëve të familjes së tij!*".[2]

Në një hadith të tretë, transmetohet se All'llahu i Madhëruar t'i ketë zbuluar Musait *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*: "*Ai që ka vdekur, pasi është penduar tek All'llahu për përgojimin, do të*

[1] "El Mehaxhetul Bejda", vëll. 5, f. 253.
[2] Burimi i mëparshëm, f. 252.

jetë i fundit që do të hyjë në Xhennet, ndërsa ai që ka këmbëngulur të përgojojë gjatë jetës së tij, do të jetë i pari që do të hyjë në zjarr!".[1]

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: *"Përgojimi e ha (konsumon) fenë e burrit më shpejt se sa e ha 'El Akeletu' trupin e tij!"*.[2]

Krahasimi i mësipërm tregon se përgojimi është i ngjashëm më zgjeben, e cila ha mishin e njeriut, kështu edhe ai e konsumon besimin e njeriut me shpejtësi.

Duke u kthyer tek arsyet dhe shkaqet e përgojimit, mund të themi se ato janë të shumta, si: smira, mendjemadhësia, koprracia, mëria, urrejtja, egoizmi, si dhe cilësi të tjera të ulëta, të fëlliqura, të ngjashme me to. Këto cilësi e qartësojnë sekretin e të qenit të përgojimit, të ndotjes së opinionit të myslimanëve në publik dhe prekjes së shenjtërisë së sekreteve të tyre, se ndikojnë deri në shkatërrimin tërësor të besimit të individit.

Transmetimet islame, lidhur me këtë kontekst, janë të shumta. Për t'i dhënë fund hulumtimit tonë për çështjen në fjalë, sjellim te lexuesi një tjetër hadith të Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*: *"Ai që nxjerr një të fshehtë apo tregon një histori të vëllait të tij besimtar, duke pasur për qëllim uljen, shembjen e personalitetit, deri në humbjen tërësore të vlerave të tij në sy të njerëzve, All'llahu ka për ta përjashtuar nga përkujdesja e Tij, duke e lënë në dorë të përkujdesjes së shejtanit. Në fund fare, as shejtani nuk ka për ta pranuar!"*[3]

---

[1] Burimi i mëparshëm.
[2] "Uslulul Kafij", vëll. 2, K. "Përgojimi", Hadithi 1; "El Akeletu", është një lloj sëmundje e lëkurës.
[3] "Uesailush Shia", vëll. 8, K. 157, Hadithi 2, f. 608.

Të gjithë këto përforcime mbështetëse dhe shprehje ngacmuese, tregojnë rëndësinë e veçantë që Islami i jep mbrojtjes se nderit të njerëzve dhe autoritetit të besimtarit në shoqëri. Ai synon, gjithashtu, të parandalojë ndikimet shkatërrimtare, që përgojimi i shkakton unitetit të shoqërisë dhe besimit të ndërsjellë, në zemrat e anëtarëve të shoqërisë. E keqja e përgojimit tejkalon çdo kufi, pasi nxit ndezjen e zjarreve të urrejtjes, të armiqësisë, të hipokrizisë dhe përhapjes së poshtërsisë në shoqëri. Këto gjëra ndodhin për arsye se, kur të metat dhe të fshehtat e njerëzve dalin nëpërmjet përgojimit në publik, ato nuk përbëjnë më rrezik në sytë e njerëzve, prandaj ndotja prej tyre ndodh shumë lehtë.

4- Kuptimi i përgojimit

Përgojimi apo "*el igtijab*", ashtu si është në pamjen e tij sipërfaqësore, nënkupton *thënien e gjërave në mungesë të pranisë së personit* për të cilin flitet.

Është e rëndësishme të theksojmë se, në këtë rast, bëhet fjalë për nxjerrjen në publik të një të mete të tjetrit, qoftë kjo një e metë fizike, trupore apo e lidhur me sjelljen, veprat, fjalët dhe moralin e të përgojuarit, qoftë dhe çështje të tjera që lidhen me të, siç janë veshja, shtëpia, bashkëshorti, fëmija, etj.

Nisur nga sa u tha më sipër, pohojmë se përmendja e cilësive të dukshme për të gjithë njerëzit, nuk konsiderohet përgojim, përveç atyre rasteve, kur nëpërmjet këtij veprimi synohet sharja, fyerja dhe ofendimi i personit të lartpërmendur. Në këtë rast, sigurisht, që kemi të bëjmë me një haram të qartë.

Edhe në ato raste, kur përmendim një cilësi të dukshme për të gjithë njerëzit, duke i thënë me qëllim ofendues një personi, për shembull: qorr, shkurtabiq, i shpëlarë, ezmer, apo ofendimin e mjekrës, etj, konsiderohet përgojim dhe është rreptësisht e ndaluar (haram).

Këtu, bëhet tërësisht e qartë, se përmendja e të metave të fshehta, cilido qoftë qëllimi, konsiderohet përgojim. Është, gjithashtu, haram, edhe përmendja e të metave dhe mangësive të dukshme, me qëllim ofendimi dhe poshtërimi; është haram, edhe nëse e konsiderojmë si pjesë të kuptimit të përgojimit, edhe nëse nuk e konsiderojmë si të tillë. Diskutimi i mësipërm, trajton ato raste, kur të metat e palës së etiketuar janë reale dhe të vërteta, në të kundërt, pra, nëse ato nuk ekzistojnë, por janë sajesa e montime, hyjmë në një tjetër mesele të rrezikshme, e cila quhet "*buhtan*" – "*shpifje*", e sajuar. Kështu që gjynahu i saj është disa shkallë dhe disa herë më i rëndë tek All'llahu i Madhëruar.

Në një hadith të transmetuar prej Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*, thuhet: "Përgojim është të përmendësh vëllain tënd me një të metë, të cilën All'llahu ka vendosur t'ia mbulojë! Nuk konsiderohet përgojim të thuash se është i rrëmbyer apo i ashpër. Të thuash atë që nuk e ka, është shpifje e madhe.".[1]

Këtu duket qartë se të gjitha justifikimet e përdorura prej shumicës së përgojuesve, janë të papranueshme. Ndodh që përgojuesi të thotë: "Nuk jam duke e përgojuar filanin, por jam duke përmendur cilësitë e tij.". Nëse cilësia më të cilën ai e përmend tjetrin nuk ekziston, atëherë, në këtë rast, kemi të bëjmë me shpifje.

[1] "Usulul Kafij", vëll. 2, kreu. "Përgojimi dhe shpifja", Hadithi 7.

Ndodh, gjithashtu, që ai të thotë: "Këto fjalë mund t'i them, edhe kur personi është i pranishëm.". Në këtë rast, pra, të përmendësh dikë me një cilësi që e ka, edhe në prani të tij, konsiderohet, gjithashtu, përgojim, për shkak të dëmit e dhimbjes që i shkakton, prandaj ky akt konsiderohet gjynah dhe përgjegjësi e madhe.

5- Ilaçi i përgojimit dhe pendesa prej tij

Ashtu si të gjitha gjynahet e tjera, edhe përgojimi është prej atyre të metave, që me kalimin e kohës, shndërrohen në forma të caktuara sëmundjesh mendore e psikologjike, duke i dhënë kështu lumturi përgojuesit, sa herë përgojon të tjerët, duke injektuar në thellësi të qenies së tij doza të pista kënaqësie, sapo e ndien që ka cenuar apo ka dëmtuar dinjitetin e ndokujt. Kjo përbën një simptomë të qartë për disa sëmundje të rrezikshme të zemrës.

Nisur nga sa thamë më sipër, për përgojuesin del si detyrë të përpiqet të kurojë ngacmimet që burojnë prej thellësisë së qenies së tij, ato që e nxisin të përgojojë dhe të kryejë këtë gjynah të madh. Burimet më të rëndësishme të dëshirës për përgojim, janë: koprracia, smira, urrejtja, armiqësia, mendjemadhësia dhe egoizmi.

Njeriu i mësuar me këtë ves fatkeq, pra, me përgojimin, duhet ta pastrojë veten nëpërmjet ngritjes së një personaliteti solid, si dhe të mendojë gjatë rreth pasojave negative të kësaj cilësie të ulët dhe rezultateve të saj shkatërrimtare. Ai duhet ta lajë e ta pastrojë zemrën nëpërmjet praktikimit të ushtrimeve të

ndryshme mendore e shpirtërore, duke ruajtur, kështu, gjuhën e tij prej ndotjes së përgojimit.

Së fundi, individi që përgojon, duhet t'i drejtohet pendesës, por, duke qenë se pendesa, në këtë rast, është e lidhur më hakun, të drejtën e shkelur të njeriut, është e pëlqyeshme që njeriu ta gjejë një mënyrë të përshtatshme për t'i kërkuar falje personit që ka përgojuar, duke i thënë: "Unë të kam përgojuar, ndonjëherë prej paditurisë dhe injorancës sime. Pa të drejtë të kam përmendur, kur nuk ke qenë i pranishëm, ndaj të lutem të më falësh!". Nuk është mirë që të zgjatet në shpjegime, duke përsëritur dhe duke përmendur imtësisht format e mënyrat me të cilat e ka përgojuar, pasi kjo formë shpjegimi mund të shkaktojë të tjera probleme, që është mirë të shmangen.

Në rast se nuk e ka të mundur të arrijë tek pala tjetër, për arsye të mosnjohjes, ose për arsye se personi i përgojuar mund të ketë kaluar te Krijuesi i tij për në Botën e Amshuar, ai duhet të lutet për të dhe të bëjë vepra të mira. Këto mund të bëhen shkak, që All'llahu i Madhëruar ta falë atë, për hatër të veprave të mira dhe kënaqësinë e palës së dëmtuar.

Rastet e përjashtimeve

Lidhur me çështjen e përgojimit, duhet përmendur, se, ashtu si çdo ligj apo rregull tjetër, edhe përgojimi ka përjashtimet e veta. Një nga këto përjashtime, është shembulli i atij apo i asaj, që ka nevojë të këshillohet apo të kërkojë informacion të hollësishëm, lidhur me cilësitë e burrit apo gruas, në rast të planifikimit për martesë. Në raste të tilla, ndodh që njerëzit të

pyesin njëri-tjetrin për cilësitë respektive, të vajzës apo djalit. Është normë e edukatës, e moralit dhe e amanetit islam, që, kur kërkohet këshillë, ajo të jepet me pastërti dhe sinqeritet, pikërisht kjo e bën, ndonjëherë, të detyrueshme që të përmenden të metat e personit, objekt i këshillimit. Ky lloj "përgojimi" nuk konsiderohet prej veprave të këqija apo të ndaluara (haram).

E njëjta logjikë, funksionon edhe për rastet e tjera të ngjashme, të lidhura me nevoja dhe qëllime këshillimore në punë, për të ndihmuar të vërtetën që të triumfojë, apo për të penguar padrejtësinë ndaj dikujt.

Natyrshëm, ai që krenohet dhe shfaqet hapur me shthurjen e tij, nuk përfshihet në çështjen e përgojimit, pasi edhe sikur t'i përmendësh të metat në mospraninë e tij, nuk konsiderohet përgojim, si rrjedhim, përgojuesi nuk preket prej gjynahut. Duhet të kemi parasysh se ky gjykim, është i lidhur përfundimisht me rastet, kur personi i përgojuar, është prej atyre që mburren dhe krenohen hapur me të metat dhe gabimet e veta.

Një tjetër aspekt tërheq vëmendjen, se nuk është vetëm përgojimi i ndaluar, (haram) por edhe dëgjimi i tij. E ndaluar është, gjithashtu, të jesh i pranishëm në një kuvend, ku po përgojohet dikush. Sipas disa transmetimeve kur'anore, përgojuesit apo shpifësit duhet të kundërshtohen dhe t'u kthehet përgjigje, pra, të mbrojmë dinjitetin dhe nderin e vëllait besimtar, i cili nuk ndodhet i pranishëm. Ku mund të gjendet, vallë, një shoqëri më e drejtë e më e ndershme se kjo, nëse rregulla të tilla morale do të zbatoheshin me përpikëri?!

Ajeti 13

يَٰٓأَيُّهَا ٱلنَّاسُ إِنَّا خَلَقۡنَٰكُم مِّن ذَكَرٖ وَأُنثَىٰ وَجَعَلۡنَٰكُمۡ شُعُوبٗا وَقَبَآئِلَ لِتَعَارَفُوٓاْۚ إِنَّ أَكۡرَمَكُمۡ عِندَ ٱللَّهِ أَتۡقَىٰكُمۡۚ إِنَّ ٱللَّهَ عَلِيمٌ خَبِيرٞ ١٣

“O njerëz! Në të vërtetë, Ne ju krijuam ju prej një mashkulli dhe një femre dhe ju bëmë popuj e fise, për ta njohur njëritjetrin. Më i nderuari prej jush tek All’llahu është ai që i frikësohet më shumë Atij. Vërtet, All’llahu është i Gjithëdijshëm dhe për Atë asgjë nuk është e fshehtë.”

Komentimi

Devotshmëria (takvaja)**, është vlera më e shtrenjtë njerëzore**

Ajeti i mëparshëm u drejtohej besimtarëve, ndaj dhe shprehej: **“O ju, që keni besuar!”**. Në ajetet e mësipërme, Kur’ani Famëlartë, sanksionoi me ndalesë disa prej sjelljeve, që mund të rrezikojnë shoqërinë islame, duke trajtuar disa prej këtyre aspekteve.

Ajeti në fjalë, u drejtohet të gjithë njerëzve, duke përcaktuar kështu themelet dhe rregullat më të rëndësishme të ekzistencës. Ai përcakton, gjithashtu, vijën ndarëse ndërmjet parametrave reale të vlerave njerëzore dhe vlerave të gënjeshtërta, joshjeve të kota, prandaj në ajet thuhet: **"O njerëz! Në të vërtetë, Ne ju krijuam ju prej një mashkulli dhe një femre dhe ju bëmë popuj e fise, për ta njohur njëri-tjetrin..."**.

Me: **"Ne ju krijuam ju prej një mashkulli dhe një femre"** nënkuptohet origjina e krijimit të njerëzve, që fillon te Profeti Adem dhe Havaja, kështu, duke qenë se të gjithë njerëzit kanë origjinë të njëjtë, nuk lejohet që njëri fis të ndihet më sipëror, në prejardhje e origjinë, se sa fisi tjetër. All'llahu i Madhëruar ka krijuar fiset, secilit prej tyre i ka dhënë veçori e detyra të caktuara, me qëllim mbrojtjen e jetës shoqërore e njerëzore, pasi diversiteti, në thelb, shërben që njerëzit të njihen mes njëri-tjetrit. Nëse do të kishin qenë të gjithë njerëzit të njëjtë e të ngjashëm, botën do ta sundonte kaosi dhe rrëmuja.

Komentuesit e Kur'anit kanë pasur mendime të ndryshme, në lidhje me ndryshimin ndërmjet fjalës *"esh shuub"* - *"popujt"* që është shumësi i fjalës *"sha'ab"* - *"popull"*, në formën *"sa'ab"* - *"pjesa më e madhe e njerëzve"* dhe fjalës *"el kabailu"* – *"fise"*, që është shumësi i fjalës *"el kabiletu"* - *"fisi"*. Ata kanë hedhur disa hipoteza në lidhje me këtë:

Disa prej tyre thonë se fjala *"popull"* është më gjithëpërfshirëse se sa fjala *"fis"*, ashtu si dhe njihet në kohën e sotme, ku me fjalën *"popull"* konsiderohen banorët e një kombi të caktuar.

Disa të tjerë kanë thënë se fjala *"shuub"* - *"popuj"*, nënkupton vetëm grupet e huaja njerëzore, që nuk i përkasin botës arabe ose axhamitë, ndërsa fjala *"el kabail"* - *"fiset"* nënkupton vetëm botën arabe me fiset e saj.

Së fundi, disa të tjerë kanë thënë se fjala *"esh shuub"* – *"popujt"*, nënkupton përkatësinë dhe shpërndarjen gjeografike të njerëzve, ndërsa fjala *"el kabail"*, nënkupton përkatësinë e tyre fisnore dhe lidhjet e gjakut.

Në fakt, komenti i parë, duket të jetë më i përshtatshëm se të tjerët. Gjithsesi, pasi Kur'ani Famëlartë i përbuzi format e mëdha të krenarisë dhe të lavdërimit, të përdorura prej arabëve në kohën e injorancës, ai vjen për të përshkruar njësinë reale matëse të vlerave dhe krenarisë, duke thënë: **"...Më i nderuari prej jush tek All'llahu është ai që i frikësohet më shumë Atij."**.

Në këtë mënyrë, Kur'ani, i vendos një vizë të kuqe ndarëse, të gjitha privilegjeve, supermacive sipërfaqësore dhe atyre materiale, duke i dhënë përparësi vetëm devotshmërisë dhe frikës ndaj All'llahut, çka do të thotë, se asgjë nuk vlen më shumë se devotshmëria për t'u afruar tek All'llahu i Lartësuar dhe hapësirat e Shenjtërisë së Tij.

Duke qenë se devotshmëria dhe përkushtimi janë cilësi të brendshme shpirtërore të njeriut, lipset që ato të përqendrohen në zemër dhe shpirt. Në realitet ndodh që shumë njerëz të pretendojnë devotshmërinë dhe përkushtimin, por, e vërtetë, është se të tillë janë vetëm një numër i vogël. Prandaj, për këtë arsye, All'llahu i Madhëruar, në fund të ajetit, thotë: **"...Vërtet,**

All'llahu është i Gjithëdijshëm dhe për Atë asgjë nuk është e fshehtë.".

All'llahu i Madhëruar ka dijeni të plotë, se cilët janë të devotshmit e vërtetë, siç dhe ka dijeni për nivelin dhe shkallën e devotshmërisë, të sinqeritetit, të qëllimit, të pastërtisë, dhe kthjelltësisë për gjithsecilin. Nisur nga ky vlerësim, Ai vlerëson dhe shpërblen secilin sipas gradës dhe shkallës që ka. Për sa u përket mashtruesve dhe gënjeshtarëve, All'llahu, gjithashtu, i shpërblen sipas veprave dhe qëllimeve të tyre.

Dy hulumtime

1- Vlerat e vërteta dhe vlerat e pavërteta

Nuk ka dyshim se është në natyrën e çdo njeriu, të kërkojë të ndihet i vlerësuar dhe të krenohet, çka përpiqet me të gjitha energjitë e qenies së tij për t'i arritur dhe për t'i siguruar këto.

Për të zbërthyer njësinë matëse të vlerave, duhet të kuptojmë se ato ndryshojnë nga njëra kulturë në tjetrën, kështu, për fat të keq, ndodh shpesh që gjërat e pavlera, të jenë më të dukshme dhe madhështore, sa nuk lejojnë asnjë hapësirë në fjalorin kulturor të individit për vlerat e vërteta.

Për shembull, një grup, e shikon vlerën e tij reale te përkatësia fisnore, te një fis i caktuar apo i njohur, për këtë arsye, për të rritur vlerën dhe reputacionin e fisit të vet, zhvillon

organizime të rëndësishme, në mënyrë që t'i rritet reputacioni dhe krenaria nëpërmjet rritjes së emrit të fisit.

Interesimi për fisin dhe krenaria e përkatësisë tek ai, ka qenë ndër çështjet më të përhapura në kohën e paditurisë, deri në atë shkallë sa secili fis e shikonte veten më lart se fisi tjetër. Është fatkeqësi e madhe që të tilla simptoma dhe sjellje të kohës së paditurisë, t'i gjejmë ende të ngulitura në thellësi të shpirtit të anëtarëve të shoqërive të ndryshme. Grupime të tjera, e shohin krenarinë e tyre tek superioriteti material, që lidhet me pasurinë që gëzojnë, me pronësinë e pallateve të luksit, me numrin e shërbëtorëve, etj. Kjo kategori njerëzish beson se këto janë elemente të rëndësishme të krenarisë, ndaj i shpenzojnë të gjitha energjitë e tyre, për të arritur pikësynime të tilla.

Disa të tjerë mendojnë se pozitat e larta politike dhe shoqërore, janë njësia matëse e peshës së personalitetit dhe vlerës shoqërore.

Duke qenë se të gjitha këto çështje janë të lëkundshme, personale, materiale dhe kalimtare, nuk mund të jenë kurrsesi të pranueshme prej parimit qiellor, siç është parimi islam. Për këtë arsye, Islami, i ka injoruar të gjitha këto çështje të kota, duke u vënë atyre, njëherë e përgjithmonë, damkën e pavlefshmërisë. Islami e mat vlerën reale të njeriut nëpërmjet cilësive të ndërgjegjes së tij të brendshme, veçanërisht devotshmërisë, pastërtisë së zemrës dhe përkushtimit fetar.

Islami, nuk i jep rëndësi, as disa çështjeve deri diku në dukje, të rëndësishme, si janë dija dhe kultura e madhe, për sa

kohë ato nuk janë në sinkron me linjën e besimit, të devotshmërisë dhe vlerave morale.

Është për t'u shënuar fakti se Islami e vendos theksin në sferën e vlerave të shpirtit, gati-gati më shumë sa interesimi i tij për vlera të tjera. Prandaj Kur'ani shfarosi çdo formë të idhujtarisë, duke e çliruar kështu njeriun prej robërisë së përkatësisë së gjakut, fisit, sojit, ngjyrës, pasurisë, pozitës ekonomike, duke e orientuar atë, drejt njohjes së vetes dhe kërkimit të vlerave të larta të thellësive të saj.

Është kënaqësi të vëresh, se në një prej arsyeve të zbritjes së ajetit, objekt i studimit tonë, gjenden urtësi dhe imtësi faktesh, që flasin qartë për thellësinë e largpamësisë së Kushtetutës islame.

Disa prej këtyre rasteve, i gjejmë në jetën e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, kur urdhëroi Bilalin të thërrasë ezanin, fill pas çlirimit të Mekës. Bilali u ngjit mbi Qabe dhe thirri ezanin. Itab bin Usejdi, i cili nuk ishte skllav, tha: "Falënderoj All'llahun që babai im është ndarë nga jeta, është larguar nga kjo botë, pa e parë këtë pamje!".

Pas tij, El Harith ibn Hishami, tha: "A nuk gjeti, i Dërguari i All'llahut, njeri tjetër të thërrasë ezanin, përveç kësaj sorre të zezë?!".

Kështu që menjëherë zbriti ajeti kur'anor, për të treguar njësinë matëse të vlerave të vërteta të njeriut.[1]

[1] Tefsiri "Ruhul Bejan", vëll. 9, f. 90, ashtu siç ka ardhur edhe te tefsiri i "Kurtubiut", vëll. 9 f. 6160.

Ndërsa, disa të tjerë kanë thënë se ky ajet ka zbritur teksa Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* urdhëroi myslimanët të martohen me disa "*metali*" - "*robëresha*", vajza të arabëve. Me "*metali*", nënkuptohen skllevërit që e kanë fituar lirinë prej pronarëve të tyre, ose të gjithë ata që nuk ishin prej arabëve dhe myslimanëve. Kur e dëgjuan këtë urdhër të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, u habitën shumë dhe thanë: "O i Dërguari i All'llahut, si mund të na urdhërosh të martohemi me vajzat që kanë qenë skllavet tona?!". Më pas zbriti ajeti kur'anor, duke i goditur një herë e përgjithmonë këto mendime të gabuara.[1]

Në disa transmetime islame lexojmë se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka ligjëruar një ditë në Mekë. Midis të tjerave ka thënë: "*O Ju, njerëz! All'llahu ju ka pastruar prej turpit dhe të metave tuaja të kohës së paditurisë, si dhe krenarisë së baballarëve tuaj! Dijeni mirë se njerëzit janë të ndarë në dy lloje. I pari është i mirë, i devotshëm dhe bujar tek All'llahu i Madhëruar, ndërsa i dyti është kriminel, i fëlliqur, që nuk ka asnjë vlerë tek All'llahu. Njerëzit janë të gjithë bijtë e Ademit. Ademin e ka krijuar All'llahu prej baltës. All'llahu i Madhëruar ka thënë:* **'O Njerëz! Në të vërtetë, Ne ju krijuam ju prej një mashkulli dhe një femre dhe ju bëmë në popuj e fise, për ta njohur njëri-tjetrin. Më i nderuari prej jush tek All'llahu është ai që i frikësohet më shumë Atij. Vërtet, All'llahu është i Gjithëdijshëm dhe për Atë asgjë nuk është e fshehtë.'**".[2]

---

[1] Tefsiri "Ruhul Bejan", vëll. 9, f. 90, siç është përmendur edhe te tefsiri i "Kurtubijjut", vëll. 9, f. 6160.

[2] Tefsiri "Kurtubijj", vëll. 9, f. 6161.

Te libri i Tabariut "Adabun Nufus", përmendet se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, hipur mbi devenë e tij iu drejtua njerëzve në një prej ditëve të Teshrikut në Mina, dita e njëmbëdhjetë, e dymbëdhjetë dhe e trembëdhjetë e muajit Dhul Hixhxheh: *"O ju, njerëz! Vërtet Zoti juaj është Një, po edhe babai juaj është një, Ademi. Nuk ka përparësi arabi ndaj joarabit, joarabi ndaj arabit, e as i kuqi ndaj të ziut, e as i ziu ndaj të kuqit, përpos në devotshmëri! A dëshmoni se unë e përcolla mesazhin e Zotit për ju?!"* Ata thanë: *"E përcolle!"* Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* tha: *"Atëherë, të pranishmit le të njoftojnë ata që nuk kanë qenë të pranishëm!"*.[1]

Një tjetër hadith dhe me të njëjtin kuptim, transmetohet nëpërmjet fjalëve të pakta, por me kuptim shumë të madh, të Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!): "All'llahu nuk sheh prejardhjen, as racat, as trupat tuaj dhe as pasurinë tuaj, por Ai sheh zemrat tuaja, prandaj All'llahu do të përkujdeset për atë që e ka zemrën të pastër. Ju jeni të gjithë bijtë e Ademit, më të dashurit te All'llahu ndër ju, janë më të devotshmit prej jush!"*.[2]

Më gjithë problematikën e gjerë të këshillave dhe udhëzimeve të pasura islame, për fat të keq, sheh akoma shumë myslimanë, që i kanë sytë ende te prejardhja familjare, te lidhjet e gjakut, te raca, te gjuha e tyre, duke i dhënë kështu përparësi

[1] Burimi i mësipërm, f. 6162. Përmendja e fjalës "*el ahmar*", në këtë transmetim, nuk nënkupton lëkurën e tij të kuqe, por lëkurën bojë gruri, pasi pjesa më e madhe e banorëve të atyre zonave kanë pasur këtë ngjyrë të lëkurës. Për këtë arsye, mund të themi se është një tjetër aspekt i këndshëm, fakti që përmendet e kuqja dhe nënkuptohet ngjyra e grurit.

[2] Burimi i mëparshëm.

gjuhës, prejardhjes familjare, gati sa lidhjes së vëllazërisë islame, fesë së njëjtë, duke ndezur, kështu edhe njëherë, fanatizmat e kohës së injorancës dhe të paditurisë. Edhe pse, për këto arsye, kanë pësuar disfata e goditje të rënda, në pamje të parë, duket se myslimanët ende nuk kanë dëshirë të zgjohen e të kthehen te ligji i Islamit dhe hapësirat e shenjtërisë së All'llahut.

All'llahu i marrtë nën mbrojtjen e Tij të gjithë myslimanet, prej sherrit të fanatikëve injorantë.

Islami i ka luftuar të gjitha format e fanatizmit të kohës së paditurisë dhe e ka ndaluar ushtrimin e tyre prej myslimanëve të të gjithë globit, sido e cilado qoftë forma e shfaqjes së tyre. Ai ka ndaluar bashkimin e myslimanëve vetëm nën flamurin e kombit, sepse Islami nuk e pranon këtë teori që shfaqet me dimension të kufizuar. Ai, të gjitha këto çështje, i konsideron të stisura dhe të pabazuara. Lidhur me këtë, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij*!) ka thënë: "*Hiqni dorë prej saj, sepse ajo është e ulët, e ndyrë!*".[1]

Prej këtu lind pyetja: Si ka mundësi që këto mendime e ide të ulëta e të ndyra të jenë gdhendur në mendjen e shumë prej atyre që pretendojnë Islamin dhe sipërfaqësisht paraqiten si ndjekës të Kur'anit dhe parimeve të vëllazërisë islame?! Përgjigjja është e thjeshtë: Nuk e dimë përse!

E ku ka më bukur që shoqëria të ndërtohet sipas vlerave dhe normave të Islamit. All'llahu i Madhëruar thotë: **"Me i nderuari prej jush tek All'llahu, është ai që i frikësohet më**

[1] "Sahihu" i Muslimit, sipas tekstit të përmendur te "Fi Dhilalil Kur'an", vëll. 7, f. 538.

shumë Atij!". Sa mirë do të jetë, sikur, të heqim dorë prej vlerave të rreme, si: kombësia, raca, pasuria dhe përkatësia gjeografike e shoqërore.

Në të vërtetë, devotshmëria hyjnore, ndjenja e brendshme e përgjegjësisë, përballja me epshet, kapja pas të vërtetës, sinqeritetit, pastërtisë, drejtësisë, janë të vetmet vlera njerëzore reale, edhe pse sot, për fat të keq, këto vlera janë harruar dhe janë lënë pas dore nga shoqëria bashkëkohore. Vendin e këtyre vlerave e kanë zënë gënjeshtrat dhe mashtrimet.

Në regjimin e vlerave të kohës së paditurisë, boshti i të cilës ishte krenaria me baballarët, pasurinë dhe fëmijët, nuk pati ndonjë rezultat tjetër, përveçse lindjes së një radhe të madhe me hajdutë e banditë. Me tjetërsimin e këtij regjimi, me ringjalljen e vlerave, si: **"Më i nderuari prej jush tek All'llahu është ai që i frikësohet më shumë Atij!"**, rezultati ishte i favorshëm. Frytet e rikthimit të vlerave krijuan njerëz, si: Selmani, Ebu Dherri, Amari, Jasiri dhe Mikdadi. Ajo çka është e rëndësishme për revolucionarizimin e shoqërisë njerëzore, është ringritja në këmbë, në emër dhe për hir të vlerave, këtij guri të rëndësishëm në themelet e Islamit.

Po e mbyllim diskutimin tonë, për çështjen në fjalë, me një hadith të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: *"Të gjithë ju e keni prejardhjen prej Ademit dhe Ademi është krijuar prej dheut! Hiqni dorë sa më parë prej krenarisë me baballarët tuaj, përndryshe vlera juaj tek All'llahu do të jetë më e vogël se sa vlera e një brumbulli!"*.[1]

[1] Tefsiri "Fi Dhilalil Kur'an", vëll. 7, f. 538.

2- Realiteti i devotshmërisë

Ashtu siç e kemi theksuar edhe më lart, Kur'ani ka përcaktuar si veçori kryesore të fuqisë, vetëm aftësinë për të dalluar dhe prekur vlerat njerëzore.

Në një ajet tjetër, në Kur'an, devotshmëria dhe përkushtimi përshkruhen si frymëzimi më i shëndetshëm dhe pija më e shijshme. All'llahu i Madhëruar thotë: **"Furnizohuni sa të mundeni, por dijeni se nuk ka furnizim më të mirë se sa devotshmëria!"**.[1]

Në suren "El A'araf", ai është përmendur në trajtën e rrobës. All'llahu i Madhëruar thotë: **"Rroba e devotshmërisë, është më e mira!"**.[2]

Te disa ajete të tjera kur'anore, ai është përmendur si një prej themeleve kryesore të thirrjes së Profetëve, madje, këta të fundit kanë marrë emrin e devotshmërisë dhe janë quajtur me të. Vetë All'llahu i Madhëruar e ka përshkruar veten nëpërmjet devotshmërisë (takuasë) dhe ka thënë në Kur'anin Famëlartë: **"Vetëm Ai është i denjë për t'u pasur frikë dhe vetëm Ai është i denjë për të falur!"**.[3]

Kur'ani e konsideron devotshmërinë dritë që buron prej All'llahut, e cila, nëse ngulitet te qeniet njerëzore, shoqërohet në njohuri dhe dituri të madhe. All'llahu i Madhëruar thotë: **"Kijeni**

[1] Sure "El Bekare", ajeti 197.
[2] Sure "El A'araf", ajeti 26.
[3] Sure "El Muddeththir", ajeti 56.

frikë All'llahun dhe All'llahu do t'ju furnizojë me shumë dije!".[1]

Në disa ajete, All'llahu e lidh devotshmërinë me mirësinë dhe thotë: **"Bashkëpunoni, o besimtarë, në punët e mira dhe në devocion!"**.[2]

Në një ajet tjetër kur'anor, All'llahu i Madhëruar, e lidh drejtësinë me devotshmërinë dhe thotë: **"Mbani drejtësi, se ajo është më pranë devotshmërisë!"**.

Tani, të kthehemi e të shohim, cili është realiteti dhe e vërteta rreth devotshmërisë, i cili përfaqëson kapitalin më të madh moral të njeriut, me të cilin ai ka të drejtë të krenohet.

Ka shumë tregues në Kur'an, të cilët ngrenë siparin e domethënies së kuptimeve dhe realitetit të devotshmërisë, kështu, në shumë prej ajeteve kur'anore zemra përmendet si vendi ku depozitohet devotshmëria e përkushtimi. All'llahu i Madhëruar, thotë: **"Ata janë njerëzit, zemrat e të cilëve, All'llahu i ka kalitur për besim e përkushtim!"**.[3]

Në një moment tjetër kur'anor, All'llahu e vendos devotshmërinë përballë krimit dhe të keqes, ashtu siç e lexojmë qartë te ajeti 8 i sures "Esh Shems", ku All'llahu i Madhëruar, thotë: **"Duke ia bërë të njohur atij, të keqen dhe të mirën!"**.

Të gjitha veprat që burojnë prej shpirtit të besimit, prej sinqeritetit dhe qëllimeve të pastra, i kanë themelet në devotshmëri e përkushtim. Këtë e vëmë re teksa, Kur'ani, cilëson

[1] Sure "El Bekare", ajeti 282.
[2] Sure "El Maide", ajeti 2.
[3] Sure "El Huxhurat", ajeti 3.

Xhaminë Kiba, në Medine, përballë së cilës hipokritët ndërtuan Xhaminë Dirar. All'llahu i Madhëruar thotë: **"Xhamia e ndërtuar me përkushtim, ndaj All'llahut, që në ditën e parë, pa dyshim, është më e denjë për të falur namaz në të!"**.[1]

Prej të gjithë këtyre ajeteve, bëhet i qartë fakti se devotshmëria dhe përkushtimi, në thelbin e tyre, janë ndjenjë e përgjegjësi, zotim, që kontrollon sjelljen e njerëzores brenda qenies. Kjo pa dyshim që vjen si rezultat i besimit të palëkundur në zemër, i cili e ndalon njeriun ndaj sipërmarrjeve negative dhe gjynaheve. Ai e fton atë për vepra të denja dhe mirësi, duke i shpëlarë kështu veprat e individit prej ndotjeve të ndryshme, duke i orientuar mendimet dhe qëllimet drejt çlirimit nga çdo e keqe e mundshme.

Teksa i kthehemi rrënjës gjuhësore të kësaj fjale, *"devotshmëri"* - *"takua"*, arrijmë në një tjetër përfundim. Fjala *"tekua"*, i ka rrënjët në fjalën *"el uikajetu"*, kuptimi i të cilës është: përpjekje e pandërprerë për të ruajtur një gjë. Kuptimi i saj në rastet e përmendura më lart, është mbrojtja e qenies prej ndotjes në kontekstin e përgjithshëm, sikur në mënyrë më specifike nënkupton vendosjen dhe përqendrimin e energjive të qenies, në funksion të çështjeve që kënaqin All'llahun. Disa njerëz të mëdhenj, kanë thënë se devotshmëria *(takuaja)* kalon nëpër tri stade të rëndësishme:

1- Mbrojtja e qenies prej ndëshkimit të përjetshëm, duke aplikuar përvetësimin e besimit të vërtetë.

2- Evitimi i të gjitha gjynaheve, devotshmëria është më e përgjithshme se lënia e obligimit apo kryerja e gjynahut.

[1] Sure "Et Teube", ajeti 108.

3- Heqja dorë nga durimi prej gjithçkaje që mund ta hutojë zemrën dhe mund ta devijojë atë nga Rruga e Drejtë. Kjo është devotshmëria e njerëzve të veçantë, saktësisht të veçantët e të veçantëve.[1]

Te libri "Nehxhul Belaga", i Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!),* gjenden shumë shprehje të gjalla dhe elokuente që lidhen me devotshmërinë *(takuanë)*, pasi fjala devotshmëri është përmendur në shumë prej ligjëratave dhe fjalëve kuptimplota të Imamit.

Në disa prej fjalëve të tij, Imami Aliu *(Paqja qoftë mbi të!),* bën krahasimin ndërmjet devotshmërisë (takuasë) dhe gjynahut, duke thënë: "*Në të vërtetë, gjynahet janë si një kalë pa fre, mbi të cilin kanë hipur kalorësit. Ai do t'i zhysë ata në zjarrin e Xhehennemit. Kurse devotshmëria është një kafshë e butë, mbi të cilën kanë hipur të devotshmit. Atyre u janë dhënë në dorë frerët, kështu që ajo do t'i dërgojë ata në Xhennet!*".[2]

Duke iu referuar këtyre krahasimeve të goditura, mund të themi se devotshmëria *(takuaja)* është gjendja e kontrollit të qenies dhe e pushtetit tërësor mbi epshet, ndërkohë që mungesa e devotshmërisë *(takuasë)* është dorëzimi ndaj epshit dhe mungesës së pushtetit mbi të.

Në një moment tjetër, Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: "*Ta dini mirë, ju, o rob të All'llahut, se devotshmëria është një vendbanim i mbrojtur dhe i nderuar, ndërsa gjynahu është një vendbanim i keq, që nuk i mbron banorët e tij, as i mirëpret ata që*

[1] "Biharul Anuar", vëll. 70, f. 136.
[2] "Nehxhul Belaga", Hytbe 16.

kërkojnë strehim në të. Dijeni se devotshmëria e këput vrullin e gabimeve!".[1]

Më poshtë ai thotë: "*Kapuni fort pas përkushtimit dhe devotshmërisë ndaj All'llahut, sepse të fortë e ka litarin dhe të mbrojtur mirë e ka strehën!"*.[2]

Pra, shprehjet e sipërpërmendura, e qartësojnë akoma më mirë kuptimin dhe shpirtin e devotshmërisë.

Këtu kemi të bëjmë me një urtësi, të cilës duhet t'i kthehemi patjetër, që konsiston në faktin se devotshmëria është fryt i pemës së besimit, ndaj, për ta pasur këtë fryt të veçantë, të rrallë e të shtrenjtë, lipset që bazat e besimit të jenë të forta dhe të qëndrueshme.

Natyrshëm, praktikimi i veprave të mira, mënjanimi prej veprave të këqija dhe orientimi kah metodave të suksesshme të moralit, i dhurojnë devotshmërisë qëndrueshmëri brenda qenies. Rezultati i pashmangshëm i tij është shfaqja e dritës së sigurt të besimit te qenia njerëzore, pasi, sa më shumë të shtohet drita e devotshmërisë, aq më shumë shtohet dhe drita e sigurisë. Për këtë arsye, vëmë re në disa transmetime islame, se devotshmëria është një shkallë më lart se besimi dhe një shkallë poshtë sigurisë në besim *(jekijnun)*.

Imam Ali ibn Musa Riza *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: "*Besimi është një shkallë mbi Islamin, ndërsa devotshmëria është një*

[1] Burimi i mëparshëm, Hytbe 157.
[2] Burimi i mëparshëm, Hytbe 190.

shkallë mbi besimin. Asgjë nuk u është dhënë njerëzve më pak se siguria në besim (jekijni)!".[1]

Këtë kapitull e mbyllim me disa vargje të ndjera poetike, që nëpërmjet shembujve të qartë dëshmojnë realitetin e devotshmërisë *(tekuasë)*.

Hiq dorë prej gjynaheve të mëdha.

Hiq dorë prej gjynaheve të vogla.

Kjo është tekua! (devotshmëri)

Vish doreza në tokën me gjemba,

të ruhesh prej asaj që ke parë.,

Vogëlimat e mëkateve, kurrë mos i nënvlerëso

se dhe malet e larta nga gurë të vegjël janë bërë.

[1] "Biharul Anuar", vëll. 70, f. 136.

Ajetet 14 – 15

۞قَالَتِ ٱلۡأَعۡرَابُ ءَامَنَّاۖ قُل لَّمۡ تُؤۡمِنُواْ وَلَٰكِن قُولُوٓاْ أَسۡلَمۡنَا وَلَمَّا يَدۡخُلِ ٱلۡإِيمَٰنُ فِي قُلُوبِكُمۡۖ وَإِن تُطِيعُواْ ٱللَّهَ وَرَسُولَهُۥ لَا يَلِتۡكُم مِّنۡ أَعۡمَٰلِكُمۡ شَيۡـٔاۚ إِنَّ ٱللَّهَ غَفُورٞ رَّحِيمٌ١٤ إِنَّمَا ٱلۡمُؤۡمِنُونَ ٱلَّذِينَ ءَامَنُواْ بِٱللَّهِ وَرَسُولِهِۦ ثُمَّ لَمۡ يَرۡتَابُواْ وَجَٰهَدُواْ بِأَمۡوَٰلِهِمۡ وَأَنفُسِهِمۡ فِي سَبِيلِ ٱللَّهِۚ أُوْلَٰٓئِكَ هُمُ ٱلصَّٰدِقُونَ١٥

“Arabët e shkretëtirës deklarojnë: ‘Ne besojmë’. Thuaju: ‘Ju nuk keni besuar!’ Por më mirë thoni: ‘Ne përulemi’, pasi besimi ende nuk ka hyrë (si duhet) **në zemrat tuaja. E, nëse i bindeni All’llahut dhe të Dërguarit të Tij, nuk do t’ju pakësohet asgjë prej veprave tuaja. Sigurisht, All’llahu është Falës dhe Mëshirëplotë.”**

“Besimtarë të vërtetë janë vetëm ata që besojnë All’llahun dhe të Dërguarin e Tij dhe pastaj nuk dyshojnë, por luftojnë në Rrugën e All’llahut me pasurinë dhe jetën e tyre. Këta janë besimtarë të sinqertë.”

Shkaku i zbritjes

Shumë komentues të Kur'anit kanë përmendur një shkak të vetëm për zbritjen e këtyre ajeteve. Po e japim shkurtimisht: Në një kohë thatësire të madhe, Medinen e vizitoi një përfaqësi e fisit Beni Esed, të cilët erdhën dhe dëshmuan me gjuhën e tyre, dy deklaratat e hyrjes në Islam, me shpresë se mund të përfitonin ndonjë ndihmë a mbështetje prej të Dërguarit të All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Ata i thanë Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!): "Fiset arabe u kanë hipur kuajve dhe ju kanë luftuar, por ne nuk kemi bërë si ata. Ne kemi ardhur, bashkë me gratë tona dhe fëmijët tanë, pa të luftuar as dhe një ditë të vetme."*. Kjo ishte mënyra, që ata zgjodhën për t'i treguar Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, se ai ua kishte borxh këtë të mirë.

Më pas, zbritën këto dy ajete, për të zbuluar e për të theksuar se Islami i tyre ishte vetëm sipërfaqësor, nuk ishte ngulitur në thellësi të zemrave të tyre. Në anën tjetër, edhe sikur të ishin besimtarë të vërtetë, ata nuk duhet t'ia shisnin Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* këtë si një nder të kryer për hatër të tij. Përkundrazi, ky ishte nderi me të cilin All'llahu i kishte nderuar. Ishte nderi i besimit në All'llah.[1]

Ekzistenca e këtij shkaku, për zbritjen e ajeteve, nuk e përjashton përgjithësimin e kuptimeve te ajeteve.

[1] Tefsiri "El Mijzan", tefsiri "Ruhul Bejan" dhe tefsiri "Fi Dhilalil Kur'an", fundi i ajeteve, objekt të studimit tonë.

Komentimi

Dallimi ndërmjet Islamit dhe besimit

Tek ajeti i mësipërm, u trajtua çështja e njësisë matëse të vlerave njerëzore, pra, devotshmëria (takuaja). Duke qenë se devotshmëria është fryt i pemës së besimit, atij besimi që depërton në thellësi të zemrës, dy ajetet e mësipërme paraqesin, kështu, qartësisht, të vërtetën rreth besimit. All'llahu i Madhëruar thotë: **"Arabët e shkretëtirës deklarojnë: 'Ne besojmë'. Thuaju: "Ju nuk keni besuar!' Por më mirë thoni: 'Ne përulemi', pasi besimi ende nuk ka hyrë** (si duhet) **në zemrat tuaja..."**.

Duke iu referuar tekstit të ajetit, arrijmë të dallojmë ndryshimin ndërmjet Islamit dhe besimit. Islami ka një kornizë të qartë ligjore, çka do të thotë, se të gjithë ata që dëshmojnë me gjuhët e tyre dy deklaratat e hyrjes në Islam, konsiderohen si myslimanë, gjykohen e trajtohen nga të njëjtat dispozita juridike si myslimanët e tjerë.

Për sa i përket besimit, ai është një çështje dhe realitet i brendshëm i njeriut. Vendi i tij është zemra e njeriut, jo shprehjet dhe sjellja e jashtme.

Përgjatë historisë, ka ndodhur, shpesh, që, feja islame të ketë qenë burim i majmë i përfitimeve, prandaj dhe shumë njerëz mund të kenë pasur interesa te caktuara materiale e personale për t'u lidhur ngushtësisht me Islamin, por besimi vjen vetëm si rezultat i bymimit të ndërgjegjes dhe moralit brenda qenies. Besimi është rezultat i natyrshëm i dijes dhe burimit të saj, sikur

është fryti i pjekur i devotshmërisë në degën e pemës së tij shtatlartë.

Këtë aspekt e shpreh në mënyrë të mrekullueshme dhe me shumë elokuencë Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* që ka thënë: *"Islami është ai që shprehet në publik, ndërsa besimi ruhet në zemër!"*.[1]

Te një hadith, transmetuar prej Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*, lexojmë: *"Islami e mbron gjakun, e dërgon amanetin në vendin e vet dhe legalizon aktin martesor, ndërsa shpërblimi është për besimin!"*.[2]

Mbase, kjo ka qenë dhe arsyeja përse disa transmetime islame e kufizojnë kuptimin e Islamit vetëm më dëshminë deklarative, ndërkohë që besimi është deklaratë me gojë dhe veprim, sipas dispozitave të caktuara. Një prej transmetimeve thuhet: *"Besimi (imani) është deklaratë dhe vepër, ndërsa Islami është deklaratë pa vepër!"*.[3]

Pothuajse të njëjtën shprehje, e gjejmë në një transmetim tjetër, në një hulumtim rreth Islamit dhe besimit. Fudejl bin Jesari thotë: "Kam dëgjuar Imam Sadikun *(Paqja qoftë mbi të!)* të thotë: *'Në të vërtetë, besimi është pjesë e Islamit, ndërsa Islami nuk është domosdoshmërish pjesë e besimit. Besimi (imani) është në zemër, ndërsa Islami është ai që legalizon martesat, trashëgimitë dhe mbron gjakun!'"*.[4]

Ky dallim, ndërmjet kuptimeve të besimit dhe Islamit, është në ato raste, kur shprehjet bashkohen me njëra-tjetrën,

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 9, f. 138.
[2] "Usulul Kafij", vëll. 2, kreu "Islami mbron gjakun", Hadithi 1.
[3] Burimi i mëparshëm, Hadithi 2.
[4] Burimi i mëparshëm, kreu "Besimi është pjesë e Islamit", Hadithi 3.

ndërsa kur ndahen prej njëra-tjetrës, ndodh që Islami të përdoret për të njëjtat gjëra që përdoret edhe besimi, që do të thotë se ndonjëherë, të dyja shprehjet, mund të përdoren me të njëjtin kuptim.

Më pas, ajeti, objekt i studimit tonë, thotë: **"...E, nëse i bindeni All'llahut dhe të Dërguarit të Tij, nuk do t'ju pakësohet asgjë prej veprave tuaja."** *E kjo për arsye se:* **"...Sigurisht, All'llahu është Falës dhe Mëshirëplotë."**.

Shprehja *"la jelitkum"*, buron nga fjala *"lejtun"* në formën *"rejbun"*. Kuptimi i saj është: pakësimi i një të drejte, i hakut tënd.[1]

Në të vërtetë, shprehjet e fundit flasin rreth një parimi shumë të rëndësishëm kur'anor, i cili ka fituar një pranueshmëri të gjerë. Ky parim konsiston në faktin se kushti themelor për pranimin e veprave të mira, është besimi. Këtë e vërejmë edhe te përmbajtja kuptimore e ajetit, ku bëhet e qartë se, nëse All'llahun e besoni me zemrat tuaja, duhet të tregoni vepra për këtë. Shenjë treguese, në këtë rast, është nënshtrimi tërësor ndaj urdhrave të All'llahut dhe Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Ky është një tregues i qartë se veprat tuaja janë të pranuara dhe do të merrni prej All'llahut shpërblimin e plotë për to. Bereqeti dhe mirësia e këtyre veprave do të shkaktojë faljen e gjynaheve tuaja, sepse All'llahu i Madhëruar është Falës dhe Mëshirëplotë.

Duke qenë se formimi i pasurisë së brendshme, siç është besimi, nuk është i lehtë, zbriti ajeti kur'anor për të përshkruar

[1] Nisur nga kjo, mund të themi se folja *"lejt"* - *"është e uritur"*, *"jaijeh"*, edhe nëse folja *"uelete"* ka të njëjtin kuptim.

shenjat e tij dalluese, ato shenja që e bëjnë dallimin të qartë, mes besimtarit dhe myslimanit, besimit të sinqertë dhe besimit të rremë. Aty tregohet qartë se besimtarët e vërtetë janë ata që i janë përgjigjur All'llahut dhe të Dërguarit të Tij, shtyrë prej dashurisë së madhe për ta, jo për të përfituar të mirat materiale të kësaj bote. All'llahu i Madhëruar thotë: **"Besimtarë të vërtetë janë vetëm ata që besojnë All'llahun dhe të Dërguarin e Tij dhe pastaj nuk dyshojnë, por luftojnë në Rrugën e All'llahut..."**.

Sigurisht, që shenja e parë dhe kryesore e besimit është vendosmëria në rrugën e Islamit. Shenja e dytë është përpjekja dhe sakrifikimi i pasurisë, ndërsa shenja e tretë, që është edhe më e rëndësishmja prej të gjithave, është sakrifikimi me veten.

Kështu, Islami synon shenjat më të qarta, nga njëra anë, vendosmërinë dhe qëndrueshmërinë, ndërsa, në anën tjetër, sakrifikimin e jetës dhe pasurisë.

Si të mos ngulitet besimi thellë në zemrën e një njeriu, që sakrifikon paranë dhe jep shpirtin, për hatër të dashurisë së madhe që ka në gjoks?!

Kjo është edhe arsyeja, pse ajeti mbyllet me shprehjen që vjen në formën e garancisë: **"...Ata janë besimtarë të vërtetë!"**.

Kjo është njësia matëse e vërtetë që përcakton Islami, për të bërë dallimin mes besimtarëve të vërtetë dhe gënjeshtarëve, të cilët pretendojnë besimin dhe shfaqen si myslimanë. Njësia matëse që përmendet në ajet, nuk është e lidhur vetëm me zbulimin e të vërtetës së besimit të fisit Beni Esed, por është njësia e vlefshme, e qartë dhe e drejtë për të gjitha kohërat dhe njerëzit. Ajo është një instrument shumë i rëndësishëm, për të saktësuar

vijën ndarëse mes besimtarëve të vërtetë dhe atyre që maskohen me Islamin. Ajo zbriti për të treguar vlerën reale të atyre që erdhën pranë Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* për ta shitur besimin e tyre të shtirur si nder karshi Tij, ndërsa kur vinte puna në praktikë, nuk tregonin asnjë shenjë të besimit dhe Islamit të tyre.

Përballë, kësaj kategorie njerëzish, qëndrojnë ata që heshtin, nuk flasin dhe as e tregtojnë besimin e tyre si nder ndaj Profetit apo All'llahut. Janë ata që e shohin veten e tyre përherë të mangët e të paplotësuar, ndërkohë që, në realitet, janë flamurtarët e sakrificës në pasuri dhe jetë, për hir të All'llahut të Madhëruar.

Nëse do ta marrim Kur'anin, për ta përdorur si njësi matëse, për të dalluar besimtarët e vërtetë dhe për të bërë veçimin e tyre prej mashtruesve e gënjeshtarëve, arrijmë të dallojmë lehtësisht cilët janë ata qindra, mijëra, madje miliona njerëz, që pretendojnë Islamin dhe e deklarojnë sipërfaqësisht atë dhe cilët janë besimtarët e vërtetë.

Ajetet 16 - 18

قُلْ أَتُعَلِّمُونَ ٱللَّهَ بِدِينِكُمْ وَٱللَّهُ يَعْلَمُ مَا فِى ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَمَا فِى ٱلْأَرْضِ ۚ وَٱللَّهُ بِكُلِّ شَىْءٍ عَلِيمٌ ١٦ يَمُنُّونَ عَلَيْكَ أَنْ أَسْلَمُوا۟ ۖ قُل لَّا تَمُنُّوا۟ عَلَىَّ إِسْلَٰمَكُم ۖ بَلِ ٱللَّهُ يَمُنُّ عَلَيْكُمْ أَنْ هَدَىٰكُمْ لِلْإِيمَٰنِ إِن كُنتُمْ صَٰدِقِينَ ١٧ إِنَّ ٱللَّهَ يَعْلَمُ غَيْبَ ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَٱلْأَرْضِ ۚ وَٱللَّهُ بَصِيرٌۢ بِمَا تَعْمَلُونَ ١٨

"Thuaju: 'Vallë, a do ta njoftoni All'llahun për fenë tuaj, ndërkohë që Ai di gjithçka që përmbajnë qiejt dhe Toka?! All'llahu është i Dijshëm për çdo gjë.'"

"Ata e quajnë si favor për ty që kanë pranuar Islamin. Thuaju: 'Mos e quani si favor për mua se keni pranuar Islamin; përkundrazi, All'llahu ju ka dhuruar mirësi dhe ju ka udhëzuar në besim, nëse ajo që thoni është e vërtetë!'"

"All'llahu i di fshehtësitë e qiejve dhe të Tokës. All'llahu i sheh të gjitha ato që bëni ju."

Shkaku i zbritjes

Disa komentues kanë thënë se pas zbritjes së ajeteve të mësipërme, objekt të studimit tonë, te Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* erdhi një grup i arabëve të shkretëtirës, ku iu betuan atij se janë të sinqertë në besimin e tyre, si në atë që shprehin me gojë, ashtu edhe në atë që kishin në zemër. Për këtë rast zbriti ajeti 16, thjesht për t'i paralajmëruar ata që të mos betoheshin, pasi All'llahu i Madhëruar ka dijeni të plotë për atë që e shfaqin dhe për atë që e fshehin, se asgjë në qiej e Tokë, nuk mund të dalë jashtë kontrollit dhe vëmendjes së Tij.[1]

Komentimi

Mos e shisni Islamin si ndonjë nder të ofruar ndokujt!

Ajetet e mëparshme përcaktuan qartë shenjat e besimtarëve të sinqertë, duke qenë se e përmendëm më lart, shkak i zbritjes së këtij ajeti ishte ardhja e një grupi arabësh të shkretëtirës te Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e*

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", tefsiri "El Mijzan", tefsiri "Ruhul Bejan" dhe tefsiri i "Kurtubijjut".

tij!), të cilët i deklaruan atij se besimi i tyre ishte i vërtetë, i qëndrueshëm dhe i sinqertë. Këto ajete zbritën për t'u treguar atyre se nuk ishte e nevojshme të ngulnin këmbë dhe, për më tepër, të betoheshin. Ky sqarim dhe paralajmërim është për të gjithë ata që ngjasojnë me grupin e arabëve, pasi çështja e besimit dhe e mohimit është e pranishme te dija e All'llahut, i cili është i mirinformuar përreth gjithçkaje.

Thelbi kuptimor i ajetit mbart, në vetvete, një kritikë të madhe. Në ajetin 16 thuhet: **"Thuaju: 'Vallë, a do ta njoftoni All'llahun për fenë tuaj, ndërkohë që Ai di gjithçka që përmbajnë qiejt dhe Toka...?!'"**.

Për ta përforcuar më tej, thelbin e mësipërm, ajeti shton: **"...All'llahu është i Dijshëm për çdo gjë."**.

Kjo do të thotë se All'llahu i Madhëruar, me Qenien e Tij të Shenjtë[1], ka dijen e Tij të plotë, që është e përhershme dhe e pafundme.

Qenia e Tij e Shenjtë, është e pranishme kudo dhe në çdo vend. Ai është më pranë jush se sa damari i qafës. Ai gjendet aty, në hapësirën mes njeriut dhe qenies së tij. Duke iu referuar këtyre cilësive, nuk është e nevojshme të deklaroni apo të mos deklaroni, te Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!),* besimin tuaj, pasi All'llahu i dallon qartë të sinqertët nga gënjeshtarët. Ai ka informacion të plotë për gjithçka fshihet thellësive të qenies së tyre, madje deri për nivelin e

[1] Te e folura e disa njerëzve, është e përhapur shprehja: Cilësitë e Zotit është vetë Qenia e Tij dhe Qenia e Tij janë vetë cilësitë e Tij", dhe të tjera të ngjashme me këtë. Kjo është një shprehje e dobët. E vërteta është ajo që gjendet në tekst (e korrigjuar).

besimit, përfaqësuar në forcë dhe dobësi. Mund të ndodhë që, ata të mos e njohin veten e tyre, por All'llahu i njeh qartësisht ata. Atëherë, përse ngulni këmbë t'i tregoni All'llahut për cilësinë e besimit tuaj?!

Më pas, Kur'ani u kthehet deklaratave të arabëve të shkretëtirës, që e paraqisnin Islamin dhe besimin e tyre, si ndonjë nder që ata bënin për hir të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!),* ndërkohë që atë e kishin luftuar fiset e tjera arabe.

Për këtë arsye, vjen përgjigjja e Kur'anit, për deklaratat e tyre pa sens: **"Ata e quajnë si favor për ty që kanë pranuar Islamin. Thuaju: 'Mos e quani si favor për mua se keni pranuar Islamin; përkundrazi, All'llahu ju ka dhuruar mirësi dhe ju ka udhëzuar në besim, nëse ajo që thoni është e vërtetë!'"**.

Fjala *"el minnetu"*, ashtu si e kemi shpjeguar edhe më parë, buron nga fjala *"el mennu"*, kuptimi i saj është: peshore e veçantë**,** me të cilën bëhet peshimi. Më pas, ky term është përdorur për të nënkuptuar çdo mirësi e begati të shtrenjtë dhe me vlerë që ka njeriu. *El Minetu* është dy llojesh: Po qe se bëhet fjalë për anën e saj praktike, që konsiston në dhënien e një të mire apo dhurate, kjo është ana pozitive dhe e pranueshme e çështjes. Dhuratat dhe mirësitë e All'llahut konsiderohen e janë realisht pjesë e këtyre kuptimeve. Por, nëse bëhet fjalë për atë lloj *menni***,** që lidhet me fjalët e thëna, pas kryerjes së një mirësie, duke ia kujtuar vazhdimisht tjetrit të mirën e bërë, në këtë rast, konsiderohet vepër e ulët dhe e papëlqyeshme.

Është domethënës fakti që fillimi i ajetit shprehet: **"Ata e quajnë si favor për ty që kanë pranuar Islamin."**. Kjo vërteton edhe njëherë faktin, se besimi i tyre nuk ka qenë i sinqertë.

Në fund të ajetit, vjen një tjetër shprehje: **"...përkundrazi, All'llahu ju ka dhuruar mirësi dhe ju ka udhëzuar në besim, nëse ajo që thoni është e vërtetë!"**.

Në të gjitha rastet, kjo përbën një çështje të rëndësishme, tek e cila duhet të përqendrohen të gjithë ata që mendojnë se, me pranimin e besimit dhe kryerjen e obligimeve adhuruese, i ofrojnë ndonjë shërbim të caktuar Shenjtërisë së All'llahut apo Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e për këtë arsye presin shpërblime.

Nëse drita e besimit lind te zemra e dikujt dhe arrin suksesin e të qenit prej grupit të besimtarëve, atëherë ky individ gjendet i përfshirë në mirësinë e madhe të All'llahut. U lartësoftë Emri i Tij!

Besimi, para së gjithash, i dhuron individit perceptime të sakta dhe të drejta përreth ekzistencës. Shikimit të tij i heq perden e vetëpëlqimit dhe të egoizmit. Ai zgjeron horizontet e shikimit, qartëson për të madhështinë e krijimit, në sytë e vetvetes.

Besimi hedh në ndjenjat e besimtarit dritë e ndriçim. Ai i fuqizon ato dhe jetëson te qenia e tij vlerat më të larta njerëzore. Ai rrit gatishmërinë e individit, i dhuron atij dije, forcë, burrëri, gatishmërinë për të sakrifikuar, falje, tolerancë dhe sinqeritet. Ai e bën njeriun të fortë e frytdhënës, edhe pse është një qenie e dobët.

Besimi është ai që e ngre njeriun në shkallën më të lartë të përsosmërisë dhe të krenarisë. Ai e plotëson individin në harmoni

të plotë me ekzistencën, duke ia nënshtruar këtë të fundit urdhrave të tij.

Cila është mirësia në këtë rast?! Kjo, që All'llahu i ka dhënë njeriut, apo ajo, që njeriu shkon dhe e parashtron te Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!),* si veprim i kryer në nder të Tij?!

Kështu pra, nënshtrimi ndaj All'llahut të Madhëruar dhe të gjitha ritet adhuruese, janë hapa të rëndësishme në rrugën drejt përsosmërisë. Ato i dhurojnë zemrës kthjelltësi, si dhe aftësinë për të kontrolluar epshet. Ato e forcojnë në thellësi të qenies shpirtin e sinqeritetit, sikur i japin shoqërisë islame unitetin, forcën dhe madhështinë, si një masë unike.

Secili prej këtyre riteve madhështore, është një mësim i madh edukativ dhe një fazë e rëndësishme në rrugën e vështirë drejt përsosmërisë.

Nisur nga sa u tha më lart, për njeriun del detyrë, që natë e ditë, të falënderojë All'llahun për mirësitë e mëdha, të lëshohet me qenien e tij në sexhde, pas çdo namazi e adhurimi e ta falënderojë përulësisht, për gjithçka, All'llahun.

Nëse njeriu do ta vlerësonte dhe do ta gjykonte veten e tij nga këto pozita, nga ky nivel i besimit dhe i nënshtrimit ndaj All'llahut, nuk do të besonte kurrsesi që Islami apo besimi i tij, është nder që kryhet për Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!),* përkundrazi e shtyn atë ta ndiejë veten borxhli ndaj All'llahut dhe të Dërguarit të Tij, i përfshirë nga mirësia e Tij të madhe. Ai do t'i kryente adhurimet me mall e do të vihej në shërbim të urdhëresave të Zotit me kokë

dhe jo me këmbë. E, nëse All'llahu e shpërblen, kjo konsiderohet një tjetër mirësi dhe begati e Tij, përndryshe kryerja e veprave të mira, është e vlefshme për vetë individin. E vërtetë është, se ky konsiderohet një tjetër sukses, që shtohet në peshoren e veprave të tij, tek All'llahu i Madhëruar.

Nisur nga sa përmendëm më sipër, udhëzimi i All'llahut është mirësi e Tij. Thirrja e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është një tjetër mirësi. Të jesh i suksesshëm në adhurim e nënshtrim, është mirësi e shumëfishuar, e të shpërblehesh për të gjithë këtë, është mirësi mbi mirësitë.

Në ajetit të fundit prej ajeteve në fjalë, i cili është edhe ajeti i fundit i sures "El Huxhurat", vjen një tjetër përforcim e mbështetje për atë që u theksua në ajetin e mëparshëm. All'llahu i Madhëruar thotë: **"All'llahu i di fshehtësitë e qiejve dhe të Tokës. All'llahu i sheh të gjitha ato që bëni ju."**.

Për këtë arsye, mos ngulni këmbë të vërtetoni besimin tuaj dhe as betimi nuk është i nevojshëm për këtë, pasi All'llahu i Madhëruar është i pranishëm në thellësi të zemrave tuaja. Ai i di të gjitha fshehtësitë e qiejve dhe të Tokës, si mund të mos dijë çfarë ka në zemrat tuaja? Si mund të mos dijë përbërjen e qenieve tuaja?!"

O All'llah! Ti na begatove me dritën e besimit, ndaj të betohemi Ty, të lutemi Ty, me madhështinë e mirësisë së udhëzimit, që t'i forcosh këmbët tona në këtë rrugë që ka destinacion përsosmërinë!

O Zoti ynë! Ti e di çfarë ka në zemrat tona! Ti ke dijeni të plotë rreth qëllimeve dhe synimeve tona, ndaj të lutemi Ty të fshehësh të metat

tona prej syve të robëve të Tu! Me bujarinë Tënde të madhe, rregulloje gjithçka të prishur te ne!

O Zoti ynë! Na e mundëso ne, që të mbështillemi me më të bukurat cilësi, me më të mirat morale, që Ti ke përmendur te kjo sure, derisa të hedhin rrënjë në qeniet tona, derisa të bëhen pjesë e thellësisë së mendjeve dhe e shpirtrave tanë!

Amin, o Zot i botëve!

Fundi i sures "El Huxhurat"

SURE "KÂF"

Zbritur në Mekë, 45 ajete

Përmbajtja e sures "Kâf"

Në boshtin e hulumtimeve të kësaj sureje, qëndron çështja e Ringjalljes. Gati të gjitha ajetet sillen rreth këtij boshti dhe disa çështjeve të tjera që lidhen me të.

Disa prej çështjeve që lidhen me Ringjalljen, kthimin te All'llahu, që trajtohen në këto ajete, janë:

1- Mohimi i jobesimtarëve për çështjen e kthimit, të Ringjalljes si dhe shfaqja e habisë ndaj saj. (Me kthimin, në këtë rast, nënkuptohet kthimi trupor e fizik.)

2- Argumentimi i çështjes së kthimit, duke iu referuar krijimit absolut, veçanërisht ringjalljes së tokës së vdekur, pasi laget nga shiu.

3- Argumentimi i çështjes së kthimit, nëpërmjet kthimit te logjika e krijimit në fillim të herës.

4- Trajtimi i çështjes së regjistrimit të veprave dhe fjalëve në Ditën e Gjykimit.

5- Trajtimi i çështjeve të lidhura me vdekjen dhe transferimi i njeriut nga kjo botë për në Botën Tjetër.

6- Përshkrimi i disa prej gjendjeve të Ditës së Gjykimit dhe përshkrimi i Xhennetit dhe i Xhehennemit.

7- Përshkrimi i ngjarjeve të tmerrshme e të frikshme të fundit të botës, të cilat konsiderohen edhe si pikënisja e Botës dhe Jetës Tjetër.

Surja trajton shkurtimisht edhe disa çështje ndikuese, si gjendja e popujve të hershëm, teksa përshkruan refuzimin dhe kundërshtinë e tyre të hapur ndaj projekteve të All'llahut për njerëzimin. Surja trajton, gjithashtu, fundin e tmerrshëm të

popujve, me në krye popullin e Faraonit, të Adit, të Lutit, të Shuajbit, të Tubbeit, si dhe disa udhëzime që All'llahu i ka dërguar Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!),* duke e orientuar atë për tek Ai. Në fillim të sures dhe në fund të saj, përmendet dhe trajtohet madhështia e Kur'anit Famëlartë.

Mirësia e këndimit të sures "Kâf"

Po t'i referohemi transmetimeve islame vëmë re, se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* interesohej shumë për suren "Kaf", aq sa e lexonte gjatë hytbes, çdo ditë xhumaje.[1]

Në një tjetër transmetim, theksohet se ai e ka lexuar atë çdo Bajram dhe çdo xhuma[2], sepse në ditën e Bajramit dhe në ditën e xhumasë, njerëzit janë më të kujdesshëm. Në këto ditë, ka një lloj demonstrimi të kthimit te natyra e parë e njeriut, si dhe rikthimit tek All'llahu, në Ditën e Gjykimit.

Duke qenë se ajetet e kësaj sureje trajtojnë çështjen e kthimit, të vdekjes, ngjarjet e Ditës së Gjykimit dhe mënyrën e përzgjedhur nga All'llahu i Madhëruar për trajtimin e tyre, ajo ka një ndikim të madh në zgjimin e njerëzve prej gjumit të paditurisë dhe edukimit të tyre. Pikërisht kjo, e ka bërë suren, që Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* të kishte interesim të veçantë për të.

[1] Tefsiri "Kurtubijj", vëll. 9, f. 6171.
[2] Tefsiri "Fi Dhilalil Kur'an", vëll. 7, f. 547.

Transmetohet se Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: *"Ai që, lexon a këndon suren 'Kaf', All'llahu ka për t'ia lehtësuar vështirësitë e vdekjes!"*.[1]

Transmetohet, gjithashtu, se Imam Bakiri *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: *"Ata që e lexojnë intensivisht suren 'Kaf' në namazet e obliguara dhe ato nafile, All'llahu do t'ua shtojë riskun, do t'ua japë Librin nga e djathta e tyre në Ditën e Gjykimit e do t'ua lehtësojë dhënien e llogarisë!"*.[2]

Nuk mendojmë se është e nevojshme, të kujtojmë lexuesin se e gjithë kjo mirësi dhe e gjithë kjo krenari, nuk është e lidhur vetëm me citimin e shkronjave, por leximi dhe këndimi duhet të jenë fillesa e zgjimit të mendimeve. Mendimet, në vetvete, janë pikënisja e veprave të mira dhe e harmonizimit të plotë të kuptimeve të kësaj sureje.

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 9, f. 140.
[2] Burimi i mëparshëm.

Ajetet 1 – 5

بِسۡمِ ٱللَّهِ ٱلرَّحۡمَٰنِ ٱلرَّحِيمِ

قٓۚ وَٱلۡقُرۡءَانِ ٱلۡمَجِيدِ١ بَلۡ عَجِبُوٓاْ أَن جَآءَهُم مُّنذِرٞ مِّنۡهُمۡ فَقَالَ ٱلۡكَٰفِرُونَ هَٰذَا شَيۡءٌ عَجِيبٌ٢ أَءِذَا مِتۡنَا وَكُنَّا تُرَابٗاۖ ذَٰلِكَ رَجۡعُۢ بَعِيدٞ٣ قَدۡ عَلِمۡنَا مَا تَنقُصُ ٱلۡأَرۡضُ مِنۡهُمۡۖ وَعِندَنَا كِتَٰبٌ حَفِيظُۢ٤ بَلۡ كَذَّبُواْ بِٱلۡحَقِّ لَمَّا جَآءَهُمۡ فَهُمۡ فِيٓ أَمۡرٖ مَّرِيجٍ٥

Me emrin e All'llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

"Kâf. Betohem në Kur'anin e Lavdishëm!"

"Po! Ata çuditen që nga gjiri i tyre u ka ardhur një paralajmërues, kështu që mohuesit thonë: 'Kjo gjë është e çuditshme.'"

"Vallë, pasi të vdesim e të bëhemi pluhur (do të ringjallemi sërish)**? Ai kthim është i largët!"**

"Ne e dimë sa prej tyre i merr toka, tek Ne është Libri që i ruan të gjitha."

“Mirëpo, ata e mohojnë të Vërtetën kur u vjen, kështu që ata janë në gjendje të turbulluar.”

Komentimi

Mohuesit kokëfortë janë të turbullt

Edhe një herë tjetër përballemi këtu me shkronjat e ndërprera, siç është shkronja “kaf”. Kemi thënë më parë, se një prej komenteve më autoritare, lidhur me këtë çështje, është fakti se Kur’ani, me gjithë madhështinë e tij, përbëhet prej shkronjave të thjeshta, si: elif, ba’a, etj. Ky është një tregues i rëndësishëm, që pohon se shpikësi i Kur’anit dhe Ai që e zbriti atë, gëzonin dije të pakufishme dhe aftësi absolute për ta ndërtuar këtë strukturë madhështore kuptimesh, edhe duke përdorur elemente të thjeshta.

Natyrshëm, që ekzistojnë komente edhe interpretime të tjera për shkronjat e ndërprera. Mund t’u kthehemi atyre në fillimet e sureve: “El Bekare”, “Ali Imran”, “El A’araf” dhe sures “Ha Mim”.

Disa komentues, kanë thënë se *“kaf”*, nënkupton disa prej Emrave të All’llahut, si: *El Kadir*, *El Kajum*, si dhe emra të tjerë që nisin më shkronjën *“kaf”*.

Në shumë komente të tjera, përmendet se "kaf" është emri i një mali të madh, i cili mund të rrethojë të gjithë Tokën.

Këtu lind pyetja: Cili mund të jetë ai mal, që mund të përfshijë rruzullin tokësor, apo gjithë perimetrin e Tokës?! Ç'synohet të përmendet nëpërmjet tij?! Sigurisht, nuk është ky vendi i duhur për të diskutuar rreth kësaj, por ajo që duhet të kujtojmë, në këtë kontekst, është fakti se, shkronja *"kaf"*, është larg të qenit emërtim për këtë mal, me toponimin *Kaf*. Kjo, jo ngaqë ky kuptim nuk përshtatet aspak me çështjet e trajtuara në sure, por, sepse shkronja *"kaf"* në këtë rast, është e barabartë me të gjitha shkronjat e veçuara që përmenden në fillimet e sureve të Kur'anit.

Për më tepër, në qoftë se do të ishte shkronja *"kaf"*, tregues për malin Kaf**,** atëherë do të duhej të shoqërohej prej vavit-të betimit, si e vëmë re, për shembull, te fjala e All'llahut të Madhëruar: **"Uet tur! - Betohem në malin Et Tur!"** dhe plot raste të tjera të ngjashme. Përmendja e një fjale të caktuar pa kryefjalë, pa kallëzues dhe pa *vavin* e betimit, nuk ka asnjë kuptim.

Përfundimisht, në të gjitha mënyrat e shkruara në Kur'an, shkronja *"kaf"*, vjen e ndarë si shkronjë *"k"*, ndërkohë që mali Kaf shkruhet në formën e një fjale, pra, *"kaf"*, jo *"K"*.

Nga treguesit e rëndësishëm, që tregojnë se shkronja *"kaf"* është prej shkronjave të shkëputura që shprehin në një formë të caktuar, madhështinë e Kur'anit, është fakti se pas kësaj shkronje, vjen menjëherë betimi. Betimi që All'llahu i Madhëruar bën për Kur'anin, duke thënë: **"Kâf. Betohem në Kur'anin e Lavdishëm!"**.

Fjala *"el mexhijd"*, përmendur në ajetin e mësipërm, buron prej fjalës *"el mexhdu"*, kuptimi gjuhësor i të cilës, është:

ndershmëri e madhe. Duke qenë se madhështia, nderi dhe lavdia e Ku'ranit janë të pakufishëm, atëherë ai është i lavdishëm në të gjitha dimensionet e tij. Kjo do të thotë se leximi i tij është i qartë, përmbajtja e tij është madhështore, mësimet e tij janë të mëdha, metodat e tij të studiueshme. Pra, e gjithë përmbajtja e Kur'anit, përçon shpirt dhe jetë në të gjitha qeniet njerëzore.

Gjithkush, ka të drejtë të pyesë: Cili është qëllimi i këtij betimi?! Ç'është në thelb targeti i vërtetë i betimit?! Komentuesit e Kur'anit kanë ngritur hipoteza të shumta për këtë problem, por, duke iu referuar ajeteve që pasojnë betimin, prej përgjigjes së tij, mund të kuptojmë se bëhet fjalë për çështjen e profetësisë së Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!),* ose për ringjalljen e njerëzve, pasi të kenë vdekur.[1]

Më pas, Kur'ani tregon disa shqetësime dhe iluzione të jobesimtarëve mohues e arabëve idhujtarë, duke përmendur dy prej tyre: Së pari, All'llahu i Madhëruar përshkruan në Kur'an: **"Po! Ata çuditen që nga gjiri i tyre u ka ardhur një paralajmërues, kështu që mohuesit thonë: 'Kjo gjë është e çuditshme.'"**.

Duke qenë se Kur'ani përmend problematikën e jobesimtarëve mohues dhe u përgjigjet atyre e kjo problematikë përsëritet shpesh, tregon se ajo, ka qenë një nga shqetësimet kryesore të mohuesve jobesimtarë.

Në fakt, nuk është vetëm Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ai që është

[1] Kuptimi i ajetit bëhet: "Kaf. Betohem në Kur'anin e Lavdishëm, që Ti, o Muhammed, je i Dërguari i All'llahut!"

përballur me problematikën e jobesimtarëve, por janë edhe Profetët e tjerë**.** Këtë, e tregon All'llahu i Madhëruar në Kur'an, ku thotë: **"Ata thanë: 'Ju jeni vetëm njerëz si ne! Ju dëshironi të na shmangni nga ajo që kanë adhuruar të parët tanë. Andaj, na sillni prova të dukshme!'"**.[1]

Ata, gjithashtu, kanë thënë: **"Ky është vetëm njeri si ju, ha nga ato që hani edhe ju, pi nga ato që pini edhe ju!"**.[2]

Ndonjëherë thanë edhe kështu**: "Përse nuk i është dërguar atij një engjëll e të bëhet me të paralajmërues?!"**.[3]

Ajo që mund të themi, me plot gojën, është fakti se të gjitha pretendimet e jobesimtarëve, janë tërësisht të pabaza dhe justifikime të kota, vetëm e vetëm për të mos pranuar nënshtrimin ndaj së vërtetës.

Tek ajetet, objekt i studimit tonë, Kur'ani nuk vjen për t'i dhënë përgjigje kësaj problematike, pasi ka dhënë përgjigje të shumta për të. All'llahu i Madhëruar synon të tregojë, se, nëse do të dërgojë një engjëll, do ta dërgojë atë në formën e një njeriu si gjithë të tjerët. Kjo do të thotë se liderët e njerëzimit duhet të jenë njerëz të dalë prej mesit të njerëzve, të ngjashëm me ta, sepse vetëm kështu do të mund të njihen me nevojat, hallet, dhimbjet dhe dëshirat që lidhen ngushtë me jetën e tyre. Ata, me dijet e tyre, duhet të jenë shembull për njerëzit, përndryshe do të thonë se, po të kishin qenë njerëz, si ne, ata nuk do të kishin rezistuar, duke qëndruar të pastër e të ndershëm.

---

[1] Sure "Ibrahim", ajeti 10.
[2] Sure "El Mu'minun", ajeti 33.
[3] Sure "El Furkan", ajeti 7.

Në të vërtetë, struktura e krijimit të engjëjve është e përshtatshme vetëm për ata dhe nuk mund të përshtatet me synimet e njerëzve dhe dhimbjet e tyre.

Përveç problematikës së parë, që shfaqin dhe ngrenë mosbesuesit, me pamundësinë e të qenit të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* njeri si gjithë të tjerët, ata ngrenë edhe një tjetër problem, që lidhet me përmbajtjen e thirrjes së tij. Mosbesuesit, drejtuan gishtërinjtë e habisë së tyre drejt një çështjeje themelore të Islamit, e thanë: **"Vallë, pasi të vdesim e të bëhemi pluhur** (do të ringjallemi sërish)**? Ai kthim është i largët!"**.[1]

Gjithsesi, në imagjinatën e tyre, kthimi edhe njëherë në jetë pas vdekjes, ishte një gjë që logjika e tyre nuk mund ta pranonte. Madje, ata, shkonin dhe më tej, teksa pretendonin se kjo ishte një gjë tërësisht e pamundur, se të gjithë ata që e besonin një gjë të tillë, ishin budallenj e të sëmurë mendorë. Kjo tablo bëhet më e qartë, kur lexojmë ajetet 7-8 të sures "Es Sebe": All'llahu i Madhëruar thotë: **"Ndërsa jobesimtarët thonë: 'A doni t'ju tregojmë një njeri,** (d.m.th. Muhammedin/*Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*)**, që pretendon se, kur të shpërbëheni plotësisht e të bëheni pluhur, ju, me siguri do të rikrijoheni nga e para? A po trillon gënjeshtra për All'llahun apo është i çmendur?'"**.

Ky nuk ishte një problem i tyre, që lidhej me një pretendim ndaj Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe*

[1] Përgjigjja e *(idha)* është e padukshme dhe ajo kuptohet prej fjalisë që e pason atë, kuptimi i të cilës është: "Pasi të vdesim e të bëhemi pluhur, do të kthehemi edhe një herë në jetë? Ai kthim është i largët?"

mbi familjen e tij!), pasi ata e kishin ngritur shpesh këtë çështje, madje dhe e kishin marrë përgjigjen e merituar prej Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Por kjo, ishte një çështje, që lidhej ngushtë me urrejtjen dhe inatin e tyre.

Në të gjitha rastet, Kur'ani ua kthen atyre përgjigjen në forma të ndryshme. Nganjëherë, ai përmend diturinë e gjerë të All'llahut, kur thotë: **"Ne e dimë sa prej tyre i merr toka, tek Ne është Libri që i ruan të gjitha."**.

Nëse shqetësimi i tyre lidhet me pyetjet: "Si mund të mblidhen kockat e shpërbëra të njeriut, mishi i tij bërë pluhur dhe atomet e tij shndërruar në gazra e avuj të ndryshëm në ajër?! Kush është ai që mund t'i mbledhë ato bashkë?! Apo, kush është ai që e zotëron një dije të tillë?!", atëherë mund të themi, se përgjigjja e secilës prej këtyre pyetjeve është më se e ditur: Ai, është All'llahu! Ai ka dijeni për gjithçka në Tokë e në qiej! Është Ai që di si t'i mbledhë edhe njëherë të gjithë këto atome e molekula, t'i bëjë bashkë ato, në kohën që dëshiron e vendos Vetë. Ashtu, si grimcat e hekurit, që gjenden në një grumbull dheu, mund t'i mbledhim përsëri bashkë me anë të një magneti, ashtu edhe mbledhjen e grimcave të shpërbëra atomike të njeriut, All'llahu mund ta bëjë përsëri, fare lehtësisht.

Nëse shqetësimi i jobesimtarëve është se kush do t'i ruajë veprat e njeriut deri në Ditën e Kthimit, përgjigjja është e qartë: Të gjitha veprat e njerëzve janë të regjistruara e të ruajtura tek Leuhi Mahfudhi. Aty nuk humbet asgjë prej ndodhive të regjistruara gjatë ekzistencës. Për këtë arsye, gjithçka, bashkë me to edhe

veprat tuaja, do të qëndrojnë të ruajtura aty, edhe nëse e ndryshojnë formën e tyre.

Sifjalia: **"Tek Ne është Libri që i ruan të gjitha."**, nënkupton librin ku mbahen të regjistruara veprat e të gjithë njerëzve dhe gjithçka që ndodh në botë. Sifjalia e mësipërme tregon qartë **Leuhi Mahfudhin**, kuptimin e të cilit e kemi zbërthyer me imtësi në fund të ajetit 39 të sures "Err Era'ad".

Më pas, Kura'ni u jep atyre një përgjigje tjetër, ku shpaloset më shumë natyra e kundërshtisë dhe e refuzimit të tyre. All'llahu i Madhëruar thotë: **"Mirëpo, ata e mohojnë të Vërtetën kur u vjen..."**.

Kjo do të thotë se ata e kanë mohuar të vërtetën, edhe pse kanë dijeni të plotë përreth saj, por pretendimet dhe dredhitë e tyre nuk mund ta mjegullojnë të vërtetën. Këtë problem do ta shohim të zbardhet qartësisht tek ajetet që do të vijnë më pas. Një shembull të qartë, në miniaturë, të Ditës së Kthimit, ata e shohin me sytë e tyre që në këtë botë, ndaj nuk ka asnjë mundësi logjike, që të kenë luhatje apo të dyshojnë.

Për këtë arsye, Kur'ani e mbyll këtë ajet: **"...Ata janë në gjendje të turbulluar."**.

Pra, duke qenë se e përgënjeshtruan Mesazhin e All'llahut, pa dyshim që gënjeshtra e tyre do të shkaktojë tek ata kundërshti në deklarata, dyshime në vepra dhe lëkundje në sjellje.

Kështu, një herë thonë se Profeti Muhammed është me të meta mendore, një herë poet, një herë tjetër magjistar, here-herë i konsiderojnë fjalët e tij si legjenda të së shkuarës. Nuk mungojnë

të thonë se pas tij qëndron dikush që e mëson. Përsëri e quajnë magjistar, duke iu referuar ndikimit që kanë fjalët e tij në mendjet dhe zemrat e njerëzve.

Një herë tjetër thonë se edhe ata mund të sjellim një Kur'an si Kur'ani i Muhammedit.

Të gjitha këto deklarata dhe pretendime të lëkundura e të veçuara, tregojnë qartë se ata e kishin kuptuar të vërtetën, por sajonin justifikime të ndryshme e të paqena. Kjo ishte edhe arsyeja, përse nuk i qëndronin një fjale apo një pretendimi të vetëm.

Për sa i përket fjalës *"të turbullt"*, ajo buron nga fjala *"merexhe"*, me të njëjtën formë me atë të fjalës *"harxhe"*, kuptimi i saj është: çështje e turbullt, mendime dhe ide të ngatërruara me njëra-tjetrën, të veshura me hije hutimi dhe dyshimesh. Kjo është edhe arsyeja pse tokën që prodhon bimë të ndryshme e të shumëllojshme, e kanë quajtur *merexh* apo *merta'a.*

Ajetet 6 – 11

أَفَلَمْ يَنظُرُوٓاْ إِلَى ٱلسَّمَآءِ فَوْقَهُمْ كَيْفَ بَنَيْنَٰهَا وَزَيَّنَّٰهَا وَمَا لَهَا مِن فُرُوجٍ۝٦ وَٱلْأَرْضَ مَدَدْنَٰهَا وَأَلْقَيْنَا فِيهَا رَوَٰسِيَ وَأَنۢبَتْنَا فِيهَا مِن كُلِّ زَوْجٍۭ بَهِيجٍ۝٧ تَبْصِرَةً وَذِكْرَىٰ لِكُلِّ عَبْدٍ مُّنِيبٍ۝٨ وَنَزَّلْنَا مِنَ ٱلسَّمَآءِ مَآءً مُّبَٰرَكًا فَأَنۢبَتْنَا بِهِۦ جَنَّٰتٍ وَحَبَّ ٱلْحَصِيدِ۝٩ وَٱلنَّخْلَ بَاسِقَٰتٍ لَّهَا طَلْعٌ نَّضِيدٌ۝١٠ رِّزْقًا لِّلْعِبَادِ ۖ وَأَحْيَيْنَا بِهِۦ بَلْدَةً مَّيْتًا ۚ كَذَٰلِكَ ٱلْخُرُوجُ۝١١

“A nuk e shohin ata qiellin që qëndron sipër tyre, si e kemi ndërtuar dhe zbukuruar, pa pasur kurrfarë plasaritje në të?”

“Ndërsa Tokën e kemi shtruar dhe në të kemi shpërndarë male të palëvizshme dhe kemi bërë, që nga ajo, të mbijnë gjithfarëlloj bimësh të bukura.”

“Si mjet ndriçimi të mendjes dhe përkujtesë për çdo rob që i drejtohet Zotit të vet.”

“Ne lëshojmë nga qielli ujë të bekuar dhe nëpërmjet tij krijojmë kopshte, drithëra që korren.”

“Dhe palma hurme të larta me tufa frutash njëra mbi tjetrën.”

“Si ushqim për robtë Tanë; në këtë mënyrë Ne me shi e ringjallim tokën e vdekur. E kështu do të jetë edhe Ringjallja.”

Komentimi

Shikojeni qiellin për një moment!

Këto ajete vazhdojnë të trajtojnë argumentet e Ringjalljes. Kështu, një herë flitet për aftësinë absolute të All'llahut, për t'i rikthyer njerëzit në Ditën e Kthimit dhe herë tjetër argumenton kthimin, duke sjellë shembuj nga realiteti i përditshmërisë së kësaj bote, të ngjashme me procesin e rikthimit.

Ajeti tërheq vëmendjen e mohuesve te mrekullia e krijimit të qiejve dhe thotë: **"A nuk e shohin ata qiellin që qëndron sipër tyre, si e kemi ndërtuar dhe zbukuruar…"**.

Me fjalën *"shikim"*, në këtë rast, nënkuptohet të parët e harmonizuar me mendimin, që fton të zotin e tij të njohë madhështinë e Krijuesit, që krijoi qiellin e gjerë, me të gjitha mrekullitë e mahnitshme që ka në të, me të gjitha bukuritë, rregullin, saktësinë dhe qëndrueshmërinë.

Për sa i përket kuptimit të sifjalisë: **"...pa pasur kurrfarë plasaritje në të",** do të thotë, pa kurrfarë çarje në të. Kjo sifjali mund të ketë njërin nga këto dy kuptime: Ajo nënkupton se, në krijimin e tyre, nuk ka asnjë të metë apo mangësi. Ky është dhe mendimi i disa komentuesve, por mund të nënkuptojë mungesën e të çarave tek ajo masë e madhe qiellore, që mbështjell rruzullin tokësor, atë që quhet atmosferë, të cilën Kur'ani Famëlartë e quan *Es sekf el Mahfudh - tavan mbrojtës,* në ajetin 32 të sures "El Enbija". Kjo shtresë e mbron Tokën prej depërtimit të rrezeve të dëmshme

dhe prej meteorëve, të cilët bien vazhdimisht drejt saj me shpejtësi marramendëse. Këta meteorë, sapo ndeshin me këtë shtresë mbrojtëse të Tokës, bëhen shkrumb e hi. Kjo shtresë e mbron e Tokën, gjithashtu, prej depërtimit të rrezeve të dëmshme të Diellit, por edhe prej rrezatimeve të tjera që vijnë prej hapësirave qiellore. Përndryshe, kuptimi i fjalës *"qiell"*, është hapësira e gjerë qiellore në të cilën notojnë yjet.

Këtu, kemi të bëjmë me një mundësi të tretë: sifjalia e mësipërme nënkupton teorinë e ekzistencës, *El Ethir* apo *Eteri*. Sipas kësaj teorie, gjithë ekzistenca, me hapësirat që janë mes yjeve, është e mbushur me një lëndë pa ngjyrë, që quhet Eter. Kjo lëndë e përçon dritën nga njëra pikë te tjetra. Sipas kësaj teorie, nuk ka mundësi të ekzistojë asnjë gropë, asnjë e çarë, asnjë boshllëk në të gjithë ekzistencën, se të gjitha yjet dhe trupat qiellorë notojnë brenda kësaj lënde, që quhet Eter.

Natyrshëm, ndërmjet këtyre tri komenteve, nuk ekziston asnjë kontradiktë apo kundërshti, edhe pse teoria e tretë, që bazohet tek Eteri, nuk merret shumë në konsideratë, e tek ajo nuk mund të mbështetemi, pasi çështja e Eterit vazhdon të mbetet objekt studimi dhe nuk është ende e provuar tërësisht.

Ajeti në vijim flet për madhështinë e Tokës: **"Ndërsa Tokën e kemi shtruar dhe në të kemi shpërndarë male të palëvizshme dhe kemi bërë, që nga ajo, të mbijnë gjithfarëlloj bimësh të bukura."**.

Në të vërtetë, kemi krijimin e Tokës në njërën anë, ndërsa, në anën tjetër, zgjerimin e saj, daljen prej ujit. Prania e maleve në Tokë dhe lidhja e tyre me njëri-tjetrin, janë si një zinxhir që e

mban Tokën të shtrënguar e të tendosur, duke e mbrojtur prej trysnive që i vijnë nga nëntoka dhe hapësira, siç janë: ekzistenca e baticës dhe e zbaticës, si dukuri që shkaktohen prej forcës tërheqëse të Diellit dhe Hënës, ekzistenca e llojeve të ndryshme të bimëve, me të gjitha mrekullitë që ato përfaqësojnë në krijim, formë e bukuri, etj. Të gjitha këto janë tregues i qartë i aftësisë absolute të Krijuesit.[1]

Ndërsa shprehja: **"prej secilit çift"**, nënkupton çështjen e çiftëzimit në botën e bimëve, e cila ka qenë tërësisht e panjohur, si teori e përgjithshme, lidhur me shumimin e bimëve, në kohën kur kanë zbritur ajetet, objekt i studimit tonë. U desh të kalojnë shumë shekuj, derisa shkenca arriti t'i zbulojë këto të vërteta. Ajo mund të nënkuptojë, gjithashtu, shumëllojshmërinë e bimëve, pasi, siç dihet, larmia dhe shumëllojshmëria në botën e bimëve është tejet e çuditshme dhe për më tepër, mahnitëse.

Ajeti që vijon, është tregues i rezultantes. All'llahu i Madhëruar thotë se të gjitha këto argumente, shërbejnë **"Si mjet ndriçimi të mendjes dhe përkujtesë për çdo rob që i drejtohet Zotit të vet."**.[2]

Vërtet, Ai që ka aftësi të krijojë qiejt dhe çka në to, prej madhështisë e bukurisë, Ai që krijoi Tokën dhe çka në të, prej mirësive, bukurive e përpikërisë, si është e mundur të mos jetë i aftë t'u veshë të vdekurve, edhe njëherë rrobën e jetës, të

[1] Kemi kryer një hulumtim të imtësishëm rreth rëndësisë së maleve, gjerësisë së Tokës dhe shtrirjes së saj, rreth çiftëzimit të bimëve, te fundi i ajetit 3, surja "Err Rra'ad".

[2] Është e mundur që fjala *"tebsireten"* të jetë kallëzues, por mund të jetë edhe kallëzues. Mundësia e parë është më pranë të vërtetës. I njëjti diskutim bëhet edhe për të trajtuar fjalën *"dhikra"*.

rezervojë për ta një kthim, edhe një tjetër jetë?! A nuk është e aftë një fuqi me përmasa të tilla, të jashtëzakonshme, argumenti më i qartë për mundësinë e Ringjalljes?!

Tek ajeti që vijon, vjen një tjetër argument, lidhur me këtë çështje, prandaj All'llahu i Madhëruar, thotë: **"Ne lëshojmë nga qielli ujë të bekuar dhe nëpërmjet tij krijojmë kopshte, drithëra që korren."**.

Me fjalën *"xhennat" - "kopshte"*, nënkuptohen kopshtet e pemëve që japin fryte, ndërsa me fjalën *"hab el hasijd" - "drithëra"*, nënkuptohen llojet e drithërave që konsiderohen prej lëndëve bazë të ushqimit të njerëzve, siç janë: gruri, elbi, misri, etj.

Më pas, ajeti 10, thotë: **"Dhe palma hurme të larta me tufa frutash njëra mbi tjetrën."** Fjala *"basikatin" - "të larta"*, në këtë ajet, është shumësi i fjalës *"basikah"*, që nënkupton një pemë shtatlartë, ndërsa fjala *"et tal'u" – "hurma"*, nënkupton frytin e palmës që vjen më pas në formën e hurmës.

Fjala *"en nedijdu" - "njëra mbi tjetrën"*, nënkupton formën më të përpiktë të grumbullimit dhe të njëtrajtshmërisë. Është i ditur fakti se dega e palmës, para se të çahet, hapet, mbart hurma që qëndrojnë njëra mbi tjetrën, por, kur çahet, hapet, ajo merr një pamje të mrekullueshme dhe një formë mahnitëse.

Ndërsa ajeti i fundit i ajeteve, objekt i studimit tonë, thotë: **"Si ushqim për robtë Tanë; në këtë mënyrë Ne me shi e ringjallim tokën e vdekur. E kështu do të jetë edhe Ringjallja."**.[1]

Kështu, pra, këto ajete zbritën, për të shpalosur mirësitë e mëdha, me të cilat All'llahu ka begatuar njerëzit, për të lëvizur brenda tyre ndjenjën e falënderimit përgjatë rrugëtimit të njohjes së Tij. Ato vijnë për t'u kujtuar njerëzve se shembulli i kthimit dhe i ringjalljes demonstrohet çdo vit te jeta e tyre në këtë botë. Kështu, toka e vdekur, e shkretë dhe e thatë, dridhet dhe lëshon mbi trupin e vetvetes bimë të ndryshme, që çelin e lulëzojnë sa bien në kontakt me ujin. Janë këto shenja dhe këto zhvillime të bimëve, që të kujtojnë oshtimën e Ditës së Kiametit. Ato duken sikur flasin e thonë: "Ai është i vetëm dhe pa ortak!"

Nuk ka dyshim se e gjithë kjo lëvizje dhe të gjitha këto zhvillime, e zbulojnë të vërtetën nëpërmjet botës së bimëve. Kjo e vërtetë është: All'llahu që e krijoi ekzistencën, është i aftë t'i ringjallë të vdekurit edhe njëherë, sepse ndodhia e diçkaje është argumenti më i fortë për mundësinë e ekzistencës së saj.

[1] Këtë çështje e kemi studiuar te komentimi i ajeteve të tjera. Kthehu te komentimi i fundit i ajetit 9, të sures "El Fatir" dhe ajetet e fundit të sures "Ja Sin".

Ajete 12 - 15

كَذَّبَتۡ قَبۡلَهُمۡ قَوۡمُ نُوحٖ وَأَصۡحَٰبُ ٱلرَّسِّ وَثَمُودُ ١٢ وَعَادٞ وَفِرۡعَوۡنُ
وَإِخۡوَٰنُ لُوطٖ ١٣ وَأَصۡحَٰبُ ٱلۡأَيۡكَةِ وَقَوۡمُ تُبَّعٖۚ كُلّٞ كَذَّبَ ٱلرُّسُلَ فَحَقَّ
وَعِيدِ ١٤ أَفَعَيِينَا بِٱلۡخَلۡقِ ٱلۡأَوَّلِۚ بَلۡ هُمۡ فِي لَبۡسٖ مِّنۡ خَلۡقٖ جَدِيدٖ ١٥

“Para tyre ka mohuar populli i Nuhut, banorët e Ressit dhe fisi Themud.”

“Edhe fisi Ad, Faraoni dhe vëllezërit e Lutit.”

“Edhe banorët e Ejkës, edhe populli i Tubbas; të gjithë ata i quajtën gënjeshtarë të Dërguarit, prandaj kundër tyre u përmbush dënimi Im.”

“Vallë, a mos u lodhëm Ne gjatë krijimit të parë? Jo, por ata dyshojnë në krijimin e sërishëm.”

Komentimi

Nuk jam i vetmi që po sprovohem me armik

Këto ajete e trajtojnë çështjen e kthimit apo të Ringjalljes nga këndvështrime të ndryshme. Kështu, fillimi i ajetit, vjen për t'i dhënë qetësi zemrës së Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e në të njëjtën kohë, për ta argëtuar atë në një formë apo në një tjetër. Ajeti ka për qëllim të thotë se ti, o Muhammed, nuk je Profeti i parë që mohuesit dhe jobesimtarët e kanë përgënjeshtruar. Ata kanë përgënjeshtruar, veç të tjerash, edhe përmbajtjen, edhe thelbin e thirrjes tënde, që është kthimi dhe Ringjallja: **"Para tyre ka mohuar populli i Nuhut, banorët e Ressit dhe fisi Themud."**.

Grupi i Themudit, është populli i Profetit të madh Salih *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, i cili ka banuar në zonën e Hixhrit, në veri të Hixhazit.

Lidhur me banorët e Ressit, komentuesit e Kur'anit kanë dhënë mendime të ndryshme. Shumë prej tyre besojnë se ata janë një grup njerëzish, të cilët kanë banuar në Jemameh. All'llahu u kishte dërguar atyre një Profet, që quhej Handhaleh, por ata e kishin përgënjeshtruar atë dhe në fund e kishin hedhur në një pus. Një prej kuptimeve të fjalës "*ress*" është edhe "*pusi*", ndërsa kuptimi tjetër i kësaj fjale është: shenja e fundit dhe e pakët mbetur prej diçkaje. E vërteta është: Ky popull ka lënë shumë pak gjurmë në kujtesën historike.

Disa komentues të tjerë, mendojnë se bëhet fjalë për popullin e Shuajbit, se ata kanë qenë të njohur për shpimin e puseve, por duke qenë se banorët e Ejkës, të përmendur në ajetet që vijojnë, janë pikërisht populli i Shuajbit, atëherë bie poshtë ky pretendim.

Komentues të ndryshëm kanë thënë se ata janë pakica e popullit të Salihut, pra, Themudit, por, duke qenë se Themudi është përmendur në veçanti, atëherë edhe kjo mundësi duket e dobët dhe pa pikë mbështetje.

Nisur, nga sa u përmend më lart, mund të themi se komentimi i parë është më i përshtatshëm. Ky komentim është më i njohuri midis komentuesve të Kur'anit.

Më pas, Kur'ani shton: **"Edhe fisi Ad, Faraoni dhe vëllezërit e Lutit."**.

Vëllezërit e Lutit, në këtë rast, nënkuptojnë popullin e tij. Kur'ani e ka cilësuar Lutin, si vëllain e popullit të tij. Kjo shprehje është prej përdorimeve të natyrshme të gjuhës arabe në përgjithësi.

Kështu, dhe ata që vijnë pas tyre: **"Edhe banorët e Ejkës, edhe populli i Tubbas"**; Kuptimi i fjalës *"el ejketu"* është: *pemë të shumta, të dendura, të futura te njëra-tjetra, ose pemë me degë të kapërthyera midis tyre*. Kështu As'habul Ejkeh**,** banorët e Ejkës, është një grupim i popullit të Shuajbit, të cilët kanë banuar në një

zonë tjetër, veças Medjenit, zonë e mbipopulluar me pemë të dendura.[1]

Nëpërmjet "*Kaum Tubba*", populllit të Tubbas, nënkuptohet një pjesë e banorëve të Jemenit, sepse tubba është llagapi i mbretërve të Jemenit, çka pohon se ky populll i ndjek dhe i pason mbretërit e tij. Sipas kuptimit të përgjithshëm të shprehjes kur'anore, në këtë rast, por, edhe në një rast tjetër, siç është ajeti 37 i sures "Ed Dukhan", bëhet fjalë për një mbret të mbretërisë së Jemenit, emri i të cilit është Esad ebu Kerbi, si dhe përmendet në disa transmetime. Një grup komentuesish besojnë se ai ka qenë njeri i ndershëm dhe besimtar, i cili ftonte njerëzit të ndiqnin dhe të pasonin Profetët, por, për fat të keq, tentativat e tij dështuan, se populli nuk i bindej.[2]

Më poshtë, ajeti flet, për tetë popujt e sipërpërmendur, duke thënë: **"Të gjithë ata i quajtën gënjeshtarë të Dërguarit, prandaj kundër tyre u përmbush dënimi Im."**.

Vëmë re, në tekstin e mësipërm kur'anor, se të gjithë popujt e përmendur në ajet, kanë përgënjeshtruar Profetët e tyre. Kjo do të thotë se secili prej këtyre popujve, ka përgënjeshtruar Profetin e tij në një kohë të caktuar e të gjithë bashkë, kanë kryer veprën e përgënjeshtrimit të Profetëve, kur ata u janë shfaqur.

Një kuptim tjetër, mund të jetë fakti se përgënjeshtrimi i një Profeti, konsiderohet si përgënjeshtrim për të gjithë Profetët e tjerë, pasi përmbajtja e thirrjes së tyre ka qenë e njëjtë.

---

[1] Për më shumë sqarim, kthehu te fundi i ajeteve: 78 i sures "El Hixhr" dhe 176 i sures "Esh Shuara'a".

[2] Për më shumë sqarim, kthehu te fundi i ajetit 37 i sures "Ed Dukhan".

Në të gjitha rastet, popujt e sipërpërmendur, jo vetëm që i kanë përgënjeshtruar Profetët e tyre, por ata kanë mohuar, gjithashtu, çështjen e Njësimit dhe të Ringjalljes.

Fundi i këtyre popujve ishte mohimi, që më pas u kthye në fatkeqësi për ta. Disa prej këtyre popujve u sprovuan me shtrëngata e tufane, të tjerë i goditi rrufeja, ca u mbytën në lum Nil, të tjerëve iu hap toka e i përpiu brenda. Përfundimisht, të gjithë ata shijuan frytin e hidhur të mohimit, të refuzimit dhe të arrogancës së tyre. Kështu, All'llahu i Madhëruar sikur thotë: "Rri i qetë, o i Dërguari i All'llahut, se, nëse populli yt do të vazhdojë të përgënjeshtrojë e të të mohojë, gjendja dhe përfundimi i tij nuk ka për të qenë më e mirë se gjendja e popujve të lartpërmendur."

Më pas, Kur'ani trajton një tjetër argument prej atyre që mbështesin mundësinë e Ringjalljes dhe të Ditës së Gjykimit: **"Vallë, a mos u lodhëm Ne gjatë krijimit të parë...?"**.[1]

Kur'ani shkon më tej, duke thënë se ata nuk kanë dyshime, as janë lëkundur në besimin e tyre te krijimi, pasi ata e dinë shumë mirë, se krijuesi i njeriut është All'llahu i Madhëruar, por ata dyshojnë te Ringjallja, me gjithë praninë e argumenteve të qarta. All'llahu i Madhëruar thotë: **"...jo, por ata dyshojnë në krijimin e sërishëm."**.

Në të vërtetë, ata përjetojnë thellë mendjeve dhe qenieve të tyre një kundërshti të madhe, për shkak të fanatizmit të tyre të verbër. Nga njëra anë, besojnë se All'llahu është Ai që i ka krijuar

[1] Te shprehja e mësipërme, kemi të bëjmë me një shkurtim të padukshëm, (të fshehur) kuptimi i të cilit është: "*Vallë, a mos u lodhëm Ne gjatë krijimit të parë, që ta kemi të pamundur krijimin për herë të dytë?!*".

për herë të parë prej dheut, ndërsa, kur diskutohet çështja e Ringjalljes dhe e kthimit të sërishëm, prej të njëjtit dhè e pluhur, këtë e konsiderojnë të pamundur, të çuditshme dhe të papërfytyrueshme. Në fakt, edhe krijimi, edhe Ringjallja, janë plotësisht të ngjashme me njëra-tjetrën. Dispozitat dhe gjykimi i të ngjashmëve, në atë që lejohet dhe në atë që nuk lejohet, është i njëjtë.

Kështu, në këto ajete dhe në ajetet e mëparshme, Kur'ani e argumenton Ringjalljen dhe rikthimin në katër mënyra të ndryshme. Një herë përmendet dija e All'llahut**,** një herë tjetër aftësia e Tij, herë duke përmendur e duke kujtuar ringjalljen e bimëve dhe së fundi, duke kujtuar historinë e krijimit të njeriut prej gjenezës.

Sa herë t'i kthehemi ajeteve të Kur'anit, që lidhen me çështjen e Ringjalljes, do të përballemi me argumente të tjera, të cilat përmenden në mënyrë të pavarur në ajete të ndryshme. Kur'ani e ka vërtetuar çështjen e Ringjalljes nëpërmjet logjikës së shëndoshë dhe shprehjes së qartë, nëpërmjet një mënyre të mahnitshme e të pakontestueshme prej mohuesve, duke e qartësuar në formën më të mirë. Përfundimisht, nëse ata do t'i dorëzoheshin logjikës së shëndoshë, do të hiqnin dorë prej paragjykimeve, fanatizmit të verbër dhe zakoneve të pakuptimta. Ata do ta pranonin këtë fakt të rëndësishëm dhe do të kuptonin se Ringjallja dhe Dita e Gjykimit nuk është dredhi apo diçka e vështirë për t'u kuptuar.

Ajete 16 - 18

وَلَقَدْ خَلَقْنَا ٱلْإِنسَٰنَ وَنَعْلَمُ مَا تُوَسْوِسُ بِهِۦ نَفْسُهُۥ ۖ وَنَحْنُ أَقْرَبُ إِلَيْهِ مِنْ حَبْلِ ٱلْوَرِيدِ ١٦ إِذْ يَتَلَقَّى ٱلْمُتَلَقِّيَانِ عَنِ ٱلْيَمِينِ وَعَنِ ٱلشِّمَالِ قَعِيدٌ ١٧ مَّا يَلْفِظُ مِن قَوْلٍ إِلَّا لَدَيْهِ رَقِيبٌ عَتِيدٌ ١٨

"Ne e kemi krijuar njeriun dhe, Ne e dimë ç'i pëshpërit atij shpirti i vet. Ne jemi më pranë tij se damari i qafës së vet."

"Dy engjëj i rrinë atij nga e djathta dhe e majta."

"Dhe, për çdo fjalë që ai thotë, ka pranë vetes një mbikëqyrës të gatshëm (për ta shënuar atë)**."**

Komentimi

Regjistrimi i të gjitha fjalëve

Në këto ajete trajtohet një grup tjetër prej çështjeve të lidhura me rikthimin dhe Ringjalljen. Bëhet fjalë për kontrollin

dhe monitorimin e veprave të njeriut, për t'u përballur e për t'u ballafaquar me to në Ditën e Llogarisë së Madhe.

Ajeti nis me përmendjen e dijes absolute të All'llahut, e cila përfshin gjithçka që ekziston. Në ajet thuhet: "**Ne e kemi krijuar njeriun dhe, Ne e dimë ç'i pëshpërit atij shpirti i vet...**".

Fjala "*tuesuis*", buron nga fjala "*el uesuesetu*", kuptimi i saj, sipas Ragibit te vepra "Mufredat", është: *mendimet e panevojshme apo të padobishme, të cilat i vijnë ndërmend njeriut*. Origjina e fjalës "*el uisuas*", *është zëri shumë i ulët*. Në të njëjtën kohë, kjo fjalë nënkupton edhe zërin që bëjnë mjetet e zbukurimit, etj.

Kuptimi i "*uesuesit*", këtu në ajet është se All'llahu i Madhëruar, ashtu si është i mirinformuar rreth mendimeve tona të fshehta e të padeklaruara, natyrshëm, ka dijeni të plotë edhe mbi besimin, veprat dhe fjalët e tij, për të cilat do të kërkojë llogari në Ditën e Gjykimit.

Sijalia: **"Ne e kemi krijuar njeriun"**, nënkupton, se është e pamundur që Krijuesi i njerëzimit të mos ketë dijeni për imtësitë e krijesave të Tij, për ato që ka krijuar Vetë, në mënyrë të përhershme, pasi mirësitë dhe begatitë e All'llahut mbërrijnë te njerëzit në çdo moment të jetës së tyre. Nëse kjo mirësi do të ndërpritej për një çast të vetëm, jeta do të shuhej në Tokë. Prej këtyre begative të mëdha, hyn drita e diellit, që buron nga mirësia e Tij dhe shpërndahet në të gjithë rruzullin tokësor. Ashtu siç do të bëjmë të ditur më pas, lidhja jonë me Qenien e Shenjtë të All'llahut, është shumë më e ngushtë dhe më e lartë se shembulli me dritën e diellit, që sollëm.

Në të vërtetë, All'llahu është Krijuesi dhe krijesat e Tij janë të përhershme, të vazhdueshme, kështu që ne jemi të lidhur me Të në të gjitha rastet. Atëherë, duke iu referuar kësaj situate, si është e mundur, që Ai të mos ketë dijeni për gjendjet tona të fshehta dhe të dukshme?!

Për më tepër, shpjegimi vjen te fundi i ajetit kur'anor, që thotë: **"...Ne jemi më pranë tij se damari i qafës së vet."**.

Sa domethënëse është kjo shprehje! Jeta jonë trupore është lidhur me një damar, që transporton gjakun në zemër e më pas e nxjerr atë prej saj, nëpërmjet një rregulli të mahnitshëm, duke e shpërndarë atë te të gjitha organet e trupit. Nëse ky damar, nuk do të punojë, qoftë dhe një fragment të vetëm, njeriu vdes. Ndërkohë, ajeti njofton se All'llahu i Madhëruar është më pranë njeriut se sa ai damar që quhet, *el hablul uerid*.

Këtë e ka sqaruar Kur'ani edhe në një përcjellje tjetër: **"Ta dini se All'llahu ndërhyn midis njeriut dhe zemrës së tij, se tek Ai do të ktheheni të gjithë!"**.[1]

Natyrshëm, ky është një krahasim i përafërt, pasi afërsia e All'llahut të Madhëruar me krijesën e vet është shumë më e madhe dhe shumë më e mahnitshme. Shembulli i përdorur në Kur'an, është mënyra e mundshme, më domethënëse, për të paraqitur këtë afërsi dhe për ta bërë atë sa më të rrokshme prej mendjes njerëzore.

Në gjithëpërfshirjen e All'llahut të Madhëruar me krijesat e Veta dhe me faktin se jemi krijesa që e zhvillojmë aktivitetin tonë jetësor në kontrollin e plotë të caktimit të Tij, obligimi ynë është i qartë: Asgjë nuk mund t'i fshihet vëmendjes dhe dijenisë së

[1] Sure "El Enfal", ajeti 24.

All'llahut të Madhëruar! As veprat, as punët, as mendimet, as qëllimet dhe as psherëtimat e mendimeve që vizitojnë shpesh mendjen, nuk mund të dalin jashtë dijenisë së All'llahut.

Në të vërtetë, reflektimi rreth kësaj të vërtete, e zgjon njeriun dhe e shtyn atë të ndërtojë raporte korrekte me All'llahun, të përkujdeset për veprat që do t'i shfaqen te libri i tij, në Gjykatën e Drejtësisë së All'llahut. Ai e nxit atë të zhvendoset prej hutisë te vetëdija, udhëzimi, përkushtimi e devotshmëria. Përcillet, që Ebu Hanifja të ketë shkuar një herë te Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* dhe i ka thënë: *"Kam parë djalin tënd, Musain, duke u falur dhe njerëzit i kalonin nga para, por, ai nuk i ndaloi ata ta bënin këtë, edhe pse kjo punë nuk është e pranueshme!"*

Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* u përgjigj: *"Ma thirrni këtu djalin tim, Musain!"*

Pasi ia sollën, ai i tregoi të birit, Musa ibn Xha'ferrit, dëshminë e Ebu Hanifes. Musa ibn Xha'aferri u përgjigj: *"Ai, për të cilin isha duke u falur, ishte më pranë meje se ata që ishin duke kaluar para meje! All'llahu i Madhëruar thotë:* **"Ne jemi më pranë tij se damari i qafës së vet!"**.

Pasi i dëgjoi këto fjalë, Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* e përqafoi fort të birin dhe tha: *"I shtrenjtë si nëna dhe babi im, je ti, depo e fshehtësive!"*.[1]

Komentuesit e Kur'anit kanë dhënë mendime të ndryshme, lidhur me kuptimin e fjalës *"el uerid"*. Disa prej tyre besojnë se fjala *"el uerid"* është një damar i lidhur me zemrën apo mëlçinë, ndërsa disa të tjerë besojnë se me fjalën *"el uerid"*, nënkuptohen të gjithë damarët e trupit të njeriut. Ndërkohë që disa mendojnë se ai nënkupton vetëm damarin e qafës.

[1] Tefsiri "Nuruth Thekaljen", vëll. 5, Hadithi 18, f. 108.

Mendojmë se komentimi i parë është më i përshtatshëm dhe më pranë të vërtetës, veçanërisht po t'i referohemi edhe ajetit 24 të sures "El Enfal", të cilën e përmendëm më lart.

Fjala *"el uerid"*, në gjithëpërfshirjen e saj kuptimore, buron nga fjala *"el uuruud"*, që do të thotë: *të shkosh në drejtim të ujit*. Duke qenë se gjaku vjen prej këtij damari për në zemër dhe më pas del po prej tij, për në organet e tjera të trupit, ai u quajt *el hablul uerid.*

Një tjetër aspekt që tërheq, gjithashtu, vëmendjen është fakti se terminologjia e përdorur këto kohë, lidhur me fjalën *"el uerid"* - *"damari"* dhe *"esh shirjan"* - *"kapilari"*, nënkupton enët që transportojnë gjakun për te të gjitha organet e njeriut. Anasjelltas, kjo terminologji është e lidhur me shkencën e biologjisë dhe të anatomisë, ndaj nuk ka lidhje me kuptimin gjuhësor të fjalës *"ueridit"*.

Në ajetin që vjen pas, Kur'ani shton: **"Dy engjëj i rrinë atij nga e djathta dhe e majta."**.[1]

Kuptimi i këtij ajeti është: Megjithëse All'llahu i Madhëruar ka dijeni dhe informacion të plotë rreth veprimtarisë sipërfaqësore të njerëzve dhe të fshehtave të tyre, janë dy engjëj të

---

[1] Fjala *"idh"* te fjalia: *"Idh jelteki el multekejan"*, është kundrinor i lidhur me një sifjali mungesore, kuptimi i të cilës është: "Kujtoni, vini re, kur dy engjëj do t'ju rrinë nga e majta dhe nga e djathta.". Ky është mendimi i një grupi komentuesish.
Një grup tjetër, janë të mendimit se fjala *"idh"*, është e lidhur me fjalën më të afërt të përmendur në ajetin e mëparshëm. Mendimi i grupit të parë të komentuesve, duket më i saktë dhe më pranë të vërtetës, sepse secila prej dy fjalive*:* **"Ne jemi më pranë tij se damari i qafës së vet"** dhe **"Dy engjëj i rrinë atij nga e djathta dhe e majta"**, e ruan pavarësinë e saj, pa qenë e varur prej fjalisë tjetër.
Nga ana tjetër, në komentimin e grupit të dytë, nuk ekziston një përputhje ndërmjet kuptimit të fillimit të dhe fundit të ajetit.

posaçëm, që janë ngarkuar me regjistrimin e të gjitha veprave dhe fjalëve, produkt i të majtës dhe i të djathtës së tij. Këta dy engjëj e shoqërojnë njeriun vazhdimisht, pa u shkëputur për asnjë moment prej tij. Kjo mënyrë e regjistrimit të veprave, e bën më të fortë argumentin ndaj njeriut gjatë dhënies së llogarisë në Ditën e Gjykimit. Llogaria për veprat e kryera.

Kuptimi i fjalës *"telekkaa"*, është *"marrja në dorëzim"*; fjala *"el multekejan"*, nënkupton: *dy engjëjt e ngarkuar prej All'llahut me detyrën e regjistrimit të veprave të njerëzve.*

Fjala *"kaijdun"*, i ka rrënjët te fjala *"el ku'ud"*, që nënkupton *"uljen"*, *"të ndenjurit ulur"*[1], kurse fjala *"kaijdun"*, në këtë rast, nënkupton ndjekësin në vazhdimësi të njeriut. Thënë ndryshe, ajeti nuk tregon se dy engjëjt janë ulur në të djathtë dhe në të majtë të njeriut, pasi njeriu shpesh mund të jetë duke ecur, herë të tjera mund të jetë i ulur, por nënkupton praninë e tyre të vazhdueshme dhe të pandërprerë pranë njeriut, duke regjistruar kështu, me rigorozitet të gjitha veprat e tij.

Gjithashtu, ata mund të jenë të ulur mbi supet e njeriut, pra, njëri në të djathtë dhe tjetri në të majtë, ku dhe regjistrojnë veprat e njeriut me fjalët e tij. Në disa transmetime të tjera, jo shumë të njohura, ka citime të ndryshme, që kanë kuptime të ngjashme me këtë që sapo thamë, si për shembull, te libri "Biharul Anuar", vëllimi 59, faqe 186, transmetimi 32.

Është me rëndësi të tërheqim vëmendjen e lexuesit, se në disa transmetime islame thuhet se engjëlli që qëndron në krahun e djathtë, regjistron veprat e mira, ndërsa engjëlli që qëndron në të majtë, regjistron veprat e këqija. Aty thuhet, gjithashtu, se engjëlli

[1] Fjala *"kaijd"* është në njëjës, ndërsa fjala *"el multekejan"* është në shumës, sepse në ajet ka një fjali të padukshme, kuptimi i të cilës është: Dy engjëj i rrinë atij, njëri qëndron në krahun e tij të djathtë dhe tjetri i qëndron në krahun e tij të majtë.

i krahut të djathtë është prijësi i engjëllit të krahut të majtë. Nëse njeriu kryen një vepër të mirë, engjëlli i krahut të djathtë e regjistron atë në dhjetëfishin e saj.

Ndërsa, kur njeriu kryen një vepër të keqe, engjëlli i krahut të majtë, sapo nis ta regjistrojë, engjëlli i krahut të djathtë, e ndalon ta shkruajë. Kështu që ai ndalet së shkruari për shtatë orë. Nëse gjynahqari i kërkon falje All'llahut, brenda këtyre orëve, ai nuk e shkruan si vepër të keqe, por, nëse nuk kërkon falje tek All'llahu, ai e regjistron atë si një të keqe të vetme.[1]

Në disa transmetime, lidhur me çështjen në fjalë, thuhet se, pasi besimtari të vdesë, dy engjëjt, thonë: "*O Zoti ynë! Ti e more shpirtin e robit Tënd. Ku do ta dërgosh atë?!*".

Ai përgjigjet: "*Qielli që kam krijuar, është i mbushur me engjëj që më adhurojnë, Toka është e mbushur me krijesat e mia që më binden e më nënshtrohen! Shkoni ju engjëj, te varri i robit tim! Më lëvdoni, më madhëroni, këndojeni shehadetin dhe regjistrojini ato prej veprave të robit Tim!*".[2]

Transmetohet, gjithashtu, se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: "*Nuk ka besimtar, të cilin All'llahu e ka sprovuar me një fatkeqësi në trupin e tij. Ai i urdhëron dy engjëjt, duke u thënë: 'Shkruani te libri i veprave të robit Tim, ato vepra që i ka pas kryer, kur ka qenë i shëndetshëm, për aq kohë sa do të jetë besimtar!'. Ai që sëmuret apo ai që udhëton, All'llahu do të shkruajë për ta njësoj si veprat që kanë pasur kryer, kur kanë qenë të shëndetshëm apo rezidentë!*".[3]

---

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 9, f. 144.

[2] Burimi i mëparshëm.

[3] Tefsiri "Ruhul Meanij", vëll. 26, f. 165, fundi i ajeteve, objekt të studimit tonë. Kjo përmbajtje është transmetuar, gjithashtu, edhe prej Imam Sadikut, te libri i tij "Usulul Kafij", si dhe te libri "Biharul Anuar", vëll. 59, f. 187, transmetimet 34-35.

Të gjitha këto transmetime tregojnë mirësinë dhe butësinë e madhe të All'llahut.

Ndërsa ajetit i fundit, i ajeteve, objekt të studimit tonë, flet rreth dy engjëjve dhe thotë: **"Dhe, për çdo fjalë që ai thotë, ka pranë vetes një mbikëqyrës të gatshëm** (për ta shënuar atë)**."**.[1]

Në ajetin e mëparshëm, folëm për regjistrimin e të gjitha veprave të njeriut, ndërsa tek ajeti i sipërpërmendur jepet rëndësia e fjalëve. Kjo tregon peshën dhe ndikimin e madh që fjalët kanë në jetën e njerëzve, pasi një fjalë apo një fjali e vetme, mund të ndikojë në përcaktimin e trajektores së shoqërisë drejt të mirës apo drejt të keqes. Ndodh, gjithashtu, që disa njerëz nuk besojnë se fjalët janë pjesë e veprave të tyre. Ata mendojnë se janë të lirë të shprehen dhe të thonë ç'të dëshirojnë, edhe pse fjala është një prej mjeteve më ndikuese dhe më të rrezikshme në jetën e njerëzve.

Nisur nga ky fakt, përmendja e këtij ajeti është një formë kujtese e të veçantës pas së përgjithshmes.

Fjala *"err rrekijb"*, nënkupton *"mbikqyrësin, monitoruesin"*, ndërsa fjala *"el akijd"*, nënkupton atë që përgatitet për të kryer një punë. Për këtë arsye, kali i përgatitur për të vrapuar, zakonisht, etiketohet me këtë fjalë, që quhet *"feresun atijd"*. Kjo fjalë përdoret, gjithashtu, edhe kur dikush përgatitet për diçka, apo ruan e kursen një gjë, duke e cilësuar atë si *"atijd"*. Kjo fjalë buron nga fjala *"el itaad"*, e ngjashme me fjalën *"el xhihad"*, kuptimi i saj është: *ruajtja apo kursimi*.

[1] Te fjala *"ledejhi"*, përemri kthehet te fjala *"kaul"*, por mund të jetë kthyer, gjithashtu, tek ai që e thotë fjalën *"el ledhi jelfidhul kaul"*. Mundësia e parë është më e përshtatshme.

Pjesa më e madhe e komentuesve besojnë se, fjalët *"err rrekijb"* dhe *"el atijd"*, janë emrat e dy engjëjve të përmendur në ajetin e mësipërm, si *"el multekejan"*. Kështu, emri i engjëllit në të djathtë, është Rekijb, ndërsa emri i engjëllit në të majtë, është Atijd. Edhe pse ajeti, objekt i studimit tonë, nuk përmban ndonjë fjalë të qartë, që t'i përcjellë këto kuptime, ky komentim bazohet në të dhënat e ajeteve të mësipërme, kështu që kjo gjë, nuk duket larg së vërtetës.

Pyetja që lind, është: Cilat janë fjalët, që shkruajnë këta engjëj?! Ka shumë mendime, lidhur me këtë çështje. Një pjesë e komentuesve kanë thënë se ata shkruajnë çdo fjalë që del nga goja e njeriut, duke përfshirë këtu edhe ulërimat që shkaktohen prej dhimbjeve. Ndërkohë që disa të tjerë, besojnë se ata shkruajnë vetëm shprehjet e mira dhe shprehjet e këqija, veprat e obliguara, veprat e pëlqyeshme, të ndaluara, haram, të papëlqyera, mekruh dhe nuk shkruajnë veprat e lejuara.

Mund të themi se natyra përgjithësuese e shprehjes, tregon se ata regjistrojnë çdo fjalë dhe shprehje që njeriu thotë.

Në një përcjellje të Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*, lexojmë një thënie të bukur: *"Kur dy besimtarë ulen të diskutojnë me njëri-tjetrin, dy engjëjt i thonë njëri-tjetrit: 'Le të veçohemi prej tyre! Ndoshta, kanë mes tyre ndonjë të fshehtë, të cilën, All'llahu, ua ka mbuluar!'"*.

Transmetuesi i kësaj thënieje pyet: "A nuk ka thënë All'llahu i Madhëruar: **'dhe, për çdo fjalë që ai thotë, ka pranë vetes një mbikëqyrës të gatshëm** (për ta shënuar atë)**.'**"? Imam

Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* përgjigjet: "*Edhe nëse dy engjëjt, nuk dëgjojnë, dëgjon e sheh All'llahu, njohësi i të fshehtave!*".[1]

Prej këtyre transmetimeve, kuptojmë se All'llahu i Madhëruar, për të vlerësuar besimtarin dhe në nder të tij, nuk ua mundëson dy engjëjve të dëgjojnë disa aspekte a biseda të fshehta të jetës së tij, por sigurisht që Ai i regjistron të gjitha këto të fshehta.

Në disa transmetime të tjera, kuptojmë se dy engjëjt e natës, nuk janë të njëjtë me engjëjt e ditës. Këto kuptime i kemi sqaruar përgjatë komentimit të ajetit 78 të sures "Isra", tek ky komentim.

Hulumtim

I dashuri është më pranë njeriut sa vetja e tij

Disa filozofë kanë thënë se ashtu si largësia e madhe, bën të detyrueshëm mungesën e shikimit apo dallimit, të njëjtën gjë bën dhe afrimiteti i madh. Si shembull marrin: Nëse dielli do të ishte shumë larg nesh, nuk do të mund ta shihnim, por edhe nëse do të ishte shumë më pranë nesh, ose ne do t'i afroheshim shumë pranë atij, do të verboheshim prej dritës, sa do ta kishim të pamundur ta shihnim atë.

[1] "Usulul Kafij", sipas tekstit të përmendur te "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, f. 110.

Kjo e vërtetë është e lidhur me Qenien e Shenjtë të All'llahut: "O Ti, që nuk dukesh prej fuqisë së dritës Tënde!"

Ndërsa tek ajetet, objekt i studimit tonë, gjejmë një krahasim të mrekullueshëm, që tregon afërsinë e All'llahut me robtë e Tij: **"Ne jemi më pranë tij se damari i qafës së vet.",** çka do të thotë se All'llahu i Madhëruar është më pranë njeriut se sa damari i qafës së tij.

Për sa u përket krahasimeve të tjera, që thonë se ekzistenca është trupi dhe All'llahu është shpirti, apo se bota është një rreze dielli dhe All'llahu është disku i saj, e të tjera interpretime të ngjashme, nuk mund t'i përshkruajnë dhe ta qartësojnë këtë marrëdhënie afrimiteti, ashtu siç përshkruhet në ajet.

Ndoshta, shprehja më e përshtatshme, lidhur me këtë, është transmetuar prej Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!),* në ligjëratën e parë të librit "Nehxhul Belaga", ku për All'llahun e Lartësuar, shprehet: "*Është pranë gjithçkaje, pa krahasim! Është i ndryshëm prej gjithçkaje, pa përfundim!*".

Për të përafruar kuptimin e afrimitetit të All'llahut, disa filozofë kanë krijuar një krahasim tjetër, ku thonë: "Qenia e Shenjtë e All'llahut është kuptimi i emrit, ndërsa krijesat janë kuptimi shkronjor i Atij emri!"

Shpjegimi i krahasimit të mësipërm pohon: Kur themi, për shembull: **"Shkoi në drejtim të Qabes!"**, fjala *"në drejtim të"*, e vetme, nuk ka asnjë kuptim, derisa asaj t'i bashkëngjitet fjala "Qabe", kështu që pa të, ajo do të mbetet e panjohur. Nisur nga ky fakt, mund të themi se radhitja shkronjore, në vetvete, nuk ka asnjë kuptim. Kuptimin e ka fjala, si përfaqësuese kuptimore e

këtij bashkimi shkronjor. Kështu, të gjitha krijesat, brenda kësaj ekzistence, janë sipas të njëjtës logjikë. Shkurt, ekzistenca e tyre, shkëputur prej Qenies së All'llahut nuk ka asnjë kuptim, madje as ekzistenca dhe as vazhdimësia e ekzistencës. Ky fakt, tregon pikën më të fundme të afrimitetit të All'llahut me robtë e Vet dhe afrimitetit të tyre më Zotin e Vet, edhe pse injorantët dhe të padituri nuk duan ta kuptojnë.

Ajete 19 – 22

وَجَآءَتۡ سَكۡرَةُ ٱلۡمَوۡتِ بِٱلۡحَقِّۖ ذَٰلِكَ مَا كُنتَ مِنۡهُ تَحِيدُ١٩ وَنُفِخَ فِي ٱلصُّورِۚ ذَٰلِكَ يَوۡمُ ٱلۡوَعِيدِ٢٠ وَجَآءَتۡ كُلُّ نَفۡسٖ مَّعَهَا سَآئِقٞ وَشَهِيدٞ٢١ لَّقَدۡ كُنتَ فِي غَفۡلَةٖ مِّنۡ هَٰذَا فَكَشَفۡنَا عَنكَ غِطَآءَكَ فَبَصَرُكَ ٱلۡيَوۡمَ حَدِيدٞ٢٢

"Agonia e vdekjes do të sjellë të vërtetën (e Jetës Tjetër)**: ja, kjo është ajo së cilës përpiqeshe t'i ikje."**

"Dhe do të fryhet në Sur - kjo është Dita e kërcënimit."

"Çdo njeri do të vijë i shoqëruar me një (engjëll) **grahës dhe një** (engjëll) **dëshmitar."**

"(Mohuesit do t'i thuhet): **'Ti ke qenë i pavëmendshëm për këtë. Tashti ta kemi ngritur perden** (e syve)**, dhe shikimi yt sot është i mprehtë.'"**

Komentimi

Ringjallja dhe shikimi i mprehtë

Ajetet e mësipërme pasqyrojnë të tjera çështje të rëndësishme, që lidhen me Ditën e Kthimit, gjendjen e vdekjes, fryrjen e surit, si dhe paraqitjen e njerëzimit në Fushën e Mahsherit.

Fillimisht, All'llahu i Madhëruar thotë: **"Agonia e vdekjes do të sjellë të vërtetën** (e Jetës Tjetër)**..."**.

Agonia e vdekjes, është e ngjashme me gjendjen e një të dehuri, tek i cili shfaqen shenjat e hutisë, të paqëndrueshmërisë, të mungesës së kthjelltësisë, etj. Ndonjëherë, kjo gjendje e mbizotëron mendjen e njeriut, sa i merr atij ndjenjën dhe zgjedhjen.

E, si mund të jetë ndryshe, kur vdekja është një moment tranzitor shumë i rëndësishëm, nëpërmjet të cilës njeriu duhet të ndërpresë të gjitha marrëdhëniet e tij me këtë botë, me të cilat ka qenë aq shumë i lidhur për vite me radhë. Atij i duhet të kalojë në një botë krejtësisht të ndryshme me të parën, një botë e mbushur me sekrete të mëdha, veçanërisht, në momentin e vdekjes, njeriu ka një perceptim të ri dhe shikim të mprehtë.

Në ato momente, njeriu kupton dhe shikon me sytë e tij, sa e paqëndrueshme është kjo botë. Në ato momente, atij i shfaqen ngjarjet e përtej vdekjes, njëkohësisht sheh veten të mbërthyer nga

një gjendje frike e vetmie, prej majës së kokës deri te këmbët, sa kur e sheh, të duket si i dehur, por në të vërtetë nuk është i tillë.[1]

Vetë Profetët dhe evlijatë, njerëzit me të përzgjedhur e më të dashur të All'llahut, të cilët e presin vdekjen me qetësi të plotë dhe paqe shpirtërore, do të preken, pjesërisht, prej vështirësive të agonisë së vdekjes. Edhe ata vetë, do të hasin disa pengesa e vështirësi gjatë kalimit nga njëra botë në tjetrën. Këtë e vërejmë, po t'i kthehemi gjendjes së shpirtit të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!),* teksa kalonte nga kjo botë për te Krijuesi i tij. Këtë e vëmë re në momentet e fundit të jetës së tij të nderuar, tek fuste dorën e tij të bekuar në një enë me ujë dhe, pasi lagu fytyrën e tij të bukur, tha: *"La ilahe ilall'Llah! - Nuk ka Zot tjetër, të adhuruar me të drejtë, përveç All'llahut të Madhëruar!"* Më pas shtoi: *"Me të vërtetë që vdekja ka agoninë e saj!"*.[2]

Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* i bën një përshkrim mahnitës gjendjes së njeriut përgjatë momenteve të vdekjes, si dhe çastit të agonisë. Ai përdor shprehje të gjalla, për të përshkruar gjendjen e vdekjes dhe me një elokuencë të padëshmuar më parë, thotë kështu: *"U rrethuan prej agonisë së vdekjes, prej dhimbjes së ndarjes e nisën të ftohen duart me gjithë këmbë. Ndryshoi ngjyra e tyre dhe ashpërsia e vdekjes u bë pengesë, mes tyre dhe mendjes së vet. Po ndahet prej familjarëve dhe me sytë e tij e sheh.*

---

[1] Fjala *"es sekr"*, në formën e fjalës *"el mekr"*, në origjinën e saj, nënkupton ndërprerjen e rrugës së ujit; fjala *"es sikr"*, në formën e fjalës *"el fikr"*, nënkupton një vend të bllokuar, një rrugë pa dalje. Duke qenë se fjala *"eth thumul" - "dehja"* qëndron si pengesë dhe si digë ndarëse ndërmjet njeriut dhe mendjes së tij, u quajt *"es sukr"*, e ngjashme me fjalën *"esh shukr"*.

[2] Tefsiri "Ruhul Bejan", vëll. 9, f. 118.

Me veshët e tij e dëgjon. Me mendje të plotë dhe të kthjellët mendon: 'Për këta e harxhova jetën?! Për këta e shpenzova moshën?!' Kujton paratë e mbledhura dhe sa ka sakrifikuar për to. I ka fituar prej të lejuarës dhe prej të dyshimtës. E kanë ndjekur pasojat e fitimit të tyre deri në fund e tani bëhet gati për t'u ndarë prej tyre, për t'ua lënë të tjerëve që vijnë pas, të gëzojnë e të lumturohen me to!".[1]

Në një tjetër moment, ky mësues i madh i njerëzimit i paralajmëron njerëzit: *"Po të kishit parë atë që kanë parë të vdekurit tuaj, do të frikësoheshit, do të tmerroheshit dhe më pas do të dëgjonit e do të bindeshit! Nuk është zbuluar për ju ajo që ata kanë parë, por shpejt do të ngrejë edhe për ju vellon e saj!"*.[2]

Në fundin e ajetit, Kur'ani, thotë: **"...Ja, kjo është ajo së cilës përpiqeshe t'i ikje."**.[3]

Në të vërtetë, vdekja është një realitet, ku pjesa më e madhe e njerëzve përpiqen t'i ikin, t'i largohen, pasi e konsiderojnë vdekjen fund, shpërbërje, udhëtim drejt asgjësë, e jo një dritare për në Jetën e Përtejme. Kjo dukuri ndodh, gjithashtu, për arsye të lidhjes së fortë të zemrës së tyre me të mirat materiale të kësaj bote, për këtë arsye e kanë të vështirë ta shkëpusin zemrën prej saj. Ndodh, gjithashtu, për shkak se errësira dhe zija mbizotëron mbi librin e veprave të tyre të kësaj bote.

Cilado qoftë arsyeja, ata përpiqen ta shmangin e t'i largohen asaj sa të munden, por asgjë nuk bën dobi, se vdekja është destinacioni i pashmangshëm që i pret të gjithë. Askush nuk

---

[1] "Nehxhul Belagah", Hytbe 109.

[2] Burimi i mëparshëm, Hytbe 20.

[3] Fjala *"tehijdu"* rrjedh prej fjalës *"hajdun"*, në formën e fjalës *"sajdun"*, që nënkupton devijimin e diçkaje dhe largimin prej saj.

mund ta shmangë atë. Të gjithë do të zbresin një ditë në gropën e vdekjes e të gjithëve do t'u tregohet realiteti prej të cilit largoheshin me aq ngut e frikë.

Ai që thotë këto fjalë, mund të jetë vetë All'llahu, mund të jenë engjëjt, mund të jenë ndërgjegjet e tyre të zgjuara, ose të gjitha bashkë.

Këto të vërteta, Kur'ani i ka qartësuar edhe në vende të tjera, si për shembull, tek ajeti 78 i sures "En Nisa". Në këtë ajet kur'anor, All'llahu i Madhëruar thotë: **"Kudo që të gjendeni, do t'ju arrijë vdekja, madje, qofshi edhe në kështjellat më të forta!"**.

Ndodh që njeriu, i pushtuar prej vetëpëlqimit e krenarisë, t'i harrojë këto të vërteta të qarta, të cilat i sheh me sytë e tij, për arsye të dashurisë së madhe për këtë botë të rreme, të dashurisë për vetveten. Këta njerëz nuk njohin asnjë kufi dhe arrijnë deri në atë gradë, sa deklarojnë se janë të përjetshëm e të pavdekshëm. All'llahu i Madhëruar i përshkruan këta njerëz në Kur'anin Famëlartë: **"Vallë, a nuk betoheshit më parë se nuk do të kishte zhdukje për ju?"**.[1]

Në të gjitha rastet, nëse betohet apo nuk betohet, nëse beson apo nuk e beson, nuk ka asnjë dyshim se vdekja është një e vërtetë e madhe, e cila do t'i mbërrijë të gjithë, prej saj askush nuk mund të shpëtojë.

Më pas, Kur'ani flet për fryrjen në Sur: **"Dhe do të fryhet në Sur - kjo është Dita e kërcënimit."**.

[1] Sure "Ibrahim", ajeti 44.

Fryrja e Surit**,** në këtë rast, nënkupton fryrjen e dytë, pasi siç e kemi qartësuar edhe më parë, Suri do të fryhet dy herë: Fryrja e parë është quajtur fryrja e frikës apo e tmerrit. Ajo do të ndodhë në fundin e botës. Kur krijesat e mbetura në Tokë e dëgjojnë atë, vdesin të gjitha. Në ato momente shpërbëhet rregulli i jetës së kësaj bote. Ndërsa fryrja e dytë është e lidhur me Ringjalljen, ngritjen prej varrit, me daljen në Fushën e Mahsherit. Ajo ndodh në fillim të Ringjalljes, në fillim të Kiametit, në kohën kur të gjithë njerëzit do të dalin e do të ngrihen prej varreve të tyre, e do të shkojnë në drejtim të Krijuesit të tyre, për të dhënë llogari para Drejtësisë së Tij absolute, për veprat që kanë kryer në këtë botë.

Fjala *"en nefkh"*, kuptohet prej të gjithëve, ndërsa fjala *"en nefkhatu" - "fryrja"*, nënkupton një fryrje të vetme. Fjala *"sur"*, nënkupton *"fyellin"*, *"trumbetën"* apo *"borinë"*. Këto janë mjete apo instrumente të ngjashme me ato që përdoren për të mobilizuar ushtarët, për t'i mbledhur, për t'i shpërndarë, për t'i orientuar drejt mensave të ushqimit apo drejt fjetoreve të tyre, për gjatë shërbimit ushtarak. Kur dëgjojmë të përmendet, Suri i Israfilit, kemi të bëjmë me një metaforë dhe krahasim. Këtë çështje e kemi sqaruar imtësisht në fund të ajetit 68 të sures "Ez Zumer".

Gjithsesi, nëse do t'i kthehemi kuptimit të sifjalisë: **"kjo është Dita e kërcënimit"**, duket qartë se këtu kemi të bëjmë me fryrjen e dytë, e cila ndodh në Ditën e Gjykimit, në Ditën e rikthimit të madh.

Në ajetin tjetër, flitet për gjendjen e njerëzve në ditën e rreshtimit, pas Ringjalljes: **"Çdo njeri do të vijë i shoqëruar me një** (engjëll) **grahës dhe një** (engjëll) **dëshmitar."**.

Për sa i përket engjëllit shoqërues, ai e shoqëron njeriun për në Gjykatën e Drejtë të All'llahut, ndërsa engjëlli dëshmitar, do të dëshmojë për veprat e tij. Ajo është një gjykatë e ngjashme me gjykatat e kësaj bote, ku i akuzuari shoqërohet për në gjykatë dhe atje e presin dëshmitarët, të cilët do të dëshmojnë për veprën e tij.

Një tjetër hipotezë, që ngrihet prej komentuesve të Kur'anit, është se me shoqërues, në ajet, nënkuptohet engjëlli, që do ta shoqërojë besimtarin për në Xhennet ose jobesimtarin për në Xhehennem, por duke qenë se në ajet përmendet fjala "*esh shehijd*" - "*dëshmitar*", e kemi më të lehtë të besojmë se komenti i parë, që flet për Gjykatën e Drejtësisë së All'llahut, është më pranë të vërtetës.

Pyetja që lind, është: Kush është shoqëruesi dhe dëshmitari?! A janë ata dy engjëj prej engjëjve apo diçka tjetër?! Lidhur me këtë çështje, kemi komente të ndryshme.

Disa komentues kanë thënë, se shoqëruesi *(es saiku)*, është engjëlli që regjistron veprat e mira të njeriut, ndërsa dëshmitari *(esh shehijdu),* është engjëlli që regjistron veprat e këqija të tij. Pra, sipas këtij komenti, kuptojmë se këta dy engjëj janë ata për të cilët folëm në ajetet e mëparshme.

Ndërsa, në disa përcjellje të tjera, mund të kuptojmë se shoqëruesi është engjëlli i vdekjes, ndërsa dëshmitari është i Dërguari i All'llahut *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Ky transmetim konsiderohet si i dobët, po t'i referohemi frymës kuptimore të ajetit.

Thuhet, gjithashtu, se shoqëruesi është engjëlli që do të shoqërojë çdo njeri, ndërsa me dëshmitarin nënkuptohen gjymtyrët e trupit të njeriut, ose libri i veprave të tij. Njeriu do ta ketë të varur në qafë atë libër, në Ditën e Gjykimit.

Nuk përjashtohet mundësia se shoqëruesi dhe dëshmitari, të jetë i njëjti engjëll dhe bashkëngjitja e të parit me të dytin, bëhet për të treguar cilësitë e ndryshme të secilit. Kuptimi i kësaj është: Njeriu do të shoqërohet për në Gjykatën e Drejtësisë së All'llahut nga një engjëll dhe i njëjti engjëll do të dëshmojë për veprat e tij.

Ajo që mund të themi me bindje të plotë, është fakti se pjesa më e madhe e këtyre komentimeve bien ndesh me kuptimin sipërfaqësor të ajetit, i cili, sipas mendimit të pjesës më të madhe të komentuesve, tregon qartë se dy engjëjt vijnë bashkë me këdo prej njerëzve. Kështu, njëri prej tyre është shoqëruesi, ndërsa engjëlli tjetër dëshmon për veprat e tij.

Është e qartë se dëshmia e disa engjëjve, nuk e përjashton praninë e dëshmive të disa dëshmitarëve të tjerë në Ditën e Gjykimit. Në këtë kategori dëshmitarësh, mund të hyjnë Profetët dhe gjymtyrët e trupit të njeriut. Mund të jetë, gjithashtu, edhe libri i veprave apo dëshmia e kohës dhe e vendit, ku është konsumuar vepra e njeriut apo gjynahu i tij.

Në të gjitha rastet, mund të themi, se engjëlli i parë e ndalon njeriun të largohet, ndërsa engjëlli i dytë e ndalon njeriun të mohojë atë që ka kryer në këtë botë. Kësisoj, secili prej njerëzve do të përballet e do të sprovohet atë ditë me veprat e tij, do të jetë tërësisht e pamundur që ai të mundë t'i shmanget llogarisë për veprat e konsumuara.

Kështu që, të gjithë kriminelëve dhe njerëzve një për një, u thuhet: **"(**Mohuesit do t'i thuhet**): 'Ti ke qenë i pavëmendshëm për këtë. Tashti ta kemi ngritur perden** (e syve)**, dhe shikimi yt sot është i mprehtë.'"**.

Në të vërtetë, kjo është dita kur do të bien perdet e materializmit të kësaj bote, perdet e shpresës, perdet e lidhjes së shpirtit pas kësaj dynjaje, pas fëmijëve, pas gruas, pas egos, pas vetëpëlqimit, pas fanatizmit, pas injorancës dhe kokëfortësisë. Dashuria e madhe për veten të ndaloi të mendosh për këtë ditë, me gjithë praninë e argumenteve të qarta të Ringjalljes dhe llogarisë. Kjo është dita, kur do të shkundet prej teje pluhuri i hutisë. Kjo është dita, kur do të ngrihet perdja e injorancës, e paditurisë dhe e kryeneçësisë tënde të madhe. Kjo është dita, kur do të çahet perdja e epshit dhe e shpresës tënde, ku gjithçka e mbështjellë në fshehtësi dhe mister do të bëhet e qartë, sot. Kjo është dita e shfaqjes së madhe, ku askush nuk mund të fshehë më asgjë. Është dita e dëshmitarëve dhe e zbulimit të së vërtetës.

Për këtë arsye, u gjend dhe shikimi i mprehtë, në mënyrë që të gjitha këto të vërteta të perceptohen e të preken në mënyrën më të mirë. Nuk ka asnjë dyshim, se e vërteta nuk ka qenë e fshehur për asnjë moment dhe as bukuria e njerëzve që duam, nuk mund të fshihet, por duhet shkundur e duhet pastruar pluhuri i rrugës, që ajo të jetë sa më e qartë.

Nga ana tjetër, është zhytja e njeriut në detin e natyrës dhe sprovimi i tij me llojet më të komplikuara të perdeve e të pengesave, të cilat qëndrojnë mes tij dhe së vërtetës, e nuk e lejojnë atë të shohë qartë. Në Ditën e Gjykimit, kur njeriu i shkëput të gjitha raportet me këtë botë, është e natyrshme që ai të

ketë një perceptim të ri dhe të qartë. Në fakt, realiteti i Ditës së Gjykimit është shfaqja e këtyre të vërtetave.

Është plotësisht e mundur, që njeriu ta çlirojë veten që në këtë botë, prej prangave të epshit dhe ndjekjes së pasioneve të shfrenuara. Është plotësisht e mundur, gjithashtu, që ai ta ngrejë perden prej syve të zemrës dhe të ketë një shikim të mprehtë për të parë, që në këtë botë, të vërtetat e mëdha. Kjo, sigurisht që nuk është e mundur për individët e kapur fort pas kësaj bote.

Vlen për t'u theksuar fakti, se fjala *"hadijd"*, përmendur në këtë ajet, është një lloj metali. Ai është përdorur nga arabët, për të emërtuar shpatën, ose shtizën prej hekuri, por më pas fjala mori kuptime më të zgjeruara, kështu që nëpërmjet saj, është nënkuptuar, gjithashtu, *"shikimi i mprehtë"* apo *"zgjuarsia e mprehtë"*. Nisur nga sa thamë, kuptojmë se me fjalën *"basar"*, nuk nënkuptohet akti i thjeshtë i shikimit nëpërmjet syrit, por *"shikimi me anë të zemrës dhe mendjes"*.

Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!),* flet për njerëzit e devotshëm të shoqërisë njerëzore (evlijatë) dhe thotë: *"Sytë e zemrës së tyre ua dhuroi dituria. Shpirti i besimit i zbuti zemrat e tyre me atë që kishte egërsuar zemrat e gjynahqarëve. Zemrat e tyre u qetësuan me atë që egërsoi zemrat e të paditurve. E jetuan këtë dynja me trupa, shpirtrat e të cilëve ishin të varur në vendin më të lartë. Ata janë mëkëmbësit e All'llahut në Tokë. Ata janë thirrësit për në fenë e Tij!"*.[1]

[1] "Nehxhul Belaga", "El Kelimatul Kisar", Fjala 147.

Hulumtime

1- E vërteta e vdekjes

Pjesa më e madhe e njerëzve, e përfytyrojnë vdekjen si një prej formave të shumta, nëpërmjet të cilës shfaqet asgjëja. Ata mendojnë se ajo është zhdukja dhe zhbërja e përhershme e njeriut. Por, kjo pikëpamje nuk është në harmoni me atë ç'ka përmendet në Kur'anin Famëlartë, as me argumentet logjike që e kundërshtojnë kryekëput atë.

Kështu, sipas pikëpamjes kur'anore, vdekja është një çështje ekzistenciale, e cila përfaqëson kalimin e njeriut nga një jetë në një tjetër jetë. Për këtë arsye, në shumë ajete kur'anore, vdekja është përfaqësuar prej kuptimeve të fjalës *"tueuffij"*, që nënkupton "dorëzimin e shpirtit" dhe kthimin e tij në trupin e njeriut, me ndihmën e engjëjve.

Shprehja e përmendur në fillim të ajetit: **"Agonia e vdekjes do të sjellë të vërtetën** (e Jetës Tjetër)**"**, tregon pikërisht këtë kuptim.[1] Vdekja është përmendur në ajete të tjera kur'anore, duke u quajtur *"khalk"* - *"krijesë"*. All'llahu i Madhëruar thotë në suren "El Mulk", ajeti 2: **"All'llahu ka krijuar vdekjen dhe jetën!"**.

[1] Për sa i përket kuptimit të shkronjës *"ba'a"* te fjala *"bil hakk"*, ekzistojnë disa lloje hamendësimesh. Disa komentues kanë thënë se kuptimi i saj është shumëllojshmëria (pluralizmi), ndërsa (bil hakk) nënkupton vdekjen. Kështu, kuptimi i fjalisë është: Agonia e vdekjes është reale, pra, agonia e vdekjes sjell me vete vdekjen. Është thënë, gjithashtu, se shkronja *"ba'a"*, ka për qëllim bashkëngjitjen, kështu që kuptimi i ajetit bëhet: Agonia e vdekjes vjen bashkë me të vërtetën.

Në transmetimet e ndryshme islame, ekzistojnë shumë shprehje që tregojnë të vërtetën e vdekjes. Në një prej këtyre përcjelljeve, thuhet se Imam Ali ibn Hysejni *(Paqja qoftë mbi të!)*, njëherë është pyetur*: "Ç'është vdekja?!"* Imami i tha: *"Për besimtarin është si të jetë duke hequr prej trupit të tij një rrobë të pistë, ose si të heqë prangat e rënda. Pra, është ndërrimi i rrobës së pistë me një veshje të bukur dhe erëmirë. Është udhëtim me mjete të rehatshme transporti, të lehta e të ulëta për t'u hipur. Është ndërrimi me shtëpi të ngrohtë. Ndërsa për mohuesin, është si të zhveshë një rrobë të bukur dhe të shtrenjtë e ta ndërrojë atë me më të ndyrat veshje. Është si të transferohet nga një shtëpi e bukur, e ngrohtë dhe e rehatshme për në një gërmadhë të ftohtë, pra, konceptohet si dënimi më i madh."*.[1]

Kur Imam Muhammed bin Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* u pyet me të njëjtën pyetje, u përgjigj: *"Vdekja është si gjumi që bëni çdo natë, me ndryshimin e vetëm se ajo zgjat më shumë se gjumi dhe njeriu e kupton vetëm në Ditën e Gjykimit!"*.[2]

Kur kemi folur për jetën e varrit, kemi thënë se gjendjet e njerëzve aty janë të ndryshme. Për disa njerëz, është si të bien në një gjumë të thellë. Disa të tjerë, si dëshmorë të rënë në Rrugën e All'llahut, ndërsa besimtarët e sinqertë, përjetojnë e shijojnë mirësitë e ndryshme të All'llahut, kurse njerëzit e këqij dhe diktatorët, do të përjetojnë lloje të ndryshme të dënimit nga All'llahut.

Kur kriza u shtua dhe lufta u ashpërsua, Imam Hysejni *(Paqja qoftë mbi të!) ka përshkruar të vërtetën e vdekjes për shokët e tij*

[1] "Biharul Anuar", vëll. 6, f. 155.
[2] Burimi i mëparshëm. Duket se me Imam Muhammed bin Ali, nënkuptohet Imami i nëntë, Muhammed El Xheuad.

në Ditën e Ashures, me këto shprehje të mahnitshme: "Bëni durim bijtë e mi fisnikë, se vdekja nuk është gjë tjetër, veçse një hark që do t'ju hedhë prej dhimbjes e mjerimit për në gjerësitë e Parajsës, për te mirësia e përjetshme. Më tregoni, cili prej jush nuk dëshiron ta transferojnë nga burgu drejt pallateve të mrekullive? A e dini se për armiqtë tuaj, vdekja nuk është gjë tjetër, përveçse transferim prej pallateve të mrekullisë për në dënimin me burg? Babai im më ka treguar një thënie të transmetuar prej të Dërguarit të All'llahut: 'Kjo botë është burgu i besimtarit dhe Parajsa e jobesimtarit, ndërsa vdekja është ura mbi të cilën besimtarët kalojnë për në Parajsën e tyre dhe jobesimtarët kalojnë për në ferrin e tyre!".[1]

Në një hadith tjetër, transmetuar prej Imam Musa bin Xha'aferrit *(Paqja qoftë mbi të!)* lexojmë: *"Me erdhi një ditë një burrë, që po përjetonte agoninë e vdekjes dhe nuk i foli askujt!"* Të pranishmit e pyetën Imam Musa bin Xha'aferrin: *"O biri i të Dërguarit të All'llahut! Kemi dëshirë të dimë si është vdekja dhe si është gjendja e shokut tonë!"*

Imami iu përgjigj: *"Vdekja është si një filtër që pastron gjynahet e besimtarëve. Ajo është dhimbja e fundit që ata përjetojnë. Ajo u fshin atyre edhe gjynahun më të fundit, që mund t'u ketë mbetur. Ajo është si një filtër, që fshin të mirat e jobesimtarëve. Ajo është kënaqësia e fundit që përjetojnë dhe vepra e tyre e fundit më e mirë. Ndërsa, shoku juaj, është shkarkuar prej gjynaheve të tij, është pastruar prej gjynaheve të tij. Është kulluar prej tyre, ashtu si kullohet e pastrohet një rrobë e bardhë prej papastërtive. Ai tashmë, është i gatshëm për të na shoqëruar*

[1] "Meanil Akhbar", kreu "Kuptimi i vdekjes", Hadithi 3, f. 289.

ne, anëtarët e Familjes së Profetit në Parajsë, te vendbanimi ynë i përhershëm!".[1]

2- Agonitë e vdekjes

Tek ajetet e mëparshme folëm përreth agonive të vdekjes dhe thamë se fjala *"es sekeratu"* është shumësi i fjalës *"es sekretu"*, që nënkupton një gjendje të ngjashme me dehjen, e cila, kur përshkallëzohet, njeriu shqetësohet dhe duket si në gjendje të dehur.

Është e vërtetë se vdekja është për besimtarët pikënisja e transferimit për në botën e gjerë, mbushur me mirësitë dhe begatitë e All'llahut. Megjithatë, kjo gjendje tranzitore, nuk është e lehtë për cilindo njeri, pasi shpirti i tij, për vite me radhë, ka qenë rrënjosur pazgjidhshmërisht me trupin, ka qenë i lidhur shumë fort me të.

Për këtë arsye, kur Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* u pyet rreth arsyes së shqetësimit dhe destabilizimit të trupit përgjatë daljes së shpirtit, tha: *"… sepse mbi të ka mbirë trupi!"*.[2]

Ky shembull, është plotësisht i ngjashëm me shkuljen e dhëmbit të prishur prej nofullës së njeriut. Në fillim ndien dhimbje, por më pas gjen qetësinë e rehatinë.

Në shumë transmetime islame lexojmë të thuhet, se tri janë ditët, kur njeriu ndien frikë në këtë botë. Dita, kur njeriu lind dhe

[1] Burimi i mëparshëm.
[2] "Biharul Enuar", vëll. 6, f. 158.

sheh botën e panjohur për të. Ditën, kur vdes dhe sheh botën e pasvdekjes. Ditën, kur ringjallet e shikon ngjarjet e Ditës së Gjykimit, të cilat nuk i ka parë kurrë më parë. Për këtë arsye, Kur'ani thotë kështu, në lidhje me Profetin Jahja bin Zekeria: **"Paqja e All'llahut ishte mbi të, ditën që u lind! Paqja e All'llahut,, do të jetë mbi të, ditën që do të vdesë! Paqja e All'llahut do të jetë mbi të, ditën kur do të ringjallet!"**.[1]

Në Kur'an thuhet që edhe Profeti Isa ibn Merjem, të ketë thënë të njëjtën gjë. Për sa u tha më sipër, kuptojmë se këta dy Profetë do të jenë të përfshirë nën përkujdesjen e All'llahut gjatë këtyre tri ditëve të vështira për njeriun.

Natyrshëm pranohet fakti se ata që janë kapur fort pas kësaj dynjaje, do ta kenë më të vështirë transferimin nga njëra botë në tjetrën. Shkulja e zemrave së tyre prej saj, do të jetë proces shumë i komplikuar. Kështu, edhe gjynahqarët e mëdhenj do t'i përjetojnë me dhimbje dhe hidhërim të madh çastet e agonisë së vdekjes.

[1] Burimi i mëparshëm, më pak shkurtim: Në suren "Merjem", ajeti 15, lexojmë rreth çështjes së Jahjasë: (*Paqja e All'llahut ishte mbi të, ditën, kur u lind. Paqja e All'llahut do të jetë mbi të, ditën, kur do të vdesë dhe ditën, kur do të ringjallet).* Tek e njëjta sure lexojmë, gjithashtu, rreth Profetit Isa bin Merjem. All'llahu i Madhëruar thotë në gojën e Isait: "Paqja e All'llahut ishte mbi mua, ditën, kur u linda. Paqja e All'llahut do të jetë mbi mua, ditën, kur do të vdes dhe ditën, kur do të ringjallem!".

3- Vdekja është Hak (e vërtetë)

Nuk janë vetëm ajetet, objekt i studimit tonë, ato që e klasifikojnë vdekjen **hakkun,** si një dukuri të padiskutueshme. Janë të shumta ajetet kur'anore, që deklarojnë se vdekja është hak, e padiskutueshme dhe e vërtetë e madhe. Tek ajeti 99 i sures "El Hixhr" lexojmë: **"Adhuroje Zotin tënd, derisa të të vijë vdekja!"**. Një ajet të ngjashëm më këtë, që sapo e cituam, e lexojmë edhe në ajetin 47 të sures "El Muddeththir".

Të gjitha këto kuptime, vijnë për të treguar se njeriu, edhe sikur të mohojë gjithçka, nuk mundet dot të mohojë vërtetësinë e vdekjes, se do të vijë dita, kur vdekja do të trokasë te dera e jetës së tij, se vdekja do të trokasë një ditë në dyert e të gjithëve dhe do t'i marrë të gjithë.

Përmendja e vërtetësisë së vdekjes dhe e meditimit rreth saj, konsiderohet si një paralajmërim për të gjithë njerëzit, u bën atyre thirrje të mendojnë më mirë dhe më shumë përreth saj. Vdekja i fton ata të rishikojnë rrugën e tyre dhe të përgatiten mirë për atë që kanë përpara, se patjetër do të vijë ajo ditë.

Një ngjarje, vërtet, emocionuese, lexojmë në disa transmetime islame: Kur një burrë erdhi te Umeri, i tha: "Unë e dua ngatërresën, e urrej të vërtetën dhe dëshmoj për diçka që nuk e kam parë!"

Kur, Umeri, dëgjoi këto fjalë, urdhëroi burgosjen e tij. Por, kur kjo ngjarje arriti te Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*, ai tha: "O Umer! Burgosja e atij njeriu është padrejtësi. Ti ke marrë gjynahe për këtë vepër!"

Umeri u shqetësua: "Përse mendon kështu, o Imam Ali?"

Aliu iu përgjigj: "Ai njeri i do paratë dhe fëmijët e tij. All'llahu i Madhëruar ka thënë, në disa prej ajeteve kur'anore, se ato janë *'fitneh'* – *'sprove e ngatërresë'*: **'Pasuria dhe fëmijët tuaj janë vetëm sprovë për ju!'"**[1] Ai të ka thënë se urren të vërtetën, vdekjen. Kur'ani, kur e përmend atë, e quan hak-të vërtetë: **"Agonia e vdekjes do të sjellë të vërtetën e Jetës Tjetër."**.[2] Ai të ka dëshmuar, gjithashtu, për Njësimin e All'llahut. Ai nuk e ka parë Atë!"

Si përfundim, Umeri tha: "I humbur do të ishte Umeri, pa Aliun!".[3]

[1] Sure "Et Tegabun", ajeti 15.
[2] Sure "Kaf", ajeti 19.
[3] Tefsiri "Ruhul Bejan", vëll. 9, f. 118.

Ajetet 23 - 30

وَقَالَ قَرِينُهُۥ هَٰذَا مَا لَدَىَّ عَتِيدٌ ٢٣ أَلۡقِيَا فِي جَهَنَّمَ كُلَّ كَفَّارٍ عَنِيدٍ ٢٤
مَّنَّاعٖ لِّلۡخَيۡرِ مُعۡتَدٖ مُّرِيبٍ ٢٥ ٱلَّذِي جَعَلَ مَعَ ٱللَّهِ إِلَٰهًا ءَاخَرَ فَأَلۡقِيَاهُ
فِي ٱلۡعَذَابِ ٱلشَّدِيدِ ٢٦ ۞قَالَ قَرِينُهُۥ رَبَّنَا مَآ أَطۡغَيۡتُهُۥ وَلَٰكِن كَانَ
فِي ضَلَٰلِۭ بَعِيدٖ ٢٧ قَالَ لَا تَخۡتَصِمُواْ لَدَيَّ وَقَدۡ قَدَّمۡتُ إِلَيۡكُم
بِٱلۡوَعِيدِ ٢٨ مَا يُبَدَّلُ ٱلۡقَوۡلُ لَدَيَّ وَمَآ أَنَا۠ بِظَلَّٰمٖ لِّلۡعَبِيدِ ٢٩ يَوۡمَ نَقُولُ
لِجَهَنَّمَ هَلِ ٱمۡتَلَأۡتِ وَتَقُولُ هَلۡ مِن مَّزِيدٖ ٣٠

"E shoqëruesi i tij (engjëll) **do të thotë: 'Këtu është** (shënimi i veprave të tij) **që kam gati.'"**

"(Do t'u thuhet): **'Hidhni në zjarr çdo njeri jobesimtar, kryeneç.'"**

"Pengues të të mirave, shkelës dhe dyshues (në fe)**."**

"Çdo njeri që ka besuar në zot tjetër, përveç All'llahut. Kështu pra, flakeni atë në dënimin më të rëndë!"

"E, shoku i tij (djall) **do të thotë: 'O Zoti ynë, unë nuk e kam mashtruar atë, por ai vetë ka qenë në humbje të madhe.'"**

"Atyre (All'llahu) **do t'u thotë: 'Mos u grindni para Meje, Unë ju kam paralajmëruar me kohë.'"**

"Fjala Ime nuk ndryshohet dhe Unë nuk jam i padrejtë me robtë e Mi."

"Atë Ditë Ne do ta pyesim Xhehennemin: 'A u mbushe?' e ai do të përgjigjet: 'A ka edhe më?'"

Komentimi

Shoqëruesit e njeriut janë prej engjëjve dhe djajve

Në këto ajete, shfaqet edhe njëherë panorama e rikthimit apo e Ringjalljes. Edhe një herë vijnë imazhet emocionuese dhe të mahnitshme, pasi engjëlli, shoqëruesi i tij, tregon para gjithë njerëzimit gjykimin përfundimtar, dënimin dhe shpërblimin e All'llahut për secilin.

Ajeti i parë prej ajeteve në fjalë thotë se engjëlli shoqërues i njeriut do të thotë: **"E shoqëruesi i tij** (engjëll) **do të thotë: 'Këtu është** (shënimi i veprave të tij) **që kam gati.'"**. Ky libër që unë mbaj, është libri ku gjenden të regjistruara të gjitha veprat e këtij njeriu! Kështu pra, ngrihet perdja para çdo gjëje, të vogël apo të madhe, që njeriu ka kryer në këtë botë.

Pyetja që lind, është: Ç'nënkupton fjala *"karinuhu"*? Komentuesit kanë debatuar shumë lidhur me këtë, megjithatë,

pjesa më e madhe e tyre mendojnë se kjo fjalë nënkupton "engjëllin" që e ka shoqëruar njeriun përgjatë gjithë jetës së tij në dynja. Pikërisht atë engjëll, që ka qenë urdhëruar dhe ngarkuar prej All'llahut të Madhëruar, me detyrën e regjistrimit të përpiktë të veprave të tij, në mënyrë që të dëshmojë për të në Ditën e Gjykimit Hyjnor.

Ajetet e mëparshme, që tregojnë dhe flasin për gjendjen e njerëzve, të cilët do të përjetojnë ngjarjet e ringjalljes, ku cilido prej tyre do të shoqërohet prej një engjëlli, dhe, se një engjëll tjetër do të dëshmonte për të, e mbështesin këtë kuptim. Shtojmë këtu dhe nuancat kuptimore të të njëjtit ajet, si dhe ajetit që e pason, të cilat përshtaten në mënyrë të plotë me këtë kuptim.

Disa komentues të tjerë, kanë thënë se me fjalën *"karinuhu"*, nënkuptohet *"shejtani i mallkuar"*, pasi fjala *"karijnun"*, është përmendur në shumë ajete kur'anore, duke nënkuptuar, qartësisht, shejtanin, i cili shoqëron njeriun. Sipas kësaj logjike, kuptimi i ajetit është: Shejtani, shoqërues i njeriut, tha: "Unë e kam përgatitur këtë kriminel për në Xhehennem dhe kam shfrytëzuar të gjitha mundësitë e mia për t'ia arritur qëllimit tim!".

Problemi nuk qëndron vetëm në faktin, se ky kuptim nuk përshtatet me kuptimet e ajeteve të mëparshme dhe atyre që e pasojnë, por ai nuk përputhet, gjithashtu, edhe me mohimin nga ana e shejtanit, që ai ta ketë shtyrë njeriun drejt humbjes së madhe. Ky fakt bëhet i qartë në deklaratat e sakta të ajeteve që pasojnë, ajetin objekt të studimit tonë.

Nisur nga komenti i ajetit, mund të themi se shejtani e pranon përgjegjësinë e tij për humbjen dhe devijimin e njeriut. Këtë e lexojmë tek ajeti i sipërpërmendur, ku All'llahu i Madhëruar thotë: E, shoku i tij, djalli, do të thotë: **"E, shoku i tij** (djall) **do të thotë: 'O Zoti ynë, unë nuk e kam mashtruar atë, por ai vetë ka qenë në humbje të madhe.'"**.

Po të vëmë re, me kujdes, lind një kundërshti mes pohimeve të mësipërme.

Ekziston dhe një koment i tretë, i cili nuk duket të ketë ndonjë bazë, ku thuhet se, me fjalën *"karinuhu" - "shoqëruesi i tij"*, nënkuptohen njerëzit me të cilët ai shoqërohej në dynja (gjatë jetës).

Më pas, All'llahu i Madhëruar urdhëroi engjëjt, që kanë regjistruar veprat e njeriut në këtë botë, duke thënë: Do t'u thuhet: **"Hidhni në zjarr çdo njeri jobesimtar, kryeneç!"**.

Fjala *"anijdun"*, buron nga fjala *"inadun"*. Kuptimi i saj është: kryeneçësia, mendjemadhësia, egoizmi, mungesa e nënshtrimit ndaj së vërtetës. Pyetja që lind këtu, është: Cilëve u drejtohet ajeti kur'anor?! Ka shumë mendime lidhur me këtë, por, për t'u përmendur, janë: si fillim është komenti i mësipërm, ndërsa disa komentues kanë thënë se, në këtë rast, bëhet fjalë për dy engjëjt e zjarrit.

Ka të tjerë që kanë thënë se është e mundur, që ajeti, në këtë rast, t'i drejtohet vetëm njërit prej tyre, ai është engjëlli që shoqëron kriminelin për tek zhvillimet dhe ngjarjet e dhimbshme të Ditës së Kiametit. Këtë gjë e vëmë re tek ajetet e mëparshme.

Ata mendojnë se përmendja e engjëjve në shumës, ka si qëllim vetëm përforcimin. Duket sikur All'llahu thotë: elki, elki, pra hidheni, hidheni! Përdorimi i shumësit për t'iu drejtuar njëjësit, është një dukuri e njohur gjuhësore e gjuhës arabe. Në fakt, ky komentim qëndron shumë larg logjikës, kështu që komentimi më i përshtatshëm mbetet komentimi i parë.

Në ajetin që pason, flitet për disa cilësi të këqija e të poshtra të këtyre mohuesve. Ajeti kur'anor thotë: **"Pengues të të mirave, shkelës dhe dyshues** (në fe)**."**.

Fjala *"el menna'u"*, paraqitet në shkallën sipërore. Ajo përdoret për të cilësuar një person që ndalon prej shumë gjërave. Kështu, me shprehjen: *"mennain lil khajri"* - *"ndalues i të mirës"*, nënkuptohet çdo njeri që bëhet pengesë për të mirën, qoftë kjo vepër apo fjalë, sido që të jetë natyra e pengesës.

Disa transmetues, kanë thënë se ky ajet ka zbritur për Uelijd ibn Mugiretu, pasi ai ndalonte djemtë e vëllait të tij të pranonin Islamin, duke u thënë: "Nuk kam për t'ju ndihmuar kurrë gjatë jetës suaj, për sa kohë do të jem gjallë!".[1]

Ndërsa fjala *"mu'tedin"*, nënkupton tejkalimin e kufirit, qoftë ky tejkalim i lidhur me nëpërkëmbjen e të drejtave të të tjerëve, qoftë i lidhur me kufijtë e Zotit, pra, dispozitat islame.

Fjala *"murijbun"*, buron nga fjala *"rejbun"* dhe nënkupton njerëzit që përjetojnë dyshime të lidhura ngushtë me mendimin e keq, ose paragjykimin. Ajo nënkupton, gjithashtu, ata që

[1] Tefsiri "Ruhul Meanij", vëll. 26, f. 168.

mashtrojnë nëpërmjet veprave të tyre, si dhe lindin dyshime te të tjerët.

Ajeti që vijon, përmend një tjetër cilësi të keqe dhe të poshtër të mohuesve, kur thotë: **"Çdo njeri që ka besuar në zot tjetër, përveç All'llahut..."**. Sigurisht, rezultati vjen në ajetin që vijon, ku All'llahu i Madhëruar thotë: **"...Kështu pra, flakeni atë në dënimin më të rëndë!"**.

Në këto ajete, paraqiten gjashtë prej cilësive të banorëve të zjarrit. Pesë cilësitë e përmendura më lart, sido që shfaqen në një mënyrë apo në një tjetër, dalin më së shumti si shkak-pasojë. Ndërsa cilësia e gjashtë, në vetvete, është shpalosja e rrënjëve të pesë të parave. Kjo, për arsye se fjala "*el kuffar*", nënkupton ata që ngulin këmbë gjatë në mohimin e tyre, deri sa ai merr formën e kryeneçësisë dhe të kokëforcisë.

Kështu, kokëforti dhe kryeneçi, janë prej atyre që e ndalojnë të mirën të ndodhë. Kjo kategori njerëzish është prej atyre që i tejkalojnë kufijtë, e tejkalojnë hakun, të drejtat e njerëzve dhe kufijtë e mirëpërcaktuar nga All'llahu i Madhërishëm.

Është zakoni i kryeneçëve, që të ngulin këmbë, deri sa t'i fusin njerëzit në dyshime e huti dhe t'i nxjerrin pastaj prej besimit.

Nisur nga sa u tha më lart, mund të themi se këto pesë cilësi janë: mohimi, kryeneçësia, ndalesa e të mirës, tejkalimi i kufijve dhe provokimi i dyshimeve, lidhen shumë fort me njëra-

tjetrën, ndaj dhe lidhja e tyre është e qartë, si e natyrës shkak-pasojë mes tyre.[1]

Për sa i përket cilësisë së gjashtë, që shfaqet në ajet: **"Çdo njeri që ka besuar në zot tjetër, përveç All'llahut."**, mund të themi se është rrënja, "nëna" e të gjithë të këqijave. Ajo është dhe arsyeja e të gjitha shmangieve të sipërpërmendura. Kjo cilësi, thënë në mënyrë të përmbledhur, përfaqëson shirkun-politeizmin. Nëse e studiojmë imtësisht këtë çështje, do të vëmë re se shirku (politeizmi) është shkaktari i të gjitha veseve dhe cilësive të këqija të njeriut.

Në ajetin në vijim, ngrihet perdja ndaj një tjetër panorame, ndaj një tjetër shfaqjeje të lidhur me atë që u ndodh mohuesve dhe si do të jetë fundi i tyre. Kjo shfaqje konsiston në debatin dhe sherrnajën publike ndërmjet qafirëve, mohuesve dhe shejtanit të mallkuar në Ditën e Gjykimit. Të gjithë mohuesit do të përpiqen t'i adresojnë te shejtani gjynahet e kryera prej tyre, t'ia faturojnë atij të gjitha fajet. Por, shoqëruesi i tij, shejtan, i kundërpërgjigjet rrufeshëm, ashtu si bëhet e qartë në Kur'anin Famëlartë, ku All'llahu i Madhëruar, thotë: **"E, shoku i tij** (djall) **do të thotë: 'O Zoti ynë, unë nuk e kam mashtruar atë, por ai vetë ka qenë në humbje të madhe.'"**.

Shejtani nuk pranon, në asnjë mënyrë, që të ketë qenë shkaktar apo detyrues i njeriut, që ky, pra, njeriu, të ndjekë rrugën e dështimit dhe të humbjes së madhe, por ishte vetë njeriu, ai që ka bërë zgjedhjen e vet, me vullnetin dhe lirinë e tij të plotë.

[1] Tefsiri "El Mijzan", vëll. 18, f. 381.

Kjo shprehje është e ngjashme me përmbajtjen kuptimore të ajetit 22 të sures "Ibrahim", teksa shohim shejtanin të heqë dorë, të "shesë" dhe të lërë në baltë ndjekësit e tij. All'llahu i Madhëruar thotë: **"Unë nuk kam pasur kurrfarë pushteti mbi ju. Unë thjesht ju thirra e ju m'u përgjigjët. Prandaj, mos më qortoni Mua, por qortoni veten!"**.

Natyrshëm, shejtani nuk synon të mohojë tërësisht ndikimin e tij në humbjen e njeriut. Ai ka për qëllim të vërtetojë, se nuk i ka detyruar njerëzit të shkojnë drejt humbjes, por, ka qenë vetë njeriu, që me zgjedhjen e tij të lirë dhe vullnetin e plotë, ka vendosur para se të ishte viktimë e frymëzimit nga shejtani. Kështu që, nuk ka asnjë kundërshti ndërmjet këtij ajeti dhe ajetit 82 të sures "Sad", ku shejtani thotë: **"Pasha Madhërinë Tënde** (O All'llah)**, unë do të bëj të pamundurën që ata** (njerëzit) **të jenë prej të humburve!"**.

Pavarësisht se, ajetet e mësipërme tregojnë vetëm ato pjesë të debatit, ku shejtani bën avokatinë e vetvetes dhe, pavarësisht se nuk bie në sy replika e njeriut dhe përgjigjja që ai i kthen shejtanit, kemi një sërë ajetesh të tjera që flasin qartë për debatin mes tyre. Në ajetin në vijim, duket qartë debati i zhvilluar ndërmjet tyre, ku All'llahu i Madhëruar, thotë: **"Atyre** (All'llahu) **do t'u thotë: 'Mos u grindni para Meje, Unë ju kam paralajmëruar me kohë.'"**.

Unë, thotë All'llahu i Madhëruar, ua kam bërë të qartë këtë realitet dhe këtë përfundim, me kohë.

Në njërën anë, All'llahu i Madhëruar tregon natyrën e komunikimit të Tij me shejtanin: All'llahu tha: **"Ik! Kushdo prej**

tyre që të pason ty, do të ketë Xhehennemin si shpërblim, një shpërblim të plotë!".[1]

Kurse nga ana tjetër, All'llahu i Lartësuar, ka paralajmëruar njerëzit që e pasojnë atë, në një ajet tjetër kur'anor: **"Do ta mbush Xhehennemin me ty dhe me ata që të pasojnë ty!"**.[2]

Ky paralajmërim dhe kërcënim i hapur, është i dallueshëm në të gjitha ajetet kur'anore, çka tregojnë qartësisht se All'llahu u ka dalë borxhit të gjithëve, shejtanë dhe njerëz. Ai i ka paralajmëruar që në fillim të herës ata, që të mos humbin veten e mos të bëhen shkaktarë për humbjen e të tjerëve.

Për ta përforcuar edhe më shumë këtë, vjen ajeti i mëposhtëm, ku All'llahu i Madhëruar thotë: **"Fjala Ime nuk ndryshohet dhe Unë nuk jam i padrejtë me robtë e Mi."**[3]

Fjala *"el kaul"*, në rastin konkret, është *"kërcënimi"* dhe *"paralajmërimi i All'llahut të Madhëruar"*, që Ai e ka përmendur në mënyrë të përsëritur edhe në ajete të tjera, që i kemi përmendur më sipër.

Fjala *"edh dhal'lam"*, është shkalla sipërore e të njëjtës fjalë dhe nënkupton shkallën më të lartë të zullumit dhe të padrejtësisë. All'llahu i Madhëruar, nuk mund të jetë kurrsesi, burim i padrejtësisë, as i të paktës dhe as i të shumtës prej saj.

---

[1] Sure "El Isra", ajeti 63.
[2] Sure "Sad", ajeti 85.
[3] Fjala *"ledejje"* është ndajfolje e lidhur me fjalën *"jubeddel"*. Disa komentues kanë thënë se ajo është e lidhur me fjalën *"el kaul"*. Kuptimi i parë është më i përshtatshëm.

Përmendja e kësaj fjalë, në rastin konkret, mund të jetë e lidhur me dëshirën e Zotit për të treguar se pozita e drejtësisë së All'llahut dhe e dijes së Tij, arrin deri në atë shkallë sa, edhe sikur të buronte prej Tij një padrejtësi, sado e vogël qoftë, ajo do të konsiderohej shumë e madhe, pra, do të kishte kuptim të njëjtë me fjalën e përmendur në ajet, *"dhal'lam"*. Nisur nga ky fakt dhe realitet, mund të themi se All'llahu i Madhëruar është larg çdo lloj padrejtësie.

Mundësia tjetër është se kjo shprehje nënkupton individë dhe njerëz të ndryshëm, çka do të thotë se, nëse padrejtësia e All'llahut prek dikë, atëherë ka dhe shumë njerëz të ngjashëm me të, si rrjedhojë, padrejtësia bëhet më e madhe.

Në të gjitha rastet, kjo shprehje tregon qartë se njerëzit janë të lirë të bëjnë zgjedhjen e tyre, në vullnetin e tyre të plotë, kështu, as shejtanët nuk janë të detyruar në shejtanllëkun e tyre, as mohuesit nuk janë të detyruar të mohojnë dhe të ndjekin shejtanin. Nuk ka ndodhur që All'llahu ta përcaktojë të ardhmen dhe fundin e dikujt, jashtë përzgjedhjes dhe vullnetit të lirë të njeriut.

Këtu lind një pyetje: Si është e mundur që All'llahu thotë: **"Fjala Ime nuk ndryshohet!"**, kur një grup prej robëve të All'llahut do të përfshihet në faljen dhe mëshirën e Tij?!

Përgjigjja e kësaj pyetje është si vijon: Vetë falja vepron sipas rregullave strikte dhe një metodologjie të mirëpërcaktuar. Ajo është nëndega e një vepre të kryer nga njeriu, vepër që, edhe pse mund të jetë kriminale, është e meritueshme për faljen. Kjo është një prej ligjeve të All'llahut, që përcakton qartë se të

merituesshmit për faljen i përfshin vetëm falja e All'llahut. Ky është një rregull, që, gjithashtu, nuk ndryshon.

Në ajetin e fundit, prej ajeteve në fjalë, shfaqet një tjetër panoramë emocionuese, lidhur me ngjarjet dhe zhvillimet e Ditës së Gjykimit. All'llahu i Madhëruar, thotë: **"Atë Ditë Ne do ta pyesim Xhehennemin: 'A u mbushe?' e ai do të përgjigjet: 'A ka edhe më?'"**.[1]

Çfarë nënkuptohet me shprehjen kur'anore: **"A ka edhe më?"**. Lidhur me të, ekzistojnë dy komentime:

Komenti i parë: Në këtë rast, kemi të bëjmë me një pyetje mohuese, çka nënkupton që Xhehennemi do të thotë se nuk ka më vend për njerëz të tjerë. Nisur nga ky këndvështrim, mund të themi se këto kuptime janë në harmoni të plotë me kuptimet e ajetit 13 të sures "Es Sexhde", ku All'llahu i Madhëruar thotë: **"Me të vërtetë, do ta mbush Xhehennemin me xhind dhe njerëz bashkërisht!"**. Ky vjen si një përforcim i mendimit, se kërcënimi i ashpër i All'llahut, drejtuar të gjithë njerëzve në botë, do të veprojë dhe do të realizohet, pikërisht, atë ditë, se Xhehennemi do të mbushet plot e përplot me mohues e kriminelë në Ditën e Madhe të Gjykimit.

Komenti i dytë:, kjo fjali, në kuptimin e saj, përmban një kërkesë për shtesë, çka do të thotë se kemi një pyetje të drejtpërdrejtë, që vjen nga vetë Xhehennemi: **"A ka të tjerë**

[1] Me cilën fjalë është e lidhur shprehja *"jeumun"* – *"ditë"*? Ka tri shpjegime lidhur këtë. Së pari, tregon se ajo është i lidhur me shprehje të fshehura, kuptimi i të cilave është *"udhkuru"* - *"kujtoni"*. Së dyti, tregon se ajo është e lidhur me fjalën *"jubeddelu"* - *"ndërrohet"*; së treti, është e lidhur me fjalën *"edh dhal'lam"* - *"bën padrejtësi"*. Mendimi i parë mbetet më pranë të vërtetës.

përveç këtyre që do të hyjnë në Xhehennem?!". Në fakt, është e natyrshme që gjithçka të jetë vazhdimisht në kërkim të ngopjes, prandaj as Xhehennemi nuk ka për t'u ngopur me mohuesit, as Xhenneti nuk ka për t'u ngopur me besimtarët e ndershëm.

Është pranuar prej të gjithë komentuesve, se kjo pyetje do të mbetet pa përgjigje, pasi kuptimi i saj, në rastin konkret, është se Xhehennemi mbetet i pambushur. Ky kuptim nuk është në harmoni me ajetin 13 të sures "Es Sexhdeh", të cilin e përmendëm pak më sipër: **"Me të vërtetë, do ta mbush Xhehennemin me xhind dhe njerëz bashkërisht!"**.

Duhet ta kemi të qartë dhe faktin se kërkesa e Xhehennemit, për më shumë mohues, nuk tregon domosdoshmërish se nuk është mbushur. Për këto arsye, shpjegojmë:

Së pari: Një enë, për shembull, mund të jetë e mbushur plot e përplot me diçka, lëndë ose ushqim, por, dikush dëshiron të shtojë edhe më shumë, duke e shtuar e shtruar buzë më buzë.

Së dyti: Kërkesa e Xhehennemit, mund të jetë që ai të ngushtohet akoma më shumë për banorët e tij, çka nënkupton dënimin dhe vuajtjen e tyre më të madhe. Kërkesa mund të jetë e lidhur, gjithashtu, me dëshirën e Xhehennemit për t'u zgjeruar edhe më shumë, që të rritet kapaciteti i tij pranues, për më shumë mohues dhe kriminelë.

Në të gjitha rastet, ky ajet tregon se numri i banorëve të Xhehennemit do të jetë shumë i madh dhe se pamja e Xhehennemit do të jetë shumë e frikshme dhe trishtuese. Ajeti

dëshmon se kërcënimi i All'llahut është i vërtetë, se Ai trondit çdo njeri, e shkund atë, e paralajmëron dhe fton të bëjë kujdes, që të mos jetë prej banorëve të tij. Meditimi i vazhdueshëm, përreth gjendjes shokuese të Xhehennemit, e nxit atë që të jetë prej të përkushtuarve, prej njerëzve të kujdesshëm, të cilët u shmangen gjynaheve të mëdha, por dhe të voglave, me sa të munden.

Këtu lind pyetja: Si është e mundur të ekzistojë komunikimi me zjarrin e Xhehennemit, ndërkohë që ai është një krijesë jo frymore, pra, pa logjikë? Atëherë, si është e mundur që ai të kthejë përgjigje?! Për këto pyetje ka tri përgjigje:

E para: Shprehësia e Xhehennemit, është një formë e krahasimit dhe e deklaratës së zëdhënësit, që do të thotë se All'llahu i Madhëruar pyet me të njëjtën gjuhë, përdorur prej Tij, që prej etapës së krijimit. Xhehennemi përgjigjet nëpërmjet gjuhës dhe mënyrave të komunikimit që vetë All'llahu, ia ka dhënë për të dëshmuar atë që do të thotë, si dhe për t'u përgjigjur pyetjeve të Tij. Ky lloj komunikimi gjendet edhe në gjuhë të tjera.

E dyta: Vendbanimi i Jetës së Përtejme është vendbanim real, aspak imagjinar, ndaj edhe krijesat pa shpirt e frymë, si zjarri dhe Xhenneti, përjetojnë një formë të caktuar të perceptimit, ndjenjës dhe jetës. Kështu, Xhenneti është i përmalluar pas besimtarëve, ndërsa Xhehennemi është në pritje të kriminelëve.

Një tjetër shembull për këtë, janë dëshmitë e gjymtyrëve të trupit të njeriut, të cilat, do të flasin dhe do të shprehen qartë, duke dëshmuar, kështu, për njeriun në Ditën e Gjykimit. Kjo dukuri, pra, e përjashton edhe mundësinë për t'u habitur me rastin e komunikimit të Xhennetit me Xhehennemin.

Madje, sipas besimit dhe gjykimit të disa komentuesve, çdo atom në këtë botë, është pajisur prej All'llahut me një formë të caktuar dhe shumë të veçantë perceptimi. Për këtë arsye, ato e lavdërojnë dhe e falënderojnë All'llahun. Këtë e lexojmë qartë, gjithashtu, edhe në disa ajete të tjera kur'anore, si tek ajeti 44 i sures "El Isra".[1]

E treta: All'llahu i Madhëruar komunikon dhe pyet engjëjt e Xhehennemit, jo Xhehennemin, dhe se janë, pikërisht, ata që i përgjigjen pyetjes së Tij.

Të gjitha këto komentime, mund të konsiderohen të pranueshme, por komenti i parë duket më i qartë dhe më i përshtatshëm.

[1] Kthehu te fundi i ajetit 44 i sures "El Isra" në këtë komentim.

Ajetet 31 - 37

وَأُزۡلِفَتِ ٱلۡجَنَّةُ لِلۡمُتَّقِينَ غَيۡرَ بَعِيدٖ ٣١ هَٰذَا مَا تُوعَدُونَ لِكُلِّ أَوَّابٍ
حَفِيظٖ ٣٢ مَّنۡ خَشِيَ ٱلرَّحۡمَٰنَ بِٱلۡغَيۡبِ وَجَآءَ بِقَلۡبٖ مُّنِيبٍ ٣٣ ٱدۡخُلُوهَا
بِسَلَٰمٖۖ ذَٰلِكَ يَوۡمُ ٱلۡخُلُودِ ٣٤ لَهُم مَّا يَشَآءُونَ فِيهَا وَلَدَيۡنَا مَزِيدٞ ٣٥ وَكَمۡ
أَهۡلَكۡنَا قَبۡلَهُم مِّن قَرۡنٍ هُمۡ أَشَدُّ مِنۡهُم بَطۡشٗا فَنَقَّبُواْ فِي ٱلۡبِلَٰدِ هَلۡ
مِن مَّحِيصٍ ٣٦ إِنَّ فِي ذَٰلِكَ لَذِكۡرَىٰ لِمَن كَانَ لَهُۥ قَلۡبٌ أَوۡ أَلۡقَى ٱلسَّمۡعَ
وَهُوَ شَهِيدٞ ٣٧

"Dhe jo larg prej aty, Xhenneti do t'u afrohet besimtarëve të devotshëm."

"(që do t'u thuhet:) **'Kjo është premtuar për ju, për këdo që është penduar dhe ruajtur** (nga gjynahet)**.'"**

"Që e ka pasur frikë të Gjithëmëshirshmin, edhe atëherë kur nuk e shihte kush, e që ka ardhur me zemër të kthyer (nga All'llahu)**."**

"Hyni në të (Xhennet) **me paqe e siguri. Kjo është Dita e Amshimit!"**

"Aty do të kenë çfarë të duan - e prej Nesh (do të kenë) **edhe më shumë."**

"Eh, sa breza shumë më të fuqishëm Ne i kemi shkatërruar para tyre! Ata brodhën nëpër Tokë, po a mund të gjenin strehim?!"

"Vërtet, këtu ka këshillë për këdo që ka zemër, dëgjon me vëmendje dhe dëshmon."

Komentimi

Ju, të devotshmit, hyni në Xhennet!

Duke iu kthyer faktit se pjesa më e madhe e hulumtimeve të kësaj sureje, trajton çështje të lidhura me rikthimin, Ringjalljen e të tjera aspekte që lidhen me to, vlen të përmendet fakti se ajetet e mëpasshme, tregojnë se si do të hidheshin në zjarrin e Xhehennemit mohuesit dhe kryeneçët. Aty tregohen forma e natyra të ndryshme të përjetimit të llojeve të dënimit, si dhe përshkruhen imtësisht cilësitë e veprat që i tërhoqën ato dinakërisht për në zjarrin e Xhehennemit.

Për sa u përket ajeteve 31-37, shfaqet një tjetër pamje që përshkruan hyrjen e besimtarëve të devotshëm, me nderime e vlerësime madhështore, në Xhennet. Aty shpalosen llojet e lumturisë, të mirësisë dhe të shpërblimit, që besimtarët do të shijojnë në Xhennet. Këto ajete përshkruajnë, gjithashtu, cilësitë e banorëve të Xhennetit, duke zbuluar, kështu, disa të vërteta të

mahnitshme, që, në një mënyrë apo në një tjetër, pasqyrojnë një krahasim të shkëlqyer mes gjendjeve të banorëve të Xhennetit me atë të banorëve të Xhehennemit.

Ajetet nisin më Fjalën e All'llahut: **"Dhe jo larg prej aty, Xhenneti do t'u afrohet besimtarëve të devotshëm."**.

Fjala *"uzlifet"*, i ka rrënjët te fjala *"zulfa"*, në formën e fjalës *"kubra"*. Kuptimi i saj është *"afrërsia"*. Pra, u afrua Xhenneti për besimtarët.

E bukura, qëndron në faktin, se Kur'ani nuk thotë: "U afruan të devotshmit për në Xhennet!"- por thotë: "Xhenneti do t'u afrohet besimtarëve të devotshëm".

Në fakt, përfytyrimi i kësaj skene është gati i pamundur, në qoftë se u referohemi kushteve dhe gjendjes së kësaj bote. Por, duke qenë se Bota Tjetër nuk i nënshtrohet të njëjtave kushte e rregulla si të kësaj bote, për arsyen e thjeshtë se ndryshojnë kryekëput mes tyre, nuk duhet të çuditemi aspak, me faktin që All'llahu i Madhëruar u afron Xhennetin besimtarëve, me bujarinë dhe respektin më të madh, në vend që të jenë ata që duhet të shkojnë drejt tij.

Gjithashtu, tek ajetet 90-91 të sures "Esh Shuara'a", lexojmë: **"Atë ditë Xhenneti do t'u afrohet besimtarëve të devotshëm! Ndërsa Xhehennemi do t'u tregohet atyre që kishin humbur!"**.

Kjo është dhe shkalla sipërore, nëpër të cilën shfaqet mirësia dhe begatia e All'llahut, që u afron besimtarëve të Tij të devotshëm. Kjo shënon edhe cilësinë e mirësisë që zhduk

mundësinë e ekzistencës së një shkalle më të lartë mirësie sa ajo vetë.

Shprehja: *"gajre bard"* - **"jo larg prej aty"**[1] është përforcim për të njëjtin kuptim.

Gjithsesi, kuptimi i këtij ajeti është se kjo ngjarje, pra, afrimi i Xhennetit për besimtarët e devotshëm, do të ndodhë në Ditën e Gjykimit, pavarësisht se në ajet ndodhia paraqitet në kohën e shkuar *"uzlifet" - "u afrua"*. Ndodh shpesh në Kur'an, që ngjarjet e padiskutueshme, si veprime të së ardhmes, të paraqiten në kohën e shkuar, sepse ato mbeten dukuri që do të ndodhin në mënyrë të padiskutueshme.

Është thënë se afrimi i Xhennetit për besimtarët, ndodh në këtë botë, pra, para tjetrës, se asgjë nuk i ndan ato prej Tij. Përmendja e shprehjes në kohën e shkuar nënkupton realisht të shkuarën. Ata do ta shohin veten e tyre në Xhennet, sapo të vdesin, por, duke iu referuar kuptimit të ajeteve të mëparshme dhe atyre që do të vijnë, që flasin përreth ngjarjeve të Ditës së Gjykimit, kuptimi i mësipërm qëndron larg të vërtetës, kështu komentimi i parë mbetet më i pranueshëm.

Më pas ajetet përshkruajnë cilësitë e banorëve të Xhennetit dhe All'llahu i Madhëruar thotë: **"**(që do t'u thuhet:) **'Kjo është premtuar për ju, për këdo që është penduar dhe ruajtur** (nga gjynahet)**.'"**.

---

[1] *"Gajre baiidin"* është një shprehje që lakohet në tri forma në gjuhën arabe. Ajo mund të jetë ndajfolje. Mund të jetë përshkrim i një gjendjeje. Siç mund të jetë edhe cilësi për një shprehje a fjalë të padukshme, kuptimi i të cilës është: U afrua për tani, është një vend jo i largët.

Ky ajet flet për dy cilësi shumë të rëndësishme të banorëve të Xhennetit: së pari: "*euuab*" – "*i penduar*" dhe së dyti: "*hafijdh*" – "*i ruajtur prej gjynaheve*".

Fjala "*euuab*", buron nga lënda "*euebe*", në formën e fjalës "*dheuebe*", kuptimi i të cilës është "*kthimi*". Ka mundësi, gjithashtu, që kuptimi i saj të jetë "*kthimi*" dhe "*pendesa prej gjynaheve të vogla e të mëdha*". Ajo mund të nënkuptojnë kthimin për te adhurimi i All'llahut të Madhëruar, kjo referuar faktit që fjala shfaqet në shkallën sipërore, çka dëshmon se banorët e Xhennetit janë njerëz të devotshëm, gjer në atë shkallë, sa dhe sikur të përballen me situata të caktuara ndikuese, që synojnë largimin e tyre prej adhurimit të All'llahut, ata reflektojnë menjëherë, kujtohen dhe kthehen përsëri në adhurimet e tyre. Pendohen pa humbur kohë për gjynahet dhe shpërqendrimin e tyre, kështu që arrijnë gradën e asaj që quhet shpirti i qetësuar dhe i paqtë me Krijuesin e vet.

Fjala "*el hafijdhu*", ka kuptim të njëjtë me fjalën "*el hafidhu*" - "*mbrojtës, ruajtës*". Atëherë, ç'nënkuptohet me të, këtu?! A kemi të bëjmë me atë që mbron dhe ruan besën e dhënë ndaj All'llahut, kur Ai ua mori atë bijve të Ademit e kërkoi prej tyre të mos adhurojnë shejtanin e mallkuar?! Këtë e shohim të pasqyruar qartë në ajetin 60 të sures "Ja Sin".

A kemi të bëjmë me ata që respektojnë kufijtë e vendosura prej All'llahut dhe ligjeve të Tij?! Apo mos kemi të bëjmë me atë që i memorizon dhe i regjistron mirë gjynahet e tij, duke e bërë të detyrueshme pendesën dhe kërkesën për falje nga All'llahu i Madhëruar?! Apo të gjitha hamendësimet e mësipërme janë reale?!

Duke pasur parasysh që ky gjykim dhe kjo dispozitë ka ardhur në formë absolute, mund të themi se komenti i fundit, që i përfshin të gjitha hamendësimet së bashku, duket më pranë së vërtetës.

Në vazhdimësi të shpalosjes së këtyre cilësive, ajeti që pason, përshkruan dy cilësi të banorëve të Xhennetit. Në fakt, këto dy cilësi vijnë edhe si sqarim e komentim, për mendimet dhe fjalët e mësipërme. All'llahu i Madhëruar thotë: **"...që e ka pasur frikë të Gjithëmëshirshmin, edhe atëherë kur nuk e shihte kush, e që ka ardhur me zemër të kthyer** (nga All'llahu)**."**.

Sifjalitë: **"që e ka pasur frikë të Gjithëmëshirshmin, edhe atëherë kur nuk e shihte kush"**, tregon qartë se ata, besimtarët e devotshëm, edhe pse nuk e shohin All'llahun me sytë e tyre, besojnë në Të, nëpërmjet argumenteve dhe shenjave të shumta, të cilat vërtetojnë ekzistencën e Tij. Kështu, ata e shoqërojnë besimin e tyre me një ndjenjë të dukshme të mbajtjes së përgjegjësisë.

Mundet që me fjalën *"el gajb"*, të nënkuptohet *"gjithçka që nuk shohin sytë e njerëzve"*, që do të thotë se ata nuk konsumojnë vepra të ndaluara, gjynahe, jo vetëm kur janë në sytë e njerëzve, por edhe kur janë larg mbikëqyrjes së syve të tyre.

Për sa i përket frikës, asaj që quhet *"el khashjeh"*, ajo është shkaktarja dhe nxitësja e pendesës. Kështu, zemrat e tyre janë, vazhdimisht, të drejtuara kah All'llahu i Madhëruar, kah adhurimi. Ata pendohen vazhdimisht për gjynahet e kryera. Ata janë në të njëjtën gjendje pendese e adhurimi. Me këtë gjendje kalojnë jetën e tyre dhe ngjarjet e Ditës së Gjykimit.

Ajeti tjetër tregon se të gjithë ata që janë pajisur me këto katër cilësi, në kohën kur engjëjt do t'i presin në dyert e Xhennetit, do t'u thonë në shenjë respekti dhe nderimi: **"Hyni në të** (Xhennet) **me paqe e siguri..."**.

Fjala *"es selam" - "paqe"*, nënkupton se ata do të jenë në paqe dhe nuk do të preken prej formave të ndryshme të vuajtjes, të dënimit dhe të ndëshkimit. Rroba e tyre e paqes do të jetë mirëqenia dhe shëndeti i plotë.

Për më shumë qetësi dhe siguri, ajeti u tregon besimtarëve se ajo ditë, Dita e Gjykimit, është dita e përjetësisë, dita e përhershmërisë. All'llahu i madhëruar thotë: **"...Kjo është Dita e Amshimit!"**.

Përveç këtyre dy sihariqeve, që janë: **i pari:** hyrja në Xhennet, në paqe e qetësi të plotë; **i dyti:** përjetësia e të qenit në Xhennet, All'llahu i Madhëruar u jep atyre edhe dy lajme të reja. Kështu numri i lajmeve shkon në katër, aq sa janë dhe cilësitë e tyre që përmenden në Kur'an. All'llahu i Madhëruar i përgëzon ata me dy sihariqe të tjerë, duke u bërë katër sihariqe, ku thotë: **"Aty do të kenë çfarë të duan"**, ky është sihariqi i trerë.

Më pas vjen **sihariqi i katërt**, të cilin All'llahu e përmend kështu: **"...e prej Nesh** (do të kenë) **edhe më shumë."**. Sigurisht, prej mirësive dhe begative që nuk i ka përfytyruar, madje as i ka çuar ndërmend njeri.

Nuk mund të përfytyrohet një shprehje më e qartë dhe më me shumë ndikim në zemër se sa kjo. Që në fillim, Kur'ani thotë: **"...Aty do të kenë çfarë të duan..."**.

Po t'i referohemi gjerësisë kuptimore të shprehjes dhe mungesës së pranisë së asnjë përjashtimi në të, e më pas t'i shtojmë kësaj premtimin për më shumë mirësi e begati prej atyre që nuk i ka menduar dhe as i ka përfytyruar njeri, nga ana e All'llahut, vëmë re, se All'llahu i ka përfshirë në mirësitë e Tij të mëdha e të pafundme, të gjithë besimtarët e devotshëm. Kështu, mirësitë dhe begatitë e Xhennetit kanë dimensione shumë të gjera, prandaj është e pamundur të përfshihen me një përshkrim apo me një deklaratë të vetme.

Nga kjo shprehje, mund të kuptojmë, gjithashtu, pamundësinë e krahasimit mes veprave të mira të besimtarëve të devotshëm dhe shpërblimit të madh të All'llahut, pasi ky i fundit, është shumë herë më i madh dhe më me vlerë se këto vepra, prandaj të gjithë do të përballen me mirësinë dhe drejtësinë e Tij të madhe në Ditën e Gjykimit. Drejtësia e Tij e madhe do t'i shpërblejë të gjithë.

Pas sqarimit përfundimtar të cilësive të banorëve të Xhennetit dhe banorëve të Xhehennemit, si dhe shkallës së tyre, Kur'ani krahason kriminelët, ngjashmërinë e tyre me ata që kanë jetuar para tyre. All'llahu i Madhëruar thotë: **"Eh, sa breza shumë më të fuqishëm Ne i kemi shkatërruar para tyre! Ata brodhën nëpër Tokë..."**.

Ajeti njofton se popujt e mëparshëm kanë qenë më të fortë dhe më të ashpër se kriminelët. Ata kishin çliruar vende të ndryshme dhe kishin qenë shumë të pushtetshëm, por All'llahu i shkatërroi për shkak të mohimit të tyre, për shkak se ishin zullumqarë, kështu që ata nuk gjetën shpëtim prej vdekjes dhe

ndëshkimit hyjnor. All'llahu i Madhëruar thotë: **"...Po a mund të gjenin strehim?!"**.

Fjala *"el karnu"* dhe fjala *"el iktiranu"*, në origjinën e tyre kuptojnë *"el kurbu"*, ose *"el iktirabu"*, të cilat nënkuptojnë *"afërsinë mes dy gjërave"*, ose ndërmjet shumë gjërave. Fjala *"el karn"* - *"shekull"*, përmendet për të nënkuptuar grupe njerëzish që kanë bashkëjetuar në periudha të njëjta kohore. Kjo fjalë përdoret edhe në shumës, *"el kurun"*, ku nëpërmjet saj nënkuptohet një periudhë e caktuar kohore. Në gjuhën arabe ajo është përdorur edhe për të nënkuptuar tridhjetë vjet, por në raste të tjera, ka nënkuptuar edhe njëqind vjet. Kështu, kur përballemi më shprehjen: *"shkatërroi shekujt e kaluar"*, kemi të bëjmë më shkatërrimin e popujve që kanë jetuar në ato kohëra.

Fjala *"el batshu"*, nënkupton mbajtjen e diçkaje, ose marrjen e saj me forcë. Ajo është përdorur, gjithashtu, për të nënkuptuar shkatërrimin dhe luftën.

Fjala *"nekkabu"*, është folje dhe i ka rrënjët te fjala *"nekabe"*. Kuptimi i saj është *"shpimi, vrima në mur apo lëkurë"*, me ndryshim se fjala *"eth thekab"* - *"vrima"*, është ajo që ndodh me drurin, ndërsa fjala *"en nekabu"*, ka kuptim më të gjerë e më gjithëpërfshirës.

Kur vjen në formën e foljes, ashtu si është përmendur edhe në ajet, ajo nënkupton lëvizjen, ecjen, hapjen e rrugës. Ajo, gjithashtu, nënkupton çlirimin dhe sundimin e një vendi.

Fjala *"el munkabetu"*, nënkupton cilësitë e dukshme të një njeriu, cilësitë e veprave të tij të mira, të cilat kanë ndikim në

zemrat e njerëzve. Janë ato vepra që hapin rrugën drejt lartësimit të qenies njerëzore, pastrimit dhe ngritjes së saj.

Fjala *"en nekijbu"*, nënkupton dikë që kërkon, studion dhe hulumton gjendjen e një grupimi të caktuar shoqëror. Informohet rreth gjendjes së tyre dhe më pas ndikon tek ata.

Fjala *"el mehijsu"*, rrjedh nga fjala *"el hajsu"*, në formën e fjalës *"el hajf"*, që nënkupton *"shmangien, heqjen dorë prej diçkaje"*. Nisur nga sa thamë më lart, ajo, gjithashtu, është përdorur për të nënkuptuar dorëzimin para problemeve dhe humbjes së luftës. Për të gjitha rastet, ajeti ka për qëllim të paralajmërojë mohuesit në kohën e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. T'i ftojë ata të shikojnë, të lexojnë dhe jo vetëm të meditojnë rreth historive të popujve të kaluar, por edhe të nxjerrin mësime prej tyre. Ata duhet të vërejnë me kujdes, se si e kanë pësuar këta popuj kryeneçë, që kanë qenë popuj shumë herë më të fuqishëm dhe më të pushtetshëm se ata që i pasuan. Ky fakt, duhet t'i nxisë mohuesit të reflektojnë e të kuptojnë, se mund të kenë një fund të ngjashëm me fundin e këtyre popujve. Këto kuptime i gjejmë të përsëritura shpesh në Kur'an. Njëri prej këtyre kuptimeve jepet në ajetin 8 të sures "Ez Zukhruf", ku All'llahu i Madhëruar thotë: **"Vërtet që, Ne kemi shkatërruar popuj shumë herë më të fuqishëm se ata!"**.

Disa komentues janë të mendimit se ajeti, objekt i studimit tonë, nënkupton: Themudin, pra, popullin e tij. Ky grupim

njerëzish ka banuar në zonat malore, që quheshin El Hixhr, vendndodhja gjeografike e të cilëve ishte veriu i Hixhazit. Ata shquheshin për ngjitjen në male, për punimin e tyre. Kanë qenë të njohur për ndërtimin e shtëpive dhe të kështjellave mahnitëse mbi malet e larta. Ajo që mund të themi, në këtë rast, është fakti se kuptimi sipërfaqësor i ajetit është shumë i gjerë, kështu që ai përfshin jo vetëm këtë popull, por edhe popuj të tjerë.

Ndërsa fjalia: **"po a mund të gjenin strehim?!"**, mund të jetë një pyetje, e vënë në gjuhën e mohuesve, prej popujve të mëparshëm, gjatë kohës kur kanë përjetuar ndëshkimin e All'llahut. Mendohet që ata të kenë pyetur, kështu: "A mund të gjejmë strehim dhe a mund t'i shpëtojmë këtij dënimi?!" Mundet, gjithashtu, që pyetja e ngritur, në këtë ajet kur'anor, të jetë një pyetje e drejtuar nga All'llahu i Madhërishëm për mohuesit, bashkëkohës të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Pyetja e drejtuar nga All'llahu, mund të shprehet në këtë formë: "A munden vallë, mohuesit që kanë jetuar përpara jush, t'i shpëtojnë dënimit të All'llahut dhe të gjejnë strehim?! Vallë, a është e mundur që t'i shpëtojnë ndëshkimit të madh (kur t'u vijë), të gjithë ata që janë treguar kokëfortë me Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*?!"

Në ajetin e fundit prej ajeteve në fjalë, Kur'ani përforcon kuptimet e mëparshme: **"Vërtet, këtu ka këshillë për këdo që ka zemër, dëgjon me vëmendje dhe dëshmon."**.

Me fjalën *"el kalbu"*, jo vetëm në këtë ajet, por edhe në ajetet e tjera kur'anore që flasin për perveptimin, intelekti, ndjenja dhe perceptimit. Në librat e gjuhës arabe lexojmë, gjithashtu, se një

prej kuptimeve të fjalës *"el kalbu"*, është *"intelekti"*. Kurse Rragibi e ka komentuar fjalën *"el kalbu"*, që përmendet në këtë ajet, me kuptimin *"el ilmu uel fehmu", dija dhe kuptimi.* Ndërsa në librin "Lisanul Arab", lexojmë që fjala *"el kalb"*, përdoret, gjithashtu, për të nënkuptuar *"intelektin"*.[1]

Transmetohet që Imam Musa bin Xhaferri *(Paqja qoftë mbi të!)* e ka komentuar fjalën *"el kalbu"***,** duke thënë: *"Zemra është intelekti."*.[2]

Në fakt, rrënja gjuhësore e fjalës *"el kalbu"*, është *"ndryshimi"* dhe *"devijimi"*, ndërsa në gjuhën e folur, kuptimi i saj është *"el inkilabu"*, *"kthimi ose ndryshimi i befasishëm"*. Duke qenë se mendimi dhe mendja e njeriut janë në gjendje të vazhdueshme ndryshueshmërie, përdoret fjala *"el kalbu"*, për t'i nënkuptuar ato. Për këtë arsye, Kur'ani, flet rreth qetësisë dhe paqes shpirtërore: **"Është** (All'llahu) **Ai që e zbriti qetësinë në zemrat e besimtarëve!"**[3] sikur thuhet në një tjetër ajet: **"Duke e përmendur All'llahun, zemrat qetësohen!".**[4]

Po, është më se e vërtetë se, vetëm duke përmendur All'llahun, mund të qetësohet kjo qenie e paqëndrueshme, që quhet njeri.

Ndërsa fraza *"elka es sema'a"*, nënkupton *"dëgjimin me shumë vëmendje dhe përqendrim"*. Ekziston një tjetër shprehje e mirënjohur, e ngjashme me këtë, e cila thotë: "Veshi im është me

[1] "Lisanul Arab", Lënda "Zemra", "Kalb".
[2] "Usulul Kafij", vëll. 1, K. "Mendja dhe padituria", Hadithi 11.
[3] Sure "El Fet'h", ajeti 4.
[4] Sure "Err Rra'ad", ajeti 28.

ty! Ta kam dhënë veshin!", që do të thotë: Jam duke të dëgjuar me shumë vëmendje!

Fjala *"esh shehijdu"* përdoret për atë që e ka zemrën e pranishme, sikur thuhet zemra e tij është e pranishme në tubim dhe e ndjek çështjen me hollësi.

Kështu, nëse do të bëjmë një përmbledhje të përmbajtjes kuptimore të ajetit, mund të themi: Janë dy grupe që përfitojnë prej këtyre mësimeve e këshillave.

Grupi i parë, është ai që zotëron logjikë të shëndoshë e vetëdije. Ky grup është në gjendje t'i zgjidhë dhe t'i arsyetojë me mendjen e tij këto çështje.

Ndërsa, **grupi dytë**, mund të mos jetë në të njëjtin nivel të lartësisë së logjikës dhe të të kuptuarit, por ata janë prej atyre që i dëgjojnë dijetarët, u dhurojnë fjalëve të tyre zemrën, mendjen dhe gjithë vëmendjen, kështu që e përftojnë dijen përmes mësimit.

Me këtë shprehje përkojnë edhe kuptimet e përmendura në tekstin e ajetit 10 të sures "El Mulk", ku All'llahu i Madhëruar, në gjuhën e banorëve të zjarrit vendos thënien: "Ata do të thonë: **'Sikur të kishim dëgjuar, ose menduar, nuk do të ishim mes banorëve të Zjarrit Flakërues!'**".

Shenjat e të vërtetës janë të qarta, përkrahësit e të vërtetës dhe dashamirësit e saj i njohin mirë ato. Ndërsa, ata që nuk kanë qenë të aftë ta perceptojnë vetë atë, mund ta marrin prej mësimeve dhe udhëzimeve të dijetarëve të devotshëm.

Nisur nga sa u tha më sipër, arrijmë në përfundimin se çdo njeri duhet të jetë i pajisur me mendje të plotë, të shëndoshë dhe

me dituri të bollshme, ose, minimalisht, të jetë një dëgjues i vëmendshëm.[1]

[1] Vini re, se dy ajetet i lidhin çështjet që trajtojnë me *"eu" - "ose"*. Kjo tregon se njëra prej të dy (cilësive) është e domosdoshme për njeriun.

Ajetet 38 – 40

وَلَقَدۡ خَلَقۡنَا ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَٱلۡأَرۡضَ وَمَا بَيۡنَهُمَا فِي سِتَّةِ أَيَّامٖ وَمَا مَسَّنَا
مِن لُّغُوبٖ٣٨ فَٱصۡبِرۡ عَلَىٰ مَا يَقُولُونَ وَسَبِّحۡ بِحَمۡدِ رَبِّكَ قَبۡلَ طُلُوعِ
ٱلشَّمۡسِ وَقَبۡلَ ٱلۡغُرُوبِ٣٩ وَمِنَ ٱلَّيۡلِ فَسَبِّحۡهُ وَأَدۡبَٰرَ ٱلسُّجُودِ٤٠

"Ne i kemi krijuar qiejt, Tokën dhe çdo gjë që gjendet midis tyre për gjashtë ditë, pa ndierë lodhje aspak."

"Prandaj, duroje atë që thonë ata, madhëroje Zotin tënd e falënderoje Atë para lindjes së diellit dhe para perëndimit."

"Madhëroje Atë edhe në një pjesë të natës, edhe pas faljes së namazit."

Komentimi

Krijuesi i qiejve dhe i tokës është në gjendje të ringjallë të vdekurit

Këto ajete vijnë për të komentuar kuptimet dhe argumentet e larmishme të ajeteve të mëparshme, që lidhen me çështjen e rikthimit apo të Ringjalljes. Ajetet 38-40, tregojnë një tjetër argument të rëndësishëm, që vërteton mundësinë e rikthimit apo të Ringjalljes, për në Botën e Amshueshme. Më poshtë, ajetet i ofrojnë Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* një buqetë udhëzimesh, të lidhura me domosdoshmërinë e përmendjes së All'llahut të Madhëruar dhe lavdërimin e Tij, pasi ky aktivitet i pasur shpirtëror do ta ndihmojë atë, të neutralizojë planet dhe qëllimet që kurdisin kurthngritësit, kundër Tij. Kështu, në ajetin 38, All'llahu i Madhëruar thotë: **"Ne i kemi krijuar qiejt, Tokën dhe çdo gjë që gjendet midis tyre për gjashtë ditë, pa ndierë lodhje aspak."**.

Fjala *"el lugubu"*, nënkupton *"lodhjen"*. Është e natyrshme, të gjithë ata që kanë mundësi dhe aftësi të kufizuar, t'i kaplojë lodhja, sa herë nisen të kryejnë ndonjë punë, që tejkalon fuqitë dhe mundësitë e tyre. Në të tilla raste, çdo njeri preket prej lodhjes dhe pafuqisë. Ndërsa për Atë që e ka mundësinë, fuqinë dhe aftësinë pa mbarim e të pakufizuar, lodhja, këputja dhe pafuqia nuk ndikojnë për asgjë. Referuar këtyre kuptimeve e kësaj logjike, mund të themi se Ai që ka mundësi, aftësi dhe fuqi të krijojë qiejt dhe Tokën, Ai që ka mundësi të krijojë këto galaktika

me gjithë ato yje, i ka, gjithashtu, mundësitë ta rilindë e ta rikthejë njeriun pas vdekjes së tij, t'i veshë për së dyti rrobën e jetës.

Lidhur me shkakun e zbritjes së ajetit, disa komentues kanë thënë se këto ajete kanë zbritur për shkak të hebrenjve, të cilët keqinformonin se All'llahu i kishte krijuar qiejt dhe Tokën për shtatë ditë. (Pra, gjashtë ditë prej ditëve të javës) dhe më pas pushoi në ditën e shtatë (të shtunën), duke vënë njërën këmbë mbi tjetrën. Për këtë arsye, hebrenjtë mendojnë se kjo mënyrë e të ulurit nuk është e përshtatshme për njerëzit, pasi ajo është mënyra e uljes së veçantë të Zotit. Kjo ishte dhe arsyeja pse zbritën ajetet e sipërpërmendura, duke i vënë, kështu, kapak një herë e përgjithmonë, broçkullave dhe sajesave të tyre qesharake.[1]

Kjo çështje nuk mund të bëhet, kurrsesi, pengesë për të ndjekur mundësinë e Ringjalljes, ndërkohë që ajo është argument i Njësimit të All'llahut, mundësisë dhe dijes së Tij. Krijimi i qiejve dhe Tokës, me pafundësinë e mahnitshme të mrekullive dhe të të fshehtave, është një proces që përfaqëson tërësinë e vet. Ai ka rregullat e tij të veçanta dhe përpikërinë absolute, që e vendos mendjen, në njërën anë të kësaj mrekullie dhe e orienton atë pashmangshmërisht kah Krijuesi i saj, vullneti dhe mundësia e të Cilit lëvizin yjet nëpër galaktika, shpërndajnë dritën e jetës ngado, duke qenë kështu, një argument i qartë për Të.

Krijimi i qiejve dhe i Tokës brenda shtatë ditëve, është përmendur në momente të ndryshme në Kur'an.[2]

---

[1] Tefsiri "Ed Durrerul Menthur", vëll. 6, f. 110.

[2] Kthehu te surja "El A'araf", ajeti 54; surja" Junus", ajeti 3; surja "Hud", ajeti 7; surja "Es Sexhde", ajeti 4; surja "El Hadid", ajeti 4; surja "El Furkan", ajeti 59.

Nëpërmjet fjalës "*jeum*" - "*ditë*", nënkuptohet një periudhë kohore, jo në kuptimin e njëzet e katër orëve, as të dymbëdhjetë orëve. Ilustrojmë mendimin: Themi se është njëlloj si kuptimi i fjalës ditë, në këtë shembull: Njerëzit kanë jetuar nën hijen e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* një ditë, një ditë tjetër nën diktatin e Beni Umejes dhe Beni Abasit, etj.

Është e qartë, se fjala "*ditë*", përdorur në këtë kontekst dhe në të ngjashmet e tij, nënkupton një periudhë kohore, qoftë *një vit, një muaj, një brez* apo *njëmijë vjet***.** Kjo është sikur të themi, për shembull: Një ditë prej ditëve, rruzulli tokësor ka qenë masë e zjarrtë. Një ditë ai u ftoh dhe u bë i përshtatshëm për të jetuar. Kështu, fjala "*ditë*", në këtë rast, përfaqëson periudhë kohore e jo një ditë të vetme.

Prej shprehjeve të cituara tek ajetet e sipërpërmendura, kuptojmë se All'llahu i Madhëruar i ka krijuar të gjitha qiejt, Tokën dhe krijesat e tjera në gjashtë etapa, apo në gjashtë periudha kohore. Shtjellimi i plotë i kësaj çështjeje bëhet në fundin e ajetit 54 të sures "El A'araf".

Kjo, do të thotë se nuk ka vend për të ngritur pyetje, pasi duke qenë se nuk ka pasur as ditë, as natë, para se të krijoheshin qiejt dhe Toka, atëherë, si i ke krijuar (o All'llah) për gjashtë ditë?!

Pas përmendjes së argumenteve të ndryshme të rikthimit, (Ringjalljes) pas paraqitjes së tablosë së qartë të ngjarjeve dhe ndodhive të ndryshme të Ditës së Gjykimit, Kur'ani, udhëzon Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* të bëjë durim, pasi do të mbetet një grup njerëzish

që nuk do t'i nënshtrohen të vërtetës, që do të këmbëngulin në kotësinë e tyre. All'llahu i Madhëruar thotë: **"Prandaj, duroje atë që thonë ata..."**, pasi vetëm me durim dhe drejtësi, mund të tejkalohen problemet.

Nga ana tjetër, duke qenë se durimi dhe drejtësia kanë nevojë për mbështetje dhe përkrahje, mbështetja dhe përkrahja më e mirë për këto raste, është përmendja e All'llahut dhe kapja fort pas parimit, parimi i dijes që mund të krijojë botën dhe ekzistencën. Për këtë arsye, Kur'ani, e komenton këtë çështje, duke shtuar dhe duke cituar, kështu: **"...madhëroje Zotin tënd e falënderoje Atë para lindjes së diellit dhe para perëndimit."**. Gjithashtu, **"Madhëroje Atë edhe në një pjesë të natës, edhe pas faljes së namazit."**.

Lavdërimi i vazhdueshëm i All'llahut bie në zemër, si bie vesa mbi tokë, duke i dhënë asaj jetë nëpërmjet ujitjes. Lavdërimi i All'llahut e frymëzon zemrën, i jep gjallëri dhe udhëzim, furnizim, ky i nevojshëm, për t'u përballur me armiqtë kryeneçë e kokëfortë.

Komentues të ndryshëm kanë dhënë shumë mendime, lidhur me synimin dhe kuptimin e *"tesbihëve" – "përmendjes dhe lavdërimit të All'llahut"*, në katër kohët e përmendura në ajet: para lindjes së diellit, para perëndimit, në një pjesë të natës dhe pas faljes së namazit.

Disa prej tyre mendojnë se këto shprehje nënkuptojnë pesë kohët ditore të faljes e bashkë me to dhe disa namaze të tjera (*nafile*) që kanë vlerë të madhe. Ata i kanë renditur kështu:

Shprehja: **"Para lindjes së diellit"**, nënkupton namazin e sabahut, të mëngjesit. Në fund të kohës së faljes së tij, lind dielli, kështu që ai duhet të kryhet përpara se Dielli të lindë.

Shprehja: **"Para perëndimit"**, nënkupton namazin e drekës dhe të ikindisë, sepse dielli perëndon në fund të kohës së tyre.

Shprehja: **"Edhe në një pjesë të natës"**, nënkupton namazet e akshamit dhe të jacisë.

Shprehja: **"Edhe pas faljes së namazit"**, nënkupton të gjitha namazet nafile pas akshamit. Ibni Abasi, me pak rezervë, ka bërë këtë komentim: "Me shprehjen, **edhe pas faljes së namazit**, nënkuptohen të gjitha namazet nafile, të pëlqyeshme, që kryhen pas namazeve farz, të obliguara.".

Duke qenë që ne besojmë se dy nafilet që kryhen pas namazeve të obliguara, janë vetëm nafilet që kryejmë pas namazit të akshamit dhe pas namazit të jacisë, themi se përgjithësimi i mësipërm, nuk është i mundur.

Disa komentues e kanë shpjeguar shprehjen, **"para lindjes së diellit"**, duke thënë se ajo nënkupton namazin e sabahut, të mëngjesit. Shprehjen, **"para perëndimit"**, me namazin e ikindisë, të pasdites.

Shprehjen: **"edhe në një pjesë të natës"**, me namazin e akshamit, të mbrëmjes dhe të jacisë, darkës. Meqë ata nuk e kanë përmendur asgjëkund namazin e drekës, ky është një tregues i qartë që tregon dobësinë e këtij komentimi.

Në disa thënie të transmetuara prej Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*, kur e pyetën rreth kuptimit të ajetit: **"Madhëroje**

Zotin tënd, e falënderoje Atë para lindjes së diellit dhe para perëndimit!", ka dhënë këtë përgjigje: *"Kuptimi i kësaj është se duhet të themi herët në mëngjes dhe pas perëndimit të diellit, dhjetë herë: "La ilahe ilall Llah, uahdehu la sherike leh. Lehul mulku ue lehul hamdu, juhji ue jumit ue huëe ala kul'li shejin kadir!" - "Nuk ka Zot tjetër të adhuruar me të drejtë përveç All'llahut të Madhëruar! Ai është i vetëm dhe i pa shoq! Atij i përket mbretëria e qiejve dhe e Tokës! Atij i takon falënderimi! Ai është dhuruesi i jetës! Ai është dhuruesi i vdekjes! Ai është i Plotfuqishëm, i Gjithëpushtetshëm!"*.[1]

Ky komentim, nuk bie në kundërshtim me komentimin e parë, prandaj ato mund të bashkohen (në ajet) me njëra-tjetrën.

Disa prej çështjeve që duhet t'u kushtojmë vëmendjen tonë, janë kuptimet e ngjashme me këto që përmendëm më lart, të pranishme, me fare pak ndryshim, në ajetin 130 të sures "Ta Ha", ku All'llahu i Madhëruar thotë: **"Prandaj duroje** (o Muhammed) **atë që thonë ata dhe lavdëroje me falënderim Zotin tënd para lindjes së Diellit dhe përpara perëndimit të tij! Lavdëroje Atë edhe në orët e natës, edhe në skajet e ditës, që të mund të kënaqesh!"**.

Sifjalia: **"Që të mund të kënaqesh"**, është tregues i qartë se ky lavdërim dhe kjo përmendje e All'llahut në këtë kohë, ka një ndikim shumë të rëndësishëm në qetësimin e zemrës dhe në kënaqësinë e mendjes së besimtarit. Ato e furnizojnë zemrën me fuqi dhe mundësi për t'u përballur me ngjarjet dhe realitetin.

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", fundi i ajeteve, objekt i studimit tonë.

Këtu shfaqet një tjetër urtësi, që meriton vëmendjen tonë. Në ajetin 49 të sures "Et Tur", All'llahu i Madhëruar thotë: **"Edhe gjatë natës lavdëroje Atë, si dhe pas perëndimit të yjeve!"**.[1]

Në një hadith të Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)* transmetohet: "*Shprehja kur'anore* **'pas faljes së namazit'**, *nënkupton dy rekate nafile, të cilat kryhen pas namazit të akshamit. Këtu duhet të tregohemi shumë të vëmendshëm, sepse pas namazit të akshamit janë katër rekate nafile, ndërsa këtu përmenden vetëm dy. Ndërsa shprehja* '**si dhe pas perëndimit të yjeve'**, vazhdon komentin Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!), nënkupton dy rekatet nafile të namazit të sabahut (falja e mëngjesit) të cilat kryhen gjatë perëndimit të yjeve dhe shpërndarjes së tyre, pra, para faljes së sabahut.* (para rekateve farz)!".[2]

Në një transmetim tjetër thuhet se shprehja: **"pas faljes së namazit"**, nënkupton namazin *(nafile)* e vitrit, i cili kryhet në përfundim të natës.[3]

Si përfundim, mund të themi se komenti i parë është më pranë të vërtetës se të gjithë. Ai është më i përshtatshëm se të tjerët, edhe pse gjerësia kuptimore e *tesbihut - përmendjes së*

[1] Duhet të vërejmë me kujdes këtu dhe të shohim se fjala *"idbar"*, në këtë ajet, ka ardhur me *"kesreh"*, pra, me *"I"*, e ngjashme me fjalën *"ikbal"*. Ndërsa në ajetin, objekt i studimit tonë, e njëjta fjalë është përmendur me *"fet'hah"* - me *"e"*, pra, *"edbar"*, e ngjashme me fjalën *"efkar"*. Këtu, ajo vjen në formën e shumësit të fjalës, *"dubur"*, kuptimi i të cilës është: *më pas, pastaj, pasi*, etj. Kështu, kuptimi i shprehjes: *"edbares suxhud"* është: përmendeni, lavdërojeni Atë, pas çdo sexhdeje. Ndërsa kuptimi i shprehjes: *"edbaren nuxhum"* është: pas shpërndarjes së yjeve.

[2] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", fundi i ajetit, objekt i studimit tonë.

[3] Burimi i mëparshëm.

All'llahut, përfshin shumë prej komentimeve dhe kuptimeve të përftuara nga transmetimet e mësipërme.

Hulumtim

Durimi është çelësi i çdo shpëtimi

Nuk është ky rasti i vetëm, ku Kur'ani flet dhe bën thirrje për domosdoshmërisë e mbështetjes në durim, me qëllim përballjen me dinjitet të shqetësimeve të ndryshme të jetës.

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, por dhe besimtarët, në përgjithësi, në shumë ajete të Kur'anit, janë urdhëruar të bëjnë durim. Kjo është një çështje, që Kur'ani i ka dhënë një rëndësi të veçantë, sepse të gjitha përvojat dëshmojnë që në fund, triumfi, fitorja dhe ngadhënjimi u përkasin durimtarëve dhe të udhëzuarve në Rrugën e Drejtë.

Në një hadith të Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*, ai urdhëron disa prej shokëve, ngaqë nuk i përballonte dot rrethanat e vështira të kohës së tij, duke u thënë: "*Duhet të bëni durim për të gjitha çështjet tuaja! All'llahu e ka dërguar Muhammedin dhe e ka udhëzuar atë të bëjë durim e kujdes. Ai duroi, derisa armiqtë e tij e bënë të vuajë më shumë nga sa mund të mbante. Zemra e tij u ngushtua prej dhimbjes, prandaj All'llahu zbriti ajetin kur'anor:* **'Ne e dimë mirë, që ty të ngushtohet zemra nga fjalët e tyre, prandaj lartësoje Zotin**

tënd, duke e lavdëruar dhe bëhu prej atyre që i përulen Atij duke u falur!'".[1] Ai duroi, megjithëse e përgënjeshtruan, e fshikulluan me litarët e akuzave dhe të shpifjeve nga të gjitha anët, derisa u mërzit dhe u trishtua prej vuajtjeve. Në këto kushte e rrethana, All'llahu i Madhëruar, i zbriti ajetin: **"Ne e dimë** (o Muhammed) **se ty të mërzisin fjalët** (shpifjet) **e tyre! Në fakt, ata nuk po të përgënjeshtrojnë ty, por zullumqarët janë duke mohuar argumentet e All'llahut. Njëlloj si ti, janë përgënjeshtruar Profetë të tjerë para teje. Ata e duruan vuajtjen dhe dhimbjen e përgënjeshtrimit, derisa u erdhi mbështetja prej Nesh!"**. Më pas, Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* thotë: "*Profeti duroi shumë, madje duroi gjatë, por mohuesit i tejkaluan të gjithë kufijtë, deri sa përgënjeshtruan dhe vetë All'llahun. Kur paturpësia e tyre mbërriti kulmin, Profeti Muhammed (Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), tha: 'Durova të gjitha vuajtjet që lidheshin me mua, me familjen time dhe me nderin tim, por nuk mund të duroj, kur përmendet Zoti im!'*. Në këtë moment, All'llahu i Madhëruar, zbriti ajetin: **"Ne i kemi krijuar qiejt, Tokën dhe çdo gjë që gjendet midis tyre për gjashtë ditë, pa ndier lodhje aspak!"**.[2] *Kjo do të thotë se Ne (All'llahu) i krijuam qiejt dhe Tokën në disa etapa, pa u nxituar dhe pa u ndikuar prej lodhjes dhe plogështisë. Kështu, duhet të durosh (o Muhammed), prandaj dhe i Dërguari i All'llahut duroi, u përball me të gjitha vështirësitë, derisa, me ndihmën e Zotit, triumfoi mbi armiqtë e tij."*.[3]

[1] Sure "El Hixhr", ajeti 97.
[2] Sure "Kaf", ajeti 38.
[3] "Usulul Kafij", njësoj me variantin e ardhur te tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, Hadithi 50, f. 117.

Ajetet 41 – 45

وَٱسۡتَمِعۡ يَوۡمَ يُنَادِ ٱلۡمُنَادِ مِن مَّكَانٖ قَرِيبٖ ٤١ يَوۡمَ يَسۡمَعُونَ ٱلصَّيۡحَةَ بِٱلۡحَقِّۚ ذَٰلِكَ يَوۡمُ ٱلۡخُرُوجِ ٤٢ إِنَّا نَحۡنُ نُحۡيِۦ وَنُمِيتُ وَإِلَيۡنَا ٱلۡمَصِيرُ ٤٣ يَوۡمَ تَشَقَّقُ ٱلۡأَرۡضُ عَنۡهُمۡ سِرَاعٗاۚ ذَٰلِكَ حَشۡرٌ عَلَيۡنَا يَسِيرٞ ٤٤ نَّحۡنُ أَعۡلَمُ بِمَا يَقُولُونَۖ وَمَآ أَنتَ عَلَيۡهِم بِجَبَّارٖۖ فَذَكِّرۡ بِٱلۡقُرۡءَانِ مَن يَخَافُ وَعِيدِ ٤٥

"Dhe vëri veshin thërritësit që thërret prej një vendi të afërt."

"Ditën, kur ata do ta dëgjojnë thirrjen e vërtetë, ajo do të jetë Dita e Daljes (RIngjalljes)**."**

"Jemi Ne ata që japin jetën dhe vdekjen. Te Ne do të kthehet çdo gjë!"

"Atë Ditë, toka do të hapet e ata do të dalin me nxitim. Për Ne është e lehtë t'i mbledhim ata të gjithë."

"Ne e dimë mirë çfarë thonë ata, por ti nuk do t'i detyrosh ata me dhunë (që të besojnë)**. Prandaj këshillo me Kur'anin këdo që ka frikë paralajmërimin Tim!"**

Komentimi

Të gjithë dalin të gjallë, sa dëgjojnë thirrjen e Ditës së Gjykimit!

Ajetet 41-45, me të cilat mbyllet surja "Kaf", si të gjitha ajetet në këtë sure, trajtojnë çështjet që lidhen me rikthimin, (Ringjalljen). Këto ajete përfshijnë një tjetër aspekt a dukuri që lidhet me Ditën e Gjykimit, siç është fryrja e Surit, dalja e të vdekurve prej varreve, për t'u rreshtuar në fushën e dhënies së llogarisë. Ajeti i parë prej ajeteve në fjalë thotë: **"Dhe vëri veshin thërritësit që thërret prej një vendi të afërt, Ditën, kur ata do ta dëgjojnë thirrjen e vërtetë, ajo do të jetë Dita e Daljes** (Ringjalljes)**."**.

Personi, të cilit i adresohet urdhri, në këtë rast (veri veshin) është vetë Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, por është e pranuar unanimisht se urdhri i adresohet të gjithë besimtareve.

Me togfjalëshin: **"veri veshin!"**, **së pari**, nënkuptohet *pritja* dhe monitorimi. Ai që pret një ngjarje a ndodhi, që fillon me një zhurmë të frikshme, sigurisht që është në gjendje të vazhdueshme ankthi, pritjeje dhe monitorimi. Pra, është duke pritur ta dëgjojë atë zë.

Së dyti, është *dëgjimi* dhe monitorimi me vëmendje i Fjalëve të All'llahut. Në këtë rast, kuptimi i saj është: "Dëgjoi me

kujdes Fjalët e All'llahut!", pasi më poshtë thuhet: **"Dhe vëri veshin thërritësit që thërret prej një vendi të afërt"** .[1]

Natyrshëm, lind pyetja: Cili është ky thirrës?! Mundësia e parë është që thërritësi të jetë vetë All'llahu i Madhërishëm. Por, mundësia më reale është që të jetë engjëlli Israfil, engjëlli që do t'i fryjë Surit. Ka shumë tregues në ajete të tjera kur'anore përreth tij, jo duke e përmendur me emër, por me shprehje të veçanta.

Shprehja: **"prej një vendi të afërt"**, tregon se oshtima e kësaj thirrjeje do të shpërndahet në atmosferë dhe do të duket sikur fryhet në veshin e gjithsecilit. Pra, të gjithë do ta dëgjojnë atë zë nga e njëjta largësi.

Në kohën e sotme, fjalët e njerëzve mund t'i dëgjojmë nga çdo vend ku ata ndodhen, duke përdorur mjetet moderne të komunikimit masiv, aq sa njerëzit duken se janë duke biseduar me njeri-tjetrin nga shumë afër. Në ndryshim me dukurinë e mësipërme, në Ditën e Gjykimit, njerëzit do ta dëgjojnë thirrjen, pa pasur nevojë për mjete të tilla komunikimi, pasi ajo (thirrja) do të jetë fare pranë për cilindo prej tyre.[2]

---

[1] Bazuar mbi komentimin e parë, fjala *"jeum"* është kallëzuesi i fjalës *"istemi'i"*. Bazuar mbi komentimin e dytë, kallëzuesi i fjalës *"istemi'i"* është i padukshëm. Kuptimi i tij i fshehur është: Dëgjoi fjalët e Zotit tënd. Kështu që fjala *"jeum"* – *"ditë"* vjen në rasën kallëzore, për shkak se përpara saj është folja *"dalin"*. Në tërësinë e vet, ato nënkuptojnë: Ata do të dalin, ditën kur do të thërrasë thirrësi, nga një vend i afërt.

[2] Një grup komentuesish janë të mendimit se *"vendi i afërt"*, i përmendur në ajet, nënkupton gurin e Shtëpisë së Shenjtë në Jerusalem. Pra, ajo nënkupton atë gur të veçantë, prej të cilit Profeti ynë i nderuar *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nisi udhëtimin e tij hyjnor për në qiell (Miraxhin). Kështu, thirrësi ngjitet në një anë të këtij guri dhe thërret: "O ju kocka të pluhurosura dhe ju o mishra të shpërbërë, ngrihuni për të dhënë

Gjithsesi, kjo thirrje nuk është thirrja e parë, e cila do të lajmërojë fundin e botës, por është thirrja e dytë. Kjo është thirrja që njofton daljen para All'llahut të Madhëruar. E vërtetë është se ajeti i dytë vjen si sqarim, por edhe si komentim i ajetit të parë, ku thuhet: **"Ditën, kur ata do ta dëgjojnë thirrjen e vërtetë, ajo do të jetë Dita e Daljes** (Ringjalljes)**."**.

Me fjalën *"nuhji"* – *"japim jetë"*, nënkuptohet jeta e parë, e jetuar në këtë botë. Me fjalën *"numrit"* - *"japim vdekjen"*, nënkuptohet fundi i jetës apo moshës. Ndërsa me fjalinë: *"Ilejna el mesijr"* - *"Te Ne do të kthehet çdo gjë!"*, nënkuptohet ringjallja në Ditën e Gjykimit: **"Jemi Ne ata që japin jetën dhe vdekjen. Te Ne do të kthehet çdo gjë!"**.

Si përfundim, ajeti tregon një të vërtetë, që duket sikur e paraqet jetën dhe vdekjen në këtë botë, si të jenë në dorën tonë. Gjithashtu, po kështu e paraqet ringjalljen dhe Ditën e Gjykimit, si të jenë në dorën tonë.

Më pas, Kur'ani njofton kohën kur do të ndodhë Ringjallja dhe rreshtimi në fushën e Mahsherit: **"Atë Ditë, toka do të hapet e ata do të dalin me nxitim..."**.

Do të thotë që të vdekurit do të dalin me shpejtësi prej varreve.[1] Më pas ajeti shton: **"...Për Ne është e lehtë t'i mbledhim ata të gjithë."**.

---

llogari dhe për të marrë shpërblimin e Zotit tuaj!". Për këtë komentim nuk ka ndonjë argument të qartë.

[1] Fjala *"sira'an"* - *"me shpejtësi"* është në rasën kallëzore dhe vjen si ndajfolje e kryefjalës së fshehur për kallëzuesin *"jekhruxhun"* - *"dalin"*, kuptimi i të cilës është: *jekhruxhune sira'an - dalin me shpejtësi*. Fjala *"sira'an"* - *"me shpejtësi"*, është

Fjala *"el hashru"*, nënkupton mbledhjen dhe grumbullimin prej të gjitha anëve dhe vendeve.

Është e qartë se Krijuesi i qiejve, i Tokës dhe i gjithçkaje, që gjendet mes tyre, e ka fare të lehtë t'i rreshtojë të vdekurit, duke i vënë ata në dispozicion të drejtësisë hyjnore, ku do të marrin shpërblimin apo dënimin e merituar.

Në fakt, çështja e vështirësisë dhe e lehtësisë analizohet dhe trajtohet vetëm në ato raste kur kemi të bëjmë me mundësi dhe aftësi të kufizuara, por i Gjithëfuqishmi dhe i Gjithëpushtetshmi, që është i aftë të bëjë gjithçka, bën me lehtësinë më të madhe çfarëdo që dëshiron: **"Atë Ditë, toka do të hapet e ata do të dalin me nxitim. Për Ne është e lehtë t'i mbledhim ata të gjithë."**.

Bukuria është se në disa transmetime lexojmë të thuhet: Njeriu i parë që do të dalë prej varrit të tij e do t'i drejtohet Fushës së Mahsherit me shoqëruesin e tij, do të jetë Imam Aliu.[1]

Kurse ajeti i fundi prej ajeteve në fjalë, i cili është edhe ajeti i fundit i sures "Kaf". Këto ajete qetësojnë dhe argëtojnë zemrën e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* që e shkëpusin mendjen e tij nga dhimbjet që ia shkaktuan mohuesit kryeneçë. All'llahu i Madhëruar thotë: **"Ne e dimë mirë çfarë thonë ata, por ti nuk do t'i detyrosh ata me dhunë** (që të besojnë)**..."**.

---

shumësi i fjalës *"seri'i"* - *"i shpejtë"*, ashtu si ndodh me fjalën *"kikam"* - *"bujarë"*, e cila është shumësi i fjalës *"kerim"* – *"bujar"*.

[1] "Kitabul Khisal", njësoj me transmetimin e përmendur te "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, Hadithi 60, f. 119.

Detyra jote (o Muhammed) është t'u përcjellësh atyre lajmin dhe paralajmërimin tim! Prandaj në fund të ajetit, All'llahu i Madhëruar, thotë: **"...Prandaj këshillo me Kur'anin këdo që ka frikë paralajmërimin Tim!"**.[1]

Në tefsirin e Kurtubiut, transmetohet prej Ibn Abasit: "Një grup njerëzish erdhi te Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe i thanë: "Na këshillo, na paralajmëro dhe na jep një lajm, o i Dërguari i All'llahut!". Në ato momente, zbriti ajeti kur'anor: **"Prandaj këshillo me Kur'anin këdo që ka frikë paralajmërimin Tim!"**.[2]

Ky është një tregues i qartë se Kur'ani, është i mjaftueshëm për t'i paralajmëruar dhe për t'i zgjuar besimtarët. Ai, në çdo faqe të tij, u kujton atyre Ditën e Gjykimit. Në ajete trajtohen historitë e popujve të hershëm dhe tregohet qartë përfundimi i tyre, sikurse tregohen cilësitë e banorëve të zjarrit dhe të Xhennetit. Në këto ajete dëshmohen, gjithashtu, ngjarjet më të rëndësishme që do të ndodhin në Gjykatën e Drejtësisë së All'llahut në Ditën e Gjykimit. Ato ngjarje shërbejnë si këshilla dhe mësime të mira për të gjithë njerëzit.

Është e rëndësishme dhe, gjithashtu, e drejtë të kujtojmë pamjet gjëmimtare të çarjes së tokës, rikthimin e shpirtit të të vdekurit, daljen e tyre prej varreve, riveshjen e trupave të tyre me rrobën e jetës, transformimin e tyre në gjendje frike e tronditjeje që i kaplon prej kokës deri në majë të këmbës, teksa i drejtohen

---

[1] Fjala *"uaijd"* - *"paralajmërim"*, e ka origjinën te fjala *"uaidii"*. Shkronja *"ja"* u shmang dhe në vend të saj u përdor zanorja *"i"*, për ta përfaqësuar atë dhe ajo është kallëzues i foljes *"jekhaf"* - *"ka frikë"*.

[2] Tefsiri "Kurtubijj", vëll. 9, f. 6198.

Gjykatës së Drejtësisë së All'llahut. Me të vërtetë, që këto janë pamje shumë emocionuese.

E veçanta qëndron në faktin se shumë prej varreve janë mbipopulluar me trupa njerëzish përgjatë kalimit të viteve dhe kohës. Disa prej tyre janë të ndershëm dhe disa të këqij, disa prej tyre janë besimtarë dhe disa mohues.

Poeti i famshëm El Mearrij shkruan:

"Ndoshta një varr ka qenë disa herë varr.

Të ngjallë të qeshura ndeshja e të kundërtave.

Të varrosur mbi mbetje të varrosurish

në kohë e periudha të gjata."

Fundi i sures "Kaf".

SURE "EDH DHARIJAT"

Zbritur në Mekë, 60 ajete

Përmbajtja e sures "Edh Dharijat"

Përmbajta e kësaj sureje është e përqendruar, kryesisht te çështjet e lidhura me rikthimin, Ringjalljen, me Ditën e Gjykimit, me shpërblimin dhe me dënimin e secilit prej besimtarëve dhe mohuesve. Kjo sure nuk është e ngjashme me suren "Kaf", sepse ajo nuk përqendrohet vetëm te çështjet e rikthimit, por trajton edhe çështje të tjera, si mund ta vërejë lehtësisht edhe lexuesi.

Përgjithësisht, mund të themi se çështjet e trajtuara në këtë sure, përqendrohen në pesë boshte kryesore, që janë:

1- Ashtu siç e kemi përmendur më parë, pjesa më e rëndësishme e sures trajton çështjen e rikthimit, të Ringjalljes. Kështu, fillimi dhe fundi i sures merret me këtë çështje.

2- Një pjesë tjetër e sures, trajton çështje të lidhura me Teuhidin, Njësimin e All'llahut, si dhe argumentet e Tij për rregullin e madh të ekzistencës. Këto, sigurisht, janë argumente plotësuese për çështjet e rikthimit.

3- Në një pjesë tjetër të sures flitet për vizitorët engjëj të Profetit Ibrahim *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* dhe urdhrat që ata kishin marrë për të shkatërruar qytetet dhe vendbanimet e popullit të Lutit.

4- Ajetet e tjera të kësaj sureje, përçojnë informacione të shkurtra që lidhen me historinë e Profetit Musa *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* dhe të disa popujve të tjerë, si: populli i Adit, i Themudit dhe i Nuhut. Nëpërmjet këtyre historive paralajmërohen mohuesit dhe ftohen të kuptojnë çfarë u ka ndodhur popujve të mëparshëm.

5- Së fundi, një tjetër pjesë e kësaj sureje flet rreth refuzimit dhe përplasjes së popujve të hershëm me Profetët e dërguar prej All'llahut. Në këtë pjesë të sures, All'llahu e udhëzon Profetin Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* të bëjë durim e të qëndrojë i vendosur gjatë përballjes me vështirësitë dhe problemet. Kjo pjesë vjen për të qetësuar zemrën e tij dhe për ta mbështetur atë.

Mirësia e leximit të kësaj sureje

Prej Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)* është transmetuar se ka thënë: "*Ai që lexon suren 'Edh Dharijat' ditën ose natën, All'llahu i Madhëruar do t'ia përmirësojë ndjeshëm cilësinë e jetesës, do ta furnizojë atë me risk të bollshëm dhe do t'ia ndriçojë varrin me një llambë që do të ndriçojë deri në Ditën e Gjykimit.*".[1]

Siç kemi përmendur vazhdimisht, leximi i Kur'anit, zhveshur prej meditimit dhe shijimit të kuptimeve, është i pamjaftueshëm për ta arritur këtë shpërblim të madh.

Në thelb, qëllimi i leximit, është meditimi rreth kuptimeve të tekstit. Ai meditim që e shtyn njeriun drejt veprave të mira.

Emërtimi i sures me fjalën "Edh Dharijat", lidhet me fjalën e parë të sures: "Betohem në erërat që çojnë pluhurin!"

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", fillimi i sures "Edh Dharijat", shpërblimi i veprave, e ngjashme me atë që është përmendur në tefsirin "Nuruth Thekalejn".

Ajetet 1- 6

وَٱلذَّٰرِيَٰتِ ذَرۡوٗا ١ فَٱلۡحَٰمِلَٰتِ وِقۡرٗا ٢ فَٱلۡجَٰرِيَٰتِ يُسۡرٗا ٣ فَٱلۡمُقَسِّمَٰتِ أَمۡرًا ٤
إِنَّمَا تُوعَدُونَ لَصَادِقٞ ٥ وَإِنَّ ٱلدِّينَ لَوَٰقِعٞ ٦

Me emrin e All'llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

"Betohem në erërat që çojnë (pluhurin)**."**

"Dhe në retë e ngarkuara rëndë."

"Dhe në ato që lundrojnë lehtë."

"Dhe në engjëjt që shpërndajnë urdhrat."

"Se, me të vërtetë, është e sigurt ajo që ju premtohet."

"Dhe çdo shpërblim e dënim do të ndodh!"

Komentimi

Betohem në furtunat dhe në retë që e shpërndajnë pluhurin

Pas sures "Es Safat", kjo është surja e dytë, në Kur'an, që nis me betim të përsëritur, me betim të thellë, të fuqishëm, kuptimplotë, që e shtyn mendjen drejt meditimeve të thella. Kjo është surja e dytë, në Kur'an, që fillon me një betim, i cili ka për qëllim ta zgjojë njeriun dhe t'i dhurojë atij vetëdije, pjekuri, maturi dhe vizion të qartë.

Janë të shumta suret në Kur'an, që, me ndihmën e All'llahut, do t'i marrim për t'i studiuar dhe për t'i komentuar në të ardhmen. Gjëja më e bukur në këtë, është se pjesa më e madhe e betimeve lidhen me rikthimin, Ditën e Gjykimit, përveç disa rasteve që trajtojnë çështjen e Teuhidit dhe gjithçka që lidhet me të.

Një tjetër aspekt, i cili tërheq vëmendjen e studiuesve, është se thelbi i këtij betimi lidhet me përmbajtjen kuptimore të zhvillimeve të Ditës së Gjykimit. Ai e ndjek këtë hulumtim me bukuri dhe elegancë, në disa aspekte.

E vërteta është se çdo pjesë apo kapitull në Kur'an, edhe pse kapitujt janë të shumtë, janë shëmbëlltyrë e një forme të caktuar të mrekullisë së Librit Qiellor, që quhet Kur'an. Kjo është një prej anëve më të bukura dhe më të mahnitshme të Kur'anit, ashtu si dhe do të analizohet imtësisht më vonë. Por çdo gjë në rendin e vet.

Në fillim të sures, All'llahu i Madhëruar, betohet mbi pesë gjëra, thënë më qartë mbi pesë dukuri të ndryshme. Katër betimet e para ishin të njëpasnjëshme, lidhur varg me njëri-tjetrin, ndërsa betimi i pestë vjen i veçuar.

All'llahu i Madhëruar thotë në fillim të sures: **"Betohem në erërat që çojnë** (pluhurin)**"**[1], që do të thotë: Betohem në erërat që i ngrenë retë në qiell dhe i shpërndajnë farërat ngado në Tokë!

Më pas thotë: **"Dhe në retë e ngarkuara rëndë"**[2] që do të thotë: Betohem në retë e ngarkuara me shira të rrëmbyeshëm! **"Dhe në ato që lundrojnë lehtë."**.[3] Me fjalën "*el xharijat*", në këtë rast, nënkuptohen anijet: Betohem në anijet që lundrojnë aq lehtë në lumenjtë e mëdhenj dhe nëpër detet e oqeanet e gjera!

"Dhe në engjëjt që shpërndajnë urdhrat." Me fjalën "*el mukasimati*", në këtë rast, nënkuptohen engjëjt që do të shpërndajnë urdhrat.

---

[1] Fjala "*edh dharijat*" - "*erërat*" është shumësi i fjalës "*edh dharijeh*" - "*erë*" dhe nënkupton erën, e cila merr me vete ç'të gjejë duke i shpërndarë ato në hapësirë.

[2] Fjala "*el uikr*" - "*rëndë*" vjen në formën e fjalës "*el fikr*" dhe nënkupton peshën e rëndë. Ajo përdoret, gjithashtu, kur duam të cilësojmë dëgjimin e rëndë, autoritetin e madh të dikujt, lëvizjen e rëndë, gjithashtu, urtësinë e qetësinë.

[3] Fjala "*el xharijat*" - "*ato që lundrojnë*", është shumësi i fjalës "*xharijeh*", në këtë rast, ato nënkuptojnë anijet; herë të tjera nënkuptojnë lumenjtë, për arsye të lëvizshmërisë së tyre. Në ajetin 12 të sures "El Gashije", All'llahu i Madhëruar ka thënë se në Xhennet do të ketë lumenj të lëvizshëm, që derdhen. Kjo fjalë përdoret edhe për Diellin për shkak të lëvizjes. Gjithashtu, përdoret edhe për vajzën e re, për arsye sepse energjia e rinisë lëviz në qënien e saj.

Në fundit të këtij ajeti, lexojmë një hadith të analizuar prej shumë komentuesve. Ibnul Keua[1] ka pyetur një herë Imam Aliun *(Paqja qoftë mbi të!)*, kur ai ishte duke mbajtur hytben, ligjëratën: "O Ali, çfarë do të thotë Fjala e All'llahut: **'Betohem në erërat që çojnë** (pluhurin)'?!"

Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* iu përgjigj: "Bëhet fjala për erërat!"

Ai, nuk mungoi ta pyesë përsëri: "Çfarë do të thotë Fjala e All'llahut: **'Dhe në retë e ngarkuara rëndë'**?!"

Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* i tha: "Bëhet fjala për retë!"

Ibnul Keua vazhdoi ta pyesë: "Çfarë do të thotë Fjala e All'llahut: **'Dhe në ato që lundrojnë lehtë'**?!"

Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* iu përgjigj qetë: "Bëhet fjala për anijet që lundrojnë!"

Pyetjet e tij vazhduan: "Çfarë do të thotë Fjala e All'llahut: **'Dhe në engjëjt që shpërndajnë urdhrat'**?!"

Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* i tha shkurt e qartë: "Bëhet fjala për engjëjt!"

Megjithatë, ekzistojnë shumë komente të tjera, që mund t'ia bashkëngjisim këtij komentimi. Në njërin prej tyre thuhet se fjala *"el xharijat"*, nënkupton lumenjtë që rrjedhin me ujë qielli, ndërsa fjalia *"uel mukasimati emra"* - **"Dhe në engjëjt që**

[1] E kanë pas thirrur me emrin Abdullah. Ai ka qenë njëri prej hipokritëve dhe njëri prej armiqve më të mëdhenj të Imam Aliut, paçka se pretendonte të ishte një prej shokëve të tij. Ai thurte vazhdimisht plane kundër tij.

shpërndajnë urdhrat", nënkupton mirësitë, riskun, begatitë e All'llahut, të cilat Ai i shpërndan në Tokë me anë të engjëjve, pra, me të mbjellat.

Nisur nga sa thamë më lart, mund të dëshmojmë se biseda rreth erërave, më pas rreth reve, pastaj rreth lumenjve dhe së fundi rreth bimëve në tokë, ka shumë ngjashmëri me çështjen e rikthimit, të Ringjalljes, pasi siç e dimë dhe e kemi trajtuar më parë, njëri prej argumenteve të mundësisë së rikthimit dhe Ringjalljes është jeta, që Zoti lindi në një tokë të vdekur me anë të ujitjes. Ky aspekt është i pranishëm, por në forma të ndryshme, edhe në shumë pjesë të tjera të Kura'nit Famëlartë.

Ekziston dhe një tjetër mundësi, pra, që këto katër cilësi të jenë të gjitha të lidhura me erën. Erërat që formësojnë retë, erërat që i mbajnë retë, erërat që i lëvizin retë nga njëri vend në tjetrin dhe erërat që shpërndajnë në çdo cep të tokës pikat e shiut.[1]

Duke iu referuar faktit që këto shprehje përmenden në të gjitha ajetet, dëshmojmë se ato janë të përgjithshme dhe gjithëpërfshirëse, se ato janë përcjellëse të të gjitha kuptimeve marrë së bashku. Gjithsesi, komentimi në të cilin mbështetemi, është komentimi i parë.

Këtu lind një pyetje: Nëse me fjalën *"el mukasimat"*, nënkuptohen engjëjt që ndajnë, shpërndajnë, atëherë çfarë shpërndajnë ato?!

Përgjigjja është: Me shpërndarje, në këtë rast, mund të nënkuptohet shpërndarja e detyrave që çdo engjëll apo grup engjëjsh ka në raport me dukuri të rëndësishme të natyrës, jo vetëm atyre që ndodhin në botë, pasi grupe të ndryshme të

[1] Këto kuptime janë trajtuar te libri "Et Tefsirul Kebijr", vëll. 28, f. 195.

engjëjve ngarkohen me përkujdesjen dhe monitorimin nga afër të këtyre dukurive. Gjithashtu, kuptojmë se me shpërndarje, në këtë rast, kemi të bëjmë me shpërndarjen e riskut dhe begative të All'llahut, për vise e vende të ndryshme të Tokës.[1]

Menjëherë pas katër betimeve të mëdha, që kanë për qëllim të tregojnë rëndësinë e asaj që vjen pas, All'llahu i Madhëruar, thotë: **"Me të vërtetë, është e sigurt ajo që ju premtohet!"**.[2]

Për më shumë përforcim, All'llahu i Madhëruar shton: **"Dhe çdo shpërblim e dënim do të ndodhë!"**. Fjala *"ed dijn"*, në këtë rast, nënkupton shpërblimin e All'llahut. E njëjta fjalë shfaqet me të njëjtin kuptim, te Fjala e All'llahut të Madhëruar në suren "El Fatiha": *"maliki jeumid'diin"*, e cila nënkupton Ditën e Gjykimit.

Në fakt, prej emrave të Ditës së Gjykimit, janë edhe *"jeumud'din"* dhe *"jeumul xheza"*. Gjithçka sqarohet, kur shohim se qëllimet e premtimeve të përmendura, janë pikërisht, ato që premtohen në Ditën e Gjykimit. Gjithçka që lidhet me shpërblimin dhe llogarinë, me dënimin, me Xhennetin dhe Xhehennemin, pra, me të gjitha ato çështje që lidhen me rikthimin e Ringjalljen. Nisur nga ky fakt, mund të themi se fjalia e parë përfshin të gjitha premtimet, ndërsa fjalia e dytë mbështet çështjen e llogarisë në Ditën e Gjykimit.

---

[1] Duhet të kemi parasysh se shkronja *"uau"* te fjala *"edh dharijat"* është *"uau"* i betimit, pra, është një shkronjë që përdoret për t'u betuar. Por, shkronja *"fa"* tek ajeti që e pason, edhe pse është shkronjë ndërlidhëse, mban edhe kuptimin e betimit. Roli i saj, në këtë rast, është, gjithashtu, ndërlidhja e katër betimeve në ajet.

[2] Duhet të kemi parasysh këtu se fjala *"ma"*, në këtë rast, është emër i lidhur. Ajo është kryefjalë e *"le enn"* dhe kallëzuesi i saj është fjala *"le sadik"*.

Më pas, i vjen radha diskutimit rreth çështjes së "*jeumid'din*" – "*Ditës së Gjykimit*". Siç e kemi përmendur dhe më herët, të gjitha anekset kuptimore të fillimit të sures kanë ngjashmëri, kështu që janë plotësisht në përshtatje me përfundimin e tyre. Arsyeja e jetës është lëvizja e reve, rënia e shiut, prandaj lindja e jetës në një tokë të vdekur, përfaqëson, në vetvete, shfaqjen dhe ngjarjen më të rëndësishme të Ditës së Gjykimit.

Disa komentues të Kur'anit kanë thënë se shprehja: **"Ajo që ju premtohet!"**, ka kuptim të gjerë. Ajo përfshin të gjitha premtimet hyjnore që lidhen me Ditën e Gjykimit me këtë botë, me shpërndarjen e begative, me ndëshkimin e kriminelëve si në këtë botë, ashtu edhe në Botën Tjetër, me triumfin e besimtarëve të ndershëm. Vetë ajeti 22 i të njëjtës sure thotë, pikërisht, kështu: **"Në Qiell është risku juaj dhe gjithçka ju është premtuar!"**. Ky ajet, mund të jetë mbështetje për këtë kuptim, por, duke qenë se domethënia e ajetit ka natyrë absolute, nuk e përjashton përgjithësimin.

Në të gjitha rastet, nuk ka dyshim se të gjitha premtimet e Zotit janë të vërteta dhe të zbatueshme, pasi mosmbajtja e premtimit është e lidhur me paditurinë, ose me paaftësinë. Padituria, nga ana e saj, është motivuese e harresës apo e ndryshimit të mendjes nga ana e premtuesit, ndërsa paaftësia, bëhet pengesë që premtuesi ta mbajë premtimin e dhënë. Por, All'llahu i Madhëruar është i Gjithëdijshëm dhe i Plotfuqishëm, prandaj Ai i respekton premtimet e Tij. Ai është i lartë nga të metat.

Ajetet 7 – 14

وَٱلسَّمَآءِ ذَاتِ ٱلۡحُبُكِ٧ إِنَّكُمۡ لَفِي قَوۡلٖ مُّخۡتَلِفٖ٨ يُؤۡفَكُ عَنۡهُ مَنۡ أُفِكَ٩ قُتِلَ ٱلۡخَرَّٰصُونَ١٠ ٱلَّذِينَ هُمۡ فِي غَمۡرَةٖ سَاهُونَ١١ يَسۡـَٔلُونَ أَيَّانَ يَوۡمُ ٱلدِّينِ١٢ يَوۡمَ هُمۡ عَلَى ٱلنَّارِ يُفۡتَنُونَ١٣ ذُوقُواْ فِتۡنَتَكُمۡ هَٰذَا ٱلَّذِي كُنتُم بِهِۦ تَسۡتَعۡجِلُونَ١٤

“Për qiellin e stolisur me yje!”

“Ju keni gjithfarë mendimesh.”

“Prej tij (Kur’anit) **shmanget ai që nuk beson.”**

“Qofshin mallkuar gënjeshtarët.”

“Të cilët janë të zhytur në padije dhe të shkujdesur (ndaj Ditës së Gjykimit)**!”**

“Ata pyesin: ‘Kur do të jetë Dita e Gjykimit?’”

“Atë Ditë ata do të përcëllohen në zjarr!”

“(Do t’u thuhet)**: Shijoni dënimin tuaj! Këtë kërkuat t’ju shpejtohet!”**

Komentimi

Betohem në qiellin e stolisur me yje

Njëlloj si ajetet e para të sures, këto ajete nisin me betim dhe flasin për dilemat që kanë jobesimtarët përreth Ditës së Gjykimit, por edhe me çështje të tjera, siç janë: personaliteti i Profetit Muhammed dhe çështja e Njësimit, Teuhidit.

Së pari, ajetet thonë: Betohem në qiellin e zbukuruar me yjet dhe me ngjyrat e bukura. All'llahu i Madhëruar thotë: **"Për qiellin e stolisur me yje!"**.

Fjala "*el hubuk*", është e njëjtë në formë me fjalën "*kutub*". Ajo mbart kuptime të shumta në gjuhën arabe dhe është shumësi i fjalës "*hibak*", e njëjtë në formë me fjalën "*kitab*".

Midis këtyre kuptimeve janë, gjithashtu, format e bukura që krijon rëra kur ngrihet nga era, pothuajse të njëjtat forma me ato që era krijon në det me anë të valëve dhe dallgëve, si dhe në qiell, nëpërmjet formave të ndryshme të shtëllungave të reve.

Fjala "*hubuk*", përdoret, edhe për të cilësuar flokët e prishur apo të pakrehur. Ajo, ndonjëherë, mund të nënkuptojë edhe bukurinë. Kjo fjalë vjen për të nënkuptuar një formë të rregullt e të qëndrueshme. Në fakt, origjina e kësaj fjale, është fjala "*habk*", që nënkupton zotërimin e plotë të diçkaje, por edhe ashpërsinë.[1]

[1] Kthehu te libri "Lisanul Arab" dhe libri "El Mufredat" i Rragibit, Lënda *"el habk"*.

Duket qartë se të gjitha këto kuptime, na shpien në një kuptim të vetëm, i cili është *ulje-ngritjet*, rrudhat, apo valëzimet e mahnitshme që shfaqen mbi rërën e shkretëtirës, mbi sipërfaqe të ndryshme të ujërave, mbi flokët dhe mbi retë në qiell.

Shfaqja e këtyre kuptimeve në qiell, bëhet e qartë teksa, All'llahu i Madhëruar, e cilëson qiellin, në ajet, me të njëjtën fjalë, duke thënë: **"Për qiellin e stolisur me yje!"**.

Në këtë ajet nënkuptohen yjet me format e tyre të ndryshme. Mund të nënkuptohen grupe të caktuara yjesh që marrin forma të magjishme në qiell. Mund të nënkuptohen, gjithashtu, valëzimet e mrekullueshme që krijohen te retë, të cilat tërheqin shikimin e njeriut, duke i krijuar lumturinë për një kohë të gjatë. Ajeti mund të nënkuptojë, gjithashtu, galaktikat e ndryshme që duken si ondulacione dhe dallgëzime flokësh, formash e bukurish mahnitëse mbi sipërfaqen e qiellit. Këto kuptime bëhen më të qarta dhe më të bukura, nëse do ta shikojmë qiellin me teleskop. Valëzimet qiellore duken njëlloj si valëzimet që formohen në flokët e njeriut, kur i rreh puhiza.

Nisur nga sa u tha më sipër, kuptimi i ajetit: **"Për qiellin e stolisur me yje!"**, është betimi i Kur'anit mbi yjet dhe galaktikat e pafundme, të cilat nuk mund të shiheshin me sy të lirë gjatë kohës kur ka zbritur Kur'ani, madje shkenca dhe informacionet që dijetarët e kohës kishin, as që mundej të kishin dijeni për to.

Vlen të përmendim se bashkimi i të gjitha kuptimeve të mëparshme është i mundur, ngaqë ato nuk mbartin, në vetvete, ndonjë kundërshti. Pra, është e mundur, që të gjitha këto kuptime të përfshihen në ajet, me kuptimin e betimit të mësipërm.

Në ajetin 17 të sures "El Mu'minun", lexojmë: **"Ne kemi krijuar mbi ju, shtatë rrugë!"**.[1]

Është e nevojshme të tërheqim vëmendjen e lexuesit në faktin se origjina e rrënjës së fjalës "*el habk*", nënkupton qëndrueshmërinë e qiellit, lidhjen e galaktikave me njëra-tjetrën, yjet që lëvizin në mënyrë të njëtrajtshme, ose yjet që notojnë në sistemin tonë diellor, si dhe harmoninë që ato kanë me diellin.

Ajeti që vijon, është përgjigjja e betimit dhe sqarimi i objektit përmbi të cilin bie ky betim. All'llahu i Madhëruar thotë: **"Ju keni gjithfarë mendimesh"**.

Ajeti duket sikur thotë: Ju kundërshtoni vazhdimisht njëri-tjetrin, ndaj përmendja e kundërshtisë dhe e debatit të pavlerë, në këtë rast, nënkupton pavlefshmërinë e fjalëve me të cilat ata kundërshtohen.

Ju thoni, ndonjëherë, lidhur me ditën e rikthimit: Nuk mund ta besojmë, kurrë, se do të ringjallemi një ditë, pasi kockat tona të jenë bërë pluhur e të jenë shndërruar në dhè!

Herë-herë thoni se keni dyshime, lidhur me këtë çështje dhe jeni të lëkundur.

Herë të tjera na ftoni të ngremë prej varreve baballarët dhe gjyshërit tuaj, që ata të dëshmojnë për ringjalljen dhe për jetën pas vdekjes, pasi kjo është mënyra e vetme, që të besoni.

Tjetër herë thoni se Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është poet, herë është magjistar, herë thoni se është i çmendur dhe herë të tjera se pas tij

[1] Ekziston një komentim i plotë i këtij ajeti. Kthehu te surja "El Mu'minun".

qëndron dikush që e mëson, pra, se ai mësohet prej një mendjeje njerëzore.

Keni sajuar, për Kur'anin, lloj-lloj teorish: Herë thoni se ai është pjesë e legjendave të së shkuarës, herë thoni se ai është një vëllim poetik, herë se është magji dhe herë të tjera thoni, është një shpifje e gënjeshtërt nëpërmjet të cilave një palë e tretë mësoi Muhammedin që t'ia kundërvë atë popullit të vet, etj!

Duke iu referuar fjalëve të mësipërme, kuptimi i betimit në ajetin, objekt i studimit tonë, bëhet i qartë. All'llahu i Madhëruar duket sikur thotë: Betohem në qiellin e mbushur me yje e brezare të mahnitshme, se fjalët tuaja (o mosbesimtarë të Mekës) janë të pavlera dhe të mbushura me kundërshti. Nëse kërkesat tuaja do të ishin të sinqerta, ato duhet të përqendroheshin në një kërkesë të qartë dhe për një çështje të caktuar, por ju çdo ditë kërkoni diçka të re dhe nuk flitni dy ditë njëlloj!

Kjo mënyrë e të shprehurit, është argument i qartë, që tregon pavërtetësinë e pretendimeve të mohuesve të Njësimit të All'llahut, të rikthimit, të Ringjalljes, të Kur'anit dhe Profetit, edhe pse përqendrimi i këtyre ajeteve bëhet kryesisht mbi ditën e rikthimit, siç do ta vërejmë dhe në ajetet në vijim.

Tashmë, është i mirënjohur fakti, se për të zbuluar gënjeshtrën e një gënjeshtari, si në çështje gjyqësore, ashtu edhe në çështje të tjera, mbështetemi te kundërshtitë që mbizotërojnë dëshminë dhe pohimet e tyre. E njëjta metodë ndiqet edhe nga Kur'ani, për të zbuluar gënjeshtrën dhe mashtrimin e jobesimtarëve.

Në ajetin që vijon, Kur'ani qartëson arsyet e shmangies së tyre prej rrugës së vërtetë, kur thotë: **"Prej tij** (Kur'anit) **shmanget ai që nuk beson."**, që do të thotë se besimit për rikthimin dhe ringjalljen, u shmangen të gjithë ata që kanë devijuar nga e vërteta, pasi argumentet e rikthimit dhe të jetës pas vdekjes janë të qarta.

Po të hulumtojmë me kujdes, do të vëmë re se shprehja në ajet është e përgjithshme dhe e kufizuar, e mbyllur, prandaj dhe përkthimi fjalë për fjalë i ajetit është: Që të shmangë prej të vërtetës atë që është i vetëshmangur!"

Fjala "*el ifku"*, në origjinën e saj, përdoret për të nënkuptuar shmangien nga diçka. Por, kjo fjalë është përdorur, gjithashtu, edhe për të nënkuptuar çdo gënjeshtër që ka ndikim tek individët, me qëllim që të devijojnë. Kjo fjalë është përdorur edhe për të emërtuar erërat e ndryshme që fryjnë, si p.sh: *el mu'tefikatu*.

Duke qenë se ajetet e mësipërme janë përqendruar në çështjet e rikthimit dhe të Ringjalljes, vëmë re se me fjalën "*ifkun"*, në rastin konkret, nënkuptohet shmangia ndaj besimit të vërtetë. Nga ana tjetër, duke qenë se në ajetin e mëparshëm flitet rreth kundërshtive në deklaratat e jobesimtarëve, bëhet e qartë se ajeti nënkupton ata që u shmangën nga besimi i tyre për rikthimin. Nënkupton të gjithë ata që u shmangën me vetëdije nga argumentet e qarta të logjikës dhe nga mënyra serioze e arsyetimit, që është vazhdimisht në kërkim të së vërtetës.

Natyrshëm, nuk ekziston asnjë pengesë logjike që ndalon të besojmë se nëpërmjet fjalës "*ifkun"*, nënkuptohet shmangia nga e vërteta, sidoqoftë lloji i shmangies, qoftë shmangien nga Kur'ani, apo nga Njësimi i All'llahut (Teuhidi), nga profetësia,

apo çështja e rëndësishme e rikthimit dhe ringjalljes në Ditën e Gjykimit. E ngjashme me këtë logjikë është edhe çështja e ndjekjes dhe e pasimit të Imamëve të pagabueshëm, trajtuar në disa transmetime të ndryshme. Ajo që mund të themi me bindje, është se boshti kryesor ku përqendrohen kuptimet e ajeteve, padyshim është çështja e rikthimit dhe e ringjalljes në Ditën e Gjykimit.

Ajeti që vijon, sjell një kritikë shumë të ashpër ndaj gënjeshtarëve dhe një kërcënim të hapur ndaj të gjithë atyre që fabrikojnë gënjeshtra. All'llahu i Madhëruar thotë: **"Qofshin mallkuar gënjeshtarët."**.

Fjala "*el kharas"*, vjen nga fjala "*harsun*", e njëjtë në formë më fjalën "*dersun"*, me të cilën nënkuptohen fjalët me natyrë hamendësuese dhe hipotetike. Duke qenë se fjalët, me natyrë hamendësuese dhe hipotetike, janë në përgjithësi gënjeshtra, kjo fjalë u përzgjodh nga Kur'ani Famëlartë për të cilësuar gënjeshtarët. Kështu, fjala "*el kharasun"*, nënkupton të gjithë ata që flasin fjalë pa ndonjë bazë e themel, fjalë të zhveshura nga të vërtetat. Duke u bazuar në sa u përmend më lart, themi se kuptimi i këtij ajeti kur'anor, duke u mbështetur dhe në kuptimet e ajeteve që do të vijojnë, është: Ata që gjykojnë rreth çështjes së rikthimit dhe Ringjalljes, me fjalë të pabaza, janë shumë larg dhe prej logjikës më të thjeshtë.

Gjithsesi, mënyra si All'llahu i Madhëruar është shprehur në këtë ajet, duket se mbart, në vetvete, diçka më shumë se mallkim, diçka më shumë se lutje kundër tyre, çka nënkupton se gënjeshtarët janë krijesa, mosqenia në jetë e të cilëve është shumë më e dobishme se sa ekzistenca e tyre.

Disa komentues e kanë shpjeguar fjalën *"el katlu"*, në këtë ajet me kuptimin e largimit, përzënies, mallkimit dhe mohimit të mëshirës së All'llahut për këtë kategori të neveritshme njerëzish.

Nisur për sa thamë, prej këtij gjykimi të përgjithshëm mund të arrijmë në përfundimin se gjykimi pa argument, pa perceptim dhe pa bazë, është i dukshëm, madje gjykimi i bazuar mbi dyshimin dhe hipoteza të kota, e çon njeriun drejt humbjes së madhe, për rrjedhim e bën atë, plotësisht, të merituesshëm për dënimin dhe mallkimin.

Kur'ani përshkruan edhe cilësitë e këtyre mashtruesve gënjeshtarë: **"...të cilët janë të zhytur në padije dhe të shkujdesur** (ndaj Ditës së Gjykimit)**!"**.

Fjala *"el gamretu"*, në origjinë të saj, nënkupton ujin që rrjedh furishëm dhe përmbyt e mbulon një vend të caktuar. Kjo është përdorur edhe për të nënkuptuar injorancën e thellë që kaplon trurin e njeriut.

Fjala *"sahuune"*, është shumësi i fjalës *"sahin"*, ajo buron nga fjala *"es seh'un"*, që në rastin konkret nënkupton *"hutinë"* dhe *"shkujdesjen"*.

Disa komentues pohojnë se injoranca ndahet në disa etapa: E para, është harresa dhe dyshimi. E dyta, vjen hutia. E treta, është shkujdesja.

Duke u bazuar në logjikën e mësipërme, kuptimi i ajetit është: Jobesimtarët e nisin me etapën e harresës, më pas rrëshqasin për në etapën e hutisë dhe së fundi, në etapën e shkujdesjes. Pasi rrugëtojnë për një kohë të gjatë nëpër këto etapa, ata zhytën plotësisht në errësirën e paditurisë. Bashkimi mes

këtyre dy shprehjeve, mes harresës dhe shkujdesjes, është treguesi i fillimit dhe i fundit të kësaj lëvizjeje.

Si përfundim, mund të themi se nëpërmjet fjalës së përzgjedhur nga Kur'ani, *"el kharasun"*, nënkuptohen të gjithë ata që janë zhytur në padituri në e tyre dhe që çdo ditë nxjerrin nga një pretekst të stisur, thjesht për t'iu shmangur të vërtetës.

Për këtë arsye, siç thotë dhe All'llahu i Madhëruar: **"Ata pyesin: Kur do të jetë Dita e Gjykimit?"**.

Fjalia: **"Ata pyesin"** dhe folja që përmendet në kohën e tashme, tregon qartë se jobesimtarët do ta bëjnë vazhdimisht këtë pyetje: **"Kur do të jetë Dita e Gjykimit?"**.

Kjo pyetje tregon, gjithashtu, se koha kur do të ndodhë Dita e Gjykimit, do të jetë e fshehtë, mundësia e ndodhjes së saj mund të jetë e papritur, në çdo kohë. Kështu, në këtë mënyrë, përfitojmë shumë ndikime pozitive edukative nga besimi i Ditës së Gjykimit, kryesisht në formimin e një personaliteti të fortë dhe një gjendjeje shpirtërore në gatishmëri të përhershme.

Ky krahasim është i ngjashëm me problemin e të sëmurit që shkon te mjeku dhe e pyet: Kur do të mbarojë jeta ime?! - pyetje të cilën ia përsërit pafundësisht. Të gjithë ata që e bëjnë pafundësisht këtë pyetje, duhet të kuptojnë se është e mjaftueshme të dinë dhe të ndërgjegjësohen, se vdekja është një e vërtetë e pashmangshme. Ky është ilaçi i duhur për të mjekuar vetveten, që Zoti të mos të të sprovojë me vdekje të shpejtë.

Jobesimtarët nuk kishin asnjë qëllim të mirë, përveç talljes dhe justifikimit me lloj-lloj pretekstesh të stisura, kështu që pyetjet

dhe shqetësimet që ata "gjoja" ngrinin, lidhur me Ditën e Gjykimit, nuk buronin nga ndërgjegjja e pastër, por prej urrejtjes, smirës, xhelozisë dhe refuzimit të tyre.

Megjithatë, Kur'ani vjen për t'u dhënë atyre një përgjigje të menjëhershme, të ashpër dhe të drejtpërdrejtë, duke thënë: **"Atë Ditë ata do të përcëllohen në zjarr!"**.

Pasi të kenë hyrë në zjarrin e Xhehennemit, do t'u thuhet: **"Shijoni dënimin tuaj! Këtë kërkuat t'ju shpejtohet!"**.

Fjala *"el fitnetu"*, në origjinalitet ka kuptimin e provimit në zjarr të floririt, për të dalluar cilësinë e tij. Për këtë arsye, fjala *"fitneh"*, nënkupton llojet e sprovave dhe të testimeve të ndryshme. Ajo përdoret, gjithashtu, për futjen e njeriut në zjarrin e Xhehennemit, si dhe për të shpjeguar domethënien e fatkeqësive, të dënimeve dhe mungesës së qetësisë, siç bëhet e qartë dhe në ajetin, objekt i studimit tonë, në këtë rast.

Ajetet 15 – 19

إِنَّ ٱلْمُتَّقِينَ فِى جَنَّٰتٍ وَعُيُونٍ ١٥ ءَاخِذِينَ مَآ ءَاتَىٰهُمْ رَبُّهُمْ ۚ إِنَّهُمْ كَانُوا۟ قَبْلَ ذَٰلِكَ مُحْسِنِينَ ١٦ كَانُوا۟ قَلِيلًا مِّنَ ٱلَّيْلِ مَا يَهْجَعُونَ ١٧ وَبِٱلْأَسْحَارِ هُمْ يَسْتَغْفِرُونَ ١٨ وَفِىٓ أَمْوَٰلِهِمْ حَقٌّ لِّلسَّآئِلِ وَٱلْمَحْرُومِ ١٩

“Pa dyshim, ata që i frikësohen All’llahut, do të jenë në kopshte e burime!”

“Duke marrë atë që ua ka dhuruar Zoti i tyre, meqë më parë kanë qenë punëmirë.”

“Ata flinin pak natën.”

“Ndërsa në agim kërkonin falje (nga All’llahu)**.”**

“Në pasurinë e tyre ka pasur pjesë për lypësit dhe nevojtarët.”

Komentimi

Shpërblimi i All'llahut për ata që kërkojnë falje në agim

Pasi kemi folur, në ajetet e mësipërme, rreth gënjeshtarëve, injorantëve, mohuesve të ringjalljes dhe dënimeve që ata do të përjetojnë, në ajetet, 15-19, do të flitet për besimtarët e devotshëm dhe të përkushtuar. Do të flitet rreth cilësive dhe shpërblimit të tyre, me qëllim që të bëhet i qartë dallimi mes dy grupeve. Kjo është një metodë e përdorur shpesh në Kur'an, për të qartësuar dallimet midis tyre.

All'llahu i Madhëruar, në fillim të këtyre ajeteve, thotë: **"Pa dyshim, ata që i frikësohen All'llahut, do të jenë në kopshte e burime!"**.

Është e natyrshme që kopshtet të jenë të mahnitshme dhe të hijeshuara prej degëve, por bukuria më e madhe në të këtë tablo është shpërthimi i ujit të burimeve që vadit pemët e këtyre kopshteve. Kjo është dhe veçoria e kopshteve të Xhennetit. Atje nuk ka një burim të vetëm, por shumë të tillë, të cilët burojnë dhe rrjedhin gëzueshëm atje.[1]

Kur'ani bën dhe një përshkrim të shkurtër, që dëshmon rreth mirësisë së këtyre kopshteve, nëpërmjet një shprehjeje të

[1] Fjala *"fii-në"*, teksa i bashkëngjitet fjalës *"el xhen'nat"* - *"Xhennete"*, ka kuptim të qartë, sepse është e ditur se të devotshmit janë brenda Xhennetit. Nga ana tjetër, kur e shohim *"fii-në"* t'i bashkëngjitet fjalës *"ujuun"* - *"burimet"*, kjo nuk do të thotë se të devotshmit do të jenë brenda atyre burimeve, por ata do të jenë në Xhennet, në brendësinë e të cilave ka burime të shumta.

mbyllur, ku thotë: **"Duke marrë atë që ua ka dhuruar Zoti i tyre..."**.

Ky ajet tregon se ata do t'i pranojnë me kënaqësi, me dëshirë dhe shumë të përmalluar këto dhurata, mirësi dhe begati prej All'llahut. Menjëherë pas fjalisë së parë të ajetit, All'llahu i Madhëruar tregon se këto dhurata e begati nuk janë të rastësishme: **"....meqë më parë kanë qenë punëmirë!"**.[1]

Fjala *"el ihsan"*, në rastin konkret, mbart një kuptim të zgjeruar, pasi përfshin nënshtrimin ndaj All'llahut dhe të gjitha veprat e mira të kryera prej njeriut.

Ajetet në vijim, do të sqarojnë llojin e mirësisë, duke na paraqitur tri prej cilësive të tyre. Si fillim, All'llahu i Madhëruar thotë: **"Ata flinin pak natën."**.

Fjala *"jehxhauune"*, e ka rrënjën e saj te fjala *"el huxhu'u"*, që nënkupton *"gjumin e natës"*. Disa komentues kanë thënë se kjo shprehje tregon se ata kanë qëndruar zgjuar në një pjesë të konsiderueshme të natës, duke kryer adhurime të ndryshme dhe kanë fjetur në një pjesë të vogël të saj.

Duke qenë se ky gjykim e kjo Kushtetutë Fetare, në formë përgjithësuese e gjithëpërfshirëse, është për të devotëshmit dhe punëmirët, komenti i mësipërm duket si larg logjikës, pasi nuk i shkon për shtat pozitës së tyre. Kjo fjalë ka kuptimin se ata rrallë e

[1] Nëpërmjet shprehjes *"kable dhalike"* - *"më parë"*, nënkuptohet koha para Ditës së Gjykimit. Pra, koha e jetës së kësaj dynjaje. Disa komentues kanë thënë se me këtë shprehje nënkuptohen të gjitha sjelljet e drejta dhe të mira që janë kryer sipas logjikës së shëndoshë të njeriut, para se dispozitat e Sheriatit të ishin të pranishme. Duket qartë se këto kuptime janë larg mendjes.

kanë bërë të plotë gjumin përgjatë natës. Me fjalë të tjera, nëpërmjet natës, në rastin konkret, kuptohet nata si dukuri kohore, në përgjithësi dhe jo një natë e caktuar.

Nisur nga sa u tha, kuptojmë se ata kanë qenë zgjuar në një pjesë të madhe të natës, të cilën e kanë mbushur me adhurime e namaz nate. Nga ana tjetër, të pakta kanë qenë netët që i kanë kaluar duke fjetur deri në agim, pa kryer, së pari, adhurimet madhështore të natës.

Ky koment është transmetuar prej Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)* në disa prej hadithe të tij.[1]

Ka edhe komentime të tjera të këtij ajeti, përmendjen e të cilave e kemi shmangur qëllimisht, pasi[2] duken qartë se janë shumë larg logjikës dhe të vërtetës.

Kur'ani na kujton një cilësi tjetër të tyre: **"Ndërsa në agim kërkonin falje!"**

Duke qenë se sytë e të hutuarve, në fund të natës, janë duke fjetur, ngado mbizotëron qetësia. Kështu, s'ka asnjë zhurmë, që të tërheqë vëmendjen, asgjë nuk e shqetëson mendjen e tyre,

[1] Këtë hadith e ka përmendur El Al'lameh Et Tabrisi në tefsirin e tij "Mexhmaul Bejan", vëll. 9, f. 155. Ky hadith është transmetuar, gjithashtu, prej El Kafit, në tefsirin "Es Safi", në këtë formë: Shumë pak net kalonin që ata të mos ngriheshin e të kryenin adhurime nate.

[2] Fjala "*ma*" në shprehjen "*ma jehxheun*" - "*nuk flenë*" mund të jetë e shtuar për qëllim plotësimi dhe vërtetimi. Ajo mund të jetë gjithashtu lidhëse ose "*paskajore*", siç është përmendur në tefsirin "El Kebijr" dhe në tefsirin "El Mijzan". Disa të tjerë kanë thënë se ajo është vetëm lidhëse, ose "paskajore", siç ka ardhur në tefsirin "Kurtubijj" dhe në tefsirin "Ruhul Bejan". Hipoteza e ngritur prej disa të tjerëve, e cila thotë se ajo është mohuese, duket larg të qenit e vërtetë.

prandaj ngrihen e dalin të qëndrojnë para All'llahut. I tregojnë Atij nevojën e madhe që kanë për Të, rreshtojnë këmbët e tyre, falin namaz dhe i luten All'llahut t'ua falë gjynahet dhe të metat që kanë.

Shumë komentues janë të mendimit se nëpërmjet fjalës "*istigfar*", nënkuptohet namazi i natës, pasi namazi i vitrit (namazi me rekate tek) përfshin istigfarin, kërkimin e faljes.

Fjala "*el es'har*", është shumësi i fjalës "*sehar*", sinonim i fjalës "*besher*". Kuptimi i saj, në origjinë, është, "*diçka e fshehur*" ose "*diçka e mbuluar*". Pra, duke qenë se në orët e fundit të natës gjithçka mbulohet e bëhet gati-gati e padukshme, quhet fundi i natës (sahar).

Ndërsa fjala "*sihrun*" - "*magji*", ku bashkëtingëllorja "*s*" shoqërohet prej zanores "*i*", përdoret për të nënkuptuar një dukuri që *mbulon realitetin e një ngjarjeje ose dukurie*, pra, mbulon të fshehtat ndaj syve të njerëzve.

Në tefsirin "Ed Durrul Menthur", përmendet një transmetim, nga Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: "*Namazi i natës, tehexh'xhud***,** *është më i pëlqyer për zemrën time, ta kryej në fund të natës, se sa ta kryej në fillim të saj, se All'llahu i Madhëruar ka thënë:* **'Ndërsa në agim kërkonin falje!'**".[1]

Në një tjetër hadith, transmetuar nga Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)*, lexojmë: "*Ata i kanë pas kërkuar shtatëdhjetë herë falje All'llahut, në namazin e vitrit, në çdo agim!*".[2]

[1] Tefsiri "Ed Durrul Menthur", vëll. 6, f. 113.
[2] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", fundi i ajeteve, objekt i studimit tonë.

Më tej, Kur'ani, përmend cilësinë e tretë të banorëve të devotshëm të Xhennetit dhe thotë: **"Në pasurinë e tyre ka pasur pjesë për lypësit dhe nevojtarët."**.

Fjala *"hakkun"*, këtu përfaqëson një nga dy mundësitë. Së pari, nënkupton të drejtën e All'llahut mbi njerëzit, pra, e drejta e All'llahut te pasuria e tyre, siç është zekati, "*khumsi*" - "*njëzet për qind*", të drejtat dhe obligimet e tjera monetare. Mundësia e dytë, është e lidhur me zotimet financiare që mund të kenë marrë me vullnetin e tyre të lirë, duke përfshirë këtu edhe kontributet e padetyruara financiare. Disa komentues hamendësojnë se ky ajet është i lidhur vetëm më pjesën e dytë të kuptimit të tij. Kështu që në kuptimet e tij nuk përfshihen detyrimet, pasi detyrimet janë të lidhura me të gjithë njerëzit, pa përjashtim. Pra, jo vetëm me besimtarët e devotshëm, por edhe me mohuesit dhe jobesimtarët.

Duke iu referuar këtij fakti, Kur'ani, thotë: **"Në pasuritë e tyre ka pasur pjesë për lypësit e nevojtarët!"**. Kjo do të thotë se, përveç detyrimeve të tyre, ata, vullnetarisht i dhanë vetes të tjera detyrime financiare që lidhen me ndihmesën dhe lëmoshën që u afrohet lypsarëve dhe të varfërve. Ajo çka mund të themi, në këtë rast, është se ndryshimi ndërmjet njerëzve të mirë dhe atyre që nuk mund të jenë të mirë, është se të parët i praktikojnë këto detyrime, ndërsa të dytët nuk ndihen të obliguar prej tyre.

Mund të themi se nëpërmjet fjalës "*lypës*", në ajetin e mësipërm, nënkuptohen të gjitha ato detyrime financiare fetare karshi të varfërve, pasi ata kanë të drejtë ta kërkojnë këtë të drejtë që u takon. Ndërsa fjala "*nevojtarët*", është e lidhur me detyrimet e pëlqyera, që nuk e arrijnë shkallën e detyrës, pasi nevojtarët nuk kanë të drejtë ta kërkojnë atë.

Në librin e tij "Kenzul Irfan", El Fadil El Mikdad deklaron se, nëpërmjet shprehjes kur'anore: "*hakkun ma'alum*" - **"ka pasur pjesë"**, nënkuptohen detyrimet financiare që besimtarët ia kanë vënë vetes, në raport me të varfrit, kështu që ndihen përgjegjës karshi vetes për zotimet e marra.[1]

Një kuptim i ngjashëm më këtë që sapo cituam, jepet në ajetet 24-25 të sures "El Mearixh": **"E që caktojnë një pjesë të pasurisë së tyre! Për lypësin dhe për nevojtarin!"**.

Vlen të përmendet fakti se përcaktimi i dispozitës *"uaxhib"* - *"i detyrueshëm"* të zekatit, është përcaktuar në një ajet kur'anor, zbritur në Medine, kështu që, duke qenë se ajetet e kësaj sureje janë të gjitha prej Mekës, preferojmë mendimin e fundit.

Transmetime të tjera, që kanë ardhur prej Ehli Bejtit *(Paqja qoftë mbi ta!)* mbështesin idenë se nëpërmjet shprehjes kur'anore*:* *"hakkun ma'alum"*, nënkuptohen detyrime financiare të lira, siç është zekati. Në hadithin e përcjellë prej Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*, lexojmë: *"Përveç zekatit, All'llahu i Madhëruar, ka përcaktuar detyrime të tjera financiare. All'llahu i Madhëruar ka thënë në Kur'anin Famëlartë:* **'E që caktojnë një pjesë të pasurisë së tyre, për lypësin.'** *Kështu, pjesa e përcaktuar, për këto raste, është ajo pjesë e pasurisë, që njeriu ia ka vënë detyrë vetes për ta ofruar si ndihmë apo lëmoshë për lypësin dhe nevojtarin, qoftë ky një detyrim ditor, javor apo i përmuajshëm."*.[2]

---

[1] Tefsiri "Mexhmaul Bejan", fundi i ajeteve, objekt i studimit tonë.

[2] "Uesailu Shia", vëll. 6, kreu "Në cilën pasuri bëhet i detyrueshëm zekati", kreu 7, Hadithi 2, f. 27; vëll. 9, kreu "Detyrimet financiare pas zekatit dhe disa dispozita fetare të lidhura me to", Hadithi 11487, f. 46. Botimi, shtypshkronja "Ehli Bejt".

Ka dhe shumë hadithe të tjera, të lidhur më çështjen e transmetuar nga Imam Ali ibn Hysejni, Imam Bakiri dhe Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi ta!)*.[1]

Është folur shumë, në lidhje me ndryshimin ndërmjet përmbajtjes kuptimore të *lypësit* dhe *nevojtarit*. Disa komentues kanë thënë se *lypësit* janë ata që kërkojnë ndihmë prej njerëzve, ndërsa *nevojtarët* janë ata që kanë turp, që për të ruajtur nderin dhe krenarinë e tyre, përpiqen të rezistojnë, të durojnë dhe të jetojnë si të munden, vetëm e vetëm që mos t'ia shtrijnë dorën kujt për ndihmë.

Kjo kategori njerëzish është quajtur "*el meharif*". Në tekstet e gjuhës gjejmë të përmendet se me fjalën "*el meharif*", nënkuptohet njeriu që, edhe pasi i ka bërë të gjitha përpjekjet, nuk arrin të fitojë gjë, prandaj shpesh i bëhet sikur i janë përplasur në fytyrë të gjitha dyert e jetës.

Kjo shprehje tregon një të vërtetë të madhe, që është: Mos prisni që nevojtarët të vijnë te ju dhe t'ju zgjasin dorën, duke ju kërkuar ndihmë, por shkoni ju t'i kërkoni e t'i gjeni atje ku janë. Kur'ani Famëlartë i ka përshkruar ata, kështu: **"Kush nuk i njeh ata, kujton se janë të kamur, se ata nuk lypin!"**.[2] Shkoni dhe ndihmojini ata, mbrojeni krenarinë dhe nderin e tyre. Kjo është një Kushtetutë e All'llahut, nenet e të cilës përkujdesen për të mbrojtur dinjitetin dhe personalitetin e myslimanëve të varfër, prandaj duhet t'i japim rëndësinë që meriton, secilit nen të saj.

Këta njerëz njihen lehtësisht, sepse kanë shenja të qarta në fytyrë dhe në trupat e tyre. Në Kur'anin Famëlartë, All'llahu i

[1] Burimi i mëparshëm.
[2] Sure "El Bekare", ajeti 273.

Madhëruar e ka përcaktuar qartë këtë detaj, duke thënë: "Ju do t'i njihni, do t'i dalloni ata prej shenjave të qarta që kanë!"

Kjo do të thotë se, me gjithë heshtjen e tyre, këta të varfër kanë shenja të qartë të vizatuara në fytyrat e tyre. Janë ato shenja që tregojnë qartë sasinë e madhe të vuajtjes, të dhimbjes dhe të skamjes, e cila sundon mbi qeniet e tyre.

Hulumtime

1- Drejtimi kah All'llahu dhe kah krijesat e All'llahut

Gjithçka që është përmendur në këto ajete, ndaj cilësive të besimtarëve, përmblidhet në dy pjesë: *Drejtim kah All'llahu*, *Krijuesi*. Ky proces ndodh në atë orë, ose në ato momente, kur plotësohen kushtet dhe gatishmëria e qenies për t'i treguar All'llahut të Madhëruar, nevojën e madhe që ai ka për Të. Ky proces shoqërohet me praninë e ndjeshmërisë së zemrës, duke shmangur në maksimum, njëherësh, hutinë dhe aktivitetin e mendjes për çështje të ndryshme. Koha reale, kur plotësohen këto kushte, kryesisht është fundi i natës.

Për sa i përket pjesës së dytë, lidhur me *drejtimin kah njerëzit*, që do të thotë të vihemi në kërkim të nevojtarëve, edhe në rastet, kur e shprehin nevojën e tyre, edhe për ato raste, kur e fshehin atë.

Kjo është një kërkesë që vjen drejtpërsëdrejti nga Kur'ani Famëlartë, është një kërkesë dhe kështillë e cituar në shumë ajete të tij. Në të gjitha ajetet ku përmendet namazi, theksohet edhe zekati, duke u dhënë kështu, njëherësh, të dyjave, rëndësi të njëjtë. Ky është një tregues shumë i rëndësishëm, që përfaqëson dy marrëdhënie të rëndësishme të njeriut. Namazi përfaqëson marrëdhënien më të fortë të njeriut me Krijuesin e tij, ndërsa zekati përfaqëson marrëdhënien me të fortë të njeriut me krijesat e All'llahut.

2- Zgjimi në zemër të natës, është sjellja e të dashuruarve

Edhe pse namazi i natës është prej namazeve të pëlqyeshme, që nuk është i detyrueshëm, ai përmendet vazhdimisht në Kur'anin Famëlartë. Ky është një tregues i qartë, i cili përcakton rëndësinë e tij të madhe. Kur'ani e ka përshkruar namazin e natës si një rrugë të sigurt për të arritur atë që quhet *el mekam el mahmud - pozitën e lartë* dhe *autoritetin e qëndrueshmërinë*. Këtë e gjejmë të përcaktuar në ajetin 79 të sures "El Isra" dhe në ajetin 17 të sures "Es Sexhde".

Një interesim të madh që lidhet më këtë aspekt, e hasim të përmendet edhe në transmetime të ndryshme islame. Kjo tregon qartë rëndësinë e namazit të natës dhe të zgjimit për adhurime. Në një moment të caktuar, Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e ka konsideruar atë si mekanizëm hyjnor, që e pastron njeriun prej gjynaheve, duke

thënë: "*O Ali, tri janë adhurimet që e pastrojnë njeriun prej gjynaheve. Ndër to është të falesh natën, kur njerëzit flenë gjumë!*".[1]

Në një tjetër hadith, transmetuar prej Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, thuhet: "*Fisnikët e ymetit tim, janë ata që e mësojnë përmendësh Kur'anin dhe ata që falen natën!*".[2]

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, në një hadith, kur këshillonte Imam Aliun *(Paqja qoftë mbi të!)*, ka thënë katër herë rresht: "*Të këshilloj namazin e natës!*".[3]

Gjithashtu, transmetohet prej Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*: "*Ata flinin pak natën! Të pakta kanë qenë ato net, kur ata nuk zgjoheshin për t'u falur natën!*".[4]

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: "*Dy rekate namaz në zemër të natës, janë më të dashura për mua se e gjithë bota dhe çfarë gjendet në të!*".[5]

Ndërsa në një hadith të Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)* citohet t'i ketë thënë njërit prej shokëve të tij, më saktë Sulejman Ed Dejlemij: "*Mos hiq dorë prej namazit të natës, sepse ai që heq dorë prej namazit të natës, i ka bërë vetës një padrejtësi të madhe!*".[6]

---

[1] "Uesailu Shia", vëll. 5, f. 273.
[2] Burimi i mëparshëm, vëll. 5, f. 275.
[3] Burimi i mëparshëm, vëll. 5, f. 275.
[4] "Uesailu Shia", vëll. 5, f. 279.
[5] "Biharul Anuar", vëll. 87, f. 148.
[6] Burimi i mëparshëm, f. 146.

Ka shumë transmetime që lidhen me këtë çështje, ku përmenden shumë fjalë të bukura, nxitëse dhe kuptimplota, sidomos përmendja se namazi i natës është një mënyrë efikase për të fshirë gjynahet, për të zgjuar mendimet, për të ndriçuar zemrat, për të përftuar riskun, për të lumturuar jetën dhe për ta mbrojtur shëndetin. Nëse do mbledhim transmetimet e lidhura për këtë çështje, do të kishim në duar një libër të veçantë.[1]

Lidhur me këtë, kemi pasur disa hulumtime, si në fund të ajetit 79 të sures "El Isra" dhe fundit të ajetit 17 të sures "Es Sexhde", që është mirë t'u ktheheni.

3- E drejta e lypësit dhe e drejta e nevojtarit

Duhet bërë e ditur, se në ajetet e mësipërme, u njoftua se te pasuria e njerëzve të ndershëm dhe bamirësve, kanë të drejtat e tyre lypsarët dhe nevojtarët. Ky është një tregues i qartë, se ata e ndiejnë veten borxhlinj karshi kësaj kategorie njerëzish. Ata e konsiderojnë lypësin dhe nevojtarin, si pjesëmarrës me kuota të caktuara në pasuritë e tyre. Ata e konceptojnë këtë të drejtë të tyre, si detyrim të madh që duhet të shlyhet, pa u kërkuar as falënderim dhe as mirënjohje. Kjo do të thotë se ata e konsiderojnë këtë të drejtë të tyre, si të ishte borxh, thjesht, si të gjitha format e tjera të borxheve.

[1] Për të lexuar këto transmetime, kthehuni librit "Uesailu Shia", vëll. 5 dhe librit "Mustedrekul Uesail", vëll. 1, "Biharul Anuar", vëll. 87.

Siç kemi theksuar më lart, ashtu si tregojnë edhe argumentet e tjera, kjo shprehje kur'anore nuk lidhet aspak me zekatin, as me format e tjera ekonomike, por është e lidhur ekskluzivisht me dhëniet e pëlqyeshme, që njerëzit e përkushtuar e të devotshëm i konsiderojnë si të ishin borxhe që u qëndrojnë mbi supe dhe në ndërgjegje.[1]

[1] Zbritja e këtyre ajeteve në Mekë dhe përmendja e kësaj dispozite fetare, lidhet posaçërisht me banorët e ndershëm të Xhennetit, si dhe me transmetimet e Ehli Bejtit, që tregojnë qartë se e drejta financiare, e përmendur në ajetet, objekt i studimit tonë, nuk nënkuptojnë zekatin, por format e tjera të bamirësisë.

Ajetet 20 – 23

وَفِي ٱلۡأَرۡضِ ءَايَٰتٞ لِّلۡمُوقِنِينَ٢٠ وَفِيٓ أَنفُسِكُمۡۚ أَفَلَا تُبۡصِرُونَ٢١ وَفِي ٱلسَّمَآءِ رِزۡقُكُمۡ وَمَا تُوعَدُونَ٢٢ فَوَرَبِّ ٱلسَّمَآءِ وَٱلۡأَرۡضِ إِنَّهُۥ لَحَقّٞ مِّثۡلَ مَآ أَنَّكُمۡ تَنطِقُونَ٢٣

"Në Tokë ka shenja për ata që besojnë me bindje!"

"Po, edhe në vetet tuaja, a nuk e shihni vallë?!"

"Në qiell është furnizimi juaj dhe gjithçka që ju është premtuar!"

"Betohem në Zotin e qiellit dhe të Tokës, se kjo (që u premtohet) **është e vërtetë, ashtu si është të folurit tuaj!"**

Komentimi

Argumentet e All'llahut dhe ndikimi i tyre në qenien tuaj

Pas komentimit të ajeteve të mëparshme, ku u fol rreth çështjeve të rikthimit dhe Ringjalljes, rreth cilësive të banorëve të Xhennetit dhe Xhehennemit, këto ajete flasin për argumentet e All'llahut dhe shenjat e Tij në Tokë dhe për qenien e njeriut. Nga njëra anë, synimi i përmendjes së këtyre argumenteve është njohja e njeriut me parimet e Teuhidit (Njësimit), njohja e tij me All'llahun dhe cilësitë e Tij, të cilat janë pikënisja dhe zanafilla e orientimit kah mirësia e përgjithshme. Nga ana tjetër, synohet njohja më nga afër e fuqisë dhe e mundësisë së All'llahut, lidhur me çështjen e rikthimit dhe të ringjalljes pas vdekjes. Këto ajete tregojnë qartë se krijuesi i jetës mbi Tokë dhe i gjithçkaje tjetër që gjendet mbi të, prej mrekullisë së mahnitshme të krijimit, janë argumente të qarta, se All'llahu e ka lehtësisht të mundur ta rilindë jetën pas vdekjes. Në fillim të ajeteve të sipërpërmendura, All'llahu i Madhëruar thotë: **"Në Tokë ka shenja për ata që besojnë me bindje!"**.

E vërtetë është se argumentet e All'llahut në tokë, fuqia e Tij e pashtershme, mundësia e Tij e pafund, dituria e Tij, urtësia e Tij e pa kufi, janë të shumta e të pafundme, si dhe vetë jeta e njeriut, që sado e gjatë qoftë, nuk do të mjaftonte për t'i numëruar dhe për t'i identifikuar të gjitha ato.

Të nisim me madhësinë e Tokës, pastaj me Diellin dhe rrotullimin e tij rreth vetes, me rrotullimin e Tokës përreth Diellit, me forcat shtytëse, forcat tërheqëse, me forcën e rëndesës, forca

këto që lindin prej rrotullimit të Tokës, duke u përshtatur dhe duke u shkëmbyer me njëra-tjetrën, sipas rregullave të sakta dhe të mirëpërcaktuara të All'llahut të Plotfuqishëm. Të gjitha këto dukuri, të mbledhura bashkë, sigurojnë jetën mbi sipërfaqen e Tokës. Kështu, pra, këto dukuri, janë disa argumente prej argumenteve të mëdha të All'llahut.

Ndërkohë, në qoftë se njëra prej këtyre dukurive do të pësonte më të voglën shmangie dhe, nëse veçoritë e tyre do të pësonin më të voglin ndryshim, ekuilibrat e ekzistencës do të çrregulloheshin dhe kushtet e jetës do të ndryshonin kryekëput mbi sipërfaqen e Tokës.

Kështu, lëndët përbërëse prej të cilëve formohet Toka, burimet ujore të nëntokës dhe mbitokës, të cilat sigurojnë jetën në të, janë të gjitha, disa argumente prej argumenteve të shumta e të qarta të All'llahut.

Malet, fushat, kodrat, lumenjtë dhe burimet, janë dukuri, që secili në vetvete, përfaqësojnë një domosdoshmëri të padiskutueshme në vazhdimësinë e jetës. Nga ana tjetër, koordinimi i mahnitshëm ndërmjet kushteve që secili prej këtyre dukurive prodhon, është një tjetër argument i qartë prej argumenteve të All'llahut.

Qindra-mijëra lloje bimësh, insektesh e kafshësh janë sot, vërtet qindra dhe mijëra, por secila ka veçoritë, mrekullitë e veta të krijimit, siç e bëjnë të qartë librat e biologjisë, të gjeologjisë, librat e botës së bimëve, të botës së kafshëve, etj.

Nuk ka dyshim se po të njihemi nga afër me të gjitha këto mrekulli të krijimit, do të mbetemi të mahnitur, të hutuar dhe të shastisur prej detajeve brilante të mrekullisë.

Po të hedhim një vështrim të kujdesshëm, vëmë re se nga çdo anë dhe cep i Tokës, gëlojnë dukuri të pashembullta, të tejmbushura me të fshehta dhe mistere të ndryshme. Një pjesë e këtyre të fshehtave janë zbuluar nga dijetarë të fushave specifike të shkencës, duke paraqitur kështu madhështinë e Krijuesit të Gjithësisë dhe mundësitë e Tij të pafundme.

Me këtë rast, po rendisim një sërë thëniesh të dijetarëve më të njohur botërorë, të cilët kanë kryer studime të shumta lidhur me këto aspekte. Të shohim me vëmendje se çfarë ka thënë dijetari i shquar, Corsy Morrison: "Kam mbetur i mahnitur prej saktësisë së lartë që rregullon dukuritë natyrore. Nëse korja e sipërfaqes së Tokës do të zmadhohet dhjetë herë më shumë nga ç'është, oksigjeni që është dhe elementi kryesor që siguron jetën mbi Tokë, do të zhduket. Nëse thellësia e deteve, do të ishte më e madhe, ose më e vogël nga ç'është, oksigjeni dhe karboni do të përthithej nga sipërfaqja e Tokës, e kjo do ta bënte të pamundur jetën e bimëve dhe të kafshëve mbi sipërfaqe të Tokës."

Në një vend tjetër, flet për atmosferën, që mbulon sipërfaqen e Tokës, ku thotë: "Nëse atmosfera që rrethon Tokën, do të ishte më e hollë nga ç'është, ajo do të depërtohej prej mijëra e miliona meteorëve shkatërrimtarë, të cilët e sulmojnë Tokën çdo ditë nga të gjitha anët. Kështu, dendësia e shtresës atmosferike që mbështjell Tokën, ndalon depërtimin e tyre. Këta meteorë shpërbëhen e shkatërrohen, sapo bien në kontakt me të, si rrjedhojë, rënia e tyre në Tokë është e pamundur.

Nga ana tjetër, nëse këta meteorë do të kishin shpejtësi më të ulët nga sa e kanë, nuk do të shpërbëheshin e nuk do të digjeshin, sa bien në kontakt me atmosferën, por do ta depërtonin atë, duke ardhur lirshëm drejt Tokës, ku do të shkaktonin shkatërrime të mëdha."

Diku tjetër, citohet të ketë thënë: "Në të vërtetë, sasia e oksigjenit në ajër është vetëm njëzet e një për qind. Nëse, kjo sasi, do të ishte pesëdhjetë për qind, në këtë botë do të digjej gjithçka e predispozuar për t'u djegur. Konkretisht, nëse në një pyll do të binte një shkëndijë e vogël, do të merrte flakë e do të digjej i gjithë pylli…"

Përqindja e dendësisë së ajrit që rrethon Tokën, është përcaktuar në mënyrë të tillë, që në Tokë të depërtojë sasia e nevojshme e rrezeve të diellit, ato rreze që ndihmojnë bimët të rriten dhe të zhvillohen. Ato janë rreze të mjaftueshme për të djegur mikrobet e dëmshme që gjenden në atmosferë. Janë ato rreze që prodhojnë vitaminat e shumëllojshme dhe aq të domosdoshme për jetën.

Ka shumë avuj, pjesa më e madhe e të cilëve janë të dëmshëm, që çlirohen nga thellësia e Tokës përgjatë shekujve, duke u përhapur ngado në atmosferë. Megjithëkëtë, ajri që rrethon Tokën, ka mbetur i pandotur dhe mjaft i pastër, për të mundësuar jetën e gjallë mbi Tokë.

Në të vërtetë, janë detet dhe oqeanet, këto aparatura gjigante, që i sigurojnë e i ruajnë këto ekuilibra në mënyrë perfekte. Janë detet dhe oqeanet ato që furnizojnë me lëndë të parë jetën, me ushqim, me shira, me kushtet e përshtatshme

klimaterike, si për rritjen e bimëve, ashtu dhe për vetë ekzistencën e njeriut, që është e lidhur ngushtë me faktorët e sipërpërmendur.

Pasi bëmë këto konstatime të rëndësishme, duhet të ulim kokën me shumë modesti para detit dhe para oqeanit, si dy "krijesa" madhështore dhe aq të rëndësishme që i ka krijuar All'llahu vetë.[1]

Në ajetin që vijon, Kur'ani, shton: **"Po, edhe në vetet tuaja, a nuk e shihni vallë?!"**, që do të thotë se këto argumente të qarta, a nuk i shihni të pranuar edhe te vetja juaj?!

Nuk ka asnjë dyshim se njeriu është mrekullia dhe çudia më e madhe në ekzistencë. Në përsosmërinë e tij, ai përfaqëson në të njëjtën kohë, më të voglën dhe më të madhen krijesë të All'llahut. Madje, mund të shkojmë edhe më tej, duke thënë se te krijimi i njeriut janë bashkuar më shumë mrekulli se sa te çdo krijesë tjetër në botë.

Çudia më e madhe, konsiston në faktin se njeriu, me gjithë madhështinë e tij, me gjithë dijen, mendjen, aftësinë e tij për të imagjinuar, për të zbuluar dhe për të ndërtuar, ka qenë në fillesë të herës një pikë e vogël uji, fare e pavlerë. Ishte ajo krijesë, ajo pikë e vogël uji, që nisi të plotësohej me shpejtësi marramendëse, sapo u vendos në mitër. U rrit dita-ditës, pësoi ndryshime të mëdha me kalimin e kohës, derisa u krijua njeriu i plotë, kjo krijesë madhështore e Krijuesit të Gjithësisë.

Një qelizë e vetme në trupin e njeriut, që është dhe njësia më e vogël përbërëse në trupin e tij, përbën një strukturë më vete,

[1] Shkrimtari Corsy Morrison në librin e tij "Esararu Khalkul Insan", f. 33-36.

tejet të ndërlikuar, me elemente të ndërthurura, çuditërisht, me mjeshtëri me njëra-tjetrën. Sipas përkufizimit të disa dijetarëve, kjo strukturë është cilësuar e barabartë me një qytet industrial.

Një prej biologëve më në zë, thotë se ky qytet i madh, përbëhet nga mijëra dyer e labirinte të mahnitshme, mijëra fabrika, mijëra depo, mijëra rrjete kanalizimesh, mijëra funksione të rëndësishme jetike, që kryejnë veprimtarinë e tyre dhe gjenden të stacionuara brenda një sipërfaqe të vogël, e barabartë me sipërfaqen dhe vëllimin e një qelize të vetme. Pikërisht kjo është një prej çështjeve më të vështira dhe mahnitëse të ekzistencës. Edhe sikur të provojmë të ndërtojmë një të ngjashme me të, duke e imituar, nuk do të mundemi kurrsesi. Për të arritur këtë, do të na duhet të kemi në dispozicion mijëra hektarë tokë, mbi të cilën do të instalohen lloje të ndryshme dhe të vështira makinerish gjigante. Ajo që është e çuditshme, në këtë rast, konsiston në faktin se Krijuesit të Gjithësisë i mjafton për ta ndërtuar këtë element bazë të jetës, një mikronjësi që është pesëmbëdhjetë milion herë më e vogël se milimetri.[1]

Të gjitha aparaturat që gjenden në trupin e njeriut, siç janë: zemra, veshka, mushkëritë dhe veçanërisht, ato dhjetëra e mijëra kilometra nervash të hollë, nerva me përmasa aq të imta, të pamundura për t'u parë me sy të lirë, kanë funksione jetike dhe për detyrë të përçojnë ushqimin, ujin dhe ajrin për te dhjetë milionë miliardë qeliza. Një tjetër mrekulli përbëjnë shqisat më të rëndësishme, si: shikimi, dëgjimi, etj. Të gjitha këto janë argumente të mëdha prej argumenteve të All'llahut të Madhërishëm.

[1] "Sefretun fi a'mak uxhud el insane", kreu *"el khalaja"*.

Më e rëndësishme se të gjitha këto, janë të panjohurat e mëdha që qëndrojnë në themelet e jetës. Struktura e shpirtit dhe e mendjes është ajo që mahnit ende njerëzit dhe i ka lënë pa përgjigje. Askush nuk është në gjendje t'i perceptojë këto struktura dhe dukuri, prandaj të gjithë njerëzit duhet të përulen me falënderim, lëvdata e adhurim për karshi Krijuesit All'llah dhe të shijojë këto vargjeve:

"Mrekulli e ekzistencës. Te Ti u hapën sytë.

Mençurinë Ti e hutove. Mendjen si uji e ke.

Kur mendja të afrohet një pëllëmbë, një milje largohesh.

Në tërheqje me verbërinë u përplase, një rrugë s'e gjete dot!"[1]

Profeti Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: *"Ai që e njeh veten e tij, do ta njohë edhe Krijuesin e tij!"*.[2]

Njohja e vetvetes, për të gjitha etapat e saj, është një rrugë e sigurt drejt njohjes së All'llahut të Madhëruar, për këtë arsye, shprehja kur'anore: "A nuk shihni, vallë?," është një shprehje shumë domethënëse. Ajo tregon qartë se argumentet që ju rrethojnë e gjenden në brendësinë tuaj, si krijesa, në themel të ekzistencës, janë qartësisht të dallueshme, sa mjafton të hapësh vetëm pak sytë. Ato janë argumentet e qarta të All'llahut, madhështia e të cilave, ujit shpirtin tuaj me jetë e besim.

[1] "Sherh Nehxhul Belagah", vëll. 13, f. 51.
[2] "Sefinetul Bihar", vëll. 2, Lënda "Nefs", f. 603.

Ajeti 22 trajton llojin e tretë të argumenteve, që shpalosin madhështinë e Krijuesit dhe mundësinë e Tij për t'ia rikthyer njerëzve jetën, pasi të kenë vdekur. All'llahu i Madhëruar thotë: **"Në qiell është furnizimi juaj dhe gjithçka që ju është premtuar!"**.

Megjithatë, disa transmetime islame, thuhet se fjalan *"risk"*, nënkupton *shiun*, pasi ai siguron jetën, është burimi i mirësisë dhe i bereqetit në të gjithë Tokën. Ajeti 5 i sures "El Xhathijeh", vjen për të mbështetur komentin që sapo përmendëm. All'llahu i Madhëruar thotë: **"Mirësitë dhe begatitë që All'llahu jua dërgon nga qielli, janë ato me të cilat Ai ngjall Tokën, pasi të ketë qenë e vdekur!"**.

Ky kuptim tregon qartë dhe përputhet me kuptimet e mësipërme, por gjerësia kuptimore e fjalës *"risk"* - *"mirësi"*, *"bereqet"*, përfshin pikat e shiut dhe gjithçka tjetër që vjen prej qiellit, si është drita e diellit, që vjen, gjithashtu, prej qiellit dhe është element shumë i rëndësishëm jetëformues. Prej mirësive që vijnë nga qielli, mund të konsiderohet edhe ajri, që është, në të njëjtën kohë, burimi kryesor i jetës së gjallesave në Tokë.

Këto kuptime i përftojmë, nëse për të shpjeguar fjalën *"qiell"* do t'i referohemi kuptimit gjuhësor të saj, pra, *qiellit që qëndron mbi ne*, por disa të tjerë kanë komentuar se kjo fjalë nënkupton botën e të panjohurës, ose atë që qëndron përtej natyrës, pra, mund të nënkuptojë edhe *"Leuhi Mahfudhin"* - *"Regjistrin e veprave të njeriut"*, ku shënohet e regjistrohet risku i njerëzve.

Natyrshëm, bashkimi mes këtyre dy komenteve është i mundur, por duhet të theksojmë se komentimi i parë është më i përshtatshëm dhe shumë më i qartë.

Për sa i përket fjalisë: **"dhe gjithçka që iu është premtuar!",** ka mundësi të jetë në formë përforcimi për çështjen e riskut dhe premtimit të All'llahut, që lidhen me këtë aspekt. Ka mundësi që kjo shprehje kur'anore, të nënkuptojë Xhennetin e premtuar prej All'llahut, pasi në ajetin 15 të sures "En Nexhm", All'llahu i Madhëruar ka thënë: **"Ku ndodhet Xhenneti i strehimit."**.

Një mundësi tjetër, është: nënkupton të gjitha llojet e mirësive, të furnizimeve, të begative dhe të dënimeve që zbresin nga qielli. Gjithashtu, ka shumë mundësi, të nënkuptojë gjithçka përmendëm më lart, pasi sifjalia: **"dhe gjithçka iu është premtuar!"**, është shumë e gjerë dhe gjithëpërfshirëse.

Gjithsesi, radhitja e këtyre tri ajeteve është e bukur dhe përmban urtësi. Kështu, ajeti 20 trajton shkaqet e ekzistencës së njeriut dhe jetës së tij. Ajeti 21 flet për vetë njeriun, ndërsa ajeti 22 flet për shkaqet e vazhdimësisë dhe të pafundësisë së njerëzimit dhe njeriut.

Vlen të theksojmë këtu se pengesa më e madhe që i ndalon sytë e zemrës, të dallojnë të fshehtat e krijimit, të fshehtat e Tokës dhe mrekullitë e ekzistencës së njeriut, është, pikërisht, përkujdesja për fitimin e pasurisë dhe riskut. Për këtë arsye, All'llahu i Madhëruar, e qetëson njeriun në ajetin 23, duke treguar se Ai ia ka siguruar riskun. Pasi njeriu bindet, se risku i tij është i siguruar prej All'llahut të Madhëruar, nis të shikojë mrekullitë e

kësaj bote. Në këtë mënyrë, ai bëhet objekti që i drejtohet pyetja nga All'llahu i Madhëruar: **"A nuk e shihni vallë?!"**.

Për këtë arsye, ajeti i fundit prej ajeteve në fjalë, përmban një betim: **"Betohem në Zotin e qiellit dhe të Tokës, se kjo** (që u premtohet) **është e vërtetë, ashtu si është të folurit tuaj!"**.

Kjo do të thotë se çështja është serioze, sa All'llahu është betuar mbi Madhështinë dhe fuqinë e Tij, për të qetësuar zemrat e dobëta të robëve të Tij, të cilët dyshojnë dhe kanë nevojë për siguri, duke u thënë atyre se gjithçka që u është premtuar, lidhur me riskun, pasurinë, shpërblimin, dënimin dhe Ringjalljen, është më se e vërtetë, se nuk ka asnjë hapësirë për të dyshuar në të.[1]

Sifjalia: **"Ashtu si është të folurit tuaj!"**, është një mrekulli më vete, pasi All'llahu i Madhëruar, për ta bërë çështjen më të qartë, shembullin e merr nga gjërat më të prekshme për njeriun. Kjo ndodh, sepse njeriu mund të gabojë në shikim apo dhe dëgjim, pra, mund të ndodhë që njeriut t'i bëhet sikur ka dëgjuar apo ka parë diçka, por nuk mund të ndodhë kurrë, që atij t'i duket sikur ka folur, pra, t'i duket sikur ka thënë një gjë, ndërkohë që, në të vërtetë, e ka thënë atë. Kështu që kuptimi i ajetit është: Ashtu siç është e prekshme dhe reale për ju, fjala që flisni, ashtu është edhe risku dhe premtimi i All'llahut për ju.

Me të drejtë mund të themi se të folurit, në vetvete, përfaqëson një risk, begati të madhe të All'llahut, prej të cilës nuk

[1] Është folur shumë prej komentuesve dhe është ngritur pyetja: Kujt i drejtohet përemri te fjala *"innehu"*? Disa kanë thënë se përemri kthehet te *"risku"*. Disa të tjerë kanë thënë se ai kthehet te *"ue ma tuadun"*, ndërsa disa të tjerë kanë thënë se përemri, këtu, kthehet tek All'llahu dhe Profeti i Tij. Në gjykimin tonë, komenti i parë është më i përshtatshëm.

është zbukuruar asnjë krijesë tjetër e gjallë mbi Tokë, përveç njeriut. Kështu që nuk është i huaj për askënd, ndikimi i të folurit në jetën shoqërore, në mësimin e njerëzve, në edukimin e tyre, në ndërveprimin e dijeve mes njerëzve, si dhe në zgjidhjen e shqetësimeve të ndryshme në jetë.

Hulumtime

1- Historia interesante dhe frymëzuese e El Asmaiut

Ez Zemakhsharij, përcjell në librin e tij "El Keshshaf",[1] një ndodhi të bukur, nga El Asmaiu: "Një ditë, kur po dilja nga xhamia e Basras, më zunë sytë një beduin prej arabëve të shkretëtirës, që kishte hipur mbi kafshën e tij. Ai m'u afrua dhe më pyeti: "Cilit fis arab, i përket?!"

I thashë se jam prej fisit të Beni El Asma'a.

Më pas vazhdoi: "Prej nga vjen?!"

I thashë se vij prej vendit, ku lexohet Fjala e All'llahut!

Ai më ftoi: "Më lexo edhe mua diçka, prej asaj që ti, lexon!"

[1] Thirrej me emrin Abdul Melik bin Kurejb dhe ka jetuar në kohën e Harun Rreshidit. Ai kishte një aftësi të jashtëzakonshme memorizuese dhe kishte informacion të bollshëm rreth historisë së arabëve dhe poezive të tyre. Është ndarë nga jeta në qytetin e Basras, në vitin 216 të hixhretit. Burimi: Libri "El Kuna uel el kab", vëll. 2, f. 37.

Lexova për të disa ajete nga surja "Edh Dharijat". Sa arrita në ajetin, ku All'llahu i Madhëruar, thotë: **"Në qiell është risku** (furnizimi) **juaj!",** më tha: "Ndalo!"

Menjëherë u ngrit në këmbë, mori një deve nga të vetat dhe e theri. Mishin e saj e shpërndau për nevojtarët. Kishte plot nga ata që shkonin e vinin. Pastaj nxori shpatën dhe e theu. Madje copat i hodhi larg. Pastaj u kthye mbrapsht e iku. Kështu përfundoi, kjo histori."

Një herë tjetër, vijon El Asmai, në shoqërinë e Harun Rreshidit, u nisa për të kryer Haxhin në Shtëpinë e Shenjtëruar të All'llahut. Teksa kryeja tauafin, rrotullimin përreth Qabes, më thërret një burrë me zë të dobët. Ktheva kokën, por ç'të shihja? Ishte arabi i shkretëtirës, ai që kisha takuar dikur. Ishte zverdhur e dobësuar shumë. Dukej qartë që e kishte marrë shumë malli. Pasi më përshëndeti me selam, kërkoi t'ia lexoj edhe njëherë suren "Edh Dharijat". Nisa t'ia lexoj. Sapo arrita te ajeti i mësipërm, thërriti fort: "Me të vërtetë, premtimi i All'llahut është i drejtë!"

Më pas më pyeti: "A ka ajet tjetër, pas këtij?!"

I thashë, po, dhe lexova ajetin: **"Betohem në Zotin e qiellit dhe të Tokës, se kjo** (që iu premtohet) **është e vërtetë!"**.

Dëgjoi me kujdes, por, sërish thirri me të madhe: "Lavdi All'llahut të botëve! Çfarë mund ta ketë mërzitur të Madhërishmin, përderisa betohet që të besojnë në Fjalën e Tij?!"[1]

[1] Tefsiri "Kesh'shaf", vëll. 4, f. 400.

2- Ku është Xhenneti?

Siç e kemi përmendur edhe në ajetet e tjera, disa komentues mendojnë se shprehja kur'anore: **"Gjithçka ju është premtuar!"**, nënkupton Xhennetin. Ata kanë thënë se prej këtij ajeti mund të kuptojmë se Xhenneti është në qiell, por ky mendim, nuk është në harmoni e nuk përputhet me kuptimin e ajetit tjetër, i cili flet për Xhennetin. All'llahu i Madhëruar, thotë: **"Xhennet, me sipërfaqen e qiejve dhe të Tokës!"**.[1]

Ashtu siç thamë dhe më lart, komentimi i fjalisë: **"Gjithçka ju është premtuar!"**, nuk është mirargumentuar, madje ai ka mundësi të jetë tregues i riskut (furnizimit të All'llahut) dhe dënimit që vjen nga qielli.

Edhe pse në ajetin 15 të sures "En Nexhm" është përmendur se Xhenneti i Banueshëm është në qiell, pranë Sidreti Munteha, ky fakt nuk përbën argument në këtë kuptim, pasi Xhenneti i Banueshëm është vetëm një pjesë e kopshteve të Xhennetit, jo i gjithë Xhenneti.

3- Përfitimi prej argumenteve të All'llahut, ka nevojë për gatishmërinë dhe përkushtimin e njeriut me parime

Kur ajetet kur'anore flasin rreth të fshehtave të krijimit dhe argumenteve për ekzistencën e All'llahut, shpesh shoqërohen edhe me një formë të caktuar kushtëzimi:

Në këto ajete, thuhet:

[1] Sure "Ali Imran", ajeti 133.

"Argumente për një popull që dëgjon." (Sure "Junus", ajeti 67.)

Dhe: **"Për një popull që mendon!"** (Sure "Err Rra'ad", ajeti 3.)

Dhe: **"Për çdo durimtar të madh dhe falënderues!"** (Sure "Ibrahim", ajeti 5.)

Dhe: **"Për një popull që beson!"** (Sure "En Nahl", ajeti 79.)

Dhe: **"Këto, me të vërtetë, janë shenja për ata që janë mendarë!"** (Sure "Ta Ha", ajeti 54.)

Dhe: **"Këto janë njëmend shenja bindëse për ata, që i kuptojnë ato!"** (Sure "El Hixhr", ajeti 75.)

Dhe: **"Argumente për të diturit!"** (Sure "Err Rrum", ajeti 22.)

Dhe ajeti në fjalë që thotë: **"A nuk e shihni vallë?!"**.

Gjithçka që përmendëm më lart, ka për synim të tregojë se argumentet e All'llahut në Tokë dhe te ju, janë të qarta e të kuptueshme, sidomos për atë kategori njerëzish që gëzon vetëdije të mprehtë. Të gjitha shprehjet tregojnë qartë se përfitimi prej ajeteve të zbritura në Tokë, të cilat janë të pafundme, dëshmojnë për ekzistencën e Qenies së Tij të Shenjtë. Prandaj, nevojitet, si fillim që, njeriu të jetë i gatshëm për t'i pranuar ato, siç janë: shikimi i mprehtë, veshë dëgjues, mendje të hapur, zemër të mençur, shpirt të përgatitur, e natyrisht, i dëshiruar për të pranuar të vërtetat e mëdha. Po të mos ekzistonin këto parapërgatitje e kushte për pranimin e të vërtetës, mund të ndodhë që njeriu të jetojë për vite me radhë, rrethuar prej këtyre argumenteve. Kështu që, qëndrimi i tij është si shembulli i kafshëve, interesimi i vetëm i të cilave është ushqimi i tyre.

4- Risku, furnizimi, është hak i vërtetë

Në grupimin e dukurive, funksionimi i të cilave diktohet prej një rregulli jashtëzakonisht të saktë, është dhe çështja e riskut, ashtu si bëhet e qartë dhe e ditur në ajetet e mësipërme.

Është e vërtetë se përfitimi prej të mirave materiale të kësaj bote është i kushtëzuar me punën, përpjekjen, seriozitetin dhe durimin, se dembelizmi e plogështia janë arsyet kryesore të varfërisë dhe të prapambetjes për këtë botë. Nga ana tjetër, është shumë e gabuar të mendojmë se të mirat materiale të njeriut shtohen duke punuar pa pushim, duke bërë bashkë të lejuarën me të ndaluarën, me qëllim që të arrihet gjithçka që do, se këto të mira pakësohen, kur njeriu ngrihet mbi nevojat dhe luksin e kësaj dynjaje.

Po t'u kthehemi haditheve islame, do të përballemi me terma interesantë. Kështu në një hadith, transmetuar prej Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, lexojmë: "*Nuk ka asnjë mundësi që riskun të mundet ta sigurojë vetëm përpjekja, ashtu sikur nuk ekziston mundësia që riskun të mund ta largojë dikush që të urren!*".[1]

Në një tjetër transmetim, prej Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*, ku një prej shokëve të tij ka kërkuar këshillë prej tij, ai i është përgjigjur: "*Përse duhet të shqetësohesh, kur e di që riskun e ke të përcaktuar?!*".[2]

Përmendja e këtyre haditheve nuk ka për qëllim të ftojë njeri për të hequr dorë ndaj përpjekjeve, punës dhe mundit. Këto

[1] Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 5, Hadithi 32, f. 126.
[2] Burimi i mëparshëm, Hadithi 33.

kanë si qëllim t'u tregojë njerëzve që mendojnë se riskun e shton ose e pakëson, vetëm sasia dhe cilësia e përpjekjeve të tyre, se risku është i siguruar.

Këtu shfaqet një tjetër urtësi, që meriton të ndalemi, pasi ajo konsiston në faktin se transmetimet islame përmendin shumë çështje, të cilat bëhen shkak, që risku të shtohet dhe të tjera që bëhen shkak, që ai të pakësohet. Secila prej këtyre çështjeve është e rëndësishme në vetvete.

Në një transmetim të Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)* lexojmë: "*Betohem në Atë që e ka dërguar gjyshin tim Profet të fesë së vërtetë, se All'llahu i Lartësuar e furnizon robin e Tij sipas nderit. Furnizimi që i dërgohet nga qielli është i lidhur me ashpërsinë e fatkeqësisë!*".[1]

Po prej tij, citohet: "*Shmangia e keqbërjes dhe e zhurmës, e shtojnë rizkun!*".[2]

Prej Profetit të Islamit, Muhammedit *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, transmetohet: "*Teuhidi, Njësimi i All'llahut, është gjysma e fesë e bashkë me dhënien e sadakasë, ato bëhen shkak për zbritjen e riskut!*".[3]

Ka shumë forma e mënyra të tjera, të cilat, gjithashtu, përmenden si shkaqe për shtimin e riskut. Disa prej tyre mund të jenë, për shembull: pastrimi i shtëpisë, larja e enëve, etj.

[1] Burimi i mëparshëm, Hadithi 31, f. 125.
[2] Burimi i mëparshëm, Hadithi 35, f. 126.
[3] Burimi i mëparshëm, Hadithi 37.

Ajetet 24 - 30

هَلۡ أَتَىٰكَ حَدِيثُ ضَيۡفِ إِبۡرَٰهِيمَ ٱلۡمُكۡرَمِينَ٢٤ إِذۡ دَخَلُواْ عَلَيۡهِ فَقَالُواْ سَلَٰمٗاۖ قَالَ سَلَٰمٞ قَوۡمٞ مُّنكَرُونَ٢٥ فَرَاغَ إِلَىٰٓ أَهۡلِهِۦ فَجَآءَ بِعِجۡلٖ سَمِينٖ٢٦ فَقَرَّبَهُۥٓ إِلَيۡهِمۡ قَالَ أَلَا تَأۡكُلُونَ٢٧ فَأَوۡجَسَ مِنۡهُمۡ خِيفَةٗۖ قَالُواْ لَا تَخَفۡۖ وَبَشَّرُوهُ بِغُلَٰمٍ عَلِيمٖ٢٨ فَأَقۡبَلَتِ ٱمۡرَأَتُهُۥ فِي صَرَّةٖ فَصَكَّتۡ وَجۡهَهَا وَقَالَتۡ عَجُوزٌ عَقِيمٞ٢٩ قَالُواْ كَذَٰلِكِ قَالَ رَبُّكِۖ إِنَّهُۥ هُوَ ٱلۡحَكِيمُ ٱلۡعَلِيمُ٣٠

“A e ke dëgjuar historinë e mysafirëve, të nderuar, të Ibrahimit?”

“Ata hynë tek ai, e thanë: ‘Paqe!’ Ai u tha: ‘Paqe, o njerëz të panjohur!’”

“E pa u vënë re, ai shkoi te njerëzit e shtëpisë dhe solli një viç të majmë.”

“Pastaj, ua ofroi atyre e, u tha: ‘A nuk po hani?!’”

“Dhe ndjeu frikë prej tyre, por ata i thanë: ‘Mos u frikëso!’ e i dhamë lajmin e mirë për një djalë të dijshëm.”

“Atëherë, erdhi gruaja e tij, që, duke thërritur dhe rrahur fytyrën tha: ‘Vallë, a mundem (të lind) **unë, plaka sterile?!’”**

"Ata thanë: 'Kështu ka qenë vullneti i Zotit tënd. Ai është vërtet i Urtë dhe i Gjithëdijshëm!'"

Komentim

Miqtë e Ibrahimit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të)*

Nisur nga ky e ajetet në vazhdim, Kur'ani trajton historinë e Profetëve të kohëve të kaluara, Profetët e dërguar te popujt e hershëm. Këto histori vijnë në mbështetje dhe përkrahje të çështjeve të trajtuara më parë, si dhe përmbajtjeve të tyre. Çështja e parë që ky ajet kur'anor thekson, është historia e engjëjve që All'llahu i Madhëruar dërgoi për të dënuar popullin e Lutit dhe që u ndalën te Profeti Ibrahim *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, duke u shfaqur në formën e njerëzve. Ata erdhën për t'i dhënë atij lajmin e madh, erdhën për t'i komunikuar vendimin që All'llahu kishte marrë, për t'i dhuruar një fëmijë, edhe pse kjo gjë dukej biologjikisht e pamundur, sepse Profeti Ibrahim *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* ishte në moshë të shkuar dhe gruaja e tij plakë e kishte të pamundur, fzikisht, të sillte në jetë një fëmijë.

Nga njëra anë, dhurimi i një fëmije nga All'llahu, për Profetin Ibrahim *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* dhe për bashkëshorten e tij plakë, që e kishte biologjikisht të pamundur të sillte një fëmijë në jetë, tregon dhe vërteton qartë edhe njëherë, se

qenia e riskut, e begative të tjera të All'llahut janë të mirëpërcaktuara prej Tij, që në fillim të herës. Këtë e kemi përmendur në ajetet e mësipërme.

Nga ana tjetër, ky është një tregues i qartë dhe i rëndësishëm që shpalos fuqinë dhe mundësinë e pakufizuar të All'llahut të Madhëruar. Këtu shfaqen të tjera argumente, të cilat duhet ta orientojnë njeriun kah Krijuesi i Gjithësisë. Ashtu si e kemi trajtuar në ajetet dhe argumentet e mëparshme.

Parë nga një këndvështrim i tretë, në këto ajete dëshmohet që popujt besimtarë janë nën mbrojtjen dhe përkujdesjen e vazhdueshme të All'llahut të Madhërishëm. Ajetet e mësipërme flasin përreth dënimit që All'llahu rezervoi për popullin e Lutit, sikur, në të njëjtën kohë, janë mesazhe që kërcënojnë për dënim hyjnor të gjitha kategoritë e kriminelëve.

Që në fillim, vëmë re se All'llahu i Madhëruar i drejtohet Profetit të Tij duke i thënë: **"A e ke dëgjuar historinë e mysafirëve, të nderuar, të Ibrahimit?"**.[1]

Lidhur me përdorimin e fjalës *"mukremin" - "të nderuar"*, ka dy mundësi. Mundësia e parë është se këta engjëj të jenë të dërguar nga ana e All'llahut të Madhëruar, ashtu si përmendet në ajetin 26 të sures "El Enbija": **"Vërtet, ata janë rob të nderuar të All'llahut!"**.

[1] Fjala *"ed dajfu" - "miku"* ka rol cilësues këtu. Ajo përdoret edhe në njëjës, edhe në shumës. Për këtë arsye, miqtë u cilësuan si të nderuar. Disa komentues mendojnë se kjo fjalë është rrënjë që nuk ka shumës. Ky mendim, nuk duket të jetë i drejtë. Zamakhshariu, në librin e tij "El Keshshaf", thotë se, në origjinë, ajo ka qenë rrënjë, ndaj kur kuptimi i saj mori natyrë cilësore, ajo u përdor njëkohësisht edhe në njëjës, edhe në shumës. Vini re me kujdes!

Ndërsa mundësia e dytë është që të jenë cilësuar si të tillë, ngaqë Profeti Ibrahim *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* i priti dhe nderoi. Ose dhe të dyja mundësitë bashkë.

Më pas Kur'ani e përshkruan gjendjen e tyre: **"Ata hynë tek ai, e thanë: 'Paqe!' Ai u tha: 'Paqe, o njerëz të panjohur!'"**.[1]

Disa komentues kanë thënë se fjalia që tregon se ata janë njerëz të panjohur, nuk është deklaratë e Profetit Ibrahim *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, por është vetëm një pohim që ai e ka përmendur mes tij dhe vetes, pasi një pohim i tillë me zë të lartë, nuk përshtatet me normat e mirësjelljes dhe të mikpritjes.

Ndodh që ashtu si thonë edhe zakonet, mikpritësi t'i thotë mikut, nuk më kujtohet ku jemi takuar më parë, apo më dukesh si i panjohur, etj.

Nisur nga sa u përmend, mund të themi se komenti i përgjithshëm i ajetit është korrekt, pasi Profeti Ibrahim *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* e ka shprehur qartë këtë, pavarësisht se mundësia e parë nuk është larg të vërtetës, veçanërisht kur shohim se miqtë nuk iu përgjigjën kësaj shprehjeje. Po të ndodhte që Profeti Ibrahim *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* ta kishte shprehur qartë një fjali të tillë, atëherë përgjigjja e miqve do të bëhej e domosdoshme.

---

[1] Fjala *"selamen"* - *"paqe"*, vjen në rasën kallëzore, për shkak të një foljeje të nënkuptuar, që e bën kuptimin e ajetit: Ju përshëndesim ju me selam. Ndërsa fjala *"selamin"*, është kryefjalë e një kallëzuesi të nënkuptuar, kuptimi i të cilës është: "Edhe mbi ju qoftë paqja!"; ose "Paqja qoftë mbi ju!" Duket sikur Ibrahimi ka dashur t'i përshëndesë ata me një përshëndetje më të mirë se ajo me të cilën e përshëndetën atë, pasi fjalia emërore nënkupton qëndrueshmërinë dhe vazhdimësinë. Tefsiri "Keshshaf", vëll. 4, f. 401.

Gjithsesi, Profeti Ibrahim *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* i ushtroi mrekullisht të gjitha detyrimet që ia përcaktonte mikpritja. Për këtë arsye, All'llahu i Madhëruar thotë: **"E pa u vënë re, ai shkoi te njerëzit e shtëpisë dhe solli një viç të majmë."**.

Sipas gjuhëtarit Err Rragib, në librin e tij "El Mufredat", citohet se folja "*raga*" - "*shkoi*", e ka rrënjën te fjala "*reug*", e ngjashme me fjalën "*sheuk*", kuptimi i të cilës është *lëvizja me hapa të ngadaltë*, që nuk bëjnë zhurmë. Mënyra e zgjedhur prej Profeti Ibrahim *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, për të lëvizur, lidhet me përpjekjet e tij për të mos e kuptuar miqtë, që ai po përpiqej t'i sajdiste ata, se miqtë mund ta ndalonin për ta bërë këtë, me qëllim që të shmangte shpenzimet e tepërta. Pyetja që lind, është: Cila është arsyeja që Profeti Ibrahim *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* përgatiti aq shumë ushqim?! Një pjesë e komentuesve kanë thënë se miqtë ishin tri persona, ndërsa një pjesë tjetër thotë se ishin dymbëdhjetë. Numri dymbëdhjetë është më i madhi që përmendet prej komenteve, lidhur më këtë çështje.[1]

Përgjigjja e pyetjes së ngritur më sipër, qëndron në faktin se njerëzit bujarë, nuk e përgatisin ushqimin në masën e miqve që vinin për t'i vizituar. Ata përgatisin ushqim edhe për ato që e gatuanin ushqimin, që t'i bashkëngjiteshin sofrës. Ndodhte që ushqimi të gatuhej me bollëk, për arsye të llogaritjes edhe të komshinjve apo të afërmve. Për këtë arsye, nuk mund të themi se gatimi me tepri nga ana e Profetit Ibrahim *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* quhet shpërdorim. Këto zakone janë të njohura edhe në

[1] E shkëputur prej tefsirit "Ruhul Bejan" dhe fundi i tefsirit "Es Safi", fundi i ajeteve, objekt i studimit tonë.

ditët e sotme, pse jo, janë pjesë të ritualeve mikpritëse në disa fise që jetojnë sipas traditave të vjetra.

Fjala *"el ixhlu"*, është e ngjashme me fjalën *"tifun"*, që nënkupton *"pjellën e lopës, viçin"*. Për sa i përket këndvështrimit të disa komentuesve, që kjo fjalë nënkupton qengjin, mendojmë se ky kuptim është tërësisht i papërshtatshëm, pasi nuk është në harmoni me tekstet gjuhësore dhe rregullat e gramatikës. Origjina gjuhësore e kësaj fjale është *"el axhele" - "shpejtësi"*, pasi kafsha në këtë kohë e në këtë moshë bën lëvizje të shpeshta dhe të shpejta, kurse, pasi rritet, këto veprime dalëngadalë shuhen.

Fjala *"es semijn"*, nënkupton *"viçin me shumë mish"*. Përzgjedhja e këtij viçi, ka për qëllim të respektojë mikun, por dhe që të ketë bollëk për të gjithë.

Në ajetin 69 të sures "Hud", është përmendur cilësia e viçit, duke e quajtur *"hanijdh"*, që do të thotë *"i pjekur"*. Edhe pse ajeti, objekt i studimit tonë, nuk përmend asnjë cilësi të këtij viçi, mund të themi se nuk kemi kundërshti mes dy shprehjeve.

Më pas, ajeti tregon rreth Profetit Ibrahim *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* dhe mikut të tij, duke thënë: **"Pastaj, ua ofroi atyre e, u tha: 'A nuk po hani?!'".**

Në fakt, Profeti Ibrahim *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* kujtonte me vete, se miqtë që kishin urdhëruar, ishin prej gjinisë njerëzore. All'llahu i Madhëruar thotë: **"Dhe ndjeu frikë prej tyre..."**.

Arsyeja pse Profeti Ibrahim *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* u frikësua, është se jo vetëm në ato kohë, por dhe në kohët e sotme, ka qenë dhe mbetet shumë i prekshëm zakoni i besës. Që do të

thotë se, kur një njeri të ka ngrënë bukën, ai është në besën tënde dhe ti je në besë të tij. Pra, njerëzit, në përgjithësi, nuk e kanë dëmtuar njëri-tjetrin, nuk e kanë tradhtuar, as e kanë shitur mikun te armiqtë e tij, sidomos kur kanë ngrënë bukën e njëri-tjetrit dhe e kanë ndarë atë mes tyre. Për këtë arsye kur, Profeti Ibrahim *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* vuri re që miqtë nuk kishin ngrënë prej ushqimit që ai kishte servirur në sofër, nisi të dyshojë, mos vallë, nuk e pranonin miqësinë e Ibrahimit, se mund të kishin ardhur për qëllime të liga e të dyshimta. Një shembull prej botës arabe, thotë kështu: "Ai që nuk ta ka ngrënë ushqimin, nuk ta ka siguruar jetën!"

Fjala *"el ijxhas"* vjen prej fjalës *"uexhese"*, sinonim i fjalës *"mekethe"*, që në origjinalitet ka kuptimin e *"zërit të ulët"*. Nisur nga ky kuptim, ajo është përdorur, gjithashtu, për të nënkuptuar një ndjenjë të brendshme, që fshihet në gjoks. Shpesh, njeriut i duket sikur dëgjon një zë brenda vetes, kur psherëtima unifikohet me fshehtësinë, ajo kthehet në ndjenjë të frikës.

Në këto çaste, ashtu si bëhet e ditur në ajetin 70 të sures "Hud", për ta qetësuar Profetin Ibrahim *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* miqtë i thanë: **"...'Mos u frikëso!' e i dhamë lajmin e mirë për një djalë të dijshëm."**.

Natyrisht, fëmija nuk mund të jetë i ditur që në ditën e lindjes, por është e mundur që ai të përgatitet që në fillim të jetës, për të qenë në të ardhmen një dijetar i madh. Ky është edhe kuptimi i nënkuptuar prej ajetit, në këtë rast.

Pyetja që lind, është: Cili është ky fëmijë?! Është Is'haku apo Ismaili?! Ka disa mendime lidhur me këtë. Mendimi më i njohur

dhe më i pranuar mes komentuesve të Kur'anit është se kemi të bëjmë me Is'hakun, por duke mos e injoruar plotësisht mundësinë që ai të ishte edhe Ismaili. Duke kujtuar se në ajetin 71 të sures "Hud", All'llahu i Madhëruar, thotë: **"Ne i dhamë lajmin e mirë për Is'hakun!"**, mundësia e dytë bie si e pavërtetë. Nisur sa thamë më sipër, mund të pohojmë me bindje të plotë se gruaja, që do të përmendet në ajetet që vijojnë, është Sara, bashkëshortja e Profetit Ibrahim *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, kurse djali i saj është Is'haku.

Më pas, All'llahu i Madhëruar thotë: **"Atëherë, erdhi gruaja e tij, që, duke thërritur dhe rrahur fytyrën tha: 'Vallë, a mundem** (të lind) **unë, plaka sterile?!'"**.

Në ajetin 72 të sures "Hud", lexojmë: **"Ajo tha: 'Ah! E mjera unë! A mos, vallë, kështu plakë do të lind unë, ndërkohë që edhe burri im është plak?!'"**.

Për sa përmendëm, mund të themi se thirrja dhe ulërima e saj erdhi si rezultat i habisë së madhe, shoqëruar në të njëjtën kohë, edhe prej gëzimit të madh.

Fjala *"sarratin"*, ka si rrënjë fjalën *"es sarru"*, dhe kuptimi i kësaj fjale, në origjinë, është *"shtrëngimi"* dhe *"lidhja"*. Ajo është përdorur, në të njëjtën kohë, për të nënkuptuar ulërimën, zërin e lartë, e grupet njerëzore që pasojnë njëri-tjetrin, për arsye të lidhjes së tyre të fortë.

Kjo fjalë është përdorur, gjithashtu, për të nënkuptuar *erën e ftohtë* (*sarsar*) se ajo e ftoh njeriun, ndërsa fjala *"es suretu"*, është përdorur për të përshkruar një njeri që nuk e ka kryer Haxhin, qoftë ky burrë apo grua. Kjo fjalë është përdorur edhe për të

nënkuptuar mungesën e dëshirës, të njërit prej tyre, për t'u martuar, pasi te martesa ka një lloj ndalese, pengese dhe lidhje këmbësh. Fjala *"sarretun"*, në këtë ajet, nënkupton *"zërin e lartë"*, *"thirrjen"* dhe *"ulërimën"*.

Fjala *"sakketun"*, e ka rrënjën te fjala *"sakkun"*, e ngjashme në formë me fjalën *"shek"*, që nënkupton gjuajtjen *"shuplakën"*, ose *"gjuajtjen e fortë"*. Në rastin konkret, ajo tregon se, kur, gruaja e Profetit Ibrahim *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* e dëgjoi lajmin e mirë, i gjuajti fytyrës me duart e saj, një zakon i njohur i grave prej habisë, prej turpit dhe prej gëzimit të madh.

Nëse i referohemi asaj që është përmendur prej disa komentuesve dhe asaj që përmendet në librin "Sifrut Tekuin", konstatojmë se mosha e bashkëshortes së Profetit Ibrahim *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, në atë kohë, kur erdhi lajmi i mirë, ka qenë diku tek të nëntëdhjetat, ndërsa Profeti Ibrahim *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* i kishte kaluar njëqind vite prej jetës së tij.

Ajeti kur'anor sjell për lexuesin përgjigjen që engjëjt i dhanë asaj: **"Ata thanë: 'Kështu ka qenë vullneti i Zotit tënd. Ai është vërtet i Urtë dhe i Gjithëdijshëm!'"**.

Kjo përgjigje ka si qëllim t'i tregojë gruas së Profetit Ibrahim *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* se pavarësisht moshës tënde të madhe, edhe pse je një grua plakë dhe burri yt është një burrë plak, është urdhër i prerë i All'llahut, i cili duhet të shkojë në vend e të gjejë zbatim, pa asnjë mëdyshje, sepse Ai ka vendosur.

Kështu, krijimi i botës dhe i gjithësisë ishte i lehtë për All'llahun, pasi ka ndodhur, menjëherë, pas urdhrit të Tij: "Bëhu!" dhe është bërë.

Fjalët "*el hakijmu*" - "*i Urtë*" dhe "*el alijmu*" - "*i Gjithëdijshëm*", tregojnë se All'llahu i Madhëruar nuk e ka të nevojshme të njoftohet dhe bëhet me dije që ti je një grua shterpë, plakë dhe burri yt është i vjetër, pasi, Ai, është i mirinformuar për të gjitha këto çështje. Prandaj, arsyeja pse Ai nuk të ka dhënë fëmijë deri në këtë moshë dhe ka vendosur ta dhurojë një të tillë tani, në moshë të plakur, lidhet me urtësinë e vendimeve të Tij.

Është interesant fakti që në ajetin 73 të sures "Hud", All'llahu njofton se engjëjt iu përgjigjën gruas së Profetit Ibrahim *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*: **"Ata** (engjëjt) **thanë: 'A mos vallë, po çuditesh me urdhrin e All'llahut? Mëshira e All'llahut dhe bekimi i Tij qoftë mbi ju, familjen e të Dërguarit. Me të vërtetë, Ai është i Falënderuar dhe i Lavdëruar!'"**.

Ndryshimi ndërmjet këtyre dy shprehjeve është se engjëjt ia thanë gjithçka Sarës. E veçanta e kësaj historie është se një pjesë e këtij komunikimi përmendet në suren "Hud", ndërsa këtu përmendet pjesa tjetër e tij. Në suren "Hud" është folur rreth Mëshirës së All'llahut dhe bekimit të Tij. Kështu që, të dyja këto shprehje përshtaten plotësisht me Qenien e All'llahut.

Në ajetin 30 flitet për dijeninë që All'llahu ka, lidhur me pamundësinë dhe mungesën e gatishmërisë së bashkëshortëve, për të sjellë në jetë një fëmijë. Kjo është një dukuri e natyrshme biologjike, që shkakton shterpësinë e gruas në moshë madhore. Përmendja e dijes së All'llahut, për këtë rast, përshtatet plotësisht. All'llahu është në dijeni të këtij fakti dhe të kësaj pamundësie.

Nëse pyetet: Përse, nuk u dhuroi një fëmijë, gjatë rinisë së tyre?!, përgjigjja është: Këtu, kemi të bëjmë me një urtësi të All'llahut.

I Lavdëruar qoftë Emri i Tij!

Hulumtim

Bujaria e Profetëve

Janë të shpeshta rastet, kur dorështrënguarit dhe koprracët hamendësojnë se bujaria dhe përpjekja për të ndihmuar, është një formë e dorëlëshimit dhe e shpërdorimit, ndërsa koprracia dhe shtrëngimi janë forma të pëlqyera të asketizmit dhe të miradministrimit.

Kur'ani vjen për të shtjelluar të vërtetën e këtij pretendimi, për ajetet e mësipërme dhe për ajetet që shfletuam në suren "Hud". Këto ajete tregojnë se mikpritja, sado e madhe qoftë, për sa kohë ushtrohet brenda normave të logjikës, nuk bie në kundërshtim me Sheriatin, me dispozitat islame. Prandaj, duke qenë se këtë vepër e ka kryer një Profet i Zotit, e shndërron atë në argument që dëshmon se kjo vepër është e pëlqyer, duke e legalizuar si një sjellje të denjë për çdo njeri. Natyrshëm, një mikpritje e tillë, që hap dyert e bujarisë, duke i përfshirë në gostinë e saj të gjithë, është prej zakoneve të njerëzve bujarë dhe të ndershëm.

All'llahu i Madhëruar, për asnjë rast, nuk ka ndaluar të kënaqemi me bukuritë dhe mrekullitë e kësaj bote. Për sa kohë njeriu i ka mundësitë financiare prej hallallit, ashtu si i kishte edhe Profeti Ibrahim *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, nuk ka asnjë pengesë që të veprojë me të njëjtën sjellje, me të cilën u soll Profeti i Zotit, Profeti Ibrahim *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*.

Profeti Ibrahim *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)*, edhe pse konsiderohej prej njerëzve që All'llahu u kishte dhënë prej pasurisë së Tij, nuk harronte për asnjë çast ta kujtonte All'llahun. Zemra e tij nuk ishte e burgosur në qelitë e pasurisë që All'llahu i pati dhënë, sikur ishin të shumtë njerëzit që përfitonin prej pasurisë së tij, pasi ai nuk e mbante gjithçka për vete.

Në ajetin 32 të sures "El' A'araf"**,** All'llahu i Madhëruar thotë: **"Thuaj: 'Kush i ka penguar stolitë dhe ushqimet e këndshme, të cilat Ai i ka krijuar për robtë e Vet?'. Thuaj: 'Ato janë për besimtarë** (dhe të tjerët) **në këtë botë, ndërsa në Botën Tjetër do të jenë vetëm për besimtarët. Kështu ua shpjegojmë Shpalljet njerëzve që dinë.'"**.

Lidhur me këtë aspekt, kemi kryer një hulumtim të hollësishëm, në fund të ajetit 32 të sures "El A'araf"**,** kështu që, për më shumë ndihmë, mund të referoheni atje.

Përktheu: **Vullnet MERJA**

Përmbajtja

Ajetet 33 – 37.....5
Komentimi.....6
Atë ditë do të duken hapur të këqijat.....6
Sure "El Ahkaf".....12
Përmbajtja e sures.....13
Mirësia e leximit të kësaj sureje.....14
Ajetet 1 – 3.....15
Komentim.....16
Kjo botë është ndërtuar mbi baza të vërteta.....16
Ajetet 4 – 6.....19
Komentim.....20
Njerëzit më të humbur.....20
Ajetet 7 – 10.....25
Komentim.....26
Nuk jam i pari Profet!!.....26
Ajetet 11 – 14.....36
Shkaku i zbritjes.....37
Komentim.....40
Kushti i triumfit, besimi dhe palëkundshmëria.....40
Ajetet 15 – 16.....46
Komentimi.....47
O ti, njeri, bëju mirë prindërve të tu!.....47
Hulumtime.....54
Ajetet 17 – 19.....58
Komentimi.....59
Ata që i shkelin të drejtat e prindërve.....59
Hulumtim.....63

Si e devijoi Beni Umeje këtë ajet?.....63
Ajeti 20.....65
Komentimi.....65

Përkorja (zuhdi) dhe kursimet për Jetën Tjetër.....65
Hulumtime.....66
Ajetet 21 – 25.....72
Komentimi.....73
Populli i Adit dhe era shkatërruese.....73
Ajetet 26 – 28.....81
Komentimi.....82
Nuk jeni kurrë më të fuqishëm se populli i Adit.....82
Ajetet 29 – 31.....86
Shkaku i zbritjes.....87
Komentimi.....90
Besimi i një grupi xhindësh.....90
Dy hulumtime.....94
1- Informacioni ndikues.....94
2- Argumenti më i mirë i madhështisë së Kur'anit është përmbajtja e tij.....95
Ajetet 33 – 35.....97
Komentimi.....98
Duro, ashtu sikurse duruan të Dërguarit e vendosur.....98
Hulumtim.....105
Profeti i Islamit ishte shembulli i durimit dhe i qëndrimit të fortë në Rrugën e Drejtë.....105
Sure "Muhammed".....110
Përmbajtja e sures.....111
Mirësia e leximit të sures.....112
Ajetet 1-3.....114
Komentimi.....115
Besimtarët janë ndihmësit e të vërtetës, kurse jobesimtarët janë ndihmësit e të kotës.....115
Ajetet 4 – 6.....121

Komentimi.....122
Në sheshin e luftës duhet vendosmëri.....122
Hulumtime.....130
1- Pozita e lartë e dëshmorëve.....130
2- Qëllimet e luftës në Islam.....133
3- Rregullat e të burgosurve të luftës.....135
4- Skllavëria në Islam.....137
Disa pika:
5- Islami dhe dukuria e skllavërisë.....138
6- A është lënë mënjanë dukuria e skllavërisë?.....139
7- Rruga e dhimbshme e skllavit në të kaluarën.....140
8- Plani i Islamit për lirimin gradual të skllavërisë.....140
Lënda e parë: Mbyllja e burimeve të skllavërisë.....141
Lënda e dytë: Hapja e një dritareje lirie.....142
Lënda e tretë: Ringjallja e personalitetit të skllavit.....146
Lënda e katërt: Marrëdhëniet njerëzore me skllevërit.....147
Lënda e pestë: Vepra më e shëmtuar është shitja e njeriut.....148
Ajetet 7 – 11.....150
Komentimi.....151
Nëse ju ndihmoni, All'llahun (fenë e Tij), Ai ju ndihmon juve.....151
Ajetet 12 – 14.....159
Komentimi.....160
Fundi i besimtarëve dhe i jobesimtarëve.....160
Ajeti 15.....165
Komentimi.....166
Një përshkrim tjetër i Xhennetit.....166
Hulumtime.....168
6- Katër lumenjtë e Xhennetit.....168
7- Ujë i mirë për pije.....169
8- Pije që nuk prishen.....170
9- Përse frutat?.....170
10- Si do të pinë ujë banorët e Xhehennemit?.....170
Ajetet 16 – 19.....171
Komentimi.....172

Janë shfaqur shenjat e Kiametit.....172
A është shfaqja e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* një prej shenjave të afrimit të Kiametit?.....176
Hulumtime.....180
Cilat janë parashenjat e Kiametit?.....180
Ajetet 20 – 24.....187
Komentimi.....188
Ata kanë frikë edhe nga fjala "xhihad".....188
Hulumtim.....194
Kur'ani është libri i mendimit dhe i veprës.....194
Ajetet 25 – 28.....198
Komentimi.....199
A nuk e lexojnë me vëmendje Kur'anin?.....199
Ajetet 29 – 31.....204
Komentimi.....205
Hipokritët njihen nga mënyra e të folurit të tyre.....205
Ajetet 32 – 34.....211
Komentimi.....212
Ata që vdesin duke qenë jobesimtarë, All'llahu kurrsesi nuk do t'i falë.....212
Hulumtim.....215
Faktorët e asgjësimit të sevapit të veprës.....215
Ajeti 35.....217
Komentimi.....217
Paqja poshtëruese!!.....217
Ajetet 36 – 38.....220
Komentimi.....220
Nëse ju i ktheni shpinën, All'llahu do t'ia japë kumtin një populli tjetër.....221
Sure "El Fet'h".....228
Përmbajtja e sures.....229
Mirësia e leximit të sures "El Fet'h".....233
Ajeti 1.....235

Komentimi.....235
Çlirimi, ndihma, fitorja e madhe.....235
Historia e paqes së Hudejbijes.....237
Ndikimet politike, shoqërore dhe fetare të paqes së Hudejbijes.....243
Ajetet 2 – 3.....249
Komentimi.....249
Rezultatet e mëdha të fitores së madhe.....249
Dy hulumtime.....250
1- Përgjigje për disa pyetje të rëndësishme.....250
2- Qëllimi i përmendjes së "ma tekademe" dhe "ma teekhere".....256
Ajeti 4.....259
Komentimi.....259
Zbritja e qetësisë në zemrën e besimtarëve.....259
Çfarë ishte kjo qetësi?!.....260
Hulumtime.....263
1- Qetësia e pashembullt.....263
2- Seria e shkallëve të besimit.....265
3- Dy shtyllat e qetësisë.....266
Ajetet 5 – 7.....267
Komentimi.....268
Një tjetër rezultat i fitores së qartë.....268
Cili është qëllimi i përmendjes së ushtarëve të qiejve dhe të Tokës?.....272
Hulumtim.....273
Cilët janë ata që mendojnë keq për All'llahun?.....273
Ajetet 8 – 10.....277
Komentimi.....278
Pozita e Profetit dhe detyrimet e njerëzve kundrejt tij.....278
Ajetet 11 – 14.....287
Komentimi.....288
Hulumtim.....294
Justifikimi dhe mbulimi i gjynahut, sëmundje e përgjithshme.....294
Ajetet 15 – 17.....298

Komentimi.....299
Të mbeturit pas si përfitues nga rasti.....299
Ajetet 18 – 19.....308
Komentimi.....308
All'llahu është i kënaqur me ata që morën pjesë te Besëlidhja e Riduanit.....308
Hulumtim.....314
Besa dhe veçoritë e saj.....314

Ajetet 20 – 21.....325
Komentimi.....326
Edhe njëherë për mirësitë e Marrëveshjes së Hudejbijes.....326
Hulumtimi.....331
Historia e luftës së Khajberit.....331
Ajetet 22 – 25.....335
Komentimi.....336
Po sikur lufta të kishte ndodhur në Hudejbije?!.....356
Ajeti 26.....346
Komentimi.....346
Arroganca dhe fanatizmi ndaj injorancës, pengesa më e madhe në rrugën e mohuesve.....346
Hulumtim.....352
Çfarë është zelltaria pagane e kohës së injorancës?.....352
Ajeti 27.....355
Komentimi.....355
Ëndrra e vërtetë e Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.....355
Hulumtime.....357
Umreja kaza.....360
Ajetet 28 – 29.....365
Komentimi.....366
"Të ashpër ndaj jobesimtarëve e të mëshirshëm midis tyre".....366
Dy hulumtime.....377
Hulumtimi i parë: Tregimi i të qënit të sahabëve pa të meta!.....377
Hulumtimi i dytë: Shkëmbimi i dashurisë islame midis tyre.....383
Sure "El Huxhurat".....386

Përmbajtja e sures "El Huxhurat".....387
Mirësitë e leximit të kësaj sureje.....389
Ajetet 1 – 5.....390
Shkaku i zbritjes.....391
Komentimi.....395
Normat e sjelljes në prani të Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.....395
Hulumtime.....404
1- Edukata, vlera më e çmuar.....404
2- Ngritja e zërit tek varri i Profetit Muhammed *(Paqja e bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.....408
3- Disiplina islame është për çdo punë dhe për çdo vend.....410
Ajetet 6 – 8.....415
Shkaku i zbritjes.....416
Komentimi.....419
Mos i jep rëndësi lajmeve të njerëzve të shthurur.....429
Hulumtime.....429
1- Udhëzimi i All'llahut dhe liria e zgjedhjes.....430
2- Udhëheqësi dhe bindja ndaj tij.....430
3- Besimi është një formë e dashurisë dhe jo vetëm perceptim i trurit.....431
Ajetet 9 – 10.....432
Shkaku i zbritjes.....433
Komentimi.....434
Besimtarët janë vëllezër.....434
Dy hulumtime.....437
Hulumtimi i parë: Kushtet për shpalljen e luftës ndaj sulmuesve *(el bugat)*.....437
Hulumtimi i dytë: Rëndësia e vëllazërisë islame.....441
Ajetet 11 – 12.....445
Shkaku i zbritjes.....446
Komentimi.....448

Tallja, dyshimi, përgojimet, spiunllëku dhe llagapet e shëmtuara janë haram!.....448
Hulumtime.....458
1- Siguria e plotë shoqërore.....458
2- Mos spiunoni!.....461
3- Përgojimi është prej gjynaheve më të rënda dhe më të mëdha...462
4- Kuptimi i përgojimit.....466
5- Ilaçi i përgojimit dhe pendesa prej tij.....468
Rastet e përjashtimeve.....470
Ajeti 13.....472
Komentimi.....472
Devotshmëria (takvaja), është vlera më e shtrenjtë njerëzore.....472
Dy hulumtime.....475
1- Vlerat e vërteta dhe vlerat e pavërteta.....475
2- Realiteti i devotshmërisë.....482
Ajetet 14 – 15.....488
Shkaku i zbritjes.....489
Komentimi.....490
Dallimi ndërmjet Islamit dhe besimit.....490
Ajetet 16 – 18.....495
Shkaku i zbritjes.....496
Komentimi.....496
Mos e shisni Islamin si ndonjë nder të ofruar ndokujt!.....496
Sure "Kâf".....503
Përmbajtja e sures "Kâf".....504
Mirësia e këndimit të sures "Kâf".....505
Ajetet 1 – 5.....507
Komentimi.....508
Mohuesit kokëfortë janë të turbullt.....508
Ajetet 6 – 11.....516
Komentimi.....517
Shikojeni qiellin për një moment!.....517
Ajete 12 – 15.....522

Komentimi.....523
Nuk jam i vetmi që po sprovohem me armik.....523
Ajete 16 – 18.....528
Komentimi.....528
Regjistrimi i të gjitha fjalëve.....528
Hulumtim.....537
I dashuri është më pranë njeriut sa vetja e tij.....537
Ajete 19 – 22.....541
Komentimi.....541
Ringjallja dhe shikimi i mprehtë.....541
Hulumtime.....550
1- E vërteta e vdekjes.....550
2- Agonitë e vdekjes.....553
3- Vdekja është Hak (e vërtetë).....554
Ajetet 23 – 30.....557
Komentimi.....558
Shoqëruesit e njeriut janë prej engjëjve dhe djajve.....558
Ajetet 31 – 37.....571
Komentimi.....572
Ju, të devotshmit, hyni në Xhennet!.....572
Ajetet 38 – 40.....585
Komentimi.....586
Krijuesi i qiejve dhe i tokës është në gjendje të ringjallë të vdekurit.....586
Hulumtim.....593
Durimi është çelësi i çdo shpëtimi.....593
Ajetet 41 – 45.....595
Komentimi.....596
Të gjithë dalin të gjallë, sa dëgjojnë thirrjen e Ditës së Gjykimit!....596
Sure "Edh Dharijat".....602
Përmbajtja e sures "Edh Dharijat".....603
Mirësia e leximit të kësaj sureje.....604
Ajetet 1- 6.....605

Komentimi.....606
Betohem në furtunat dhe në retë që e shpërndajnë pluhurin.....606
Ajetet 7 – 14.....612
Komentimi.....613
Betohem në qiellin e stolisur me yje.....613
Ajetet 15 – 19.....622
Komentimi.....623
Shpërblimi i All'llahut për ata që kërkojnë falje në agim.....623
Hulumtime.....630
1- Drejtimi kah All'llahu dhe kah krijesat e All'llahut.....630
2- Zgjimi në zemër të natës, është sjellja e të dashuruarve.....631
3- E drejta e lypësit dhe e drejta e nevojtarit.....633
Ajetet 20 – 23.....635
Komentimi.....636
Argumentet e All'llahut dhe ndikimi i tyre në qenien tuaj.....636
Hulumtime.....646
1- Historia interesante dhe frymëzuese e El Asmaiut.....646
2- Ku është Xhenneti?.....648
3- Përfitimi prej argumenteve të All'llahut, ka nevojë për gatishmërinë dhe përkushtimin e njeriut me parime.....648
4- Risku, furnizimi, është hak i vërtetë.....650
Ajetet 24 – 30.....652
Komentim.....653
Miqtë e Ibrahimit *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të)*.....653
Hulumtim.....662
Bujaria e Profetëve.....662

ألأمثل فى تفسير كتاب الله المنزل

مؤلف: العلامة الفقيه المفسر ناصر مكارم الشيرازى

الجزء الرابع و العشرون

تيرانا: 2020

نام کتاب: الامثل فی تفسیر کتاب الله المنزل (جزء بیست و شیشم)

نویسنده: فقیه مفسّر حضرت آیة الله العظمی ناصر مکارم شیرازی (دام ظلّه)

ترجمه به زبان آلبانی: ادموند عبازی و وُلْنَتْ مِرْيَا

زیر نظر: وُلْنَتْ مِرْيَا

ویرایش: یریدا کولا

تصحیح ادبی: ویولسا کارای

صفحه بندی و جلد: صبریه فزا

ناشر: جمعیت "نسیم"

چاپ: انتشارات "لیلو"

تیرانا: 2020